FLETORJA ZYRTARE
E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 31

Tiranë – E premte, 24 shkurt 2023

PËRMBAJTJA

		Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 85, datë 22.2.2023	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Fier, për Njësinë Administrative Fier, të një pjese të truallit të pasurisë nr. 3/656, zona kadastrale 8532, për një ndryshim në vendimin nr. 915, datë 11.11.2015, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, dhe për një shtesë në vendimin nr. 574, datë 28.5.2009, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar.....	2883
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 86, datë 22.2.2023	Për transferimin në pronësi të Bashkisë Mat të një pjese të pasurisë 638/5, me vendndodhje në zonën kadastrale 1325, Njësia Administrative Komsi dhe për një shtesë në vendimin nr. 698, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave.....	2889
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 88, datë 22.2.2023	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030.....	2891
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 89, datë 22.2.2023	Për kalimin te bashkitë Durrës dhe Kamzë të njësive individuale të banimit.....	3037
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 22.2.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike 'Burdullias', Bashkia Berat".....	3039
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 91, datë 22.2.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit "Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh, Bashkia Mallakastër".....	3040
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 92, datë 22.2.2023	Për disa shtesa në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, "Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrënguese ndërkombëtare, të ndryshuara", të ndryshuar.....	3042

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 93, datë 22.2.2023	Për pjesëmarrjen e personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin e NATO-s "FOCOPS", në Detin Mesdhe.....	3064
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 94, datë 22.2.2023	Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe planit të veprimit.....	3065
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 96, datë 22.2.2023	Për miratimin e formatit të aktit administrativ që vendos masën administrative dhe llojin e masave, që përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes	3206

VENDIM
Nr. 85, datë 22.2.2023

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË FIER, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE FIER, TË NJË PJESE TË TRUALLIT TË PASURISË NR. 3/656, ZONA KADASTRALE 8532, PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 915, DATË 11.11.2015, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR, DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 574, DATË 28.5.2009, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "f", 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Fier, për Njësinë Administrative Fier, të një pjese të truallit të pasurisë nr. 3/656, zona kadastrale 8532, me sipërfaqe 1 422 (një mijë e katërqind e njëzet e dy) m^2, sipas formularit dhe planit të rilevimit bashkëlidhur këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e transportit vendor.

2. Në pikën 1, të tabelës nr. 2, që i bashkëlidhet vendimit nr. 915, datë 11.11.2025, të Këshillit të Ministrave, "Për transferimin në pronësi, nga këshillat e qarqeve te bashkitë, të rrjetit të rrugëve rurale dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të ndërmarrjeve të mirëmbajtjes së këtyre rrugëve", të ndryshuar, të dhënat e objekteve të pronës, me emërtimin "Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Rrugëve Rurale të Qarkut Fier", të ndodhura mbi pasurinë nr. 3/656, zona kadastrale 8532, ndryshojnë sipas formularit, planimetrive dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

3. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit që i bashkëlidhet vendimit nr. 574, datë 28.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të Bashkisë Fier, të qarkut të Fierit", të ndryshuar.

4. Bashkisë Fier i ndalohet ndryshimi i destinacionit, tjetërsimi dhe dhënia në përdorim te të tretët i pasurive të përcaktuara në pikat 1 dhe 2, të këtij vendimi.

5. Ngarkohen Bashkia Fier dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE

(Per inventarizimin e pronave te veçanta)

Bashkia Fier

Fusha e perdorimit te Prones: Transport Vendor

Identifikoi: **Erdiola Dhanili,** *Specialiste e Menaxhimit te Pronave*
Hyrisha Taçi, *Specialiste e Menaxhimit te Pronave*

Supervizoi: **Erald Filipi,** *Drejtor i Menaxhimit te Pronave*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)

Aprovoi: **Armando Subashi,** *Kryetar I Bashkise*
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	8532 FR-G-9	3/656	Truall	Fier	1422	168.2	Transport Vendor	Bashkia Fier	Bashkia Fier	Pasuria 3/656 ka siperfaqe totale 1544 m2 sipas karteles se pasurise, prej te ciles 1422 m2 i kalojne ne pronesi Bashkise Fier. Ne kete pasuri ndodhen tre objekte ne pronesi te Bashkise Fier: Objekti Nr. 1 (Zyra) Sip. = 128.0 m², Objekti Nr. 2 (Ofiçine) Sip. = 27.9 m², Objekti Nr. 3 (Tualete) Sip. = 12.3 m²

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : "BASHKIA FIER" **DATE 03.11.2021** **QELLIMI: "REGJISTRIM PRONE"**

VENDNDODHJA
BASHKIA FIER DVASHK / ZVASHK FIER ZONA KADASTRALE 8532 NUMRI PASURISE 3/656 INDEKSI HARTES FR-G-9

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE: TRUALL SIP.PASURISE: 1544m2 SIP. GJURMES SE NDERTIMIT: NUMRI I KATEVE NUMRI I PEMEVE ____

X=464111.05
Y=4511738.14

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=464208.42
Y=4511738.14



PER NDARJE PASURIE:
Parcela 3/656 vijon ne: (Sip. ne KPP=1544m2)
SHPJEGUES
→ Parcela A, S=1422 m2 Pronë e Bashkisë Fier Transferuar me Vendim Nr. 915 dt. 11.11.2015
→ Parcela B, në pronësi SHTET

KUFIRI SIPAS HARTES KADASTRALE
Parcela 3/656, S =1522m2; Parcela A, S =1391m2; Parcela B, S =131m2
KUFIRI SIPAS GJENDJES FAKTIKE
Parcela 3/656, S =1553m2; Parcela A, S=1422m2; Parcela B, S =131m2

X=464111.05
Y=4511672.11

SH 1:500

X=464208.42
Y=4511672.11

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	VERI			3/422		
2	JUG			3/655		
3	LINDJE			3/377, 3/359		
4	PERENDIM			3/460		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT

EMRI : Ing. Gjeo PETRIT JANI
LICENSA : NR. T 1097/1 DATE 25.01.2019
KOMPANIA : PERSON FIZIK
NIPT : L91930004B
NENSHKRIMI / VULA

REALIZOI PER ASHK

SPECIALISTI _____
DVASHK _____
NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI

PERGJEGJESI/DREJTORI_____
NENSHKRIMI / VULA _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:_____

Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;

PERCAKTIMI KUFIRIT:_____

Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA:

Për regjistrimin në pronësi të Bashkisë Fier, të një pjese të pasurisë 3/656, ZK 8532, me sipërfaqe A=1422m^2 si dhe objekteve brenda kësaj sipërfaqe: Objekti Nr. 1 (Zyra) S= 128.0 m^2, Objekti Nr. 2 (Ofiçine) S= 27.9 m^2, Objekti Nr. 3 (Tualete) S = 12.3 m^2, transferuar ne pronesi te saj me Vendim Nr. 915 dt. 11.11.2015.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI_____
NENSHKRIMI _____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

PLANIMETRI E ZYRAVE



SIPERFAQE OBJEKTIT 128.0 m2

Punoi: Erdiola Dhanili

Hyrisha Taço

PLANIMETRI E OFIÇINES



SIPERFAQE OBJEKTIT 27.9 m2

Punoi: Erdiola Dhanili

Hyrisha Taço

PLANIMETRI E TUALETEVE



SIPERFAQE OBJEKTIT 12.3 m2

Punoi: Erdiola Dhanili

Hyrisha Taço

VENDIM
Nr. 86, datë 22.2.2023

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË MAT TË NJË PJESE TË PASURISË 638/5, ME VENDNDODHJE NË ZONËN KADASTRALE 1325, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOMSI DHE PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 698, DATË 16.8.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja "gj", 5, 7 e 8, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Mat të një pjese të pasurisë 638/5, me vendndodhje në zonën kadastrale 1325, Njësia Administrative Komsi, sipas formularit dhe planit të rilevimit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me qëllim për t'u përdorur në fushën e shërbimeve funerale.

2. Pasuria e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit, që i bashkëlidhet vendimit nr. 698, datë 16.8.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Komsi, të qarkut të Dibrës".

3. Bashkisë Mat i ndalohet të ndryshojë destinacionin e përdorimit të pasurisë së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Bashkia Mat dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

Bashkia :Mat

Fusha e përdorimit të pronës: Varreza

Identifikoi: Ajorda Çiba Specialiste e Prones (emer,mbiemer,pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Agim Selita Pergjegjes i Sektorit te Pronave (emer,mbiemer,pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Agron Malaj Kryetar Bashkie (emer,mbiemer,pozicioni zyrtar)

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi I Hartës	Nr.Pasurisë	Lloji I Pronës	Emri I Pronës Adresa	Sip.Totale e Pronës (m2)	Nga sip.Totale:Sa Ndërtesë (m2)	Funksioni për të cilën përdoret prona	Institucioni/Enti me përgjegjësi administrative	Institucioni/Enti i përdoruesi,Statusi juridik I përdorimit	Të dhëna të tjera (Shënime të tjera)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	1325	638/5	Vreshtë	Rrugëve "Batërr"	4156	0	Varreza	Bashkia Mat	Bashkia Mat	

PLAN RILEVIMI PER PUNIME KADASTRALE

PRONARI : SHTET DATE 25/01/2022 QELLIMI: INVENTARIZIM

VENDNDODHJA
BASHKIA MAT DVASHK/ZVASHK: MAT ZONA KADASTRALE: 1325 NUMRI PASURISE : 638/5 INDEX HARTE:K-34-89-(49-A)

TE DHENAT E PASURISE
LLOJI PASURISE:VRESHTE SIP.PASURISE= 13715 m2 SIPERFAQE GJURMES NDERTIMIT= m2 NUMRI KATEVE: NUMRI PEMEVE_____

X=500813.63
Y=4607640.21

KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTARE

X=501287.42
Y=4607640.21

X=500813.63
Y=4607935.71

SH 1:2500

X=501287.42
Y=4607935.71

Nr.	ORIENTIMI	PERDORIMI	TIPI KUFIRIT	KUFITARI	ID/NIPT	SHENIME TE REALIZUESIT
1	**VERI**			**426/6**		
2	**LINDJE**			**938**		
3	**JUG**			**637**		
4	**PERENDIM**			**638/4,638/3,837**		

REALIZOI PER SUBJEKT PRIVAT
EMRI: _____
LICENCA: NR._____ DATE _____
KOMPANIA:_____
NIPT:_____
NENSHKRIMI/VULA _____

REALIZOI PER BASHKINE MAT
SPECIALISTI HARTOGRAF MEVLUD DAÇI
ING. MEVLUD DAÇI
NENSHKRIMI _____

KONFIRMOI
KRYETARI BASHKISE MAT
AGRON MALAJ
NENSHKRIMI _____

TEKNOLOGJIA E MATJEVE:_T-Terren; O-Ortofoto; Z-Zyre
Kode per teknologjine e matjeve: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash;
PERCAKTIMI KUFIRIT:_PB-Perfaqesues Bashkie
Kode per percaktimin e kufirit:P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale;

SHENIME TE VECANTA: Sipërfaqja S1 prej 4156 m2, pjesë e pasurisë 638/5, kërkohet ti kalojë në pronësi Bashkisë Mat.

PRONARI/BASHKEPRONARET-DEKLARIM MBI MARREDHENIET ME KUFITARET

EMRI_____
NENSHKRIMI_____

Kode per teknologjine e matjeve dhe percaktimi kufirit: T-Terren; Z-Zyre; O-Ortofoto; G-GPS; S-Stacion Total; D-Matje Distancash; P-Përfaqësues i Pronarve; K-Kufitarët të Gjithë; KP-Kufitarët Pjesërisht; PB-Përfaqësues Bashkie, HK-Harta Kadastrale

VENDIM
Nr. 88, datë 22.2.2023

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022–2030, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet qendrore, të përmendura në strategji, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STRATEGJIA KOMBËTARE PËR ZHVILLIM DHE INTEGRIM EVROPIAN 2022–2030

SHKURTIMET

AASF	Programi i Mbështetjes së Agrobiznesit Shqiptar
ADISA	Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara
AFP	Arsimi dhe formimi profesional
AIDA	Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve
AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
ASHDMF	Agjencia Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës
AMSHC	Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
BE	Bashkimi Evropian
BERZH	Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim
BP	Ballkani Perëndimor
BRE	Burime të Rinovueshme të Energjisë
CEDAW	Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave
CFSP	Politika e përbashkët e jashtme dhe e sigurisë së BE-së
CRM	Tregu i Përbashkët Rajonal
ECAA	Zona e Përbashkët Evropiane e Aviacionit
ECTC	Qendra Evropiane Kundër Terrorizmit
EE	Energjia Elektrike
ERRU	Enti Rregullator i Ujit
FARSH	Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë
FATF	Task-Forcë e Veprimit Financiar
GATT	General Agreement on Tariffs and Trade
GCM	Pakti Global për Migracionin
GES	Good Environmental Status
GMIP	Grupi i Menaxhimit të Integruar të Politikave
GRECO	Group of States Against Corruption
IHD	Investimet e Huaja Direkte
ILD	Inspektoriati i Lartë i Drejtësisë
IMO	International Maritime Organization
INSTAT	Instituti i Statistikave
KBU	Këshillat e Baseneve Ujore
KED	Këshilli i Emërimeve në Drejtësi
KPK	Kontributi i Përcaktuar Kombëtar
KKU	Këshilli Kombëtar i Ujit
KLGJ	Këshilli i Lartë Gjyqësor
KLP	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
KPP	Komisioni Shqiptar i Prokurimit Publik
KQZ	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
KVSP	Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike
LIS	Sistem Qendror i Informacionit të Tokës
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MM	Ministria e Mbrojtjes

MBZhR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MD	Ministria e Drejtësisë
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFP	Menaxhimi i Financave Publike
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MB	Ministria e Brendshme
MSA	Marrëveshja e Stabilizim Asociimit
MShMS	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Multinational Geospatial Co-Production Program Topographic Map
NDC	Nationally determined contributions
NECP	Veprimi për Klimën dhe Energjinë
NVM	Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme
NjQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
ODIHR	Office for Democratic Institutions and Human Rights
OECD	Organization for Economic Co-operation and Development
OJF	Organizata Jo-Fitimprurese
OPRC	Mirëmbajtja dhe Rehabilitimi i bazuar në Produktin dhe Performancën
OSSH	One Stop Shops
OSHEE	Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PBA	Programi Buxhetor Afatmesëm
PBB	Prodhimi i Brendshëm Bruto
PKIE	Plani Kombëtar për Integrimin Evropian
PKVR	Plani Kombëtar i Veprimit për Rininë
PPAP	Programi i Përgjithshëm Analitik i Projektakteve
QKB	Qendra Kombëtare e Biznesit
QNOD	Qendra Ndërinstitucionale Operacionale Detare
R&E	Komuniteti Rom dhe Egjiptian
ReSPA	Shkolla Rajonale e Administrimit Publik
RMIT	Reforma e Menaxhimit të Integruar të Tokës
SASPAC	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës
SDM	Strategjia e Drejtësisë për të Mitur
SIGMA	Support for Improvement in Governance and Management
SKE	Strategjia Kombëtare e Energjisë
SKM	Strategjia Kombëtare për Migracionin
SKZHIE	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian
SME	Ndërmarrje të vogla dhe të mesme
SNKK	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit
SNRAP	Strategjia Ndërsektoriale e Reformës në Administratën Publike
SPAK	Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar
SPI	Sistemi i Planifikimit të Integruar
SHKO	Platforma Shërbime Konsullore Online
SHMB	Shërbime të mbështetjes së biznesit

TIK	Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit
TKT	Traktati i Komunitetit për Transportin
TSC	Qendra Ndërkombëtare Kundër Terrorizmit
UN/OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
UNESCO	The United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization
VTMIS	Sistemi i Monitorimit dhe Informacionit të Trafikut të Mjeteve Lundruese
WBIF	Western Balkans Investment Framework
WEF	Forumi Ekonomik Botëror
WISE	Water Information System for Europe
WTTC	Këshilli Botëror i Udhëtimeve dhe Turizmit

PËRMBAJTJA

KUADRI STRATEGJIK
Institucionet Pjesëmarrëse
Përmbajtja dhe Qëllimi i Strategjisë Kombëtare
Arritjet, mësimet e nxjerra dhe nxitësit e ndryshimit
Arritjet në prioritetet e qeverisë
Mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të SKZHI II në vitet 2014-2020
Vizioni për zhvillimin kombëtar të vendit
Shtyllat dhe përparësitë e strategjisë
Sfidat kryesore të strategjisë
Treguesit e nivelit strategjik
Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.
Qëllimi parësor: Integrimi Evropian
DEMOKRACIA E FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE DHE QEVERISJES SË MIRË
Reformimi i sistemit të drejtësisë
Forcimi i të drejtave të njeriut
Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të pronësisë
Forcimi i proceseve legjislative dhe zgjedhore
Politika e jashtme
Menaxhimi i integruar i kufijve
Menaxhimi i migracionit
Mbështetja e diasporës dhe Shqiptarëve kudo në botë
Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit
Fuqizimi i rendit publik, mbrojtjes së vendit dhe përgatitja për rastet e emergjencave civile
Krijimi i një mjedisi mundësues për shoqërinë civile dhe zhvillimin e saj
Qeverisja e mirë, e hapur dhe administrimi publik
Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit
Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore
AGJENDA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK, NDËRLIDHJEN DHE RRITJEN E GJELBËR
Fuqizimi i sistemit financiar dhe politikës monetare
Fuqizimi i financave publike dhe stabiliteti fiskal
Zhvillimi i biznesit dhe tregtisë, mbrojtja e konkurrencës dhe promovimi i investimeve të huaja
Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut

Bujqësia dhe zhvillimi rural
Ekonomia blu
Zhvillimi i turizmit
Ekonomia dhe shoqëria digjitale
Energjia dhe burimet natyrore
Infrastruktura e ndërlidhjeve: transporti dhe telekomunikacioni
Menaxhimi i integruar i ujrave
Furnizimi me ujë dhe kanalizimet
Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor
Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese
Qëndresa dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike
Planifikimi hapësinor, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rajonal
Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit
KOHEZIONI SOCIAL
Arsim cilësor për të gjithë
Sistem i fortë dhe më i aksesueshëm i kujdesit shëndetësor
Rritja e mundësive të punësimit
Fuqizimi i mbrojtjes shoqërore dhe sigurimeve shoqërore
Fuqizimi i rinisë dhe fëmijëve
Fuqizimi i artit, kulturës dhe sporteve
Zbatimi dhe koordinimi
Monitorimi dhe raportimi
Kosto e zbatimit të SKZHIE 2030
Shtojca 1: Lista e dokumenteve strategjikë
Shtojca 2: Lista e treguesve strategjikë të monitorimit

KUADRI STRATEGJIK

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian (SKZHIE) 2022-2030 shtrihet në harkun kohor 2022-2030 dhe vijon zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 (SKZHI II) në të gjitha fushat strategjike të zhvillimit të Shqipërisë dhe procesit të integrimit të saj në Bashkimin Evropian. Në dallim nga ciklet e mëparshme të kuadrit strategjik, SKZHIE 2022-2030 synon të pasqyrojë prioritetet e zhvillimit në një periudhë relativisht më të gjatë kohore, duke konsideruar:

- Harmonizimin e zbatimit të SKZHIE 2030 me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ), pjesë e Agjendës 2030, për të cilat Shqipëria është plotësisht e angazhuar deri në përfundimin e procesit në vitin 2030;
- Ndërtimin dhe zbatimin e një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit;
- Shtrirjen deri në vitin 2030 të disa prej strategjive të rëndësishme sektoriale të miratuara, apo në proces përgatitjeje;
- Përmbushjen e angazhimeve të procesit të integrimit Evropian sipas agjendës së tij dhe dobinë e ndërtimit të një kuadri strategjik afatgjatë që ndihmon procesin e integrimit të Shqipërisë në BE brenda një kornize të qartë e të qëndrueshme strategjike;
- Mbështetjen e procesit të buxhetimit afatmesëm (PBA) duke ndërtuar projeksione afatgjata të shpenzimeve buxhetore për arritjen e synimeve strategjike dhe objektivave të politikave për zhvillimin e vendit.

Duke pasur parasysh shtrirjen kohore të SKZHIE 2022-2030, strategjia përmban objektiva dhe synime të përcaktuara si në periudhën afatgjatë, ashtu dhe të ndërmjetme të shtrira në periudha afatmesme dhe afatshkurtra.

Institucionet Pjesëmarrëse

Procesi i hartimit të SKZHIE 2022-2030 është realizuar përmes angazhimit të një numri të konsiderueshëm institucionesh shtetërore ku përfshihen të gjitha Ministritë e qeverisë shqiptare, institucione të pavarura, agjenci të rëndësishme zbatuese të politikave sektoriale, përfaqësues të qeverisjes vendore dhe aktorë të tjerë të rëndësishëm në proces. Puna për përgatitjen e SKZHIE 2030 është koordinuar nga Agjencia e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC). I gjithë procesi i hartimit të SKZHIE 2030 është shoqëruar me konsultime me palët e interesit, shoqërinë civile, përfaqësuesit e biznesit, akademinë etj. Përgatitja e SKZHIE 2030 është bazuar në një sërë të gjerë dokumentesh strategjikë dhe marrëveshjesh bashkëpunimi, ndër të cilat vlen të përmenden:

- Programi i Qeverisë 2021-2025
- Plani Kombëtar i Integrimit Evropian 2022- 2024
- Dokumentet e Kuadrit Strategjik Kombëtar (Strategjitë Sektoriale dhe Ndërsektoriale, Planet e Veprimit, dokumentet e politikave të miratuara dhe në proces përgatitjeje)
- Dokumenti i Përgjigjes Strategjike IPA III 2021-2024 – Shqipëri (2021)
- Prioritetet e Programit IPA 2021 & 2022
- Agjenda e Gjelbër e Ballkanit Perëndimor
- Plani Ekonomik dhe i Investimeve për Ballkanin Perëndimor 2021-2027

- Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillimin e Qëndrueshëm me Kombet e Bashkuara 2022-2026
- Vendimet e Komitetit të Planifikimit Strategjik
- Raporti Diagnostikues për Sektorin Privat në Shqipëri (Investimet dhe Tregtia), Banka Botërore, Qershor 2022
- Rishikimi Multidimensional i Ballkanit Perëndimor/Nga Analiza në Veprim, OECD 2022 etj.

Përmbajtja dhe Qëllimi i Strategjisë Kombëtare

Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030 është dokumenti kryesor strategjik që jep drejtimet dhe përcakton përparësitë e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik e shoqëror të vendit në rrugën e anëtarësimit të plotë të tij në Bashkimin Evropian përfshirë edhe ndërlidhjen me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm në funksion të arritjes së synimeve të Agjendës 2030 duke përcaktuar vizionin për zhvillimin e demokracisë, zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të vendit gjatë periudhës 2021-2030. SKZHIE 2030 paraqet se si ky vizion do të arrihet përmes politikave dhe përparësive të mëposhtme:

- Nxitjen e ritmeve të zhvillimit të vendit, duke gjeneruar rritje ekonomike të qëndrueshme, përmes një stabiliteti makroekonomik dhe financiar;
- Arritjen e standardeve që u shërbejnë qytetarëve, rritjes së mirëqenies dhe sigurimit të mbrojtjes së të drejtave të tyre;
- Transformimin e Shqipërisë në një vend me standarde, që mundësojnë anëtarësimin në Bashkimin Evropian;
- Ndërtimin e politikave që rrisin konkurrueshmërinë dhe rritjen ekonomike të vendit, krahasuar me vendet e rajonit dhe më tej.

SKZHIE 2030 është pjesë e rëndësishme e Sistemit të Planifikimit të Integruar (SPI) i cili përbëhet nga një sërë parimesh operative që sigurojnë se planifikimi dhe zbatimi i politikave planifikuese të qeverisë të kryhet në mënyrë koherente, efikase dhe të integruar. SPI ka evoluar dhe përfshin dy shtylla bazë për planifikimin strategjik dhe bashkërendimin e politikave në nivel kombëtar:

- Procesin e planifikimit strategjik afatmesëm deri në afatgjatë, shoqëruar me strategji sektoriale, të cilat udhëheqin politikëbërjen në nivel të lartë në përcaktimin e përparësive dhe qëllimeve strategjike kombëtare, dhe,
- Procesin e buxhetimit afatmesëm, ose programin buxhetor afatmesëm (PBA), i cili kërkon që çdo ministri dhe agjenci qeveritare të përgatisë një plan tre vjeçar brenda një tavani të përcaktuar shpenzimesh, për realizimin e objektivave të politikave, si hapa të ndërmjetme për përmbushjen e SKZHIE 2030.

SKZHIE 2030 pararend miratimin e fondeve vjetore të buxhetit të shtetit, duke përcaktuar objektivat e politikave që përfshihen në udhëzimet e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë për përgatitjen e buxhetit nga të gjitha institucionet shtetërore. SKZHIE 2030 është gjithashtu një dokument i rëndësishëm referimi për partnerët e zhvillimit, për harmonizimin e strategjive dhe programeve të zhvillimit e proceseve të integrimit të vendit në BE, me mbështetjen që partnerët ndërkombëtarë i japin Shqipërisë.

Arritjet, mësimet e nxjerra dhe nxitësit e ndryshimit

Në vitin 2016, Qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2015-2020 si dokumenti kryesor i politikës që përmbante vizionin e zhvillimit dhe përparësitë strategjike të Shqipërisë si një

ekonomi me të ardhura të mesme, pjesë e rëndësishme e rajonit, që synon të përparojë nivelin e prosperitetit të qytetarëve duke qenë një "*një demokraci në forcim, në rrugën e saj drejt integrimit në Bashkimin Evropian, me një ekonomi konkurruese, të stabilizuar dhe të qëndrueshme dhe me garanci për të drejtat themelore dhe liritë e njeriut*". Përmbushja e këtij vizioni është kryer duke synuar rritje ekonomike të qëndrueshme, që nuk dëmton mjedisin, e siguruar përmes një stabiliteti makroekonomik në rritje, një mjedisi biznesi më konkurrues dhe novator, dhe përdorimit më të qëndrueshëm të burimeve.

Integrimi në Bashkimin Evropian ka qenë përparësia kryesore kombëtare e SKZHI II, dhe synimi më i rëndësishëm strategjik i vendit, i mbështetur në konsensusin e plotë politik dhe mbështetjen mbarëkombëtare si një qasje përcaktuese për arritjen e një të ardhmeje të qëndrueshme. Objektivi strategjik i sigurimit të qeverisjes së mirë dhe sundimit të ligjit si pjesë e procesit të integrimit në BE është një objektiv ndërsektorial i SKZHIE-së dhe ka mbështetur të gjitha objektivat e tjera strategjike. Procesi i integrimit Evropian, është nxitur nga përparimi dhe përfundimi i shumë reformave komplekse dhe të ndërlidhura, duke përfshirë pesë fusha të identifikuara si prioritete në këtë proces:

- Reforma e administratës publike, institucionet e qëndrueshme dhe një shërbim civil modern, profesional dhe i depolitizuar;
- Forcimi i pavarësisë, efikasitetit dhe llogaridhënies së institucioneve gjyqësore;
- Rritja e luftës kundër korrupsionit;
- Rritja e luftës kundër krimit të organizuar;
- Garantimi i mbrojtjes së të drejtave të njeriut, përfshirë të drejtat mbi pronën.

Anëtarësimi i Shqipërisë në BE, si objektivi kryesor kombëtar dhe qëllimi parësor strategjik për SKZHI II, shënoi arritje me komunikimin e hapjes së negociatave të vendit në mars 2020, duke vijuar me mbajtjen e Konferencës së Parë Ndërqeveritare midis Shqipërisë dhe BE-së më 19 korrik 2022 në Bruksel, si një moment historik në realizimin e aspiratës së popullit shqiptar për të qenë pjesë e familjes Evropiane. Në kuadër të shtyllave prioritare dhe qëllimeve strategjike të SKZHI II, institucionet janë fokusuar në zbatimin e reformës në drejtësi, luftën kundër korrupsionit dhe kundër krimit të organizuar, mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe reformën në administratën publike, të cilat vijojnë të mbeten si prioritete edhe në kuadër të procesit të negociatave.

Reforma në sistemin e drejtësisë është procesi më transformues i realizuar në Shqipëri gjatë zbatimit të SKZHI-II. Sistemi i drejtësisë i është nënshtruar një sërë reformash të thella, në funksion të përmbushjes së standardeve Evropiane në këtë sistem. Përmes miratimit të Ligjit nr. 76/2016 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417/1998 "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", e ndryshuar, Shqipëria filloi zbatimin e reformës në drejtësi. Ndryshimet kushtetuese dhe paketa e ligjeve organike të miratuara në kuadrin e reformës së drejtësisë përmbajnë dispozita të përcaktuara qartë që garantojnë pavarësinë, paanshmërinë, profesionalizmin, integritetin e sistemit gjyqësor, si dhe përmirësimin e mekanizmave llogaridhënës dhe monitorues të funksionimit të saj.

Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit Shqiptar. Institucionet ekzistuese janë modifikuar dhe institucione të reja janë krijuar nga amendamentet kushtetuese dhe ligjet specifike organike të lartpërmendura. Ngritja e institucioneve të reja si dhe vënia në funksionim e institucioneve ekzistuese ka nisur të japë rezultatet e para me goditjet që i janë dhënë krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend.

Tërmeti i Nëntorit 2019, efektet shkatërruese të tij dhe procesi i rindërtimit, si dhe pandemia e Covid-19 krijuan kosto të rënda për ekonominë Shqiptare gjatë vitit 2020. Si pasojë e këtyre dy goditjeve, ekonomia shqiptare, sikurse dhe të gjitha ekonomitë botërore, pësoi tkurrje shoqëruar me efekte negative në zhvillimin e saj e me

pasoja në buxhet, gjë që pasqyrohet edhe në treguesit përkatës që lidhen me zhvillimet makroekonomike apo sektoriale të SKZHI-II. Pandemia e Covid-19 krijoi një tkurrje ekonomike prej rreth 3.5 përqind të PBB gjatë vitit 2020, dhe pjesa më e madhe e rezultateve në treguesit e monitorimit të SKZHI-II nuk lidhet me mungesë progresi në reformat e fushave përkatëse por është pasojë e drejtpërdrejtë e efekteve negative në ekonominë shqiptare nga dy goditjet madhore që vendi kaloi gjatë periudhës 2019-2020.

Arritjet në prioritetet e qeverisë

Platforma qeverisëse gjatë periudhës së zbatimit të SKZHI-II bazohej mbi një vizion të përshpejtimit të rritjes ekonomike, krijimit të vendeve të punës, rikthimit të besimit tek qeveria, çuarjen më përpara të progresit drejt anëtarësimit në BE dhe realizimin e nevojave urgjente të qytetarëve. Realizimi i këtij vizioni u mbështet në miratimin e gjashtë prioriteteve kryesore për qeverinë, të cilat shoqërojnë në vazhdimësi reformat e kryera në këtë periudhë.

Ofrimi i shërbimeve publike novatore, me në qendër qytetarin

Në drejtim të mirëqenies inovative, një ndër gjashtë prioritetet e qeverisë Shqiptare për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik dhe social është transformimi i mënyrës së ofrimit të shërbimeve në Shqipëri përmes qasjes me në qendër qytetarin. Kjo mishërohet në Strategjinë Ndërsektoriale të Reformës në Administratën Publike 2018 - 2022, e cila përbën kuadrin e përgjithshëm për modernizimin dhe transformimin e institucioneve dhe praktikave të administratës publike në vend. Në këtë kuadër, në vitin 2014 u ndërmor një reformë që synon përmirësimin rrënjësor të përvojës së qytetarëve sipas parimit: qytetari në qendër. Vizioni i kësaj reforme bazohej në tre shtylla kryesore:

- Përmirësimi i aksesit në shërbimet publike;
- Përmirësimi i cilësisë së shërbimeve;
- Përmirësimi i transparencës dhe eliminimi i korrupsionit.

Portali e-Albania, menaxhuar nga Agjencia Kombëtare e Shoqërisë së Informacionit (AKSHI), vepron si një pikë e vetme për ofrimin e shërbimeve publike të institucioneve qeveritare, duke shërbyer për qytetarët 24/7. Portali, i cili aktualisht ofron 1,226 shërbime elektronike, është i lidhur me Platformën Qeveritare të Ndërveprimit që është arkitektura themelore që lejon ndërveprimin midis 57 sistemeve elektronike të institucioneve publike, duke mundësuar mbi 200 milionë transaksione çdo vit.

Rimëkëmbja dhe konsolidimi financiar i sektorit të energjitikës

Në vitin 2013, Shqipëria përballej me sfida të rëndësishme në sektorin e energjisë elektrike, për shkak të dështimit të privatizimit të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë, i cili trashëgoi një ecuri teknike dhe financiare të përkeqësuar, e më pas u vu në administrim të përkohshëm, duke parandaluar kompaninë të investonte në sistemin e shpërndarjes për një periudhë të gjatë. Kompania ndër vite kishte krijuar një borxh të lartë që kërcënonte të paralizonte të gjithë sistemin energjitik në Shqipëri dhe paraqiste rreziqe fiskale të larta për buxhetin. Humbjet në rrjetin elektrik arritën në gati 46 përqind në 2013, ndërsa normat e arkëtimit kishin rënë, në drejtim të kundërt me pritshmëritë e privatizimit të kompanisë së shpërndarjes, proces i cili përfundimisht dështoi. Situata e krijuar përbënte një sfidë të madhe për qeverinë Shqiptare, së cilës i mbetej të kthente mbrapsht privatizimin e kompanisë, duke transferuar sërish pronësinë e saj në publike dhe transformuar rrënjësisht aktivitetin e kompanisë për të përmbushur kërkesat e konsumatorëve dhe për të përmirësuar performancën e saj financiare.

Në vitin 2018 qeveria Shqiptare miratoi Strategjinë Kombëtare të Energjisë 2018–2030, si dokumenti strategjik kryesor për sektorin e energjisë. Strategjia është në përputhje me synimet e SKZHI-II për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe për të përmbushur angazhimet ndaj komunitetit të energjisë, si dhe për integrimin në

BE dhe marrëveshje të tjera ndërkombëtare, duke rritur sigurinë e furnizimit me energji dhe duke minimizuar ndikimet mjedisore me kosto të përballueshme për qytetarët shqiptarë.

Menaxhimi i integruar i ujit

Strategjia Kombëtare për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore është miratuar nga qeveria në vitin 2018. Duke qenë se Shqipëria është një vend kandidat për pranimin në BE, ajo ka nevojë t'i përqaset përputhshmërisë me një numër të konsiderueshëm të direktivave të BE-së që lidhen me menaxhimin e ujrave. Gjatë periudhës së zbatimit të SKZHI-II, një numër i rëndësishëm direktivash të BE që lidhen me ujin, janë transpozuar në legjislacionin shqiptar.

Përmirësimi i inovacionit dhe konkurrueshmërisë

Gjatë viteve të fundit, një sërë reformash janë ndërmarrë për të ulur barrierat administrative dhe përmirësuar mjedisin e biznesit. Siç konfirmohet nga Renditja e Bankës Botërore për lehtësinë e të bërit biznes, është bërë progres në drejtim të rritjes së aksesit ndaj kredive dhe forcimit të procedurave për zgjidhjen e paaftësisë paguese. Shqipëria u rendit e 82-ta nga 190 vende pjesë e raportit për lehtësinë e të bërit biznes të vitit 2020, duke u renditur më lart se Bosnjë Hercegovina (90) por më poshtë se Maqedonia e Veriut (17), Serbia (44), Mali i Zi (50) dhe Kosova (57).

Regjistrimi i biznesit dhe procesi i aplikimit për licenca janë përmirësuar ndjeshëm duke reduktuar numrin e dokumenteve dhe hapat e nevojshme për shqyrtim. Sipërmarrësit i regjistrojnë bizneset e tyre dhe aplikojnë online për licenca dhe leje në Qendrën Kombëtare të Biznesit, e cila operon si një one-stop-shop.

Në Indeksin e Politikave për NVM-të aksesi në financë evidentohet si një pengesë, veçanërisht për NVM-të lokale. Investimet financohen më së shumti nga burime të brendshme (rreth 80 përqind e investimeve), ndërkohë që vetëm 12 përqind e bizneseve i financojnë investimet e tyre përmes bankave. Financimet përmes institucioneve financiare jobanka mbeten mjaft të kufizuara. Mikrokreditë, qiraja financiare dhe faktoringu janë mjete të disponueshme dhe mbështeten nga një bazë ligjore e konsoliduar, por penetrimi mbetet i ulët. Mikrokreditë përbëjnë dy të tretat e të gjitha kredive nga institucionet financiare jobanka, ndërsa qiraja financiare përbën më pak se 30 përqind të tyre.

Përveç përmirësimeve në mjedisin e biznesit, Shqipëria ka përmirësuar gjithashtu edhe performancën në dimensionin e 'Shërbimeve të mbështetjes së biznesit për NVM-të' të Indeksit të Politikave për NVM-të, i kryer nga OECD. Që prej vlerësimit të fundit në vitin 2016, vlerësimi i Shqipërisë u rrit nga 2.65 në 3.61. Pavarësisht këtij progresi, Shqipëria mbetet ende nën mesataren e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë me 3.89.[1]

Sistemet e menaxhimit të tokës

Në vitin 2011, kishte 388,697 ferma të regjistruara në Shqipëri, me madhësi mesatare të fermës familjare 1.26 ha tokë në pronësi. Sipas të dhënave në vitin 2014, numri i fermave u zvogëlua në 352,315, me një sipërfaqe mesatare prej 1.16 ha tokë për familje fermerësh. Rreth 46 përqind e fermave kishin më pak se 1 ha tokë, dhe 86 përqind më pak se 2 ha. Sipërfaqja e përgjithshme e tokës bujqësore (696,000 ha) përbënte 24 përqind të territorit të vendit. Nga sipërfaqja e përgjithshme bujqësore, 562,000 ha (80 përqind) ishte në pronësi private dhe 134,000 ha (20 përqind) në pronësi publike.

Reforma e Menaxhimit të Integruar të Tokës (RMIT) dhe forcimi i produktivitetit dhe qëndrueshmërisë së përdorimit të tokës për të promovuar zhvillimin është një përparësi kryesore e qeverisë. RMIT konsistoi në

[1] OECD/ETF/BE/BERZH (2019), Indeksi i Politikave për NVM-të: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2019, Vlerësimi i Zbatimit të Ligjit për Biznesin e Vogël për Evropën

riorganizimin institucional dhe plotësimin e bazës ligjore përkatëse, në kuadër të një menaxhimi efiçent të tokës, për të nxitur zhvillimin ekonomik të vendit, duke ngritur ASHK, përmes ligjit përkatës dhe integruar disa institucione në një të vetëm.

Reforma strukturore fiskale

Reforma strukturore fiskale, si një nga prioritetet e qeverisë në SKZHI II, u konsolidua në stabilizimin e financave publike, qëndrueshmërinë makroekonomike, si një nga shtyllat e SKZHI II, si dhe në amortizimin e ndikimit të krizave ndërkombëtare në sistemin financiar të vendit. Pozita fiskale e Shqipërisë u përkeqësua pas krizës globale financiare dhe qeveria ka ndërmarrë hapa të rëndësishëm për të stabilizuar financat publike që nga viti 2013. Pas shlyerjes së një pjese të madhe të detyrimeve të prapambetura ndaj sektorit privat në 2014, defiçiti fiskal fillimisht u zgjerua, në 5.2 përqind të PBB -së (nga 3.1 përqind në 2010). Në një situatë të tillë të pafavorshme, në 2013, qeveria nisi një platformë të reformës ekonomike që synonte përshpejtimin e rritjes ekonomike, krijimin e vendeve të punës, rivendosjen e besimit dhe përparimin e mëtejshëm në integrimin Evropian.

Si rezultat i këtyre reformave, mbështetur nga investimet private dhe ato në projektet kryesore të infrastrukturës e konsumin në rritje ekonomia e vendit u rrit me 4 përqind në 2018. Ritmi i rritjes ekonomike në periudhën 2015-2018 është pasqyruar në një sërë parametrash makroekonomikë në vend. Megjithatë, ekonomia Shqiptare përjetoi dy goditje të forta brenda një harku kohor të shkurtër – tërmetin e nëntorit të vitit 2019 dhe pandeminë Covid-19 gjithë vitit 2020. Viti 2019 shënoi një rritje ekonomike prej 2.1 përqind, krahasuar me rritjen prej 4 përqind të një viti më parë, si pasojë e faktorëve të paqëndrueshëm apo të përkohshëm përgjatë gjithë vitit, por edhe si pasojë e tërmetit, ku PBB reale u tkurr me 0.2 përqind në terma vjetorë në tremujorin e katërt, pas një rritje prej 4.2 përqind në tremujorin e tretë.

Përgjatë vitit 2020 ekonomia globale u përball me vazhdimin e përhapjes së pandemisë Covid-19 dhe me masat shtrënguese të ndërmarra nga autoritetet publike për frenimin e përhapjes. Në Shqipëri, qeveria vendosi kufizime të lëvizjes së lirë që prej muajit mars, për të parandaluar përhapjen e mëtejshme të pandemisë në vend. Shqipëria është veçanërisht e ekspozuar ndaj tkurrjes ekonomike prej pandemisë për shkak se mbështetet fort nga sektori i turizmit dhe për shkak të marrëdhënieve të saj intensive me disa ekonomi të BE-së të prekura rëndë nga pandemia. Rritja ekonomike parashikohet mesatarisht rreth 3.3 përqind në vit përgjatë periudhës afatmesme në vijim 2022-2024.

Mësimet e nxjerra gjatë zbatimit të SKZHI II në vitet 2014-2020

SKZHI-II shtrihet në një periudhë kohore relativisht jo shumë të gjatë (2015-2020), por intensive për sa i përket reformave të ndërmarra dhe sfidave me të cilat është përballur Shqipëria, të cilat vlejnë gjithashtu për të kuptuar dhe nxjerrë mësime të vlefshme për zbatimin e strategjisë kombëtare në të ardhmen. Gjatë kësaj periudhe Departamenti i Zhvillimit dhe Mirëqeverisjes është transformuar dhe fuqizuar në funksion të koordinimit të zbatimit të SKZHI-II dhe strategjive të tjera në bashkëpunim me institucionet e tjera të vendit. Në të njëjtën kohë janë krijuar dhe fuqizuar mekanizma të reja dhe ekzistues për bashkërendimin e politikave, si grupet sektoriale të punës dhe janë ndjekur e zbatuar procese të rëndësishme siç është Agjenda 2030 dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, realizimi i të cilave është koordinuar në vazhdimësi me ecurinë e SKZHI-II. Disa nga mësimet kryesore që dalin nga përvoja e deritanishme lidhen me:

Shtrirjen në kohë. Periudha afro 5-vjeçare e zbatimit të SKZHI-II rezulton si jo optimale për një strategji kombëtare e cila përfshin objektiva dhe reforma të cilat shtrihen gjatë në kohë dhe i kapërcejnë kufizimet e mandateve politike. Shtrirja më e gjatë në kohë e SKZHIE 2030 do të mundësojë krijimin dhe zbatimin e një vizioni afatgjatë për zhvillimin e vendit dhe përfshirjen nën suazën e saj të shumë strategjive sektoriale të cilat e kanë të rëndësishme vizionin afatgjatë, duke ndihmuar njëkohësisht programimin e qëndrueshëm të buxhetit

afatgjatë e objektivave makroekonomikë të vendit si dhe koordinimin e me procesin e integrimit dhe me partnerët ndërkombëtarë.

Koordinimin me Agjendën 2030. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm nisën të funksionojnë si pjesë e Agjendës 2030 pikërisht në kohën që SKZHI-II nisi të zbatohej. Për këtë arsye, ndonëse SKZHI-II përmban referenca për lidhjet midis OZHQ-ve dhe shtyllave kryesore të SKZHI-II, shkalla e harmonizimit midis tyre mund të jetë edhe më e lartë për të sinkronizuar reformat dhe veprimet në kuadër të SKZHI me arritjen e OZHQ-ve. Duke qenë se shtrirja në kohë e Agjendës 2030 përkon me afatin e SKZHIE 2030, ky harmonizim do e bëjë më të lehtë bashkëveprimin për arritjen e rezultateve dhe monitorimin e përparimit të kryer.

Treguesit e monitorimit. Përvoja me treguesit e monitorimit të SKZHI-II tregon se një pjesë e mirë e treguesve lidhen me ecurinë e zhvillimit ekonomik të vendit ndaj do të ishte e dobishme një qasje më e integruar duke balancuar nevojën e pasqyrimit të progresit në aspektin social, të mjedisit apo sektorëve të tjerë të rëndësishëm. Nga ana tjetër, disa prej treguesve të përzgjedhur për monitorimin e SKZHI-II raportohen nga organizata ndërkombëtare, të cilat shpesh ndryshojnë metodologjitë e matjes apo ndryshojnë treguesit e monitorimit, duke e vështirësuar përdorimin e tyre në kontekstin kombëtar, duke pasur parasysh këtu edhe shfazimet në kohë të matjeve dhe raportimit të këtyre treguesve. Duke qenë se në kuadër të fuqizimit të sistemit të statistikave kombëtare është kryer një punë paraprake për të identifikuar treguesit e matshëm në Shqipëri nga treguesit globalë të monitorimit të OZHQ, do të ishte e udhës që tregues të tillë të përdoren sa më shumë të jetë e mundur edhe për monitorimin e ecurisë së SKZHIE 2030, krahas treguesve prioritarë të procesit të integrimit Evropian dhe monitorimit të arritjes së OZHQ-ve. Së fundi, do të ishte e dobishme që raportet e monitorimit të zbatimit të SKZHIE 2030, të ishin periodikë mbi afate të qarta kohore.

Përgjigjen dhe qëndrueshmërinë ndaj rasteve të paparashikueshme. Pasojat e tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë Covid-19 ndryshuan në mënyrë dramatike rezultatet e pritshme të zbatimit të SKZHI-II, veçanërisht në treguesit ekonomikë dhe socialë të zhvillimit të vendit. Nisur nga kjo përvojë, ndërtimi i strategjive komplekse dhe afatgjata siç është SKZHIE 2030, do të ishte më i qëndrueshëm nëse modelet e përdorura do të merrnin parasysh edhe goditje nga faktorë të paparashikueshëm që sjellin pasoja zinxhir në zbatimin e strategjisë.

Nevojën për forcimin e kapaciteteve. Zbatimi i suksesshëm i SKZHIE-së është i pandarë nga trajtimi i strukturës dhe cilësisë së kapaciteteve që kërkohen për zbatimin e politikave, për thithjen në shkallë të konsiderueshme të financimit, për vazhdimin, mbajtjen e ritmit, koordinimin apo funksionimin e reformave në zbatim. Zhvillimi i kapaciteteve të qëndrueshme njerëzore dhe institucionale kërkon një qasje më gjithëpërfshirëse dhe strategjike, dhe se instrumentet e tilla si vlerësimi i ndikimit rregullator, duhen përdorur në bazë më sistematike për të përballur sfidat e anëtarësimit në BE. Në këtë kontekst, vlen të përmendet nevoja për forcimin e kuadrit të koordinimit dhe zhvillimit të politikave dhe politikëbërjes, sidomos në pikëpamje të instrumenteve teknike për të rritur efiçencën e administratës publike, si dhe përfshirjen e qytetarëve në politikëbërje.

Kompleksitetin e strategjisë dhe prioritetet afatshkurtra. Struktura e SKZHI-II shoqëruar nga strategjitë sektoriale ka rezultuar komplekse dhe për më tepër shtrirja në kohë e strategjive të miratuara apo atyre në proces, nuk është e sinkronizuar. Ndonëse numri i strategjive kyçe është zvogëluar, ende mbetet një numër i konsiderueshëm strategjish mbështetëse, programesh afatgjata dhe masterplanesh të cilat duhet të shtrihen përgjatë afatit kohor të SKZHIE 2030. Çështja e kompleksitetit dhe shtrirjes në kohë lidhet edhe me përcaktimin e përparësive të qeverisë, të cilat krahasuar me shtrirjen e SKZHIE-së, janë relativisht më afatshkurtra dhe që jo detyrimisht shtrihen përgjatë një mandati qeverisës. Shembull nga zbatimi i i SKZHI-II është prioriteti qeverisës në fushën e energjisë, i cili ishte një problem tepër i rëndësishëm në fillim të mandatit (dhe zbatimit të SKZHI-II). Por me reformën e shpejtë dhe arritjen e rezultateve, prioriteti në këtë fushë u kthye në normalitet ndërkohë që të tjera prioritete afatshkurtra lindën gjatë zbatimit të strategjisë.

Përfshirjen e dimensionit të zhvillimit vendor. Me kryerjen e reformës administrative dhe territoriale në vitin 2015, roli i pushtetit vendor në Shqipëri vazhdon të forcohet ndërkohë që kompetenca të pushtetit vazhdojnë të transferohen prej atij qendror drejt bashkive në të gjithë vendin. Realizimi dhe zbatimi i SKZHIE 2030 gjatë dekadës së ardhshme do të kërkojë një bashkëpunim dhe koordinim edhe më të mirë me të gjithë aktorët e zhvillimit të vendit, ku njësitë e qeverisjes vendore kanë një rol tejet të rëndësishëm.

Integrimi në BE. Procesi i integrimit në BE përbën një shtysë të rëndësishme ndaj qeverisë dhe të gjithë sektorëve të ekonomisë. Ky nxitës i jashtëm i ndryshimit do të bëhet gjithnjë e më shumë pjesë përbërëse, teksa institucionet shqiptare reagojnë ndaj kërkesave për një efikasitet më të madh në të gjithë kriteret për integrim në BE. Përfitimet e integrimit në BE po shihen si nga qeveria, ashtu edhe nga shoqëria si më të mëdha për nga kostot dhe përshtatjet që duhen bërë.

Qytetari dhe kërkesa. Stimuli kryesor i ndryshimit dhe reformës është përgjigja ndaj kërkesave të qytetarëve për shërbime me cilësi më të mirë, më në kohë, më të sigurta, më të gjindshme, më llogaridhënëse, më transparente dhe më efikase në pikëpamje të kostos. Në qendër të zhvillimit në Shqipëri janë qytetarët, shoqëria civile dhe organizatat e tregut/biznesit në të cilat ata marrin pjesë. Synohet të fuqizohet sistemi ekzistues, duke e shndërruar në një model të ofrimit të shërbimeve me në qendër qytetarin, duke luftuar korrupsionin përmes novacionit dhe modernizimit.

Krizat globale. Efektet e krizave globale, përfshirë pandeminë, krizat financiare apo atë energjitike, si dhe paqëndrueshmëritë rajonale e konfliktet si lufta aktuale në Ukrainë – kanë ndikime afatgjata. Shqipëria do të vijojë të monitorojë, analizojë dhe reagojë ndaj efekteve të jashtme në evoluim, nëpërmjet veprimesh kyçe të politikave dhe strategjive monetare, fiskale dhe të tjera makroekonomike, strategji të cilat do të kenë ndikime që priten të sjellin ndryshime në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.

Energjia, uji dhe ndryshimet klimatike. Detyrimi kombëtar për burime të përballueshme, të qëndrueshme, të gjindshme dhe të sigurta energjitike dhe ujore do të jetë, në periudhën e ardhshme të parashikuar, një nxitës kryesor i ndryshimeve të mëdha dhe zhvillimit në këta sektorë dhe në ata mbështetës.

Teknologjitë e informacionit dhe komunikimit. Futja e TIK-ut në një gamë të gjerë funksionesh të qeverisë ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë një efekt transformues në mënyrën se si funksionon qeverisja, llojet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve, llojet e bizneseve dhe sektorëve të ekonomisë që do të rriten. Bashkë me forma të tjera të ndryshimeve teknologjike dhe të novacioneve, qeveria Shqiptare dhe institucionet e sektorit privat do të duhet jo vetëm të reagojnë ndaj këtyre nxitësve të ndryshimit, por edhe të kërkojnë në mënyrë aktive mundësi për ndryshim, konkurrueshmëri më të madhe dhe rritje ekonomike e zhvillim të përgjithshëm.

Sigurisht, nxitës të tjerë ndryshimi dhe reformash do të faktorizohen në zhvillimin kombëtar të vendit dhe politikat dhe strategjitë e integrimit në Bashkimin Evropian. Këto përfshijnë ndër të tjera ndryshimet demografike, konventa dhe marrëveshje të tjera rajonale dhe globale, dhe ndër të tjera, anëtarësinë në NATO dhe sigurinë kombëtare dhe rajonale.

Vizioni për zhvillimin kombëtar të vendit

Shqipëria 2030: *"Një ekonomi dinamike, pjesë e Bashkimit Evropian dhe rajonit, që ofron kushte të barabarta për rritjen e mirëqenies së të gjithë qytetarëve të saj mbështetur në një demokraci funksionale që garanton të drejtat themelore dhe liritë e njeriut"*

Shtyllat dhe përparësitë e strategjisë

Mbështetur në vizionin për zhvillimin e vendit, duke reflektuar edhe mendimin e grupeve të interesit të përfshira në procesin e konsultimit, SKZHIE 2030 mbështetet në një qëllim parësor që synon integrimin e plotë të vendit në Bashkimin Evropian dhe tre shtylla kryesore:

1. *Demokracia e fuqizimi i institucioneve dhe qeverisjes së mirë;*
2. *Agjenda për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ndërlidhjen dhe rritjen e gjelbër;*
3. *Kohezioni social.*

Këto shtylla, të ndërlidhura me njëra tjetrën në funksion të vizionit afatgjatë dhe integrimit të vendit në BE, dhe të mbështetura në arritjen e objektivave të Agjendës 2030, përbëhen nga një numër sektorësh të ndërlidhur dhe të ndërthurur që i përgjigjen prioriteteve të një politike specifike sektoriale ose më gjerë.

Ato përbëjnë edhe orientimin e politikave strategjike të përshkruara më hollësisht në strategji si dhe politikave sektoriale dhe zbërthimin e tyre në objektiva gjatë hartimit apo rishikimit të dokumenteve strategjikë në zbatim të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2030. Ato trajtohen më në detaje në seksionet vijuese nga pikëpamja e situatës aktuale, sfidave ose risqeve që duhen adresuar, objektivave strategjikë që duhen realizuar dhe treguesve me anë të të cilëve do të matet përmbushja e qëllimeve të politikave përkatëse.

Vizioni "Shqipëria 2030" mbështetet në një qasje gjithëpërfshirëse dhe reformuese që synon të realizojë objektivin më të rëndësishëm kombëtar, integrimin në BE, duke forcuar demokracinë dhe shtetin ligjor, mbështetur zhvillimin e shoqërisë shqiptare dhe transformuar ekonominë e vendit drejt aktiviteteve me vlerë të shtuar në dobi të mirëqenies për të gjithë. Kjo qasje ka në thelb të saj progresin në të gjitha fushat e zhvillimit të vendit dhe veçanërisht në gjashtë të mëposhtmet, të cilat përbëjnë dhe përparësitë kryesore të kësaj strategjie:

Integrimi evropian është synimi politik dhe strategjik më i rëndësishëm i Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit të plotë në të.

Integrimi evropian bazohet jo vetëm në një angazhim të plotë të institucioneve të vendit, por edhe në përfshirjen e të gjithë faktorëve të tjerë të rëndësishëm të shoqërisë shqiptare, si një aspiratë e hershme e mbështetur në një shumicë dërrmuese dhe në mënyrë të vazhdueshme nga të gjithë shqiptarët. Procesi drejt anëtarësimit, dhe më pas, anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesin më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisin konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve të vazhdueshme reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përqasjen me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies dhe sigurisë sociale.

Në thelb të këtij prioriteti qëndron përshpejtimi i plotësimit të kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sipas metodologjisë së re të anëtarësimit, dhe nxitja e progresit në procesin e anëtarësimit dhe zbatimin e reformave drejt BE-së, përmes koordinimit efektiv të procesit të negociatave, koordinimit cilësor të reformave dhe politikave të lidhura me anëtarësimin, rritjes së shkallës së përafrimit të legjislacionit me Acquis dhe progresit në zbatimin e MSA-së, ngritjes së kapaciteteve institucionale, si edhe transparencës dhe komunikimit të procesit ndaj qytetarëve dhe faktorëve të tjerë të rëndësishëm të shoqërisë shqiptare.

Lufta ndaj korrupsionit është një nga shtysat kryesore të reformës në drejtësi dhe arritjet e kësaj reforme kanë dhënë rezultate pozitive në këtë drejtim. Korrupsioni paraqet një sfidë në nivel kombëtar pasi prek shoqërinë në mënyra të ndryshme, duke sjellë pasoja negative si në jetën ekonomike, ashtu edhe në atë sociale të qytetarëve. Në raste të caktuara, korrupsioni ka ndikuar edhe në integritetin e besimin në raport me institucionet shtetërore.

Qëllimet e politikës në strategjinë kundër korrupsionit kanë synuar rritjen e efektivitetit në parandalimin, ndëshkimin dhe ndërgjegjësimin lidhur me korrupsionin.

Modernizimi i shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale, për të siguruar ofrimin digjital të të gjitha shërbimeve të mundshme për qytetarët, si dhe rritjen e cilësisë së shërbimit, si një instrument i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm për parandalimin e korrupsionit ka dhënë rezultate pozitive. Në drejtim të vazhdimit të reformave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit, programi parashikon objektivin e qeverisë për rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet digjitalizimit të sistemit, si dhe zgjerimin dhe fuqizimin e Rrjetit të Koordinatorët Kundër Korrupsionit.

Angazhimi i politikëbërësve drejt një agjende kombëtare antikorrupsion dhe drejt përmirësimit të kuadrit institucional dhe legjislativ në fushën e antikorrupsionit është parësor. Gjithashtu, ekziston nevoja për të forcuar vlerësimin e rreziqeve dhe dobësive ndaj korrupsionit si dhe efektivitetin e mekanizmave për parandalimin.

Lufta ndaj korrupsionit përbën një qasje horizontale e cila përfshin sektorë si transparenca, prokurimet publike, shërbimet elektronike, inspektimet dhe kontrollet financiare në administratën publike, integritetin e autoriteteve publike qendrore dhe vendore, bashkëpunimin e autoriteteve ligjzbatuese si edhe ndërgjegjësimin dhe edukimin e publikut kundër korrupsionit.

Energjia është një sektor prioritar për vendin në përmbushje të agjendës së tij 2030. Energjia është e rëndësishme jo vetëm për të mbështetur zhvillimin vrullshëm e të qëndrueshëm të sektorë të ndryshëm të vendit, për të ofruar një jetë dinjitoze për familjet shqiptare, por edhe një sektor me kontribut të rëndësishëm të drejtpërdrejtë në rritjen ekonomike të vendit.

Shqipëria do të vazhdojë të rrisë kapacitet e gjenerimit të energjisë elektrike bazuar në burime të rinovueshme, kryesisht diell dhe erë. Do të mbështeten dhe lehtësohen investimet private të autoprodhuesve. Do të forcohet infrastruktura e transmetimit të energjisë duke nxitur tregtimin e energjisë në bursën e vendit dhe ato rajonale.

Do të zgjerohet mbështetja për efiçencën e energjisë së sektorin e banesave rezidenciale, në godinat me qëllim publik përdorimi, në përdorimin energjisë elektrike në furnizimin me ujë dhe trajtimin e ujrave të përdorura, në përdorimin e energjisë elektrike në vaditje dhe mbrojtje nga përmbytjet, si dhe në industrinë e lehtë të prodhimit dhe agropërpunimit.

Duke qenë se thuajse e gjithë energjia elektrike e prodhuar në vend bazohet në burime të rinovueshme, me qëllim uljen e varësisë nga ndryshimet klimatike dhe diversikimin e gjeografisë së gjenerimit të energjisë do të kryhen disa investime që rrisin kapacitet gjeneruese të bazuara në lëndë djegëse fosile. Shqipëria nxit zhvillimin dhe konsolidimin e sistemeve energjitike të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe sidomos integrimin e këtyre sistemeve në një treg rajonal energjitik me qëllim jo vetëm përmirësimin e cilësisë së qytetarëve të vendeve respektive dhe të rritjes së konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve por edhe të krijimit të një klime besimi reciprok midis vendeve.

Me gjithë arritjet në përgjysmimin e humbjeve (nga 42 përqind në 21 përqind) në periudhën 2013 – 2022, fakti që një e pesta e energjisë së hedhur në treg ende humbet, dëshmon për nevojën e përmirësimeve të mëtejshme në këtë sektor të rëndësishëm. Sa më sipër do të garantojmë që deri në 2030 vendi të kthehet në një eksportues vjetor neto të energjisë si nga pikëpamja e energjisë së prodhuar/përdorur edhe nga pikëpamja financiare e sektorit, duke u përpjekur që energjia të jetë e përballueshme si për biznesin ashtu edhe për familjet shqiptare.

Bujqësia vazhdon të mbetet një sektor me kontribut të rëndësishëm në ekonominë e vendit dhe sidomos, në angazhimin e njerëzve me punë duke kontribuar kështu në zbutjen e pabarazive ekonomike në vend. Sektori do të vazhdojë të mbështesë nevojat për ushqim të shëndetshëm për familjet shqiptare, nevojat në rritje për ushqim të shëndetshëm e të larmishëm që vijnë edhe nga rritja e ndjeshme në vitet në vijim e kërkesës nga sektori i turizmit. Sektori ka ende potenciale të fjetura që vijnë kryesisht nga përmasa e vogël e fermës

bujqësore prandaj do të vijojmë reformat e nisura të konsolidimit të tokës. Rritja e sektorit rrezikohet nga ndryshimet klimatike dhe mungesa e krahut të punës.

Prandaj, do të vijojë fuqimisht mbështetja e bujqësisë nën strehë, një sistemi dhe modeli të ri të ujitjes dhe kullimit, teknologjive të reja dhe inovacionit duke pasur vëmendje të veçantë në sigurinë ushqimore për shëndetin e qytetarëve dhe për të zgjeruar mundësitë për eksport. Në fshat do të vazhdojë nxitja e zhvillimit rural si plotësues i aktiviteteve të mirëfillta bujqësore dhe blegtorale.

Në periudhën 2013 – 2022 eksportet bujqësore (ku përfshihet edhe peshkimi) janë rritur më shumë se dy herë. Raporti import- eksport nga 5,2:1 ka rënë në 3:1 gjatë kësaj periudhe, por synimi është që në vitin 2030 eksportet bujqësore të arrijnë 1 miliardë USD.

Turizmi jep një kontribut të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit duke qenë edhe një sektor ku ofrohet mundësi për punësim dhe zhvillim të harmonizuar midis rajoneve të vendit. Në periudhën 2013 – 2019 numri i vizitorëve të huaj është rritur me 75 përqind (nga 3,7 milionë vizitorë në 6,4 milionë vizitorë). Sektori u godit fort nga pandemia e Covid 19, por në vitin 2022 pritet një rritje e numrit të vizitorëve duke arritur në rreth 7,4 milionë vizitorë, duke bërë që Shqipëria të jetë një nga 3-4 vendet me kapërcimin më shpejtë të efekteve të krizës së pandemisë.

Në 2030 synohet të arrihet në 10 milionë vizitorë të huaj, mbështetur dhe në rritjen e kapaciteteve akomoduese me cilësi të lartë, përmirësimit të infrastrukturës së transportit rrugor, detar dhe ajror, të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike dhe me ujë të pijshëm, të infrastrukturës së trajtimit të ujrave të përdorura dhe mbetjeve të ngurta. Gjatë dekadës, vendi do të ketë 4 marina dhe tri aeroporte ndërkombëtare për pasagjerë.

Oferta turistike do të akomodohet në ofertën rajonale duke u bazuar në peisazhin natyror, afërsinë e detit me malin, klimën dhe pozicionin gjeografik, trashëgiminë kulturore dhe historike materiale dhe jomateriale, larminë e florës dhe të faunës, mikpritjen karakteristike, ofertën e larmishme e të shëndetshme kulinare ujore dhe tokësore.

Digjitalizimi: Teknologjitë e informacionit dhe telekomunikimit kanë çelur mundësi dhe oportunitete të reja në të gjithë botën të paimagjinueshme disa dekada më parë. Këto teknologji të reja të zhvilluara shumë vrullshëm janë mundësi për më shumë zhvillim, mirëqenie dhe demokratizim, por njëherazi rreziqe që mund të krijojnë hendeqe të reja midis vendeve e civilizimeve të ndryshme apo edhe midis vetë shtresave të ndryshme të shoqërisë së një vendi, duke mbarsur konflikte potenciale sociale apo midis shteteve.

Qasja në informacion të paanë është sot më e lehtë se kurrë, por teprimi me informacion të pasigurtë apo të rremë bart rrezikun e deformimeve zhvillimore, sociale dhe kulturore. Shqipëria ka arritje të ndjeshme, të evidentuara edhe ndërkombëtarisht, në rritjen e mundësive digjitale që ka ofruar në vitet e fundit për sipërmarrjet dhe qytetarët e saj, por që ende është prapa në rezultatet digjitale, sidomos në sektorin privat.

Zhvillimi i sektorit digjital do të mbajë në konsideratë 4 çështje që i konsiderojmë kyçe:

- Rritjen e aksesit në teknologjitë digjitale qoftë nga pikëpamja e penetrimit gjeografik, po ashtu edhe nga pikëpamja e përballueshmërisë financiare;
- Aftësitë digjitale jo vetëm të nxënësve, të rinjve, profesionistëve të sektorit por edhe të popullsisë në moshë madhore;
- Mbrojtjen e të dhënave personale në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian;
- Sigurinë kibernetike në bashkërendim me partnerët tanë strategjikë euroatlantikë.

Zhvillimi digjital do të harmonizohet me parimet e vendosura nga Bashkimi Evropian në rregulloret e tij të reja:

- Akti i Tregjeve Digjitale;
- Akti i Shërbimeve Digjitale;
- Akti i Identifikimit Elektronik dhe Shërbimeve të Besuara 2.0 që parasheh edhe vënien në përdorim të një "portofoli" digjital për çdo individ.

Sfidat kryesore të strategjisë

Demografia

Popullsia e Shqipërisë ka përjetuar tkurrje dhe plakje të konsiderueshme gjatë viteve të fundit. Sipas të dhënave demografike të publikuara nga INSTAT, popullsia e Shqipërisë vazhdon në rënie nga viti në vit për çdo vit gjatë dy dekadave të fundit, përjashtuar vitin 2017 dhe ndërkohë mosha mediane e popullsisë është rritur nga mosha 33.2 vite në vitin 2012, në moshën 38.2 vite në vitin 2022.

Projeksionet e popullsisë, sipas skenarit të mesëm të ndërtuar nga INSTAT-i, tregojnë se deri në vitin 2030 popullsia totale e Shqipërisë do të pakësohet edhe me rreth 86 mijë vetë, në vijim të rënies prej mbi 104 mijë vetë gjatë dekadës së fundit 2012-2021. Zvogëlimi i popullsisë shqiptare gjatë viteve të fundit lidhet me rënien në vazhdimësi në vite të lindjeve të reja, e cila e shoqëruar edhe me lëvizjet migratore sjell një bilanc negativ të shtesës natyrore të popullsisë. Ky proces është shoqëruar dhe me hapjen e plotë të Shqipërisë ndaj botës, lëvizjen e lirë të shqiptarëve kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian, shoqëruar me emigrimin e paligjshëm drejt vendeve ku ende ka pengesa hyrjeje apo qëndrimi.

Migrimi nga zonat rurale dhe qytetet më të vogla drejt zonave kryesore urbane, krahas emigrimit të popullsisë, është një fenomen prezent aktualisht në Shqipëri, si pasojë e urbanizimit dhe mundësive më të mira për strehim dhe punësim që ofrohen në qytetet e mëdha të vendit. Sipas të dhënave të INSTAT-it, rreth 39 mijë persona në vit kanë lëvizur mesatarisht brenda vendit gjatë periudhës 2014-2020.

Faktorët e mësipërm demografikë paraqesin sfida të rëndësishme veçanërisht për tregun e punës në vend por njëkohësisht dhe për konsumin e brendshëm, zhvillimin e biznesit vendas, qëndrueshmërinë e sistemit të pensioneve apo përballjes me problematika të sektorëve specifikë si zhvillimi i bujqësisë, turizmit etj.

Pavarësia Energjitike

Prodhimi i energjisë elektrike gjatë vitit 2021 (8,962 GWh, nga i cili 5,343 GWh prodhuar nga kompania publike) e tejkaloi konsumin e energjisë për të njëjtën periudhë (8,415 GWh). Pavarësisht këtij fakti, Shqipëria mbetet e ekspozuar ndaj risqeve të rëndësishme që lidhen me sektorin energjitik. Ndryshimi i konsumit të energjisë në periudha të caktuara të vitit apo gjatë ditës në mënyrë të pashmangshme e bën sistemin energjitik të varur ndaj importeve të energjisë (2,253 GWh gjatë vitit 2021). Nga ana tjetër, për shkak të peshës kryesore që hidrocentralet zënë në prodhimin e energjisë elektrike, Shqipëria është shumë e varur ndaj sasisë vjetore të reshjeve apo shpërndarjes së tyre gjatë vitit dhe zonave të vendit. Kështu, prodhimi i realizuar për vitin 2021 rezulton rreth 2,887 GWh ose 47.5 përqind më i lartë se mesatarja e prodhimit për periudhën 2009 – 2021. Për këto arsye, diversifikimi i prodhimit të energjisë, krahas zhvillimit të investimeve në sektor, paraqet një sfidë të rëndësishme për t'u adresuar në të ardhmen në drejtim të fuqizimit të pavarësisë energjitike. Lidhur me produktet e tjera energjitike, kryesisht nënproduktet e naftës dhe gazin, varësia e vendit ndaj tregjeve globale, është shumë më e theksuar.

Kriza aktuale energjitike në tregjet globale e ka nxjerrë edhe më në pah nevojën e fuqizimit të pavarësisë energjitike dhe Shqipëria ka mjaft potencial energjitik për të zvogëluar apo shmangur pasojat që vijnë nga kriza të tilla për zhvillimin e vendit, buxhetin e shtetit, biznesin apo konsumatorin vendas.

Tranzicioni i Gjelbër

Konektiviteti, Agjenda e Gjelbër për Vendet e Ballkanit Perëndimor, si pjesë e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të Bashkimit Evropian për këto vende, përfshirë Shqipërinë, janë në qendër të shtyllës së dytë të strategjisë. Së bashku me prioritetet afatgjata të identifikuara për vendin ato përbëjnë njëkohësisht edhe drejtimin më të qartë për orientimin e kërkesës dhe përgatitjen e ofertës në tregun shqiptar për periudhën deri në vitin 2030.

Për Shqipërinë, tranzicioni i gjelbër do të sjellë zhvendosjen graduale të ekonomisë dhe punësimit nga sektorë si industria minerare apo ndërtimi, drejt aktiviteteve më produktive si turizmi i mbështetur në mbrojtjen e ekosistemeve dhe biodiversitetit, bujqësia produktive e bazuar në metodat e qëndrueshme të prodhimit ushqimor, traditën dhe vlerat e veçanta të prodhimit vendas, promovimin e ekonomisë qarkulluese, si dhe trajtimin efektiv të mbetjeve, ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës apo kontributit në reduktimin e emetimeve përmes investimeve në energjitë e rinovueshme.

Ndryshimet Klimatike dhe Qëndrueshmëria

Shqipëria është vendi më i prekshëm ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, për shkak të katastrofave natyrore që lidhen me klimën, si përmbytjet, thatësira, zjarret etj. Skenarët klimatikë për të ardhmen në Shqipëri parashikojnë ndryshime të theksuara, si rritje të temperaturave, ulje të reshjeve dhe reduktim të burimeve ujore dhe tokës së punueshme. Reshjet në verë do të vijojnë të zvogëlohen, ndërsa muajt e dimrit parashikohet të kenë rritje, duke përfshirë rritjen e shpeshtësisë dhe intensitetit të shirave të rrëmbyeshëm. Gjithashtu, ndryshimet klimatike pritet të ndikojnë negativisht në rrjedhën e lumenjve, gjë që do të ndikojë në kapacitetin gjenerues të hidrocentraleve, në disponueshmërinë e ujit, përfshirë sektorin e bujqësisë dhe sigurinë e popullsisë për shkak të fatkeqësive të shtuara. Banka Botërore vlerëson se ndikimi i përmbytjeve në PBB e Shqipërisë është në nivelin e 200 milionë USD në vit dhe pritet që një shifër e tillë të vijojë të rritet në vitet pasardhëse. Ndikimi i këtyre efekteve në ekonomi dhe në zhvillimin e vendit kërkon kapacitete dhe burime financiare të cilat aktualisht janë të pamjaftueshme sa duhet.

Detyrimi kombëtar për burime të përballueshme, të qëndrueshme, të gjindshme dhe të sigurta energjitike dhe ujore do të jetë, në periudhën e ardhshme të parashikuar, një nxitës kryesor i ndryshimeve të mëdha dhe zhvillimit në këta sektorë dhe në ata mbështetës.

Nga ana tjetër, pasojat e tërmetit të vitit 2019 dhe pandemisë Covid-19 në treguesit ekonomikë dhe socialë të zhvillimit të vendit, përfshirë koston e rimëkëmbjes prej tyre, treguan se Shqipëria do të duhet të përgatitet për përballimin e sfidave madje edhe më të paparashikueshme se ndryshimet klimatike në të ardhmen. Adresimi i kësaj problematike horizontale për të gjithë sektorët e zhvillimit është thelbësore për kuadrin strategjik të vendit në të ardhmen dhe të gjitha modelet e përdorura do të duhet të marrin parasysh edhe goditje nga faktorë të paparashikueshëm që sjellin pasoja zinxhir në zbatimin e SKZHIE 2030.

Transformimi Digjital

Përdorimi i teknologjisë së informacionit në ofrimin e shërbimeve publike të qeverisë ka pasur dhe do të vazhdojë të ketë një efekt transformues në mënyrën se si funksionon qeverisja, llojet dhe mënyrën e ofrimit të shërbimeve, sikurse ka ndikimin e tij dhe në aktivitetin e bizneseve dhe zhvillimin e sektorëve të ekonomisë. Bashkë me forma të tjera të ndryshimeve teknologjike dhe të novacioneve, qeveria Shqiptare dhe institucionet e sektorit privat do të duhet jo vetëm të reagojnë ndaj këtyre nxitësve të ndryshimit, por edhe të kërkojnë në mënyrë aktive mundësi për ndryshim, konkurrueshmëri më të madhe dhe rritje ekonomike e zhvillim të përgjithshëm. Transformimi digjital që po i paraprin këtyre proceseve do të kërkojë përvetësimin dhe fuqizimin e aftësive më të fundit digjitale të kohës, veçanërisht nga brezi i ri që përgatitet për të hyrë në tregun e punës dhe

krijimin e bizneseve të reja, sikurse nga ana tjetër dhe përfshirjen e tij në mënyrën e organizimit dhe funksionimit të bizneseve shqiptare.

Aftësitë

Shqipëria aktualisht po përballet me dy sfida kryesore lidhur me aftësitë. Së pari, është niveli i ulët i aftësive të popullsisë në moshë pune. Sipas Anketës së Forcave të Punës të vitit 2021, 41.6 përqind e forcave të punës dhe 48.3 përqind e popullsisë në moshë pune në Shqipëri është me arsim bazë (8-/9-vjeçar) ose më të ulët. Ka edhe grupe të caktuara, të cilat nuk e kanë përfunduar arsimin fillor.

Sfida e dytë lidhet me zotërimin nga fuqia punëtore të aftësive të kërkuara në tregun e punës, mungesa e të cilave mund të pengojë krijimin e më shumë vendeve të punës apo vende pune me cilësi më të mirë. Disa nga treguesit kryesorë të mospërputhjes së mundshme të aftësive mund të konsiderohen shkalla e lartë e papunësisë tek të rinjtë dhe shkalla e lartë e papunësisë së të diplomuarve nga arsimi i lartë. Shkalla e lartë e të rinjve që nuk janë as në punësim, as në arsim apo trajnim (NEET) është një tjetër tregues që nxjerr në pah mospërputhjen e aftësive.

Sfidat e mungesës apo mospërputhjes së aftësive, janë rezultat i sasisë, cilësisë apo rëndësisë së pamjaftueshme të ofertës së arsimit dhe formimit. Tregues i cilësisë së pamjaftueshme të sistemit arsimor janë rezultatet e PISA-s, sipas të cilave të rinjtë shqiptarë të moshës 15-vjeçare kanë rezultate nën mesataren e OECD-së në të tri disiplinat: lexim, matematikë dhe shkencë.

Konkurrueshmëria

Struktura e aktivitetit ekonomik në vend dominohet nga SME-të që përbëjnë më shumë se 90% të bizneseve të regjistruara dhe që operojnë kryesisht në aktivitete të bazuara në punën dhe me vlerë të shtuar të ulët. Rritja e konkurrueshmërisë së kompanive shqiptare është tepër e rëndësishme për zgjerimin e aktivitetit të tyre brenda vendit por dhe përtej kufirit, në tregun e integruar rajonal dhe atë të BE. Nga ana tjetër, hapja e plotë e ekonomisë së vendit, integrimi në BE dhe mbështetja që BE jep për vendet e Ballkanit Perëndimor, janë faktorë të rëndësishëm që do të ushtrojnë presion pozitiv e në rritje për kompanitë vendase që ato të përmirësojnë ndjeshëm konkurrueshmërinë e tyre në treg dhe të jenë të afta të konkurrojnë brenda vendit dhe të jenë aktive për të kërkuar mundësi zgjerimi të aktivitetit edhe jashtë tij. Për të përmirësuar konkurrueshmërinë e ekonomisë shqiptare, ka hapësirë për përfitime në sajë të rritjes së efiçencës përmes përmirësimeve të produktivitetit në sektorë kryesorë si bujqësia dhe industritë, sikurse dhe përmes zhvendosjeve të fuqisë punëtore, investimeve dhe mbështetjes prej sektorit të ndërtimit, drejt aktiviteteve më produktive dhe me vlerë të shtuar të lartë si turizmi i qëndrueshëm, shërbimet, IT, NVM e bazuara në inovacion e teknologji, financimet dhe aktivitetet e gjelbra etj.

Produktiviteti

Produktiviteti i ekonomisë shqiptare, si faktor përcaktues i nivelit të mirëqenies së qytetarëve, mbetet relativisht i ulët krahasuar me Bashkimin Evropian. Të dhënat (World Development Indicators database, 2022) tregojnë se gjatë dekadës së fundit, niveli mesatar i produktivitetit të ekonomisë shqiptare, i matur në USD (konstant PPP - i konvertuar në USD sipas normës së paritetit të fuqisë blerëse) si kontribut në PBB i çdo personi të punësuar, arriti në 34.7 për qind në vitin 2021.

Aktivitetet me vlerë të lartë të shtuar që kontribuojnë për rreth 1/3 e punësimit (përjashtuar bujqësinë dhe administratën) kanë pasur rritjen më të lartë të punësimit gjatë dekadës së fundit. Përpos rritjes së produktivitetit në nivel kombëtar ndryshimi i konsiderueshëm që ekziston në nivelin e produktivitetit sipas sektorëve të ndryshëm të veprimtarisë ekonomike, është i rëndësishëm. Gjatë dekadës së fundit 2011 – 2020, sektorët jobujqësorë me rritjen më të lartë të produktivitetit në Shqipëri janë ata të shëndetësisë, shërbimeve të ndryshme, publikimet dhe software etj., sektorë për të cilët niveli i produktivitetit është rritur mbi dy herë

krahasuar me dhjetë vite më parë. Fuqizimi i mëtejshëm i sektorëve të tillë dhe të tjerëve potencialë, përmes politikave mbështetëse për zgjerimin e punësimit që shoqërojnë diversifikimin e mëtejshëm dhe orientimin e ekonomisë drejt aktiviteteve produktive, krijon mundësi të mëtejshme për të përmirësuar konkurrueshmërinë e ekonomisë dhe kontribuar në mënyrë të qenësishme në rritjen e mirëqenies së qytetarëve.

Sundimi i Ligjit

Një nga sfidat themelore të reformës në drejtësi ishte rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe mirëfunksionimi i tij. Reforma në drejtësi ka sjellë ndryshime të rëndësishme në përcaktimet institucionale të gjyqësorit shqiptar. Institucionet ekzistuese janë transformuar dhe institucione të reja janë krijuar përmes ligjeve specifike organike. Ngritja e institucioneve të reja si dhe vënia në funksionim e institucioneve ekzistuese ka nisur të japë rezultatet e para me goditjet që i janë dhënë krimit të organizuar dhe korrupsionit në vend.

Institucionet shqiptare janë angazhuar plotësisht në avancimin e zbatimit të reformës më gjithëpërfshirëse të ndërmarrë në sistemin e drejtësisë. Që nga fillimi i saj, reforma në drejtësi ka synuar përputhjen me standardet më të larta të arritshme të acquis në fushën e shtetit të së drejtës.

Vendimi i BE për mbledhjen e konferencës së parë ndërqeveritare, sikurse dhe hapja e negociatave të anëtarësimit, janë arritur vetëm pas bindjes se Shqipëria kishte bërë përparimin e duhur në një numër çështjesh të caktuara, ndër të cilat sundimi i ligjit është dhe do të mbetet thelbësor.

Gjeopolitika

Zhvillimet gjeopolitike të kohëve të fundit dhe përkeqësimi i situatës së sigurisë në kufirin lindor të NATO-s janë pasqyrë e një mjedisi ndërkombëtar sigurie nën presion të vazhdueshëm nga kërcënime komplekse, shumëdimensionale dhe me ndryshime të papritura. Këto kërcënime dhe rreziqe, të ndërthurura me konkurrencën strategjike, zgjerimin e aftësive kibernetike, hyrjen apo fuqizimin e aktorëve të rinj në skenën globale, terrorizmin apo ekstremizmin e dhunshëm, dhe pasigurinë e shkaktuar nga pandemia Covid-19, janë sfida konkrete që ndikojnë ndjeshëm në natyrën, intensitetin dhe ndikimin ndaj sigurisë globale.

Fillimi i vitit 2022 e gjeti ekonominë shqiptare në një moment pozitiv zhvillimi. Megjithatë, sulmi ushtarak i Rusisë ndaj Ukrainës ka gjeneruar një realitetet të ri ekonomik dhe gjeopolitik. Duke qëndruar në planin ekonomik, agresioni rus dhe pengesat në tregtinë botërore kanë sjellë rritje të shpejtë të çmimeve dhe lëvizje agresive të bankave qendrore në drejtim të shtrëngimit të qëndrimit të politikës monetare. Në të njëjtën kohë, rritja e pasigurisë, gërryerja e fuqisë blerëse dhe rritja e kostove të shërbimit të borxhit, kanë frenuar ritmin e rritjes ekonomike. Si një vend i vogël e i hapur, Shqipëria nuk mund të bëjë përjashtim nga këto tendenca globale.

Shqipëria do të vijojë të monitorojë, analizojë dhe reagojë ndaj efekteve të jashtme në evoluim, nëpërmjet veprimesh kyçe të politikave dhe strategjive monetare, fiskale dhe të tjera makroekonomike, strategji të cilat do të kenë ndikime që priten të sjellin ndryshime në të gjithë sektorët e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare.

Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar në procesin e integrimit rajonal me vendet e Ballkanit Perëndimor, duke thelluar me tej bashkëpunimin ekonomik dhe tregtar për funksionimin e tregut të përbashkët rajonal dhe promovimin e paqes në rajon mbështetur në një politikë konstruktive dhe të moderuar, mbi parimet e fqinjësisë së mirë, perspektivës euro-atlantike, bashkëpunimit gjithëpërfshirës, integrimit ekonomik rajonal si dhe respektimit dhe përparimit të të drejtave të pakicave.

Treguesit e nivelit strategjik

Monitorimi i zbatimit të SKZHIE 2030, krahas vlerësimit dhe analizës periodike të ecurisë së strategjisë dhe strategjive sektoriale, do të kryhet mbi bazën e performancës së treguesve të nivelit strategjik të përzgjedhur për këtë qëllim nga të gjithë sektorët e përfshirë në strategji. Caktimi i këtyre treguesve ka pasur parasysh që ata të jenë përfaqësues për sektorin, specifikë, të matshëm, të arritshëm, të rëndësishëm, të lidhur me procesin e integrimit Evropian dhe treguesit e Agjendës 2030 dhe të realizueshëm brenda afateve të strategjisë.

Për të gjithë këta tregues, janë vendosur objektiva të matshëm për vitin 2030 duke dhënë një pasqyrë të prekshme të synimeve për vizionin Shqipëria 2030 dhe mundësuar monitorimin e arritjes së qëllimeve të politikës së strategjisë. Shtojca Nr.2 përmban të detajuar listën e treguesve strategjikë të monitorimit sipas sektorëve, shoqëruar me vlerat e vitit bazë dhe objektivit përkatës për vitin 2030.

Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm.

Shqipëria është plotësisht e angazhuar për zbatimin e Agjendës 2030. Parlamenti shqiptar ka miratuar njëzëri një rezolutë që konfirmon angazhimin e vendit për Agjendën 2030 pasi ajo luan një rol të rëndësishëm në arritjen e OZHQ. Janë krijuar mekanizmat institucionalë për të ndërlidhur SKZHIE si dhe strategjitë dhe politikat sektoriale me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm. Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm 2022 – 2026, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Organizatës së Kombeve të Bashkuara, lidhet me përparësitë e vendit: integrimin në Bashkimin Evropian, Agjendën 2030 për Zhvillim dhe me treguesit për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm për Shqipërinë, me një fokus tek cilësia e sektorit të shëndetësisë dhe arsimit, qeverisjes së mirë e të hapur dhe sundimit të ligjit, ofrimit të shërbimeve publike, dhe në përgjigjen efektive dhe ringritjen nga pandemia e Covid-19.

Mjaft punë është kryer për përafrimin e OZHQ-ve me strategjitë kombëtare dhe identifikimin e synimeve 2030 në sektorët prioritarë për procesin e zhvillimit. Qeveria Shqiptare ka ndjekur qasjen për integrimin e proceseve të planifikimit të OZHQ-ve dhe Agjendës 2030, në sistemet dhe instrumentet kombëtarë të proceseve të planifikimit të politikave dhe të strategjive/dokumenteve strategjike. Kjo nënkupton harmonizimin e OZHQ-ve me kuadrin strategjik të vendit, përfshirë SKZHIE 2030 dhe strategjitë sektoriale e ndërsektoriale. Kjo qasje është ndjekur me qëllim efiçencën lidhur me: (i) përdorimin e mekanizmave të sistemeve të vendit; (ii) evitimin e mbivendosjeve të proceseve planifikuese/dokumenteve strategjikë planifikues; (iii) përdorimin efektiv të burimeve njerëzore; (iii) planifikimin realist të burimeve në kuadër të Agjendës 2030, si pjesë e Agjendës zhvillimore të vendit; (iv) evitimin e raportimeve të dyfishta në kuadër të ndjekjes së zbatimit.

Lidhja midis prioriteteve strategjike të vendit, të përfshira në këtë strategji, dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030, shtjellohet në detaje sipas sektorëve përkatës për çdo shtyllë të SKZHIE 2030.

Qëllimi parësor: Integrimi Evropian

Qëllimi strategjik konsiston në një perspektivë të qartë dhe të bazuar në merita për anëtarësimin e plotë në BE për Shqipërinë, e cila mbështetet në progresin e vazhdueshëm të procesit të negociatave, si edhe në zbatimin e reformave dhe politikave në përputhje më standardet e BE-së.

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është synimi politik dhe strategjik i Republikës së Shqipërisë dhe i sistemeve të saj ligjore, ekonomike dhe institucionale. Procesi i anëtarësimit në BE përfaqëson një mbështetje për

demokratizimin e Shqipërisë, konsolidimin e institucioneve dhe të sundimit të ligjit dhe proceseve të vazhdueshme të reformave themelore në drejtim të Bashkimit Evropian dhe anëtarësimit.

Ky vizion është në interesin politik, ekonomik dhe në interesin e sigurisë të vetë Bashkimit Evropian, për të cilin, në kohën e sfidave globale në rritje e të shumanshme, zgjerimi mbetet më shumë se kurrë një investim gjeostrategjik për një Evropë të qëndrueshme, të fortë dhe të bashkuar.

Situata aktuale

Anëtarësimi në Bashkimin Evropian është synimi politik dhe strategjik kryesor i Republikës së Shqipërisë. Realizimi i këtij synimi kërkon angazhimin dhe përqendrimin e burimeve politike, financiare, sociale, intelektuale dhe administrative. Në këtë kuadër do të jetë e nevojshme që të përshtaten, harmonizohen dhe përmirësohen të gjitha sistemet dhe procedurat ligjore, ekonomike dhe institucionale të shoqërisë shqiptare në përgjithësi, dhe të shtetit shqiptar në veçanti, në përputhje me ato të Bashkimit Evropian.

Ky synim politik dhe strategjik reflekton identitetin politik dhe kulturor të Shqipërisë dhe shqiptarëve, si pjesë e Evropës, si dhe bazohet në vlerat dhe parimet demokratike mbi të cilat funksionon shteti shqiptar, në konsolidim dhe forcim të gjithanshëm drejt standardeve Evropiane. Gjithashtu ky synim bazohet në ekonominë e tregut, në zhvillimin dhe integrimin e mëtejshëm në ekonominë evropiane dhe zinxhirët e saj të vlerës, si edhe ngrihet mbi vullnetin e qytetarëve shqiptarë dhe partive politike dhe shoqërisë civile shqiptare, të cilët mbështesin në shumicë dërrmuese dhe të vazhdueshme procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Nga ana tjetër, procesi drejt anëtarësimit, dhe më pas vetë anëtarësimi në Bashkimin Evropian, do të mbështesin më tej demokratizimin dhe forcimin e shtetit të së drejtës në Shqipëri, do të nxisin konsolidimin e institucioneve publike dhe vazhdimin e proceseve të vazhdueshme reformuese, duke përshpejtuar zhvillimin ekonomik dhe përqasjen me nivelet më të mira evropiane të mirëqenies dhe sigurisë sociale.

Një perspektivë e qartë dhe e bazuar në merita për anëtarësimin e plotë në BE për Shqipërinë është gjithashtu në interesin politik, ekonomik dhe në interesin e sigurisë të vetë Bashkimit Evropian. Procesi i anëtarësimit të shteteve të reja në Bashkimin Evropian përcaktohet nga neni 49 i Traktatit të BE-së, i cili përcakton në vija të përgjithshme kriteret që duhet të plotësojnë këto shtete, të njohura ndryshe si kriteret e Kopenhagës.

Procesi i integrimit të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Evropian filloi me lidhjen e Marrëveshjes ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komunitetit Ekonomik Evropian për tregtinë dhe bashkëpunimin tregtar dhe ekonomik, e cila hyri në fuqi më 1 dhjetor 1992.[2] Në vitin 1995, Shqipëria kërkoi hapjen e negociatave për një marrëveshje asociimi. Shqipëria u bë pjesë e Procesit të Stabilizim-Asociimit, të shpallur për vendet e Evropës Juglindore në Samitin e Zagrebit, në vitin 2000 dhe nënshkroi dhe ratifikoi në vitin 2006,[3] Marrëveshjen e Stabilizim-Asociimit me Komunitetet Evropiane dhe Shtetet Anëtare të tyre, e cila hyri në fuqi më 1 prill 2009.[4] Raportet vjetore të Komisionit Evropian në vite kanë konfirmuar se Shqipëria ka plotësuar mirë detyrimet e saj në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.[5]

Në prill të vitit 2009, Republika e Shqipërisë, aplikoi për anëtarësim në Bashkimin Evropian. Komisioni Evropian në përgjigje të aplikimit kërkoi plotësimit e 12 rekomandimeve kyçe në vitin 2010, që më pas u reduktuan në 5 prioritete në vitin 2013. Pas zbatimit të dy planeve të veprimit dhe miratimit të Vendimit të Këshillit të

2 https://qbz.gov.al/eli/ligj/1992/10/06/7617/27aaa741-da1b-432f-aa1b-b938f3a5b8f6 dhe https://eur-lex.Europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX përqind3A21992A1125 përqind2801 përqind29

3 https://qbz.gov.al/eli/ligj/2006/07/27/9590/92c1cfc1-2743-4c3f-9750-e36fdd90a9cc

4 https://eur-lex.Europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX përqind3A02009A0428 përqind2802 përqind29-20170201

5https://ec.Europa.eu/neighbourhood-enlargement/albania-report-2021_en

Ministrave Nr. 330, datë 28.05.2014, "Për miratimin e Udhërrëfyesit për 5 prioritetet e rekomanduara nga Komisioni Evropian, 2013", Këshilli Evropian në qershor 2014, vendosi që t'i akordojë Shqipërisë statusin e vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Evropian.[6]

Komisioni Evropian bazuar në përparimin e bërë nga Shqipëria rekomandoi fillimisht në vitin 2016[7] hapjen e kushtëzuar të negociatave të anëtarësimit. Duke filluar nga viti 2018[89], Komisioni rekomandoi në mënyrë të pakushtëzuar hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Më 25 mars 2020, Këshilli Evropian vendosi hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë.[10] Këshilli vendosi që konferenca e parë ndërqeveritare do të mblidhej pasi që Shqipëria të kishte bërë përparim në një numër çështjesh të caktuara.

Strukturat e posaçme kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar janë ngritur dhe janë funksionale. Kuvendi i Shqipërisë vendosi në 2021 të rrisë numrin e prokurorëve në Prokurorinë e Posaçme për të forcuar luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Për më tepër, 10 ministri kanë miratuar një plan integriteti, duke përcaktuar masat specifike që duhet të ndërmerren për të zbutur ose parandaluar rreziqet e korrupsionit. Janë shtuar përpjekjet qeveritare në luftën kundër korrupsionit nëpërmjet krijimit të Drejtorisë së parë të Përgjithshme Kundër Korrupsionit në varësi të Ministrisë së Drejtësisë.

Përparim është arritur edhe në reformën e administratës publike me plotësimin dhe zbatimin e kuadrit strategjik dhe atij ligjor. Vlerësimi i monitorimit të SIGMA-s për vitin 2021 tregon se Shqipëria është në pararojë krahasuar me fqinjët në rajonin e Ballkanit Perëndimor, duke shënuar vlera më të larta se mesatarja rajonale për të gjashtë parimet kryesore të BE-së për administrimin publik, mbi bazën e të cilave kryhet vlerësimi. Strategjia e Menaxhimit të Financave Publike është zbatuar plotësisht, duke përmirësuar efiçencën e investimeve publike. Në këtë raport, fusha e prokurimit publik në Shqipëri është vlerësuar me nota të larta në treguesit përkatës duke marrë vlerësim maksimal sa i takon cilësisë së kuadrit ligjor në fushën e prokurimit, kapaciteteve institucionale në nivel qendror për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e politikave në fushën e prokurimit në mënyrë efektive dhe eficente si dhe sistemit të shqyrtimit të ankesave. Procesi i prokurimit publik është krejtësisht i digjitalizuar, lehtësisht i aksesueshëm dhe transparent, në të gjitha fazat e tij.

Nga data 1 Maj 2022, të gjitha shërbimet publike ofrohen vetëm *on-line* duke përmirësuar cilësinë e shërbimit, shmangur korrupsionin dhe abuzimin dhe rritur kërkesën e llogarisë.

Ligji për pakicat kombëtare dhe pjesa kryesore e akteve nënligjore janë miratuar dhe ka filluar zbatimi i tyre. Ligji për regjistrimin e popullsisë është miratuar dhe pyetësori përkatës është bazuar në rekomandimet e OKB-së dhe Eurostat-it. Në lidhje me respektimin e të drejtës së pronës është miratuar ligji për kadastrën, ligji për proceset kalimtare të pronësisë, si edhe është ngritur dhe konsoliduar Agjencia Shtetërore e Kadastrës.

Në lidhje me kriteret ekonomike, Shqipëria ka bërë përparim në drejtim të krijimit të një ekonomie tregu funksionale dhe të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik, nëpërmjet një politike të shëndoshë monetare. Tërmeti i 2019, pandemia COVID-19, si edhe agresioni Rus ndaj Ukrainës, sollën ndikimin e tyre në ekonominë shqiptare, por pa cenuar perspektivën afatgjatë të rritjes ekonomike. Qeveria Shqiptare parashikon, që rritja

6https://data.consilium.Europa.eu/doc/document/ST-8288-2014-INIT/en/pdf
7https://ec.Europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20161109_strategy_paper_en.pdf
8https://ec.Europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417-albania-report.pdf
9https://ec.Europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/20180417_strategy_paper_en.pdf
10ttps://data.consilium.Europa.eu/doc/document/ST-7002-2020-INIT/en/pdf

ekonomike të stabilizohet në rreth 3.4 përqind gjatë periudhës 2023 – 2025 dhe borxhi publik bruto si raport i PBB-së do të ndjekë trajektoren rënëse nisur nga viti 2021 në përputhje me rregullin fiskal përkatës.[11]

Në lidhje me kriterin e tretë për standardet evropiane, Shqipëria e ka zbatuar MSA-në në përgjithësi dhe pa probleme, në bazë të afateve të përcaktuara dhe sipas rekomandimeve të institucioneve të përbashkëta BE-Shqipëri, të ngritura në bazë të MSA-së. Çdo vit, qeveria Shqiptare miraton Planin Kombëtar për Integrimin Evropian, si planin kombëtar për përafrimin e legjislacionit shqiptar me legjislacionin e Bashkimit Evropian. Realizimi i Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për vitin 2020 ishte në rreth 87 përqind ndërsa për vitin 2021 në rreth 76 përqind.

Zbatimi me sukses i MSA-së deri tani ka garantuar ndikime pozitive, në veçanti, në krijimin e një zone të tregtisë së lirë midis Shqipërisë dhe BE-së. BE-ja vazhdon të jetë partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, me një rritje mesatare vjetore të eksporteve Shqiptare në 27 vendet e BE-së prej 9.2 përqind për periudhën nga 2017 deri në 2021.[12]

Shqipëria jep një kontribut të rëndësishëm në procesin e bashkëpunimit rajonal në Ballkanin Perëndimor, duke u angazhuar plotësisht në këtë fushë edhe në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit. Shqipëria merr pjesë aktive në të gjitha nismat rajonale dhe strukturat rajonale, si Procesi i Bashkëpunimit të Evropës Juglindore, Këshilli i Bashkëpunimit Rajonal, Procesi i Berlinit, Ballkani i Hapur, Zona Ekonomike Rajonale etj. dhe punon në mënyrë proaktive për të çuar përpara arritjen e objektivave të tyre.

Gjithashtu, Shqipëria ka vijuar në mënyrë të vazhdueshme të shprehë dhe tregojë përafrim të plotë me politikën e përbashkët të jashtme dhe të sigurisë së BE-së (CFSP). Si një anëtare jo e përhershme që nga janari 2022, Shqipëria ka qenë e angazhuar në mënyrë aktive në Këshillin e Sigurimit të OKB-së.

Me Vendimin Nr. 424, datë 22.6.2022 u miratua Deklarata Hapëse e Republikës së Shqipërisë, Pozicioni i Përgjithshëm, në kuadër të Konferencës së Parë Ndërqeveritare për Anëtarësimin e Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian Më 19 korrik 2022 u zhvillua Konferenca Ndërqeveritare për negociatat e anëtarësimit me Shqipërinë, ku Shqipërisë iu dha formalisht korniza e përgjithshme dhe kuadri negociues për anëtarësimin. Komisioni filloi menjëherë procesin e shqyrtimit dhe që prej shtatorit 2022 ka filluar procesi i shqyrtimit analitik të Acquis të BE-së (*screening)*.

Raporti i Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2022, vlerëson se Shqipëria ka bërë progres, të një niveli të caktuar, për 32 nga 33 kapitujt e Acquis-it të BE, ashtu si edhe në të gjitha kriteret e integrimit në BE. Raporti njeh faktin se qeveria ka vazhduar në rrugën e reformave për integrimin në BE, si edhe përgëzon Shqipërinë për qasjen plotësisht në linjë me BE për çështje të politikës së jashtme dhe sigurisë. Raporti thekson veçanërisht, se Shqipëria ka bërë progres të kënaqshëm dhe të mirë në të gjithë kapitujt e grupimit 1, ose Grupkapitulli Themelor i procesit të integrimit në BE.

Sfidat

Metodologjia e re e anëtarësimit kërkon vazhdimësinë e reformave dhe politikave të koordinuara dhe të njëkohshme në të gjithë sektorët, për plotësimin e kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe detyrimeve të MSA-së. Sfidat kryesore lidhen me domosdoshmërinë e: (i) vazhdimit të mëtejshëm dhe thellimit në zbatimin e reformave themelore, duke përfshirë reformën në drejtësi, funksionimin e institucioneve

11 https://qbz.gov.al/alfresco/api/-default-/public/alfresco/versions/1/nodes/96201f41-65f2-40df-ab68-e23d8555a8a3/content?attachment=true&alf_ticket=TICKET_91d90537815bbc093295f1f0f36f9451ed6cc38f

12 https://webgate.ec.Europa.eu/isdb_results/factsheets/country/details_albania_en.pdf

demokratike dhe reformës së administratës publike; (ii) përmbushjes së të gjitha detyrimeve të MSA-së dhe harmonizimit të mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së sikurse kërkohet nga MSA-ja dhe anëtarësimi në BE; (iii) angazhimit të përgjithshëm për finalizimin e procesit *screening*, plotësimin e kritereve për hapjen e negociatave në grupimin themelorët dhe më pas në grupimet e tjera; (iv) koordinimin dhe integrimin vertikal dhe horizontal të politikave dhe reformave të lidhura me procesin e anëtarësimit.

Qëllimi i politikës

Qëllimi i politikës konsiston në përshpejtimin e procesit të plotësimit të kritereve të anëtarësimit në Bashkimin Evropian, sipas metodologjisë së re të anëtarësimit, dhe nxitja e progresit në procesin e anëtarësimit dhe zbatimin e reformave drejt BE-së, përmes koordinimit efektiv të procesit të negociatave, koordinimit cilësor të reformave dhe politikave të lidhura me anëtarësimin, rritjes së shkallës së përafrimit të legjislacionit me Acquis dhe progresit në zbatimin e MSA-së, ngritjes së kapaciteteve institucionale, si edhe transparencës dhe komunikimit të procesit ndaj qytetarëve.

Masat Prioritare:

1. Mbështetja dhe forcimi i strukturave përgjegjëse qendrore për procesin e anëtarësimit në BE;
2. Zbatimi i plotë i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, sigurimi i progresit në harmonizimin ligjor me Acquis të BE dhe plotësimi i angazhimeve të Shqipërisë gjatë procesit të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian;
3. Sigurimi i transparencës dhe komunikimit mbi ecurinë, përfitimet dhe kostot e procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian;
4. Koordinimi efektiv i procesit të anëtarësimit në Bashkimin Evropian me qytetarët dhe grupet e interesit;
5. Forcimi i kapaciteteve institucionale të njësive të qeverisjes vendore për procesin e anëtarësimit.

DEMOKRACIA E FUQIZIMI I INSTITUCIONEVE DHE QEVERISJES SË MIRË

Shtylla e parë e SKZHIE 2030 parashtron nevojën e forcimit të mëtejshëm të institucioneve efikase të vendit si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE. Funksionimi i sistemit të drejtësisë, modernizimi i shërbimeve publike dhe digjitalizimi, arritja e standardeve të BE-së në administratën publike, lufta ndaj korrupsionit dhe sigurimi i llogaridhënies dhe transparencës në sektorin publik, zgjerimi i decentralizimit dhe demokracisë vendore si dhe përfshirja e qytetarëve dhe shoqërisë civile në këto procese mbeten përparësi kyçe të qeverisjes së mirë për Shqipërinë.

Qëllimi strategjik: Forcimi i mëtejshëm i institucioneve të vendit si bazë që siguron demokracinë, konkurrencën dhe zhvillimin ekonomik të vendit duke e përgatitur atë për anëtarësim në BE.

Reformimi i sistemit të drejtësisë

Në sistemin e drejtësisë në Republikën e Shqipërisë ndër vite janë marrë një sërë iniciativash në reformimin e vazhdueshëm të sektorit me synim vendosjen e stabilitetit dhe garancisë demokratike. Reforma në Drejtësi konsiderohet si një nga reformat më të thella ligjore dhe institucionale e cila ka prekur sistemin e drejtësisë në vend në dy dekadat e fundit, synimi i së cilës ishte krijimi i një sistemi drejtësie të besueshëm, efektiv, të pavarur dhe profesional i bazuar në parimet e shtetit të së drejtës dhe në përputhje me standardet Evropiane.

Reforma në Drejtësi realizoi ndërhyrje rrënjësore duke njohur zhvillime të reja në konsolidimin dhe miratimin e amendamenteve të Kushtetutës me ligjin nr. 79, më 21 korrik 2016[13], si piketa e parë e kësaj Reforme. Ndryshimet prekin disa momente të rëndësishme ligjore, duke rikonceptuar dhe detajuar aplikimin e disa parimeve kushtetuese siç është pavarësia dhe paanshmëria e gjyqësorit. Kushtetuta e re synon të krijojë një frymë të re të funksionimit dhe administrimit të gjykatave, frymë e cila synon të pasqyrohet edhe në ligjet dhe aktet e tjera që do të vijojnë. Miratimi i ndryshimeve kushtetuese u pasua nga miratimi i një liste gjithëpërfshirëse të ligjeve që synonin fuqizimin e përgjegjshmërisë dhe profesionalizmit të sistemit të drejtësisë.

Ndryshimet e reja kushtetuese konsistojnë në zgjerimin e juridiksionit të Gjykatës Kushtetuese dhe të subjekteve që mund t'i drejtohen asaj, në ndryshimin e mënyrës së emërimit të gjyqtarëve kushtetues dhe të Gjykatës së Lartë, në krijimin e organeve të reja në administrimin e drejtësisë, përgjegjëse për mbikëqyrjen e gjyqësorit dhe të prokurorisë, çështjet e karrierës, masat disiplinore të gjyqtarëve dhe prokurorëve tashmë shqyrtohen nga Këshilli i Lartë Gjyqësor dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë. Hetimi dhe verifikimi i ankesave iu besua një organi të ri kushtetues, Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, i cili është përgjegjës për verifikimin e ankesave dhe hetimin disiplinor të gjyqtarëve dhe prokurorëve, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë, si dhe Prokurorit të Përgjithshëm.[14] Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, si organ *ad hoc* (jo i përhershëm), parashikon kriteret që duhet të plotësojnë anëtarët e institucionit, procedurat për t'u zgjedhur si dhe funksionet e tij kryesore. Për herë të parë, në Kushtetutë u parashikua një kuadër i plotë institucional në drejtim të hetimit dhe gjykimit të korrupsionit dhe krimit të organizuar, përmes krijimit të Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, Byrosë Kombëtare të Hetimit / Njësisë së Posaçme Hetimore dhe Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit për Krimin e Organizuar dhe Korrupsionin.

Një nga qëllimet themelore të reformës në drejtësi ishte rritja e besimit të publikut në sistemin e drejtësisë, pavarësia dhe mirëfunksionimi i tij. Bazuar në këtë qëllim, si pjesë integrale e paketës së ndryshimeve kushtetuese, Kuvendi i Shqipërisë miratoi ligjin për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë[15], qëllimi i të cilit ishte përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin e të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve, si një proces që do të shërbejë për të siguruar profesionalizmin e tyre, integritetin moral, verifikimin e pasurive, si dhe për të zbuluar lidhje të mundshme ose ndikime nga krimi organizuar dhe korrupsioni. Rivlerësimi kalimtar i gjyqtarëve dhe prokurorëve ose siç njihet ndryshe *"vettingu"*, është një nga masat më të rëndësishme reformuese të sistemit të drejtësisë konsideruar nga Komisioni i Venecias si masë e jashtëzakonshme, tranzitore dhe e nevojshme në kushtet e Shqipërisë.

Bashkimi Evropian nëpërmjet Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2021, thekson se *"Rivlerësimi i përkohshëm i të gjithë gjyqtarëve dhe prokurorëve (procesi i vetting-ut) ka vijuar në mënyrë të qëndrueshme, duke dhënë rezultate të prekshme - një kusht për Konferencën e parë Ndërqeveritare, i cili vijon të përmbushet"*. Legjislacioni i ri prezantoi qasje novatore në shpërndarjen territoriale të gjykatave, duke përcaktuar parime dhe kritere të reja të konfigurimit të hartës së re gjyqësore parime dhe kritere të cilat kishin si synim kryesor korrigjimin e problemeve ekzistuese.[16]

[13] Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, ndryshuar me ligjin nr.76/2016, datë 22.7.2016

[14] Ligji nr. 76/2016 ndryshoi pjesën e tetë të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese, pjesën e nëntë, pushteti gjyqësor pjesën e dhjetë, prokuroria, pjesën e tetëmbëdhjetë, dispozitat tranzitore, ku rregullohej kalimi në sistemin e ri të drejtësisë, si edhe Kushtetutës iu bashkëlidh një shtojcë e cila detajonte rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

[15] Ligjin nr. 84/2016 "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë"

[16] http://klgj.al/ëp-content/uploads/2021/12/NJ përqindC3 përqind8B-HART përqindC3 përqind8B-E-RE-GJYQ përqindC3 përqind8BSORE-.pdf

Kjo arkitekturë e re institucionale e sistemit të drejtësisë ka dhënë rezultatet e para në disa drejtime, përfshirë ndër të tjera: rezultate tejet pozitive në drejtim të realizimit të procesit të rivlerësimit kalimtar; në emërimet e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese dhe të disa gjyqtarëve në Gjykatën e Lartë nga radhët e juristëve të shquar; në funksionimin e plotë të të gjitha organeve të qeverisjes të sistemit të drejtësisë dhe në ngritjen e funksionimin e të gjithë strukturave të specializuara në luftën kundër korrupsionit dhe krimit të organizuar. Paralelisht, Shkolla e Magjistraturës ka vijuar të formojë gjyqtarë e prokurorë të rinj të kualifikuar, si dhe të ofrojë trajnime për ata në detyrë përmes kurrikulave trajnuese të rishikuara.

Në dhjetor të vitit 2021, u miratua Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe Plani i saj i Veprimit. Ky dokument pasqyron **fazën e dytë** të Reformës në Drejtësi duke synuar gjatë periudhës së shtrirjes, konsolidimin e kuadrit institucional, zbatimin e politikave moderne Evropiane në drejtësinë penale, përmirësimin e infrastrukturës së sistemit të drejtësisë dhe mundësi të reja për teknologjinë e informacionit, përfshi zgjidhje inovative elektronike, që mbështesin një rritje thelbësore të efikasitetit dhe transparencës në sistemin e drejtësisë.

Faza e tretë, e cila shtrihet 4-5 vite (deri në 2030) pas fazës së dytë, konsiderohet si faza e fundit e reformave madhore[17], do të synojë 1) të eliminojë backlog-un, 2) rritjen e cilësisë së shërbimeve dhe 3) ofrimin e një drejtësie në nivelin dhe standardet e BE-së.

Faza e tretë e Strategjisë Ndërsektoriale të Drejtësisë do të përqendrohet në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve nga gjykatat, institucionet e drejtësisë penale, nga disa prej institucioneve të tjera të varësisë dhe drejtoritë e Ministrisë së Drejtësisë, si dhe në investime të lidhura me infrastrukturën.

Sfidat për të ardhmen

Megjithëse rezultatet e fazave të para të kësaj Reforme evidentohen qartë, sistemi i drejtësisë për konsolidimin e tij do të vijojë të fokusohet në:

- Konsolidimin e ndryshimeve ligjore dhe institucionale pas krijimit të themeleve të tyre;
- Qasje më e mirë dhe cilësi e përmirësuar e shërbimeve në përputhje me standardet Evropiane;
- Përmirësimi i infrastrukturës së sektorit dhe krijimi i një baze të dhënash elektronike për gjyqësorin të cilat ndikojnë në rritjen e efikasitetit, llogaridhënies, forcimit të besimit të publikut dhe transparencës në këtë sektor;
- Marrjen e masave për të siguruar eliminimin e *backlog*-ut.

Vizioni *"Shqipëria një shtet me një sistem drejtësie të bazuar në llogaridhënie, transparencë që garanton pavarësi e qëndrueshmëri dhe ofron shërbime të ngjashme nga sektori i drejtësisë të BE-së".*

Qëllimet e politikës:

- Funksionimi i plotë dhe profesional i institucioneve të qeverisjes së sistemit të drejtësisë në përputhje me kërkesat kushtetuese dhe ligjore dhe standardet Evropiane, duke garantuar pavarësinë, efiçencën dhe llogaridhënien;

[17] Reformat mund të vijojnë edhe pas përfundimit të fazës së III, por është parashikuar të jenë të lidhura me përmirësimet graduale në nivel institucional, por pa përfshirë reforma të gjera ndërsektoriale

- Fuqizimi i transparencës, efikasitetit të gjyqësorit dhe aksesit nga të gjithë në drejtësi në përputhje me kërkesat kushtetuese, ligjore dhe standardet Evropiane;
- Një Sistem i Drejtësisë Penale i mbështetur në parimet moderne Evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit;
- Koordinimi, menaxhimi efikas dhe efektiv i sistemit të drejtësisë në të gjitha institucionet e sektorit.

Forcimi i të drejtave të njeriut

Shqipëria respekton instrumentet e të drejtave të njeriut dhe ka ratifikuar shumicën e konventave ndërkombëtare [18]në lidhje me mbrojtjen e të drejtave themelore. Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, e ratifikuar me ligjin nr. 8137, datë 31.07.1996 dhe Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, kanë si qëllim mbrojtjen dhe zbatimin efektiv të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore. Shteti i së drejtës, garanton dhe respekton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut. Kushtetuta, afirmon se të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.

Të drejtat e fëmijëve janë të drejtat e njeriut. Fëmija është bartës i të drejtave dhe këto të drejta janë universale, të patjetërsueshme, të pandashme, të ndërvarura dhe progresive. Interesi më i lartë i fëmijës dhe garantimi i të drejtave, janë të parashikuara në Kodin e Familjes, së ndryshuar dhe në ligjin nr. 18/2017 "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës" si dhe në legjislacionin në fuqi. Çdo fëmijë, duke ndjekur frymën e ligjit, duhet të jetojë pa diskriminim dhe të mbrohet nga të gjitha format e dhunës, abuzimit, shfrytëzimit e neglizhimit. Miratimi i Ligjit për "Të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijëve" dhe ndryshimet në Ligjin për Dhunën në Familje në vitin 2020, sollën përmirësime lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Në kuadër të Reformës për Konsolidimin e Drejtësisë Penale për të Mitur, u ngrit për herë të parë Qendra e Parandalimit të Krimeve për të Miturve dhe të Rinjve. Bazat e drejtësisë penale për të mitur, janë të materializuara edhe në Strategjinë Ndërsektoriale të Drejtësisë dhe Planin e Veprimit, 2022-2026, që përbën dokumentin kryesor strategjik që përcakton si një nga shtyllat kryesore të tij, një sistem drejtësie penale, bazuar në parimet Evropiane të drejtësisë, që garanton risocializimin, riintegrimin dhe rehabilitimin, si dhe respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut dhe barazisë gjinore brenda një qasjeje të integruar dhe me praktika solide të parandalimit të krimit. Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë për të Mitur 2022- 2026 synon të forcojë dhe të konsolidojë aksesin në drejtësinë miqësore për çdo fëmijë me qëllim parandalimin parësor të përfshirjes së fëmijëve në kriminalitet dhe viktimizimin e tyre, aksesin në ndihmën juridike falas, fuqizimin e kapaciteteve të profesionistëve të drejtësisë, garantimin e një procesi të rregullt ligjor për çdo fëmijë në çdo kohë dhe pa vonesë, ushtrimin e të drejtave në fushën familjare, civile, administrative dhe penale, konsolidimin e masave alternative të shmangies nga ndjekja penale ose procedimi gjyqësor, me anë të zbatimit të programeve

[18] Deklarata Universale për të Drejtat e Njeriut, Konventa Ndërkombëtare për të Drejtat Civile dhe Politike, Konventa kundër Torturës si dhe Trajtimit apo Ndëshkimeve të tjera Mizore e Çnjerëzore apo Poshtëruese, Konventa "Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj gruas", (CEDAW) e ratifikuar me ligjin nr.7767, datë 09.11.1993 Konventa e Këshillit të Evropës "Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje" e ratifikuar me ligjin nr. 104/2012 datë 8.11.2012, Konventa e Kombeve të Bashkuara për të drejtën e personave me paaftësi (ratifikuar me ligjin nr. 108/2012); Konventa për mbrojtjen e fëmijëve kundër shfrytëzimit seksual dhe abuzimeve seksuale (ratifikuar në 14/4/2009); Konventa e të Drejtave të Fëmijës së OKB ratifikuar me Ligjin 7531, datë 11.12.1991; Konventa për njohjen dhe zbatimin e detyrimeve ushqimore (aderuar me ligjin nr. 10398, datë 17/3/2011); Konventa e Këshillit të Evropës për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve (qershor 2011), Konventa për statusin ligjor të fëmijëve të lindur jashtë martese (qershor 2011), e ratifikuar me ligjin nr.10 424, datë 2.6.2011, Pakti ndërkombëtar për të drejtat civile dhe politike.

restauruese e ndërmjetësuese, duke mbajtjur fëmijët jashtë proceseve penale dhe procedimeve gjyqësore këshillimit, mbikqyrjes së fëmijës në rastet kur familja ose përfaqësuesi ligjor i tij nuk mund ta ushtrojë, rehabilitimin dhe riintegrimin e fëmijës në shoqëri.

Objektivi Specifik 3.3 synon përmirësimin e drejtësisë për të mitur, duke garantuar një drejtësi miqësore ndaj të miturve, e cila mbron interesin më të lartë të tyre. Ai lidhet me Kapitullin 23 '*Gjyqësori dhe të drejtat themelore*' dhe Nenin 78 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit midis Komuniteteve Evropiane dhe shteteve të tyre anëtare dhe Republikës së Shqipërisë, "*Rifuqizim i institucioneve dhe shtetit të së drejtës*" si dhe Planin Kombëtar për Integrimin Evropian 2021–2023, Bazuar edhe në rekomandimet e Raportit të Komisionit Evropian për Shqipërinë për vitin 2020 prioritetet për Kapitullin 23 "Gjyqësori dhe të Drejtat Themelore.

Ky objektiv specifik lidhet me OZHQ 16 i cili promovon një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm, siguron qasje në drejtësi për të gjithë dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Në veçanti, ai lidhet me nën-objektivat 16.3 "*Promovim i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurim i aksesit të barabartë për drejtësi për të gjithë*", 16.6 "*Zhvillim i institucioneve efektive, llogaridhënëse dhe transparente në të gjitha nivelet*" dhe 16.7 "*Sigurimi i vendimmarrjes reaguese, përfshirëse, pjesëmarrëse dhe përfaqësuese në të gjitha nivelet*" të OZHQ.

Sfidat:

(i) Hartimi i politikave miqësore për të miturit përfshirë ndërtimin e kapaciteteve dhe shërbime të specializuara për të përmbushur nevojat e fëmijëve, përfshirë dhe miratimin e kritereve mbi trajnimin, licencimin, kreditimin e specialistëve të ndryshëm në kuadër të zbatimit të Kodit të Drejtësisë Penale për të Mitur;

(ii) Përmirësimi i kuadrit ligjor dhe përafrimi i tij, me instrumentet ndërkombëtarë;

(iii) Aksesi i barabartë në drejtësi, për të mitur, për persona me aftësi të kufizuara, për gratë, të rejat dhe vajzat në zonat rurale, dhe i pakicave Romëve dhe Egjiptianëve për regjistrimin civil, si dhe i personave me çrregullime të shëndetit mendor;

(iv) Bashkëpunimi midis hallkave të sistemit të drejtësisë dhe strukturave të pushtetit vendor, për plotësimin e kuadrit institucional, për të zbatuar në praktikë legjislacionin për drejtësinë për të mitur;

(v) Vënia në funksionim të mekanizimit të deklarimit të braktisjes, për të garantuar interesin më të lartë të fëmijës dhe duke mos i mbajtur fëmijët "peng" në institucionet sociale deri në mbushjen e moshës madhore, pa mundësuar kthimin e tyre pranë familjes biologjike ose të afërmve të tjerë dhe pa mundësuar, nga ana tjetër, vendosjen e tyre pranë një familjeje birësuese;

(vi) Mbrojtja e të dhënave të qytetarëve sipas standardeve më të larta të mbrojtjes së të dhënave dhe forcimi/promovimi i transparencës proaktive me qëllim rritjen e llogaridhënies dhe përgjegjshmërisë së autoriteteve publike;

(vii) Mbrojtje efikase, me mjete ligjore nga diskriminimi dhe marrja e masave për ndërgjegjësimin për mbrojtjen nga diskriminimi.

Vizioni: *Garantimi dhe respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, së ndryshuar dhe me instrumentet ndërkombëtare, duke siguruar një pjesëmarrje të barabartë dhe pa diskriminim në të gjitha sferat e jetës dhe aksesin në drejtësi dhe një proces të rregullt ligjor.*

Qëllimet e politikës:

- Funksionimi i një sistemi të integruar të mbrojtjes sociale, gjithëpërfshirës, të dobishëm dhe të ndjeshëm si dhe drejtësi miqësore për mbrojtjen e fëmijëve;
- Rritja e aksesit të grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTQI+, të moshuara, nëna të vetme, vajza mbi 16 vjeç, të mbijetuara të dhunës/trafikimit/shfrytëzimit, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj.) në shërbimet dhe produktet financiare, si dhe në burimet produktive;
- Mbrojtja më e mirë e grave, burrave, të rejave, të rinjve, vajzave dhe djemve, nga të gjitha grupet nga të gjitha format e praktikave të dëmshme, seksizmit, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje, përmes përmirësimit të legjislacionit, zbatimit efektiv të tij, ofrimit të shërbimeve mbështetëse të specializuara për personat e dhunuar, ndëshkimin e dhunuesve dhe vënien në funksionim të programeve rehabilituese;
- Përmirësimi i qasjes në drejtësi të grave, të rejave dhe vajzave, nga të gjithë grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTQI +, nëna të vetme, të moshuara, azilkërkuese, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese), për të mbrojtur të drejtat e tyre;
- Fuqizimi i grave, të rejave dhe vajzave nga të gjitha grupet (nga zonat rurale, minoritetet etnike, me aftësi të kufizuara, LGBTQI+, nëna të vetme, të dhunuara/trafikuara, vajza nëna, migrante dhe azilkërkuese, etj) për të pasur kontroll të plotë, për të vendosur lirshëm dhe me përgjegjësi për çështjet që lidhen me shëndetin seksual e riprodhues;
- Rritja e numrit të individëve me aftësi të kufizuara, romët dhe egjiptianët që përdorin shërbimet e ndihmës juridike falas;
- Ofrimi i ndihmës ligjore për pasqyrimin e të dhënave reale në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të Minoritetit Romë dhe Egjiptian me qëllim zgjidhjen e problematikave që i pengojnë në aksesin e tyre të plotë në shërbimin e gjendjes civile;
- Minimizimi/eliminimi i gjuhës së urrejtjes dhe krimeve të urrejtjes ndaj R&E, grave, vajzave, LGBTQI+ dhe kategorive të tjera;
- Zbatimi i normave rregullatore për të forcuar mbrojtjen e të dhënave personale në epokën e digjitalizimit të shpejtë;
- Rritja e ndërgjegjësimit të publikut mbi diskriminimin dhe të drejtën për mundësi të barabarta në përgjithësi, dhe mbi mënyrën se si preken sektorët, fushat dhe grupet shoqërore më të pamundura;
- Stimulimi i legjislacionit dhe i politikave që kontribuojnë për parandalimin e diskriminimit dhe vendosjen e barazisë gjinore.

Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të pronësisë

Reforma e Menaxhimit të Integruar të Tokës është një nga prioritetet kryesore për zhvillimin e vendit dhe do të mundësojë përshpejtimin e zhvillimit të vendit me ndikim të drejtpërdrejtë në aspektet ekonomike, sociale dhe mjedisore. Reforma përqendrohet në menaxhimin efektiv dhe të qëndrueshëm të tokës dhe sigurimin e shërbimeve cilësore dhe transparente ndaj publikut.

Reforma në fushën e të drejtave të pronësisë synon mbrojtjen e të drejtës së qartë të pronësisë dhe eliminimin e pasigurisë ligjore, dhe shihet si një çështje e ndërthurur dhe parakusht për konsolidimin e shtetit ligjor, zhvillimin ekonomik, tërheqjen e investimeve të huaja, dhe për plotësimin e kritereve për integrim në BE.

Ligji "Për Kadastrën" 111/2018, ka ngritur Agjencinë Shtetërore të Kadastrës si një nga institucionet kryesore të zbatimit të saj. Qëllimi kryesor i këtij ligji është të përmirësojë kuadrin ligjor të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, duke vendosur norma të reja ligjore për administrimin e regjistrit të pasurive të paluajtshme si dhe për përmirësimin dhe përditësimin e të dhënave kadastrale me synim korrektimin e pasaktësive dhe mungesave të trashëguara gjatë tre dekadave të fundit. Agjencia Shtetërore e Kadastrës (ASHK), është një bashkim i Agjencisë për Legalizimin, Urbanizimin dhe Integrimin Ndërtimeve Informale (ALUIZNI), Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) dhe Agjencisë për Inventarizimin dhe Transferimin e Pronave Shtetërore.

Ligji 20/2020 "Për përfundimin e proceseve tranzitore të pronësisë", plotëson Ligjin për Kadastrën duke përcaktuar proceset kryesore që do të realizohen nga ASHK, si përfundimi i Legalizimit të ndërtimeve informale, përfundimi i shpërndarjes dhe regjistrimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore dhe përfundimin e inventarizimit të pronave shtetërore. Digjitalizimi dhe unifikimi i të gjitha të dhënave kadastrale do të ndihmojë në përgatitjen e një kuadri efikas për menaxhimin e subvencioneve bujqësore.

Pasaktësia e të dhënave kadastrale mbi tokën dhe pasuritë e paluajtshme dhe digjitalizimi i pjesshëm i tyre mbetet problematika kryesore që përballon sot ASHK. Reformat prioritare në bujqësi, turizëm, menaxhimin e tokës shtetërore dhe tregun e tokës dhe pasurive të paluajtshme, kërkojnë një angazhim dhe investim thelbësor në cilësinë, besueshmërinë dhe efiçencën e të dhënave dhe shërbimeve kadastrale.

Vizioni: "*Shqipëria, një shtet ligjor Evropian i zhvilluar dhe i konsoliduar, i aftë të garantojë në praktikë të drejtën e pronësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut, të siguruar përmes një sistemi të rregulluar e të harmonizuar të pronës së patundshme, i cili ofron tituj pronësie të qartë dhe të sigurt dhe mbështet zhvillimin dinamik të tregut të tokës dhe pasurive të paluajtshme*".

Sfidat. Gjatë periudhës së SKZHIE 2022-2030, sfidat kryesore në fushën e pronësisë përfshijnë:

- Rregullimi dhe shpërblimi i drejtë i çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet nëpërmjet përfundimit të procesit të kompensimit të pronave në përputhje me kuadrin ligjor;
- Përfundimi i regjistrimit fillestar sistematik i pasurive të paluajtshme, duke përfshirë titujt e pronësisë mbi tokën bujqësore në përputhje me Ligjin 20/2020, në të gjithë territorin e vendit brenda 2030;
- Përfundimi i procesit të legalizimit të ndërtimeve informale duke mbrojtur të drejtat e pronarëve të truallit për një kompensim të drejtë dhe në afate ligjore;
- Përfundimi i inventarizimit dhe regjistrimit të pronave shtetërore;
- Digjitalizimi i të dhënave të Kartelave të Pasurive të Paluajtshme;
- Përmirësimi dhe përditësimi i të dhënave kadastrale me qëllim pasqyrimin dhe administrimin e saktë dhe real të pozicionit gjeografik dhe të drejtave ligjore mbi tokën dhe pasuritë e paluajtshme, duke përfshirë hartën kadastre, kartelën e pasurisë se paluajtshme dhe ndërlidhjen e të dhënave kadastrale dhe baza të tjera të dhënash shtetërore;
- Hartimi dhe zbatimi i planit të masave për luftën kundër korrupsionit në sistemin e regjistrimit të pasurive të paluajtshme;
- Ekzekutimin e vendimeve të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.

Qëllimet e politikës:

- Rregullimi dhe shpërblimi i drejtë i çështjeve të së drejtës së pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet nëpërmjet përfundimit të procesit të kompensimit të pronave në përputhje me kuadrin ligjor;
- Forcimi dhe mbrojtja e të drejtës së pronësisë dhe sigurimi kapaciteteve për të garantuar realisht të drejtën e pronësisë, si një nga të drejtat themelore të njeriut, nëpërmjet një sistemi të rregulluar dhe të harmonizuar të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, i cili ofron tituj të qartë dhe të saktë të pronësisë dhe mbështet zhvillimin dinamik të tregut të tokës dhe pasurive të paluajtshme;
- Zhvillimi i sistemit qëndror modern të menaxhimit të integruar të tokës, digjitalizimi dhe unifikimi i të gjitha të dhënave kadastrale për të mundësuar një përdorim dhe përditësim të thjeshtë dhe efikas të tyre nga të gjithë përdoruesit.

Forcimi i proceseve legjislative dhe zgjedhore

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres të konsiderueshëm në forcimin e procesit legjislativ, i cili ka kontribuar në forcimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor. Kuvendi i Republikës së Shqipërisë luan një rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës i vendit. Kuvendi përfaqëson vullnetin e popullit dhe është mbrojtësi i vlerave të demokracisë, si organi i zgjedhur që përfaqëson popullin Shqiptar, Kuvendi është organi ligjvënës, i cili shqyrton dhe miraton ligje në dobi të interesave të shoqërisë dhe të zhvillimit të vendit. Gjithashtu, Kuvendi luan një rol thelbësor në procesin e integrimit Evropian të vendit, duke garantuar legjitimitetin demokratik dhe kontrollin ligjor dhe politik të procesit. Mbështetjen mbi përparimin e Shqipërisë në rrugën drejt Bashkimit Evropian dhe hapjen e negociatave të anëtarësimit, Kuvendi e ka shprehur në rezolutat e datave 18 Qershor dhe 24 Shtator 2020. *Në vijim, Kuvendi do vijojë të rrisë cilësinë e ushtrimit të funksionit ligjbërës përmes përmirësimit të punës në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në komisionet parlamentare, në seancë plenare, duke përfshirë dhe aspektet gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.*

Vizioni i Kuvendit është: "Kuvend përfaqësues, efektiv, efiçent dhe transparent për qytetarët, drejt standardeve më të larta të demokracisë përfaqësuese".

Misioni i Kuvendit në kuadër të procesit legjislativ është: "Ligjbërje cilësore e mbështetur në evidencë, pranë qytetarëve, për konsolidimin e demokracisë, qeverisjen e mirë, zhvillimin, mirëqenien dhe integrimin Evropian të Shqipërisë".

Qëllimi i politikës për procesin legjislativ: *Rritja e cilësisë së ushtrimit të funksioneve ligjbërëse përmes "përmirësimit të punës në procesin e shqyrtimit dhe miratimit të projektakteve në komisionet parlamentare, në seancë plenare, duke përfshirë aspektet gjinore dhe objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm.*

Sistemi aktual zgjedhor i zbatuar në Shqipëri emërtohet "proporcional rajonal" për shkak se votimi është i ndarë në bazë të qarqeve dhe mandatet për partitë ndahen në proporcion me votat e marra. Ndryshimet e fundit të Kodit Zgjedhor japin risinë e "votës parapëlqyese". Votimi parapëlqyes i jep mundësinë votuesit, që krahas partisë të zgjedhë dhe njërin nga kandidatët. Për marrjen e një mandati në parlament, subjektet zgjedhore, përfshirë edhe kandidatët e pavarur, duhet të kalojnë pragun prej 1 përqind (një përqind) në shkallë vendi.

Amendimet e Kodit Zgjedhor, krijuan një arkitekturë të re të administrimit zgjedhor me formimin e tre organeve drejtuese të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, që janë Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve; Komisioni

Rregullator; Komisioni i Ankimimeve dhe Sanksioneve. Ndryshimet e Kodit Zgjedhor sollën risi në përdorimin e teknologjisë në zgjedhje në përputhje me këto ndryshime.

Masat prioritare në fushën e administrimit të procesit zgjedhor janë:

1. Të mundësohet votimi nga jashtë vendit në zgjedhjet për Kuvendin, për zgjedhësit që kanë vendbanimin e përhershëm jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
2. Implementimi i votimit elektronik, numërimit elektronik dhe të sistemit elektronik të identifikimit të votuesve në zgjedhje;
3. Forcimi i kontrollit të financimit të partive politike;
4. Rritja e informimit, edukimit dhe sensibilizimit të zgjedhësve duke pasur në fokus target grupet e synuara me qëllim rritjen e pjesëmarrjes në zgjedhje;
5. Forcimi i proceseve zgjedhore dhe legjislative, përfshirë funksionet përfaqësuese dhe mbikëqyrëse, të cilat do kontribuojnë në forcimin e demokracisë dhe të shtetit ligjor.

Politika e jashtme

Politika e jashtme e Shqipërisë mbetet aktive në garantimin e sigurisë, pavarësisë, integritetit territorial, përfaqësimin, mbrojtjen dhe forcimin e interesave kombëtare dhe zhvillimin e mëtejshëm ekonomik, si dhe për konsolidimin e rolit rajonal dhe ndërkombëtar të Shqipërisë. Kjo politikë karakterizohet nga vijueshmëria dhe qëndrueshmëria e prioriteteve.

Mbrojtja e interesit jetik kombëtar është boshti kryesor i veprimit diplomatik, ku ruajtja e koherencës se vendimeve politike dhe sigurimi i mbështetjes se gjerë nga opinioni publik përbëjnë elemente të domosdoshëm.

Sistemi ndërkombëtar në të cilin Shqipëria realizon interesat e saj strategjike bazohet në Kartën e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Aktit Final të Helsinkit dhe në parimin e zgjidhjes paqësore të mosmarrëveshjeve dhe konflikteve mes shteteve, si dhe në zbatimin e respektimin e së drejtës ndërkombëtare. Kryesimi i OSBE-së nga Shqipëria gjatë vitit 2020 kontribuoi pozitivisht në sigurinë Evropiane. Si anëtar jo i përhershëm në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara gjatë periudhës 2022-2023, Shqipëria është një aktor i rëndësishëm në skenën ndërkombëtare dhe projekton vlerat dhe parimet e rendit ndërkombëtar të bazuar në multilateralizmin me OKB në qendër të saj. Shqipëria ka qenë aktive në kontributet për misionet paqeruajtëse në botë.

Marrëdhëniet e vendit tonë me Bashkimin Evropian përcaktojnë boshtin tjetër kryesor të politikës së jashtme të Shqipërisë. Marrëdhëniet me BE janë strategjike dhe prioritare me synim anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në BE. Pas nisjes zyrtare të negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian, Shqipëria ka hyrë në një fazë të re, atë të vendit negociues, dhe me një perspektivë të qartë të anëtarësimit në BE. Ndërkohë, në zbatim të agjendës së stabilizim–asociimit, Shqipëria ka arritur asocimin e plotë të saj me BE-në, nëpërmjet arritjes së disa standardeve që nga rritja e efiçencës së organeve ligj zbatuese, ashtu edhe në arritjen e standardeve që lidhen me sigurinë individuale dhe të popullatës. Shqipëria linjëzohet plotësisht me politikën e përbashkët të jashtme e të sigurisë së BE. Linjëzimi i plotë është zgjedhja strategjike e Shqipërisë, duke u bërë kështu një partner i besueshëm i BE në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në arenën ndërkombëtare.

Shqipëria është pjesë e rajonit të Ballkanit Perëndimor dhe politika jonë e jashtme rajonale do të vijojë të konsolidohet si një politikë konstruktive dhe e moderuar rajonale, e mbështetur në parimet e fqinjësisë së mirë,

perspektivën euro-atlantike, bashkëpunimin gjithëpërfshirës, integrimin ekonomik rajonal (në tregti-mallra, shërbime, kapitale dhe lëvizshmëri, investime dhe digjitalizim), respektimit dhe përparimit të të drejtave të pakicave. Partneritetet strategjike në rajon dhe më gjerë, aktivitetet tri dhe katërpalëshe, mbledhjet e përbashkëta të qeverive, si dhe iniciativat rajonale shënojnë instrumente të rëndësishëm për një politikë të jashtme pro-aktive rajonale.

Potencialet e partneriteteve strategjike do të shfrytëzohen më tej në funksion të realizimit të objektivave të vendit tonë në marrëdhëniet me Bashkimin Evropian dhe për një zhvillim të qëndrueshëm të Shqipërisë në sektorët strategjikë prioritarë. Vlerësojmë angazhimin e vazhdueshëm të partnerëve strategjikë për luajtjen e një roli proaktiv dhe konstruktiv në lehtësimin e përparimit të merituar të Shqipërisë në rrugën e saj drejt BE-së. Gjithashtu, mirëpresim bashkëpunimin mes partnerëve Euro-Atlantikë në dobi të zgjidhjes së çështjeve të hapura në Ballkan, si një kontribut, jo vetëm në drejtim të forcimit të paqes dhe stabilitetit në rajonin e Ballkanit Perëndimor, por edhe në drejtim të avancimit të vendeve të rajonit në rrugën e tyre drejt BE-së.

Diplomacia Shqiptare kultivon **marrëdhënie dypalëshe dhe shumëpalëshe me partnerët tradicionalë,** rajonalë dhe globalë, në funksion të zhvillimit ekonomik të shpejtë dhe të qëndrueshëm të vendit, avancimit dhe maksimizimit të fitimeve tona kombëtare në tregti dhe investime, si dhe shtimin e partnerëve dhe bashkëpunëtorëve ekonomikë dhe tregtarë, thithjen e investimeve të huaja dhe rritjen e shkëmbimeve tregtare me prioritet ato vende, me të cilat ndajmë të njëjtat vlera demokratike, bazuar në interesat tona kombëtare.

Në bashkërendim dhe koordinim me të gjithë aktorët dhe faktorët shtetërorë dhe privatë, brenda dhe jashtë saj, Shqipëria bën përpjekje aktive për të **promovuar një imazh të ri dhe bashkëkohor të vendit në Evropë dhe botë**, zgjeruar atraktivitetin, prezantuar vlerat dhe interesat e vendit e shtetasve tanë, trashëgiminë tonë historike dhe kulturore, si dhe duke promovuar pasuritë kombëtare dhe potencialet ekonomike që ofron vendi në funksion të forcimit të marrëdhënieve ekonomike me vendet e tjera, rritjes dhe diversifikimit të produkteve dhe partnerëve tregtarë dhe të biznesit, si dhe rritjes së investimeve të huaja në vend. Tradita e bashkëjetesës në paqe e harmoni midis komuniteteve të ndryshme fetare promovohet si një vlerë unike kombëtare.

Politika e jashtme e Shqipërisë është **në shërbim të ruajtjes dhe promovimit të të drejtave të shqiptarëve në rajon,** duke vlerësuar kontributin e tyre konstruktiv në konsolidimin e shteteve ku jetojnë, apo perspektivës Euro-Atlantike të këtyre vendeve. Republika e Shqipërisë është e vendosur të përmbushë detyrimin e saj kushtetues për **respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të shqiptarëve kudo ku jetojnë,** bazuar në marrëveshjet ndërkombëtare, standartet e Bashkimit Evropian dhe ato më të mira ndërkombëtare dhe duke përdorur të gjitha mekanizmat diplomatikë, politikë, ekonomikë, arsimorë, kulturore apo komunikues.

Diaspora Shqiptare, historike dhe e re, është një aset dhe vlerë e shtuar e shoqërisë Shqiptare dhe organizimi i komuniteteve Shqiptare në botë ka qëllim faktorizimin dhe angazhimin e tyre në rritjen dhe forcimin e lidhjes me vendin amë, për përshpejtimin e zhvillimit ekonomik dhe social të vendit në kushtet e globalizmit dhe procesit të integrimit Evropian. Po ashtu, forcimi i lidhjeve dhe kontakteve me komunitetin shqiptar, synon identifikimin e nevojave të tyre, thellimin e bashkëpunimit kulturor, biznesit dhe arsimit, ofrimin e mbështetjes sa më koncize për problemet që hasin, integrimi dhe roli i tyre në aspektet ekonomike të vendit nëpërmjet tërheqjes së investimeve dhe njohurive (*know-how*) të tyre në vendin amë.

Qeveria Shqiptare ka qenë dhe mbetet e angazhuar fuqimisht në **respektimin e të drejtave të pakicave kombëtare në Shqipëri, si pjesë përbërëse e mbrojtjes dhe respektimit të të drejtave të njeriut**, konform standardeve ndërkombëtare. Qasja jonë ndaj të drejtave të pakicave kombëtare synon realizimin e një shoqërie ku dialogu, mirëkuptimi dhe diversiteti kulturor vlerësohen si parime të bashkëjetesës në një shoqëri të

përbashkët vlerash e respektimi të ndërsjellët, që është baza sociale e duhur për zhvillimin e qëndrueshëm dhe stabilitetin e vendit.

Shqipëria është një ndër vendet e pakta Evropiane që ka hartuar një ligj të veçantë mbi pakicat kombëtare, i cili është vlerësuar në përputhje me standardet ndërkombëtare, modelet dhe praktikat e mira si Konventa Kuadër për Mbrojtjen e Pakicave Kombëtare të Këshillit të Evropës, Zyra e Komisionerit për Mbrojtjen e Minoriteteve në OSBE, rekomandimet e organizatave ndërkombëtare etj.

Ligji i miratuar shpreh angazhimin e Shqipërisë, në radhë të parë, për përmirësimin e të drejtave të njeriut, si një detyrim ndaj qytetarëve të vet, pa asnjë diskriminim, dhe së dyti, në përmbushje të angazhimeve që rrjedhin nga Konventat ku është palë, si dhe të angazhimeve dhe objektivave në kuadër të procesit të integrimit të vendit.

Shqipëria dhe shërbimi i saj i jashtëm kanë bërë hapa të rëndësishëm në drejtim të **përshtatjes me teknologjitë e reja të informim-komunikimit**. Në këtë kontekst, është realizuar **lehtësimi i shërbimeve konsullore** nëpërmjet aplikimeve *on-line* si dhe **shtimi i komunikimit ndërmjet përfaqësive** tona diplomatike jashtë vendit dhe shtetasve (kryesisht shqiptare) në vendet përkatëse.

Platforma Shërbime Konsullore *on-line* (SHKO) tashmë ka sjellë ndryshime rrënjësore në ofrimin e shërbimit për shqiptarët në botë, rritjen e cilësisë, lehtësimin e procedurave, shkurtimin e kohës së shërbimit si dhe rritjen e transparencës dhe luftës kundër korrupsionit. Në vijim edhe të objektivave që qeveria ka vendosur (digjitalizimi i të gjitha shërbimeve që ofrohen nga institucionet shërbimofruese) shërbimet digjitale ofrohen brenda dhe jashtë vendit në masën 90 përqind.

Shtimi i përdorimit të teknologjive të reja të informim-komunikimit dhe i platformave sociale në jetën e përditshme ka bërë të domosdoshëm zhvillimin e diplomacisë digjitale. Kjo e fundit nuk duhet konsideruar si zëvendësuese e diplomacisë tradicionale, por si formë e re e ushtrimit të diplomacisë publike dhe si përshtatje e diplomacisë klasike në kontekstin aktual në funksion të përmbushjes së objektivave të politikes së jashtme.

Sfidat e sistemit

Projektimi i politikës sonë të jashtme në funksion të objektivave të zhvillimit të qëndrueshëm dhe integrimit Evropian të Shqipërisë do të duhet të marrë në konsideratë sfidat, si rezultat i përpjekjeve të vendeve të caktuara për **ndryshim të balancave gjeopolitike dhe gjeostrategjike** në rajone të caktuara.

Shqipëria e konsideron kuadrin e OZHQ-ve si pjesë të rëndësishme të vizionit për zhvillimin dhe integrimin e vendit, duke qenë plotësues i agjendës parësore për integrimin Evropian.

Duke qenë të ndërgjegjshëm se integrimi Evropian i Shqipërisë është në funksion të disa faktorëve, **politika jonë e jashtme do të jetë pro-aktive në drejtim të mbrojtjes së vlerave dhe parimeve të BE-së në politikën e jashtme, të sigurisë, dhe të mbrojtjes, çka përcaktohet nga zgjedhja strategjike e drejtimit të politikës sonë të jashtme. Politika e jashtme e shtetit shqiptar do të punojë për fuqizimin e komunikimit strategjik për avancimin e shpejtë të Shqipërisë në negociatat e anëtarësimit në BE, nëpërmjet evidentimit të progresit të arritur tek institucionet evropiane dhe shtete anëtare. Kjo do të ndikojë në rritjen kësisoj të imazhit të Shqipërisë si një vend partner i besueshëm në marrëdhëniet politike me institucionet evropiane dhe shtetet anëtare të BE-së, si dhe do të ruajë besueshmërinë e procesit të integrimit evropian të Shqipërisë në BE.**

Diaspora Shqiptare është dinamike, e integruar mirë brenda vendeve pritëse dhe është aktive në shumë fusha të çështjeve politike, ekonomike dhe sociale të atyre vendeve. Për të **konsoliduar marrëdhëniet me diasporën e**

saj, Republika e Shqipërisë fokuson përpjekjet e saj në parandalimin e asimilimit dhe humbjes së identitetit kombëtar të Shqiptarëve që jetojnë jashtë vendit.

Ruajtja dhe **intensifikimi i lidhjeve me diasporën** krijon një urë unike midis Shqipërisë dhe komunitetit ndërkombëtar, pasi organizatat e komunitetit Shqiptar në mbarë botën **mbështesin zhvillimin e lidhjeve dypalëshe me vende të ndryshme dhe nxisin integrimin Evropian të Shqipërisë** dhe konsolidimin e demokracisë.

Krijimi i një baze të dhënash për të gjitha organizatat dhe shoqatat e diasporës do të jetë një mekanizëm i rëndësishëm për koordinimin e veprimtarisë dhe informacionit.

Largimi i personave të kualifikuar dhe të arsimuar nga vendlindja vlerësohet si një dëm i zhvillimit social-ekonomik të një vendi, pasi ata janë forca zhvilluese e çdo vendi. Marrja e masave për të shmangur largimin e përhershëm të individëve të kualifikuar dhe të arsimuar kërkon nxitjen dhe promovimin e migracionit të përkohshëm, në veçanti të migracionit qarkullues të individëve të kualifikuar. Qeveria e Shqipërisë synon të aplikojë **kthimin vullnetar të emigrantëve të kualifikuar**, të përhershëm ose të përkohshëm, nëpërmjet qëndrimeve afat-shkurtra për qëllime konsultimi, mësimdhënie apo trajnimi. Kësaj do t'i shërbejë edhe evidentimi i të gjithë kapaciteteve intelektuale që ndodhen jashtë vendit.

Vizioni

Roli aktiv i politikës së jashtme të Shqipërisë në funksion të anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian (BE), si objektivi më i rëndësishëm strategjik i vendit gjatë dhjetëvjeçarit të ardhshëm, mbetet parësor. Shërbimi i jashtëm i Shqipërisë do të vijojë të kontribuojë qenësisht dhe në mënyrë prioritare në arritjen e objektivit afatshkurtër të hapjes zyrtare të bisedimeve të anëtarësimit, si një hap kyç dhe cilësor drejt realizimit të objektivit final të anëtarësimit në BE.

Anëtarësimi në BE është një proces që kërkon kohë dhe investim në përpjekje të konsiderueshme në nivelin e reformave të brendshme të lidhura me plotësimin e kritereve të anëtarësimit, por në fjalë të fundit ndikon në arritjen e disa standardeve që kanë të bëjnë me respektimin e vlerave dhe të standardeve të demokracisë, sundimit të ligjit dhe respektimit të të drejtave të njeriut.

Edhe në këtë kuptim, mbetet objektiv parësor strategjik i politikës sonë të **jashtme dhënia e një kontributi sa më të konsiderueshëm në drejtim të kujdesit dhe ruajtjes së marrëdhënieve të fqinjësisë së mirë**, **krijimit të një mjedisi sa më bashkëpunues dhe të sigurt, rajonal, Evropian dhe global,** që mundëson zhvillim të qëndrueshëm dhe partneritet të drejtë për Shqipërinë dhe shqiptarët kudo ku ndodhen.

Rajoni mbetet fokusi ynë i një rëndësie të posaçme, me një diplomaci aktive, konstante, të parashikueshme, në përputhje me vlerat Evropiane dhe standardet Euro-Atlantike. Shqipëria është një faktor kohezioni dhe përbashkimi për bashkëpunimin dhe integrimin rajonal, si dhe për të ardhmen euroatlantike. Faktori Shqiptar dhe Shqipëria janë tashmë të mirënjohur si aleatë të pazëvendësueshëm në rajon për luftën kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Po ashtu, ata mbeten një zë i fuqishëm dhe një aleat i padiskutueshëm në përballjen me aktivitetin shkatërrues të aktorëve të tretë në rajon dhe më gjerë.

Duke pasur parasysh ekspozimin në rritje të shumë çështjeve që lidhen me sigurinë dhe interesat tona kombëtare, **politika jonë e jashtme do të synojë të ushtrojë rolin e saj në fushën e diplomacisë shumëpalëshe**, si vendi më i përshtatshëm për të shprehur sovranitetin tonë kombëtar e për të ndjekur interesat tona kombëtare.

Qëllimet e politikës së jashtme dhe shërbimit diplomatik

- Politika jonë e jashtme bazohet mbi një parim të qartë strategjik, që është aleanca e patjetërsueshme strategjike me SHBA-të dhe BE-në;
- Vendosja e interesave të të gjithë shqiptarëve në qendër të diplomacisë sonë duke përmbushur njëkohësisht edhe funksionin e përmirësimit të imazhit të vendit;
- Forcimi i imazhit të një Shqipërie të fortë rajonalisht, që konsiderohet partnere serioze globalisht;
- Vazhdimi i kontributit të Shqipërisë në misionet paqeruajtëse në botë;
- Forcimi dhe intensifikimi i marrëdhënieve me vende dhe organizata partnere;
- Shqipëria mbetet e përkushtuar për marrëdhënie të mira fqinjësore dhe angazhim proaktiv në të gjitha nismat dhe formatet rajonale, me synimin e vetëm arritjen e standarteve që do të ndihmojnë anëtarësimin e plotë të Shqipërisë në BE;
- Çojmë përpara nismën Ballkani i hapur, vijojmë punën për të ndjekur zbatimin e marrëveshjeve të lidhura, por edhe për të eksploruar mundësi të reja bashkëpunimi mes 3 vendeve pjesëmarrëse;
- Vazhdimi i angazhimit në kuadër të Procesit të Berlinit, si për zbatimin e tre marrëveshjeve për mobilitetin në rajon, ashtu edhe për funksionalizimin e Tregut të Përbashkët Rajonal.
- Mbrojtja e të drejtave të shqiptarëve nëpër botë dhe ofrimi i shërbimeve cilësore për shtetasit tanë dhe diasporën Shqiptare.

Objektivat për Zhvillimin e Qëndrueshëm 2030 në realizmin e të cilave ndikon drejtpërdrejt politika e jashtme.

Objektivi 16. Promovimi i shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrim i aksesit në drejtësi për të gjithë dhe krijimi i institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

16.3 Promovimi i shtetit të së drejtës në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimi i aksesit të barabartë në drejtësi për të gjithë.

Objektivi 17. Forcimi i mjeteve të zbatimit dhe rivitalizimi i Partneritetit Global për Zhvillim të Qëndrueshëm.

17.16 Rritja e Partneritetit Global për Zhvillimin e Qëndrueshëm, shoqëruar me partneritete shumëpalëshe që mobilizojnë dhe ndajnë njohuri, ekspertizë, informacion për teknologjinë dhe burimet financiare, për të mbështetur arritjen e Qëllimeve të Zhvillimit të Qëndrueshëm në të gjitha vendet, veçanërisht në vendet në zhvillim.

Menaxhimi i integruar i kufijve

Shqipëria gjatë viteve 2013-2020 ka realizuar progres të vazhdueshëm në të gjithë komponentët përbërës të Menaxhimit të Integruar të Kufirit, si në fushën e përmirësimit të kuadrit ligjor, të koordinimit të agjencive kufitare, të rritjes së kapaciteteve administrative dhe profesionale të tyre, të aplikimit të Procedurave Standarte të Punës, të trajnimit dhe përshtatjes së kurrikulave, të përmirësimit të infrastrukturës dhe teknologjisë së informacionit, në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, lehtësimit të lëvizjes së lirë, por edhe të forcimit të goditjes së aktivitetit të paligjshëm nëpërmjet kufirit shtetëror dhe duke synuar siguri maksimale kufitare.

Menaxhimi i Integruari i Kufirit përbën një angazhim të veçantë në raport me përshtatjen e legjislacionit në fuqi, objektivave politike të vendit dhe Sigurinë Kombëtare, si dhe në kuadër të zhvillimeve rajonale e ndërkombëtare, veçanërisht në procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.

Është realizuar plotësisht paketa e duhur ligjore për kontrollin kufitar, duke u përafruar me legjislacionin komunitar të menaxhimit të kufirit. Në përmbushje të objektivave janë rishikuar marrëveshjet me vendet fqinje për Pikat e Kalimit Kufitar duke i kthyer ato në Pika të Përbashkëta të Kalimit Kufitar; është konsoliduar bashkëpunimi ndërmjet institucioneve të përfshira në kontrollin dhe menaxhimin e lëvizjes së shtetasve brenda dhe jashtë vendit; janë miratuar aktet ligjore dhe masat plotësuese për kontrollin e territorit; si dhe është përmirësuar legjislacioni kombëtar në lidhje me shkëmbimin efikas të informacionit ndërmjet agjencive kufitare.

Në drejtim të përmirësimeve organizative e strukturore, u konsolidua struktura e Policisë Kufitare dhe Migracionit, sipas rekomandimeve dhe bazuar në objektivat e Strategjisë, është ngritur dhe funksionon struktura e Analizës së Riskut dhe Sektori i Hetimit, organizimi i të cilave është rishikuar dhe përmirësuar në mënyrë të vazhdueshme.

Në të gjitha PKK e Republikës se Shqipërisë është i shtrirë dhe funksionon sistemi TIMS, një sistem ku Policia Kufitare evidenton hyrje/daljet në kufirin shtetëror dhe të gjithë problematikën që lind në kufi. Fushatat ndërgjegjësuese dhe puna sensibilizuese e bërë nga strukturat e ndryshme të Policisë së Shtetit dhe për llogari të agjencive të tjera të zbatimit të ligjit, ka lehtësuar ndjeshëm punën e Policisë Kufitare në kontrollin e qarkullimit të shtetasve, mjeteve dhe mallrave.

Fenomeni i migracionit të parregullt me prejardhje Afrikane dhe Aziatike në drejtim të vendeve të Bashkimit Evropian ka disa vite që ekziston duke u zhvilluar në rrugë dhe në mënyra të ndryshme. Në linja të përgjithshme ky migracion zhvillohet në rrugë detare, tokësore dhe nga ajri. Viti 2015, 2016 dhe 2017 njohu rënie të numrit të imigrantëve të parregullt, por viti 2018 dhe 2019 dhe viti 2020 shënon një trend rritjeje, me hapa të shpejtë, gjë që tregon se Shqipëria vijon të jetë vend atraktiv për kalimin tranzit nga Greqia drejt vendeve të Bashkimit Evropian.

QËLLIMI STRATEGJIK: ***Garantimi i lëvizjes së lirë e të sigurtë të shtetasve dhe qarkullimit të sigurtë të mallrave nëpërmjet kufirit shtetëror dhe marrja e masave të nevojshme për të parandaluar dhe goditur të gjitha format e krimit ndërkufitar dhe migrimit të parregullt.***

Qëllimet e politikës së në fushën e Menaxhimit të Integruar të Kufirit synojnë zhvillimin e një sistemi të integruar të administrimit të kufijve në përputhje me sistemin Evropian të mbikëqyrjes kufitare dhe rritjen e sigurisë kufitare:

1. Parandalimi dhe goditja e krimit ndërkufitar dhe menaxhimi i flukseve migratore;
2. Lehtësimi i qarkullimit legal të shtetasve dhe mallrave;
3. Respektimi i plotë i të drejtave themelore, përfshirë trajtimin e çdo individi me respekt të plotë për dinjitetin dhe mundësimin e qasjes në mbrojtjen ndërkombëtare të atyre që kanë nevojë.

REFERENCA ME KAPITULLIN E "ACQUIS":

- Kapitulli 24 "Drejtësia, Liria dhe Siguria", Nënkapitulli: Kufijtë e jashtëm

- Marrëveshja e Stabilizim Asociimit BE-Shqipëri (MSA): Titulli VII "Liria, Drejtësia dhe Siguria", Neni 80: "Vizat, menaxhimi i kufijve, azili dhe migracioni", Neni 81: "Parandalimi dhe kontrolli i imigrimit të paligjshëm; ripranimi". Marrëveshja është ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006
- Strategjia Evropiane Teknike dhe Operacionale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit.

Menaxhimi i migracionit

Migracioni vijon të jetë një fenomen i rëndësishëm në zhvillimin social dhe ekonomik të Shqipërisë dhe mirëqeverisja e tij një prioritet në procesin e anëtarësimit të vendit në Bashkimin Evropian. Në përgjithësi, Shqipëria vijon të jetë një vend i origjinës së emigrantëve ekonomikë, por edhe vend tranzit dhe i destinacionit për emigrantët ekonomikë, azilkërkuesit dhe refugjatët që vijnë kryesisht nga vendet e treta.

Gjatë viteve të fundit një vëmendje e veçantë i është kushtuar edhe çështjes së migracionit të parregullt të shtetasve shqiptarë, veçanërisht keqpërdorimit të regjimit pa viza në zonën Shengen dhe Bashkimin Evropian. Ministria e Brendshme, në rolin e institucionit lider për politikat e migracionit, ka reaguar me efikasitet nëpërmjet zbatimit të masave të duhura dhe fushatave të ndërgjegjësimit, të cilat kanë sjellë një rënie të ndjeshme të këtij fenomeni dhe aplikimeve për azil, gjatë viteve 2019-2021.

Situata aktuale migratore tregon se vendi ende nuk është përballur me flukse të mëdha, por që rreziku i një fluksi të papritur është ende aktual, veçanërisht duke konstatuar situatat e konfliktit në vendet e lindjes së mesme dhe në Ukrainë. Qeveria e Shqipërisë ka hartuar gjatë vitit 2021 një Plan Kombëtar Kontigjence, për një krizë të mundshme të migrimit dhe refugjatëve.

Shqipëria po bëhet një vend tërheqës për të huajt. Kuadri ligjor Shqiptar gjatë viteve të fundit ka qenë në një linjë me legjislacionin e BE-së dhe ka synuar ndërtimin e një politike migratore sa më të fortë dhe koherente. Në muajin Qershor të vitit 2021, Parlamenti Shqiptar miratoi ligjin e ri nr.79/2021 "Për të huajt", që synon përmirësimin e fushës së të drejtave të të huajve.

Shqipëria ishte gjithashtu vendi i parë, ndër vendet e rajonit, që nënshkroi dhe zbatoi marrëveshjen me FRONTEX për bashkëpunimin në menaxhimin e kufirit. Zbatimi i saj filloi me një operacion të përbashkët me FRONTEX, më 22 maj 2019. Shqipëria ka qenë pjesë aktive në proceset rajonale dhe ndërkombëtare, veçanërisht në Procesin e Pragës dhe Procesin e Budapestit. Gjithashtu, ka qenë pjesë aktive në iniciativën rajonale MARRI, e themeluar në Tiranë në vitin 2004. Shqipëria ka një bashkëpunim të shkëlqyer me Delegacionin e Bashkimit Evropian në Tiranë, si edhe me agjencitë e BE-së, si Europol dhe EASO.

Gjatë viteve të fundit është rritur ndjeshëm edhe bashkëpunimi me organizatat ndërkombëtare IOM dhe UNHCR. Shqipëria miratoi Paktin Global për Migracionin (GCM), gjatë Konferencës Ndërqeveritare të Marrakeshit, në Dhjetor 2018 dhe ka në vëmendje zbatimin e objektivave të paktit, kjo edhe në linjë me dinamikat e ndryshme të migracionit me të cilat vendi ynë është përballur dhe po përballet aktualisht..

Situata migratore jashtë dhe brenda vendit, kërkonte një qasje ndërsektoriale të qeverisjes së migracionit, me qëllim adresimin e sfidave që lidhen me flukset komplekse të migrimit. Për këtë qëllim në Qershor të vitit 2019, Qeveria miratoi Strategjinë Kombëtare për Migracionin (SKM) dhe Planin e saj të Veprimit (2019-2022).

Pavarësisht progresit në menaxhimin me efektivitet të migracionit në Shqipëri, si edhe zbatimit të suksesshëm të Strategjisë Kombëtare për Migracionin dhe Planin e saj të Veprimit (2019-2022), disa sfida mbeten të patrajtuara:

- Parandalimi i plotë i fenomenit të emigrimit të parregullt të shtetasve Shqiptar dhe keqpërdorimi i regjimit pa viza, në zonën Shengen dhe BE;
- Trajtimi efektiv i flukseve të përziera migratore që vijnë nga zonat e konfliktit;
- Forcimi i mekanizmit të ri-integrimit me qëllim garantimin e një kthimi të qëndrueshëm të shtetasve Shqiptar, përmes ofrimit të mbështetjes;
- Ndikimi i zhvillimit të migrimit duhet të forcohet, ndër të tjera me anë të promovimit të investimeve njerëzore dhe financiare të shqiptarëve që janë jashtë vendit për vendin;
- Forcimi i strukturave të menaxhimit të migracionit dhe politikave të imigracionit në drejtim të integrimit të imigrantëve, përfshirë aksesin në shërbimet parësore, në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Vizioni në fushën e migracionit, është që deri në vitin 2030, *në frymën e proceseve globale të migracionit dhe integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian, të ofrohet një përgjigje gjithëpërfshirëse dhe ndaj sfidave dhe mundësive të migracionit, në kontekstin e Shqipërisë.*

Qëllimi Strategjik: *'Qeverisja e efektshme e migracionit në Shqipëri, nëpërmjet adresimit dhe menaxhimit të problematikave dhe sfidave që lindin nga lëvizjet migratore, duke synuar rritjen e ndikimit të migracionit tek zhvillimi, në të mirë të migrantëve dhe shoqërisë Shqiptare'.*

Referenca me Kapitullin përkatës të "Acquis" Kapitulli 24, si dhe Kapitujt, 2,3,19.

Qëllimet e politikës

1. Zhvillimi i politikave të efektshme për migracionin për motive punësimi duke rritur ndikimin pozitiv të migracionit tek zhvillimi socio-ekonomik kombëtar/lokal;
2. Promovimi i migracionit të rregullt dhe mbrojtja e të drejtave të migrantëve dhe integrimi i tyre në shoqërinë Shqiptare.

Mbështetja e diasporës dhe Shqiptarëve kudo në botë

Diaspora Shqiptare, konsiderohet si një aset, vlerë e shtuar, por e larguar e vendit tonë. Krijimi dhe organizimi I komuniteteve të Shqiptarëve nëpër botë, ka për qëllim forcimin e marrëdhënieve midis Shqiptarëve të diasporës mes njëri tjetrit, si edhe forcimin e marrëdhënieve dhe vendosjes së urave të komunikimit me atdheun e tyre. Profesionistët e rinj të larguar, studentë të cilët studiojnë jashtë dhe më pas në përfundim të studimeve të tyre kërkojnë oportunitete të ndryshme, qoftë edhe jo në fushën e tyre, për të qëndruar në shtetin pritës. Kompleksiteti i fenomenit të diasporës kërkon koordinimin e shumë institucioneve dhe organeve shtetërore.

Vitet e fundit janë krijuar disa agjenci shtetërore në funksion të trajtimit të çështjes së diasporës:

1. Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës;
2. Qendra e Botimeve të Diasporës;
3. Qendra e Studimeve dhe Publikimeve për Arbëreshët.

Faktorët kryesorë të migrimit

1. Faktorë ekonomikë e shoqërorë: Largimi për arsye ekonomike, pabarazia, kushtet e vështira të jetesës, shërbimet;

2. Siguria publike: Përballje me valë të mëdha migracioni, familje me kushte të mira ekonomike që preferojnë migrimin;
3. Mungesa e besimit tek institucionet: Qytetarët bëhen më skeptikë në lidhje me përmirësimin e situatës në vend, korrupsioni i pranishëm dhe mosfunksionimi normal i organeve ligjzbatuese, si edhe vështirësia e hasur në ndërtimin e aktiviteteve private zbehin dhe ndikojnë negativisht në joshjen e emigrantëve të cilët kanë synim kthimin dhe vendosjen në vendin e tyre;
4. Mungesa e vizionit: Transparenca, vendosja e një ure komunikimi midis qeverisë dhe qytetarëve, nocioni më gjithëpërfshirës, prekja reale e ndryshimeve, qartësia në vizion dhe mungesa e një plani konkret për të zhvilluar vendin e tyre, duke shtuar dëshirën për qëndrim dhe zbehur dëshirën për largim;
5. Gjakmarrja: si një fenomen i njohur në Shqipëri, ndonëse shkakton një përqindje të vogël të migrimit.

Fenomeni Brain Drain, largimi i profesionistëve, inovatorëve, të rinjve/rejave të arsimuar/a për një jetë më të mirë, kushte më të mira ekonomike nga një shtet në një shtet tjetër është fenomen i cili ndodh në shtete në zhvillim dhe vërehet dukshëm në realitetin Shqiptar. Largimi i personave të arsimuar dhe të kualifikuar nga vendlindja, konsiderohet si një humbje dhe dëm i madh i zhvillimit social-ekonomik, pasi etiketohen si forca kryesore e zhvillimit të një vendi, fuqia e tij për të ecur në drejtimin e duhur.

Vizioni

Vizioni ka për synim rivlerësimin e angazhimit të diasporës duke u bazuar në strukturën e marrëdhënieve aktuale të shtetit shqiptar me diasporën. Parashikon angazhimin e Shqipërisë për përforcimin, nxitjen e iniciativës për ndërtimin e urave afatgjata dhe funksionale me komunitetet e shqiptarëve në diasporë duke kuptuar si interesat e zhvillimit ekonomik të vendit, ashtu edhe rëndësinë e ruajtjes së identitetit kombëtar. Misioni është fuqizimi i rolit të diasporës shqiptare në zhvillimin ekonomik të vendit dhe me ekspertizë profesionale.

Qëllimet e politikës

Strategjia Kombëtare e Diasporës përqendrohet në një strukturë objektivash strategjikë të cilët ndihmojnë në fokusin e aktiviteteve që do të organizohen nëpërmjet Planit të Veprimit. Për objektivat strategjikë të Strategjisë Kombëtare të Diasporës është marrë parasysh nevoja për të realizuar një marrëdhënie të rregulluar institucionale në angazhimin e diasporës shqiptare, si edhe përcaktimi i komponentëve kyçë tematikë dhe operacionale për zbatimin e strategjisë. Objektivat kryesorë janë:

- Përshtatja e ndryshimeve ligjore me nivelin e politikëbërjes;
- Koordinimi i administratës shtetërore për nivelin e ri të politikës shtetërore për diasporën;
- Angazhimi i strukturave shtetërorë të krijuara për të përmirësuar dhe fuqizuar bashkëpunimin me komunitetet Shqiptare në diasporë.

Zhvillimi i rrjeteve funksionale të biznesit, të mësuesve, të mjekëve, të shkrimtarëve, të mediave, të avokatisë dhe rrjeti i angazhimit të grave do të inkurajohen. Rrjetet profesionale janë vlerësuar si mekanizma partneriteti nëpërmjet së cilave strukturat shtetërore dhe diaspora mund të bashkëpunojnë për të sjellë ndryshime progresive. Ndërtimi i rrjeteve profesionale në diasporë përfshin edhe planifikimin dhe zbatimin e fushatave të informimit dhe të rritjes së ndërgjegjësimit për:

1. Regjistrimin e migrantëve për votim dhe të drejtën e votës (pas miratimit në Kuvend);
2. Mbrojtjen e identitetit dhe kulturës shqiptare në komunitetet Shqiptare të diasporës;
3. Organizimin e informacionit për çështje me interes profesional apo që kanë të bëjnë me zhvillimet e fundit politike, sociale dhe ekonomike në vendin e origjinës;
4. Zhvillimin e një kuadri ligjor për investimet nga diaspora Shqiptare;
5. Realizimin e një strukture të rrjeteve të profesionistëve të diasporës Shqiptare.

Zhvillimi duhet të fillojë në rrënjë, përkrahja dhe mbështetja për brezin e ri duhet të jetë e palodhur dhe konstante, në mënyrë që truri, njerëzit e punësuar dhe profesionistët e rinj mos të largohen nga vendi ynë dhe të japin kontribut në zhvillimin ekonomik, social, kulturor në të ardhmen e dëshiruar.

Janë hartuar dhe do të realizohen projekte me synime si:

- koordinimi i administratës shtetërore me nivelin e ri të politikës shtetërore për diasporën për të fuqizuar bashkëpunimin me komunitetet Shqiptare në diasporë;
- digjitalizimi i plotë i shërbimeve, regjistrimi i popullsisë dhe votimi në diasporë;
- përmirësimi i kuadrit ligjor në raport me zhvillimet social-ekonomike të vendit; ruajtja e identitetit, gjuhës dhe kulturës me krijimin e qendrave kulturore;
- prodhimin, transmetimin dhe financimin e emisioneve të posaçme televizive, arsimore dhe kulturore, të dedikuara për diasporën;
- çertifikimi i mësuesve për mësimin e gjuhës dhe kulturës Shqiptare në diasporë;
- inkurajimi i investimeve duke krijuar një klimë të favorshme për investimet nga diaspora nëpërmjet aktiviteteve për stimuj fiskalë, shpërndarje informacioni, ulje të riskut si dhe përmirësim të elementëve të tjerë nxitës;
- krijimi i strukturave institucionale për të realizuar "rikthimin e trurit", tërheqjen e profesionistëve të diasporës për angazhime afatshkurtra dhe afatgjata si dhe studentëve ekselentë shqiptarë, të cilët mund të jenë një forcë kontribuese për vendin e origjinës.

Lufta kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe trafikimit

Lufta kundër krimit të organizuar është përpjekje e gjithë shoqërisë Shqiptare, veçanërisht e institucioneve ligjzbatuese si dhe një kusht për integrimin. Përpjekja e Reformës në Drejtësi duhet parë e lidhur me këtë realitet, luftën ndaj korrupsionit dhe krimit të organizuar.

Institucionet e vendit në këtë drejtim kanë ngritur në mënyrë të qëndrueshme kapacitetet për t'u përballuar me këtë kërcënim. Zhvillimi i Institutit të Policisë Shkencore, krijimi i Akademisë së Sigurisë, nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe dhe shumëpalëshe, trajnimet dhe kalimi i Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Konfiskuara dhe Sekuestruara nën Ministrinë e Brendshme janë vetëm disa nga masat e marra në këtë drejtim.

Përmirësimi i situatës së rendit publik në vend tregohet nga indikatorët dhe nga raportet ndërkombëtare. Krahas vlerësimeve periodike të kryera nga institucionet Shqiptare, organizma ndërkombëtarë të pavarur dhe të paanshëm, raportojnë, se: "*Shqipëria ka bërë përparim të mirë në forcimin e luftës kundër krimit të organizuar ... dhe rezultate të prekshme janë arritur në këtë drejtim*". Sipas Komisionit Evropian, përparimi i bërë në këtë

drejtim nga vendi ynë dëshmohet përmes intensifikimit të mëtejshëm të operacioneve policore për shkatërrimin e grupeve kriminale dhe angazhimit të fortë për të shkatërruar trafikimin e drogës.

Një vëmendje e posaçme i është kushtuar rëndësisë dhe rolit të institucioneve të reja të drejtësisë, konkretisht Prokuroria e Posaçme. Sipas vlerësimit të Task-Forcës së Veprimit Financiar (FATF), Shqipëria ka ndërmarrë hapa në drejtim të forcimit të efektivitetit të regjimit të saj kundër pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, duke përfshirë miratimin e legjislacionit për zbatimin e regjistrit për pronarët përfitues, marrjen e masave për reduktimin e ekonomisë informale dhe përdorimin e cash-it dhe ngritjen e ekipeve të specializuara dhe zyrtarëve për hetimin dhe ndjekjen penale të pastrimit të parave, në çdo qark.

Gjatë periudhës 2015-2021 është bërë një progres i vazhdueshëm në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda. Me gjithë përparimin e bërë, sfida kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda mbetet e madhe dhe për këtë arsye rishikohet qasja në përballjen me të.

Si rezultat i veprimtarisë së krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, ndër vite, shumë qytetarë kanë vuajtur pasojat e kësaj veprimtarie në forma të ndryshme, si trafikimi për qëllime prostitucioni apo pune të detyruar, zhvatja e vlerave monetare apo materiale, dëmtimi i pronës dhe i pasurisë dhe deri në dëmtimin e shëndetit dhe humbjen e jetës. Anëtarët e strukturave të krimit të organizuar kanë shfaqur, gjithashtu, synimin dhe prirjen për veprime neutralizuese të punës së nëpunësve publikë, përfshirë institucionet e zbatimit të ligjit dhe të organeve të drejtësisë, përmes formave të ndryshme të intimidimit dhe të korrupsionit.

Për më tepër, krimi i organizuar ka ndikim negativ në ekonominë e ligjshme të një vendi. Nëpërmjet përfitimeve të mëdha monetare, grupet kriminale synojnë të kryejnë investime dhe depërtojnë në sektorë të ndryshëm të ekonomisë nëpërmjet formave të ndryshme të pastrimit dhe të riciklimit të të ardhurave kriminale, prezantimin e praktikave gjysmë të ligjshme të biznesit dhe krijimin e aktiviteteve të ligjshme për të mbuluar veprimtaritë e fshehta kriminale dhe origjinën e të ardhurave të përftuara prej tyre, dëmtimin e konkurrencës etj.

Qëllimi strategjik: *Garantimi i një mjedisi të sigurt për zhvillimin e vendit dhe të shoqërisë nga kërcënimet e krimit të organizuar dhe e krimeve të rënda, duke siguruar jetën e individit, sipërmarrjen e lirë dhe respektimin e ligjshmërisë në tërësi.*

Referenca me Kapitullin përkatës të "Acquis", Kapitulli 24, "Drejtësia Liria dhe Siguria".

Qëllimi I Politikës 1: *Ulja e kërcënimit dhe ndikimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda*

Ky qëllim politik mbështetet në vizionin për mbrojtjen e qytetarëve dhe përparimit të vendit nga kërcënimet dhe ndikimi i krimit të organizuar dhe krimet e rënda, përmes zvogëlimit të risqeve dhe rritjes së fuqisë parandaluese. Me qëllim të uljes së kërcënimit të krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, nevojitet adresimi njëkohësisht i shqetësimeve kryesore që lidhen me veprimtaritë e paligjshme të krimit të organizuar, sidomos atyre në fushën e narkotikëve dhe trafiqeve të paligjshme, si dhe veprave penale në fushën e krimit ekonomik dhe pastrimit të parave.

Qëllimi i Politikës 2: *Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë*

Qëllimi politik "Mbrojtja e qytetarëve, institucioneve dhe ekonomisë", synon rritjen e qëndrueshmërisë së shoqërisë kundër krimit të organizuar. Në luftën kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, agjencitë ligjzbatuese duhet të jenë të afta të garantojnë shëndetin dhe jetën e dëshmitarëve, bashkëpunëtorëve, funksionarëve të drejtësisë, viktimave të trafikimit dhe grupe të tjera vulnerabël. Në këtë mënyrë do të rritet besimi i njerëzve në institucionet shtetërore dhe do të forcohet marrëdhënia shtet-qytetar.

Shqipëria, si një vend i cili është renditur që në momentet e para në koalicionin kundër terrorizmit përgjatë viteve ka modernizuar legjislacionin si dhe ka ngritur kapacitete të reja të specializuara për të adresuar këtë çështje. Gjithashtu, edhe në kuadër të Kapitullit 24 të Acquis "Drejtësia, Liria, Siguria" lufta kundër terrorizmit mban një seksion të veçantë dhe është një ndër kriteret kryesore për procesin e anëtarësimit në BE, në kuadër të konsolidimit të shtetit të së drejtës, rritjes së sigurisë në vend dhe respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të individit.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka bërë progres në masat parandaluese kundër terrorizmit dhe ekstremizmit të dhunshëm, rritjen e kapaciteteve të agjencive ligj-zbatuese dhe zhvillimin e politikave efektive në këtë fushë. Progresi i bërë në parandalimin e terrorizmit dhe konsolidimit të kapaciteteve u pasqyrua në raportet e progresit të viteve të fundit të Komisionit Evropian për Shqipërinë në luftën kundër terrorizmit duke vlerësuar arritjet e Shqipërisë. Në progres raportin e vitit 2020, Shqipëria është vlerësuar për kuadrin ligjor gjithëpërfshirës për parandalimin dhe luftimin e financimit të terrorizmit i cili është mjaft i avancuar në përafrimin me pjesën kryesore të acquis të BE -së.

Strategjia e BE-së Kundër Terrorizmit dhe Plani i Përbashkët i Veprimit Kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor, nënshkruar nga BE dhe të gjithë partnerët e Ballkanit Perëndimor, në Tetor 2018, është dokumenti kryesor politik në këtë fushë. Ky plan ka si objektiv shkëmbimin efektiv të informacionit dhe bashkëpunimin operacional mes vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe agjencive ligj-zbatuese të BE. Shqipëria ka shënuar progres të dukshëm duke realizuar plotësisht 3 nga 5 objektivat e këtij plani ndërkohë që dy objektivat e tjerë janë në progres pozitiv. Më 9 dhjetor 2022 u miratua marrëveshja e rishikuar për zbatimin e Planit të Përbashkët të Veprimit kundër Terrorizmit në Ballkanin Perëndimor mes Komisionit Evropian dhe autoriteteve shqiptare për një periudhë 2 vjeçare (2023-2024).

Bashkëpunimi ndërkombëtar i policisë vazhdoi të jepte rezultate të mira në lidhje me operacionet e policisë, ndalimet dhe bashkëpunimin për hetimet. Numri i hetimeve kundër terrorizmit dhe financimit të terrorizmit, po ashtu u rrit gjatë këtyre viteve. Analiza e riskut dhe përdorimi i inteligjencës penale u përmirësua në mënyrë të konsiderueshme gjatë këtyre viteve në luftën kundër terrorizmit. Rekomandimet e MONEYVAL për luftën ndaj pastrimit të parave dhe financimin e terrorizmit u adresuan. Ndryshimet në Kodin Penal trajtuan çështjen e luftës kundër terrorizmit dhe financimit të tij.

Juridiksioni për të gjitha veprat terroriste u përqendrua përsëri në nivelin e Zyrës së Prokurorisë Speciale SPAK dhe Gjykatave Speciale në qershor të vitit 2021. Qendra Koordinuese në Luftën kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, e kryesuar nga koordinatori kombëtar i Qendrës Koordinuese Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm, është ngarkuar me ngritjen e kapaciteteve, koordinimin e aktiviteteve të Qendrës Koordinuese Kundër Ekstremizmit të Dhunshëm në institucionet qeveritare dhe mbikëqyrjen e zbatimit të strategjisë kombëtare kundër ekstremizmit të dhunshëm.

Një fokus i veçantë ju kushtua luftës kundër terrorizmit, në veçanti, parandalimit të ekstremizmit dhe radikalizmit të shoqëruar me orientime të forta fetare dhe etnike. Kjo u pasqyrua në ndryshimet e bëra në Kodin Penal dhe hyrjen në fuqi të "Ligjit për ndalimin e pjesëmarrjes në konflikte të armatosura nga qytetarët Shqiptarë jashtë territorit të vendit", i cili parashikon ndëshkimin e rëndë të veprave të tilla penale.

Një sërë ndjekjesh penale dhe dënime kanë përfunduar me sukses gjatë viteve 2015-2020 në fushën kundër krimeve terroriste.

Bashkëpunimi rajonal dhe shkëmbimi i informacionit të ndjeshëm me partnerët ndërkombëtarë mbetet i kënaqshëm. Edhe pse ka progres, strukturat e antiterrorit duhet të përdorin më proaktivisht platformën e komunikimit, produktet dhe shërbimet e Qendrës Evropiane kundër Terrorizmit dhe të vazhdojnë të bashkëpunojnë me Njësinë e Referimit të Internetit të Europol. Shqipëria gjithashtu duhet të vazhdojë të hetojë lidhjet midis krimit të organizuar dhe terrorizmit.

SFIDAT

Pavarësisht arritjeve të dukshme dhe progresit të bërë në luftën kundër terrorizmit, disa nga sfidat kryesore janë:

- Rreziku i riaktivizimit të kërcënimit terrorist qoftë nga pjesëtarët e organizatave terroriste përmes luftëtarëve të huaj terroristë, celulave të fjetura por edhe nga simpatizantët dhe mbështetësit që mund të inspirohen për kryerjen e akteve të dhunshme;
- Indoktrinimi me ideologji radikale/ekstremiste e bazuar kryesisht përmes propagandës në internet;
- Kërcënimi nga terrorizmi kibernetik – sfidat që burojnë nga epoka kibernetike;
- Rreziku i infiltrimit përmes migracionit të parregullt i personave të përfshirë në organizata terroriste etj.

Qëllimi strategjik: Shqipëria, një shoqëri gjithëpërfshirëse, e sigurt, pa kërcënime terroriste, me realitetin dhe imazhin e një vendi paqësor, me standarde Evropiane të sigurisë dhe të respektit të përbashkët për të drejtat e njeriut, barazinë dhe liritë themelore

REFERENCA ME KAPITULLIN PËRKATËS TË "ACQUIS"

Kapitulli 24 i Acquis (Planit Kombëtar të Integrimit Evropian) "Drejtësia, Liria dhe Siguria"

- Nënkapitulli: Lufta kundër terrorizmit;

Kapitulli 31 i Acquis (Planit Kombëtar të Integrimit Evropian) "Politika e Jashtme, e Sigurisë dhe e Mbrojtjes"

- Nënkapitulli: Lufta kundër terrorizmit;

Marrëveshja e Stabilizim Asociimit

- Titulli VII "Liria, drejtësia dhe siguria";

Nëntitulli: Bashkëpunimi në luftën kundër pastrimit të parave dhe drogave të paligjshme

Në këtë pjesë të MSA është parashikuar edhe lufta kundër financimit të terrorizmit.

- Nëntitulli: Bashkëpunimi kundër terrorizmit.

Qëllimet e politikës:

- Qasja parandaluese - parandalimi i terrorizmit dhe ekstremizmit e radikalizimit që çon në terrorizëm përmes sistemit të sinjalizimit të hershëm;
- Qasja hetuese - goditja e grupeve/rrjeteve dhe individëve të përfshirë në veprimtari terroriste përmes hetimit dhe zbulimit të veprave të terroriste;

- Qasja reaguese rehabilituese dhe riintegruese - rritja e kapaciteteve institutionale për t'ju përgjigjur sulmeve terroriste dhe reduktimi i pasojave të fenomeneve të ekstremizmit të dhunshëm dhe terrorizmit;
- Qasja mbrojtëse – rritja e nivelit të sigurisë dhe mbrojtjes nga kërcënimet.

Fuqizimi i rendit publik, mbrojtjes së vendit dhe përgatitja për rastet e emergjencave civile

Siguria Kombëtare

Shqipëria, si vend anëtar i NATO-s, karakterizohet nga siguria, paqja dhe prosperiteti. Anëtarësimi në NATO dhe perspektiva e anëtarësimit në BE kanë forcuar demokracinë dhe rritur stabilitetin e brendshëm e vendi është shndërruar në një faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon.

Rajoni i Ballkanit nga pikëpamja gjeostrategjike përfaqëson një zonë ndërthurjeje kulturore, fetare, ideologjike dhe një mjedis konkurrence për influencë politiko-ekonomike. Ky diversitet, i shfrytëzuar nga vende me qëndrim jo miqësor ndaj NATO-s, rajonit dhe vendit tonë, përbën kërcënim për paqen dhe prosperitetin e rajonit.

Kriza e viteve të fundit në Lindjen e Mesme është shoqëruar me një rritje të migracionit të paligjshëm dhe aktiviteteve kriminale. Migracioni, i nxitur nga situata e vështirë ekonomike, presioni demografik, konfliktet e armatosura, qeverisja e dobët dhe ndryshimet klimatike, do të vazhdojnë të jenë çështje madhore në dekadën e ardhshme.

Kërcënimet dhe sulmet kibernetike përbëjnë kërcënim potencial për sigurinë globale, rajonale dhe sigurinë e Republikës së Shqipërisë. Rreziku për sigurinë e sistemeve dhe rrjeteve kompjuterike të strukturave të mbrojtjes vlerësohet shumë i lartë, veçanërisht në lidhje me informacionin që trajtohet në to. Shqipëria do të mbështetet në mbrojtje të fortë dhe elastike kibernetike për të përmbushur detyrat kryesore në kuadër të Aleancës për mbrojtjen kolektive, menaxhimin e krizave dhe sigurinë së përbashkët. Sfidë për Mbrojtjen dhe Sigurinë Kombëtare mbetet përgatitja për të mbrojtur rrjetet dhe operacionet, në kushtet e sofistikimit në rritje të kërcënimeve dhe sulmeve kibernetike me të cilat mund të përballet. Gjatë viteve të fundit, pas hyrjes së vendit tonë në NATO, është evidentuar një rritje e kërcënimeve nga shërbimet e huaja me qëndrim jo-miqësor ndaj NATO-s dhe vendit tonë.

Gjithashtu në kontekstin e zhvillimit të mëtejshëm të konceptit të sigurisë kombëtare kemi përpara disa sfida:

1. Adresimi i aspektit mjedisor të sigurisë kombëtare dhe tre komponentëve të tij kryesorë: problemet mjedisore që vijnë nga lufta ose konflikti i armatosur; mosmarrëveshjet ndërkombëtare mbi kontrollin, aksesin dhe zotërimin e burimeve; fatkeqësitë natyrore dhe katastrofat industriale;

2. Fusha të tjera të rëndësishme të politikave – si ekonomia dhe financat, energjia dhe infrastruktura, teknologjia dhe industria – duhet të kuptohen dhe diskutohen përmes një lenteje të sigurisë kombëtare;

3. Në vijë me mishërimin e partneritetit me NATO dhe BE, në raport me politikën e përbashkët të sigurisë, mbrojtjes dhe atë të jashtme, ekziston nevoja e artikulimit më të qartë të konceptit të interesit tonë kombëtar (*national interest*) në termat e zhvillimit të vendit si edhe të objektivave kyçe të sigurisë kombëtare që do ndihmonin për këtë.

Objektivat Strategjikë 2030

Mjedisi i përgjithshëm dinamik i sigurisë kërkon zhvillimin e kapaciteteve në mënyrë të tillë që të sigurohet vazhdimësia e realizimit me sukses të kërkesave për informacion të konsumatorëve të çdo niveli, për zbulimin në kohën e duhur të kërcënimeve dhe rreziqeve. Objektivat strategjikë do të jenë:

1. Bashkëpunimi i zgjeruar i strukturave të inteligjencës me ato të NATO/BE dhe vendeve partnere;
2. Modernizimi dhe zhvillimi i kapaciteteve të vendit.

Objektiva të parashikuara në kuadër të mbrojtjes kibernetike

a) Ngritja dhe vendosja në funksion të plotë operacional të Njësisë Ushtarake të Sigurisë Kibernetike, për monitorim dhe reagim në kohë reale në mjedisin kibernetik;

b) Zhvillimi i dokumenteve strategjike dhe doktrinore në fushën e mbrojtjes kibernetike si edhe aplikimi i praktikave më të mira në mbrojtjen e sistemeve të teknologjisë së informacionit;

c) Shtrirja e bashkëpunimit ndër-institucional kombëtar dhe ndërkombëtar.

Mbrojtja e vendit

Zhvillimet gjeopolitike të kohëve të fundit dhe përkeqësimi i situatës së sigurisë në kufirin lindor të Aleancës janë pasqyrë e një mjedisi ndërkombëtar sigurie nën presion të vazhdueshëm nga kërcënime komplekse, shumëdimensionale dhe me ndryshime të papritura.

Ky mjedis dinamik, i shfrytëzuar nga aktorë shtetërorë me interesa rajonale dhe marrëdhënie të ngushta historike me shtete të caktuara të rajonit, nxit ndjeshëm kërcënimet dhe rreziqet në situatën e sigurisë rajonale.

Ndërkohë që kërcënimet janë në rritje, do ta kemi më të nevojshme të bashkëpunojmë me partnerët, duke u ngritur në lartësinë e tyre, duke shprehur vullnetin tonë për të investuar më tepër për njerëzit me uniformë që garantojnë mbrojtje dhe siguri.

Në muajin Shtator 2019 u miratua dokumenti i Rishikimit të Strategjisë së Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë, i cili përshkruan interesat strategjikë kombëtarë dhe politikat e mbrojtjes si edhe përcakton bazën e zhvillimit dhe përparësitë e transformimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH).

Sektori i Mbrojtjes është i fokusuar në krijimin e një Force Moderne si edhe implementimin e një modeli koherent, të shkathët dhe inovativ të Forcave të Armatosura, duke siguruar pjesëmarrje aktive në operacionet e drejtuara nga NATO, BE, dhe OKB por edhe në angazhime të brendshme të cilat potencialisht çojnë në pjesëmarrje më të shpeshta në aktivitete në mbështetje të popullatës.

Sfidat. Sfidat në sektorin e mbrojtjes fokusohen në përmbushjen e detyrimeve kombëtare si dhe kontributit në kuadrin ndërkombëtar kombëtar si e lidhur ngushtësisht dhe thelbësisht nga përqasja e fortë atlantike, që ka vendi ynë. Këto janë: 1) përshtatja me "Procesin e Reflektimit NATO - 2030, "Agjendën Trans-Atlantike për të Ardhmen" dhe "Konceptin e ri Strategjik" si udhërrëfyeset tona në kuadër të sigurisë brenda mundësive dhe kapaciteteve kombëtare; 2) përfundimi i reformës në fushën e Arsimimit të Lartë Ushtarak e cila do të plotësojë nevojat e mbrojtjes; 3) mbrojtja e sistemeve të komunikimit dhe informacionit dhe të infrastrukturës nga sulmet dhe manipulimet e mundshme kibernetike; 4) sinergji e plotë bashkëpunimi dhe mbështetje e përbashkët me

partnerët; 5) ndërtimin e një force të ndërveprueshme dhe të shkallëzuar që mund t'i përgjigjet në mënyrë proaktive situatës dhe e aftë të veprojë në një larmi skenarësh ku lind nevoja për aktivizimin të saj.

Vizioni: "Ushtri moderne, e ndërveprueshme dhe kontribuese"

Objektivat Strategjikë

1. Përmbushja e misionit kushtetues të FARSH: Në koordinim të ngushtë me instrumentet e tjera të fuqisë kombëtare, sipas konceptit të gjithëpërfshirjes, duke angazhuar sipas ligjit të gjitha kapacitetet e vendit, publike dhe private.

2. Modernizimi i kapaciteteve të Forcave të Armatosura: Në përmbushje të këtij objektivi, në mënyrë specifike synohet:

- Arritja dhe mbajtja e shpenzimeve në nivelin 2 përqind të PBB për buxhetin e mbrojtjes, 20 përqind e të cilit për investimet dhe modernizimin;
- Zbatimin e paketës së Objektivave të Kapaciteteve, me prioritet njësitë e deklaruara në NATO;
- Zhvillimin e rrjeteve të informacionit dhe komunikimit të sigurtë.

3. Ndërveprimi me Aleancën, dislokueshmëria dhe vetëmbështetja e FARSH: Vëmendje e shtuar do të kushtohet në drejtim të rritjes së ndërveprueshmërisë, dislokueshmërisë dhe vetëmbështetjes së strukturave të Forcave të Armatosura, si rezultat i rritjes së mundësisë që FARSH të angazhohet njëkohësisht për kryerjen e operacioneve brenda dhe jashtë vendit.

4. Reformimi i sistemit të Arsimimit të Lartë Ushtarak: Akademia e Forcave të Armatosura, si institucioni i vetëm publik i arsimit të lartë, në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kombëtare, do të vijojë transformimin e mëtejshëm.

5. Ndërtimi i një organizate më të zgjuar, të shkathët dhe inovative: Me qëllim përfitimin maksimal nga zhvillimet teknologjike dhe inovacioni, sektori i Mbrojtjes do të kontribuojë në zhvillimin e shoqërisë sonë përmes mbështetjes më të gjerë të inovacionit të teknologjisë në FARSH.

6. Promovimi i bashkëpunimit rajonal dhe fqinjësisë së mirë: Bashkëveprimi në kuadrin ndërkombëtar, orientohet nga roli ynë në kontekstin e NATO-s, bashkëpunimi me aleatët e ngushtë, si dhe synimet strategjike dhe objektivat parësore të politikës së jashtme të Shqipërisë. Në kuadër rajonal, do të vijojë kontributi aktiv në iniciativat rajonale dhe të synohet nxitja e bashkëpunimit, për konsolidimin e sigurisë, stabilitetit dhe paqes në Evropën Juglindore.

Siguria publike:

Niveli i rendit publik dhe sigurisë në vendin tonë gjatë viteve të fundit paraqitet në parametra normal, si rezultat i rritjes së aftësive profesionale të Policisë së Shtetit dhe forcimit të kontrollit të territorit. Shqipëria është sot një vend më i sigurt për të gjithë ata që jetojnë në territorin e saj, për jetën, bizneset dhe pronat e tyre, për investimet e huaja dhe turistët që e vizitojnë atë.

Gjatë gjithë periudhës 2015-2021 nga analiza e treguesve të aksidenteve rrugore rezulton se çdo vit në krahasim më vitin paraardhës ka pasur reduktim të numrit të aksidenteve rrugore nga 2,6 përqind deri në 17.6 përqind më pak, me përjashtim të vitit 2016. Reduktime të ndjeshme gjatë periudhës 2015-2021 ka pasur edhe për sa i

përket pasojave të ardhura nga aksidentet rrugore. Përforcimi i zbatimit të ligjit në fushën e sigurisë rrugore ka luajtur rol të veçantë për të parandaluar sjelljet e shpeshta të rrezikshme të përdoruesve të rrugës.

Gjatë viteve 2016-2018 policia rrugore u riorganizua, ku është implementuar sistemi i tabletave digjitale (250 njësi). Gjatë periudhës 2015-2020, masat e marra dhe të zbatuara nga Policia e Shtetit janë fokusuar në ndryshimin cilësor të sistemit të kontrollit të territorit dhe policimit në komunitet, në funksion të parandalimit të kriminalitetit dhe shkeljeve të ligjit.

Reformimi i strukturave dhe funksionimit të Policisë së Shtetit me fokus në reformën e personelit, rritjen e bashkëpunimit operacional, shkëmbimin në kohë të informacionit policor, mbështetjes logjistike dhe aktiviteteve të ndërgjegjësimit të publikut, si dhe përmirësimet në drejtim të transparencës, digjitalizimit të shërbimeve të policisë, shërbimit ndaj qytetarit, si dhe trajtimit financiar, ekonomik dhe logjistik konsiderohen arritje të dukshme dhe të prekshme.

Një prej risive më të mëdha në nivel vendor për fuqizimin e sigurisë publike janë Këshillat Vendorë të Sigurisë Publike (KVSP). Procesi i ngritjes së KVSP-ve në Shqipëri nuk është shoqëruar deri më tani me akte ligjore ose nënligjore akoma, por synohet që ky mekanizëm këshillues të bëhet funksional në vazhdimësi.

SFIDAT

Problemet të cilat ndikojnë në sigurinë në komunitet, që nga aktet kriminale në fushën e sigurisë në komunitet e deri tek problemet e funksionimit të mekanizmave relevantë në këtë fushë, janë një ndër sfidat kryesore për shtetin dhe shoqërinë shqiptare në përgjithësi. Sfidë mbetet:

- Parandalimi i veprave penale dhe krimeve të tjera, duke u udhëhequr nga filozofia e "Policimit në komunitet", përmes ndërveprimit të vazhdueshëm me komunitetin dhe organet e vetëqeverisjes vendore;
- Sigurimi i ligjshmërisë në territor dhe një marrëdhënie të re me biznesin, komunitetin në tërësi dhe shoqërinë civile në funksion të garantimit të sigurisë së qytetarëve;
- Përmirësimi i menaxhimit të qarkullimit rrugor me synim minimizimin e aksidenteve; parandalimit dhe përballimit të situatave emergjente;
- Marrjes së përgjegjësisë dhe llogaridhënies së institucioneve përgjegjëse dhe koordinimit më të mirë të mekanizmave në nivel qendror dhe vendor si p.sh krijimi, forcimi dhe institucionalizimi i Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike, ridimensionimit të rolit të prefektit për menaxhimin dhe koordinimin e kontrollit në territor.

Qëllimi i Politikës Nr. 1: *Rritja e parametrave të sigurisë në komunitet*

Qëllimi i politikës nr. 1 synon, rritjen e sigurisë në komunitet nëpërmjet sigurisë rrugore, uljes së kriminalitetit/sjelljeve anti shoqërore në komunitet, uljen e veprave penale që cenojnë sigurinë në komunitet. Gjithashtu duhet të synuar vizionin i BE-së (Vizioni Zero), lidhur me objektivin e saj strategjik afatgjatë për të arritur afër zero vdekjeve dhe zero lëndime serioze në rrugët e BE-së deri në vitin 2050 dhe objektivin afatshkurtër për të reduktuar vdekjet dhe lëndimet e rënda me 50 përqind deri në vitin 2030 në përputhje me Deklaratën e Valetës.

Qëllimi i Politikës Nr.2: A*ngazhimi dhe ndërveprimi me komunitetin*

Kjo politikë ka në thelb filozofinë e policimit në komunitet, duke synuar vendosjen dhe ruajtjen e besimit të ndërsjellë si qëllim kryesor të komponentit të parë thelbësor të sigurisë në komunitet, atë të partneritetit me komunitetit, ka në thelb parandalimin e sjelljeve kriminale duke i angazhuar dhe ndërvepruar me komunitetin nëpërmjet edukimit/ndërgjegjësimit, përmirësimit të komunikimit me publikun si dhe instiucionalizimin e Këshillave Vendorë të Sigurisë Publike.

Qëllimi i Politikës Nr 3: "*Kontrolli i Territorit*"

Ky qëllim politik, synon kontrollin e plotë të territorit, jo vetëm në fushën e ndërtimeve pa leje, por të mjedisit ujërave dhe pyjeve si edhe paligjshmërive të tjera. Në fokus do të jenë edhe puna për krijimin e "qyteteve të sigurta për gratë dhe vajzat" (në përputhje me OZHQ 11.7), të cilat mund të lëvizin pa frikën e ngacmimit apo dhunës (verbale, fizike e seksuale) në hapësirat publike urbane dhe rurale

Policia e Shtetit do të marrë një rol të rëndësishëm në kontrollin e territorit duke u bërë forcë kryesore përgjegjëse për evidentimin e çdo lloj forme paligjshmërie ndaj territorit, mjedisit dhe pyjeve. Njëherësh, veprimet e përbashkëta të Policisë së Shtetit me institucionet tjera do të përqendrohen në masat parandaluese, si dhe në penalizimin e shkelësve të ligjit. Aksioni i strukturave shtetërore për heqjen e ndërtimeve pa leje në bregdet, në zonat e mbrojtura dhe në interes të planeve kombëtare e rajonale zhvillimore do të intensifikohet më tej.

Mbrojtja Civile dhe Emergjencat:

Për shkak të pozitës gjeografike, Shqipëria është një vend i prirur ndaj fatkeqësive natyrore, si tërmetet, përmbytjet, zjarret në pyje dhe rrëshqitjet e dheut. Shqipëria shtrihet në një zonë sizmikisht aktive dhe lëkundjet janë të zakonshme, ndërsa tërmetet e mëdha janë më pak të shpeshta, por ndodhin. Sipas raportit vjetor të riskut botëror, i cili llogarit indeksin e riskut të fatkeqësive për 180 vende bazuar në ekspozimin, ndjeshmërinë, vulnerabilitetin dhe aftësitë përballuese dhe adaptuese, Shqipëria renditet e para në Evropë dhe e 61-ta në botë.

Ndryshimet klimatike të viteve të fundit të shoqëruara me zjarre masive në të gjithë territorin, ndryshime të theksuara të temperaturave dhe kushteve të motit, përmbytjeve të çrregullta me forcë në rritje e plot fenomene të tjera natyrore të pazakonta deri disa vite më parë, e kanë nxjerrë edhe më në pah nevojën për përgatitjen dhe përballjen e fuqishme sistematike që duhet në raste të tilla.

Përvojat e fundit treguan se ekziston një nevojë urgjente për të forcuar gatishmërinë ndaj fatkeqësive dhe aftësitë e menaxhimit të riskut, për të miratuar sisteme dhe procedura të përshtatshme reagimi dhe për të përmirësuar kapacitetin institucional për koordinimin dhe menaxhimin e reduktimit të risqeve nga fatkeqësitë për bashkëveprimin midis niveleve publike të qeverisë, si dhe me aktorët privatë dhe ata të shoqërisë civile. Në këtë drejtim, vëmendja u përqendrua në përmirësimin e bazës ligjore në kuadër të emergjencave civile çka bëri të mundur vendosjen e koncepteve moderne, gjithëpërfshirëse dhe në përputhje me terminologjinë Evropiane e botërore, duke synuar zbatimin më efektiv të masave për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, të cilat nga ana e tyre kanë një ndikim thelbësor në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Me qëllim përmirësimin e mëtejshëm të punës, nga viti 2017 planifikimi dhe përballimi i emergjencave civile janë përgjegjësi e Ministrisë së Mbrojtjes, ku është ngritur dhe funksionon Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), e cila ka përgjegjësinë për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile, në të gjithë

territorin e Republikës së Shqipërisë. Funksionalizimi i AKMC, është i fokusuar në plotësimin dhe forcimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të infrastrukturës së mbrojtjes civile dhe emergjencave.

Qëllimet e politikës

- Krijimi, konsolidimi dhe përforcimi i strukturave të emergjencave civile në nivel qendror dhe veçanërisht në atë vendor, për të siguruar komunikimin dhe informimin e hershëm nga rreziqet e mundshme, gatishmërinë, koordinimin dhe përgjigjen në situatat e emergjencës civile në nivel vendor, rajonal e kombëtar si edhe menaxhimin e informacionit mbi humbjet nga fatkeqësitë;
- Ngritja e Qendrës Kombëtare të Trajnimit për Mbrojtjen Civile dhe zhvillimi i burimeve njerëzore të sistemit të mbrojtjes civile, për të siguruar kushtet e përshtatshme për trajnimin e personelit dhe aktorëve të tjerë të sistemit të mbrojtjes civile;
- Rritja e kapaciteteve teknike të strukturave operacionale të mbrojtjes civile;
- Krijimi dhe funksionimi i rrjetit të vullnetarëve për angazhimin në aktivitete të mbrojtjes civile apo në operacionet e parandalimit dhe të përballimit të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësive të tjera në nivelin qendror dhe lokal;
- Plotësimi i kuadrit nënligjor duke u fokusuar në Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, vlerësimin e riskut nga fatkeqësitë në nivel qendror dhe Planin Kombëtar për Emergjencat Civile;
- Përmbushja e kushteve dhe anëtarësimi në Mekanizmin Evropian të Mbrojtjes Civile;
- Bashkëpunimi dhe ndërveprimi me strukturat homologe rajonale në drejtim të mbështetjes së ndërsjellët në kuadër të mbrojtjes civile.

Krijimi i një mjedisi mundësues për shoqërinë civile dhe zhvillimin e saj

Subjektet e regjistruara si organizata pa qëllim fitimi, kanë një rol të rëndësishëm dhe të pazëvendësueshëm në përfaqësimin dhe promovimin e grupeve të interesit publik në fushat përkatëse të aktivitetit të tyre. Ndonëse numri i organizatave të regjistruara është relativisht i lartë, vetëm një pjesë e tyre arrijnë të jenë aktive gjatë gjithë vitit. Fokusi i aktivitetit të OJF-ve ndjek shpesh planet zhvillimore të partnerëve, ndërsa intensiteti i punës dhe rezultatet e tyre varen shpesh nga ecuria e mbështetjes financiare nga jashtë.

Në vazhdën e reformave dhe të rrugëtimit të Shqipërisë drejt BE, shteti Shqiptar ka zhvilluar dhe vënë në përdorim mekanizma dhe platforma të ndryshme që kanë si qëllim të mbështesin pjesëmarrjen e OJF-ve në proceset e politikëbërjes. Nëpërmjet AMSHC, shteti Shqiptar ka vënë në dispozicion një linjë buxhetore për të mbështetur zhvillimin e sektorit të OJF-ve si dhe punën e tyre.

Organizatat e shoqërisë civile kanë përfituar gjithashtu nga marrëdhëniet me simotrat e tyre në rajon dhe BE për të ngritur dhe fuqizuar rrjetëzime me impakt në politikëbërje në Ballkan dhe në shtetet anëtare të BE. Nga ana tjetër, sinergjitë me organizata bamirëse të huaja të fokusuara në zonat rurale dhe më të varfëra kanë kontribuar në lehtësimin e kushteve të jetesës së banorëve të këtyre zonave.

Fillimi i negociatave me BE pritet të ndikojë pozitivisht dhe fokusi i punës së OJF-ve do të kushtëzohet për nga përmbajtja si dhe nga forma. Përmbajtja do të duhet të përvijohet në kuadrin e kapitujve të negociatave dhe të reformave të ndërlidhura, ndërsa forma e pjesëmarrjes do të bazohet gjithashtu në shembujt e suksesshëm të vendeve fqinje. Po ashtu, progresi drejt anëtarësimit hap mundësi të tjera pjesëmarrjeje në komponentë politikë-bërje të BE, që shoqërohen me mundësi mbështetjeje financiare shtesë dhe qasje në linja të reja dhe më

të mëdha buxhetore. Konteksti gjeopolitik dhe situatat financiare që pasojnë pritet të rrisin vëmendjen dhe kërkesat e qytetarëve ndaj politikëbërjes. Si pasojë, roli i OJF-ve si zë i pavarur i qytetarëve dhe përfaqësuesi tjetër i interesave të tyre në nivel komuniteti, lokal, kombëtar, rajonal dhe në BE, merr një rëndësi strategjike.

Sfida kryesore me të cilën sektori përballet është legjitimiteti i organizatave të shoqërisë civile. OJF përfaqësues të interesave të qytetarëve janë relativisht të pakta dhe të fokusuar kryesisht në aktivitete në shërbim komuniteteve të caktuara apo në fusha të veçanta si në sektorin e mjedisit. Nismat për një përfaqësim shumë-sektorial përtej sektorit të mjedisit kanë rezultuar të përkohshme, për shkak të interesit të ulët të qytetarëve për çështje të vlerësuara jo-urgjente dhe larg vendit ku banojnë, si dhe nga një vëmendje e ulët e donatorëve për çështje urgjente por që nuk janë në plan-programet e tyre shumë-vjeçare. Niveli i aktivizimit qytetar shpesh është ulur me shuarjen e kauzës për të cilën OJF kanë qenë fillimisht të angazhuar.

Duke u varur në mënyrë jo të qëndrueshme nga donacionet institucionale vendore ose të huaja, sektori i OJF-ve në Shqipëri përballet me sfidën e humbjes së kontaktit me nevojat e qytetarëve dhe për pasojë reduktimin e legjitimitetit. Nga ana tjetër, shpesh institucionet shtetërore dhe donatorët e ndryshëm rrezikojnë të kontribuojnë në rritjen e nivelit të mos-besueshmërisë së shoqërisë drejt tyre dhe të humbasin një nga partnerët e tyre të besueshëm për zbatimin e iniciativave të ndryshme dhe ofrimin e njohurive të specializuara në sektorë të ndryshëm.

Duke marrë parasysh dobësitë sa më sipër, mbështetja e shoqërisë civile do të vijojë nga ngritja e kapaciteteve të organizatave jo-qeveritare, drejt rritjes së qëndrueshmërisë së tyre dhe mbi të gjitha, në rritjen e impaktit të tyre në terren dhe mirëqenien e qytetarëve. Si pasojë, një numër relativisht i lartë programesh mbështetëse kanë filluar të funksionojnë ku synimi është mbështetja e shembujve lokalë të suksesshëm, dhe identifikimi e mbështetja e tyre. Në këtë drejtim, një qasje transversale unike nga mbulimi, përfshirja dhe impakti është duke u zbatuar në kuadër të Titullit Evropian "Tirana Kryeqyteti Evropian i Rinisë 2022".

Vizioni: *Mbështetja dhe inkurajimi i OJF-ve Shqiptare për një përfaqësim sa më të qenësishëm dhe aktiv të interesave të qytetarëve dhe një kontribut praktik në reformat e ndërmarra dhe në politikat zhvillimore dhe të integrimit në BE, në nivel komuniteti, lokal, kombëtar, rajonal dhe në politikat e BE-së që ofrojnë mundësitë për një qasje të tillë.*

Qëllimet e politikës

SKZHIE 2030 synon rritjen e reziliencës, rëndësisë, legjitimitetit dhe impaktit të aktorëve të sektorit të OJF-ve në Shqipëri si: i) përfaqësues të interesave të grupeve qytetare; ii) mbajtës të njohurive kritike të domosdoshme për suksesin dhe qëndrueshmërinë e reformave, politikave sektoriale dhe progresit të vendit drejt BE-së; dhe, iii) partnerë të institucioneve dhe faktorë në suksesin e reformave, të zhvillimit të vendit dhe progresit të vendit drejt BE-së.

- Përfundimi, zbatimi, përmirësimi dhe thjeshtimi i vazhdueshëm i kuadrit ligjor, institucional dhe financiar që rregullon funksionimin e OJF-ve në Shqipëri;
- Vlerësimi, rishikimi dhe zbatimi i kuadrit institucional i pjesëmarrjes së OJF-ve në politikëbërje në të gjitha nivelet: komunitar, lokal, kombëtar, rajonal dhe BE, kompletuar me burimet e nevojshme;
- Përfshirja aktive e shoqërisë civile në negociatat me BE për anëtarësimin e plotë të Shqipërisë;
- Rivitalizimi dhe përmirësimi i mekanizmave koordinues të mbështetësve të OJF-ve kombëtare dhe ndërkombëtare e sidomos Këshillit Kombëtar për Shoqërinë Civile, dhe mekanizmave zbatues dhe

burimeve përkatëse; dizajnimi dhe adoptimi i një qasjeje përfshirëse të OJF-ve në të gjithë ciklin e jetësimit të ndihmës së huaj, me fokus të veçantë tek IPA;

- Promovimi i rasteve të suksesit dhe identifikimi i mekanizmave të përshtatshëm për të mobilizuar qytetarët – në zona urbane dhe rurale – në aktivitete që synojnë mbrojtjen dhe promovimin e interesit të komunitetit dhe të mirave të përbashkëta.

Qeverisja e mirë, e hapur dhe administrimi publik

Reforma e mirëqeverisjes dhe administrimit publik është një nga shtyllat e procesit të zgjerimit, bashkë me shtetin e së drejtës dhe qeverisjen ekonomike, të cilat përbëjnë edhe bllokun e parë që hapet në kuadër të procesit të negociimit. Një mirëqeverisje efikase dhe administratë publike që funksionon sipas standardeve të BE-së si dhe një menaxhim cilësor është e domosdoshme për qeverisjen demokratike. Në këtë këndvështrim, përpjekjet e Qeverisë kanë qenë të fokusuara në kriterin politik që lidhen veçanërisht me reformat e mirëqeverisjes, e cila prek gjerësisht administratën publike, financat publike, shërbimet publike, digjitalizimin, antikorrupsionin dhe qeverisjen vendore.

Pavarësisht sfidave të shumta të krijuara nga tërmeti i 2019 dhe pandemia COVID-19, gjatë viteve të fundit Shqipëria ka bërë progres në zbatimin e reformave të rëndësishme në fusha të ndryshme të administrimit publik. Një nga qëllimet kryesore të sistemit të mirëqeverisjes është rritja e cilësisë së menaxhimit, llogaridhënies dhe transparencës. Për të krijuar një sistem efikas politikash dhe projektligjesh sa më gjithëpërfshirëse dhe transparente, janë krijuar mekanizmat e nevojshëm ligjorë që sigurojnë pjesëmarrjen e publikut. Konsultimi publik është një nga gjashtë fushat e parimeve të administrimit publik të monitoruara nga Komisioni Evropian dhe është pjesë e objektivit të politikës të strategjisë së reformës së administratës publike.

Konsultimi publik gjatë vitit 2021 ka ndjekur trend pozitiv të performancës që vijon nga viti 2019, duke shënuar rritje të treguesve të cilësisë në lidhje me zbatimin e procesit. Mesatarja e tre viteve të fundit të realizimit të indeksit të konsultimit publik është 72 përqind, duke treguar zhvillim pozitiv. Ecuria e kuadrit strategjik për vitin 2021 rezulton se janë hartuar dhe publikuar 34 përqind e raporteve të monitorimit dhe vlerësimit për strategjitë më të rëndësishme, duke rezultuar rreth 20.3 përqind më i lartë krahasuar me 2019 dhe 2018. Lidhur me strategjitë në kuadër të mirëqeverisjes, indeksi i performancës për raportet e monitorimit rezulton të jetë 30.06 përqind.

Përsa i përket përmirësimit të procesit të rekrutimit, tashmë i digjitalizuar në çdo fazë, puna ka vijuar me unifikimin e praktikave në menaxhimin e shërbimit civil në nivel qëndror dhe vendor; zhvillimin e procedurave të rekrutimit të bazuar në meritë; ngritjen e kapaciteteve në fushën e zbatimit të legjislacionit të shërbimit civil; ndërveprimin dhe standartizimin e proceseve në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore përmes përdorimit të platformës së bashkëpunimit "administrata.al"; përdorimin e Sistemit Informatik të Menaxhimit të Burimeve Njerëzore (SIMBNJ) dhe shtrirjes së tij në institucionet e administratës publike.

Si rezultat i praktikave pozitive dhe këtyre zhvillimeve është rritur numri i pjesëmarrësve në procedurat e rekrutimit duke treguar rritjen e besueshmërisë së publikut për pjesëmarrje në procedurat e rekrutimit të bazuar në meritë, e cila ka ardhur si pasojë e punës në drejtim të respektimit rigoroz të legjislacionit, transparencës me publikun, aktiviteteve në funksion të rritjes së vizibilitetit, etj.

Portali e-Albania u shërben mbi 2.6 milionë qytetarëve dhe 221,074 bizneseve (2.8 milionë të regjistruar) pa asnjë kosto shtesë, pa pritur në radhë dhe pa pasur asnjë kontakt fizik me punonjësit apo administratën. Jane bërë mbi 40 milionë aplikime për shërbime elektronike kryesisht në shërbime të gjendjes civile, turizëm, kulturë

dhe art, financë dhe ekonomi, shërbime sociale, arsim, punë të jashtme etj. Për sa i përket qeverisjes elektronike dhe ofrimit të shërbimeve publike interaktive për qytetarët dhe bizneset, si treguesi kryesor i ofrimit të shërbimeve është arritur që 95 përqind e të gjitha shërbimeve publike ofrohen vetëm online. Në e-Albania aktualisht ofrohen 1,227 shërbime elektronike vetëm on-line.

Riinxhinierizimi për shërbimet publike si masë e nevojshme për thjeshtësimin e procedurave administrative dhe reduktimin e numrit të hapave procedurial të ndërmarrë nga qytetarët dhe stafi mbështetës është arritur në 91 përqind. Gjithashtu niveli i realizimit të produkteve të Agjendës digjitale është shumë i mirë (bazuar në shkallën 86 përqind-110 përqind të outputeve/aktiviteteve të realizuara). Revolucioni digjital i shërbimeve publike në Shqipëri ka ndryshuar prej kohësh perceptimin e qytetarëve, në lidhje me komunikimin elektronik me institucionet shtetërore. Qeveria Shqiptare, si promovuese e shndërrimit të shërbimeve offline në shërbime online, e shndërroi platformën e-Albania, e cila ne 2013 kishte vetëm 14 shërbime elektronike, në një histori suksesi dhe arriti të ndërtojë një imazh serioz të shtetit dhe të rivendoste besimin e qytetarëve në institucionet publike.

E gjithë veprimtaria bazohet në një kornizë të posaçme ligjore, e cila ka ecur paralelisht me të gjitha proceset e implementimit teknik të procedurave, për zhvillimin e e-Qeverisjes në vend. Qëllimi i këtyre politikave është lehtësimi i procedurave për ofrimin dhe përfitimin e shërbimeve publike elektronike, ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarin dhe përmirësimin e jetesës, si dhe garantimin e gjithëpërfshirjes duke mos lënë askënd të privuar marrja e këtyre shërbimeve.

Kjo qasje ndaj digjitalizimit të shërbimeve është vlerësuar edhe nga raportet e organizatave ndërkombëtare. Sipas Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Shqipëria u rendit në vendin e 59-të në botë në Indeksin e Qeverisjes Elektronike dhe në vendin e 31-të për shërbimet *on-line*, duke lënë pas jo vetëm të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor, por edhe vende të tjera Evropiane si Zvicra, Italia dhe Gjermania. Komisioni Evropian gjithashtu, ka vlerësuar për dy vitet e fundit, progresin e bërë në shërbimet e qeverisjes elektronike, duke theksuar rolin e rëndësishëm që ato luajnë në uljen e korrupsionit dhe informalitetit.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale, rrjeteve të telekomunikacionit/komunikimeve elektronike të shpejta dhe shumë të shpejta është një domosdoshmëri për të mbështetur gjithë transformimin digjital të ekonomisë dhe zhvillimet inovatore në sektorë strategjikë si energji, transport, industri, edukim, arsim etj. si dhe përmirësimin rrënjësor të cilësisë së shërbimeve publike. Qeveria Shqiptare ka vazhduar promovimin e TIK në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika të ndryshme të cilat e kanë TIK në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digjitale dhe zhvillimin e Broadband-it.

Situata e zhvillimit të infrastrukturës digjitale dhe ndarja e theksuar midis zonave urbane dhe rurale, tregon nevojën e lartë për investime të rëndësishme për zhvillimin e infrastrukturës digjitale broadband dhe se investimi nga sektori privat në zhvillimin e rrjeteve, në veçanti në zonat rurale dhe të largëta, është i pamjaftueshëm. Si rezultat i të gjitha zhvillimeve të mësipërme të e-Qeverisjes, nga 1 Maji 2022 qeveria Shqiptare vendosi të reduktojë në mënyrë drastike numrin e sporteleve fizike në vend. Të vetmet zyra të hapura për qytetarët janë ato që ofrojnë shërbime që e kanë të domosdoshme për praninë fizike të qytetarit (martesa, regjistrimi i gjurmëve të gishtave gjatë aplikimit për pasaportë etj.) ose automjetit (kontroll teknik etj.).

Forcimi i mëtejshëm i sistemit të e-qeverisjes do të vazhdojë të synojë reduktimin e burokracisë, kostos dhe kohës në marrjen e shërbimeve publike, rritjen e transparencës, llogaridhënies dhe shmangien e kontaktit fizik me punonjësit e administratës dhe përmirësimin e besimit të qytetarëve dhe biznesit ndaj institucioneve publike në vend.

Në lidhje me arritjet e MFP-së, rezultatet janë rritur në të ardhurat tatimore me 2.55 përqind të PBB-së gjatë zbatimit të PBA-së 2022-2026, ku të ardhurat rriten me 1.31 përqind të PBB-së si rezultat i politikave fiskale dhe 1.24 përqind të PBB-së si rezultat i administrimit tatimor. Gjatë vitit 2021 rezulton 95 përqind e punës për zbatimin e procedurave të automatizuara të bazuara në rrezik për të gjitha rimbursimet dhe kreditë e TVSH-së të bartura. Të gjitha kërkesat për rimbursim të përpunuara sipas metodës FIFO janë rimbursuar brenda afateve ligjore, duke e ulur stokun. Gjithashtu, stoku total i rimbursimit të TVSH-së është ulur me gati 95 përqind deri më 31.12.2021 krahasuar me stokun e një viti më parë (2020). Kuadri Makroekonomik e Fiskal për periudhën 2023-2025 synon një balancë primare në nivel pozitiv (suficit primar) që prej vitit 2023 dhe do të vijojë e tillë në vijim. Ndërkohë që, duke filluar prej vitit buxhetor 2024 e në vijim ky target do të jetë edhe ligjërisht i detyrueshëm, ku në Ligjin Organik të Buxhetit përcaktohet që duke filluar nga viti buxhetor 2024 e për çdo vit në vijim balanca primare të rezultojë jo më e vogël se sa zero (pra së paku e balancuar ose pozitive). Në vitin 2023, balanca primare është projektuar në rreth 0.3 përqind të PBB-së, në përmirësim të qartë nga niveli negativ prej 1.2 përqind i PBB i pritshëm deri në fund të 2022 dhe do të vazhdojë të zgjerohet më tej në normën prej 0.9 përqind në vitin 2024 dhe në 1.2 përqind në vitin 2025".

Raporti i fundit i Progresit për Shqipërinë (19 tetor 2021) theksoi progresin në kuadër të mirëqeverisjes dhe konsideronte progresin e arritur, ku theksohet se "Shqipëria është e përgatitur mesatarisht me reformën e administratës së saj publike".

Udhërrëfyesi për Mirëqeverisjen dhe Administrimin Publik 2030 përbën dokumentin strategjik kryesor që orienton thelbësisht menaxhimin cilësor të kornizës së përbashkët të vlerësimit, administratën publike dhe financat publike, shërbimet publike, digjitalizimin, antikorrupsionin dhe decentralizimin. Me qëllim zbatimin efektiv të reformave të Mirëqeverisjes dhe përmbushjen e kërkesave lidhur me negociatat dhe procesin e integrimit Evropian. Udhërrëfyesi 2030 për Mirëqeverisjen dhe Administrimin publik, është bazë në orientimin e reformave për një qeverisje të mirë, si gur themeli për funksionimin e administratës shtetërore, për të ofruar menaxhim cilësor në përmbushje të performancës drejt një kornize të përbashkët vlerësimi, shërbime publike me standarde, me qëllim nxitjen e një rritje ekonomike solide, të qëndrueshme dhe të përshpejtuar, si dhe nxitjen e konvergjencës sociale. Prioritetet kryesore të Udhërrëfyesit të Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik 2030 adresojnë sfida si:

- Rritjen e cilësisë dhe aftësisë së administratës publike të cilat meritojnë vëmendje të veçantë;
- Ndryshimi i shpejtë teknologjik kërkon përshtatjen e metodave të punës së administratës publike përmes digjitalizimit;
- Qasje e re për një model të ri operimi të BNJ për rishpërndarjen e kapaciteteve dhe menaxhimin e burimeve njerëzore.

Sistemi i vlerësimit *ex-ante* të legjislacionit është futur në proceset administrative të vendin tonë, në fillim të vitit 2019, në përputhje me objektivin e inkurajimit dhe forcimit të hartimit të legjislacionit dhe politikëbërjes bazuar në të dhëna. Në këtë mënyrë mund të sigurohet që ndërhyrja e qeverisë të fokusohet aty ku është e nevojshme dhe në mënyrën më të mirë të mundshme, duke dhënë kështu rezultatet më të mira me ndërhyrje rregullatore minimale, kosto efektive dhe duke reduktuar barrën administrative.

Zgjidhjet e synuara për autoritetet vendore përmes një modeli të ri si qasja e qeverisjes të integruar/*multi-level governance* është shumë e rëndësishme. Megjithatë, shumica e reformave të modernizimit fokusohen në nivelin

qendror. Ndërkohë që ka një tendencë të fortë të decentralizimit të përgjegjësive ndaj qeverisjes vendore, shpesh ka një disbalancë ndërmjet detyrimeve dhe burimeve.

Promovimi i parimeve të mirëqeverisjes në nivel qendror dhe vendor si dhe në institucionet e pavaruara do të mund të forcojnë partneritete dhe praktika të mira të ndërsjella si dhe rritjen e modernizimit të praktikave në përputhje me rrethanat.

Që prej vitit 2011, Shqipëria është pjesë e Nismës së Partneritetit të Qeverisjes së Hapur që bazohet në idenë se një qeveri e hapur është më e aksesueshme, më e përgjegjshme dhe me llogaridhënëse ndaj qytetarëve dhe se përmirësimi i marrëdhënieve midis njerëzve dhe qeverisë së tyre ka përfitime afatgjata dhe eksponenciale për të gjithë. Plani i veprimit 2020–2022 i Shqipërisë është plani i pestë i veprimit i vendit. Ai përmban nëntë angazhime, të cilat synojnë të zhvillojnë plane integriteti, një regjistër të pronareve përfitues, të përmirësojnë dhe Digjitalizojnë ofrimin e shërbimeve publike, të publikojnë të dhëna të hapura, të zgjerojnë masat që sigurojnë akses në drejtësi dhe të zbatojnë transparencën buxhetore dhe transparencën e aseteve dhe të ardhurave shtetërore.

QËLLIMI STRATEGJIK

Reforma e Mirëqeverisjes dhe Administrimit Publik, që qeveria ka në fokus përqendrohen tek nevojat e qytetarëve dhe të biznesit, të cilëve duhet t'i shërbejë një administratë cilësore e orientuar drejt kornizës së përbashkët të vlerësimit dhe performancës, e përgjegjshme, transparente, menaxhim më i mirë i financave publike, që punon me efikasitet dhe me kërkesë të lartë llogarie për funksionimin e shtetit dhe plotësimin e kërkesave për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

QËLLIMET E POLITIKAVE

- Forcimi i parimeve të mirëqeverisjes përmes menaxhimit cilësor të kornizës së përbashkët të vlerësimit si një instrument Evropian për orientimin drejt performancës dhe cilësisë në administratën publike në nivel qendror dhe lokal;
- Një planifikim strategjik efektiv dhe një politikëbërje e bazuar në dëshmi, gjithëpërfshirëse dhe transparente në qeverisjen qendrore dhe vendore;
- Rritja e aftësisë së administratës publike;
- Institucione transparente dhe me integritet të lartë, që gëzojnë besimin e qytetarëve dhe garantojnë shërbim cilësor dhe të pakorruptueshëm;
- Një administratë publike e përgjegjshme, e hapur dhe transparente;
- Një ofrim shërbimi i aksesueshëm, me kosto të përballueshme dhe i përqendruar tek qytetarët;
- Zgjidhje të synuara për autoritetet vendore përmes qasjes së qeverisjes të integruar në disa nivele;
- Garantimi i një sistemi të financave publike që nxit transparencën, llogaridhënien, disiplinën fiskale dhe efikasitetin në menaxhimin dhe përdorimin të burimeve publike për ofrimin e shërbimeve të përmirësuara dhe zhvillimin ekonomik;
- Një Sistem Statistikor Kombëtar që të funksionojë në një nivel të krahasueshëm me sistemet statistikore kombëtare më të përparuara në Bashkimin Evropian, duke zbatuar standardet ndërkombëtare dhe praktikat më të mira për të përftuar statistika dhe tregues, të cilët janë të besueshme nga përdoruesit dhe plotësojnë nevojat e tyre.

Për qëllime monitorimi dhe transparence, strategjia kombëtare e zhvillimit të një vendi është një burim i rëndësishëm kërkese për statistika zyrtare. Përgjegjësia për çdo indikator i është caktuar një ministrie apo institucioni. Megjithatë, SKS nuk arrin të plotësojë të gjitha kërkesat për statistika në lidhje me monitorimin e SKZHIE-së. INSTAT, si koordinator i SKS-së dhe prodhuesi më i madh i statistikave zyrtare në vend, ka përgjegjësinë për të propozuar aktivitete statistikore të qenësishme dhe në përputhje me standardet e BE-së, në mënyrë që të zgjerojë gamën e statistikave zyrtare të kësaj natyre.

INSTAT ka përmirësuar ndjeshëm treguesit e matjes së situatës shoqërore dhe ekonomike të familjeve dhe individëve në Shqipëri. Janë kryer vrojtime për matjen e nivelit të jetesës dhe të ardhurave, për forcat e punës, turizmin, kulturën, drejtësinë, bujqësinë, mjedisin etj. Një sistem të dhënash statistikore në aspektin gjeografik dhe rajonal) është vënë në dispozicion për përdoruesit në faqen zyrtare të INSTAT-it.

Në aspektin e statistikave ekonomike, janë vlerësuar dhe përditësuar një numër treguesish makroekonomikë. Me publikimin e pasqyrave afatshkurtra makro-ekonomike, Shqipëria arriti të plotësonte edhe kërkesën tepër të rëndësishme të standardeve të shpërndarjes së të dhënave të posaçme dhe transmetimit të tyre në Eurostat. Regjistri statistikor i bizneseve, i përditësuar në përputhje me kërkesat e BE-së ishte një ndër produktet më të rëndësishme të Censusit të sipërmarrjeve ekonomike jo-bujqësore.

Shqipëria ka bërë progres në drejtim të statistikave gjinore, duke rritur numrin e treguesve statistikorë sipas gjinive, përfshirjen e tyre në hartimin e strategjisë kombëtare dhe atyre sektoriale. Treguesit e migracionit dhe analizat e mirëfillta në kuadër të analizave të trendeve migratore ndihmon në zbatimin e masave për arritjen e objektivave në strategjinë e migracionit. Në fushën e turizmit, rritja e numrit të treguesve statistikorë ka ndihmuar dhe do të ndikojë në monitorimin e zbatimit të masave në këtë sektor.

Për sa i takon zbatimit të standarteve nëpërmjet përafrimit të klasifikimeve statistikore, duhet theksuar intensifikimi i rolit të Komisionit Kombëtar për Nomenklaturën duke arritur të përafrohen një numër i konsiderueshëm nomenklaturash, si ajo e veprimtarive ekonomike (NVE Rev.2), shpenzimeve sipas produkteve (COICOP), llojeve të sëmundjeve (ICD10), tipologjisë së rajoneve (NUTS) etj.

Sfidat

Sfidat kryesore për statistikat për periudhën e SKZHIE-së, përfshijnë:

- Forcimin e rolit të Sistemit Kombëtar të Statistikave për t'ju ofruar institucioneve publike e më tej statistika zyrtare të mjaftueshme, të sakta dhe transparente;
- Mobilizimin e burimeve për financimin e programeve dhe projekteve statistikore;
- Përgatitjen e statistikave në nivel vendor dhe sipas zonave urbane dhe rurale;
- Rritjen e kapaciteteve pranë ministrive/institucioneve të stafit të angazhuar me të dhëna/statistika për të përmirësuar cilësinë e informacionit të ofruar prej tyre;
- Rritjen dhe përditësimin hap pas hapi të kontakteve ndërinstitucionale dhe kapaciteteve profesionale për zhvillim të barabartë, në çdo aspekt;
- Rritjen e besimit të publikut tek INSTAT-i në ofrimin e informacionit statistikor, si një e mirë publike dhe shërbim për përdoruesit publik.

Vizioni: Një Sistem Statistikor Kombëtar që të funksionojë në një nivel të krahasueshëm me sistemet statistikore kombëtare më të përparuara në Bashkimin Evropian, duke zbatuar parimet dhe standardet evropiane dhe

ndërkombëtare si dhe praktikat më të mira për të përftuar statistika dhe tregues, të cilët janë të besueshme nga përdoruesit dhe plotësojnë nevojat e tyre.

Qëllimet e politikës

- *Zhvillimi i SKS për të përmbushur plotësisht acquis communautaire lidhur me statistikat dhe të mbështesë plotësisht dhe mundësojë progresin në procesin e integrimit Evropian;*
- *Plotësimi i kërkesave të përdoruesit për statistika zyrtare, duke mundësuar përdorimin e burimeve ekzistuese dhe në përputhje me nevojat për statistika;*
- *Prodhimi i statistikave zyrtare të një niveli të lartë cilësie, që të përputhen me standardet e pranuara Evropiane dhe ndërkombëtare dhe të jenë të krahasueshme me to;*
- *Rritja e numrit të institucioneve pjesë e Sistemit Kombëtar Statistikor, partnere për prodhimin e statistikave zyrtare;*
- *Modernizimi i proceseve, metodave, produkteve dhe shërbimeve statistikore për të përmirësuar cilësinë, dorëzimin në kohë dhe efiçencën në kosto të statistikave zyrtare, duke përdorur teknologjinë dhe metodat bashkëkohore;*
- *Rritja e besimit të publikut në Sistemin Kombëtar Statistikor dhe njohja e tij si strukturë institucionesh me performancë të duhur dhe profesionalisht të pavarur.*
- *Fuqizimi i statistikave vendore dhe rajonale si ndihmuese në proceset e vendimmarrjes.*

Transparenca dhe lufta kundër korrupsionit

Parandalimi dhe ndëshkimi i korrupsionit është një detyrim që rrjedh nga aderimi i Shqipërisë në instrumentet ndërkombëtarë për luftën kundër korrupsionit si Konventa e Kombeve të Bashkuara kundër Korrupsionit, Konventa Penale e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit, Konventa Civile e Këshillit të Evropës kundër Korrupsionit etj. Shqipëria ndjek dhe zbaton Strategjinë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, që prej vitit 2015, me afat përfundimtar vitin 2023.

Strategjia në zbatim kundër korrupsionit konfirmon qëllimet e politikës (parandalim –ndëshkim- ndërgjegjësim) dhe 18 objektivat specifike të saj, një qasje horizontale e luftës kundër korrupsionit e cila përfshin sektorë si transparenca, prokurimet publike, shërbimet elektronike, inspektimet dhe kontrollet financiare në administratën publikë, integriteti i autoriteteve publikë qendrore dhe vendore, bashkëpunimi i autoriteteve ligjzbatuese si edhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i publikut kundër korrupsionit.

Në vitin 2020 u miratua Plani i Veprimit 2020-2023, që përmban 83 masa për zbatimin e të cilave janë të përfshira 22 institucione, për të garantuar më shumë transparencë, llogaridhënie dhe efiçencë në ritmin e luftës kundër korrupsionit në vend.

Forcimi i rolit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit, përmes rishikimit të bazës ligjore, riorganizimit të kompetencave dhe ngritjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Antikorrupsionit pranë Ministrisë së Drejtësisë me një rrjet të gjerë koordinatorësh në 44 institucione publike në vend, është një tjetër rekord pozitiv i arritur gjatë vitit 2021, i cili dëshmon progres sa i takon komponentit të luftës kundër korrupsionit në vend.

Rrjeti i Koordinatorëve kundër Korrupsionit ka për mision hetimin, verifikimin dhe ndëshkimin e çdo rasti korruptiv, praktike abuzive ose arbitrare, të cilat cënojnë të drejtat ligjore të qytetarëve apo kufizojnë e mohojnë aksesin e tyre në shërbimet publike, kjo me qëllim parandalimin dhe luftimin e këtij fenomeni në organet

publike pjesë e Rrjetit kundër Korrupsionit, si dhe ndëshkimin e dërgimin para organeve të procedimit penal të personave përgjegjës.

Për të garantuar qëndrueshmërinë dhe vazhdimësinë e politikave për reduktimin progresiv të korrupsionit, forcimin e integritetit të institucioneve dhe promovimin e qeverisjes së mirë, qeveria shqiptare do të hartojë dhe miratojë një strategji të re kundër korrupsionit për periudhën 2023 – 2030. Vizioni i saj është pasja e institucioneve publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike dhe ofrojnë shërbime efiçente ndaj qytetarëve. Duke njohur përhapjen dhe qëndrueshmërinë e korrupsionit, strategjia e re do të zgjerojë shtrirjen e saj nga një qasje ndërsektoriale në një qasjeje kombëtare, gjithëpërfshirëse dhe të integruar.

Raportet ndërkombëtare të publikuara gjatë viteve të zbatimit të SNKK kanë bërë vlerësime të luftës kundër korrupsionit në vend. Në raportin më të fundit të vlerësimit, nga GRECO, 2020, Shqipëria ka arritur 9 nga 10 rekomandime të dhëna. Referuar Progres Raportit të Komisionit Evropian për vitin 2021, Shqipëria ka bërë progres në forcimin e luftës kundër korrupsionit. Janë arritur rezultate të prekshme në luftën kundër krimit të organizuar, duke përfshirë rritjen e bashkëpunimit me shtetet anëtare të BE-së dhe Europolin - një kusht për IGC-në e parë, e cila vazhdon të përmbushet.

Struktura e Specializuar Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar (SPAK), e përbërë nga Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, është funksionale - kusht për IGC-në e parë, i cili vijon të plotësohet. Zbatimi i Strategjisë Ndërsektoriale kundër Korrupsionit në përgjithësi është në rrugën e duhur. Vettingu i anëtarëve të drejtësisë ka sjell rezultate në luftën kundër korrupsionit.

Çështje të cilat duhen adresuar sipas rekomandimeve të raporteve ndërkombëtare në fushën e antikorrupsionit:

- Vazhdimi i forcimit të luftës kundër korrupsionit; progres i mëtejshëm drejt krijimit të një historie solide të hetimeve, ndjekjes penale dhe gjykimit të rasteve të korrupsionit, sekuestrimin dhe konfiskimin/rikthyerjen e aseteve kriminale që rezultojnë nga veprat e lidhura me korrupsionin;
- Të sigurojë që struktura e Posaçme për Kundër Korrupsionit dhe Krimin e Organizuar (SPAK), d.m.th. Prokuroria e Posaçme dhe Byroja Kombëtare e Hetimit, si dhe Gjykatat e SPAK, të trajtojnë efektivisht korrupsionin e nivelit të lartë; të sigurojë burime, aftësi dhe bashkëpunim të përshtatshëm ndërmjet këtyre strukturave të reja dhe subjekteve të tjera prokuroriale dhe gjyqësore;
- Përmirësimi i efiçencës së mekanizmave parandalues përmes fuqizimit të Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit si dhe zbatimit e monitorimit të planeve të integritetit dhe mbështetjes së vëmendjes së publikut ndaj çështjeve të korrupsionit;
- Të sigurojë që procedurat penale të nisin në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike kundër gjyqtarëve dhe prokurorëve të akuzuar për sjellje kriminale gjatë procesit të rivlerësimit;
- Adresimi efektiv i rekomandimeve të GRECO-s dhe zbatimi i planit të veprimit përkatës brenda kornizës kohore.

Sfidat e së ardhmes:

Korrupsioni paraqet një sfidë në nivel kombëtar pasi prek shoqërinë në mënyra të ndryshme, duke sjellë pasoja negative si në jetën ekonomike, ashtu edhe në atë sociale të qytetarëve. Në këtë aspekt, u vërejt se në raste të caktuara, korrupsioni ka ndikuar edhe në integritetin e besimin në raport me institucionet shtetërore. Angazhimi

i politikëbërësve drejt një agjende kombëtare antikorrupsion dhe, respektivisht, drejt përmirësimit të kuadrit institucional dhe legjislativ në fushën e antikorrupsionit është parësor. Gjithashtu, ekziston nevoja për të forcuar vlerësimin e rreziqeve dhe dobësive ndaj korrupsionit si dhe efektivitetin e mekanizmave për parandalimin.

Lidhur me modernizimin e shërbimeve dhe konsolidimin e infrastrukturës digjitale, në seksionet "Modernizimi për Zhvillim" dhe "Shoqëria Digjitale", programi parashikon ambicien e qeverisë Shqiptare për të siguruar ofrimin digjital të të gjitha shërbimeve të mundshme për qytetarët, si dhe për rritjen e cilësisë së shërbimit, si një instrument i rëndësishëm dhe i pazëvendësueshëm për parandalimin e korrupsionit. Ndërsa, në drejtim të vazhdimit të reformave dhe forcimit të kapaciteteve institucionale kundër korrupsionit, programi parashikon objektivin e qeverisë për rritjen e aksesit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë nëpërmjet digjitalizimit të sistemit, si dhe zgjerimin dhe fuqizimin e Rrjetit të Koordinatorët Kundër Korrupsionit.

Strategjia e re antikorrupsion, ka një parashikim kohor zbatimi vitet 2023-2030, dhe do të ofrojë një ndërthurje të qasjes horizontale antikorrupsion me sektorë specifikë, që kanë rezultuar me problematika dhe me perceptimin më të lartë të korrupsionit, siç janë: arsimi, shëndetësia, pronat, taksat e tatimet.

Vizioni i strategjisë është "*Institucione publike që funksionojnë në përputhje me standardet më të larta të integritetit, transparencës dhe llogaridhënies publike, dhe ofrojnë shërbime efiçente ndaj qytetarëve*".

Risi të SNKK-së re janë prioritizimi i elementëve të integritetit, forcimit institucional të burimeve njerëzore e profesionale në fushën e antikorrupsionit, mekanizmit të lobimit si instrument antikorrupsion, përfshirjes së kapaciteteve të biznesit në mekanizmat antikorrupsion, si dhe orientimit të qasjes *gender* kundër korrupsionit.

Strategjia Ndërsektoriale Kundër Korrupsionit 2023-2030, ofron bazën mbështetëse që shteti në tërësi të angazhohet në pastrimin e korrupsionit duke kthyer Shqipërinë në një shoqëri pa korrupsion ku integriteti, transparenca dhe llogaridhënia drejtojnë veprimet dhe sjelljen e institucioneve publike, të bizneseve dhe të qytetarëve. SNKK 2023-2030, synon të angazhojë aktorët politikë, administratën publike dhe sektorin e biznesit për të luftuar në mënyrë efektive korrupsionin, për të promovuar transparencën e vendimmarrjes e për të forcuar aftësinë e autoriteteve përkatëse, si dhe për të gjetur dhe identifikuar përgjegjësinë tek ata që janë përfshirë në praktika korruptive. Gjithashtu, SNKK 2023-2030, synon krijimin e një ndërgjegjësimi të gjerë kombëtar për shkaqet dhe pasojat e korrupsionit duke forcuar mekanizmat mbi angazhimin e qytetarëve për raportimin dhe denoncimin e këtij fenomeni.

Decentralizimi dhe fuqizimi i qeverisjes vendore

Reforma Administrative Territoriale dhe avancimi i procesit të decentralizimit me anë të kalimit të një sërë funksionesh tek pushteti vendor ka arritur rezultate të rëndësishme në drejtim të fuqizimit të këtij pushteti duke transformuar qeverisjen në të gjithë Shqipërinë. Ruajtja e interesit për objektivat e decentralizimit si dhe konsolidimi i mëtejshëm i këtij procesi janë vendimtare në afat të mesëm, ndaj do të vijohet duke adresuar sfidat e hasura gjatë zbatimit të funksioneve të decentralizuara. Decentralizimi konsiderohet një proces i cili ka nevojë të vazhdueshëm për dialog lidhur me arritjet dhe sfidat kryesore, e njëkohësisht me shtrirjen dhe thellësinë e decentralizimit në sektorët ekzistues dhe të rinj.

Pas miratimit të hartës së re administrative filloi procesi i konsolidimit administrativ i njësive të mëparshme dhe krijimi i njësive të reja. Ligji i ri për vetëqeverisjen vendore nr. 139/2015, i ndryshuar, shtoi numrin e funksioneve të veta për NJVV pasi transferoi tërësisht funksionet e ndara. Rikonfigurimi i qeverisjes vendore ka mundësuar hedhjen e hapave cilësorë në sigurimin e shërbimeve, shoqëruar me planifikim dhe realizim të investimeve të një shkallë më të gjerë. Në mënyrë të përmbledhur, disa nga arritjet kryesore që evidentohen në nivel objektivi strategjik, ashtu edhe funksioni janë si më poshtë vijon:

- Qasje e integruar dhe afatgjatë në ofrimin e shërbimeve sociale: thuajse të gjitha bashkitë (61) kanë planet e tyre sociale dhe ofrojnë shërbime sociale (58);
- Përpjekjet drejt krijimit të konsolidimit të trupave menaxheriale të ofrimit të shërbimeve sociale dhe ngritja e fondit social konkurrues në nivel qendror dhe aftësimi i bashkive;
- Progres i vazhdueshëm i NJVV-ve për menaxhimin, administrimin dhe financimin e arsimit parashkollor;
- Lidhur me mbetjet, hapa të rëndësishëm mbi shërbimin e mbledhjes, grumbullimit dhe transportit të tyre;
- Ujësjellës-Kanalizime: Reforma e Ndërmarrjeve të Ujësjellës-Kanalizimeve;
- Rrugët rurale: rritje e mbulimit me rrjet rrugor të mirëmbajtur (32 përqind në 2015 në 50 përqind në 2020);
- Trajnime të vazhdueshme çdo vit: në pushtetin vendor janë trajnuar në total 4,259 profesionistë, nga të cilët 4,128 nëpunës civilë, 131 punonjës me Kod Pune - (950 meshkuj dhe 3,309 femra);
- Krijimi i Zyrave me Një Ndalesë në nivel vendor lidhur me shërbimet administrative;
- Përmirësim të ndjeshëm të financave vendore, ndarja e tatimit mbi të ardhurat personale e të rentës minerare (dyfishim të ardhurave vendore gjatë periudhës 2015-2021);
- Aktualisht rreth 90 përqind (56 nga 61 bashki) e Njësive të Vetëqeverisjes Vendore kanë hartuar dhe janë duke zbatuar Planet e Përgjithshme Vendore (pjesa tjetër është në proces përfundimi);
- Transparencë dhe gjithëpërfshirje të mbledhjeve të Këshillave Bashkiakë. Këto këshilla kanë ndërtuar dhe konsoliduar procedurat dhe rregullat e punës se tyre si në marrëdhënie me administratën, por dhe në komunikim me qytetarët;
- Struktura institucionale në nivelin vendor lidhur me agjendën e integrimit evropian rezulton e plotësuar – të gjitha bashkitë (61) kanë ngritur dhe kanë funksionale Njësinë e Integrimi Evropian;
- Bashkitë kanë rritur në mënyrë të vazhdueshme aksesin e tyre në programet e financuara nga BE – 8 IPA CBC & 8 Fonde të Unionit: 148 projekte të zbatuara në 5 vitet e fundit – 63 përqind të financuar nga fondet IPA CBC/ Transnacionale.

Përtej arritjeve të decentralizimit të lidhura përgjithësisht me procesin e harmonizimit ligjor midis ligjit organik të pushtetit vendor 139/ 2015 dhe ligjeve sektoriale, rritjes së të ardhurave vendore dhe menaxhimit të tyre efikas, ushtrimit të funksioneve të deleguara, procesi i decentralizimit rendit edhe sfida, të cilat kërkojnë adresim. Më konkretisht, sfidë mbetet diferenca në zhvillimin ekonomik vendor, veçanërisht ndërmjet bashkive të mëdha dhe atyre të vogla e të mesme. Qeverisja vendore sot përballet me mungesën e qëndrueshmërisë së burimeve njerëzore dhe mekanizmave për incentivimin e stafit të bashkive.

Nevoja e standardeve minimale në ofrimin e shërbimeve vendore është një aspekt i rëndësishëm lidhur me ofrimin e shërbimeve cilësore. Me qëllim rritjen e ofrimit të shërbimeve tek qytetarët është e rëndësishme që shërbimi të ofrohet në mënyrë të njëjtë tek qytetarët, pavarësisht diferencave në bashki. Autonomia financiare ka nevojë për forcim të mëtejshëm, përtej arritjeve shumë të mira në këtë drejtim. Sërish, bashkitë kanë nevojë për fonde në ushtrimin sa më të mirë funksioneve të tyre. Duke qenë se rreth 70 përqind e legjislacionit të Bashkimit Evropian do të duhet të zbatohet në nivel vendor, agjendës së decentralizimit i kërkohet të adresojë këtë çështje me një vëmendje të shtuar. Gjithashtu, kjo kërkon edhe bashkërendim të shtuar midis qeverisjes qendrore dhe asaj vendore drejt agjendës së përbashkët të integrimit Evropian.

Në kuadër të përmirësimit të mbarëvajtjes së këtij procesi, ka ende nevojë për të intensifikuar bashkëpunimin ndërmjet qeverisë vendore dhe asaj qendrore, për të përputhur bazën ligjore me funksionet, implementimin e funksioneve të reja dhe vazhdimin e punës për rritje të kapaciteteve të bashkive, shoqëruar me menaxhim më efiçent të financave vendore dhe mirëqeverisje, me qëllim nxitjen e zhvillimit ekonomik vendor të qëndrueshëm, duke marrë në konsideratë perspektivën e qeverisjes vendore në zbatimin në tërësi dhe ushtrimit të funksioneve në veçanti.

Vizioni: Fuqizimi i qeverisjes vendore për zhvillim ekononomik të qëndrueshëm drejt standardeve evropiane.

Qëllimet e politikës:

- Forcimi dhe nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm vendor;
- Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve vendore me qëllim rritjen e cilësisë dhe standardit të ofrimit të tyre për qytetarët;
- Digjitalizimi i shërbimeve vendore dhe përmirësimi i infrastrukturës së ofrimit të tyre;
- Rritja e autonomisë financiare vendore nëpërmjet konsolidimit të sistemit të të ardhurave të veta;
- Përmirësimi i demokracisë vendore dhe avancimi i agjendës së integrimit evropian në nivel vendor;
- Forcimi i kapaciteteve qendrore dhe vendore, në mbështetje të qeverisjes vendore, si edhe shoqatave të vetëqeverisjes vendore.

Lidhja me PKIE dhe Legjislacionin e BE-së:

Kriteri Politik & Pjesa 4

2.1 Demokracia dhe Shteti i së Drejtës;

2.1.3 Qeverisja;

2.1.4 Reforma në administratën publike.

Kapitulli 11: Bujqësia dhe Zhvillimi Rural;

Kapitulli 14: Politikat e Transportit;

Kapitulli 19: Politikat Sociale dhe Punësimi;

Kapitulli 26: Arsimi dhe Kultura;

Kapitulli 27: Mjedisi dhe Ndryshimet Klimatike;

Kapitulli 32: Kontrolli Financiar.

Lidhja me OZHQ-të:

OZHQ4: Sigurimi i arsimit cilësor gjithëpërfshirës dhe të drejtë dhe nxitja e mundësive për mësim gjatë gjithë jetës për të gjithë;

OZH6: Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë;

OZHQ16: Nxitja e shoqërive paqësore dhe gjithëpërfshirëse për zhvillim të qëndrueshëm, ofrimi i mundësisë për drejtësi për të gjithë dhe ngritja e institucioneve të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet.

AGJENDA PËR ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK, NDËRLIDHJEN DHE RRITJEN E GJELBËR

Vlerësimet tregojnë se rritja ekonomike e Shqipërisë gjatë vitit 2021 ka arritur në nivelin 8.5 përqind, duke e tejkaluar ngadalësimin e ekonomisë gjatë periudhës së pandemisë si pasojë e efekteve ekonomike dhe sociale që ajo solli për të gjitha vendet e botës. Pritshmëritë e zhvillimit ekonomik të vendit, bazuar në ecurinë e sektorit privat si pjesa thelbësore e ekonomisë së vendit, shoqëruar me prirjet e eksporteve, investimeve publike në infrastrukturë dhe mbështetjen e biznesit, dëshmojnë për vazhdimin e një rritje të qëndrueshme në rreth 3.4 përqind mbi bazë vjetore që do të vijojë përgjatë periudhës 2023-2025. Një rritje e tillë mbështetet dhe nga pritshmëritë e rritjes ekonomike (2.7 përqind gjatë 2022) në zonën e Bashkimit Evropian i cili krahas faktorëve të tjerë të rëndësishëm, është gjithashtu partneri kryesor tregtar i Shqipërisë, me rreth 2/3 e tregtisë së vendit dhe destinacion i rreth 80 përqind të eksporteve Shqiptare.

Rritja ekonomike dhe e punësimit gjatë viteve të fundit mbështetet gjerësisht në zhvillimin e sektorit privat që përbën shtyllën kurrizore të ekonomisë në vend dhe pasqyrohet në ecurinë e përgjithshme të këtij sektori. Të dhënat tregojnë se gjatë dekadës së fundit (2012-2021) numri i ndërmarrjeve aktive në vend, përfshirë fermerët, është rritur me 74 përqind duke arritur në 181,549 në fund të vitit 2021[19]. Të dhënat administrative të tregut të punës tregojnë se zhvillimi i sektorit privat, shoqëruar me formalizimin e tregut, është pasqyruar edhe në tregun e punës, në të cilin numri i kontribuesve në pagesën e sigurimeve shoqërore, ku sektori privat përbën rreth 74 përqind të tij, është rritur mesatarisht me 5.6 përqind në vit gjatë viteve të fundit, duke arritur në mbi 703 mijë kontribues në vitin 2021, krahasuar me 482 mijë të tillë në vitin 2014.

[19] INSTAT, Rregjistrat e Biznesit, 2022

Bujqësia është sektori që vijon të angazhojë në punë pjesën më të madhe të Shqiptarëve, me rreth 33.8 përqind të të punësuarve gjatë vitit 2021. Sektorë të tjerë që kryesisht punësojnë më shumë punonjës në vend janë tregtia me pakicë, shërbimet e ndryshme, ndërtimi, tregtia me shumicë, shërbimi ushqimor, tekstile dhe veshje, industria e këpucëve etj., ndërkohë që punësimi në sektorët e tjerë të ekonomisë është në nivele më të ulëta. Ecuria e punësimit në vitet e fundit dëshmon se sektorët që kanë pasur rritjen relative më të lartë të tij në vend janë shërbimet e informacionit, inxhinieri të tjera përpunuese, shëndetësia, hoteleri turizmi, programimi, tregtimi dhe riparimi i automjeteve, shërbime të tjera etj.

Vizioni dhe prioritetet e SKZHIE 2030 sa i takon rritjes ekonomike marrin në konsideratë vizionin e Bashkimit Evropian, për të garantuar zhvillimin e një ekonomie konkurruese, të bazuar mbi shfrytëzimin e balancuar dhe të qëndrueshëm të burimeve. Më shumë vëmendje do t'i kushtohet zhvillimit të infrastrukturës së vendit, për të siguruar më shumë akses për popullatën, paralelisht me integrimin e mëtejshëm të vendit në sistemet evropiane. Vëmendje e posaçme do t'i kushtohet mbrojtjes së natyrës, burimeve kombëtare dhe përdorimit të qëndrueshëm të mjedisit. Rëndësi të veçantë gjithashtu ka fakti që përfitimet e rritjes ekonomike të shpërndahen në të gjithë vendin, duke përfshirë rajonet më pak të zhvilluara, me synim zhvillimin e balancuar dhe forcimin e kohezionit territorial.

Konektiviteti, Agjenda e Gjelbër për Vendet e Ballkanit Perëndimor, si pjesë e Planit Ekonomik dhe të Investimeve të Bashkimit Evropian për këto vende, përfshirë Shqipërinë, janë në thelb të Shtyllës së dytë të SKZHIE 2030, së bashku me prioritetet tashmë të identifikuara për vendin – turizmi, energjia, bujqësia dhe digjitalizimi.

Fuqizimi i sistemit financiar dhe politikës monetare

Ndjekja e politikave monetare dhe financiare koherente, me fokus stabilitetin e çmimeve dhe atë financiar ka kontribuar në ruajtjen e ekuilibrave të përgjithshëm ekonomikë e financiarë të vendit. Me gjithë goditjet e njëpasnjëshme negative të viteve të fundit, inflacioni dhe kursi i këmbimit kanë qenë të qëndrueshëm, tregu financiar ka funksionuar normalisht, kredia ka vazhduar të rritet dhe familjet Shqiptare kanë vazhduar t'i besojnë sektorit bankar për ruajtjen e kursimeve të tyre. Sistemi financiar është i qëndrueshëm dhe sektori bankar vijon të karakterizohet nga tregues të mirë likuiditeti, kapitalizimi dhe përfitueshmërie. Sektori financiar jobankar paraqitet gjithashtu i qëndrueshëm, me tregues të mirë likuiditeti e mbulimi me provigjone në tregun e sigurimeve, rritje të vazhdueshme të fondeve private të pensionit, si edhe shtim të fondeve të reja të investimit.

Ky rezultat është arritur falë një sërë reformash, ku ndër më kryesoret janë:

- **Në fushën e politikës monetare** është modernizuar infrastruktura e analizës dhe parashikimit, është përmirësuar kuadri operacional i zbatimit të politikës, si dhe është rritur transparenca e përmirësuar ndaj efektivitetit të komunikimit dhe llogaridhënies të saj;
- **Në fushën e politikave financiare** është zbatuar programi i reduktimit të kredive me probleme, është iniciuar dhe zbatuar plani i masave për nxitjen e përdorimit të monedhës kombëtare në sistemin financiar, është administruar me sukses procesi i konsolidimit të sektorit bankar;
- **Në fushën e infrastrukturës financiare**, është hartuar dhe zbatuar strategjia kombëtare për fuqizimin e tregut të pagesave me vlerë të vogël, është ofruar sistemi i ri për procesimin dhe shlyerjen e pagesave në euro brenda vendit, është përmirësuar kuadri rregullator i sistemeve të pagesave në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian dhe është nxitur përdorimi i pagesave *on-line*;

– **Në fushën e Integrimit Evropian,** është punuar në vazhdimësi për përafrimin e kuadrit rregullator me *acquis.* Në qendër të vëmendjes është përmbushja e të gjithë detyrimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit, nga raport progreset e Komisionit Evropian, nga Nënkomitetet e përbashkëta BE-Shqipëri, si dhe nga Plani Kombëtar për Integrimin Evropian.

Referenca me dokumente me rëndësi strategjike: Kapitujt e "*Acquis*" që lidhen me fushën financiare dhe monetare e kontributin e institucioneve shqiptare, përfshijnë Kushtet themelore – Kriteri Ekonomik, Kapitullin 9- Shërbimet Financiare, Kapitullin 2- Liria e lëvizjes së punëtorëve, Kapitullin 3- Liria për të ofruar shërbime, Kapitullin 4 -Lëvizja e lirë e kapitalit, Kapitullin 6- Legjislacioni për shoqëritë tregtare, Kapitullin 17- Politika ekonomike dhe monetare, Kapitullin 18 – Statistikat, Kapitullin 28- Mbrojtja e konsumatorit dhe Kapitullin 32 – Kontrolli Financiar.

Objektivat strategjikë:

- **Garantimi i stabilitetit të çmimeve si një parakusht i domosdoshëm për rritjen e qëndrueshme dhe afatgjatë të vendit, promovimin e stabilitetit financiar dhe rritjen e mirëqenies së shtetasve shqiptarë.** Përmbushja e këtij objektivi kërkon hartimin e një politike monetare të kujdesshme, fleksibël dhe largpamëse, e cila synon por edhe mbështetet në:
- **Forcimin e mëtejshëm të stabilitetit financiar nëpërmjet mbikëqyrjes dhe rregullimit bankar dhe atij jo-bankar të kujdesshëm.** Prioritet do të jenë:
- Diversifikimi i sistemit financiar dhe zhvillimi i sektorit financiar jobankar, nëpërmjet zgjerimit të tregjeve të kapitalit, të sigurimeve dhe pensioneve private vullnetare.
- Zhvillimi i financimit të gjelbër dhe harmonizimi me praktikat evropiane në financat e gjelbra.
- **Rritja e edukimit dhe e përfshirjes financiare e cila ndihmon në reduktimin e informalitetit dhe në rritjen e mirëqenies së shoqërisë.**

Me synimin e reduktimit të pasojave negative të krizave të mëparshme financiare, rregullatorët financiarë dhe bankat qendrore në mbarë botën kanë bërë përpjekje të mëdha për ta bërë sistemin financiar ekzistues më të qëndrueshëm, duke rritur kërkesat për kapital dhe likuiditet të bankave, duke zhvilluar plane për ndërhyrjet e jashtëzakonshme dhe duke kërkuar që tregtimi i instrumenteve derivative të kalojë përmes institucioneve qendrore të kleringut. Këto përpjekje kanë qenë të vlefshme duke ulur probabilitetin e krizave të tjera financiare në afatin e shkurtër. Por ato ende nuk kanë arritur të trajtojnë si duhet çështjen themelore - aftësinë e sistemit bankar për të krijuar kreditin, paranë, fuqinë blerëse dhe riskun e paqëndrueshmërisë financiare që mund të pasojë.

Angazhimi i Qeverisë Shqiptare për të siguruar mirëqenie për të gjithë qytetarët nënkupton një ekonomi të zhvilluar që ofron mundësi për të gjithë. Nëpërmjet rritjes së përgjegjësisë fiskale dhe monetare rritet edhe qëndrueshmëria e financimit publik, reduktohet tendenca afatgjatë e polarizimit të ekonomisë që është një sfidë aspak e lehtë edhe për vendet më të zhvilluara si edhe nxitet seriozisht drejtësia sociale, ekonomike dhe mundësitë për një jetesë më dinjitoze.

Diversifikimi i sistemit financiar nëpërmjet zhvillimit të tregjeve financiare jobankare synon mbështetjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme, si dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare përmes mirëfunksionimit të këtyre tregjeve. Zhvillimi i **tregjeve të kapitalit** është kyç në forcimin e ekonomisë dhe ruajtjen e stabilitetit financiar. Një treg i zhvilluar ofron më shumë mundësi investimi si dhe alternativa të reja financimi. Përmes kanalizimit të

kursimeve drejt sektorëve produktivë dhe novativë këto tregje nxisin zhvillimin e biznesit dhe rrjedhimisht shoqërohen me përfitime që shtrihen në të gjithë ekonominë.

Një treg i zhvilluar kapitalesh si segment i sistemit financiar ndihmon në diversifikimin e burimeve të financimit, por edhe në zbutjen e ekspozimit të tij ndaj riskut sistemik, duke qenë se risku nuk përqendrohet më i tëri tek sistemi bankar. Gjithashtu, operatorët e tregut të sigurimeve, fondeve të investimit dhe fondeve private të pensionit janë investitorë institucionalë të rëndësishëm dhe zhvillimi i mëtejshëm i këtyre sektorëve financiarë jobankarë do t'i jepte më shumë hov zhvillimit të tregut vendas të kapitaleve.

Në tregun e sigurimeve synohet rritja dhe zhvillimi i këtij tregu, nëpërmjet mbështetjes dhe promovimit të produkteve të reja, me qëllim zgjerimin e bazës së personave të siguruar, shtim të numrit të produkteve të reja dhe përmirësim i atyre ekzistuese, si edhe rritjes së mirëqënies së grupeve të përfshira në mbulimet me sigurim.

Fondet private të pensionit synohet të zhvillohen më tej, në funksion të zgjerimit të sigurisë dhe mbrojtjes më të mirë sociale për moshën e tretë dhe garantimit të të ardhurave shtesë, krahas skemës shtetërore të pensionit. Ligji i ri për fondet private të pensionit zgjeron format e organizimit të këtyre fondeve, realizon një harmonizim të mëtejshëm me legjislacionin dhe direktivat evropiane të fushës, si edhe stimulon një përfshirje më të madhe në skemat private të pensioneve.

Zhvillimi i **financimit të gjelbër** dhe harmonizimi me praktikat evropiane në financat e gjelbra vlerësohen thelbësore në kuadër të avancimit drejt një ekonomie të qëndrueshme. Sektori financiar ka një rol kyç në këtë drejtim, pasi shërben për të riorientuar investimet drejt teknologjive dhe bizneseve të gjelbra, si edhe për të financuar rritjen në një mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë.

Për arritjen e këtyre objektivave kërkohet bashkërendimi i përpjekjeve dhe koordinimi mes të gjithë aktorëve të përfshirë për ndërmarrjen e një sërë veprimesh si:

- Krijimin e një sistemi të unifikuar klasifikimi në linjë me praktikat evropiane përmes vendosjes së rregullave për taksonominë, i cili do të përmbajë kriteret që përcaktojnë se kur aktivitetet ekonomike apo investimet do të konsiderohen të gjelbra dhe qëndrueshme nga ana mjedisore.
- Nxitjen dhe promovimin e emetimit të obligacioneve të gjelbra, ku fondet e përfituara nga emetimi i këtyre obligacioneve alokohen në projekte me ndikim pozitiv tek klima apo mjedisi.
- Përfshirjen në bazën ligjore e rregullatore të kërkesave për transparencë dhe informacion lidhur me faktorët ESG (faktorë mjedisore, socialë dhe të qeverisjes korporative) dhe menaxhimin e rrezikut të këtyre faktorëve.
- Edukim financiar për rritjen e ndërgjegjësimit për efektet financiare dhe ekonomike të ndryshimeve klimatike, me qëllim ndryshimin e sjelljes financiare të investitorit shqiptar për të konsideruar faktorë mjedisorë gjatë krijimit të portofolit të tij të investimeve.

Tregu i kapitaleve në Shqipëri është ende i vogël dhe me një peshë të ulët në sistemin financiar. Megjithatë ky treg ka potencial të lartë për të luajtur, në një periudhë afat-gjatë, një rol të rëndësishëm në ekonominë e vendit. Një treg kapitalesh i zhvilluar mbart edhe funksionin e rëndësishëm ekonomik në lidhje me orientimin e kapitalit drejt përdorimit produktiv të tij duke kontribuar në alokimin efiçent dhe rritjen e produktivitetit në vend si dhe rritjen e konkurrueshmërisë në nivel ndërkombëtar, duke synuar:

- Sigurimin e alternativave të reja të financimit për bizneset, përfshirë Ndërmarrjet e Vogla dhe të Mesme (NVM), me qëllim zhvillimin dhe rritjen e këtyre bizneseve;

- Ofrimin e alternativave të reja të investimit për qytetarët nëpërmjet shumëllojshmërisë së instrumenteve financiare dhe fondeve të investimit e atyre të pensionit duke ofruar edhe mundësi diversifikimi të investimeve të tyre;
- Rritjen e kursimeve dhe mobilizimin e tyre drejt investimeve në sektorët më produktivë;
- Krijimin e vendeve të reja të punës; rritjen e fuqisë blerëse të qytetarëve dhe rritjen e standardit të jetesës dhe sigurimin e konvergjencës ekonomike me vendet e zhvilluara të Bashkimit Evropian;
- Rritjen e produktivitetit më anë të gjenerimit të fondeve për projekte inovative etj.

Politika për zhvillimin e tregjeve të kapitalit nga pikëpamja kombëtare synon mbështetjen e rritjes ekonomike të qëndrueshme si dhe rritjen e konkurrueshmërisë kombëtare përmes mirë-funksionimit të tregjeve të kapitalit. Rritja ekonomike varet nga fakti se sa në mënyrë efiçente janë të alokuara burimet në projektet apo sektorët më produktivë, alokim ky që realizohet ndërmjet tregjeve financiarë të zhvilluar. Mbështetur në Raportin *Doing Business* (2019) të Bankës Botërore, evidentohet nevoja e përmirësimit të indikatorit për Shqipërinë për listim të kompanive shqiptare në Bursë gjë që ndikon në përthithjen e investitorëve dhe besimin e tyre për të investuar në Shqipëri.

Me qëllim zhvillimin e këtij tregu lind domosdoshmëria e adresimit të disa çështjeve si:

- Rritja e besimit të investitorit vendas në tregjet e kapitalit;
- Përmirësimi i transparencës dhe qeverisjes korporative të kompanive Shqiptare;
- Nxitja e investitorëve të huaj për investim në tregun e kapitalit vendas;
- Krijimi i lehtësirave fiskale për të nxitur përdorimin e fondeve në këto tregje;
- Forcimi i kapaciteteve mbikëqyrëse të Autoritetit etj.

Promovimi i tregjeve efiçente të kapitalit nëpërmjet nxitjes së zhvillimit të këtyre tregjeve dhe mbikëqyrjes efektive të tyre synohet të fokusohet në 4 fusha kryesore të prioritetit si më poshtë:

1. Krijim i Kushteve të Përgjithshme për mirë-funksionimin e Tregut të Kapitalit;
2. Përmirësim i Infrastrukturës së Tregut të Kapitaleve;
3. Zgjerimi i Gamës së Instrumenteve Financiare dhe Bazës së Investitorit;
4. Plotësim i Kuadrit Rregullativ dhe Legjislativ.

Fuqizimi i financave publike dhe stabiliteti fiskal

Shqipëria mbetet mjaft e ekspozuar ndaj risqeve nga ngadalësimi potencial i rritjes ekonomike në Evropë, më shumë në partnerët kryesorë të shkëmbimeve tregtare. Një rënie ekonomike në këto shtete mund të sjellë nivele më të ulëta të eksportit, të dërgesave private nga jashtë dhe të investimeve të huaja të drejtpërdrejta (IHD). Për më tepër, kufizimi i pritshëm i kushteve të përgjithshme financiare në rang botëror do të rrisë kostot e Shqipërisë për financime. Borxhi publik është i lartë, ndërsa kursimet e ulëta kombëtare dhe mungesa e investitorëve të mëdhenj institucionalë shtojnë varësinë në burimet e huaja të financimit. Mbështetja në rritje në Partneritetin Publik-Privat (PPP-të) për projektet infrastrukturore ka sjellë edhe rritjen e detyrimeve të kushtëzuara.

Ndër risqet kombëtare përfshihet edhe ekspozimi i lartë që Shqipëria ka ndaj faktorëve negativë natyralë si tërmetet, përmbytjet, epidemitë, thatësirat në prodhimin e energjisë dhe sektorin bujqësor, duke sjellë kështu

sfida dhe rreziqe të konsiderueshme për buxhetin, të cilat janë provuar si të tilla gjatë viteve të fundit. Nga ana tjetër, menaxhimi i financave publike do të jetë i lidhur edhe më mirë me ndryshimet klimatike duke pasur në vëmendje të politikës ndikimet e mundshme në këtë dimension apo përkrahjen e zgjidhjeve që reduktojnë emetimet e dëmshme dhe orientojnë ekonominë e vendit drejt një të ardhmeje më të gjelbër.

Referenca me Kapitullin përkatës të "Acquis": 13 nga 24 komponentë të reformës së MFP-së janë të lidhur me kapitujt e PKIE, specifikisht kapitullin 5, 8, 16, 17, 18, 22, 29, 32, 33. Menaxhimi i Financave Publike në nivel vendor lidhet me kapitullin 22 të PKIE-së. Kontroll i brendshëm efektiv lidhet me kapitullin 22 dhe 32 të PKIE-së.

Qëllimet e politikës:

- Menaxhim financiar i matur, efektiv dhe efikas i qeverisjes vendore;
- Planifikimi dhe mbikëqyrja e investimeve publike;
- Forcimi dhe zbatimi i sistemit për Kontrollin e Brendshëm Financiar Publik në qeverisjen qendrore dhe vendore.

Reformat kryesore tatimore dhe administrative të parashikuara për periudhën 2022-2030 kanë në fokus të tyre përmirësimin e politikave tatimore me qëllim rritjen e neutralitetit të sistemit të tatimeve dhe taksave, eliminimin e deformimeve të krijuara në sistem si dhe përmirësimin në nivelin e tarifave tatimore me qëllim stimulimin e sektorëve prioritarë të ekonomisë.

Reformat tatimore 2022-2030, parashikohen që të rrisin të ardhurat tatimore me rreth + 5 përqind të PBB-së, duke e çuar koefiçentin "Të ardhura tatimore"/ PBB në 30 përqind nga 25,2 përqind që ka rezultuar në vitin 2019. Ndërkohë, totali i hyrjeve në buxhet në fund të kësaj periudhe synohet të jetë mbi 32 përqind të PBB-së, nga 27,2 përqind që ka rezultuar në vitin 2019.

Bazuar në objektivat e ERP, politika fiskale në periudhën afatmesme do të jetë e orientuar drejt konsolidimit fiskal në përputhje me rregullat fiskale të përcaktuara në Ligjin Organik të Buxhetit si dhe rekomandimet e dhëna nga KE. Konsolidimi fiskal dhe reduktimi i borxhit publik vijon të jetë objektivi themelor i politikës fiskale, në funksion të drejtpërdrejtë të sigurimit të stabilitetit makroekonomik të vendit, si një premisë thelbësore për sigurimin e një rritje ekonomike të qëndrueshme e gjithëpërfshirëse. Edhe në terma afatgjatë, politika fiskale do të vijojë të mbetet qartësisht e orientuar drejt konsolidimit fiskal, duke synuar ulje në çdo vit të nivelit të borxhit publik në raport me Produktin e Brendshëm Bruto deri në vitin 2028, me synimin që në terma kohorë, tej vitit 2028, niveli i tij të arrijë objektivin afatgjatë prej 45 përqind të PBB të përcaktuar në rregullat fiskale të ligjit organik të buxhetit.

Duke pasur parasysh nevojën për të përmirësuar infrastrukturën dhe zhvillimin e burimeve njerëzore në Shqipëri, konsolidimi fiskal duhet të mbështetet nga përmirësimet në politikën tatimore dhe administrimin tatimor që çojnë në të ardhura më të larta.

Ritmet jo të duhura në rritjen e të ardhurave të buxhetit bëjnë të domosdoshme ndërmarrjen e reformave të thella me qëllim rritjen dhe konsolidimin e të ardhurave të buxhetit, nëpërmjet të cilave do të bëhet i mundur financimi i shpenzimeve dhe mbajtja nën kontroll e defiçitit buxhetor. Nëpërmjet masave dhe ndryshimeve të parashikuara në politikat dhe administrimin tatimor, Strategjia Afatmesme e të Ardhurave (SAA) synon rritjen e të ardhurave të buxhetit me rreth 5 përqind të PBB-së për periudhën 2022-2030, nga të cilat 2.5 përqind do gjenerohen nga ndryshimet në politikat tatimore dhe 2.5 përqind e PBB-së nga përmirësimi i elementeve të administrimit tatimor dhe doganor.

Sfidat

Administrimi - Informaliteti

Pavarësisht përpjekjeve që janë bërë ndër vite për formalizmin e ekonomisë, ende Shqipëria ka probleme të nënraportimit, informalitetit dhe evazionit fiskal. Anketimet e bëra nga Këshilli i Investimeve mbi klimën e biznesit në vend me rreth 3 mijë biznese, në janar 2020, treguan një rritje të perceptimit mbi ekzistencën e konkurrencës informale krahasuar me një vit më parë.

Informaliteti është një fenomen i krijuar në një periudhë 30 vjeçare në të cilin ka pasur një ndërveprim midis bizneseve dhe strukturave të administratave tatimore e doganore, të cilat për mungesë kapacitetesh e vullneti kanë lejuar ndër vite informalitet/evazion/nënraportim. Pikërisht për këtë arsye të ardhurat tatimore në përqindje të PBB në Shqipëri janë ndër më të ulëtat në krahasim edhe me vendet e Rajonit.

Krahasimi me vendet e rajonit

Përgjithësisht, Shqipëria ka disa karakteristika ekonomike, tipare të taksimit dhe elementë ligjorë, të cilët janë të ngjashme me vendet e rajonit të Ballkanit perëndimor, por edhe me disa nga vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore. Nëse analizojmë ndarjen në: tatime mbi konsumin (tatime indirekte) dhe tatime mbi të ardhurat (tatimet direkte), dallimet dhe ngjashmëritë në kontekstin rajonal bëhen edhe më të qarta.

- Krahasuar me vendet e rajonit, Shqipëria është më poshtë në përqindjen e mbledhjes së të ardhurave në raport me PBB-në se mesatarja e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore (pjesë e BE-së) dhe vendeve të tjera të Ballkanit që nuk janë pjesë e Bashkimit Evropian;
- Shqipëria ngjason me vendet e rajonit për sa i takon mbledhjes së të ardhurave, sidomos të të ardhurave tatimore. Këto të ardhura, së bashku me të ardhurat e mbledhura nga kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore përbëjnë bazën kryesore të të ardhurave për thuajse të gjitha shtetet e rajonit të Ballkanit, Evropës Qendrore dhe asaj Lindore;
- Shqipëria ka një raport të koefiçentit C të efiçencës së TVSH-së relativisht të ulët. Ky koefiçent në Shqipëri llogaritet të jetë 0.54, çka do të thotë se mblidhen 54 përqind e të ardhurave potenciale nga TVSH-ja me normën standarde;
- Të ardhurat nga tatimi direkt i të ardhurave personale dhe kontributet mbeten një nga burimet më të rëndësishme të të ardhurave për Shqipërinë.

Shqipëria ka një nga skemat më progresive të tatimit mbi të ardhurat. Megjithatë, ky progresivitet i tatimit mbi të ardhurat në disa momente ka krijuar një incentivë të gabuar në lidhje me favorizimin e trajtimit të të vetëpunësuarve jashtë skemës së tatimit mbi të ardhurat personale nga puna.

VIZIONI, QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT PËR RRITJEN E TË ARDHURAVE

Për forcimin dhe rritjen e përqindjes së të ardhurave që mblidhen në raport me PBB-në, nevojitet një Strategji të Ardhurash, e cila do të shërbejë si pikë kyçe e orientimit të vendimmarrjes në lidhje me të ardhurat publike. Strategjia mbështetet në vizionin se politikat fiskale të hartuara mirë luajnë rol të rëndësishëm në zhvillimin e qëndrueshëm të vendit.

Objektivi i Strategjisë të të Ardhurave është rritja e qëndrueshme në nivelin deri + 5 përqind të përqindjes së mbledhjes së të ardhurave në raport me Produktin e Brendshëm Bruto, nga të cilat 2.5 përqind pritet të

gjenerohen si rezultat i masave që do të ndërmerren në fushën e ndryshimeve të politikave fiskale dhe 2.5 përqind nga reformat e ndërmarra në fushën e administrimit tatimor/ doganor dhe investimeve në teknologji.

Realizimi i vizionit, qëllimit dhe objektivave, mbështetet në katër shtylla themelore:

- Përcaktim i qartë i objektivave sasiorë dhe synimeve që duhen arritur nëpërmjet Strategjisë;
- Reformë tërësore e politikave tatimore dhe kuadrit përkatës ligjor për të arritur objektivat e të ardhurave;
- Konsensus sa më të gjerë politik për objektivat afatmesme në lidhje me të ardhurat që nevojiten për financimin e shpenzimeve publike të dakordësuara;
- Koordinim i kapaciteteve dhe mbështetje e bashkërenduar, përfshirë financime dhe mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve administrative për zbatimin e Strategjisë.

Dy drejtimet kryesore ku do mbështetet reformimi i sistemit tatimor Shqiptar dhe ku do bazohet Strategjia e të Ardhurave janë:

A. Rishikimi dhe ridizenjimi i politikave tatimore nëpërmjet analizës së efekteve të politikave aktuale dhe korrigjimeve të nevojshme për periudhën afatmesme.

B. Përmirësimi i procedurave të administrimit tatimor dhe doganor me qëllim rritjen e efikasitetit të administratës fiskale nëpërmjet investimeve në teknologji, burimeve njerëzore dhe modernizim të procedurave operacionale.

Zhvillimi i biznesit dhe tregtisë, mbrojtja e konkurrencës dhe promovimi i investimeve të huaja

Ekonomia shqiptare ka ruajtur një ritëm pozitiv të rritjes në dekadën e fundit për shkak të potencialit ekonomik të pashfrytëzuar dhe zbatimit të reformave aktive ekonomike. Momentumi pozitiv vazhdon, por diversifikimi i ekonomisë duke u përqendruar më shumë në sektorët kryesorë me rritje dhe produktivitet të lartë është i rëndësishëm për të ruajtur një rritje afatgjatë dhe për të lejuar hapësirë për përballjen e tronditjeve të paparashikueshme të jashtme e të brendshme.

Shqipëria do të vazhdojë të punojë për ndërtimin e ekonomive të qëndrueshme dhe konkurruese, nëpërmjet hartimit dhe zbatimit të masave që mundësojnë ekonominë e gjelbër dhe transformimin digjital për të mbështetur rritjen dhe rimëkëmbjen ekonomike. Në lidhje me konkurrueshmërinë do të vijojnë reformat për forcimin e sektorit të NMVM-ve, reduktimin e barrierave të tregut, lehtësimin e investimeve dhe tregtisë, zhvillimin e ekonomisë digjitale, nxitjen për kërkimin dhe inovacionin, menaxhimin e partneriteteve publike-private dhe përmirësimin e qeverisjes së ndërmarrjeve shtetërore.

Efektiviteti në zbatimin e këtyre reformave vlerësohet vazhdimisht nga Komisioni Evropian ndërsa vendi vazhdon përgatitjen e tij për anëtarësim në BE. Në Raportin e OECD "Konkurrueshmëria dhe zhvillimi i sektorit privat në Evropën Juglindore 2021", Shqipëria arriti rezultatet "Mesatare më të larta " në politikën tregtare, politikën mbi arsimin, politikën për energjinë, politikën e taksave, politikën e nxitjes së investimeve dhe politikën e punësimit. Raport Progresi BE 2021 konsideron se digjitalizimi në rritje i shërbimeve publike ka dhënë impakt në uljen e barrës administrative mbi bizneset, si dhe korrupsionin dhe informalitetin. Shqipëria ka vijuar të lehtësojë procedurat e regjistrimit të biznesit dhe licencimit nëpërmjet portalit të qeverisjes elektronike.

Shqipëria është e pasur me pasuri të konsiderueshme ekonomike, duke përfshirë një pozicion strategjik gjeografik, bukuri të jashtëzakonshme natyrore dhe burime të rinovueshme dhe jo të rinovueshme. Me 300

milje vijë bregdetare në detin Adriatik dhe Jon, që ofron akses të drejtpërdrejtë në tregjet Evropiane dhe globale. Shqipëria zotëron burime të mëdha natyrore: rreth një e katërta e sipërfaqes së saj totale është e punueshme dhe e përshtatshme për një gamë të gjerë kulturash; malet dhe lumenjtë e saj ofrojnë energji hidroelektrike të lirë dhe me karbon të ulët; dhe shumëllojshmëria e pasur e ekosistemeve bregdetare kanë mbështetur zhvillimin e peshkimit dhe turizmit. Asetet nëntokësore të Shqipërisë përfshijnë depozita tregtare të qëndrueshme të naftës, gazit natyror, kromit dhe bakrit dhe vendi pret një pjesë të Gazsjellësit Trans-Adriatik.

Gjatë viteve të fundit, Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash për të ulur barrierat administrative dhe përmirësuar mjedisin e biznesit. Siç konfirmohet nga Renditja e Bankës Botërore për lehtësinë e të bërit biznes, është bërë progres në drejtim të rritjes së aksesit ndaj kredive dhe forcimit të procedurave për zgjidhjen e paaftësisë paguese. Gjithashtu, Shqipëria e ka lehtësuar procesin e lidhjes me rrjetin e energjisë elektrike, zbatimin e lejeve të ndërtimit dhe pagesën e taksave. Shqipëria u rendit e 82-ta nga 190 vende pjesë e raportit për lehtësinë e të bërit biznes të vitit 2020, duke u renditur më lart se Bosnia dhe Hercegovina (90) por më poshtë se Maqedonia e Veriut (17), Serbia (44), Mali i Zi (50) dhe Kosova (57).

Ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (NVM-të) i kontribuojnë performancës ekonomike dhe zhvillimit të qëndrueshëm dhe angazhues të shoqërive. NVM-të në Shqipëri, Bosnjë dhe Hercegovinë, Kosovë, Mal të Zi, Republikën e Maqedonisë së Veriut, Serbi dhe Turqi (shtatë ekonomitë pretendente për BE) përbëjnë rreth tre të katërtat e punësimit të sektorit privat dhe gjenerojnë rreth 60 përqind të vlerës së shtuar të sektorit privat.

Në fushën e zhvillimit të konkurrueshmërisë së sektorit privat, do synohet rritja e konkurrueshmërisë së sipërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM), me qëllim sigurimin e vendeve të punës ekzistuese apo krijimin e vendeve të reja. Përveç kësaj, do të mbështeten aktivitet kryesore të zbatimit të strategjisë BIDS 2021-2027 për të integruar NMVM-të në zinxhirët e vlerës rajonale ose Evropiane.

Tregtia e lirë:

Shqipëria është anëtare e Organizatës Botërore të Tregtisë që nga shtatori 2000 dhe politika tregtare ndjek parimet dhe rregullat e kësaj organizate. Shqipëria është shumë aktive në pjesëmarrjen në iniciativat e OBT-së. Marrëveshja e Stabilizim-Asociimit (MSA) Shqipëri-BE përfshin një pjesë thelbësore tregtare që krijon një zonë të tregtisë së lirë ndërmjet Shqipërisë dhe BE-së.

Shqipëria është palë në Marrëveshjen Rajonale të Tregtisë së Lirë CEFTA 2006. Protokolli Shtesë 5 i CEFTA për lehtësimin e tregtisë ka filluar zbatimin në vitin 2020 dhe Protokolli Shtesë 6 në CEFTA hyri në fuqi në janar 2021. Shqipëria, si kryesuese e CEFTA-s për vitin 2019, ka marrë pjesë dhe ka kontribuar në mënyrë konstruktive në të gjitha takimet dhe aktivitetet e CEFTA-s.

Ndërkohë, Shqipëria po zbaton marrëveshjen e tregtisë së lirë me shtetet e EFTA-s, marrëveshjen e tregtisë së lire me Turqinë dhe së fundmi Marrëveshjen e Partneritetit, Tregtisë dhe Bashkëpunimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar. Paralelisht, do të vlerësohet nevoja për marrëveshje të reja të tregtisë së lirë.

Regjimi tregtar nuk ka pësuar ndonjë ndryshim thelbësor dhe ka ruajtur nivelin e tij të përgjithshëm të hapjes. Nën drejtimin e Komisionit Evropian, Shqipëria është pjesë e iniciativave rajonale. Plani Shumëvjeçar (MAP REA) u promovua në korrik 2018, si një plan veprimi teknik konkret duke iu referuar të gjitha masave në shtyllën

tregtare, i cili më pas u zëvendësua me Planin e Veprimit për tregun e përbashkët rajonal, ku Shqipëria ka marrë pjesë në mënyrë aktive.

Tregu rajonal është një partner tregtar shumë i rëndësishëm për Shqipërinë, me një bilanc tregtar pozitiv. Në vitin 2021, rreth 8 përqind e totalit të importeve vijnë nga Ballkani Perëndimor, ndërkohë që rreth 19 përqind e totalit të eksporteve drejtohen në këto vende. Tregu i Përbashkët rajonal shërben si një katalizator për një integrim më të thellë ekonomik rajonal dhe një hap drejt tregut të vetëm të BE-së.

Ballkani i Hapur

Në kuadër të Iniciativës për Ballkanin e Hapur të liderëve të tre vendeve të Ballkanit Perëndimor, Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Serbisë, në korrik 2020, u nënshkrua një Memorandum Mirëkuptimi mes palëve për të lehtësuar më tej tregtinë, eksportin, importin dhe transitin ndërmjet këtyre vendeve. Kjo nismë është gjithëpërfshirëse për të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe tre liderët kanë ftuar Bosnjën dhe Hercegovinën, Kosovën dhe Malin e Zi që të jenë pjesë e kësaj nisme.

Po në kuadër të procesit të Ballkanit të Hapur, në Dhjetor 2021 janë nënshkruar disa marrëveshje si më poshtë:

- Marrëveshje bilaterale me Serbinë dhe Maqedoninë e Veriut për njohjen reciproke të autorizimeve të operatorit ekonomik të autorizuar - Siguria dhe Siguria (AEO);
- Marrëveshje nga administratat e akreditimit në fushën e akreditimit dhe thjeshtimin e procedurave për njohjen e shenjave të konformitetit dhe rezultateve të testeve të lëshuara nga laboratorë të akredituar për të lehtësuar importin, eksportin dhe lëvizjen e mallrave ushqimore dhe jo ushqimore;
- Bashkëpunim në fushën e tatimeve;
- Bashkëpunim në fushën e turizmit;
- Bashkëpunim për tregun e punës;
- Pikë e përbashkët doganore – *one stop shop* me Maqedoninë e Veriut.

Gjithashtu, në kuadër të procesit të Ballkanit të Hapur është duke u punuar mes agjencive për promovimin e investimeve mes vendeve palë të iniciativës në mënyrë që të punojnë për një udhërrëfyes për tërheqjen e investimeve.

Shqipëria mbështetet plotësisht në një sistem tregtar global shumëpalësh të hapur, jodiskriminues dhe të bazuar në rregulla me një regjim tregtar të liberalizuar sikurse është e angazhuar në incentivat rajonale për të thelluar bashkëpunimin ekonomik me rajonin bazuar në standardet Evropiane. Në kuadër të procesit të Berlinit, në Samitin e Sofjes të mbajtur në nëntor 2020, liderët e Ballkanit Perëndimor adaptuan Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal. Bazuar në këtë samit, sot po punohet për ndërtimin e një tregu të përbashkët rajonal me 16 milionë konsumatorë dhe me një potencial të konsiderueshëm ekonomik.

Në kuadër të plotësimit të kushteve të Kriterit Ekonomik, lidhur me funksionimin e ekonomisë së tregut, pesë janë drejtimet kryesorë të punës : 1) Qeverisja ekonomike; 2)Stabiliteti Makroekonomik ; 3) Tregjet e produkteve; 4)Tregjet financiare; 5) Tregjet e punës.

Bazuar në Programin e Qeverisë[20] 2021-2025, janë evidentuar disa sektorë kyçë të cilët do të gjenerojnë rritjen ekonomike, të tilla si:

[20] https://kryeministria.al/wp-content/uploads/2021/10/Programi_Qeverises_2021-2025.pdf

- **Manifaktura** për të kaluar në ciklin e plotë të prodhimit duke promovuar markën "Made in Albania";
- **Sipërmarrjet e reja** në ekonominë digjitale;
- **Turizmi** në të gjitha format e zhvillimit të tij detar e malor, përfshirë agroturizmin;
- **Bujqësia** nëpërmjet shtimit të prodhimin, rritjes së cilësisë dhe certifikimet standarde;
- **Energjia** sektor në të cilin Shqipëria synon të bëhet një vend eksportues neto i energjisë elektrike në të gjithë rajonin, me një sistem energjitik shumë më të diversifikuar.

Turizmi është një nga sektorët më të rëndësishëm dhe gjeneron shuma të konsiderueshme të ardhurash në buxhetin e shtetit, atë sipërmarrës dhe atë sektorial. Sipas Raportit të Ndikimit Ekonomik të Udhëtimeve dhe Turizmit 2022, të Këshillit Botëror të Udhëtimeve dhe Turizmit (WTTC), gjatë vitit 2021, sektori i turizmit regjistroi një kontribut të përgjithshëm prej 17.4 përqind të PBB, duke e pozicionuar këtë sektor si një nga kontribuesit kryesorë në zhvillimin ekonomik.

Bujqësia është baza tradicionale e ekonomisë Shqiptare dhe mbetet burimi kryesor i të ardhurave për një pjesë të madhe të popullsisë. Gjatë vitit 2021, ky sektor punësoi pothuajse 34 përqind të popullsisë së punës të vendit dhe kontribuoi në PBB-në e vendit me 16.8 përqind[21].

Energjia dhe Energjia e Rinovueshme. Shqipëria ka një potencial të konsiderueshëm të Burimeve të Rinovueshme të Energjisë (BRE). BRE-të përfaqësojnë një burim të rëndësishëm energjie në dispozicion në Shqipëri. Përdorimi i burimeve të tilla për prodhimin e energjisë paraqet një strategji afatgjatë për zbatimin e tre objektivave të politikave energjitike të vendit, si: mbështetja e zhvillimit të përgjithshëm ekonomik; rritjen e sigurisë së furnizimit me energji dhe mbrojtjen e mjedisit. Ky sektor është aktualisht sektori më i rëndësishëm për sa i përket investimeve, duke tërhequr 29 përqind të totalit të IHD-ve në Shqipëri. "Mineralet, lëndët djegëse, energjia elektrike" luajnë një rol kyç në ekonominë shqiptare, duke përfaqësuar 18.8 përqind të totalit të eksporteve në vitin 2021, me një rritje prej 74 përqind nga viti 2020 në 2021.

Sektori i **prodhimit** përfaqëson rreth 5.1 përqind të PBB-së. Ky sektor ka diversifikuar vazhdimisht gamën e eksporteve të tij, siç tregohet nga rritja e eksporteve të 'Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi' me 29,1 përqind nga viti 2020 deri në vitin 2021. Tekstilet dhe këpucët luajnë një rol kyç në ekonominë Shqiptare, duke përfaqësuar 30,5 përqind. të totalit të eksporteve në vitin 2021, dhe duke punësuar më shumë se 40 përqind të të punësuarve në industrinë përpunuese. Produktet industriale më të eksportuara në vitin 2021 ishin "Tekstile dhe këpucë", "Materiale ndërtimi dhe metale" dhe "Makineri, pajisje dhe pjesë këmbimi".

TIK & BPO. Që nga fillimi i viteve 2000, Shqipëria është bërë një destinacion kryesor për shërbimet ICT-BPO me kulturën e saj urbane, disponueshmërinë e burimeve, infrastrukturën dhe stimujt tërheqës për investime. Tirana është qendra kryesore ICT-BPO e Shqipërisë, e ndjekur nga Durrësi, Shkodra dhe Vlora. Sektori ICT-BPO në Shqipëri ka parë rritje të qëndrueshme që nga fillimi i tij, duke rritur punësimin dhe duke arritur vlerat e industrisë që i kalojnë 130 milionë dollarët dhe një numër punonjësish rreth 35,000 për vitin 2020. Deri në fund të vitit 2021, në Shqipëri ishin rreth 4,005 sipërmarrje aktive që operonin në sektorin e Informacionit dhe Komunikimit. Modernizimi i shërbimeve dhe i infrastrukturës digjitale përbën një instrument të patjetërsueshëm dhe të pazëvendësueshëm për të luftuar korrupsionin dhe për të rritur në mënyrë të shpejtë cilësinë e

[21] Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Treguesit Makroekonomikë për vitin 2021

shërbimeve ndaj publikut, si dhe produktivitetin e sipërmarrjes. Nga data 1 maj 2022 të gjitha shërbimet pubike ofrohen vetëm *on-line* duke ulur kështu kohën dhe kostot për bizneset dhe qytetarët.

Ligji për investimet strategjike i vitit 2015 përcaktoi sektorët strategjikë të ekonomisë, në bazë të shumës së qarkullimit dhe numrit të të punësuarve. Këta sektorë janë: Energjia dhe Minierat; Transporti; Telekomunikacioni; Infrastruktura dhe mbetjet urbane; Turizmi; Bujqësia dhe peshkimi; Zonat Ekonomike dhe Zonat me prioritet zhvillimi. Për vitin 2021, treguesi i fluksit është 1,031 milionë €. Fluksi i investimeve të huaja në vend dominohet nga Holanda, e ndjekur nga Italia, Turqia, Franca dhe Austria. Për vitin 2021, burimi kryesor i fluksit së IHD-ve ishte 'Industria Nxjerrëse' e cila përfaqëson 24 përqind të fluksit total.

Shqipëria ofron shumë një sërë avantazhesh për tërheqjen e investitorëve të huaj si:

- Vendndodhja optimale gjeografike: Shqipëria ka një vendndodhje strategjike në Ballkanin Perëndimor, në udhëkryqin e korridoreve kryesore tranzitore të Evropës;
- Akses i lirë në tregjet e mëdha: Shqipëria ka një regjim tregtar shumë të liberalizuar;
- Tatimet konkurruese dhe stimujt;
- Zhvillimet në infrastrukturën e re dhe të përmirësuar në energji, telekomunikacion, transport detar dhe ajror;
- Partnerët kryesorë tregtarë shqiptarë janë vendet anëtare të BE-së;
- Përafërsisht gjysma e popullsisë është nën 35 vjeç;
- Shqipëria u rendit e para në rajonin e Ballkanit Perëndimor për aftësitë e fuqisë punëtore të saj aktuale dhe të ardhshme (2019 Global Competitiveness Index);
- Kapacitete shumëgjuhëshe, ku 59.4 përqind e popullsisë së re flasin të paktën 1 gjuhë të huaj, dhe 8 përqind flasin 3 gjuhë të huaja.

Investimet e Huaja Direkte (IHD) përbëjnë një element mbështetës për rritjen ekonomike në Shqipëri dhe një burim të rëndësishëm financimi për defiçitin e llogarisë korrente.

Shqipëria ka një performancë të lartë në rajon me IHD të cilat përbëjnë më shumë se 8 përqind të produktit vendas, ose rreth 1 miliard euro në vit gjatë dekadës së fundit. Portofoli i investimeve të huaja direkte është i larmishëm në të gjithë sektorët dhe i fokusuar veçanërisht në energji, turizëm dhe shërbime, pasuri të paluajtshme dhe nxjerrjen e burimeve kombëtare. IHD-të kanë kontribuar në integrimin e Shqipërisë në specializimin global të zinxhirëve të vlerës. Fluksi i IHD-të është rritur ndjeshëm në dhjetë vitet e fundit - i nxitur, ndër të tjera, nga reformat e klimës së investimeve. Në vitin 2019, fluksi i IHD-ve arriti në më shumë se 1 miliardë €, duke u rritur me 14.6 përqind nga viti 2016. FDI-të neto zënë 7.6 përqind të PBB-së - një nga vlerat më të larta në vendet e Ballkanit Perëndimor. Vendet e BE-së mbeten burimi kryesor i IHD-ve në Shqipëri dhe në fund të vitit 2020 ishte 54.2 përqind i stokut total të IHD-ve.

Klima e investimeve në Shqipëri është përmirësuar gjatë viteve të fundit. Sipas Indeksit 2019 të OECD-së për Kufizimet Rregullatore të IHD-ve, regjimi i IHD-ve në Shqipëri është më pak kufizues se sa mesatarja e OECD-së apo ekonomisë së BE-së, por më pak i hapur ndaj IHD-ve se sa vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor.

Vizioni i strategjisë 7 vjeçare për Zhvillimin e Biznesit dhe Sipërmarrjes, 2021-2027 është: "Një ekonomi shqiptare më konkurruese, e drejtuar nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, që krijon vende pune të reja dhe me cilësi më të lartë, duke shfrytëzuar potencialet e tranzicionit digjital dhe transformimin e zinxhirëve të vlerës ndërkombëtare dhe duke theksuar zhvillimin e qëndrueshëm, BE dhe integrimin rajonal".

Në fushën e **konkurrencës** dhe ndihmës shtetërore, detyrimet e Shqipërisë përcaktohen nga nenet 40, 70 dhe 71 të MSA-së dhe legjislacionin shqiptar që fokusohet në promovimin dhe mbrojtjen e konkurrencës së lirë në Shqipëri. Zbatimi i legjislacionit përmes monitorimit të tregut dhe sanksioneve të vendosura shoqërive për sjellje anti-konkurruese në treg kanë ndihmuar në drejtim të mbrojtjes së konkurrencës në tregun vendas dhe paraprirjes se ndalimit të përqendrimit të tregut në sektorë të caktuar. Komisioni i Ndihmës Shtetërore ka punuar në vazhdimësi për të rritur numrin e njoftimeve të skemave të ndihmës shtetërore nga ofruesit e ndihmës, me synim promovimin e punësimit.

Sfida e përgjithshme për periudhën deri në 2030 lidhet me nevojën për mbrojtje më të madhe të konkurrencës së lirë dhe efikase në treg për të garantuar një treg të hapur dhe funksional në përputhje me praktikat më të mira të Bashkimit Evropian. Në vëmendje do të jenë ndalimi i sjelljes anti-konkurruese, kontrolli më efikas i tregut, liberalizimit në rritje që nevojitet për të vlerësuar të drejtat individuale dhe ekskluzive, nevojës për bashkëpunim më parandalues midis politikëbërësve, autoriteteve publike dhe organeve rregullatore, me qëllim mbrojtjen dhe rritjen e konkurrencës në tregje ku ka ndërhyrje nga shteti dhe nevojës më të madhe për të forcuar kapacitetet administrative të strukturave dhe institucioneve të ngarkuara me kontrollin e ndihmës shtetërore.

Objektivat strategjike:

- Përfundimi i harmonizimit të legjislacionit parësor dhe dytësor me ligjin Evropian për të përmbushur detyrimet që burojnë nga integrimi në BE;
- Forcimi i kapaciteteve investigative me anë të investimeve për të optimizuar infrastrukturën e informacionit dhe rritur nivelin e ekspertizës dhe numrin e ekspertëve të konkurrencës;
- Forcimi i mbrojtjes dhe promovimit të konkurrencës në Shqipëri;
- Rritja e nivelit të njohurive të gjyqësorit për të njohur më mirë ligjin dhe praktikat më të mira të Gjykatës Evropiane të Drejtësisë në fushën e ligjit të konkurrencës;
- Sigurimi i bashkëpunimit aktiv midis rregullatorëve të tregjeve të posaçme dhe institucioneve të tjera publike, për një treg më efikas përmes rritjes së konkurrencës;
- Forcimi i kulturës së konkurrencës me anë të forcimit të zbatimit të ligjit dhe aktiviteteve njohëse duke theksuar interesin publik dhe përfitimet ekonomike që sjell konkurrenca për konsumatorin fundor dhe bizneset;
- Vendosja dhe zbatimi i një sistemi të thjeshtuar për monitorimin e ndihmës shtetërore, duke përfshirë asistencën minimale;
- Rritja e efikasitetit të monitorimit në zbatimin e ndihmës shtetërore të miratuar nga Komisioni i Ndihmës Shtetërore.

Qëllimi Strategjik: Një ekonomi Shqiptare konkurruese, e nxitur nga inovacioni dhe e bazuar në njohuri, e cila krijon vende pune të reja dhe cilësore, duke shfrytëzuar mundësitë që ofron transformimi digjital dhe transformimi i zinxhirit të vlerave ndërkombëtare, me theksin mbi zhvillimin e qëndrueshëm, Integrimin Evropian dhe atë rajonal. Integrim më të thellë ekonomik rajonal të Shqipërisë dhe përgatitja e kushteve për të ecur të sigurtë drejt Tregut të Vetëm Evropian, në përputhje me acquis e 4 lirive tregtare të Bashkimit Evropian.

Qëllimet e politikës:

1. Krijimi i Tregut të Përbashkët Rajonal ndërmjet 6 vendeve të Ballkanit Perëndimor
   Rritja e efektivitetit dhe ndikimit të përpjekjeve për tërheqjen e investimeve duke mbështetur rimëkëmbjen dhe qëndrueshmërinë afatgjatë të ekonomisë

Mbrojtja e konsumatorit dhe mbikëqyrja e tregut

Mbrojtja e konsumatorit mbulon mbrojtjen e interesit publik për çështje të sigurisë së produkteve të konsumatorëve dhe interesave të tyre ekonomike, për aspekte të lidhura me politikën, legjislacionin dhe zbatimin e tij. Këtij qëllimi i shërben, gjithashtu, edhe rrjeti i infrastrukturës së cilësisë, me fushat dhe institucionet përkatëse të standardizimit, akreditimit dhe metrologjisë. Angazhimet në fushën e mbrojtjes së konsumatorit janë në përputhje me detyrimet që rrjedhin nga nenet 70 dhe 76 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, si dhe të dispozitave përkatëse të acquis së BE-së. Detyrimi për të përafruar ligjin Shqiptar me atë të Bashkimit Evropian buron nga neni 70 i MSA-së dhe Kriteret e Kopenhagës.

Krijimi i Inspektoriatit Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut, mbështetur në legjislacionin e sigurisë së produkteve, ka ndikuar në forcimin më tej të zbatimit të standardeve dhe legjislacionit për sigurinë e produkteve në treg dhe mbrojtjen e konsumatorëve, duke siguruar monitorim dhe kontroll të tregut, si dhe zhvillimin e mjeteve parandaluese të rrezikut nëpërmjet informimit, këshillimit dhe bashkëpunimit.

Siguria e produkteve, përmirësimi i sigurisë së produkteve dhe shërbimeve në treg, sidomos për ato sektorë/produkte për të cilat ende nuk ka një bazë legjislative/rregullatore të harmonizuar, vijon të mbetet prioritet, me qëllim sigurimin e ofrimit të produkteve të sigurta dhe në përputhje me gjithë kërkesat, kjo edhe në kuadër të procesit të integrimit dhe përshtatjes me ndryshimet e legjislacionit Evropian.

Infrastruktura e Cilësisë (standardizim, metrologji, akreditim, testim-certifikim, vlerësim konformiteti) përbën themelin e reformave në tregun brendshëm, të cilat krijojnë premisat për vendime të rëndësishme lidhur me cilësinë e jetës së qytetarëve, në lidhje me mbrojtjen e shëndetit, ambientit, sigurinë e përgjithshme teknike, mbrojtjen e interesave ekonomike të konsumatorit dhe të sektorit privat, në lidhje me cilësinë e produkteve dhe shërbimeve të prodhuara në Shqipëri.

Në dispozicion të konsumatorit, që nga Shtatori 2015, është dhe faqja e internetit e Komisionit të Mbrojtjes së Konsumatorëve që ka për qëllim të ofrojë informacion më të mirë për konsumatorët, si dhe për paraqitjen online të ankesat të tyre (http://kmk.financa.gov.al/). Faqja online solli një prezantim më të mirë të informacionit për konsumatorët, lehtësoi paraqitjen e ankesave nga konsumatorët dhe përpunimin e ankesave dhe të dhënave nga Sekretariati Teknik i Komisionit.

Pavarësisht arritjeve të viteve të fundit, sfidat për të ardhmen lidhen me hartimin e një dokumenti strategjik me natyrë gjithëpërfshirëse, në fushën e mbrojtjes së konsumatorit, që do të përfshijë aspekte të sigurisë së përgjithshme të produkteve ushqimore dhe atyre joushqimore, çështje të mbrojtjes së konsumatorëve që nuk kanë lidhje me aspektet e sigurisë, si dhe të informimit dhe ndërgjegjësimit, duke iu përgjigjur në këtë mënyrë

nevojës së plotësimit të boshllëkut dhe duke shërbyer si një përgjigje efektive ndaj të gjitha prioriteteve që shfaqen në kuadër të zhvillimeve edhe në nivel Evropian në këtë fushë.

Referenca me Kapitullin përkatës të "Acquis"

- Kapitulli 28 "Mbrojtja e Konsumatorit dhe Shëndeti Publik";
- Kapitulli 1 "Lëvizja e Lirë e Mallrave".

Qëllimi i politikës: Përmirësimi i shkallës së mbrojtjes së Konsumatorit nëpërmjet përmirësimit të mëtejshëm të kuadrit ligjor dhe rregullator shqiptar në përputhje me acquis e BE, me synim fuqizimin e rolit të tij në treg duke garantuar rritjen e ndërgjegjësimit të konsumatorëve, përmirësimin e njohurive të tyre mbi drejtat e tyre të mbrojtjes së interesave ekonomike.

Masat që lidhen me qëllimin e politikës:

- Përmirësimi i legjislacionit dhe harmonizimi i tij me legjislacionin Evropian;
- Ndërgjegjësimi i konsumatorëve në lidhje me sigurinë e produkteve në treg dhe interesave të tyre ekonomike;
- Hartimi i dokumentit strategjik në fushën e mbrojtjes së konsumatorëve.

Bujqësia dhe zhvillimi rural

Sektori bujqësor përjeton rritje të qëndrueshme, me formim vjetor të kapitalit fiks bruto prej rreth 53.7 milionë Euro, dhe rritje të produktivitetit vjetor prej 5,680 Euro në vitin 2020. Kontributi i bujqësisë në totalin e vlerës së shtuar bruto të ekonomisë është rreth 22 përqind. Në vitin 2019, 36.4 përqind e forcës totale të fuqisë punëtore ishte në bujqësi, pylltari dhe peshkim.

Prodhimi bujqësor dominohet nga fermat e vogla dhe fermat familjare pasi 85 përqind e fermave klasifikohen si të vogla. Madhësia mesatare e pandryshuar prej 1.2 ha, e kombinuar me fragmentimin dhe të drejtën e paqartë të pronës janë sfidat kryesore për rritjen dhe konkurrencën e sektorit të bujqësisë. Megjithatë, fermat e vogla luajnë rol të rëndësishëm për sigurimin e ushqimit të popullsisë Shqiptare, si dhe për uljen e varfërisë në zonat rurale, por janë të integruar në mënyrë të pamjaftueshme në zinxhirët e shkurtër të furnizimit.

Bujqësia është orientuar drejt produkteve me avantazhe konkurruese dhe krahasuese, të cilat sigurojnë edhe të ardhura më të mëdha për njësi sipërfaqe dhe që kanë potencial për eksport. Në vitet e fundit janë mbështetur dhe stimuluar ndryshimet në strukturën e mbjelljeve të produkteve bujqësore në funksion të rritjes së prodhimtarisë, zbatimit të standardeve të larta dhe plotësimin e kërkesave të tregjeve të brendshëm dhe atij ndërkombëtar. Ndryshimet më të mëdha në strukturën e mbjelljeve kanë ndodhur kryesisht në zinxhirët e vlerës të perimeve, pemëve frutore, ullinjve, agrumeve, bimëve mjekësore dhe aromatike, luleshtrydheve etj.

Sektori i prodhimit blegtoral me gjithë vështirësitë që paraqet puna për blegtorët ka qëndrueshmëri në prodhimin e qumështit si nga gjedhi edhe të imtat por edhe të mishit për furnizimin e tregut të brendshëm. Agro-përpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 viteve të fundit duke arritur në 24.4 përqind të xhiros totale të bujqësisë. Xhiroja e sektorit është pothuajse dyfishuar, ndërkohë që punësimi është rritur me rreth 20 përqind, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme për produkte të përpunuara dhe rritja e eksportit të produkteve të përpunuara.

Prodhimi total primar nga peshkimi është rritur në mënyrë të konsiderueshme në vitet e fundit, ku akuakultura detare dhe peshkimi kanë kontribuar në mënyrë të ndjeshme në rritjen e sektorit, ndërsa ujrat e brendshme dhe lagunat bregdetare kanë pasur një kontribut më të kufizuar.

Eksportet nga bujqësia në vitin 2020 krahasuar me vitin 2017 janë rritur me 33.3 përqind; peshkimi është rritur me 31.8 përqind, ndërsa agroindustria me 23.7 përqind.

Vizioni : *Të bëjë të mundur një sektor agroushqimor dhe të peshkimit të efektshëm, inovativ dhe të qëndrueshëm, i cili të mund të përballojë sfidat afatmesme dhe afatgjata që lidhen me sigurimin e ushqimit dhe të reagojë ndaj sfidave të ndryshimeve klimatike, menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe biodiversitetit; ndërkohë që kontribuon në rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e cilësisë së jetës duke i bërë më konkurruese familjet në zonat rurale.*

Zhvillimi i bujqësisë do të mbështetet duke mbrojtur biodiversitetin e vendit, përkrahur kultivimin e qëndrueshëm të bimëve aromatike e mjekësore, prodhimin organik, produktet cilësore me gjeografi të identifikueshme, transferimin e njohurive dhe inovacionit si dhe fuqizimit të shërbimit publik të ekstensionit.

Qëllimet e politikës për sektorin:

1. Promovimi i prodhimit të qëndrueshëm dhe të cilësisë së ushqimit nëpërmjet zhvillimit të një sektori konkurrues dhe inovativ agroushqimor;
2. Forcimi i menaxhimit të qëndrueshëm të burimeve natyrore dhe përshtatja ndaj ndryshime klimatike;
3. Forcimi i strukturës sociale-ekonomike të zonave rurale duke nxitur promovimin e zhvillimit lokal nëpërmjet përmirësimit të punësimit dhe mundësive të biznesit në fermë dhe jashtë saj, si dhe përmes iniciativave zhvillimore të udhëhequra nga komuniteti;
4. Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm detar dhe të ujrave të brendshme nëpërmjet forcimit të akuakulturës dhe tregjeve konkurruese si dhe nxitjen e peshkimit të qëndrueshëm dhe ruajtjen e biodiversitetit dhe ekosistemeve;
5. Forcimi i kapaciteteve institucionale dhe administrative drejt përafrimit me acquis communautaire të BE-së në klasterin dhe kapitujt përkatës, 11, 12 dhe 13;
6. Transferimi i njohurive dhe inovacionit në bujqësi dhe zonat rurale si dhe nxitja e përvetësimit dhe zbatimit të tyre.

Lidhja me PKIE, me acquis të BE-së, me Politikën e Përbashkët Bujqësore të BE-së (PPB).

Ndërhyrjet e mëtejshme prioritare përfshijnë krijimin e Rrjetit të të Dhënave të Kontabilitetit të Fermës që do të krijojë bazën e nevojshme të të dhënave që ofron dëshmi të besueshme dhe lejon një kuptim të drejtë të tendencave të ndryshme në sektor për një politikëbërje të bazuar në dëshmi. Zbatimin e Regjistrit të Fermës, përmirësimin e regjistrit të blegtorisë (sistemit (RUDA) si dhe krijimin e sistemit të besueshëm për identifikimin e parcelave të tokës (LPIS) si pjesë e Sistemit të Integruar të Kontrollit Administrativ (IACS), që siguron regjistrimin unik të çdo përfituesi të fondit publik.

Ndërhyrjet në lidhje me harmonizimin me acquis të **kapitullit 11** janë planifikuar për të rritur dhe siguruar kapacitete efikase institucionale, administrative dhe njerëzore të Strukturës Operative IPARD (Autoriteti Menaxhues IPARD dhe Agjencia e Pagesave), por edhe të Organeve Teknike për zbatimin dhe kontrollin e katër masave të IPARD të akredituara si dhe për dorëzimin për besimin e pesë masave të tjera IPARD siç janë planifikuar në draft programin IPARD III. Ndërhyrje të tjera do të nevojiten në **një sistem certifikimi për OP-të (organizatat/grupet e prodhuesve) dhe SHOP-et,** si edhe përafrimi i mëtejshëm **i kuadrit ligjor kombëtar të verës dhe bujqësisë organike** me legjislacionin e BE-së, duke përfshirë edhe një sistem kontrolli të përforcuar.

Bujqësia është e lidhur me **kapitullin 12** për forcimin e mëtejshëm të politikave të Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë dhe ato Fitosanitare.

Lidhja me **kapitullin 13**, përfshin masa për të forcuar kapacitetet ligjore, institucionale dhe administrative si dhe të operatorëve për zbatimin e Politikës së Përbashkët të Peshkimit (PPP). Gjithashtu, angazhimet e Qeverisë Shqiptare në lidhje me Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor, do të kërkojnë gjithashtu në përgatitjen e legjislacionit horizontal në lidhje me Acquis të **kapitullit 27** - Mjedisi dhe klima - veçanërisht në lidhje me Direktivat e BE-së për ujin, mbrojtjen e natyrës dhe biodiversitetit lidhur me bujqësinë dhe peshkimin.

Lidhja me OZHQ

Ndërhyrjet specifike kontribuojnë në arritjen e Objektivave të mëposhtëm të Zhvillimit të Qëndrueshëm:

OZHQ 2 për të arritur sigurimin e ushqimit dhe të ushqyerjes të përmirësuar dhe për të promovuar një bujqësi të qëndrueshme duke përfshirë peshkimin;

OZHQ 5 Barazia Gjinore;

OZHQ 12 për të siguruar modele të qëndrueshme të konsumit dhe të prodhimit në sektorin agroushqimor dhe të peshkimit;

OZHQ 13 për të nxitur veprime për të luftuar ndryshimin e klimës dhe ndikimet e saj;

OZHQ 14 për të ruajtur dhe përdorur në mënyrë të qëndrueshme Detin Mesdhe dhe burimet detare për zhvillim të qëndrueshëm;

OZHQ 15 për të mbrojtur, rivendosur dhe promovuar përdorimin e qëndrueshëm të ekosistemeve tokësore me vëmendje të veçantë për të ndaluar dhe përmbysur degradimin e tokës dhe për të ndaluar humbjen e biodiversitetit;

OZHQ 17 për të rritur partneritetin global, për të forcuar strukturat e bashkëpunimit për zhvillim të qëndrueshëm në shkëmbimin e njohurive, ekspertizës, inovacioneve dhe burimeve financiare.

Zhvillimi Rural

Popullsia rurale llogaritet në 964,791 banorë (2019). Përqindja e popullsisë rurale ka rënë vazhdimisht nga 42,57 përqind në vitin 2015 në 38,89 përqind në vitin 2019, e shkaktuar nga migrimi jashtë dhe përgjithësisht nivelet më të ulëta të lindjeve. Disponueshmëria dhe cilësia e infrastrukturës rurale dhe e shërbimeve bazë janë në proces zhvillimi në zonat rurale, por mbetet sfidues veçanërisht në zonat e thella dhe malore: me gjithë vëmendjen e rritur, akoma mbeten për t'u përmirësuar furnizimi i qëndrueshëm me energji elektrike, sistemet e

administrimit të ujërave të zeza dhe të kanalizimeve, grumbullimi i mbetjeve, rrjeti rrugor rajonal dhe rural ose konektiviteti digjital.

Zhvillimi ekonomik në zonat rurale karakterizohet nga një mbizotërim i sektorit ekonomik nga bujqësia. Agropërpunimi është rritur ndjeshëm gjatë 10 viteve të fundit duke arritur në 24.4 përqind të xhiros totale të bujqësisë. Tendencat janë shumë pozitive, të cilat tregojnë se sektori ka potencial të lartë për zhvillim dhe krijimin e vendeve të punës. Xhiroja e sektorit është pothuajse dyfishuar, ndërkohë që punësimi është rritur me rreth 20 përqind, mbështetur nga rritja e kërkesës së brendshme për produkte të përpunuara dhe rritja e eksportit të produkteve me origjinë bimore, ndërkohë që mundësimi i eksportit të produkteve me origjinë shtazore është në proces realizimi me disa prej vendeve të rajonit, por edhe në të ardhmen me vendet e Bashkimit Evropian, pas përfundimit të procesit të reformave të rëndësishme të ndërmarra në fushën e sigurisë ushqimore në të cilat është angazhuar sektori.

Transformimi me ritme më të shpejta i prodhimit bujqësor, që është i nevojshëm për të ndërtuar sisteme të qëndrueshme ushqimore kërkon një sektor bujqësor ekonomikisht perfomues dhe të qëndrueshëm, si edhe një sektor konkurrues të agropërpunimit. Sfidat kryesore ekonomike dhe shoqërore janë, si për të përmirësuar mundësitë e aktivitetit në bujqësi, ashtu edhe për të gjeneruar mundësi të reja, si dhe për të konsoliduar tregjet ekzistuese dhe eksploruar tregje të reja, brenda dhe jashtë vendit për sektorin agroushqimor. Me synimin e rritjes së eksporteve, do të promovohet veçanërisht rritja e konkurrueshmërisë, duke përmirësuar nivelin e mekanizimit të fermave, duke rritur sipërfaqet e serrave, të pemëve frutore intensive, ullishtave dhe bimëve mjekësore dhe aromatike, diversifikimi i produkteve bujqësore të kultivuara dhe shtimi i sipërfaqeve, të cilat kanë vlerë më të lartë të shtuar për operatorët e sektorit dhe ose kalojnë nëpërmjet përpunimit, si dhe nëpërmjet shtimit të blegtorisë së imët dhe rritjes së rendimentit për krerë në lopët e qumështit.

Çështjet kryesore që do të adresohen:

- Mbështetja e një procesi të përshtatshëm të konsolidimit të fermës në terma ekonomikë dhe strukturorë;

- Mbështetja e të ardhurave të fermave familjare të vogla dhe të mesme dhe të atyre që ndodhen në zona me kufizime natyrore nëpërmjet forcimit të bashkëpunimit midis operatorëve në faza të ndryshme të prodhimit, tregtimit apo përpunimit;

- Tërheqja e fermerëve të rinj në biznesin bujqësor dhe rural dhe lehtësimi i ngritjes rishtazi dhe zhvillimit të biznesit të tyre (start-up) për një rinovim të gjeneratës së fermerëve në sektorin e bujqësisë;

- Përmirësimi i efektshmërisë dhe i qëndrueshmërisë së prodhimit në fermë;

- Rritja e kapacitetit të fermerëve për të krijuar dhe për të zotëruar një pjesë më të madhe të vlerës së shtuar në zinxhirin e furnizimit ushqimor;

- Rritja e qëndrueshmërisë/elasticitetit (aftësisë për të reaguar) të fermave ndaj faktorëve klimatikë;

- Ruajtja e biodiversitetit të lartë të lidhur me livadhet dhe kullotat e shfrytëzuara në mënyrë ekstensive dhe me ullishtat tradicionale;

- Mirëmbajtja e burimeve gjenetike në bujqësi dhe blegtori;

- Inkurajimi i bujqësisë organike;

- Përafrimi në mënyrë progresive i fermave të qëndrueshme dhe i bizneseve të përpunimit agroushqimor apo i tregtimit me standardet e BE-së, për të siguruar produkte ushqimore të sigurta dhe për të rritur konkurrencën e tyre kombëtare dhe ndërkombëtare (rritje të eksportit);

- Nxitja e inovacionit dhe e një niveli të lartë të trajnimit dhe të investimeve në bujqësi dhe në përpunimin ushqimor;

- Forcimi i turizmit rural dhe në veçanti i zinxhirit të vlerës së agroturizmit;

- Stimulimi i aksesit në financa për zhvillimin e biznesit;

- promovimi i praktikave të mira për mirëmbajtjen e burimeve natyrore, si ajri, toka dhe uji;

- Forcimi i kapaciteteve të rrjetëzimit dhe të kapaciteteve mbështetëse. Zbatimi i qasjes LEADER (zhvillimi i një territori të caktuar që mbulon një GVV) do të hapte një dritare financimi afatgjatë për GVV-të.

Bashkimi Evropian ka ofruar mbështetje të konsiderueshme për bujqësinë dhe zhvillimin rural në Shqipëri përmes Programit IPARD II me një buxhet grant prej 94 milion euro të financuar pjesërisht nga Qeveria Shqiptare, për mbështetjen e investimeve nëpërmjet implementimit IPARD II për zhvillimin e zonave rurale, diversifikimin e ekonomisë, investimet në sektorin agro-ushqimor për përmirësimin e konkurrencës, pajtueshmërinë me standardet e BE-së dhe ruajtjen e natyrës dhe mjedisit.

Ujitja dhe kullimi

Klima e Shqipërisë është mesdhetare, me verë të nxehtë e të thatë, dhe dimër të ftohtë e të lagësht, ku mesatarja vjetore e reshjeve është 1485 mm me rreth 80 përqind të reshjeve që bien në periudhën Tetor–Mars. Defiçiti ujor për ujitje gjatë periudhës maj-shtator është rreth 300-400 mm, çka nënkupton se për çdo hektar nevojitet rreth 3000-4000 m3 ujë (për ujitjen sipërfaqësore), që duhet të sigurohet nëpërmjet ujitjes. Ndaj, ujitja dhe kullimi janë faktorë të rëndësishëm për rritjen e qëndrueshme të prodhimit bujqësor, për më tepër, që me projeksionet e ndryshimeve të mundshme klimaterike, mund të kemi pakësim të reshjeve vjetore dhe çrregullime të theksuara në intensitetet e reshjeve gjatë periudhës vjeshtë-dimër.

Infrastruktura e ujitjes dhe kullimit është projektuar dhe ndërtuar para vitit 1990 për të ujitur një sipërfaqe prej rreth 420 000 ha (nga të cilat rreth 100 000 ha me ngritje mekanike) dhe kullimin e rreth 280 000 ha (nga të cilat 75 000 ha me ngritje mekanike- hidrovore). Në këtë sistem ujitës rreth 180 000 ha janë projektuar të ujiten nga 626 rezervuarë me aftësi ujëmbledhëse të projektuar rreth 560 milion m3, ndërsa për rreth 240 000 ha, skemat ujitëse kanë për burim ujor ujrat e lumenjve dhe përrenjve. Kryesisht për shkak të zgjerimit të zonave urbane dhe të dëmtimeve të ndodhura, infrastruktura ekzistuese mund të mbulojë me ujitje një sipërfaqe rreth 360 000 ha, nga të cilat rreth 75 000 ha kanë për burim ujor stacionet e pompimit, që aktualisht janë thuajse të gjithë jashtë funksioni, ndërsa rreth 285 000 ha furnizohen me ujë nga rezervuarët, lumenjtë dhe përrenjtë. Si pjesë e reformës së decentralizimit, një pjese e konsiderueshme e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit është transferuar në pronësi tek bashkitë e vendit.

Në infrastrukturën e ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave, nëpërmjet buxhetit të shtetit dhe Projektit të Burimeve Ujore, të financuar nga Banka Botërore, gjatë 5 viteve të fundit janë investuar rreth 18.9 miliardë lekë (nga të cilat 3.6 miliardë janë alokuar direkt për bashkitë) nëpërmjet të cilave është mundësuar:

- Dyfishimi i sipërfaqes së ujitshme me infrastrukturë të rehabilituar dhe përmirësuar, nga 120 000 ha, në rreth 250 000 ha në 2020;
- Për mbrojtjen nga përmbytjet janë rehabilituar dhe ndërtuar rreth 80 km argjinatura mbrojtëse në lumenjtë e vendit;
- Nëpërmjet pastrimit intensiv të rrjetit kullues, në sajë edhe të shtimit të të numrit të ekskavatorëve të rinj për bashkitë dhe drejtoritë e ujitjes dhe të kullimit, është përmirësuar kullimi në rreth 230 000 ha nga 280 000 ha të sipërfaqes totale që kullon;
- Rehabilitimi i hidrovorëve të rëndësishëm duke përmirësuar treguesit e kullimit me ngritje mekanike në rreth 20,000 ha.

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë reforma të rëndësishme në sektorin e ujitjes dhe kullimit, të cilat kanë rritur rolin e bashkive në menaxhimin e ujitjes dhe kullimit, nëpërmjet transferimit në pronësi të infrastrukturës përkatëse, është miratuar ligji për administrimin e ujitjes dhe të kullimit i cili përcakton qartësisht detyrat dhe përgjegjësitë e bashkive dhe drejtorive të ujitjes dhe kullimit si dhe të gjitha aktet nënligjore të tij, së bashku me Strategjinë Kombëtare të Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 si dhe Planit të Veprimit.

Gjendja e sistemit të ujitjes dhe kullimit dikton vazhdimin e procesit të rehabilitimit, modernizimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës së ujitjes, kullimit, mbrojtjes nga përmbytja dhe sigurinë e digave, me synim kryesor sigurimin e një ujitje të qëndrueshme në rreth 250 000 ha, me infrastrukturë të rehabilituar/ përmirësuar dhe shtimin e sipërfaqes ujitëse me rreth 110 000 ha, kryesisht me skema ujitëse me ngritje mekanike me stacione pompimi, për të arritur në këtë mënyrë në ujitjen në të gjithë sipërfaqen potencialisht të ujitshme rreth 360 000 ha.

Gjithashtu do të vazhdojë të përmirësohet sistemi kullues në rreth 280 000 ha, nëpërmjet rehabilitimit dhe modernizimit të hidrovoreve, rinovimit të parkut të makinerisë së rëndë dhe rikthimit të kullimit të rreth 7500 ha toka torfike sikurse dhe rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytja nëpërmjet rehabilitimit dhe rikonstruksionit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja të mbrojtjes nga përmbytja në lumenjtë kryesorë të vendit.

QËLLIMI I POLITIKËS PËR SEKTORIN E UJITJES DHE KULLIMIT: *Rritja e prodhimit bujqësor nëpërmjet plotësimit të vazhdueshëm të nevojave të fermerëve për ujë, për ujitje, sigurimin e kullimit dhe zvogëlimin e rrezikut nga përmbytjet dhe prishja e digave.*

Siguria ushqimore

Siguria Ushqimore ka të bëjë me kontributin në mbrojtjen e shëndetit të konsumatorit, shëndetit dhe mirëqenies së kafshëve dhe shëndetit të bimëve, duke aplikuar një qasje bashkëpunuese dhe integruese për forcimin e pajtueshmërisë dhe rregullimin e sektorit agro-ushqimor. Në arritjen e këtij vizioni, parashikohet që qeveria Shqiptare dhe organet përkatëse qeveritare të marrin pjesë aktive në procesin e përafrimit me acquis të BE-së në rrugën e tyre drejt anëtarësimit në BE dhe të angazhohen me organizmat ndërkombëtarë për të siguruar përafrim me rregullat e Organizatës Botërore të Tregtisë (OBT) për tregtinë ndërkombëtare.

Siguria ushqimore lidhet me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, sidomos me ato që lidhen me eliminimin e urisë dhe varfërisë, dhe me promovimin e shëndetit dhe mirëqenies. Siguria ushqimore është jetike për rritjen dhe shndërrimin e bujqësisë, që nevojitet për të ushqyer popullatën në mënyrë më të shëndetshme, për të mbështetur modernizimin e sistemeve kombëtare të ushqimit dhe integrimin efikas të vendit në tregjet

rajonale, ndërkombëtare, dhe të Bashkimit Evropian. Siguria ushqimore në industrinë agroushqimore është një tregues i rëndësishëm i zhvillimit të sektorit dhe aftësisë së tij për të konkurruar ndërkombëtarisht.

Nga këndvështrimi i kërkesës së konsumatorit për përmirësimin e ushqimit dhe shëndetit, prodhimi i ushqimit të sigurt, me vlera ushqyese dhe të qëndrueshëm, reduktimi i mbetjeve ushqimore dhe mirëqenia e përmirësuar e kafshëve janë të nevojshme për të zbatuar standardet dhe objektivat e përcaktuara në Strategjinë e BE-së nga ferma në tavolinë në lidhje me reduktimin e mbetjeve të azotit dhe të pesticideve dhe përdorimin e substancave antimikrobike në sektorin agroushqimor.

Programet e mirëqenies së kafshëve janë pjesë e programeve vjetore të kontrollit të shëndetit dhe të mirëqenies së kafshëve. Njëkohësisht, ato janë pjesë e kontrolleve nga drejtoritë rajonale të veterinarisë dhe mbrojtjes së bimëve, në përbërje të Autoritetit Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve. Në vitin 2019, u zbatua një përditësim dhe regjistrim gjithëpërfshirës i Regjistrit të Kafshëve (sistemi RUDA). Numri i kafshëve u verifikua dhe u regjistrua në mbarë vendin me një inspektim kapilar "derë më derë" gjatë vitit 2020 për çdo fermë të vetme.

Që prej prillit të vitit 2022, të dhënat në ferma (libri i fermerit) për llojin dhe sasinë e pesticideve të aplikuara në parcela do të regjistrohen nga ana e fermerëve dhe do të kontrollohen nga shërbimet e specializuara të kontrollit. Inputet bujqësore që aktualisht janë të regjistruara janë plehrat organike, PMB-të, ilaçet veterinare, produktet e bujqësisë organike dhe biocidet (preparatet e luftimit biologjik të sëmundjeve).

Objektivat strategjikë në fushën e sigurisë ushqimore

1. Forcimi i sigurisë ushqimore duke u fokusuar në nxitjen e teknologjive të reja, njohurive dhe mbështetjes së praktikave të qëndrueshme të prodhimit bujqësor;
2. Mbështetja e skemave të adoptimit bazuar në konceptin e BE 'nga ferma në tavolinë (*from farm to fork*)';
3. Përgatitja e kuadrit ligjor që rregullon kontrollet në lidhje me sigurinë ushqimore, shëndetin e kafshëve dhe të bimëve në të njëjtën linjë me parashtrimet e kuadrit ligjor të BE-së, në kuadrin e një politike kombëtare të konsoliduar;
4. Rritja e Efektivitetit të Sistemit të Kontrollit Agro-Ushqimor;
5. Fuqizimi i Konsumatorit për të marrë vendime të informuara;
6. Përfundimi i reformës për ristrukturimin e shërbimit veterinar, për ta bërë këtë shërbim plotësisht operacional;
7. Ngritja e kapaciteteve efektive për mbikëqyrjen dhe kontrollin e sëmundjeve kryesore infektive.

Ekonomia blu

Sektori i detarisë është duke u rritur me shpejtësi vitet e fundit duke qenë burim me potencial të rëndësishëm për zhvillim ekonomik dhe bashkëpunim ndërkombëtar. Shqipëria ka një vijë bregdetare 427 km të gjatë me 273 km bregdet në perëndim në detin Adriatik dhe 154 km bregdet në jugperëndim në detin Jon. Për shkak të kufizimeve infrastrukturore dhe zhvillimit të sektorit, Shqipëria ka vetëm një peshë të vogël në transportin detar ndërkombëtar.

Sektori i peshkimit duke dhënë një kontribut relativisht të ulët në ekonominë shqiptare, për sa i përket kontributit në PBB dhe punësim në përgjithësi, është i rëndësishëm nga pikëpamja socio-ekonomike në komunitetet bregdetare dhe në ujërat e brendshme ku ofron punësim në ato zona me mundësi të kufizuara

punësimi dhe kosto të ulët të punës. Në Shqipëri janë rreth 630 anije peshkimi të licencuara dhe flota operon kryesisht në detin Adriatik. Mosha mesatare e flotës vlerësohet në 39 vite, e cila është e lartë në krahasim me mesataren e BE-së prej 21 vjetësh.

Shqipëria është ndër vendet e pakta në Mesdhe që i mungojnë tregjet moderne të shitjes me shumicë të prodhimit të peshkimit. Tregjet e ankandeve konsiderohen si një mënyrë efektive për peshkatarët për të marrë një çmim të drejtë për punën e tyre. Forcimi i rolit të organizatave prodhuese të peshkimit mbetet i nevojshëm, në mënyrë që ato të mund të luajnë më shumë një rol në të gjithë zinxhirin e produkteve të anëtarëve të tyre nga zënia deri në tregtim dhe të ndihmojnë në orientimin e aktivitetit drejt peshkimit të qëndrueshëm dhe të tregjeve të peshkimit drejt ankandeve elektronike.

Sfidat

Planifikimi hapësinor

Rritja e konkurrencës për hapësirën detare midis sektorëve të ekonomisë blu ka nxjerrë në pah nevojën për të menaxhuar ujërat në mënyrë më koherente. Prandaj, planifikimi hapësinor detar është bërë një instrument kyç i politikës së integruar detare. Kjo është një mundësi e mirë për zhvillimin në zonat bregdetare, pasi proceset e planifikimit mund të tregojnë zona të reja ku mund të zhvillohen më tej sektorët e ekonomisë blu.

Gjendja mjedisore dhe zonat e mbrojtura

Aktivitetet ekonomike në det dhe në tokë po dëmtojnë ekuilibrin e cenueshëm të mjedisit detar deri në pragun e mundësive të ekosistemit. Dëmet e shkaktuara nga ndotja, si derdhjet e naftës dhe mbeturinat detare, veçanërisht plastika, si dhe peshkimi i tepërt, kanë edhe pasoja të rënda ekonomike në turizëm dhe peshkim. Një problem i evidentuar në Shqipëri është mungesa e ndërgjegjësimit mjedisor për ndikimin negativ të praktikave të ndryshme të peshkimit. Çështje të tilla si kapja e peshkut më të vogël se madhësia e lejuar, periudhat e ndalimit të peshkimit, peshkimi i specieve të ndaluara, dëmtimet e ekosistemeve që shkaktohen nga peshkimi i paligjshëm, përdorimi i mjeteve jo selektive etj., nuk respektohen si duhet nga komuniteti i peshkatarëve dhe popullsia në përgjithësi.

Mbikëqyrja dhe siguria detare

Zhvillimi blu ka nevojë për një mjedis të sigurt. Mbikëqyrja e integruar detare synon të sigurojë në aspekte të ndryshme të mbikëqyrjes, p.sh. kontrollin kufitar, sigurinë dhe sigurinë, inspektimin dhe kontrollin e peshkimit, doganat, mjedisin ose mbrojtjen, mënyra për të shkëmbyer informacione dhe të dhëna. Në Shqipëri ekziston një sistem mbikëqyrjeje që operohet nga Qendra Operative Detare Nderinstitucionale, institucion që siguron mbikëqyrjen e hapësirës detare shqiptare, integrimin e hapësirës detare shqiptare, për të realizuar organizimin, planizimin, bashkërendimin dhe drejtimin e operacioneve në det, në përputhje me legjistlacionin detar kombëtar dhe ndërkombëtar. Sistemi i mbikëqyrjes ka luajtur një rol të rëndësishëm në monitorimin e të gjithë hapësirës detare shqiptare, duke kontribuar kështu në det më të sigurt dhe më të pastër si dhe parandalimin e humbjeve të jetëve dhe luftimin e trafikimit të paligjshëm.

Vizioni

Qëllimi i përgjithshëm është zhvillimi dhe shndërrimi i ekonomisë detare të Shqipërisë në një kontribues kryesor të rritjes së qëndrueshme duke rikthyer traditën e lundrimit dhe mbështetur zhvillimin e turizmit detar, peshkimit, sportiv dhe argëtues me mekanizma dhe mjete të pajtueshme me mjedisin në të gjithë bregdetin. Kjo

do të arrihet duke e shndërruar të gjithë bregdetin shqiptar, duke përfshirë territoret, rajonet dhe industritë e lidhura me të, në një motor zhvillimi ekonomik rajonal të vendit.

Qëllimet e politikës për sektorin:

- Krijimi i Kornizës Rregullatore dhe Forcimi i Kapaciteteve. Zhvillimi i ekonomisë blu në vend mund të kryhet vetëm përmes një qasjeje efikase të integruar e cila kërkon një koordinim të posaçëm ndërsektorial midis të gjithë aktorëve të përfshirë në këtë proces. Ky komponent përfshin gjithashtu ndryshimin e ligjeve dhe rregullave procedurale të zbatueshme për sektorët e krijuar të ekonomisë blu për të rritur shkallen e ndërveprimit midis institucioneve, që përfshijnë 'burimet e jetesës detare' (peshkimin, akuakulturën dhe përpunimin dhe shpërndarjen e peshkut), 'turizmin bregdetar', 'transportin detar, aktivitetet portuale, ndërtimin dhe riparimin e anijeve ';
- Zhvillimi i ekonomisë blu do të realizohet nëpërmjet ruajtjes së bregdetit, biodiversitetit dhe vlerave të tjera të veçanta të Shqipërisë që do të marrin jetë nga investimet e qëndrueshme në këtë sektor, vendimmarrja për të cilat do të jetë e mirëinformuar ndaj pasojave të mundshme prej ndryshimeve klimatike;
- Përmirësimi i Infrastrukturës dhe Shërbimeve Publike. Ky komponent kërkon masa mbështetëse për të përmirësuar infrastrukturën ekzistuese, veçanërisht duke pasur parasysh vijën bregdetare në dispozicion. Faza e parë duhet të fokusohet në zhvillimin e marinave në bregdetin e vendit si një shtysë premtuese për rritjen ekonomike;
- Aktivitetet e Marketingut. Ky komponent synon të krijojë një pozicionim të bregdetit shqiptar si një qendër e re turistike marinash, si dhe një qendër lidhëse në rajon dhe më gjerë;
- Financimi i Mikrokredive dhe Granteve. Ekonomia detare ndër të tjera do të synojë të nxisë zhvillimin e ekuilibruar territorial në zonat bregdetare të Shqipërisë. Nga ana tjetër, në këto zona funksionojnë shumë ndërmarrje të vogla dhe të mesme të cilat, përmes mbështetjes financiare, synojnë të stimulojnë krijimin e produkteve të larmishme turistike, mundësi për zhvillimin e biznesit lokal dhe të rrisin mundësitë për përdorimin e produkteve bujqësore vendase.

Zhvillimi i turizmit

Përtej vështirësive që iu imponuan sektorit të turizmit, pas situatës dramatike të tërmetit të Nëntorit të vitit 2019 dhe cikleve të njëpasnjëshme të pandemisë së Covid 19, që kulmuan përgjatë vitit 2020 me një rënie prej rreth 60 përqind të numrit të vizitorëve dhe turistëve, industria e turizmit po konsolidohet me një ritëm të qëndrueshëm, si një nga sektorët prioritarë të zhvillimit ekonomik të vendit. Bazuar në të dhënat e publikuara nga INSTAT, viti 2021 mund të konsiderohet si viti i rikthimit gradual në normalitet, duke regjistruar rreth 5,7 milionë turistë të huaj që vizituan Shqipërinë, ose rreth 90 përqind e numrit të vizitorëve të shënuar në vitin 2019.

Bazuar në raportin e "Impaktit ekonomik të udhëtimeve dhe turizmit"[22] të vitit 2022, të Këshillit Botëror të Udhëtimit dhe Turizmit (WTTC), përgjatë vitit 2021, sektori i turizmit regjistroi një kontribut total në ekonomi prej 3,1 miliard USD, që përbën rreth 17.4 përqind të PBB-së[23]. Gjithashtu, kjo industri, e mirënjohur si

[22] https://wttc.org/DesktopModules/MVC/FactSheets/pdf/704/28_20220613152800_Albania2022_.pdf
[23] https://www3.weforum.org/docs/WEF_Travel_Tourism_Development_2021.pdf

punësuese intensive, siguroi punësimin në gjithë zinxhirin e vlerës së turizmit të rreth 226 mijë punonjësve, duke zënë rreth 20 përqind të numrit të të punësuarve. Përgjatë po të njëjtit vit, të ardhurat e siguruara nga "Turizmi hyrës" i jorezidentëve, arritën në nivelin e 2,4 miliard USD, të cilat përbëjnë rreth 83 përqind të eksporteve Shqiptare dhe në të njëjtën kohë luajtën një rol të rëndësishëm në bilancin e pagesave.

Sa i takon investimeve në turizëm, ato arritën përgjatë vitit 2021 në nivelin e rreth 210 milion USD dhe përbënë rreth 7.5 përqind të të gjitha investimeve në vend. Sipërmarrjet e akomodimit dhe të shërbimeve në funksion të turizmit në vitin 2021 sipas Regjistrit të Biznesit[24] të INSTAT, numëronin rreth 19,000 njësi, Sektori i shërbimeve të akomodimit dhe ushqimit përbën rreth 17.5 përqind të gjithë sektorit të shërbimeve si dhe 10.6 përqind të të gjitha aktiviteteve në Shqipëri.

Evropa është burimi kryesor i turistëve që vizitojnë Shqipërinë, duke zënë një volum prej rreth 91 përqind të të gjithë turistëve. Megjithatë së fundmi turistë nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kina apo vende të tjera të Azisë dhe Lindjes së Mesme, kanë shënuar një interes domethënës rritës, duke inkurajuar kështu indirekt zhvillimin e segmenteve të turizmit, sidomos turizmin historik dhe atë kulturor.

Si rrjedhojë e fokusimit në zhvillimin e turizmit bregdetar, industria përballet me pasojat sezonalitetit të lartë që ky segmenti turizmit shfaq duke reflektuar pasoja zinxhir në të gjithë industrinë që lidhet me punësimin e përkohshëm, cilësinë e ulët të shërbimeve, ndotjen e ambientit nga mbetjet, zhurmat, ofrimin e pamjaftueshëm të shërbimeve publike që lidhen me furnizimin me energji, furnizimin me ujë, mbledhjen dhe administrimin e mbetjeve etj. E kufizuar në pushimet pasive të detit dhe diellit, në destinacionet bregdetare të turizmit masiv si Velipoja, Shëngjini, Durrësi, Vlora, Himara, Saranda, Ksamili, kryesisht e bazuar në struktura familjare, turizmi bregdetar është larg potencialit që përmban.

Zhvillimi i turizmit natyror dhe rural, ka shënuar progres, duke krijuar disa rajone të mirënjohura tashmë për nënsegmentet e turizmit natyror si Alpet e Shqipërisë, zona e Theth-Valbonës për zhvillimin e ngjitjeve alpinistike, ecjes në natyrë, lumenjtë Vjosa dhe Osum në zhvillimin e rafting, lundrimin me vela përgjatë bregdetit dhe liqeneve, etj. Një burim i rëndësishëm i ofertës turistike po bëhen territoret e zonave të mbrojtura natyrore të cilat zënë rreth 21 përqind të sipërfaqes së përgjithshme të territorit të vendit. Vitet e fundit këto zona po tërheqin gjithnjë e më shumë vizitorë, vendas apo të huaj, duke arritur në mbi 4 milionë në vitin 2021.

Sfidat

Pavarësisht ecurisë pozitive, sektori i turizmit në vend vazhdon të përballet me sfida që pengojnë zhvillimin e mëtejshëm të tij.

Sezonaliteti i lartë, me vizitat më të mëdha në muajt korrik dhe gusht, i shoqëruar me përqendrimin në destinacione të veçanta të vijës bregdetare.

Mjedisi urban jo miqësor, pavarësisht programit intensiv të "Rilindjes Urbane", degradimi mjedisor, shpesh herë për shkak të zhvillimit kaotik hapësinor, aksesi dhe lidhja e papërshtatshme me objektet relevante të trashëgimisë kulturore, natyrore, të besimit, krijojnë një ngërç për të nxitur një eksperiencë pozitive tek turistët.

Aksesi dhe infrastruktura hyrëse e kufizuar në vend, nuk janë në koherencë me nevojën për zhvillimin intensiv të këtij sektori, duke u kthyer shpesh herë në frenues të zhvillimit të tij. Pikat hyrëse dhe dalëse tokësore, korridoret rrugore që të çojnë në destinacionet kryesore, portet tregtare dhe portet turistike, aeroportet dhe heliodromet, hekurudhat, digjitalizimi i transportit urban dhe shtrirja e shërbimeve të tilla nga qendrat urbane

[24] http://www.instat.gov.al/media/10101/tab2.xlsx

në destinacionet turistike stacionet multimodale të transportit ndërkombëtar dhe ndërqytetëse, sinjalistika dhe në tërësi informacioni turistik, mbeten sfida të mëdha.

Planifikimi i shërbimeve publike që lidhen me sigurinë fizike, ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit, furnizimin me ujë, furnizimin me energji, administrimin e mbetjeve, infrastrukturën dhe shërbimet në zonat historike, arkeologjike dhe muzeale, mund të adresojë nevojat e shtuara për shkak të ngopjes së destinacioneve të njohura, si dhe të minimizojnë efektet negative përkundrejt cilësisë së jetës së banorëve dhe vizitorëve.

Depërtimi i ulët dhe përdorimi i pamjaftueshëm i teknologjive digjitale, kanë tkurrur mundësinë e sektorit për të eksploruar tregje të reja, për të lehtësuar një sërë shërbimesh dhe për të sjellë produkte innovative.

Mungesa e një strukture për sigurimin e menaxhimit efektiv të turizmit duke nisur nga njësitë më të vogla të interesit, në nivel Bashkie, nivel rajonal dhe nivel kombëtar, me përfshirjen dhe bashkëpunimin publik-privat.

Mungesa e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve të përfshirë në industrinë e turizmit dhe më së pari ndërmjet aktorëve të sektorit privat, etj.

Vizioni: "*Shqipëria si destinacion turizmi tërheqës, dinamik dhe produktiv përgjatë gjithë vitit*"

Qëllimet e politikës për sektorin:

1. Mbështetjen e sektorit privat dhe investimeve në turizëm të qëndrueshëm në të gjithë zinxhirin e vlerës që krijohet brenda vendit sipas standardeve më të mira ndërkombëtare;
2. Ngritjen e një sistemi kombëtar të edukimit turistik me kurrikula profesionale bashkëkohore;
3. Nxitjen dhe zhvillimin e rrjeteve digjitale dhe shërbimeve që burojnë prej tyre, duke bashkërenduar me sektorin privat të turizmit, ofruesit e teknologjive dhe inovatorët;
4. Zbatimin e investimeve që i kthejnë zonat e mbrojtura në parqe natyrore, me infrastrukturë të përshtatshme për vizitueshmërinë e tyre ku krijohet ekonomi e qëndrueshme;
5. Zhvillimin e shërbimeve që lidhen me aktivtetet e turizmit detar dhe nxitjen e zhvillimit të festave dhe eventeve në destinacione;
6. Nxitjen e përgatitjes dhe miratimit të planeve të zhvillimit të territorit, mbështetjen projekteve për rigjenerimin e territoreve urbane, zbatimin e investimeve që përmirësojnë infrastrukturën lidhëse nga qendrat urbane apo rurale në drejtim të zonave me interes për t'u vizituar;
7. Buxhetimin e burimeve të nevojshme, për përmbushjen e sigurisë fizike, ruajtjen dhe mbrojtjen e shëndetit, furnizimin me ujë, furnizimin me energji, administrimin e mbetjeve.

Me synimin për të arritur objektivin prej 10 milion turistë në vitin 2030, Shqipëria synon ta kthejë sektorin në një kontributor të zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe mirëqenies sociale, duke zënë rreth 24 përqind të prodhimit të përgjithshëm bruto në një vlerë prej rreth 5.5 miliard USD. Realizimi I këtij objektivi do të kërkojë një ndryshim rrënjësor të ofertës turistike shqiptare, duke synuar ofrimin e produkteve me vlerë të shtuar, zgjatjen e kohëqëndrimit të turistëve, shërbime plotësuese të produktit kryesor dhe diversifikim të produkteve duke synuar ato jo tradicionalë.

Ekonomia dhe shoqëria digjitale

Shqipëria është në një pikë kthese të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore për shkak të një sërë sfidash transformuese të udhëhequra nga tranzicioni digjital. Teknologjitë digjitale po bëhen më thelbësore në jetën e përditshme, të nxitura veçanërisht nga pandemia COVID-19, e cila tregoi fuqinë e teknologjive digjitale për të na ndihmuar për t'iu përgjigjur sfidave tronditëse. Shqipëria do të shfrytëzojë fuqinë e digjitalit për të trajtuar sfidat e mëdha me të cilat përballemi në vitet e ardhshme – arritjen e objektivave tona ndaj ndryshimit të klimës, demografinë, nxitjen e gjithëpërfshirjes dhe rritjen e produktivitetit.

Synimi strategjik është të jemi një lider digjital në rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe në harmoni me prirjet digjitale globale duke promovuar agjendën digjitale në mënyrë efektive dhe koherente në të gjitha fushat e politikave të qeverisë dhe ofrimit të shërbimeve, duke punuar ngushtë me të gjithë aktorët pjesëmarrës në zhvillimin e vendit.

Përfshirja e një sërë parimesh dhe të drejtash digjitale është një element kyç i qasjes së agjendës së integrimit në BE, me fokus sipas shkallës në të cilën qytetarët mendojnë se digjitalizimi i shoqërisë po u shërben atyre. Teknologjitë digjitale mund ta bëjnë jetën e të gjithë qytetarëve tanë më të mirë përmes krijimit të mundësive të reja të punës dhe mënyrave të reja të punës; akses më i madh dhe më i barabartë në mundësitë personale, sociale dhe qytetare; dhe përmirësimin e shërbimeve publike qendrore dhe vendore të aksesueshme për të gjithë. Të gjitha grupet do të mbështeten dhe fuqizohen për të përfituar nga mundësitë digjitale duke përfshirë bizneset e vogla dhe të mëdha, komunitetet urbane dhe rurale, njerëzit të rinj dhe të moshuar për të kapërcyer hendekun digjital në sipërmarrje dhe shoqëri.

Drejtimi i tranzicionit digjital dhe teknologjive të lidhura me to, do të mbështesë gjithashtu arritjen e objektivave tona klimatike, me ambicien e gjelbër dhe digjitale që përforcojnë njëra-tjetrën. Ambicia jonë është e rrënjosur në përmirësimin e modelit ekonomik të vendit dhe ekosistemit të veçantë, fuqizimin dhe sigurimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse. Kjo do të thotë nxitje e një ndryshimi hapash në NVM-të; shfaqja e lidershipit duke avancuar ofrimin e shërbimeve publike digjitale dhe nëpërmjet rregullave të qarta; shtrirja e infrastrukturës dhe siguria; dhe mbështetjen e talenteve dhe aftësive në të gjitha nivelet në të gjithë popullsinë, të punësuarit dhe sipërmarrjet.

Transformimi Digjital i Biznesit

Do të ofrohet mbështetje për sipërmarrjet në të gjitha aspektet e transformimit të tyre digjital duke ndjekur një qasje koherente, të integruar dhe proaktive ndaj tranzicionit digjital, përmes një ekosistemi të fortë dhe mundësive të forta.

Shqipëria synon të jetë një vend mikpritës për gjigandët digjitalë botërorë. Është prioritet për qeverinë që të drejtojë ndryshimin drejt adoptimit digjital në të gjitha ndërmarrjet. Për të qenë i suksesshëm, transformimi digjital kërkon jo vetëm përdorimin e teknologjisë, por ndryshime në kulturë, udhëheqësi, aftësi profesionale dhe procese.

Përdorimi i teknologjive digjitale nuk është uniform në të gjithë sektorët. Në Shqipëri, industritë që kanë shumë punë intensive si ndërtimi, argëtimi, tregtia me pakicë dhe hoteleria, kanë prirje të renditen më nivele të ulëta në përdorimin e teknologjive digjitale. Për sektorë të tillë si ndërtimi, teknologjitë digjitale dhe integrimi i tyre mund të adresojnë sfidat që lidhen me mungesën e fuqisë punëtore, konkurrencën, efiçencën e burimeve dhe energjisë, cilësinë dhe produktivitetin duke rritur prodhimin e ndërtimit, veçanërisht në sektorin e banimit. Përpos ekzistencës së infrastrukturës së nevojshme që përfshin inkubatorët, përshpejtuesit, qendrat e

inovacionit etj., ka ende mjaft për të bërë në drejtim të kërkesave më të avancuara të bizneseve dhe sipërmarrësve që lidhen me certifikimin, të drejtat e pronësisë intelektuale, transferimit të teknologjisë etj.

Për të mbështetur angazhimin digjital në sektorin e manifakturës do të ofrohet qartësi në aksesin e teknologjisë së duhur dhe ekspertizës kërkimore, shërbimeve këshillimore dhe mbështetjes financiare. Për sektorin e shërbimeve financiare, mjete të tilla si *blockchain*, Inteligjenca Artificiale dhe *Big Data* do të transformojnë mënyrën në të cilën veprojnë aktualisht shumë brenda sektorit. Pandemia ka qenë katalizatori për shumë konsumatorë dhe kompani për të përqafuar financat digjitale (*fintech*). E gjithë strategjia për *fintech* do të ndihmojë sipërmarrjet shqiptare të përfitojnë nga këto mundësi dhe të zhvillojnë njohuri për klientët për të promovuar përfshirjen financiare.

Në bujqësi, teknologjitë digjitale, duke përfshirë dronët me Inteligjencën Artificiale, tashmë janë duke u përdorur për të përmirësuar efikasitetin, produktet dhe zbutur efektet e ndryshimeve klimatike. Bujqësia digjitale do të gjenerojë një rendiment më të lartë për krerë dhe hektar përmes menaxhimit të tufës dhe të vjelave bazuar në të dhëna.

Infrastruktura digjitale

Ndërlidhja digjitale universale dhe me cilësi të lartë është jetike për arritjen e objektivave të qeverisë për zhvillim të balancuar dhe të qëndrueshëm rajonal. Kjo përfshin rritjen e mundësisë së punës në distancë, kontribuimin në rigjallërimin e qyteteve dhe fshatrave, ndihmën për të adresuar ndarjen digjitale për zonat rurale dhe reduktimin e emetimeve të karbonit.

Me përshpejtimin e përdorimit të digjitalit në të gjitha aspektet e jetës sonë, rëndësia e sigurisë kibernetike po rritet. Siguria kibernetike në sektorin publik dhe privat, dhe investimi në njerëz, produkte dhe procese janë thelbësore për të garantuar infrastrukturën, të dhënat dhe sistemet jetike digjitale. Do të ndërmerren hapa të duhur për të parandaluar dhe zbutur efektet e sulmet në banesa, në sipërmarrje dhe në shërbimet thelbësore dhe qeveria po rrit kapacitetin, ekspertizën dhe infrastrukturën e sigurisë kibernetike të vendit.

Të gjitha zonat e populluara të mbuluara nga 5G deri në vitin 2030. Ndërlidhje digjitale me të gjitha shkollat të lidhura deri në vitin 2025. Do të adresohen sfidat e energjisë dhe ekonomisë qarkulluese duke i dhënë përparësi kapacitetit, ekspertizës dhe infrastrukturës së ndërlidhjes dhe sigurisë kibernetike të vendit. Nxitja e ekosistemeve të nevojshme për të lehtësuar vendosjen e aplikacioneve dhe shërbimeve të *Smart City* në komunitetet urbane/periferike, qyteza dhe rurale, me përfitime pozitive, duke përfshirë emetimet neto zero.

Lehtësimi i zhvillimit të ndërlidhjes përgjatë korridoreve tona kryesore të transportit për të mbështetur shërbimet inteligjente të transportit. Administratat publike do të maksimizojnë përfitimet nga teknologjitë 5G përmes krijimit të infrastrukturës që u mundëson përdoruesve të përpunojnë të dhënat në vendndodhjen e duhur. Kjo do të kontribuojë ndjeshëm në sigurinë publike të vendit dhe përballjen me fatkeqësitë e ndryshme, duke ofruar gjithashtu njohuri praktike mbi përdorimin e këtyre zgjidhjeve për të gjithë sektorët.

Sfidat që lidhen me zhvillimin e infrastrukturës digjitale kanë të bëjnë me polarizimin e këtij zhvillimi drejt zonave urbane duke lënë më në hije zonat rurale ku dhe kosto e lidhjes në rrjet është më e lartë, zhvillimin në fazë ende embrionale të infrastrukturës 5G, nevoja e fuqizimit të sigurisë kibernetike si dhe fuqizimi i kapaciteteve që operojnë këto sisteme.

Aftësitë Digjitale

Që Shqipëria të jetë një lider ndërkombëtar në ekonominë digjitale, politika jonë e kompetencave profesionale do të fokusohet në plotësimin e nevojave për aftësi digjitale në të gjitha nivelet. Kjo përfshin:

- Aftësitë digjitale të Nivelit të Lartë: Sigurimi i një burimi të fortë talentesh dhe ekspertize për ekonominë nëpërmjet zhvillimit të aftësive digjitale të nivelit të lartë
- Aftësitë digjitale për tregun e punës: Mbështetja e niveleve të duhura të aftësive digjitale për fuqinë punëtore në tërësi
- Aftësitë digjitale për shoqërinë: Sigurimi i aftësive digjitale për popullatën e përgjithshme, për të mundësuar që të gjitha grupet të angazhohen plotësisht në shoqëri dhe të përfitojnë nga transformimi digjital.

Transformimi digjital i ekonomisë dhe shoqërisë evidenton rëndësinë e aftësive kolektive, njohurive dhe kualifikimeve të fuqisë punëtore për qëndrueshmërinë ekonomike dhe sociale të vendit. Do të ofrohet aftësi digjitale në të gjithë shoqërinë, për t'u mundësuar të gjitha grupeve të përfshihen me digjitalizimin. Rritja e përqindjes së të rriturve me aftësi digjitale bazë në 80 përqind deri në vitin 2030.

Sfidat për aftësitë digjitale lidhen kryesisht me nivelin e përgjithshëm të ulët të njohurive digjitale dhe pabarazive në përvetësimin e këtyre aftësive, mungesa në treg e punonjësve me aftësi të përparuara digjitale dhe hendekun që ekziston midis aftësive të përftuara nga sistemi arsimor dhe kërkesave të tregut të punës.

Digjitalizimi i Shërbimeve Publike

Qeveria është e përkushtuar për përshpejtimin e Qeverisjes Digjitale, duke lëvizur drejt një modeli shërbimi më të avancuar dhe të përqendruar tek përdoruesi. Shfrytëzimi dhe ndërtimi mbi rritjen e ndjeshme të ofrimit dhe përdorimit të shërbimeve digjitale gjatë pandemisë COVID-19 është i rëndësishëm në krijimin e një shërbimi publik digjital efiçent, të besueshëm dhe gjithëpërfshirës, pikë referimi në rajon. Përdorimi më i mirë i të dhënave është thelbësor për forcimin e marrëdhënieve midis qeverisë dhe njerëzve të cilëve u shërbejnë. Qeverisja e fortë e të dhënave dhe shfrytëzimi efektiv i të dhënave të mbajtura nga shërbimi publik për të ofruar akses më të mirë dhe më të sigurt në të dhëna dhe transparenca në përdorimin e tyre është thelbësore për përmirësimin e shërbimeve publike.

Qytetarët duan dhe presin që shërbimet e tyre publike të jenë po aq të personalizuara dhe të përgjegjshme sa shërbimet që marrin nga sektori privat. Pesë vitet e fundit kanë parë një hap të rëndësishëm përpara në ofrimin e shërbimeve të qeverisjes elektronike në Shqipëri, me një përdorim të qëndrueshëm të shërbimeve digjitale, i cili u rrit jashtëzakonisht gjatë pandemisë COVID-19.

Këto suksese ofrojnë një bazë të fortë për një model shërbimi më të avancuar dhe të përqendruar tek përdoruesi, me evolucionin nga *e-Government*, ku shërbimet dhe proceset ekzistuese manuale u kompjuterizuan, në qeverisjen digjitale, ku shërbimet ri-imagjinohen dhe zhvillohen bazuar në një kuptim më të madh të veprimeve të përdoruesve. Këto ambicie janë në përputhje me planet e BE-së për Dekadën Digjitale, e cila synon deri në vitin 2030 të ketë jetë demokratike dhe shërbime publike në internet në një format më të mirë në klasë, plotësisht të aksesueshëm, duke ofruar shërbime dhe mjete të lehta për t'u përdorur, efikase dhe të personalizuara, me standarde të larta sigurie dhe privatësie. BE-ja e sheh teknologjinë që mbështet përfundimisht sistemet inteligjente multi-modale të transportit, reagimet e shpejta emergjente ndaj aksidenteve, zgjidhjet më të synuara të menaxhimit të mbetjeve, menaxhimin e trafikut, planifikimin urban, zgjidhjet inteligjente të energjisë dhe ndriçimit, sistemet moderne dhe efikase të drejtësisë dhe, pa dyshim, qytetet dhe fshatrat inteligjente.

Është jetike të sigurohemi që grupet individuale të shoqërisë të mos mbeten mbrapa ndërsa ne përshpejtojmë shërbimet digjitale. Kjo kërkon një fokus në aftësitë bazë digjitale dhe infrastrukturën e shtrirë, si dhe prioritizimin e një qasjeje të fokusuar tek përdoruesit ndaj shërbimeve publike digjitale, duke përfshirë shërbimet digjitale të asistuara aty ku është e nevojshme dhe e përshtatshme.

Vitet e ardhshme do të kenë të bëjnë me ndërtimin mbi baza të forta dhe krijimin e një shërbimi të besueshëm, të drejtuar nga përdoruesit, intuitiv, gjithëpërfshirës dhe efikas të qeverisë digjitale në botë, në të cilin 100 përqind e shërbimeve të aplikueshme kryhen në internet. Parimet kryesore përmbajnë përfshirjen e të gjitha palëve të interesuara, duke përfshirë publikun, në krijimin e shërbimeve tona digjitale në mënyrë që ato të përmbushin nevojat gjithnjë e më të larmishme në shoqëri në mënyrë të sigurt dhe të përqendruar tek privatësia, dhe maksimizimin e ripërdorimit të të dhënave dhe zgjidhjeve kudo që të jetë e mundur.

Rritja e përdorimit të shërbimeve digjitale, në një mënyrë të përqendruar tek përdoruesit, do të lehtësojë gjithashtu lirimin e burimeve njerëzore për të mbështetur më mirë ata që mund të kenë vështirësi me teknologjinë dhe/ose mund të mos jenë në gjendje të angazhohen në mënyrë të pavarur në internet.

Energjia dhe burimet natyrore

Shqipëria ka miratuar Planin e parë të Veprimit për Klimën dhe Energjinë (NECP) për periudhën 2021-2030. Ky Plan bazohet në Strategjinë Kombëtare të Energjisë dhe NDC-në e miratuar në COP21. NECP për Shqipërinë lidh Politikat dhe Masat për arritjen e objektivave të klimës, në respekt të akteve për Strategjinë Kombëtare të Energjisë, plani i dytë dhe i tretë i veprimit për EE, Plani i Konsoliduar i Veprimit për Energjinë e Rinovueshme, Plani Kombëtar për Zbutjen i GES dhe Strategjinë për dekarbonizimin e sektorit të Transportit.

Në Kontekstin e politikave energjitike, sektori i energjisë është i plotësuar me legjislacionin për secilin nga pesë dimensionet e Unionit të Energjisë: (i) krijimi i një tregu të brendshëm mbështetës për energjinë e rinovueshme; (ii) sigurinë energjitike; (iii) efiçencën e energjisë, (iv) mbrojtjen e mjedisit, dhe (v) reduktimin e emetimeve të GES (gazeve me efekt serrë) dhe substancave që dëmtojnë shtresën e ozonit në atmosferë.

Për zbatimin e plotë të politikave energjitike dhe klimatike, legjislacioni dytësor për EE, përfshirë performancën energjitike në ndërtesa, është miratuar plotësisht gjatë vitit 2020 dhe legjislacioni dytësor për burimet e rinovueshme të energjisë është ende në proces ndryshimi për ta adoptuar me direktivat e reja të BE-së.

Në Kontekstin ekonomik, zhvillimi dhe zbatimi i politikave kombëtare të energjisë sipas NECP do të ndikojë ndjeshëm në rritjen ekonomike në sektorë të ndryshëm ekonomikë. Politikat dhe masat që lidhen me ndërtimin dhe rinovimin e ndërtesave si dhe ndërtimin e sistemeve fotovoltaike do të kontribuojnë në mënyrë thelbësore në krijimin e vendeve të gjelbra. Reduktimi i varësisë nga importet e energjisë jo vetëm që do të kontribuojë në përmirësimin e sigurisë të furnizimit me energji por edhe siguri makroekonomike dhe politike e vendit nëpërmjet uljes së defiçitit buxhetor të brendshëm.

Në Kontekstin mjedisor politikat energjitike të Shqipërisë ndjekin tre objektiva: (i) mbështetje për zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, (ii) rritja e sigurisë së furnizimit me energji, dhe (iii) mbrojtjen e mjedisit. Kështu Energjia e rinovueshme, veçanërisht e ndryshme nga ajo hidro, është një zgjidhje për uljen e varësisë strategjike nga importet e energjisë dhe zbutjen e ndikimit të ndryshimeve klimatike që rezulton në prodhimin sezonal nga hidrocentralet.

Në Kontekstin social, Rritja e punësimit kryesisht nëpërmjet investimeve në sektorin e energjisë dhe të ndërtimit ka sjellë rritjen e të ardhurave personale/familjare e më pas në rritjen e standardit të jetesës së

shoqërisë. Objektivat për Efiçencën e Energjisë synojnë uljen e konsumit të energjisë për njësi dhe në këtë mënyrë një kontribut në furnizimin me energji të përballueshme dhe uljen e varfërisë energjitike.

Shqipëria ka përparuar në drejtim të reformave dhe sidomos **për energjinë elektrike**. Procesi i ndarjes së operatorit të sistemit të shpërndarjes për energjinë elektrike ka përfunduar dhe ngritja e një tregu të organizuar ALPEX ka përparuar ndjeshëm por hapja e bursës "live" është vonuar për shkak të krizës energjitike. Kjo parashikohet të ndodhë në pjesën e parë të vitit 2023.

Lidhur me prodhimin e energjisë elektrike, Shqipëria është në një pozitë të shkëlqyer për Marrëveshjen e Gjelbër, me një sektor energjitik të bazuar plotësisht në hidrocentralet që prodhojnë energji të pastër. Ankandet për prodhimin e energjisë elektrike nga BRE-të vazhdojnë me sukses. Si të gjitha vendet e WB6, Shqipëria është e ndërlidhur mirë me fqinjët e saj përmes rrjetit 400kV. Shqipëria ka bërë progres hapjen e plotë të tregut balancues. Ndarja e OSHEE është përfunduar dhe ligjërisht janë integruar në OSHEE Group-it tre shoqëri të licencuara përkatësisht si, Furnizues i Shërbimit Universal (FSHU), furnizues i tregut të lirë (FTL) dhe Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH).

Në **sektorin e gazit**, Gazsjellësi Trans Adriatik (TAP) është bere funksional në fund të vitit 2020, por ende pa kërkesë konkrete për furnizimin e tregut të brendshëm. Shqipëria është një vend transit për TAP-in dhe shpreson të rrisë rolin e gazit për prodhimin e energjisë elektrike. Diskutimet për vënien në funksion të termocentralit të Vlorës me gaz natyror janë finalizuar dhe pritet që përmes një marrëveshjeje të vendoset në Vlorë një stacion i LNG së bashku me rijetëzimin e Tec Vlora për prodhim energjie elektrike nga gazi natyror. Investimet në infrastrukturën e gazit do të jenë të pajtueshme me angazhimin dhe kontributet e Shqipërisë në kuadër të Marrëveshjes së Parisit për ndryshimet klimatike.

Sektori i Naftës është i liberalizuar plotësisht. Detyrimi i mbajtjes së stokut i është caktuar industrisë së naftës (rafinerive të naftës dhe kompanive të shitjes me shumicë të naftës), të cilat kërkohet me ligj të mbajnë stoqe për të paktën 90 ditë shitje mesatare vjetore. Sistemi është në përputhje me Direktivën 2009/119/KE. Nga janari 2009, vetëm karburantet me benzinë dhe naftë që plotësojnë kërkesat e standardeve Evropiane lejohen të vendosen në treg.

Prodhimi minerar në Shqipëri është tërësisht aktivitet i sektorit privat, i cili mbështetet kryesisht në prodhimin e mineraleve bazë - kromi dhe bakri - të cilat nxirren 100 përqind për eksport. Vëmendje prioritare në të ardhmen do t'i kushtohet: (1) përdorimit të mineraleve në mënyrë të tillë që të sigurojnë qëndrueshmërinë e tyre si burim kombëtar për zhvillimin e degëve të tjera të ekonomisë; (2) përmirësimeve të efikasitetit dhe efiçencës së përdorimit të këtyre burimeve natyrore; dhe (3) rritjes së shkallës së përpunimit në vend me qëllim produktet finale që sigurojnë më shumë të ardhura dhe ulin varësinë nga importet, duke ndihmuar në zhvillimin e aktivitetit me vlerë të lartë të shtuar në vend dhe zvogëlimit të ndotjes së ambientit, trafikut dhe rëndimit të infrastrukturës si pasojë e transportit të mineraleve të papërpunuara drejt portit apo pikave tokësore kufitare.

Pesha e **burimeve të energjisë së rinovueshme** në konsumin e energjisë në Shqipëri arriti në 39,3 përqind në vitin 2021. Janë instaluar 2400MW impiante me burime të rinovueshme për prodhimin e energjisë elektrike. Ligji për burimet e rinovueshme përcakton skemat mbështetëse në formën e tarifave nxitëse (FiT) të vendosura në mënyrë administrative dhe kontratave për diferencë (CfD). Të gjithë prodhuesit e burimeve të rinovueshme u bënë përgjegjës bilancimi në prill 2021. Po kështu gjatë 2022, prodhuesit nën skemën e mbështetjes kanë marrë përgjegjësinë e balancimit përmes adoptimit të akteve nënligjore. Shqipëria ka realizuar me sukses dy ankande fotovoltaike me kapacitet total 240 MW. Ndërsa në qershor 2021, u shpall një ankand i erës 100 MW. Ofertuesit

mund të konkurrojnë me projekte ndërmjet 10 MW dhe 75 MW dhe fitueseve do t'u jepet një marrëveshje 15-vjeçare e blerjes së energjisë. Ankandi pritet të finalizohet në gjysmën e dytë të vitit 2023.

Objektivat dhe masat e politikave për efiçencën e energjisë. Ndryshimet në Ligjin për Efiçencën e Energjisë të miratuar në Mars 2021 transpozuan Direktivën 2012/27/BE. Objektivat e efiçencës së energjisë për vitin 2030, si dhe objektivat e rinovimit për ndërtesat publike janë përcaktuar si pjesë e NECP. Falë zbatimit të direktivave të BE, Shqipëria do të përfitojë nga zbatimi i teknologjive dhe praktikave të përparuara në ndërtim dhe mundësive të tjera për zhvillimin e biznesit të gjelbër, si pjesë e angazhimeve në kuadër të marrëveshjes së gjelbër të BE dhe Ballkanit Perëndimor.

Performanca e energjisë në ndërtesa është zhvilluar mjaft mirë në Shqipëri. Janë miratuar aktet nënligjore për Performancën Energjitike të Ndërtesave, duke përfshirë metodologjinë për llogaritjen dhe përcaktimin e kërkesave minimale të performancës energjitike dhe certifikimin e ndërtesave. Ndryshimet në Ligjin për Efiçencën e Energjisë nxisin zhvillimin e tregut ESCO-ve, me një rol të fortë lehtësues nga Agjencia e Efiçencës së Energjisë. Gjithsesi Shqipëria është fokusuar në implementimin në kohë të Planit Kombëtar të Energjisë dhe Klimës (NECP), i cili është i rëndësishëm projektet dhe zbatimin e masave efikase për energjinë me qëllim aritjen e objektivave të EE deri në vitin 2030.

VIZIONI: *Zhvillimi i burimeve kombëtare të energjisë i aftë për të përmbushur kërkesën vendase për energji që funksionon në një sistem rajonal të integruar dhe të diversifikuar të energjisë bazuar në parimet e tregut, dhe kontribuon për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë, duke garantuar sigurinë dhe cilësinë e furnizimit, mbrojtjen e mjedisit dhe veprimet klimatike, dhe rritjen e mirëqenies me kosto sociale minimale*.

PRIORITETET STRATEGJIKE

Politikat e energjisë lidhen me statusin e përafrimit të legjislacionit të sektorit të energjisë me *acquis* e BE-së me qëllimin që objektivat strategjike të Shqipërisë për të hyrë në BE të harmonizohen me legjislacionin e saj për të krijuar përgjegjësi të qarta dhe transparente për zbatimin e tyre. Objektivat strategjike të Planit Kombëtar të Veprimit për Klimën dhe Energjinë që përfshin Strategjinë Kombëtare të Energjisë (SKE) dhe Kontributin e Përcaktuar Kombëtar (KKK). SKE ka vendosur një objektiv prej 42 përqind në TPES për BRE-të në 2030 dhe 15 përqind reduktim të përdorimit të energjisë përmes masave për EE.

Në mënyrë të përmbledhur ato përmbajnë kryesisht masa në zbatim të politikave për objektivat strategjikë të cilat janë:

Dekarbonizimi, Emetimet dhe largimet e GES:

Për sa i përket emetimeve të GHG, skenari i realizimit të masave të parashikuara në NECP çon në emetime totale prej 12,6 Mt CO2eq në vitin 2030, ndërsa skenari pasiv në 10,2 Mt CO2eq, që korrespondon me një reduktim prej 18.7 përqind të GES. Krahasuar me vitin bazë 2018, WAM (With Active Measures) sjell një reduktim të emetimeve me 6.1 përqind në vitin 2030, me një rritje paraprake të emetimeve para vitit 2030, duke arritur vlera pak mbi 2018 në 2040 (plus 4.0 përqind). Synohet që reduktimi i emetimit të CO2 (NDC), krahasuar me 0 përqind në 2020, të arrijë në 5.75 përqind në vitin 2025 dhe 11.5 përqind në vitin 2030.

Rreth 80 përqind e reduktimit kombëtar të emetimeve të GS do të arrihet në sektorët e Energjisë (me fokus të veçantë në Transport), Bujqësi dhe Ndryshimi i Përdorimit të Tokës dhe Pylltarisë (LUCF).

Në këtë kuadër, institucionet do të ndërmarrin masat e duhura për ngritjen dhe funksionimin e bazës ligjore dhe infrastrukturës së nevojshme për zhvillimin e tregut të automjeteve elektrike në vend mbështetur në studim të plotë të këtij tregu me potencial zhvillimi për të ardhmen.

Energjia e rinovueshme: Synimet e bazuara në pjesën analitike të NECP-së të burimeve të rinovueshme në konsumin final të energjisë përcaktohen sipas Direktivës 2009/28/EC (RED; BE (2009). Në terma të përgjithshëm, masat shtesë rrisin peshën e burimeve të rinovueshme në energjinë përfundimtare nga 33.5 përqind (skenari WEM) në vitin 2030 në 54.4 përqind (skenari WAM).

Pjesëmarrja e BRE në kërkesën për energji finale [Përqindje] siç është parashikuar me masa shtesë për vitin 2030.

BRE- Energjia Elektrike: 178,1 përqind[25]

BRE-Transport: 34,6 përqind

BRE-Ngrohje dhe Ftohje: 16,6 përqind

Dimensioni i Efiçencës së Energjisë: (1) kontributi kombëtar tregues i efiçencës së energjisë për arritjen e objektivave të BE për efiçencën e energjisë prej të paktën 32,5 përqind në 2030 siç përmendet në Direktivën 2012/27/BE, bazuar në qoftë konsumi primar apo final i energjisë, kursimet e energjisë primare apo përfundimtare, apo intensiteti i energjisë.

Dimensioni i Sigurisë së Energjisë: Objektivi i sigurisë së energjisë është të sigurojë një furnizim të qëndrueshëm, të sigurt dhe cilësor të të gjitha sistemeve të prodhimit dhe furnizimit me energji. Siguria do të thotë që energjia duhet të jetë e disponueshme, e aksesueshme, e përballueshme dhe e pranueshme në raport me zhvillimin e vendit.

Objektivat kombëtare në lidhje me diversifikimin e burimeve: SKE parashikon stimulimin e diversifikimit të duhur të prodhimit të energjisë përmes investimeve të reja, rritjes së bashkëpunimit rajonal dhe integrimit dhe ndërlidhjes me rrjetet rajonale dhe Evropiane të energjisë elektrike dhe gazit natyror në përputhje me Acquis të Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

Integrimi i tregut shqiptar të energjisë elektrike me Kosovën do të rrisë gjithashtu diversifikimin e burimeve dhe furnizimit me energji elektrike. Lidhja e dy sistemeve, duke kombinuar gjenerimin do të përmirësonte sigurinë e furnizimit nëpërmjet përdorimit më efikas të kapaciteteve të linjave ekzistuese të interkonjeksionit dhe sinjaleve tarifore.

Furnizimi me gaz i termocentralit ekzistues në Vlorë dhe prodhimi prej tij i energjisë elektrike, si dhe ndërtimi i një terminali rigazifikimi në Vlorë,do të kontribuojë në rritjen e diversitetit të energjisë.

Objektivat e biokarburanteve prej 10 përqind si pjesë e biokarburanteve kundrejt konsumit total të karburantit në sektorin e transportit në vitin 2030 pritet gjithashtu të kenë një efekt në diversifikimin e burimeve të energjisë në sektorin e transportit.

[25] Vlerat mbi 100 përqind i detyrohen eksporteve të energjisë elektrike.

Objektivat kombëtare në lidhje me reduktimin e varësisë nga importi i energjisë: Objektivat kryesore janë: (i) për të reduktuar varësinë nga importi në lidhje me energjinë elektrike dhe, (ii) për të reduktuar varësinë nga importi për produktet e naftës.

Në Sektorin e energjisë elektrike: Zgjerimi i kapaciteteve të reja gjeneruese në të ardhmen: disa HEC-e të rinj të mëdhenj si Skavica në lumin Drin, kaskada e lumit Devolli, kaskada e lumit Fan, disa termocentrale të vegjël që janë në ndërtim e sipër, fotovoltaikë dhe eolikë të zhvilluar përmes ankandeve, si dhe zhvillimi i burimeve të rinovueshme pa masa mbështetëse do të kontribuojnë në uljen e varësisë nga importi i energjisë.

Në Sektorin e gazit: Krijimi dhe funksionimi i tregut të gazit dhe krijimi i një klime të favorshme investimi për investime në sistemin kombëtar të transmetimit dhe shpërndarjes së gazit dhe integrimi në rrjetet rajonale dhe ndërkombëtare do të kontribuojë në uljen e varësisë nga importi i energjisë. Furnizimi me LNG i termocentralit ekzistues në Vlorë dhe ndërtimi i një terminali rigazifikimi në Vlorë do të kontribuojë në uljen e sasisë së importit të energjisë dhe rritjen e diversitetit të energjisë.

Në Sektorin e naftës: Shqipëria është bërë shumë e varur nga produktet e importuara të naftës për shkak të një rënie të prodhimit të naftës në kombinim me një kërkesë në rritje të mprehtë për benzinë, naftë dhe naftë të rëndë. Sektori i transportit ishte konsumatori më i madh i energjisë, me rreth 40 përqind të konsumit total final (2013). Përveç faktit që Shqipëria vlerësohet si një nga vendet më të pasura të Evropës me rezerva hidrokarbure në tokë, shumë pak është bërë për rritjen e produktivitetit dhe përmirësimet teknologjike, të cilat për këtë arsye u integruan në NECP.

Objektivi për të zhvendosur transportin rrugor ekzistues në modalitete të tjera transporti, si transporti hekurudhor ose ujor, apo bazuar në transport elektrik, do të kontribuojë në uljen e konsumit të karburantit.

Dimensioni Tregut të brendshëm të energjisë: Objektivi i tregut të brendshëm të energjisë është të harmonizojë dhe liberalizojë tregun e brendshëm të energjisë në vend, të adresojë aksesin në treg, transparencën dhe rregullimin, mbrojtjen e konsumatorit, mbështetjen e ndërlidhjes dhe nivelet e duhura të furnizimit, si dhe vënien në funksionim të bursës së energjisë.

Ndërlidhja e energjisë elektrike: Integrimi në tregjet e energjisë rajonale dhe të BE-së është një objektiv strategjik i qeverisë Shqiptare për të përmbushur kërkesën e saj në rritje për energji, diversitetin e burimeve të energjisë, efiçencën dhe fleksibilitetin e sistemit kombëtar të energjisë.

Infrastruktura e transmetimit të energjisë

Energjia elektrike për infrastrukturën e transmetimit të energjisë elektrike janë këto objektiva:

- Arritja e reduktimit të humbjeve teknike në rrjetin e transmetimit të energjisë elektrike me 1.7 përqind në vitin 2030;
- Përmirësimi i besueshmërisë së sistemit të transmetimit dhe sigurisë së furnizimit me energji elektrike;
- Përmirësimi i besueshmërisë së rrjetit të komunikimit dhe sistemit të monitorimit dhe kontrollit në distancë për të rritur sigurinë e furnizimit me energji elektrike;
- Zhvillimi i rrjetit për t'iu përgjigjur rritjes së kërkesës për kapacitet transmetues nga konsumatori industrial dhe/ose prodhimi hidro;
- Integrimi i përshpejtuar i RES të ndryshueshme në sistemin energjitik dhe disponueshmëria e shtuar e rezervave rregullatore për të balancuar prodhimin e tyre;

- Rritja e kapacitetit transmetues të linjave individuale të planifikuara për rivitalizim dhe aplikimi i teknologjive të reja në transmetim.

Infrastruktura e ndërlidhjeve: transporti dhe telekomunikacioni

Zhvillimi dhe modernizimi i infrastrukturës së transportit ka qenë dhe mbetet një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare që ka synuar: i) krijimin e parakushteve për zhvillimin e sektorëve të tjerë të ekonomisë, sidomos turizmit, ii) rritjen e aksesit të mallrave dhe pasagjerëve në tregtinë dhe ofrimin e shërbimeve, në tregun rajonal dhe Evropian; iii) kontributin e ndjeshëm në rritjen dhe zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të vendit dhe iv) plotësimin e angazhimeve të Shqipërisë në kuadër të Traktatit të Komunitetit të Transportit midis vendeve të Evropës Juglindore dhe BE.

Shqipëria është mbështetëse e përkushtuar e 'Procesit të vendeve të Ballkanit Perëndimor[26]' dhe është e angazhuar plotësisht për të arritur qëllimet e lidhura veçanërisht me Agjendën e Ndërlidhjes/Konektivitetit, si edhe proceset integruese rajonale të lidhura me Tregun e Përbashkët Rajonal. Firmosja e Traktatit të Komunitetit për Transportin (TKT) nga 6 Kryeministrat e Ballkanit Perëndimor në Samitin e nivelit të lartë në Trieste në 12 Korrik 2017 përfaqëson arritjen më të madhe në bashkëpunimin rajonal për sektorin e Transportit. Marreveshja për TKT[27] dhe ajo për Zonën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit së bashku me anekset e tyre, përbëjnë një udhërrëfyes në procesin e sektorit të lidhur me integrimin në BE.

Investimet për sektorin e transportit për periudhën 2016-2020 janë në nivelin 915,98 milion Euro, ku nënsektori i transportit rrugor përbën edhe prioritetin kryesor në pikëpamje të investimeve me 96 përqind të shpenzimeve ose 883 milion Euro. Prioritet strategjik është përshpejtimi i integrimit të sistemit të transportit të vendit dhe krijimi i një tregu të integruar të përbërë nga infrastruktura e transportit në rrugë tokësore (rrugore dhe hekurudhore), me det dhe me rrugë ujore të brendshme, si dhe në transportin ajror, ku është zhvillimi i aeroporteve të reja me ndikim në ekonomi dhe aktivitetin turistik në veri dhe jug, si dhe konkurrencë mes Tiranës, Kukësit dhe një aeroporti "jugor" për më shumë transportues ajrorë për t'i shërbyer rajonit.

QËLLIMI STRATEGJIK: *Zhvillimi i infrastrukturës në mënyrë të qëndrueshme, inteligjente, si edhe të integruar me rrjetet Evropiane dhe rajonale, bazuar në shfrytëzimin e gjelbër të burimeve, si edhe duke siguruar nxitje të zhvillimit ekonomik dhe shërbime me cilësi për qytetarët.*

Për infrastrukturën dhe shërbimin e transportit: *Zhvillimi i sistemit kombëtar të transportit shqiptar mbi bazën e një lëvizshmërie më të sigurt, më inteligjente, më të gjelbër, elastike dhe konkurruese, të cilat sigurojnë një transport të qëndrueshëm, të ndërlidhur, ndërveprues dhe të integruar me rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë me sistemin Evropian të transportit*.

Prioritetet strategjike për sektorin e transportit për periudhën **2021-2030**:

- Sigurimi i një kuadri rregullator dhe ligjor, që nxit funksionimin optimal të sistemit të transportit, në mbështetje të zhvillimit të ekonomisë;
- Sigurimi i një qasje të barabartë në shërbimet e transportit në të gjithë territorin e vendit, që çon në balancë të përmirësuar të zhvillimit rajonal të vendit;
- Promovimi dhe përshpejtimi i integrimit i sistemit të transportit të Shqipërisë me Bashkimin Evropian dhe përmbushja e kërkesave të transportit në rajonin e Ballkanit Perëndimor;
- Përmirësimi i sigurisë, cilësisë dhe besueshmërisë së sistemit të transportit;

[26] Vendet e Ballkanit Perëndimor përfshijnë Shqipërinë, Bosnjë-Hercegovinën, Maqedoninë e Veriut, Malin e Zi, Serbinë dhe Kosovën
27 Ligji nr. 8/2018, datë 26.02.2018 "Për ratifikimin e Traktatit të Themelimit të Komunitetit të Transportit", është miratuar nga Kuvendi.

- Krijimi i një sistemi transporti të qëndrueshëm;
- Krijimi i një tregu të integruar, i përbërë nga infrastruktura e transportit nëpërmjet tokës (rrugëve dhe hekurudhave), ajrit, detit dhe ujrave të brendshme.

TRANSPORTI RRUGOR

Transporti rrugor mbetet një prioritet i qeverisë shqiptare, e cila ka në fokus të programit afatmesëm të saj *ndërtimin e një rrjeti efikas dhe efiçent të transportit rrugor të disponueshëm dhe të aksesushëm nga të gjithë qytetarët; të menaxhuar nga autoritete të besueshme, transparente, me performancën e duhur, dhe që siguron ndjeshëm mobilitetin, rritjen e cilësisë së jetës dhe rritjen ekonomike.*[28] Investimet në infrastrukturës së transportit rrugor janë përqendruar për ndërtimin e akseve rrugore të rëndësishme të Rrjetit Kryesor (*Core Network*), me një vlerë totale investimi prej 883,51 milion Euro[29].

Investime të rëndësishme janë kryer në lidhje me Korridorin Veri – Jug, si Bypass-et e Fierit dhe Vlorës, Kardhiq-Delvinë, bypass Plepa-Kavaje-Rrogozhina, Unaza e Tiranës – pjesa jug-perëndimore (në vazhdim); ndërtimi i by-pasit të Shkodrës; ndërtimi i by-pasit të Tepelenës. Është planifikuar ndërtimi i segmentit Fushë Krujë – Thumanë (dublimi) dhe Thumanë – Kashar / Vorë, si pjesë e Korridorit Adriatiko - Jonian. Është miratuar ndërkohë është përfunduar studimi i fizibilitetit të Korridorit Adriatiko-Jonian, 305 km, si një ndër projektet më prioritare të Qeverisë së Shqipërisë, financuar nga WBIF.

Investimet në rrugën e Kombit që lidhen me mirëmbajtjen apo rindërtimin e urës dhe tunelit Morinë – Kukës, ndërkohë që po punohet për ndërtimin e dublimit në segmentin Milot-Rrëshen. Investimet në Korridorin e 8-të ose Lindje-Perëndim, si segmenti Qukës - Qafë Plloçë, segmenti Qafë Thanë-Lin-Pogradec; rruga Tiranë - Elbasan; segmenti Elbasan-Banjë, të cilat kanë ndikuar në rritjen e shkëmbimeve tregtare dhe lëvizshmërisë së qytetarëve. Ndërkohë është planifikuar ndërtimi i bypassit të Elbasanit. Studimi i detajuar për ndërtimin e rrugës së Arbrit u përvijua me punimet konkrete për ndërtimin, një nga veprat më të mëdha infrastrukturore në vend, të cilat janë duke u përfunduar.

Në lidhje me legjislacionin, është vazhduar me përafrimin e mëtejshëm të legjislacionit shqiptar me acquis të BE dhe janë miratuar disa akte të rëndësishme nënligjore, lidhur me procesin e licencimit/autorizimit, trajnimin, etj, për ushtrimin e veprimtarive në transportin ndërkombëtar rrugor të udhëtarëve dhe mallrave, mallrave të rrezikshme, të drejtave të udhëtarëve, funksionimit të terminaleve të autobusëve, strategjia për sistemet inteligjente të transportit, etj. Transpozimi i *acquis* të BE-së është bërë në përputhje me angazhimet që rrjedhin nga nenet 54, 59, 70 dhe 106 të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit dhe Protokollit 5 të MSA-së për transportin.

Sfidat kryesore për sektorin e transportit rrugor

- Përfundimi i ndërtimit të rrjetit rrugor kombëtar, duke përfshirë linjat kryesore strategjike;
- Përfundimi i studimit të fizibilitetit për autostradën Adriatiko-Joniane, Veri-Jug (për të lehtësuar fillimin e punimeve në segmente të veçanta), duke përfshirë përfundimin e plotë të korridorit Milot-Morinë, Rrugën Arbrit si degë e Korridorit VIII, autostradën *Milot – Lezhë (Balldren); autostradën Milot – Thumanë – Kashar – Lekaj (Rrogozhinë) – Fier, Bypass-i i Gjirokastrës; Murriqan – Lezhë;*
- Përafrimi i legjislacionit kombëtar me atë të BE-së për transportin rrugor të mallrave dhe pasagjerëve;

[28] Programi i Qeverisë 2021-2025, fq 23
[29] Raporti i Monitorimit të Strategjisë Kombëtare të Transportit 2020, fq.46

- Reformimi i rrjetit të transportit rrugor të udhëtarëve ndërqytetas;
- Ndërtimi i infrastrukturës të nevojshme për zhvillimin e transportit elektrik;
- Ruajtja e infrastrukturës së transportit rrugor të Shqipërisë sipas standardeve të BE-së;
- Vëzhgimi i standardeve teknike duke përfshirë nevojën për të rritur sigurinë në rrugë.

QËLLIMI I POLITIKËS : *Zhvillimi i sistemit kombëtar të transportit mbi bazën e një lëvizshmërie më të sigurt, më inteligjente, më të gjelbër, elastike dhe konkurruese, të cilat sigurojnë një transport të qëndrueshëm, të ndërlidhur, ndërveprues dhe të integruar me rajonin e Ballkanit Perëndimor dhe më gjerë me sistemin Evropian të transportit.*

Ky qëllim i politikës përkon me procesin e integrimit në BE, sidomos në lidhje me përafrimin e legjislacionit dhe përmbushjen e standardeve përkatëse lidhur me procesin e negociatave, e më pas me anëtarësimin në BE. Gjithashtu, qëllimi i politikës lidhet me Agjendën 2030, sidomos në lidhje me sigurinë rrugore, e cila u përfshi shprehimisht si një çështje e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm, në objektivat 3.6 lidhur me numrin e vdekjeve dhe lëndimeve globale nga aksidentet në trafikun rrugor dhe 11.2, lidhur me shëndetin dhe qytetet.

TRANSPORTI HEKURUDHOR

Gjatë viteve të fundit ka vijuar procesi për transformimin e sektorit, duke krijuar parakushtet e nevojshme për të krijuar një treg të hapur për investitorët publikë dhe privatë qoftë në aspektin e rregullimit të tregut, menaxhimit të infrastrukturës apo operacioneve hekurudhore. Është miratuar Kodi Hekurudhor i Republikës së Shqipërisë[30], që synon ndarjen e operacioneve të trenave nga menaxhimi i infrastrukturës[31], si dhe krijimin e një Organi Rregullator Hekurudhor dhe një Autoriteti të Sigurisë, në bazë të parimit të ndarjes së administruesit të infrastrukturës dhe veprimtarive të transportuesve hekurudhore, si dhe zhvillimin dhe përmirësimin e sistemit të sigurisë hekurudhore.

Gjatë vitit 2020, janë miratuar akte të rëndësishme nënligjore që lidhen me ndarjen e shoqërisë Hekurudhore Shqiptare[32], krijimin e Autoritetit Rregullator të Hekurudhave; krijimin e Autoritetit të Sigurisë Hekurudhore; krijimin, organizimin dhe funksionimin e Autoritetit Kombëtar të Hetimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare[33]. Deklarata e Komisionit Evropian dhe takimet e Ministrave të Ballkanit Perëndimor, dakordësoi për rrjetin hekurudhor kryesor të transportit për Ballkanin Perëndimor zgjerimin e rrjetit trans-Evropian për rrjetin hekurudhor kryesor të Ballkanit Perëndimor rehabilitimin e ROUTE 2 Podgorice (Podgorica Mali i Zi – Durrës /Tirana Shqipëri).

Gjendja e transportit hekurudhor në Shqipëri ka vite që është në rënie. Hekurudhat Shqiptare (HSH), si menaxhuese e rrjetit për të gjithë vendin, kanë përgatitur një program investimi për një periudhë 8-10 vjeçare për të siguruar ndërveprim të plotë me rrjetin Evropian dhe për të rritur standardet e përgjithshme operacionale.

Ka nisur një riparim në shkallë të gjerë i rrjetit hekurudhor. Në fillim të vitit 2021 është nënshkruar kontrata për përmirësimin i hekurudhës që lidh kryeqytetin, Tiranën, me portin e Durrësit. Përveç kësaj, do të ndërtohet një

[30] Ligji nr. 142/2016, datë 22.12.2016

[31] Ligji përafron pjesërisht direktivat: Direktiva 2012/34 / EU e Parlamentit Evropian; Direktiva (EU) 2016/798 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Direktiva (EU) 2016/797 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Direktiva 2007/59 / EC / e Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Rregullorja (EU) 2016/976 e e Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Rregullorja (EC) 1370/2007 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit; Regulation (EC) 1371/2007 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit;

[32] VKM nr. 1011, datë 16.12.2020

[33] VKM nr. 1050, datë 16.12.2020

linjë e re hekurudhore prej 5 km që lidh qytetin e Tiranës me Aeroportin "Nënë Tereza" dhe po punohet për rehabilitimin e segmenteve Vorë-Hani i Hotit dhe Durrës-Rrogozhinë. Në lidhje me investimet për sektorin, janë synuar korridore hekurudhore tërheqëse dhe konkurruese për Portin e Durrësit në përputhje me Paketën e Projekteve Strategjike të Sektorit (PPSS-në për transportin).

Sfidat kryesore për transportin Hekurudhor

Sfidë kryesore vijon të mbetet **reformimi i sistemit hekurudhor,** që duhet të vazhdojë të thellohet për të krijuar një treg të hapur për investitorë të ndryshëm si në aspektin e menaxhimit infrastrukturor, edhe në funksionimin e hekurudhës. Sipas Raportit të Progresit të BE për 2021, Shqipëria duhet të sigurojë funksionimin e plotë të rrjetit hekurudhor dhe për këtë, nevojiten përpjekje të mëtejshme për të hartuar kuadrin strategjik për zbatimin e ITS-ve në rrjetin kryesor hekurudhor.

QËLLIMI I POLITIKËS: *Reformimi i sektorit hekurudhor për krijimin e mundësive reale të funksionimit të transportit hekurudhor për publikun, si edhe për krijimin e një tregu të hapur për investitorët publikë dhe privatë, duke e transformuar rrjetin hekurudhor shqiptar si një aktor funksional në korridoret e transportit të Evropës Jug-Lindore.*

TRANSPORTI DETAR

Në sektorin e transportit detar është punuar në disa drejtime, sic janë përmirësimi i kapaciteteve teknike të administratës detare dhe zhvillimi i legjislacionit detar për arritjen e standardeve të BE-së; modernizimi i infrastrukturës portuale nëpërmjet investimeve dhe rritja e funksioneve portuale për të rritur intermodalitetin e tyre, veçanërisht për ndërlidhjen portuale; si edhe aftësi më të mira të përpunimit të portit të kombinuara me një orientim në një sistem intermodal.

Procesi lidhur me përafrimin e legjislacionit dhe ratifikimin e rregulloreve të BE-së dhe të IMO-së ka pasur progres. Janë zhvilluar disa standarde rregullatore për të garantuar sigurinë, sigurinë dhe qëndrueshmërinë mjedisore të operacioneve detare dhe portuale. Autoriteti Kombëtar i Investigimit të Aksidenteve dhe Incidenteve Hekurudhore dhe Detare i ngritur me ligj, është një institucion i rëndësishëm që synon sigurinë detare, në funksion të parandalimit të aksidenteve e të incidenteve, në kuadër edhe të Traktatit të Komunitetit të Transportit.

Progres në sektorin e transportit detar tregon edhe rritja e trafikut të pasagjerëve përmes porteve duke shënuar një rritje prej 28.4 përqind (2018 kundrejt vitit 2015) ndërsa për të njëjtën periudhë ka rezultuar me një rritje të dërgesave me kontejnerë me 29.3 përqind[34]. Hapa janë hedhur edhe në krijimin dhe zbatimin e Sistemit Shqiptar të Monitorimit dhe Informacionit të Trafikut të Mjeteve Lundruese (VTMIS), i cili është një prioritet i përfshirë në listën e Paketës së Projekteve Strategjike për Sektorin e Transportit. Krijimi i Sistemit VTMIS do të ofrojë mbështetje për të gjithë trafikun detar të përfshirë në korridoret TEN-T dhe lehtëson procedurat e përpunimit të mallrave në portet detare, sigurinë e jetës në det, sigurinë e lundrimit, si dhe mbrojtjen e mjedisit detar.

Në Portin e Vlorës ka përfunduar zgjerimi i Terminalit të Pasagjerëve, rikonstruksioni i Terminalit të Pasagjerëve, si edhe është zbatuar projekti i rikonstruksionit të kalatave në vlerën 15.3 milionë Euro. Gjithashtu ka përfunduar rikonstruksioni i terminalit të pasagjerëve (kalatat 7 & 8) dhe sheshi i përpunimit pranë Autoritetit Portual të Durrësit. Në portin e Sarandës është përfunduar gërmimi i basenit portual dhe terminali RO-RO (për

[34] Raporti i Progresit të Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020

tragete transportuese mjetesh motorike), është rehabilituar dhe tashmë është i operueshëm. Kalata e lundrimit në portin e Sarandës është modernizuar dhe e pajisur me ambientet e nevojshme për ngarkimin dhe shkarkimin e turistëve.

Një objektiv me rëndësi konsiston në reformimin e strukturës institucionale të porteve të Vlorës, Shëngjinit dhe Sarandës, drejt strukturave portuale qiradhënëse, ku aktualisht është përfunduar dhe ka nisur zbatimi i reformës së plotë portuale. Për Portin e Vlorës dhe të Durrësit janë lidhur përkatësisht marrëveshje koncesionare për shndërrimin e tyre në marina turistike, ndërsa shërbimet portuale transferohen në Portin e Triportit të Vlorës dhe në portin e ri të Porto Romanos në Durrës.

Plani i Integruar Ndërsektorial për Bregdetin 2015–2030 thekson nevojën për të krijuar kushte për zhvillimin e infrastrukturës dhe transportit detar, të cilat do të jenë pjesë thelbësore për zhvillimin e ekonomisë dhe integrimin me zinxhirët e vlerave globale. Në kuadër të zhvillimit të infrastrukturës detare, si një potencial zhvillimi i ekonomisë blu, një nga prioritetet e Qeverisë në fushën e zhvillimit të infrastrukturës portuale është ndërtimi me partneritet publik privat i porteve të reja (turistike dhe tregtare). Në 4 vitet e fundit është kryer dhënia me koncesion BOT e kontratës së portit turistik në Spille, Kalaja e Turrës, Kavajë, Shëngjin ku kanë nisur punimet e ndërtimit, ndërsa porti në Porto Romano[35], pas punimeve të ndërtimit të fazës së pare, ky port është miratuar për t'u hapur për transport ndërkombëtar dhe është operativ. Edhe për portin në Triport të Vlorës është nënshkruar kontrata koncesionare për zhvillimin e një porti të ri modern dhe të integruar, për transport mallrash dhe peshkim.

Turizmi detar ka potencial për t'u zhvilluar dhe rritja e industrisë së jahteve në Evropë, ofron një mundësi për të maksimizuar pozicionin qendror të vendit tonë në detin Adriatik. Sigurimi i infrastrukturës së jahteve është një sfidë për tu adresuar, si në afat të shkurtër ashtu edhe në atë afatgjatë për të përmbushur objektivat e qeverisë në këtë sektor. Gjatë viteve të fundit, janë zhvilluar skema nxitëse për tërheqjen dhe promovimin e turizmit detar dhe lundrimit, që përmes përjashtimeve fiskale synon të nxisë krijimin e një flote detare shqiptare, si edhe zhvillimin e infrastrukturës detare[36].

Sfidat kryesore për Transportin Detar

- Modernizimi i infrastrukturës të porteve përmes investimeve;
- Forcimi i Administratës Detare në përputhje me standardet e BE-së;
- Një rritje e specializimit të funksioneve të porteve me qëllim rritjen e intermodalitetit të tyre, sidomos për lidhjen port-hekurudhë;
- Aftësi më të mira të përpunimit të portit të kombinuara me një orientim drejt një sistemi intermodal.

QËLLIMI I POLITIKËS : *Ridimensionimi i infrastrukturës portuale dhe transportit detar përmes zgjerimit të zonave portuale, komplementimit me zona të zhvillimit ekonomik, zhvillimit dhe specializimit të porteve ekzistuese sipas sektorëve ekonomikë primarë ku operojnë, si dhe përmes shtimit të strukturave të specializuara për akomodimin dhe ofrimin e shërbimeve për mjetet lundruese turistike, të luksit, të transportit të mallrave apo të pasagjerëve.*

[35] Kontratë BOT si një port MBM (Multy Buoy Mooring),

[36] Ligji bën përjashtimin nga detyrimi për të paguar TVSH 20 përqind për anijet turistike të importuara, me vjetërsi jo më shumë se 20 vjet. Ky ndryshim i ligjit synon: (i) rindërtimin e një flote shqiptare me anije turistike miqësore me mjedisin; (ii) të zgjerojë flotën me flamurin shqiptar; (iii) stimulimin e zhvillimit të infrastrukturës së marinës.

TRANSPORTI AJROR

Në periudhën 2015-2020 është punuar kryesisht në drejtim të zhvillimit dhe ndërtimit të infrastrukturës aeroportuale, krijimit të kushteve të përshtatshme për një treg më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara, me qëllim uljen e kostove të udhëtimit; zbatimin dhe unifikimin e standardeve ndërkombëtare për sigurinë ajrore. Portat e ajrit janë konsideruar nga qeveria si një mundësi për zhvillimin e qëndrueshëm të ekonomisë së vendit në përgjithësi, dhe turizmit në veçanti. Në transportin ajror vijon zbatimi me ritëm i strategjisë për krijimin e një rrjeti aeroportesh që do të mbulojë operime të brendshme, rajonale dhe ndërkontinentale.

Duke qenë se zhvillimi i turizmit është konsideruar si prioritar nga Qeveria Shqiptare, me qëllim mbështetjen e zhvillimit të turizmit, transporti ajror është orientuar drejt rritjes së numrit të aeroporteve ndërkombëtare në vend. Në prill 2021 u hap aeroporti i Kukësit në verilindje të vendit, si aeroporti i dytë ndërkombëtar në vend. Progres është bërë edhe në ndërtimin e aeroporteve të tjera, ku në ka filluar ndërtimi me koncesion i një aeroporti të ri në Vlorë, në jug të vendit. Gjithashtu, në 2021 është tenderuar fondi 37 milionë euro për ndërtimin e një aeroporti të katërt, në qytetin jugor të Sarandës.

Legjislacioni shqiptar në transportin ajror është kryesisht në përputhje me acquis të BE-së. Shqipëria është duke përmbushur kushtet në lidhje me përfundimin e fazës së parë të Marrëveshjes Shumëpalëshe për Themelimin e Zonës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit ECAA, duke përfshirë në legjislacionin kombëtar, kuadrin ligjor të BE-së, i përcaktuar në Shtojcën I të ECAA, e përditësuar me vendimin e Komisionit Evropian nr. 1/2019 e 31 korrikut 2019.

QËLLIMI I POLITIKËS: *Krijimi i një tregu më konkurrues me shërbime ajrore të liberalizuara, përmes zhvillimit dhe ndërtimit të aeroporteve të reja, si dhe zbatimit dhe unifikimit të standardeve ndërkombëtare dhe BE-së për sigurinë në operim.*

TRANSPORTI INTERMODAL

Aktualisht në Shqipëri transporti i kombinuar ofrohet në formën e transportit multimodal që përkufizohet me kalimin e transportit detar tek ai rrugor dhe anasjelltas. Ky transport i kombinuar aplikohet për transportimin e kontenierëve që magazinohen në portin e Durrësit drejt Kosovës. Transporti multimodal pritet të zhvillohet në vitet në vijim, duke qenë se do të përfshijë edhe transportin hekurudhor të mallrave, kryesisht pas rehabilitimit të linjës hekurudhore Tiranë–Durrës.

Është identifikuar nevoja për një minimum prej dy vendndodhjesh potenciale për ndërtimin e terminaleve intermodale të mallrave – në zonën qendrore/veriore dhe juglindore, në linjë me rrjetin hekurudhor dhe të lidhur me portet kryesore shqiptare. Aktualisht është në vazhdim ndërtimi i dy qendrave logjistike në zonën e Elbasanit dhe Milotit për rehabilitimin e linjës hekurudhore, në përputhje me Strategjinë e BE-së dhe strategjinë SEETO për të përmirësuar transportin multimodal midis Portit të Durrësit me rajonin në brendësi të vendit (Korridorit VIII). Gjithashtu, një qendër logjistike është në ndërtim e sipër në qarkun Tiranë-Durrës nga sektori privat, duke mbështetur objektivin për zhvillimin e transportit multimodal.

QËLLIMI I POLITIKËS: *Promovimi dhe krijimi i kushteve të favorshme për zhvillimin e transportit intermodal e të kombinuar dhe logjistikës përkatëse për transport multimodal.*

TELEKOMUNIKACIONI

Zhvillimi i infrastrukturës së Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK), është ndër prioritetet e Qeverisë Shqiptare dhe pjesë e objektivave strategjike kombëtare, për zhvillimin dhe integrimin si një domosdoshmëri për të mbështetur gjithë transformimin digjital të ekonomisë dhe zhvillimet inovatore në sektorë strategjikë si energji, transport, industri, edukim, arsim etj.

Shqipëria ka ndërmarrë një numër reformash strukturore në sektorë dhe aktivitete të ndryshme ekonomike duke përfshirë dhe sektorin e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit. Qeveria Shqiptare prej më shumë se dhjetë vitesh nga strategjia e parë për zhvillimin e TIK, ka vazhduar promovimin e TIK, në sektorë të ndryshëm, duke prezantuar dhe implementuar strategji dhe politika të ndryshme të cilat e kanë TIK në fokusin e tyre, zhvillimin e shoqërisë së informacionit, agjendën digitale dhe zhvillimin e Broadband-it. Për më tepër në vitet e fundit qeveria shqiptare ka investuar fort në digjitalizimin e infrastrukturës publike dhe ngritjen e sistemeve dhe shërbimeve elektronike qeveritare.

Zhvillimi i infrastrukturës digjitale broadband, 5G, tarifat e roamingut dhe në tërësi komponentët e integrimit digjital janë pjesë e angazhimeve rajonale të Ballkanit Perëndimor (BP) në Planin e Veprimit të Tregut të Përbashkët Rajonal 2021-2024 (CRM), i miratuar nga udhëheqësit e BP në Samitin e Sofies në Nëntor 2020, si një hap i rëndësishëm në afrimin e rajonit me Tregun e Përbashkët të BE-së.

Agjenda Digjitale për Ballkanin Perëndimor, si një përpjekje e përbashkët e partnerëve të Ballkanit Perëndimor (BP) dhe Komisionit Evropian (KE), është një nga gjashtë iniciativat e Komunikatës mbi një perspektivë të besueshme të zgjerimit dhe angazhimin e BE-së me Ballkanin Perëndimor. Në Deklaratën e mbështetjes së Agjendës Digjitale të Ballkanit Perëndimor, u arrit një marrëveshje për të hequr tarifat roaming në rajon dhe për të mbështetur uljen e tarifave roaming midis BP dhe BE-së si dhe për përmirësimin e klimës së investimeve për projektet digjitale dhe lehtësimit të tregjeve të qëndrueshme, të parashikueshme dhe konkurruese në sektorin e telekomunikacionit.

Situata e përgjithshme e zhvillimit të infrastrukturës se telekomunikacionit, broadband, në veçanti e rrjeteve fikse dhe ndarja e theksuar digjitale midis zonave urbane dhe rurale, tregon nevojën e lartë për investime të rëndësishme për zhvillimin e Infrastrukturës Digjitale Broadband dhe se investimi vetëm nga sektori privat në zhvillimin e rrjeteve, në veçanti në zonat rurale dhe të largëta, është i pamjaftueshëm. Zhvillimi i infrastrukturës broadband dhe mbulimi i zonave të bardha, zonave rurale me broadband të shpejtë dhe shumë të shpejtë është një nga drejtimet kryesore të investimeve e identifikuar në flagship 8, të Planit Ekonomik dhe të Investimeve për Ballkanin Perëndimor të miratuar nga BE. Ky plan ka nënvizuar se nevoja për investime për rrjetet broadband në Ballkanin Perëndimor është rreth 3.6 miliard Euro.

Për rëndësinë që paraqet infrastruktura digjitale për zhvillimin e gjithë ekonomisë, në veçanti në erën e transformimit digjital, u miratua Plani i ri Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025, i cili ka përcaktuar si vizion: "Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit".

Qëllimi Strategjik: *Shqipëria me Infrastrukturë Digjitale Broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në të gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit*

Për realizimin e këtij vizioni, përcaktohen këto objektiva strategjike të zhvillimit të broadband:

Objektivi strategjik 1: *Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës broadband*

Objektivi strategjik 2: *Reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve broadband gjithëpërfshirëse*

Objektivi strategjik 3: *Rritje e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit.*

Për zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe arritjen e objektivave të vendosura në planin kombëtar të broadband, është iniciuar projekti për Zhvillimin e Broadbandit Rajonal i cili është pjesë e Projekteve Kombëtare të NSPP (National Single Project Pipeline) të miratuara nga Komiteti Kombëtar i Investimeve.

Tendencat e zhvillimit të tregut të telekomunikacionit në Shqipëri, janë në përputhje me zhvillimet në rajon dhe më gjerë. Kemi rënie në depërtimin e telefonisë fikse, rritje të përdorimit të rrjeteve celulare dhe të Internetit, dhe përpjekje të vazhdueshme për të përmirësuar disponueshmërinë e Broadband-it dhe kushtet e aksesit.

Për sa i përket përdorimit TIK, 79.3 përqind e shqiptarëve përdorin Internetin dhe 78.3 përqind e familjeve kanë akses në Internet fiks. Depërtimi i lidhjeve fikse të Internetit të shpejtë, (broadband-it fiks) është rritur në mënyrë të vijueshme vit pas viti. Në fund të vitit 2021 numri total i lidhjeve fikse broadband ishte rreth 550 mijë. Njëkohesisht ka rritje të shpejtësisë së lidhjes për broadbandin fiks. Rreth 73 përqind e pajtimtarëve kanë akses në internet me shpejtësi lidhjeje nga 10 – 100 Mbps, 17 përqind e totalit të pajtimtarëve fiks kanë akses në internet deri në 10 Mbps. Megjithatë numri i pajtimtarëve me lidhje gigabit/s është i ulët sikurse jepet në tabelën e mëposhtme. Diferencat në zonat urbane dhe rurale mbeten ende të larta për sa i përket shtrirjes së rrjeteve fikse të Internetit broadband.

Mbulimi i rrjeteve celular me teknologjinë 3G/4G/4G+ në vitin 2021 ishte 99 përqind e popullsisë dhe përdoruesit e broadband nga rrjetet celulare ishin rreth 2 milionë deri në fund të vitit 2021 me një penetrim 73 përqind. Rrjetet 5G që shihen si një mundësi shumë e madhe për transformimin digjital dhe përdorimin e gjerë në industrinë vertikale, në zhvillimin e smart city etj., nuk janë prezantuar ende në vend.

Referenca me Kapitullin përkatës të "Acquis"- Kapitulli 10 "Shoqëria e Informacionit dhe Media", përbëhet nga tre fusha bazë: Komunikimet elektronike, Shërbimet e shoqërisë së informacionit, dhe Politika audiovizuale.

Shqipëria si vend kandidat për anëtarësim në BE, është e angazhuar të harmonizojë politikat e saj kombëtare, në lidhje me zhvillimin e komunikimeve elektronike, me ato të BE-së, të cilat do të harmonizohen me objektiva strategjikë të iniciativës të BE-së në vitin 2010 mbi Agjendën Digjitale për Evropën, si një strategji gjithëpërfshirëse për zhvillimin e shoqërisë së informacionit dhe strategjinë e BE-së e vitit 2016 "Drejt një Shoqërie Gigabit për vitin 2025".

Pjesa kryesore e acquis në fushën e komunikimeve elektronike përbëhet nga kodi i komunikimeve elektronike të BE-së, direktiva 2018/1972/EU e miratuar në dhjetor 2018, e cila ka zëvendësuar paketën e direktivave të komunikimeve elektronike të vitit 2002 dhe 2009. Kodi përfshin masa për nxitjen e investimeve në rrjetet e kapaciteteve shumë të larta, rregulla të reja për spektrin e frekuencave dhe rrjetet celulare 5G, ndryshime në regjimin e shërbimit universal, rregulla për mbrojtjen e konsumatorit, numeracionin dhe komunikimet e emergjencave. Përveç Rregullores së re të BE-së për Mbrojtjen e të Dhënave të Përgjithshme që hyri në fuqi në Maj 2018, rregullat e e-privatësisë në komunikimet elektronike janë duke ndryshuar. Pjesë e rëndësishme legjislative është gjithashtu Direktiva për sigurinë e sistemeve të rrjetit dhe informacionit.

Në fushën e politikës audiovizuale, pjesa kryesore legjislative është Direktiva 2010/13/BE për shërbimet audiovizive dhe audiovizuale që mbulon transmetimet televizive tradicionale dhe shërbimet mediatike audio-vizuale në kërkesë dhe vendos një sërë rregullash minimale për të dy llojet e shërbimeve. Këshilli i BE-së ka

miratuar ndryshimet në Direktivën 2010/13/BE për shërbimet audiovizive. Këto ndryshime përfshijnë disa rregullime të reja që synojnë mbrojtjen më të mirë të minoreneve, rregulla të reja për platformat online, promovimin e punëve Evropiane etj.

Shqipëria është mesatarisht e përgatitur për anëtarësim në Bashkimin Evropian për sa i përket shoqërisë së informacionit dhe medias audio-vizuale.

Një element i ri kyç në PKB përfshin mundësinë e planifikuar të financimit publik nëpërmjet detyrimit të shërbimit universal (USO) dhe ndihmës shtetërore për të rritur mbulimin e infrastrukturës në zonat rurale dhe të largëta. PKB ka përcaktuar objektiva për rritjen e penetrimit broadband. Zhvillimi i broadband dhe infrastrukturës digjitale ka nevojë për investime të mëdha dhe për krijimin e një sinergjie midis gjithë projekteve të infrastrukturës dhe projektet e lidhura me digjitalizimin, në nivel qendror dhe vendor.

Në lidhje me objektivat strategjike për: zhvillimin e qëndrueshëm të Infrastrukturës Broadband, reduktimin e ndarjes digjitale dhe ofrimi i Shërbimeve Broadband, dhe rritjen e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit, prioritetet e sektorit përfshijnë çështje të një niveli të lartë rëndësie si: promovimi i ndërtimit të rrjeteve së gjeneratës të së ardhmes NGN, zhvillimi i infrastrukturës e shtrirja e fibrës optike, përfshirë zhvillimin e Rrjeteve Mobile Broadband NGN, (lirimi i brezit 700 MHz dhe spektrit tjetër për 5G), avancimi i hartëzimit të infrastrukturës dhe bashkëpërdorimi i infrastrukturës në nivel vendor dhe kombëtar. Investimet në mbulimin e zonave të bardha me broadband do të jenë pjesë e masave për përmbushjen e këtij objektivi strategjik.

Adresimi i dhënies në kohë të lejeve për ndërtim të rrjetit dhe e drejta e kalimit, nga bashkitë apo institucionet qendrore, janë prioritet kryesor dhe kusht paraprak kryesor që grupet e interesit të kryejnë investime. Për të nxitur operatorët që të investojnë duhet të bëhen përmirësime të rëndësishme në procesin e aplikimit, ngritjen e kapaciteteve në nivel bashkiak si dhe në vendosjen e afateve strikte.

Qëllimi i politikës:

(a) Nxit zhvillimin ekonomik e social të vendit dhe përmirëson klimën e biznesit;

(b) Redukton ndarjen digjitale dhe mundëson marrjen e shërbimeve të kudondodhura;

(c) rrit mundësinë për punësim dhe biznese të reja bazuar në teknologjitë digjitale.

Rrjetet 5G

Përdorimi i Internetit përmes celularit dhe Rrjetet Mobile Broadband, janë mbizotëruese në Shqipëri. Mobile Broadband, dhe 5G do të jenë një komponent kryesor i infrastrukturës kombëtare në Shqipëri. Në lidhje me zhvillimin e rrjeteve 5G do synohet:

- Lehtësim i vënies në dispozicion në kohë i spektrit;
- Thjeshtim, përmirësim i proceseve dhe reduktim i kompleksitetit për lejet e ndërtimit;
- Adresim i çështjeve mjedisore dhe zhvillimi miqësor me ndikim minimal në mjedis;
- Promovim i ndërgjegjësimit mbi mundësitë dhe përfitimet nga 5G;
- Garantimi i sigurisë së rrjeteve dhe mbrojtja e konsumatorëve.

Adresimi i sigurisë së Rrjeteve Broadband

Një prioritet kryesor në zhvillimin e Infrastrukturës Broadband është përdorimi i sigurt, i mbrojtur dhe i besueshëm i aksesit internet broadband, i cili nuk duhet të ketë kërcënime kibernetike. Rrjetet e telekomunikacionit janë të ekspozuara ndaj dëmtimeve të rrjetit, që mund të cenojnë integritetin e tij duke sjellë pasoja në aksesin e paautorizuar në rrjet, humbje të konfidencialitetit të komunikimit, si dhe rrezikun e disponueshmërisë së shërbimeve të komunikimit, të domosdoshme në ditët e sotme. Tendencat e zhvillimit në telekomunikacion, zhvillimet e pritshme si kalimi në rrjetet e gjeneratës 5G, pritet të sjellin ndryshime të rëndësishme në komunikime me prezantimin e aplikimeve/modeleve të reja të komunikimit të lidhura me industrinë (transportin, energjinë, shëndetësinë, etj.), me institucionet publike, komunikimet midis pajisjeve (internetin e gjërave (IoT), komunikimet masive të makinave (mMMC) etj. Këto zhvillime po shoqërohen në nivel global me rritjen e vëmendjes ndaj çështjeve të sigurisë së komunikimeve në rrjetet 5G.

Sulmet kibernetike kanë potencial për të dëmtuar rëndë shkëmbimin e informacionit në infrastrukturat kritike të informacionit. Në Ligjin Nr. 9918 datë 19.5.2008 "Për Komunikimet Elektronike në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, janë parashikuar masa të rëndësishme për forcimin e gjendjes së sigurisë në fushën e komunikimeve elektronike dhe eliminimin e efekteve të rreziqeve për Sigurinë Kombëtare, që mund të burojnë nga angazhimi i subjekteve ekonomike private dhe të huaja në fushën e komunikimeve elektronike dhe postare.

MASAT PRIORITARE PËR QËLLIMIN E POLITIKËS

- Hartimi dhe miratimi i kuadrit ligjor të ri për komunikimet elektronike dhe 5G;
- Kryerja e investimeve për mbulimin me broadband të zonave të bardha për reduktimin e ndarjes digjitale.

Menaxhimi i integruar i ujërave

Uji është burim jetik. Shqipëria klasifikohet si një vend i pasur me burime ujore, duke përfshirë si ujrat sipërfaqësorë ashtu edhe ato nëntokësorë, me sasinë më të lartë të ujit të disponueshëm si ujë të pijshëm për frymë. Burimet ujore në vendin tonë janë në formën e lumenjve, liqeneve, ujërave detare, akuifereve, burimeve gjeotermale dhe rezervuarëve artificialë. Volumi mesatar shumëvjeçar i ujit që shkarkohet brenda një viti është 39.22 miliardë m3 /vit, nga të cilat 95 përqind shkarkohen në detin Adriatik dhe 5 përqind në detin Jon. I gjithë territori përshkohet nga shtatë lumenj kryesorë nga lindja në perëndim: Drini, Mati, Ishmi, Erzeni, Shkumbini, Semani dhe Vjosa. Pellgu hidrografik i baseneve ujëmbledhëse të Shqipërisë shtrihet edhe jashtë kufijve territorialë të vendit. Shqipëria ka rreth 476 km vijë bregdetare nga të cilat 326 km në detin Adriatik dhe 150 km në detin Jon. Gjithashtu në ultësirën perëndimore dhe gjatë luginave të lumenjve ka akuiferë të cilët kontribuojnë me rreth 23 përqind në rrjedhjen totale vjetore. Përgjatë lumenjve janë ndërtuar 650 rezervuarë artificialë, të cilët përdoren për ujitje, hidroenergji dhe ujë të pijshëm.

Për të qenë në harmoni me Marrëveshjen e Gjelbër Evropiane, Shqipëria duhet të transformojë menaxhimin e energjisë, transportit, bujqësisë dhe shërbimeve të ekosistemit dhe të zbusë rreziqet nga katastrofa. Menaxhimi i integruar i burimeve ujore dhe zvogëlimi i rrezikut nga katastrofat mund të ndihmojë në ekuilibrimin e nevojave për energji hidrike me ato të bujqësisë, turizmit, mbrojtjes nga përmbytjet dhe sektorin e peshkimit, veçanërisht nëse siç parashikohet, nivelet e reshjeve bien dhe katastrofat e lidhura me klimën rriten. Në bujqësi, barrierat strukturore pengojnë rritjen, veçanërisht për aktivizimin ekonomik të grave në zonat rurale.

Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm lidhet me përparësitë e vendit, integrimi në Bashkimin Evropian dhe Agjendën për Zhvillim të vitit 2030. Sektori i ujit përfshihet në Agjendën e zhvillimit të qëndrueshëm kryesisht nëpërmjet OZHQ 5 (Barazia gjinore), OZHQ 6 (Uji dhe kanalizimet); OZHQ 13 (Veprimet për klimën), OZHQ 14 (Jeta nën ujë) dhe OZHQ 15(Jeta në tokë), por më specifikisht me OZHQ 6.5.1 (Shkalla e

zbatimit të menaxhimit të integruar të burimeve ujore) dhe OZHQ 6.5.2 (Përqindja e zonës së baseneve ndërkufitarë me një marrëveshje operative për bashkëpunimin ujor).

Po kështu, në kuadër të detyrimeve që lindin nga "Kuadri i Bashkëpunimit për Zhvillim të Qëndrueshëm (2022-2026)" midis Qeverisë së Shqipërisë dhe OKB-së, sektori i ujit ka një lidhje të rëndësishme, duke qenë në fokus të Përparësisë Strategjike B: "Rritje ekonomike e gjelbër, e qëndrueshme dhe me përshtatshmëri ndaj ndryshimeve dhe menaxhim i burimeve", me rezultat : Deri në vitin 2026, zgjidhje politikash novative dhe të integruara përshpejtojnë zhvillimin ekonomik, produktiv, dhe të qëndrueshëm, duke rritur nivelin e përshtatshmërisë ndaj ndryshimeve klimatike dhe zbutjen e pasojave të tyre, si dhe kalimi në një ekonomi më të gjelbër dhe blu.

Në kontekstin e rëndësisë së ujit, që prej vitit 2014, qeveria po ndjek një qasje të **integruar të menaxhimit të ujit,** e cila bazohet fuqimisht mbi parimet e kuadrit juridik dhe programin politik të BE-së. Vizioni i qeverisë në lidhje me këtë qasje të re është "***përmbushja e nevojave bazë të jetesës, konkurrueshmëria e përdorueseve dhe vendosja e përparësive drejt përfitimit ekonomik, duke marrë në konsideratë qëndrueshmërinë e ekosistemeve".***

Vizioni për sektorin e ujit është që "*Deri në vitin 2030, Shqipëria do të jetë një vend me përdorim efikas të ujit dhe menaxhim të integruar dhe funksional të burimeve ujore".*

Menaxhimi i burimeve ujore përfshin një sistem të plotë monitorimi, menaxhimin e rrezikut të përmbytjeve dhe mungesës së ujit dhe bazohet në parimet e barazisë dhe qëndrueshmërisë për përfitime të barabarta, sociale, ekonomike dhe gjinore, si dhe drejtësi mjedisore për brezat e tanishëm dhe të ardhshëm.

Uji për njerëzit, që përfshin ujin e pijshëm dhe shërbimet e kanalizimeve;

Referuar të dhënave të raportimit vullnetar në *Water Information System for Europe (WISE*) në 2019, shumica e ujit të pijshëm (90.2 përqind), nxirret nga burimet nëntokësore. Referuar raportit vjetor 2021 të ERRU-së, "Mbulimi me Furnizimin me Ujë" për vitin 2021 është në nivelin 77 përqind, ndërkohë që "Mbulimi me Kanalizime" shënon nivelin 51.9 përqind.

Brenda kontekstit të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore, ndikim krijon edhe turizmi, i cili ndjehet në ndryshimin sezonal në kërkesën për ujë dhe përdorimin e lumenjve si atraksione turistike. Që lumenjtë të jenë një tërheqje turistike, duhet që ato të mbahen sa më shumë të jetë e mundur në gjendjen e tyre natyrore; një objektiv në harmoni të plotë me Direktivën Kuadër të Ujrave.

Uji për ushqimin, që përfshin përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe kullimit;

Bujqësia është një nga sektorët që përdor gjerësisht burimet ujore. Në verë kërkohet një sasi shtesë e ujit, duke qenë se vetëm 20 përqind e reshjeve të përgjithshme vjetore (mesatarisht 1,485 mm/vit) bien midis muajve Maj dhe Tetor. Defiçitet e ujit ndërmjet muajve Qershor dhe Gusht variojnë midis 400 dhe 500 mm, duke e bërë ujitjen të nevojshme për prodhimin efikas të kulturave bujqësore. Uji nga 626 rezervuarët e ndërtuar për ujitje (me një kapacitet të parashikuar prej 560 milion m^3) përdoret për ujitje, ndërsa rreth 450 milion m^3 ujë devijohen drejtpërsëdrejti nga lumenjtë dhe përrenjtë.

Uji për mjedisin, që përfshin zonat e mbrojtura, ligatinat dhe pyjet;

Sfida e menaxhimit të ujit për mjedisin është të balancojë nevojën për ekosisteme të ndryshme me nevojat e përdoruesve të tjerë të ujit.

Zonat e Mbrojtura kanë rëndësi të madhe ekologjike për vendin. Këto zona janë nën kërcënim në rritje për shkak të migrimit të popullsisë, kërkesës në rritje për industrializim, shoqëruar me rritjen e ndotjes, copëtimin e habitatit, pakësimin e biodiversitetit dhe shkatërrimin e përgjithshëm mjedisor. Zonat e Mbrojtura të Shqipërisë ndahen në 6 kategori, por ato që lidhen më shumë me burimet ujore janë si më poshtë:

Ligatinat janë të rëndësishme për biodiversitetin e vendit pasi rreth 70 përqind e shpendëve, zvarranikëve dhe gjitarëve të vendit mund të gjenden në këto zona. Për më tepër, 65 përqind e vertebrorëve të ligatinave janë identifikuar si specie të kërcënuara kudo në botë. Aktualisht në Shqipëri katër ligatina janë shpallur si zona të rëndësishme ndërkombëtare.

Pyjet kanë rëndësi për menaxhimin e burimeve ujore pasi ato: (i) ndihmojnë në parandalimin e erozionit të tokës, (ii) reduktojnë përmbytjet e shpeshta, (iii) ofrojnë biodiversitet për florën dhe mbrojtjen natyrore të faunës, dhe (iv) ofrojnë mundësi për përthithjen e karbonit dhe rregullimin e klimës.

Uji për industrinë, që përfshin hidro-energjitikën, burimet hidro-termike, veprimtaritë e industrisë së lehtë dhe të rëndë, menaxhimin e mbetjeve të ngurta, peshkimin dhe kulturat ujore, lundrimin dhe zbavitjen;

Prodhimi i energjisë hidrike është burimi kryesor i prodhimit të energjisë elektrike në Shqipëri, duke zënë 97 përqind të prodhimit energjitik aktual të brendshëm. Mbështetja pothuajse ekskluzive në energjinë hidrike për furnizimin me energji elektrike e bën prodhimin vjetor shqiptar shumë të varur nga ndryshueshmëria e kushteve hidrologjike. Megjithëse disponueshmëria e përgjithshme e ujit për prodhimin e energjisë pritet të jetë e mjaftueshme, duhet të ndërmerren masa për të menaxhuar ujin gjatë periudhave të verës, në mënyrë të atillë që prodhimi i energjisë të jetë i përshtatshëm.

Përparësitë afatshkurtra dhe afatmesme:

Duke marrë në konsideratë ndarjen e shtyllave prioritare të përdorimit të burimeve ujore, lidhur me **Ujin për njerëz**, në përputhje me *acquis* të BE-së dhe Strategjinë Kombëtare për Ujësjellës dhe Kanalizime, shihet si përparësi përmirësimi i furnizimit me ujë dhe kanalizimet në zonat turistike të vendit.

Për sa i përket **Ujit për ushqim** duhet të sigurohet përmirësimi i sistemit ujitës dhe kullimit, nëpërmjet rritjes së sipërfaqes së tokës së ujitur.

Lidhur me **Ujin për mjedisin** duhet të garantohet përdorimi i qëndrueshëm i ujit si komponent shumë i rëndësishëm i mjedisit natyror dhe biodiversitetit, mbrojtja dhe përmirësimi i statusit të trupave ujore, nëpërmjet kontrollit të shkarkimeve, respektimit të rrjedhjes ekologjike dhe uljes së presioneve.

Lidhur me **Ujin për industrinë** duhet garantuar përdorimi i qëndrueshëm i ujit për qëllime industriale, në veçanti për prodhimin e energjisë elektrike duke respektuar kriteret mjedisore, trajtim i ujërave të perdorur brenda parametrave cilësorë dhe sasiorë përpara shkarkimit në trupat ujorë, nxitja e ripërdorimit të ujërave industriale.

Në të gjitha këto dimensione, përdorimi i burimeve ujore do të lidhet ngushtë me efektet e ndryshimeve klimatike ndaj burimeve ujore si dhe me aftësinë e qëndrueshmërisë dhe adaptimit ndaj këtyre ndryshimeve.

Furnizimi me ujë dhe kanalizimet

Një nga prioritetet kryesore të Qeverisë Shqiptare është reformimi i sektorit të ujësjellës kanalizimeve për një sistem të besueshëm të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve mbarëkombëtare që plotëson nevojat e një ekonomie në zhvillim duke mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e qytetarëve. Bazuar në Agjendën 2030, qeveria është e angazhuar në vijimin e planeve dhe projekteve për t'i bërë realitet Objektivat specifike për Zhvillim të Qëndrueshëm për ujin dhe kanalizimet (SDG 6) "Sigurimi i disponueshmërisë dhe menaxhimit të qëndrueshëm të ujësjellës-kanalizimeve për të gjithë".

Sfidat më kritike me të cilat përballet sot sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve lidhen me financimin e pamjaftueshëm për arritjen e objektivave strategjikë, tarifat e ulëta, angazhimi i pamjaftueshëm dhe joefektiv i njësive të qeverisjes vendore në proceset operative dhe planifikimi, mungesa e ekonomisë së shkallës e bëjnë të vështirë financimin e shoqërive aksionare të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve.

Sektori i Ujësjellës Kanalizimeve ka si qëllim të përmirësojë ofrimin cilësor të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për qytetarët e Shqipërisë dhe të mbështesë zhvillimin ekonomik të vendit, bazuar në performancën e një shërbimi kyç të infrastrukturës.

Vizioni: "*Një sistem i besueshëm mbarëkombëtar për furnizimin me ujë, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura që plotëson nevojat për zhvillimin ekonomik dhe të shoqërisë në tërësi, duke ruajtur dhe mbrojtur mjedisin, shëndetin dhe sigurinë e popullsisë në Republikën e Shqipërisë.*"

Kushtet që duhen plotësuar dhe shërbejnë si bazë për arritjen e parimeve kryesore të sektorit, janë:

- *Qëndrueshmëria:* Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të jenë të qëndrueshme ekologjikisht, teknikisht dhe financiarisht përmes mbulimit të plotë të kostos;
- *Përputhshmëria:* Sektori i furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ofron një qasje universale që plotëson të gjitha kërkesat rregullatore/Evropiane sipas parimit ndotësi paguan;
- *Efiçenca:* Shoqëritë e Ujësjellës Kanalizimeve kanë efikasitet dhe performancë cilësore shërbimi, ekuivalente me praktikën e mirë Evropiane dhe sipas parimeve të ekonomisë qarkulluese;
- *Përballueshmëria*: Të sigurojë ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve për konsumatorët me një çmim të përballueshëm;
- *Transparenca*: Sigurimi i pjesëmarrjes dhe transparencës së publikut në politikat e ujit.

Qëllimet e politikës për sektorin, të cilat janë specifike, të matshme dhe të arritshme në kohë:

1. Zgjerimi dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit të furnizimit me ujë;
2. Zgjerimi dhe përmirësimi i aksesit në sistemet e grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujrave të zeza për popullatën;
3. Zbatimi i programit për riorganizimin e shërbimeve të furnizimit me ujë, largimin dhe trajtimin e ujrave të zeza në bazë rajonale;
4. Përmirësimi i qëndrueshmërisë financiare dhe përballueshmërisë së shërbimeve të furnizimit me ujë, largimi dhe trajtimi i ujrave të zeza sipas parimeve të kontrollit dhe mbulimit të plotë të kostove operacionale;
5. Ngritja e kapaciteteve dhe mirëadministrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë, largimi dhe trajtimi i ujrave të ndotura;
6. Përmirësimi i qeverisjes dhe kuadrit ligjor e rregullator të sektorit.

Zhvillim i qëndrueshëm mjedisor

Mbrojtja e mjedisit është një ndër sektorët prioritarë të identifikuar në programin e qeverisë për dekadën e ardhshme. Nënfushat e mjedisit, kontribuojnë në arritjen e objektivave madhore të këtij sektori.

Mbrojtja e natyrës: Gjatë vitit 2023 do të fillojë rishikimi dhe përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, për periudhën deri në 2030, në linjë me kontekstin global Post 2020 për biodiversitetin, të Konventës së Kombeve të Bashkuara për Diversitetin Biologjik dhe Strategjinë Evropiane post 2020 për Biodiversitetin.

Përafrimi me legjislacionin e Bashkimit Evropian, kryesisht referuar Direktivave për Habitatet dhe Shpendëve, është një nga prioritetet e MTM për sa ti takon mbrojtjes së natyrës nivel të avancuar. Gjatë vitit 2022 do të fillojë rishikimi dhe përditësimi i Strategjisë dhe Planit të Veprimit për Biodiversitetin, për periudhën deri në 2030, në linjë me kontekstin global Post 2020 për biodiversitetin, të Konventës së biodiversitetit dhe strategjinë Evropiane post 2020 për Biodiversitetin.

Forcimi i mëtejshëm i kapaciteteve në nivel kombëtar dhe lokal për zbatimin në praktikë të kuadrit ligjor të përditësuar dhe për procesin e ngritjes së rrjetit Natura 2000 në vend, është prioritet i fushës së mbrojtjes së natyrës, si detyrimi kryesor në kuadrin e procesit të integrimit Evropian të vendit. Në këtë kuadër, fuqizimi i Agjencisë Kombëtare të Zonave të Mbrojtura do të jetë përparësi e posaçme gjatë zbatimit të kësaj strategjie. Zhvillimi i sektorit të turizmit dhe realizimi i veprave të rëndësishme të infrastrukturës në vend do të ketë në konsideratë të përhershme zhvillimin e qëndrueshëm, mbrojtjen e vlerave natyrore dhe biodiversitetin, si dhe pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje.

Zonat e Mbrojtura: Deri në vitin 2022 mbulimi i Zonave të Mbrojtura është rritur në 605,433 hektarë ose **21 përqind** e territorit të vendit si rezultat i rishikimit të kufijve të zonave të mbrojtura, nëpërmjet shpalljes apo heqjes së statusit të zonave të mbrojtura apo zgjerimit të atyre ekzistuese.

Për përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, duhet vënë theks i veçantë në menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor e kullosor kombëtar si një burim i rëndësishëm, i cili shtrihet në 62 përqind të sipërfaqes së përgjithshme të territorit, si dhe rreziku që lidhet me zjarret në pyje, fenomen me pasoja tepër të dëmshme që është ndeshur shpesh gjatë periudhës së nxehtë të viteve të fundit.

Në prill 2020, u miratua Ligji 57/2020 "Për pyjet" dhe më pas në korrik u miratua edhe krijimi i Agjencisë Kombëtare të Pyjeve.

Sfidat kryesore

Me rritjen e sipërfaqes së zonave të mbrojtura, në përputhje me objektivat globalë 'post 2020' si dhe menaxhimi i integruar i tyre në përputhje me standardet më të mira ndërkombëtare, përballen me sfidat që lidhen me:

- Kapacitete të pamjaftueshme të burimeve njerëzore për menaxhimin dhe monitorimin në terren të këtyre sipërfaqeve;
- Nevoja për menaxhimin e zonave të mbrojtura, duke u mbështetur jo vetëm në kapacitetet kombëtare/lokale, por si një vlerë e shtuar dhe të aktorëve lokalë (organe qendrore, shoqëri civile, biznese private, grupe interesi etj.);
- Përfshirjen e komuniteteve lokale në procesin e menaxhimit, duke mundësuar dhe promovimin e produkteve lokalë;

- Përfshirjen e zonave të mbrojtura në zhvillimin ekonomik të vendit;
- Krijimin e paketave ekoturistike të zonave të mbrojtura si destinacione turistike duke ndikuar pozitivisht në rritje të numrit të turistëve dhe ekonominë e vendit;
- Rritja e investimeve mbi sektorin, nëpërmjet përfshirjes së sektorit në skemat e financimit IPARD III, në bashkëpunim me MBU.

Në përputhje me Kuadrin Global për Biodiversitetin post 2020, për adresimin e sfidave të mësipërme objektivat e synuara për periudhën deri në 2030, janë:

Në fushën e mbrojtjes së natyrës:

- Transpozimi i plotë i *acquis* së BE-së për natyrën dhe biodiversitetin dhe zbatimi i tij në praktikë;
- Përmirësimit të statusit të ruajtjes për llojet dhe habitateve të kërcënuara për të siguruar menaxhimin e qëndrueshëm të komponentëve të biodiversitetit;
- Nevojën për krijimin e rrjetit ekologjik Natura 2000 për Shqipërinë dhe Komunitetin Evropian;
- Futja e biodiversitetit dhe shërbimeve të ekosistemit në programet arsimore në shkolla të ndryshme dhe ciklet e arsimit të lartë.

Cilësia e ajrit:

Legjislacioni kombëtar për cilësinë e ajrit të mjedisit, është përafruar në një nivel të avancuar me atë të Bashkimit Evropian dhe është plotësuar më tej me akte nënligjore që synojnë reduktimin e shkarkimeve që vijnë nga sektori transportit rrugor, nëpërmjet përmirësimit të flotës së mjeteve motorike dhe automjeteve që qarkullojnë në vend, përmirësimit të cilësisë së lëndës djegëse të lëngët, si dhe sigurimit të informacionit për konsumatorin mbi konsumin e lëndës djegëse dhe shkarkimet e CO_2 gjatë marketingut të automjeteve të reja të pasagjerëve etj.

Plani Kombëtar për Menaxhimin e Cilësisë së Ajrit në Mjedis, identifikon masat që duhen zbatuar nga institucionet përgjegjëse për reduktimin e shkarkimeve nga sektorët përkatës si: transporti, zhvillimi urban, sektori bujqësisë, aktivitetet industriale si dhe ngarkon bashkitë që të hartojnë planet e tyre lokale të menaxhimit të cilësisë së ajrit në mjedis.

Sfidat:

Legjislacioni kombëtar në këtë fushë, duhet të forcojë zbatimin e tij, ndërsa rrjeti dhe praktikat e monitorimit të cilësisë së ajrit që zbatohen aktualisht, duhet të përputhen me standardet e Bashkimit Evropian dhe angazhimet e Shqipërisë ndaj Konventës së UNECE për Ndotjen e Ajrit në Distancë të Madhe (CLRTAP). Është e nevojshme rritja e financimeve dhe investimeve të përshtatshme, për të garantuar monitorimin e vazhdueshëm, sigurimin e të dhënave dhe raportimin mbi shkarkimet në ajër nga të gjithë sektorët kontribues.

Numri i lartë i automjeteve në raport me popullsinë dhe përqëndrimi i popullsisë në zonat urbane paraqesin sfida që duhen adresuar përmes masave konkrete, përfshirë reduktimin e automjeteve të vjetra në qarkullim, uljen e numrit të automjeteve në qytete, dhe rritjen investimeve qe inkurajojnë përmirësimin, promovimin, përdorimin e transportit publik, automjeteve elektrike, transportit hekurudhor apo burimeve të tjera alternative të transportit miqësore me mjedisin që ndihmojnë në përmirësimin e cilësisë së ajrit.

Në përputhje me synimin OZHQ 3.9, vlerësimi i ndikimit të ndotjes së ajrit mbi shëndetin publik dhe informimi i publikut, është pjesë e menaxhimit të cilësisë së ajrit.

Masat prioritare për cilësinë e ajrit, janë:

i. Hartimi i Strategjisë kombëtare për cilësinë e ajrit në mjedis, për vitet 2024 e në vijim duke konsideruar ndërlidhjet me aspektet e ndryshimeve klimatike, shëndetit publik dhe biodiversitetit;

ii. Rritja e zbatimit në praktikë dhe përforcimi i legjislacionit kombëtar për fushën e cilësisë së ajrit;

iii. Reformimi i sektorëve me peshë të rëndësishme në cilësinë e ajrit, për të adresuar sfidat e përmirësimit të cilësisë së ajrit;

iv. Rritja e ndërgjegjësimit të publikut, grupeve të interesit për rëndësinë e cilësisë se ajrit dhe efektet e tij;

v. Reduktimi çdo vit i sasisë totale vjetore të substancave ozonholluese që importohen, me qëllim mbrojtjen e shtresës së ozonit.

Menaxhimi i integruar i mbetjeve dhe ekonomia qarkulluese

Menaxhimi i mbetjeve kryhet në të gjitha zonat urbane dhe më pak në zonat rurale. Mbetjet hidhen kryesisht në venddepozitime të caktuara nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore por ka sasi që hidhen dhe në vende të paautorizuara, përgjatë rrugëve dhe afër vendbanimeve. Shërbimi i menaxhimit të mbetjeve kryhet përmes kontraktimit nga Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore të ndërmarrjeve private apo dhe përmes kompanive të tyre dhe këto kontrata janë zakonisht me një kohëzgjatje 3-5 vjet. Infrastruktura e mbledhjes është e dobët, pasi shpesh numri i kontenierëve është i pamjaftueshëm. Pajisjet e grumbullimit (kontenierë dhe kamionë) nuk janë sipas standardeve Evropiane dhe kanë nevojë për rinovim në mënyrë të vazhdueshme.

Riciklimi ka shënuar progres krahasuar me disa vite më parë, pasi janë ngritur kompani që grumbullojnë metalet, plastikën, letrën dhe qelqin dhe i riciklojnë ato. Edhe për rryma të tjera mbetjesh ka filluar grumbullimi dhe menaxhimi i tyre. Për t'u përmendur janë mbetjet spitalore, të baterive, të vajrave, të pajisjeve elektrike dhe elektronike. Përpjekjet për ndarjen në burim të mbetjeve, kanë qenë të shpeshta por pa rezultat pozitiv. Kjo për shkak të mungesës së plotë të infrastrukturës por edhe të ndërgjegjësimit publik. Sa i takon përgatitjes së kuadrit ligjor në fushën e menaxhimit të integruar të mbetjeve është arritur një përputhshmëri e konsiderueshme me direktivat dhe rregulloret e BE-së, por sfidë mbetet ende zbatueshmëria e plotë e tij.

Mbrojtja e mjedisit dhe reduktimi i mbetjeve do të jenë në thelb të funksionimit të ekonomisë qarkulluese mbështetur veçanërisht në kërkim, inovacione dhe përmirësime teknologjike e menaxhimi, si një ndër angazhimet e Shqipërisë në kuadër të Deklaratës së Sofies mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor. Mbështetja në ekonominë qarkulluese do të ndihmojë bizneset vendase të integrohen natyrshëm në zinxhirët e vlerës së produkteve që prodhohen dhe tregtohen në rajon dhe BE. Për këtë qëllim, do të ndërtohen dhe zbatohen strategji specifike për zhvillimin e ekonomisë qarkulluese, menaxhimin e integruar të mbetjeve, adresimin në nivel rajonal, kombëtar dhe lokal të problematikës aktuale të mbetjeve dhe zbatimin e strategjive të specializimit inteligjent e inovativ për të mundësuar transformimin e qëndrueshëm të zinxhirëve të prodhimit dhe konsumit.

Kalimi drejt ekonomisë qarkulluese, duke përfshirë edhe përmirësimin e menaxhimit të mbetjeve, lidhet edhe me përmbushjen e drejtpërdrejtë të tre Objektivave për Zhvillimin e Qëndrueshëm të OKB, konkretisht objektivi 11, 12, 14.

Sfidat në administrimin e mbetjeve lidhen me:

- Shtrirjen e pjesshme të mbulimit me shërbimin e menaxhimit të mbetjeve;
- Mungesën e infrastrukturës për menaxhimin e integruar të mbetjeve;
- Praninë e një numri të madh venddepozitimesh, të cilat janë jashtë standardeve sanitare dhe inxhinierike;
- Mungesën e ndarjes së mbetjeve në burim dhe përqindjen e ulët të riciklimit;
- Mungesa e të dhënave analitike (sasiore dhe cilësore) mbi statistikat e mbetjeve;
- Grumbullimin dhe largimin e pamjaftueshëm të mbetjeve;
- Numrin e kufizuar dhe cilësinë jo të mirë të pajisjeve për grumbullimin dhe transportin e mbetjeve;
- Zbatimin jo të plotë të ligjit dhe në përgjithësi të akteve nënligjore;
- Ndërveprimin dhe koordinimin e dobët të strukturave të qeverisë qendrore me pushtetin vendor dhe sektorët e tjerë të interesuar.

Qëllimi Strategjik: *Përmirësimi i cilësisë së mjedisit dhe shëndetit të qytetarëve*.

Qëllimet e politikës për sektorin deri në 2030 janë:

1. Përmirësimi i menaxhimit të mbetjeve duke përmbushur kërkesat ligjore të planifikimit dhe harmonizimit të kuadrit ligjor me BE;
2. Fuqizimi i ekonomisë qarkulluese mbështetur në kërkim, inovacione dhe përmirësime teknologjike e menaxhimi, dhe angazhimeve të tjera të Shqipërisë në kuadër të Deklaratës së Sofies mbi Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor;
3. Financimi i qëndrueshëm i menaxhimit të mbetjeve;
4. Rritje e ndërgjegjësimit, edukimit dhe përfshirjen e publikut në kuadër të mbrojtjes së mjedisit;
5. Rehabilitimi i hotspoteve në të gjithë territorin e vendit.

Qëndresa dhe përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike

Vizioni: *"Një ekonomi e fortë dhe e qëndrueshme për Shqipërinë përmes një rruge me zero emetime dhe Rritje Ekonomike të Gjelbër."*

Shqipëria është një nga vendet me emetimet më të ulta në rajon për sa i takon gazrave me efekt serë, por njëkohësisht vendi më vulnerabël ndaj efekteve të ndryshimeve klimatike, për shkak të katastrofave natyrore që lidhen me klimën si përmbytjet, thatësirat, zjarret në pyje etj. dhe ndikimi i tyre në ekonomi, shoqëruar me kapacitete të pamjaftueshme si duhet për t'u përballur me katastrofa të tilla. Për t'ju përgjigjur kësaj situate Shqipëria ka krijuar kuadrin ligjor në fushën e ndryshimeve klimatike me miratimin e një sërë dokumentesh me rëndësi si ligji për ndryshimet klimatike, Strategjia për ndryshimet klimatike, kontributi kombëtar i përcaktuar dhe plani kombëtar për energjinë dhe klimën 2020-2030.

Qëllimi i politikës:

a) Në përgjigje të situatës aktuale dhe angazhimeve ndërkombëtare, ndërmarrja e një sërë masash në nivel kombëtar për uljen e emetimeve me 20.9 përqind deri në vitin 2030;

b) Të sigurohet mbrojtja e vendit nga efektet e ndryshimeve klimatike përmes masave përshtatëse me fokus në pjesën bregdetare deri në 2030;

c) Zbatimi i Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor.

Masat prioritare:

Është e rëndësishme, përcaktimi, përkufizimi dhe mobilizimi i burimeve financiare dhe burimeve të tjera të nevojshme për ta mbrojtur Shqipërinë nga efektet e ndryshimeve klimatike si dhe kalimin në një rrugë zhvillimi me aftësi rimëkëmbëse ndaj klimës dhe zero emetime.

Ndërhyrjet më të rëndësishme të parashikuara për arritjen e masave prioritare janë:

- Plotësimi i legjislacionit primar dhe sekondar në fushën e ndryshimeve klimatike si dhe integrimi i çështjeve të klimës në të gjithë sektorët e ndikuar deri më 2027;
- Integrimi i masave zbutëse dhe përshtatëse në buxhetimin publik deri më 2025 dhe dokumente strategjikë kombëtarë dhe vendor deri më 2030;
- Ndërtimi i platformës kombëtare të informacioneve dhe shërbimeve për klimën dhe sigurimi i ndërveprimit institucional për përdorimin e këtyre të dhënave deri më 2030;
- Adoptimi dhe zbatimi i qasjeve të integruara, të bazuara në ekosistem(QbE) dhe/ose i zgjidhjeve të bazuara në natyrë në nivel lokal dhe qendror deri më 2027;
- Forcimi i menaxhimit të rrezikut nga fatkeqësitë përmes sistemeve të paralajmërimit të hershëm deri më 2030.
- Reformim dhe forcim institucional e organizativ i strukturave që merren me gjenerimin dhe sigurimin e të dhënave publike mbi klimën dhe efektet e saj në sektorët kyç të ekonomisë, sigurisë dhe shëndetit të popullsisë, si dhe sigurimi i burimeve financiare dhe njerëzore të nevojshme deri më 2030

Planifikimi hapësinor, zhvillimi i qëndrueshëm urban dhe rajonal

Diferencimi rajonal i zhvillimit në Shqipëri mund të shpjegohet me dy shkaqe kryesore të ndërlidhura - niveli i urbanizimit dhe struktura e ekonomisë, që ndikon në produktivitetin e përgjithshëm të punës. Megjithatë, ekzistojnë disa pabarazi rajonale të rëndësishme në nivele të ndryshme territoriale. Shqipëria është tepër monocentrike, me 26 përqind të popullsisë kombëtare dhe 36 përqind e PBB-së së vendit të përqendruar në Zonën Urbane Funksionale të Tiranës. Shqipëria është një vend disi i polarizuar në përgjithësi dhe sidomos në aspektin e potencialit ekonomik - me potencial ekonomik të mbyllur kryesisht në trekëndëshin Durrës - Tiranë - Laç.

Ekzistojnë pabarazi të konsiderueshme ndër- dhe brenda- rajonale. Diferencimi i theksuar ndërmjet qarqeve më të zhvilluara të Tiranës dhe Durrësit dhe qarqeve më pak të zhvilluara të Kukësit dhe Dibrës. Dallime të theksuara ndërmjet zonave urbane dhe rurale, sidomos në drejtim të disa treguesve që kanë të bëjnë me aksesin, shërbimet publike, etj. Në nivel rajonal katër rajonet e planifikimit të zhvillimit statistikor ndahen në dy grupe: Tiranë/Durrës (që dallohet për shumicën e treguesve dhe karakterizohet nga situata më e favorshme e zhvillimit) dhe tre rajone që janë më pak të zhvilluara, më shumë rurale, me rrjet vendbanimesh të fragmentuar, të varura në masë të konsiderueshme nga prodhimi i pakët bujqësor, me cilësi më të ulët të kapitalit njerëzor etj. Për treguesit e kombinuar, situata është më pak favorizuese në veri të Shqipërisë.

Ulja e papunësisë është një objektiv parësor i Politikës Rajonale në Shqipëri. Prioriteti NJERËZIT trajton menaxhimin e ofertës së tregut të punës në mënyrë më efikase dhe efektive. Tre nga katër rajonet kanë zona rurale dhe të largëta ku ofrimi dhe mundësia për shkollim është e pamjaftueshme.

Cilësia e jetës së qytetarëve (dhe imazhi i rajonit për investitorët) lidhet në masë të madhe me ndjenjën e tyre të përgjithshme të mirëqenies. Zhvillimi i një identiteti rajonal domethënës do të përmirësohet ndjeshëm, nëse fondet vihen në dispozicion për të siguruar infrastrukturën rajonale dhe trajnimin e nevojshëm për të

mbështetur këtë aftësi rikuperuese. Për efektivitet rajonal, zhvillimi i korridoreve të mëdha të transportit, do të kërkojë modernizimin e rrugëve lidhëse rajonale dhe lokale, si rrugore ashtu edhe hekurudhore, veçanërisht në ato që aktualisht kualifikohen si me cilësi të keqe ose shumë të keqe dhe që konsiderohen se janë pengesa për rritjen socio-ekonomike. Edhe pse infrastruktura e TIK, mund të zbusë efektet negative të infrastrukturës së dobët të transportit, nuk mund të ofrojë zgjidhje të plotë në lidhje me konjeksionin rajonal.

Shërbimet publike të pakta ose të munguara janë pengesë kryesore që qytetarët të arrijnë një cilësi të pranueshme të jetës. Kjo mangësi është shpesh faktor për migracionin nga zona të tilla veçanërisht të të rinjve dhe gjithashtu ndikon në hezitimin e investitorëve për të zhvilluar bizneset dhe fuqinë punëtore të tyre. Fokusi tek qasjet novatore të riciklimit për reduktimin e mbetjeve dhe mbrojtjen e furnizimit me ujë në një mënyrë të qëndrueshme do të jetë më reagues ndaj nevojave të rajoneve dhe mund të përfshijë qasjet e "teknologjisë alternative" të qëndrueshme dhe të mbështetura në nivel vendor

Shumë njerëz që jetojnë në zona të largëta nuk mund t'i plotësojnë lehtësisht nevojat e tyre të përditshme sa i përket kujdesit shëndetësor / medikamenteve, ushqimit dhe furnizimeve të tjera bazë. Këto mundësi mund të mungojnë për shumë arsye: mosha, dobësia, aftësia e kufizuar, përgjegjësitë e kujdesit ose thjesht mungesa e rregullt e transportit të përballueshëm. Adresimi i nevojave të tilla në mënyrë të strukturuar do të përmirësojë cilësinë e jetës në këto zona.

Ofrimi i mbështetjes për autoritetet lokale që të zhvillojnë dhe zbatojnë më tej zgjidhje novatore dhe të qëndrueshme bazuar në njohuritë në vend të asaj që ka funksionuar deri tani dhe në rrethana specifike lokale mund të çojë në rezultate më të mira dhe më të gjera në nismat tashmë ekzistuese dhe në zgjidhje të reja që mund të përdoren në të gjithë Shqipërinë dhe të ndihmojnë në stabilizimin e këtyre vendbanimeve të largëta dhe t'i bëjnë ato më tërheqëse si vende për të jetuar dhe punuar.

Qytetet dhe qendrat urbane luajnë rol gjithnjë e më të rëndësishëm në mjedisin socio-ekonomik. Ato tërheqin investitorë, ofrojnë mundësi punësimi dhe kontribuojnë në efektin e shpërndarjes së rritjes ekonomike. Sidoqoftë, një qasje e "polit të rritjes" (monopolare) rrezikon përmirësimin në dëm të zonave që ndodhen në afërsi. Një nga problemet më serioze me të cilat përballet Shqipëria, e përbashkët me pjesën më të madhe të Evropës, është urbanizimi dhe shpopullimi i zonave rurale, gjë që zvogëlon mobilizimin e plotë të burimeve më të rëndësishme të saj, të popullit dhe të tokës.

Për këtë arsye, zhvillimi rajonal i bazuar tek vendi i nxitur nga partneriteti në Shqipëri do të fokusohet tek zhvillimi policentrik, i cili synon në mënyrë specifike të sigurojë shpërndarjen e përfitimeve në rrethinat e largëta të zonave të identifikuara të zhvillimit të rajoneve. Vetëm mjedisi i ndërtuar me cilësi të lartë nuk mjafton për të mbajtur popullatën dhe për të tërhequr vizitorë dhe investitorë dhe duhet të plotësohet me jetë komunitare - kulturore, sociale, etj. Fokusi tek komunitetet etnike synon në veçanti ndërtimin e strukturës shoqërore në rajone dhe përdorimin e larmisë kulturore dhe etnike si një mjet për të pasuruar cilësinë e jetës për të gjithë.

Në përfundim, fokusi tek të moshuarit vjen jo vetëm nga të kuptuarit se popullsisë tashmë të moshuar të rajoneve duhet t'u ofrohet mbështetje për të ofruar cilësi më të mirë të jetës, por gjithashtu nga mënyra se si përvoja e tyre mund të përdoret për të pasuruar jetën e të rinjve. Duke ju krijuar të moshuarve mundësi për të komunikuar më lehtë (p.sh. përmes TIK) etj. dhe duke bërë të mundur dhe duke i inkurajuar ata dhe të rinjtë që të ndërveprojnë, komunitetet në Shqipëri fitojnë vlerë të shtuar.

Plani i Përgjithshëm Kombëtar (PPK) "Shqipëria 2030" është instrumenti më i lartë i planifikimit territorial në Shqipëri, i cili adreson në mënyrë të integruar çështjet e planifikimit, duke e parë territorin shqiptar si një të

tërë. Në bazë të parimeve, objektivave dhe specifikimeve të tij, do të detajohen planet e hierarkive më të ulëta, Planet kombëtare sektoriale (PKS), Planet e detajuara për zonat e rëndësisë kombëtare (PDZK), Planet për zhvillimin rajonal (PZHR), Planet sektoriale në nivel qarku (PSNQ), Planet e përgjithshme vendore (PPV) dhe çdo instrument tjetër planifikimi territorial, që buron si rrjedhojë e nevojave për zhvillim.

Vizioni: *Rajonet e Shqipërisë do të përbëjnë një vend më të mirë për të jetuar, si rezultat i një standardi dhe cilësie të rritur të jetesës dhe përmes krijimit të një kuadri socio-ekonomik dhe institucional që do të shtojë mundësitë për realizimin e ambicieve dhe mundësive të rajoneve dhe komuniteteve nën-rajonale dhe lokale. Rajonet e Shqipërisë do të jenë më të forta ekonomikisht, më të integruara në aspektin ekonomik, shoqëror dhe hapësinor, si dhe më autonomë si rezultat i procesit të decentralizimit dhe zbatimit më të gjerë të parimit të partneritetit dhe subsidiaritetit.*

Qëllimi strategjik: *"Përmirësimi i situatës socio-ekonomike dhe cilësisë së jetës të banorëve të të gjitha rajoneve të Shqipërisë nëpërmjet mobilizimit efikas të potencialeve specifike rajonale dhe territoriale dhe zhvillimit më të balancuar dhe të qëndrueshëm rajonal"*

Referenca me Kapitullin përkatës të "Acquis", Kapitulli 22, Politikat Rajonale dhe Koordinimi i Instrumenteve Strukturore.

Qëllimet e politikës:

1. NJERËZIT- Përmirësimi i burimeve njerëzore në rajonet e Shqipërisë nëpërmjet një qasjeje të bazuar në nevojat specifike të qytetarëve të tyre në aspektin e punësimit dhe të të ardhurave;

2. VENDI - Përmirësimi i mjedisit në të cilin njerëzit jetojnë, punojnë dhe pushojnë, me qëllim që të inkurajohet investimi, aktiviteti ekonomik dhe stabiliteti i fuqisë punëtore të kualifikuar;

3. KAPACITETI PRODHUES - Krijimi i vendeve të reja të punës në përputhje me nevojat dhe potencialet specifike të rajoneve të veçanta duke promovuar veçanërisht aktivitetet ekonomike të gjelbra.

Zgjerimi i kërkimit shkencor dhe inovacionit

Shkenca, teknologjia dhe inovacioni në Shqipëri vlerësohen si themelore për një shoqëri të bazuar në dije në të gjitha fazat e zhvillimit ekonomik. Sistemi i kërkimit shkencor përfshin institucionet e arsimit të lartë, institucionet e kërkimit shkencor, zhvillimin e njohurive dhe teknologjisë (novacionin), si dhe ndërmarrjet private që operojnë në fushën e kërkimit, zhvillimit dhe inovacionit. Një ndikim të konsiderueshëm në produktet shkencore ka ushtruar përputhja e veprimtarisë kërkimore me direktivat e BE-së dhe iniciativat Evropiane, veçanërisht programet kuadër Horizont 2020 dhe aktualisht Horizont Evropa.

Strategjia Kombëtare e Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit ka fokus të veçantë në:

- Përmirësimin e infrastrukturës bazë kërkimore në gjendje të mbështesë mjaftueshëm trajnimin universitar në tre nivele (nivele BSc, MSc, PhD);
- Krijimin e ekselencës shkencore në fushat prioritare të kërkimit shkencor;
- Tërheqjen e njerëzve të kualifikuar në sistemin shqiptar të kërkimit;
- Forcimin e lidhjeve ndërmjet organizatave kërkimore shkencore dhe sektorit privat për të nxitur inovacionin si bazë për rritjen ekonomike dhe krijimin e vendeve të punës;

- Përmirësimi i perceptimit publik dhe të kuptuarit të shkencës me qëllim që të gjenerohet ndërgjegjësimi për rolin e inovacionit dhe teknologjive të reja për shoqërinë dhe ekonominë;
- Zhvillimi i një Plani Stimulues, duke siguruar që të garantohen burimet e nevojshme për tërheqjen e fondeve Evropiane me synim rritjen e pjesëmarrjes dhe interesit, përvojës dhe potencialit pjesëmarrës të komunitetit shkencor dhe teknologjik shqiptar në këto programe.

Gjithashtu kjo strategji ka parashikuar një rritje të buxhetit për kërkim shkencor duke synuar nivelin 1 përqind të PBB-së. Por vlerësimet tregojnë se buxheti i dedikuar kërkimit shkencor në Shqipëri arrin deri në 0.2 përqind. Mbështetja financiare aktuale është për infrastrukturën e kërkimit shkencor (laboratorët e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor), për projektet e Kërkim Zhvillimit (R&D), pjesëmarrjen në programet kuadër të Bashkimit Evropian dedikuar kërkimit shkencor, zhvillimit teknologjik e inovacionit, si dhe pjesëmarrjes së talenteve në programet Evropiane të kërkimit shkencor.

Shqipëria ka marrë pjesë në programet e bashkëpunimit ndërkombëtar të BE-së : Erasmus+, Evropa Kreative (Kultura dhe Media), Punësimi dhe Inovacioni Social, Programi për Konkurueshmërinë e Ndërmarrjeve dhe Ndërmarrjeve të Vogla dhe të Mesme (COSME), Drejtësia, Evropa për Qytetarët dhe Agjencia për të Drejtat Themelore të BE-së. Në vitin 2022, Shqipëria nënshkroi Marrëveshjen e Asociimit Horizon Europe, programi më i madh për financimin e kërkimit shkencor dhe invacionit i cili synon të reduktojë ndryshimet klimatike, ndihmon në arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara dhe nxit Konkurueshmërinë dhe rritjen e Bashkimit Evropian.

Në drejtim të inovacionit, krijimi i një ekosistemi të favorshëm për start-up-et është bërë një prioritet për Shqipërinë. Në 2022 u miratua ligji për inovacionin e dedikuar për start-up, i cili parashikon një ndarje të buxhetit të shtetit në mbështetje të ekosistemit të inovacionit. Janë ngritur nisma të shumta të mbështetura nga sektori privat, ofrimi i programeve të përshpejtimit për start-up me potencial të lartë, asistencë teknike, mentorim dhe trajnime për marrëdhëniet me investitorët.

Si pjesë e Agjendës së Ballkanit Perëndimor mbi inovacionin, kërkimin, edukimin, kulturën, rininë dhe sportet, asosiacioni dhe veçanërisht integrimi i Shqipërisë në Zonën e re Evropiane për Kërkim dhe Inovacion (ERA) dhe Zonën Evropiane të Arsimit (EEA) do të shërbejë si nxitës për reformat kombëtare dhe tranzicionin e politikave drejt një sistemi Kërkimi dhe Inovacioni më efikas duke ndihmuar vendin të rrisë kapacitetet e tij dhe potencialin në infrastrukturë si dhe përafrimin e tij të vazhdueshëm me acquis të Bashkimit Evropian .

Qëllimet e politikës për sektorin:

Krijimi i një sistemi kërkimor dhe inovator të aftë të përballojë me sukses sfidat e ardhshme të zhvillimit të vendit të tilla si, rritja e kapaciteteve të burimeve njerëzore, çështje të energjisë, çështje mjedisore, çështje të shëndetit publik, çështje të inovacionit, dhe të kohezionit social.

1. Përmirësimi i cilësisë së kërkimeve në sektorin publik;

2. Forcimi i inovacioneve dhe transferimi i njohurive dhe teknologjive në sektorin prodhues;

3. Specializimi inteligjent, për të mbështetur prioritizimin rajonal në sektorë, fusha dhe teknologji inovative;

4. Përmirësimi i kapaciteteve institucionale të sistemit kërkimor dhe të inovacioneve.

KOHEZIONI SOCIAL

Shtylla e tretë e SKZHIE 2030 ka në qendër të vëmendjes burimet njerëzore si kapitalin më të çmuar në vend, duke synuar ofrimin për të gjithë qytetarët të shërbimeve bazë publike, luftimin e varfërisë dhe nxitjen e punësimit, fuqizimit të sistemit të mbrojtjes shoqërore dhe mbështetjen e shtresave të veçanta dhe në nevojë më të madhe të shoqërisë. Në këto segmente të shtetit qëndrojnë të gjitha ato vlera themelore për lirinë, barazinë, mirëqenien dhe sigurinë e personit dhe pronës. Së bashku me sistemet e mirëqeverisjes, demokracisë dhe shtetit ligjor janë dimensionet njerëzore dhe sociale të Shqipërisë ato që qëndrojnë në themel të rritjes ekonomike.

Arsim cilësor për të gjithë

Shqipëria ka një rrjet të përbërë prej 3,462 institucionesh arsimore të nivelit parauniversitar, prej të cilave 3,218 janë publike dhe 441 private. Sot në Shqipëri funksionojnë 15 institucione publike dhe 27 jopublike të arsimit të lartë ose 14 institucione për 1 milion banorë që është në nivelin e disa vendeve të Rajonit, por mbi nivelin e Bashkimit Evropian – 7 IAL për 1 milion banorë. Shqipëria ka rreth 4,900 studentë në 100,000 banorë, ndërsa raporti bruto i regjistrimit në arsimin e lartë është 59.2 përqind..

Si pjesë e Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA) dhe Procesit të Bolonjës nga viti 2003, Shqipëria është e angazhuar të përmbushë të gjitha angazhimet e Procesit të Bolonjës duke qenë shumë aktive në *Bologna Follow-Up Group (BFUG)*, si dhe të kontribuojë në këtë proces nëpërmjet pjesëmarrjes në grupe të ndryshme pune/këshilluese të BFUG.

Duke nisur nga viti 2015 të gjitha institucionet e arsimit të lartë i nënshtrohen akreditimit të detyrueshëm nga ASCAL-i. Megjithatë, procesi i akreditimit shoqërohet me mbikëqyrje të vazhdueshme të institucioneve të arsimit të lartë për t'u siguruar se ato i përmbahen kushteve të akreditimit.

Struktura e të diplomuarve në Shqipëri ka shpërndarje të ngjashme me atë të të diplomuarve në vendet e BE-së. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë vajzat në vitin 2019 janë "Arsim" me 81.4 përqind, ndjekur nga "Shëndet dhe mirëqenie" me 79.1 përqind dhe "Arte dhe shkenca humane" me 78.2 përqind. Fushat në të cilat janë diplomuar më shumë djemtë janë "Shërbime" me 73.6 përqind, "Inxhinieri, prodhim dhe ndërtim" me 62.6 përqind, dhe "Bujqësi, pyje, peshkim dhe veterinari" me 55.1 përqind.

Platforma *punetembare.al* është e dedikuar posaçërisht dhe tërësisht ndaj punësimit të studentëve të ekselencës në administratë. Përveç praktikës së ofruar nga fakultetet ku studentët kanë kryer studimet, studentëve dhe profesionistëve të rinj deri në moshën 26 vjeçare u mundësohet pjesëmarrja në Programin Kombëtar të Praktikave të Punës në administratën shtetërore, në nivel qendror dhe vendor, dhe institucionet e tjera publike për profesionistë të rinj.

Në vitin akademik 2021-2022 personeli mësimor efektiv në IAL-të shqiptare përbëhej nga 9,897 pedagogë, nga të cilët 5221 me kohë të plotë dhe 4676 me kohë të pjesshme. Raporti i konvertuar student për pedagogë në IAL-të publike është 9 dhe në IAL-të jopublike është 12.

Aplikimi i kandidatëve për studentë nëpërmjet portalit UAlbania ka bërë të mundur ruajtjen e parimit bazë "meritë-preferencë". Vendosja e pragut hyrës të mesatares të Arsimit të mesëm të lartë ka rritur cilësinë e studentëve të regjistruar në programet "Bachelor". Të dhënat tregojnë për një ulje të numrit të studentëve të regjistruar në IAL-të publike dhe një rritje të studentëve të regjistruar në IAL-të jo-publike në tre vitet e fundit akademike.

Pakti për Universitetin mundësoi përgjysmimin e tarifës për të gjithë studentët që janë në cikël të parë apo të integruar të studimeve në IAL-të publike, përjashtimin nga tarifa të gjithë studentëve që janë ekselentë, që kanë mesatare nga 9-10, si dhe të studentëve që vijnë nga kategori në nevojë, pra ose janë me ndihmë ekonomike, ose kanë nevoja të veçanta, ose i përkasin ndonjë kategorie tjetër në nevojë. Pajisja e studentëve me kartën e studentit ishte një nga nismat e Paktit për Universitetin. Shqipëria nuk ka traditë të ofrimit të favorizuar të shërbimeve për studentët. Ndaj, nga shkurti 2018 e në vazhdim, ka pasur një sërë komunikimesh me Komisionin Evropian për përfshirjen e Shqipërisë në Kartën Evropiane të Studentit.

Bashkëpunimi ndërkombëtar në institucionet e arsimit të lartë menaxhohet nga zyrat e marrëdhënieve ndërkombëtare. Këto zyra janë ngritur pothuajse në të gjitha IAL-të shqiptare dhe bashkëpunojnë ngushtë me IAL-të e huaja për njohjen e lëvizshmërisë (mobilitetit) dhe diplomave të huaja të studentëve, legalizimin e dokumenteve, transferimin e studimeve dhe marrëveshjet e ndërsjella. Zyrat e marrëdhënieve ndërkombëtare mbulojnë zbatimin e marrëveshjeve bilaterale dhe shumëpalëshe dhe zbatimin e projekteve ndërkombëtare.

"Fondi i Ekselencës" i krijuar me vendim të Këshillit të Ministrave, mbështet studentë dhe shkencëtarë të rinj të shkëlqyeshëm që pranojnë të ndjekin një program studimi master ose doktoratë në një nga 15 IAL-të më të mirë të botës, sipas renditjes së *Times Higher Education (QS – World University Rankings)* për vitin më të fundit.

Renditja ndërkombëtare që përfshin, pa diskriminim, të gjitha institucionet e arsimit të lartë në Shqipëri është *Webometrics*, i cili mat prezencën dhe vizibilitetin në internet të këtyre institucioneve shquhet për një korrelacion mjaft të mirë me rankimet e tjera ndërkombëtare të IAL-ve më prestigjioze. Rezultatet e një sondazhi të zhvilluar me 14,000 studentë shqiptarë në muajin maj 2020 tregojnë se vetëm 22 përqind e tyre kanë laptop, gjë që flet për shfrytëzim të kufizuar të mundësive që ofron teknologjia.
Indeksi i Barazisë Gjinore mat pabarazitë gjinore në Bashkimin Evropian në përputhje me kontekstin e politikave të BE-së. Indeksi i përgjithshëm i Barazisë Gjinore për Republikën e Shqipërisë për vitin 2017 shënoi 60.4, duke treguar një hendek gjinor të konsiderueshëm. Në të vërtetë, Indeksi i Barazisë Gjinore për Shqipërinë është 7 pikë më poshtë se mesatarja e BE-28 (67.4), me përjashtim të fushës së qeverisjes, ku Shqipëria ka më shumë barazi gjinore sesa BE-28.

Femrat në Shqipëri gjithashtu kanë më shumë të ngjarë të diplomohen në nivele të ndryshme arsimore dhe të kryejnë më shumë shkollim sesa meshkujt. Hendeku në raportin e diplomës bruto midis femrave dhe meshkujve është më i madh në nivele më të larta arsimi dhe femrat pritet të përfundojnë rreth 1.3 vjet arsim shtesë krahasuar me meshkujt (15.5 vjet përkundrejt 14.2 vjet). Kjo diferencë është më e lartë se mesatarja në vendet e OECD-së (17.6 për femrat përkundrejt 16.8 për meshkujt). Të dhënat nga PISA 2018 tregojnë performancë dukshëm më të lartë për femrat sesa për meshkujt në fushat e leximit dhe shkencës.

Në përgjithësi, nivelet e ulëta të shpenzimeve për arsimin ngrenë problematika lidhur me nivelet e aksesit, gjithëpërfshirjes dhe efikasitetit të arsimit. Në vitin 2017, shpenzimet totale për arsimin arritën në 4 përqind (3.1 përqind shpenzime publike dhe 0.9 përqind private) të PBB-së, përqindje që është shumë poshtë mesatares së OECD-së prej 6.3 përqind. Shpenzimet për arsimin janë ulur nga 11.3 përqind e shpenzimeve buxhetore totale në vitin 2010, në 10.9 përqind në vitin 2018.

Gjithëpërfshirja ka qenë në fokus të politikave arsimore në Shqipëri në dhjetëvjeçarin e fundit, duke synuar rritjen e pjesëmarrjes në arsim në fëmijërinë e hershme, si dhe të pjesëmarrjes në arsim të fëmijëve nga grupet vulnerabël. Midis viteve 2008 dhe 2017, Shqipëria ka ngushtuar hendekun e barazisë në qasjen në arsim për nxënësit që vijnë nga grupet më të cenueshme, megjithëse vazhdojnë të ekzistojnë disa sfida kritike, veçanërisht

në parashkollor. Në fushën e infrastrukturës dhe shërbimeve publike, bashkitë janë përgjegjëse për administrimin dhe rregullimin e sistemit arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.

Shqipëria ka një numër të konsiderueshëm shkollash të vogla me klasa të bashkuara kolektive ku nxënës të klasave të ndryshme mësojnë së bashku. Mësimi në klasa të bashkuara zhvillohet në zona rurale dhe zona të thella malore.

Përmirësimi i infrastrukturës shkollore zë vend të rëndësishëm në politikat e shtetit shqiptar. Në vitet 2018 dhe 2019, shpenzimet kapitale të MASR-së kanë arritur shumën prej 6.52 miliardë lekë (~ 53 milion. EUR). Tërmeti i 26 nëntorit të vitit 2019 shkaktoi dëme të konsiderueshme në infrastrukturën shkollore. Sipas të dhënave në dispozicion, 321 institucione arsimore të llojeve të ndryshme nga 11 bashki janë prekur nga tërmeti, prej të cilave 76 janë të papërdorshme dhe duhet të rrënohen, 75 pjesërisht të papërdorshme, por mund të riparohen, ndërsa 170 kanë pësuar dëmtime të lehta.

Reforma kurrikulare në arsimin parauniversitar ka në themel të saj aftësimin e nxënësve për jetën dhe për të nxënit gjatë gjithë jetës, në përmbushje të Rekomandimeve të Parlamentit dhe të Këshillit të Evropës për kompetencat themelore për të nxënit gjatë gjithë jetës. Kurrikula kombëtare kombinon si përmbajtjet e vlefshme që rrjedhin nga traditat e arsimit shqiptar, ashtu dhe çdo element të ripërtërirë, në përputhje me rrymat bashkëkohore.
Edhe pse jo në masë të mjaftueshme, shkollat shqiptare janë pajisur me kompjuterë dhe aksesorë, janë instaluar rrjete lokale kompjuterike, si dhe është bërë e mundur lidhja e tyre në internet.

Përgjegjësia e sigurimit të cilësisë (SC) në Shqipëri ndahet midis tri niveleve të ndryshme: 1) Nivelit qendror, i përfaqësuar nga Agjencia e Sigurimit të Cilësisë së Arsimit Parauniversitar (ASCAP), Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe Qendra e Shërbimeve Arsimore (QShA); 2) Nivelit rajonal/lokal, përfaqësuar nga drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar (DRAP) dhe zyrat vendore të arsimit parauniversitar (ZVAP) që janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar (DPAP) dhe 3) Institucioneve arsimore si ofrues të drejtpërdrejtë të shërbimit.

QËLLIMI STRATEGJIK: Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimit gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqënien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian.

Qëllimet e politikës:

1. Arsim parauniversitar cilësor dhe gjithëpërfshirës që krijon kushte që nxënësit të zhvillojnë njohuri, shkathtësi, qëndrime dhe vlera në pajtim me kërkesat e shoqërisë demokratike; të përballen në mënyrë konstruktive me sfidat e jetës, si dhe të kontribuojnë në ndërtimin e mirëqënies vetjake dhe të shoqërisë.
2. Menaxhim efektiv dhe efiçent i sistemit të arsimit në të gjitha nivelet, i bazuar në mekanizma funksionalë për sigurimin e cilësisë, transparencës dhe llogaridhënies.
3. Arsim i lartë gjithëpërfshirës që plotëson standardet ndërkombëtare të cilësisë, integritetit akademik e transparencës, dhe është promotor i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të vendit.

Sistem i fortë dhe më i aksesueshëm i kujdesit shëndetësor

Kërkesa e sotme për një mënyrë jetese të shëndetshme dhe aktive gjatë gjithë ciklit jetësor është thelbësore për një cilësi të lartë të jetës për të gjitha brezat. Struktura moshore e shoqërisë shqiptare po ndryshon, me

përqindjen e të moshuarve në rritje. Mundësitë më të mira për balancimin e jetës së punës janë një faktor i rëndësishëm i një jete familjare cilësore dhe lejojnë pjesëmarrjen në shoqëri dhe ne aktivitetet e kohës së lirë përgjatë gjithë jetës. Për shkak të ndryshimit të strukturës moshore të popullsisë, do të jetë e nevojshme të rritet më tej fuqizimi i grupmoshave të ndryshme dhe promovimi i jetëgjatësisë.

Një tjetër sfide e madhe për shoqërinë e së ardhmes është sigurimi i shëndetit më të mirë për njerëzit përgjatë gjithë jetës së tyre, pasi plakja e popullsisë nënkupton edhe rritje të sëmundjeve kronike. Reduktimi i pabarazive shëndetësore është një nga sfidat kryesore në krijimin e kushteve për një nivel të lartë ne cilësinë e jetës, ku do të jetë e nevojshme të përmirësohet gjendja shëndetësore e popullatës në të gjitha rajonet, veçanërisht e të moshuarve, komuniteteve të margjinalizuara shoqërore dhe atyre më pak të arsimuara. Në këtë drejtim, do të jetë e nevojshme të përmirësohen zakonet e të ushqyerit dhe ushtrimeve të shëndetshme të fëmijëve dhe të rinjve, dhe, për të krijuar një sistem efektiv të kujdesit afatgjatë për njerëzit që nuk janë në gjendje t'i kryejnë vetë aktivitetet e jetës. Kujdesi për shëndetin mendor do të jetë gjithashtu i rëndësishëm, pasi ai i lejon njerëzit të kuptojnë potencialet e tyre mendore dhe emocionale dhe të përballen me sukses me sfidat, përmes të cilave ata do të mund të kontribuojnë për komunitetet ku ata jetojnë.

Sistemi shëndetësor është i përfshirë në një sërë reformash që garantojnë një qasje të integruar dhe harmonike të sistemit tonë publik në të gjithë hallkat, me shëndetin e qytetarit në qendër të tij. Gjatë viteve të fundit sektori i shëndetësisë ka përmirësuar dukshëm shtrirjen dhe cilësinë e shërbimit përmes transformimit të institucioneve të politikëbërjes shëndetësore dhe sociale në nivel kombëtar, krijimit të institucioneve të reja si Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Urgjenca Kombëtare, Rindërtimi i 300 Qendrave të Kujdesit Shëndetësor Parësor etj.

Qytetarët e referuar në të gjithë nivelet e sistemit shëndetësor publik nëpërmjet sistemit të referimit me pikënisje mjekun e familjes, përfitojnë shërbim shëndetësor të barabartë, pavarësisht nëse kanë apo jo status kontributiv në skemën e sigurimeve shëndetësore. Ky shërbim ofrohet falas ose përkundrejt një tarife të ulët për shërbime të specializuara spitalore. Sistemi publik shëndetësor sot garanton pjesën më të madhe të shërbimeve parandaluese, diagnostikuese dhe trajtuese. Në vitin 2021 për herë të parë ka filluar pilotimi i modelit të ofrimit të shërbimit terciar në nivel rajoni me ndërtimin dhe funksionimin e spitalit të parë rajonal në Fier.

Shpenzimet për shëndetësinë përkundrejt Produktit të Brendshëm Bruto janë rritur nga 2.6 përqind në 2013 në 3.7 përqind në vitin 2021. Kjo rritje është shënuar si rezultat i përmirësimeve të vazhdueshme në sistemin shëndetësor publik dhe financimin e sistemit shëndetësor që ka rezultuar dhe në reduktimin e shpenzimeve nga xhepi për qytetarët në 43 përqind në vitin 2019.

Programet e parandalimit dhe depistimit kanë qenë në fokus, veçanërisht për gratë dhe qytetarët 35 - 70 vjeç. Programi i Kontrollit Mjekësor Bazë filloi zbatimin në vitin 2015 si një program depistimi për zbulimin e sëmundjeve jo-ngjitëse në një fazë të hershme. Progres ka pasur nga viti në vit dhe 40 përqind e grupmoshës së synuar ka përfituar nga programi. Nga viti 2018 janë miratuar edhe dy Programe Kombëtare të parandalimit dhe diagnostikimit të hershëm, Programi i Kontrollit të Kancerit të Gjirit që synon gratë mbi 50 vjeç dhe Programi i Kontrollit të Kancerit të Qafës së mitrës që synon gratë 40 - 49 vjeç.

Të sëmurët kronikë përfitojnë trajtim mjekësor falas nga Lista e Barnave të Rimbursimit (LBR). Rishikimet e fundit të Listës së Barnave të Rimbursimit dhe Marrëveshjet e Çmimit të Konfidencialitetit (MAH), një mekanizëm i ri kontraktues në fuqi që nga viti 2018, ka ndihmuar pacientët me sëmundje tumorale të përfitojnë nga terapi të shtrenjta të kimioterapisë dhe imunoterapisë, falas drejtpërdrejt nga Lista e Barnave me Rimbursim.

Reformat e viteve të fundit në sistemin shëndetësor kanë synuar mbështetjen dhe promovimin e burimeve njerëzore në vend. Një mjek apo infermier në spital sot paguhet 63 përqind më shumë se në vitin 2013. Politikat e rritjes progresive të pagave për personelin shëndetësor do të vijojnë duke synuar që deri në 2025 pagat e bluzave të bardha të rriten me 40 përqind.

Sfidat e sistemit shëndetësor

Menaxhimi i pandemisë Covid-19 vuri përballë një prove të vështirë çdo hallkë të sistemit shëndetësor, duke filluar nga parandalimi, diagnostikimi dhe trajtimi sipas protokolleve më të mira shëndetësore në të gjithë strukturat publike.

Për këtë arsye, vijimi i reformës së sistemit spitalor, që do të rrisë qëndrueshmërinë e sistemit shëndetësor dhe do të shtojë garancitë për një shërbim cilësor dhe të aksesueshëm për qytetarët, do të ofrojë shpërblime sipas meritës për mjekët e stafet dhe transparencë në menaxhimin e fondeve publike nga strukturat spitalore të udhëhequra nga parimi i vetëadministrimit spitalor. Këto çështje si dhe ngritja dhe funksionimi i një sistemi efikas kundër korrupsionit brenda sistemit shëndetësor, do të përbëjnë sfidën kryesore të transformimit të sistemit shëndetësor deri në vitin 2030.

Zhvillimi i sistemit shëndetësor deri në vitin 2030 është i lidhur ngushtë me arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Agjendës 2030 e veçanërisht në OZHQ 3, 2 dhe 5. Shumë prej treguesve të monitorimit të sistemit shëndetësor janë pjesë e sistemit të monitorimit të Agjendës 2030 sikurse dhe të kësaj strategjie. Çështje të rëndësishme të shëndetësisë, si përdorimi i drogës, abuzimi me alkoolin, duhanpirja, siguria ushqimore dhe kequshqyerja, sëmundjet e reja infektive dhe sëmundjet e neglizhuara, ndikimi i faktorëve mjedisorë, përhapja e sëmundjeve tumorale do të vijojnë të jenë në qendër të vëmendjes së zhvillimit të sistemit shëndetësor deri në vitin 2030.

Modernizimi i mëtejshëm i shërbimeve dhe konsolidimi i infrastrukturës digjitale në sistemin shëndetësor përbën gjithashtu një domosdoshmëri për të ardhmen.

Vizioni

Vizioni për sistemin shëndetësor në Shqipëri deri në vitin 2030 synon një qasje të integruar të funksionimit në të gjitha nivelet e sistemit, duke vendosur në qendër shëndetin e qytetarëve. Vizioni mbështetet në tre shtylla kryesore: Kujdes Shëndetësor Universal; Modernizim të Infrastrukturës dhe Teknologjisë Shëndetësore dhe Fuqizimin e Burimeve Njerëzore.

Synimi i reformës është që brenda vitit 2025 do të krijohen katër Polet Spitalore që do të jenë Qendra Reference Diagnostikuese dhe Trajtuese, dhe krahasimisht do të punojmë për transformimin dhe fuqizimin e ofrimit të shërbimit në portën hyrëse të sistemit tonë shëndetësor.

Financimi publik për kujdesin shëndetësor synohet të arrijë 70 përqind të shpenzimeve totale të shqiptarëve për shëndetësinë deri në vitin 2025 *krahasuar me 43 përqind në 2013*, duke siguruar që asnjë familje shqiptare të mos bjerë në varfëri për shkak të pagesës për kujdes shëndetësor. Do të vijojmë të promovojmë jetën e shëndetshme, duke rritur investimet në të gjithë sektorët që lidhen me shëndetin, garantojmë akses të plotë dhe zgjerim të shërbimeve shëndetësore që ofrohen në kohë dhe me cilësi, me besim në moton "më shumë vite jetës dhe më shumë shëndet viteve".

Parandalimi dhe diagnostikimi i hershëm i sëmundjeve tumorale do të vijojë të mbetet një nga prioritetet kryesore, ndërthurur me përfshirjen në skemat e trajtimit të terapive bashkëkohore. Do të hartohet për herë të parë Programi Kombëtar për Kancerin Kolorektal.

Do të konsolidohet Platforma e Integruar e Shëndetësisë Digjitale gjatë gjithë ciklit të jetës, me zgjerimin e sistemeve të shëndetësisë elektronike, krijimin e sistemeve të përgjigjes ndaj epidemive, sistemet e shërbimit farmaceutik dhe rrjetin e Telemjekësisë dhe konsultave ambulatore në çdo nivel të shërbimit, si një garanci për rritjen e transparencës, cilësisë dhe gjurmueshmërisë së transaksioneve në sistemin tonë shëndetësor.

Qëllimet e politikës:

1. Investimi në shëndetin e popullatës gjatë gjithë ciklit të jetës. Shqipëria do vijojë të zhvillohet shoqëruar me stil të jetës së shëndetshme dhe sigurimin e një mjedisi të shëndetshëm.

2. Progresi drejt mbulimit universal shëndetësor nëpërmjet sigurimit të përgjigjes së sistemit shëndetësor ndaj nevojave shëndetësore të popullatës.

3. Fuqizimi i sistemit të integruar shëndetësor përmes fuqizimit të kujdesit shëndetësor parësor, garantimit të efiçencës së shërbimit për sistemin spitalor nëpërmjet krijimit të 4 poleve rajonale të referencës së specializuar.

4. Zhvillimi i Shëndetit digjital nëpërmjet rritjes së rolit të qytetarit në aksesin dhe përdorimin e shërbimeve digjitale në kujdesin shëndetësor.

Rritja e mundësive të punësimit

Gjatë viteve 2014-2021 Shqipëria ka bërë përparim të rëndësishëm që si burrat ashtu edhe gratë të kenë akses në mundësi të shtuara punësimi. Pavarësisht se shkalla e punësimit është përmirësuar ndjeshëm në vitet e fundit, sidomos tek gratë (nga 40 përqind në 2013 në 53.7 përqind në TM2-2021), Shqipëria mbetet pas mesatares së Bashkimit Evropian. Pabarazia gjinore në punësim mbetet problematike, ku shkalla e punësimit të meshkujve tejkalon atë të femrave me 14,1 përqind.

Treguesit e punësimit gjatë viteve të fundit në Shqipëri dëshmojnë për një ulje të shkallës së papunësisë nga 17.5 përqind gjatë vitit 2014 në 11.5 përqind, ose në të njëjtin nivel përpara nisjes së pandemisë, gjatë vitit 2021. Ulja e papunësisë në këtë periudhë vjen si pasojë e krijimit të vendeve të reja të punës, zhvillimit të sektorit privat dhe masave aktive për reduktimin e ekonomisë informale në vend.

Por niveli i papunësisë tek të rinjtë është në nivel shumë të lartë (27.1 përqind në vitin 2021) dhe rreth dy herë më shumë se i njëjti tregues për Bashkimin Evropian (13.9 përqind në të njëjtin vit), duke treguar se të rinjtë në një masë të konsiderueshme nuk arrijnë të gjejnë në treg punë që i përgjigjet pritshmërive të tyre.

Problematikat në tregun e punës nuk janë një veçori e zhvillimeve në Shqipëri por në mënyrë të ngjashme të gjitha vendet e rajonit përballen me sfidat të njëjta. Të dhënat më të fundit tregojnë se gjatë vitit 2019, Shqipëria ka nivelin më të lartë në rajon sa i përket pjesëmarrjes në forcat e punës dhe renditet e dyta, pas Serbisë, sa i përket shkallës së papunësisë.

Një përqindje e lartë e të rinjve as në punësim, as në arsim dhe trajnim (NEET), veçanërisht në më të arsimuarit tregon një tranzicion sfidues të tregut të punës për të rinjtë. Norma e NEET për Shqipërinë në 2020 ishte 27.9, nga 26.6 në 2019 (INSTAT), më shumë se dyfishi i mesatares së BE-27 (12.6 përqind). Në këtë grup, 36,5 përqind klasifikohen si të papunë (INSTAT 2020). Megjithatë vetëm rreth 18,000 të rinj NEET, nga gjithsej që janë mbi 190,000, janë regjistruar në Shërbimin Publik të Punësimit dhe shtrirja duhet të shtrihet përtej këtij grupi që

përfaqëson më pak se 10 përqind të të rinjve NEET. Të rinjtë në Shqipëri aktualisht vuajnë nga disa sfida, duke përfshirë një shkallë të ulët punësimi prej 26.4% sipas Anketës së Forcave të Punës të INSTAT, një nga më të ulëtat në rajon.

Popullsia e Shqipërisë vazhdon në rënie nga viti në vit për çdo vit gjatë dy dekadave të fundit, përjashtuar vitin 2017 dhe ndërkohë mosha mediane e popullsisë është rritur nga mosha 33.2 vite në vitin 2012, në 38.2 vite në vitin 2022. Projeksionet e popullsisë, sipas skenarit të mesëm të ndërtuar nga INSTAT, tregojnë se deri në vitin 2030 popullsia totale e Shqipërisë do të pakësohet edhe me rreth 86 mijë vetë, në vijim të rënies prej mbi 104 mijë vetë gjatë dekadës së fundit 2012-2021. Po kështu, emigrimi jashtë vendit është faktor kryesor në brerjen e fuqisë punëtore në vend pasi hapja e plotë Shqipërisë ndaj botës, lëvizja e lirë e shqiptarëve kryesisht në vendet e Bashkimit Evropian, shoqëruar me emigrimin e paligjshëm drejt vendeve ku ende ka pengesa hyrjeje apo qëndrimi, kërkesa për fuqi punëtore në këto vende, ka ndikuar në rritjen e fluksit të emigrantëve shqiptarë që vazhdojnë të largohen nga vendi.

Synimi strategjik në fushën e punësimit është identifikimi dhe hartimi i politikave të përshtatshme nxitëse në vend për punësimin dhe formimin profesional të fuqisë punëtore me qëllim krijimin e vendeve të punës cilësore dhe mundësive për punësim dhe aftësi në të gjithë vendin, duke ofruar arsim dhe trajnim cilësor për të rinjtë dhe të rriturit, nxitjen e përfshirjes dhe kohezionit social dhe forcimin e sistemit të punës dhe kualifikimeve në treg.

Reforma e sistemit të arsimit dhe formimit profesional (AFP) në Shqipëri është fokusuar kryesisht në përmirësimin e atraktivitetit të sistemit të AFP-së, aksesueshmërinë dhe lidhjet/përshtatjen me tregun e punës, ndërsa përpiqet të sigurojë parimet thelbësore të gjithëpërfshirjes, autonomisë, cilësisë, bashkëpunimit, pjesëmarrjes, lëvizshmërisë dhe diversitetit.

Aktualisht arsimi dhe formimi profesional ofrohet në 35 shkolla publike të arsimit profesional, ku ofrohen 26 drejtime mësimore, 87 profile profesionale dhe për vitin 2021-2022 në shkollat e arsimit profesional studiuan rreth 17.000 nxënës. Numri i vajzave që ndjekin shkollat profesionale është rreth 3.000 nxënëse. Rëndësi i është dhënë gjithëpërfshirës në shkollat profesionale, ku ndjekin mësimin rreth 616 nxënës nga komuniteti Romë dhe Egjiptian. Numri i nxënësve me aftësi të kufizuar është 153 nxënës.

Financimi buxhetor për shkollat e arsimit të mesëm profesional është rritur dhe me fonde të buxhetit të shtetit, janë rikonstruktuar shkollat dhe reparte të praktikave profesionale duke siguruar mjedise bashkëkohore për procesin mësimor dhe zhvillimin e praktikave profesionale.

Përmirësimi i aftësive për punë dhe inovacioni është një nga tre shtyllat për fuqizimin e konkurrueshmërisë së ekonomisë shqiptare, sipas programit të qeverisë, së bashku me përmirësimin e klimës së biznesit dhe investimeve, dhe funksionimin e një mbrojtjeje efektive sociale. Qeveria ka identifikuar sektorët e turizmit, teknologjisë së informacionit, energjisë dhe bujqësisë si parësorë për zhvillimin e vendit. Për këtë arsye, së bashku me sektorët e përmendur më sipër, që mundësojnë punësim më të vrullshëm për shqiptarët dhe ku niveli i produktivitetit krijon premisa për rritje të nivelit të mirëqenies së qytetarëve përmes investimeve dhe zhvillimit të sektorit privat, është e nevojshme që të aftësimi i të rinjve dhe të rejave si dhe atyre të angazhuar në punë t'i paraprijë kërkesave që këta sektorë do të kenë për tregun e punës gjatë dekadës së ardhshme në përputhje me stadin e zhvillimit të tyre.

Vizioni: *Punësim cilësor dhe aftësim i vijueshëm për të gjithë*

Qëllimet e Politikës:

1. Zhvillimi i aftësive dhe lidhje më e mirë e kërkesës me ofertën në tregun e punës për punësim më të lartë
2. Mundësimi i punësimit të denjë nëpërmjet zbatimit të politikave gjithëpërfshirëse të tregut të punës

Fuqizimi i mbrojtjes shoqërore dhe sigurimeve shoqërore

Mbrojtja shoqërore është komponent themelor i një qeverisjeje të mirë dhe të hapur. Një jetë dinjitoze për të gjithë brezat dhe grupet sociale është përgjegjësi dhe angazhim për të gjithë shoqërinë. Ajo lind nga respektimi i dinjitetit njerëzor. Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të mbrojtjes dhe mbështetjes sociale siguron reduktimin e pabarazive social-ekonomike, ofron mekanizma të duhur për të mbrojtur të gjithë individët në nevojë, me aftësi ndryshe ose të përjashtuar, nëpërmjet programeve parandaluese dhe riintegrimit social si edhe atyre për mbrojtjen e shëndetit dhe punës. Gjithashtu përveç fuqizimit të mbrojtjes shoqërore do të punohet fort për sigurimin e një niveli të ulët të pabarazisë së të ardhurave dhe asaj pasurore.

Skema e Ndihmës Ekonomike (NE) është instrumenti kryesor për "zbutjen dhe lehtësimin e varfërisë" në vend. Aktualisht janë 64,000 familje, të cilat përfitojnë pagesat e NE-së. Sipas të dhënave të fundit të Anketës së të Ardhurave dhe Nivelit të Jetesës për vitin 2020, Treguesi i rrezikut për të qenë i varfër në Shqipëri, është 21.8 përqind, duke pësuar një rënie prej 1.2 pikë përqindje krahasuar me vitin 2019. Masa e ndihmës ekonomike është rritur gjatë këtyre viteve dhe është dyfishuar masa për familjet me shumë fëmijë dhe gratë kryefamiljare. Gjithashtu, masa e ndihmës ekonomike është trefishuar për kategoritë si jetimë dhe viktima të dhunës e të trafikimit. Me këto rritje masa mesatare është rritur me 72% duke arritur në vlerën 9,400 lekë. Në vitin 2020 janë vlerësuar 621.504 individë që jetojnë nën kufirin e rrezikut për të qenë të varfër. Kjo tregon se niveli i përgjithshëm i të ardhurave familjare të disponueshme është rritur dhe numri i individëve në rrezik për të qenë të varfër është ulur me rreth 5.7 përqind. Përfitimet sociale, si pensionet e pleqërisë dhe ato familjare, të përfshirë në të ardhurat familjare të disponueshme, ndikojnë në uljen e rrezikut për të qenë i varfër.

Një nga elementet kryesorë të reformës së mbrojtjes sociale është përdorimi me efikasitet i Regjistrit Kombëtar Elektronik të NE-së që përdoret për procesin e aplikimit për ndihmë ekonomike, kontrollin e kryqëzuar të informacionit etj. Masa mesatare e ndihmës ekonomike është rritur me 50 përqind duke arritur në vlerën 8,700 lekë. Shpenzimet për NE janë rritur në vlerë absolute gjatë viteve të fundit. Pagesës në cash i shtohen edhe subvencione dhe kompensime të tjera siç janë subvencionet shtesë të ndjekjes së arsimit të detyruar, vaksinimin e fëmijëve dhe kompensimin e energjisë elektrike. Me gjithë rritjet e vazhdueshme në masën e ndihmës ekonomike, ndikimi i saj në uljen e varfërisë mbetet i kufizuar.

Sfidat kryesore që duhen trajtuar lidhur me skemën e ndihmës shoqërore përfshijnë:

- konsolidimin e skemës dhe transformimin e programit të Ndihmës Ekonomike në skemë integrimi nëpërmjet krijimit të mundësive për punësim nëpërmjet zbatimit të Programit të Daljes nga skema e NE;
- rritjen e kapaciteteve të strukturave qendrore, rajonale dhe vendore, në fusha që përfshijnë administrimin, monitorimin dhe vlerësimin e skemës së Ndihmës Ekonomike;
- zhvillimin e koordinimit të skemave me vende të tjera të rajonit dhe me BE-në.

Qëllimi i politikës: Deri në vitin 2030, të ndikohet në zbutjen e varfërisë duke rritur shënjestrimin e individëve, fëmijëve dhe familjeve të varfra, si dhe integrimin social të tyre, duke rritur në 50 përqind pjesën e përfituesve të përfshirë në skemat e punësimit, duke e kthyer nga një skemë pasive në një skemë aktive.

Mbrojtja Sociale: Personat me Aftësi Ndryshe

Politikat dhe strategjitë e Qeverisë së Shqipërisë për përfshirjen sociale të Personave me Aftësi Ndryshe janë në përputhje me objektivat e Konventës së Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara [37] dhe Strategjisë Evropiane të Aftësisë së Kufizuar 2021-2030.

Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar përmirëson cilësinë e jetës së personave me aftësi të kufizuara duke zgjeruar rrjetin e integrimit të shërbimeve sociale, nëpërmjet punësimit dhe formimit profesional, në bashkëpunim me pushtetin vendor. Mbulimi Universal Shëndetësor mbetet një angazhim i Qeverisë Shqiptare, nëpërmjet ofrimit të shërbimeve shëndetësore të aksesueshme. Ofrimi i kujdesit shëndetësor cilësor në gjithë territorin dhe rritja e kapaciteteve në qendrat shëndetësore ka përmirësuar vlerësimin e aftësisë së kufizuar. Gjithashtu vijon rimbursimi i plotë i ndërhyrjes së implantit koklear për fëmijët që nuk dëgjojnë. Miratimi i Ligjit "Për përkthimin zyrtar dhe profesionin e përkthyesit zyrtar" solli një risi nëpërmjet përkufizimit ligjor të rolit të përkthyesit të gjuhës së shenjave për personat që nuk dëgjojnë.

Personat me Aftësi Ndryshe përfitojnë dhe nga ndihma juridike falas. Ligji nr. 20/2021 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 44/2012 "Për shëndetin mendor" i ndryshuar, përmirësoi kuadrin ligjor për mbrojtjen ligjore në fushën e çrregullimeve të shëndetit mendor. Ligji Nr.15/2019 "Për Nxitjen e Punësimit", në dispozitat e tij ka parashikuar krijimin e një Fondi Social të Punësimit, i cili do të përdoret për programe që synojnë punësimin, vetëpunësimin, rehabilitimin në punë dhe shërbimet mbështetëse për personat me aftësi të kufizuara.

Arsimi gjithëpërfshirës është një nga fushat e Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuar me rritjen e numrin e mësuesve ndihmës dhe prioritizuar qendrat burimore në arsimin special. Skema e aftësisë së kufizuar mbështet aktualisht 161,286 individë , nga të cilët 72,757 persona janë invalidë pune që përfitojnë si nga pagesat e sigurimeve shoqërore ashtu edhe nga pagesat shtesë të skemës së mbrojtjes sociale dhe 70,490 fëmijë e të rritur, që marrin pagesat e aftësisë së kufizuar dhe përfitime të tjera në sistemin e mbrojtjes sociale dhe 18,039 kujdestare (ndihmës personal).

Reformimi i sistemit të vlerësimit përmban këto komponentë (a) rishkrimin e kritereve për vlerësimin e aftësisë për realizimin e detyrave bazë të jetës në përputhje me moshën, (b) krijimin e një procesi të ri vlerësimi shumëdisiplinor me disa hallka informacioni e pika verifikimi, (c) përdorimin e regjistrit elektronik kombëtar, (d) rishikimin e procesit të ankimimit, (e) përmirësimin e procesit administrativ për të parandaluar e shmangur abuzimin.

Sfidat kryesore që duhen trajtuar lidhur me skemën e aftësisë së kufizuar lidhen me krijimin e një sistemi shërbimesh integruese që kombinon shërbimet e kujdesit social me pagesat në para, duke ofruar një paketë të integruar shërbimesh për personat me aftësi të kufizuar, punësimi i personave me aftësi të kufizuar, aksesueshmëria etj.

Vizioni: *Përfshirja dhe pjesëmarrjen e Personave me Aftësi ndryshe në të gjitha sferat e jetës, rritja e aksesueshmërisë, pavarësisë dhe lirisë së zgjedhjes, pa dallim dhe në përputhje me standardet ligjore ndërkombëtare.*

Lidhja me PKIE: Kapitulli 19; Nënkapitull Përfshirja Sociale dhe Personat me Aftësi të Kufizuar

Lidhja me OZHQ: OZHQ: 1,4,8,10,11,16

[37] KDPAK është ratifikuar me Ligj Nr. 108/2012 "PËR RATIFIKIMIN E KONVENTËS SË OKB për Personat

Qëllimet e Politikës:

1. Realizimi i aksesit në mjedise, shërbime, transport dhe informacion për personat me aftësi të kufizuara;

2. Garantimi i aksesit të barabartë në sistemin e drejtësisë për të gjithë personat me aftësi të kufizuara;

3. Rritja e pjesëmarrjes në tregun e punës dhe nxitja e mundësive të barabarta për punë të denjë për personat me aftësi të kufizuara;

4. Sigurimi dhe ofrimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe cilësor për të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuara;

5. Përmirësimi i cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara nëpërmjet shërbimeve/përfitimeve

të aksesueshme, të përballueshme financiarisht dhe që kanë në qendër klientin.

PËRFSHIRJA SOCIALE

Qëllimi Strategjik i Politikës 1: *Mbrojtje, integrim dhe gjithëpërfshirje, nëpërmjet mënjanimit të pabarazive dhe diskriminimit për Romët dhe Egjiptianët, personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në nivel kombëtar dhe vendor, vajzat dhe gratë viktima të dhunës, trafikimit dhe shfrytëzimit.*

Romët dhe Egjiptianët

Plani Kombëtar i Veprimit për Barazinë, Përfshirjen dhe Pjesëmarrjen e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025 është në përputhje me objektivat socialë ekonomikë të Programit të Qeverisë, në përgjigje të Strategjisë së BE-së për Romët dhe të Deklaratës së Partnerëve të Ballkanit Perëndimor të Poznanit për integrimin e romëve. Treguesit socialë dhe ekonomikë janë më të ulët për grupet vulnerabël si Romët dhe Egjiptianët duke theksuar nevojën për politikat në trajtimin e pabarazive dhe aksesin në arsim punësimi dhe strehim. Plani Kombëtar për Romët dhe Egjiptianët 2021-2025 , është i harmonizuar me parimet për Platformën e Përfshirjes së Romëve 2021-2030.

Qeveria e Shqipërisë vendosi të mbështesë familjet rome që nuk përfitonin nga ndihma ekonomike. në të gjitha aspektet e jetës shoqërore veçanërisht qasjen në arsim, punësim, strehim, shërbime shëndetësore dhe sociale, për të përmirësuar cilësinë e jetës dhe mirëqenien si dhe mori masa për parandalimin e përhapjes së COVID-19 dhe për vazhdimësinë e shërbimeve sociale për Romët dhe Egjiptianët.

Sfidat

Përjashtimi social dhe pabarazitë ekzistuese në arsim, shëndetësi dhe strehim. Vlerësimi intensitetit, shkaqeve, dhe llojeve të varfërisë në kontekstin zhvillimor dhe institucional. Sfidë mbetet matja e varfërisë me fokus grupet vulnerabël. Nevojitet bashkëpunimi i përforcuar i qeverisjes qendrore dhe vendore për analizën e shërbimeve dhe zhvillimin e planeve të shërbimeve sociale në njësitë e qeverisjes vendore, në mënyrë gjithëpërfshirëse.

Mbrojtja dhe të drejtat e Fëmijëve

Vitet e fundit ka pasur progres në drejtim të plotësimit të kuadrit ligjor dhe të politikave që synojnë promovimin dhe respektimin e të drejtave të fëmijës në të gjithë sektorët: drejtësi, shërbime shoqërore, arsim, shëndetësi dhe kulturë. Është hartuar dhe plotësuar kuadri ligjor për të drejtat e fëmijës, me miratimin e ligjit nr. 18/2017, "Për të drejtat dhe mbrojtjen e fëmijës", si dhe të 18 akteve të tij nënligjore.

Raporti i konsultimeve me fëmijët dhe të rinjtë në kuadër të hartimit të këtij dokumenti, nxori në pah shqetësimin e fëmijëve që prindërit të zbatojnë më mirë "Të drejtën e fëmijëve për t'u dëgjuar". Nga mënyra sesi e parashtruan fëmijët shqetësimin e tyre, qëndrimet dhe praktikat e të rrituve (përfshirë, prindër, kujdestarë, ofrues shërbimi, vendimmarrës, politikanë etj.) në të gjitha mjediset duhet të transformohen për të përfshirë në mënyrë kuptimplotë fëmijët, përfshirë ata me aftësi të kufizuara në marrjen e vendimeve që ndikojnë jetët e tyre. Mekanizmat e përfshirjes së fëmijëve duhet të forcohen për t'i bërë ato të qëndrueshme, dhe josporadike.

Dhuna fizike, emocionale dhe psikologjike, si dhe ajo seksuale ndodhin sot në shtëpi, shkollë, komunitet dhe botën virtuale. Dhuna online, në kontekstin e vendit, është një rrezik dhe shqetësim që kërkon të trajtohet më vete për shkak të veçorive dhe risive që ajo paraqet. Sa i përket trajtimit të formave të ndryshme të dhunës tek fëmijët, ka ende mungesa në ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes së fëmijëve, që nga identifikimi i hershëm, referimi dhe trajtimi i tyre.

Shkolla është një element i rëndësishëm i mjedisit mbrojtës të fëmijës dhe është parë se dhuna midis bashkëmoshatarëve nuk konsiderohet problem i veçantë në Shqipëri, ndonëse mund të jetë nënraportim. Në anketimin e HBSC 2017/2018, rreth 22 përqind e fëmijëve raportonin se kishin pësuar të paktën një episod bulizmi në shkollë, me prevalencë më të lartë tek djemtë sesa vajzat (përkatësisht 24 përqind kundrejt 20 përqind) . Këto shifra nuk janë të papërfillshme dhe tregojnë që mund të nevojitet hartimi i një politike të përkushtuar për arsimin parauniversitar në fushën e parandalimit dhe adresimit të çdo lloj dhune dhe abuzimi, përfshirë bulizimin dhe ekstremizmin në shkolla.
Sistemi shëndetësor përfaqëson mundësinë më të mirë për të identifikuar dhe referuar rastet e dhunës të familje. Deri më tani, kjo mbetet shumë pak e realizuar. Ndonëse legjislacioni parashikon si duhet të funksionojë sistemi i referimit të rasteve të identifikuara në nevojë për mbrojtje për sektorin e shëndetësisë ka nevojë për udhëzues dhe instrumente praktike për specialistët e këtyre fushave për të zbatuar siç duhet interesin më të lartë të fëmijës dhe

Sfidat

Pavarësisht, arritjeve të viteve të fundit për të evidentuar më tepër tregues zyrtarë statistikor me përqëndrim fëmijët, mbetet shumë për të bërë nga INSTAT-i, ministritë dhe institucionet në vartësi, dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për të prodhuar, analizuar dhe më së shumti përdorur të dhënat për politika e masa efektive. Mungesa e analizave të përditësuara të situatës së fëmijëve, kryesisht grupeve më vulnerabël, është evidente, duke rrezikuar që nevojat e tyre të mbeten të panjohura plotësisht dhe të papërmbushura.

Buxhetimi për fëmijët është një fushë veprimi për të cilën ka ende sfida në të kuptuarin dhe zbatimin e tij. Në këtë drejtim kërkohet që të investohet në kapacitete dhe të planifikohen burimet e duhura për të zhvilluar në mënyrë periodike analizë buxhetore me përqendrim tek fëmijët, si dhe ngritje kapacitetesh për buxhetimin me qendër fëmijën.

Vizioni: *Krijimi i një mjedisi të favorshëm për mirëqënien e fëmijëve nëpërmjet aksesit në shërbime cilësore, praktikave pozitive të pjesëmarrjes, prindërimit të mirë, eliminimit të çdo forme dhune dhe të zhvillimit në botën digjitale.*

Lidhja me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm:

OZHQ 1. Jo varfëri – fundi i varfërisë në të gjitha format e saj kudo.

OZHQ 2. Zero uri.

OZHQ 3. Shëndet i mirë dhe mirëqënie.

Qëllimi 4. Sigurimi i arsimit gjithëpërfshirës dhe me cilësi të barabartë dhe promovimi i mundësive të të mësuarit gjatë gjithë jetës.

OZHQ 5. Barazia gjinore.

OZHQ 8. Punë e denjë dhe rritje ekonomike.

OZHQ 10. Reduktimi i pabarazive.

OZHQ 16. Paqe, drejtësi dhe institucione të forta.

Qëllimet Strategjike të Agjendës për të Drejtat e Fëmijëve

1. Qeverisja e mirë në funksion të respektimit, mbrojtjes dhe përmbushjes së të drejtave të fëmijëve;
2. Eliminimi i të gjitha formave të dhunës dhe mbrojtja e fëmijëve;
3. Sistemet dhe shërbimet miqësore për fëmijë dhe adoleshentë;
4. Promovimi i të drejtave të fëmijëve në botën digjitale.

Mobiliteti social

Përfshirja sociale për grupet vulnerabël shënjestron pabarazitë dhe mosdiskriminimin në nivelin vertikal dhe horizontal. Politikat synojnë rritjen e potencialit njerëzor dhe krijimin e mundësive të barabarta, pavarësisht nga sfidat sociale-ekonomike. Qasja në shërbime shëndetësore dhe mbrojtje sociale, arsim, punësim e formim synon në veçanti fuqizimin e grupeve të veçanta. Reformat në legjislacion për grupet në nevojë kanë sjellë një ndryshim cilësor në mirëqenien dhe përfshirjen sociale gjatë zbatimit të SKZHI 2015-2020. Grupet e rrezikuara nga varfëria ose përjashtimi social si Personat me aftësi të kufizuara, fëmijët në nevojë, R/E. LGBTI,+ përballen me pengesa që pengojnë pjesëmarrjen e tyre të plotë dhe efektive në shoqëri, në baza të barabarta me të tjerët.

Strategjitë dhe Planet Kombëtare për kategori të ndryshme përmbajnë masa dhe ndërhyrje që ndikojnë drejtpërdrejt në mirëqenien dhe lëvizshmërinë sociale. Në tërësinë e Dokumentit të Politikave të Përfshirjes Sociale do të zhvillohet koncepti i fuqizimit të grupeve në nevojë në kontekstin e mobilitetit social.

Barazia Gjinore

Zbatimi i përshpejtuar i normave dhe standardeve ndërkombëtare për fuqizimin e grave dhe barazinë gjinore, qëndron në themel të veprimeve qeverisëse. Qeveria e Shqipërisë edhe në kuadër të perspektivës së integrimit në BE prej vitesh tashmë ka vënë në prioritet fuqizimin e kuadrit ligjor dhe institucional në lidhje me barazinë gjinore, dhunën me bazë gjinore e dhunën në familje, duke synuar njëkohësisht dhe harmonizimin e këtij kuadri ligjor kombëtar me atë ndërkombëtar, bazuar veçanërisht në: Konventën e Kombeve të Bashkuara mbi Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) dhe Protokollin Shtesë të saj, Deklaratën dhe Platformën për Veprim të Pekinit, Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm, Konventën e Këshillit të Evropës për Parandalimin dhe Luftën e Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, Strategjinë e Barazisë Gjinore 2020-2025 të Bashkimit Evropian dhe Planin e Veprimit për Barazinë Gjinore (GAP III) 2021-2025, etj. Arritjet janë të shumta dhe në një tërësi fushash, ku ndër më kryesoret përmendim:

Pjesëmarrja e grave dhe të rejave në vendimmarrje: Indeksi i Barazisë Gjinore në vend, i publikuar për herë të parë në vitin 2020, sipas metodologjisë Evropiane, e rendit Shqipërinë më mirë se mesatarja e anëtarëve të BE-

së në fushën e pushtetit, ku zbatimi i kuotave gjinore ka rezultuar në një rritje të ndjeshme të përfaqësimit të grave në jetën politike dhe vendimmarrje:

- Në legjislaturën 2021-2025, gratë zënë 50 mandate nga 140 gjithsej, ose 35.7 përqind janë gra/të reja deputete dhe 90 burra/të rinj ose 64.3 përqind. Krahasuar me legjislaturën 2017-2021 kemi një rritje prej 3,2 përqind (11 gra/të reja më shumë në 2021 krahasuar me 2017); Nga totali prej 1,871 grave/të rejave, 732 gra/të reja ose 39 përqind kandiduan për deputete në zgjedhjet e 2021;
- Kryetarja e Kuvendit 1 grua; nënkryetare/nënkryetarë 1 grua dhe 1 burrë; nga 8 Komisione të Përhershme gjithsej 4 ose 50 përqind drejtohen nga gra;
- Qeveria aktualisht drejtohet nga: 1 Kryeministër burrë, 1 zëvendëskryeministre grua dhe përbëhet nga 16 ministre/ministër nga të cilët 12 gra dhe 4 burra;
- Pushteti vendor: Nga zgjedhjet vendore të 2019 rezultojnë 8 kryetare bashkie gra nga 61 bashki gjithsej (ose 13 përqind). Krahasuar me vitin 2016 ku ishin 6 kryetare bashkie ose 9.8 përqind kemi një rritje prej 3.2 përqind. Gratë në Këshillat Bashkiakë përbëjnë rreth 44 përqind të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve.

Vendimmarrja dhe biznesi[38]: Në vitin 2020, përqindja e grave pronare ose administratore në ndërmarrjet aktive është 25,5 përqind nga 25,4 përqind që ishte në vitin 2019. Përqindja e pronareve ose administratoreve gra është më e lartë në ndërmarrjet e vogla (me 1- 4 të punësuar) me 25,8 përqind gra, përqindje kjo e njëjtë, krahasuar me vitin 2019.

Huamarrës dhe depozitues sipas gjinisë[39]. Të dhënat e Bankës së Shqipërisë pasqyrojnë diferenca të vogla midis burrave dhe grave, gjatë periudhës 2016-2020. Në vitit 2020, numri i huamarrësve në bankat tregtare ishte 338.871, prej të cilëve 56,8 përqind ishin burra dhe 43,2 përqind ishin gra. Gjatë periudhës 2017-2020, numri i huamarrësve gra edhe pse më i ulët se i burrave ka ardhur në rritje.

Punësimi dhe politikat e punësimit[40]**.** Shkalla e punësimit për popullsinë 15-64 vjeç është 77,1 përqind për burrat dhe 61,2 përqind për gratë e kësaj grupmoshe. Hendeku gjinor në paga është 6,6 përqind. Pra burrat kanë një pagë mesatare mujore bruto 6,6 përqind më të lartë sesa gratë. Krahasuar me vitin e mëparshëm, në vitin 2020 vihet re një ulje e hendekut gjinor në paga me 3,5 pikë përqindje, etj.

Raporti i Vlerësimit të Strategjisë Kombëtare të Barazisë Gjinore për vitet 2016- 2020[41] gjithashtu tregoi realizimin e kësaj strategjie në masën 80 përqind, ndërsa të qëllimit strategjik të fuqizimit ekonomik të grave dhe burave në masën rreth 75 përqind, duke evidentuar kryesisht:

- Rritje të pjesëmarrjes së grave dhe burrave në tregun e punës apo rritje të aksesit të barabartë në programet punësimit e formimit profesional;
- Rritje të përfshirjes së vajzave e të rejave në fushat e studimit të lidhura me shkencën dhe inovacionin;
- Përmirësim në ofrimin e shërbimeve shëndetësore për gratë e zonave rurale;
- Përmirësime ligjore për të drejtat pronësore mbi tokën bujqësore;

[38] INSTAT "Gra dhe burra në Shqipëri, 2021". Shiko: http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf (fq.107)
[39] Po aty
[40] INSTAT "Gra dhe burra në Shqipëri, 2021". Shiko: http://www.instat.gov.al/media/8713/burra-dhe-gra.pdf (fq.70)
[41] MSHMS "Strategjia Kombëtare për Barazinë Gjinore 2021-2030". Shiko: https://shendetesia.gov.al/wp-content/uploads/2021/07/Strategjia-Kombetare-per-Barazine-Gjinore-2021-2030.docx

- Ngritjen e Mekanizmave të Koordinuar të Referimit (MKR) të rasteve të dhunës në familje në mbarë vendin (61 bashki) etj.

Pavarësisht sa më sipër dhe me gjithë rastet e shumta të njohjes zyrtare dhe përparimin e bërë, barazia midis grave dhe burrave, të rejave dhe të rinjve, vajzave dhe djemve në jetën e përditshme ende nuk është bërë realitet. Raporti mbi Indeksin Global të Boshllëkut Gjinor 2021[42] i Forumit Ekonomik Botëror e rendit Shqipërinë në vendin e 25 në listën prej 156 shtetesh, me rreth 77 përqind të boshllëkut gjinor të plotësuar (ndërkohë që dy shtetet kryesuese kanë plotësuar rreth 85 përqind të boshllëkut gjinor).

Vizioni: "*Një shoqëri e cila vlerëson barazinë dhe drejtësinë gjinore si kushte të domosdoshme drejt zhvillimit të qëndrueshëm social, ekonomik e politik të vendit, fuqizon të gjithë individët për të gëzuar të drejta dhe mundësi të barabarta në të gjitha fushat e jetës, nuk lejon që askush të mbetet pas, si dhe mbështetet në parimin e tolerancës zero kundër praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore e dhunës në familje, duke ndëshkuar dhunuesit dhe duke mbrojtur, rehabilituar e riintegruar personat e dhunuar*".

Qëllimet e politikës:

1. Mbështetja për rikuperimin e pasojave ekonomike të Covid-19 dhe përfshirja e barabartë e grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet, në ekonominë mjedisore dhe digjitalizim;
2. Pjesëmarrje, përfaqësim dhe udhëheqje e barabartë e grave, të rejave dhe vajzave nga të gjithë grupet në vendimmarrjen politike e publike;
3. Zvogëlimi i të gjitha formave të praktikave të dëmshme, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës në familje;
4. Aplikimi i integrimit gjinor si mjeti kryesor për arritjen e barazisë dhe drejtësisë gjinore në shoqëri.

LGBTQI+

Gjatë periudhës 2016-2020 janë bërë përmirësime të ndjeshme në drejtim të trajtimit të personave LGBTQI+ në Shqipëri, në aspektin legjislativ, të shërbimeve në përgjithësi dhe atyre të dedikuara (si p.sh. funksionimi dhe mbështetja edhe nga ana e shtetit për Strehëzën LGBTQ), si dhe në mbështetjen dhe bashkëpunimin me OJF e specializuara apo të ngritura nga vetë personat LGBTQI+.

Sa u përket ndryshimeve legjislative, janë bërë hapa pozitivë për ndihmën juridike dhe strehimin social. Ndryshimet e bëra në fund të 2020 në ligjin për mbrojtjen nga diskriminimi[43] parashikuan përkufizimin lidhur me gjuhën e urrejtjes dhe forma të tjera diskriminimi në përputhje me standardet e Këshillit të Evropës. Sa i përket strehimit, vlerësohet përfshirja e personave LGBTQI+, si grup përfituesish në ligjin nr. 22/2018, "Për strehimin social" dhe zbatimi i këtyre ndryshimeve për disa persona LGBTQI+, kryesisht në Tiranë.

Për të avancuar më tej në lidhje me mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të personave LGBTQI+ si dhe për një ofrim të shërbimeve sa më cilësore, u përgatit dhe miratua me VKM 700 datë 18.11.2021 "Plani Kombëtar i Veprimit për personat LGBTI+ 2021-2027", i përputhur me plotësimin e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm(OZHQ) dhe me Agjendën 2030.

Vizioni: "*Një shoqëri gjithëpërfshirëse që u mundëson personave LGBTI+ lirinë për të qenë vetvetja, mosdiskriminim, trajtim, mundësi dhe qasje të barabartë në shërbime publike cilësore e të përshtatura sipas nevojave, si dhe pjesëmarrje aktive në të gjitha fushat e jetës pavarësisht nga shprehja e identitetit gjinor, orientimi seksual, karakteristikat e seksit apo nga tërësia e karakteristikave të tjera individuale të tyre*".

[42] Shiko: Global Gender Gap Report 2021: https://www3.weforum.org/docs/WEF_GGGR_2021.pdf (fq.10)
[43] Ligj nr. 124/2020, "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10221/2010, 'Për mbrojtjen nga diskriminimi'

Qëllimet e politikës:

1. Përmirësimi i aksesit të personave LGBTQI+ në shërbime publike dhe shërbime mbështetëse të specializuara efektive, cilësore dhe të disponueshme në mbarë vendin;
2. Rritja e aksesit të personave LGBTQI+ në sistemin e drejtësisë;
3. Krijimi i një shoqërie gjithëpërfshirëse, pranuese dhe jodiskriminuese kundrejt personave LGBTQI+ në Shqipëri.

ZHVILLIMI I SHËRBIMEVE TË INTEGRUARA SHOQËRORE

Zhvillimi i shërbimeve shoqërore udhëhiqet nga tre parime thelbësore, të cilat janë përshkruar si reforma 3D (tre dimensionale), përkatësisht: Deinstitucionalizimi që ka të bëjë me transferimin e institucioneve rezidenciale dhe kalimin e kujdesit dhe shërbimeve nga institucione të mbyllura e të ofruara për një kohë relativisht të gjatë, në shërbime me bazë komunitare, të cilat janë me kosto më të ulët dhe më pranë nevojave të qytetarëve; Diversifikimi, që ka të bëjë me promovimin e modeleve të reja të sigurimit të shërbimeve shoqërore të integruara, nga ofrues publikë dhe jo-publikë; si dhe Decentralizimi, transferimi i të drejtave, detyrave dhe përgjegjësive sa më pranë pushtetit vendor, si një mënyrë për të afruar shërbimet tek qytetari.

Rregullimi i mekanizmit të financimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror ka sjellë rritjen e shërbimeve komunitare të ngritura sipas nevojave të vlerësuara të kategorive vulnerabël nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planet sociale vendore. Aktualisht ofrohen 493 shërbime sociale, krahasuar me 228 shërbime që ofroheshin në 2019. Nga këto 154 shërbime parashoqërore: 46 përqind e shërbimeve sigurohen nga institucione publike, ndërsa 42 përqind e tyre sigurohen nga institucione jo publike. Totali i përfituesve për vitin 2021 është 42,553, krahasuar me rreth 10.000 përfitues në 2019. Nga këta 22,553 në institucione publike, 11,509 në institucione jopublike dhe 8,511 në institucione të përziera. Fondi Social, ngritja, funksionimi dhe metodologjia e financimit, të rregulluara me dy Vendime të Këshillit të Ministrave (respektivisht Nr. 11/2018 dhe Nr. 150/2019) ka për qëllim:

- Përmirësimin e standardeve e të kapaciteteve administruese të shërbimeve ekzistuese;
- Planifikimin e krijimin e shërbimeve të reja si dhe zhvillimin e politikave sociale.

Deri më sot (2020-2022) janë financuar 27 shërbime të reja në 26 Bashki, dhe 13 shërbime të specializuara në 6 Qarqe, me një vlerë prej 539 mln ALL, ku kanë përfituar shërbime 10,477 përfitues nga të gjithe kategoritë vulnerabël.

Me reformën institucionale janë ndarë rolet dhe kompetencat e qeverisjes qendrore dhe vendore qartazi për herë të parë në këtë ligj. Në çdo bashki po ngrihet një strukturë e posaçme për shërbimet shoqërore, si njësi më vete e strukturës së bashkive, duke ndarë detyrat e koordinatorit shoqëror që merret me pagesat Cash nga detyrat e një punonjësi të dedikuar për shërbimet në familje, i cili duhet të jetë një figurë profesionale.

Gjatë viteve 2018-2020 bashkitë për herë të parë hartuan, kostuan dhe miratuan nga Këshilli Bashkiak planet sociale, të mbështetura nga ekspertiza e Agjencive apo Organizatave Ndërkombëtare. Bazuar në projektet, tashmë të parashikuara në planet sociale, janë financuar modele të reja shërbimi: shërbimeve lëvizëse për shërbimet në familje për fëmijët me AK, shërbimi fuqizimi për fëmijët e familjet, dhe shërbimi i strehimit emergjent për viktimat e dhunës në familje, si dhe janë hartuar standardet të reja për këto modele shërbimesh.

Sfidat e politikës lidhen me krijimin e një sistemi funksional të integruar të kujdesit shoqëror të bazuar në parimin e decentralizimit dhe deinstitucionalizimit, për përfshirjen e grupeve vulnerabël në programet e mbrojtjes sociale. Konkretisht:

1-Shndërrimi i shërbimeve rezidenciale në shërbime të kujdesit shoqëror të integruara në komunitet, emergjence, me shërbime alternative etj, në masën më të madhe të mundshme, sipas modeleve/tipologjive të reja të shërbimeve.

2-Plotësimi dhe fuqizimi i të gjitha njësive të vetëqeverisjes vendore me strukturat e shërbimeve sociale/Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit.

3-Integrimi i shërbimeve në nivel vendor me programe të tjera mbështetëse në arsim, punësim dhe formim profesional për kategoritë në nevojë, duke trajtuar rastin nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit të Informacionit të Shërbimeve të Kujdesit Social, të integruar me sistemet e tjera kombëtare.

Qëllimi i politikës: *Çdo person dhe familje shqiptare, siç janë kategoritë në nevojë, do të ketë qasje të barabartë dhe do të përfitojnë nga një sistem funksional dhe i integruar i shërbimeve të kujdesit shoqëror, bazuar në parimet e decentralizimit, deinstitucionalizimit dhe diversifikimit të shërbimeve të kujdesit shoqëror.*

SISTEMI I SIGURIMEVE SHOQERORE

Si rezultat i strategjisë së zhvilluar në 6 vitet e fundit evidentohet një rritje e ndjeshme e të ardhurave nga kontributet e cila kryesisht është pasojë e rritjes së numrit të kontribuesve, sepse efekti mesatar i rritjes së tyre për shkak të rritjes së pagës minimale është jo shumë i lartë ose rreth 13 përqind. Krahasuar me vitin 2013, që konsiderohet si viti bazë i reformës së pensioneve 2014, të ardhurat nga kontributet në vitin 2021 janë rritur me 43,413 miliardë lekë ose 84.5 përqind më shumë. Rritje e ndjeshme evidentohet edhe në numrin e kontribuesve, i cili është edhe faktori kryesor i rritjes së volumit të të ardhurave. Krahasuar me vitin 2013 numri i personave të mbrojtur në vitin 2021 është rritur me mbi 229,600 persona ose rreth 40.9 përqind më shumë.

Krahas rritjes së të ardhurave, rritje të ndjeshme kanë pësuar edhe shpenzimet, në totalin e të cilave mbi 98 përqind i përkasin transfertave në buxhetet familjare, pasi kosto e administrimit është mesatarisht rreth 1,8 përqind të shpenzimeve gjithsej të periudhës. Shpenzimet për përfitime në vitin 2021 krahasuar me 2013 janë rritur me 52 miliardë lekë ose me rreth 55 përqind. Këto përfitime të rritura me rreth 55 përqind, janë adresuar në buxhetet e familjeve të pensionistëve ndërkohë që indeksi akumulativ i çmimeve të mallrave të konsumit ka një rritje prej rreth 23.6 përqind. Pjesa tjetër e rritjes i referohet shtimit të numrit të përfituesve, futjes së skemave të rimbursimit të çmimeve kryesisht energjia elektrike, vendosjes së skemave të veçanta pensionale për profesionet e vështira si në kuptim të skemave të reduktimit të moshës ashtu edhe të rritjes së të ardhurave nëpërmjet shtesave mbi pension si dhe shtesës së përfitimeve nëpërmjet shpërblimeve të fundvitit.

Instituti i Sigurimeve Shoqërore ka realizuar indeksimin e pensioneve në vite sipas vendimeve, me indeksin e çmimeve të shportës së pensionistëve, ku indeksi kumulativ i çmimeve të mallrave të konsumit për periudhën 2014-2021 ka një rritje prej rreth 23.6 përqind. Gjithashtu është realizuar indeksimi i pensioneve në masën 2.7 përqind për vitin 2021. Në vite është realizuar zbatimi i vendimeve për dhënien e kompensimeve për efekt të heqjes së fashës së konsumit të energjisë elektrike dhe ndryshimeve të çmimit të energjisë elektrike.

Qëllimet e Politikës:

1. *Qëndrueshmëri financiare e skemës së sigurimeve shoqërore;*

2. *Ruajtja dhe përmirësimi i standarteve të jetesës për pensionistët dhe të moshuarit duke siguruar të ardhura më të larta.*

STREHIMI

Ligji "Për strehim social", i miratuar në vitin 2018 ka zgjeruar mundësitë e adresimit të nevojës për strehim për shtresat dhe grupet më të pa favorizuara të shoqërisë. Ligji përcaktoi gjithashtu edhe një kuotë vjetore për familjet e minoritetit Rom e Egjiptian që do të përfitojnë çdo vit nga programet e strehimit të mos jetë më i ulët se 5 përqind. Gjatë periudhës 2016 – 2021 janë adresuar nevojat për strehim të rreth 13,250 familjeve nëpërmjet programeve të ndryshme të strehimit dhe janë akorduar 5.93 miliardë lekë fonde, pa përfshirë fondet e subvencionimit të familjeve të prekura nga tërmeti i vitit 2019.

Dy tërmetet e vitit 2019, nga të cilët ai i nëntorit me përmasa shkatërruese të një numri të konsiderueshëm banesash, kanë ndikuar drejtpërsëdrejti në politikat e strehimit. Përveç nevojës për rindërtimin e banesave të shkatërruara, në dy vite (2020 dhe 2021) janë akorduar 6 miliard lekë për subvencionimin e qirasë në treg.

Sipas raportit të ndërmjetëm të strategjisë për strehim social 2016-2025, Tirana është ndër 7 qytetet kryesore Evropiane për nivelin e papërballueshmërisë së strehimit. Raporti Çmim banesë mbi të Ardhura vjetore familjare, i cili është matësi bazë për përballueshmërinë e strehimit, është 16.49 (raporti 4 – 5 konsiderohet treg i përballueshëm) duke treguar vështirësi për sa i përket përballueshmërisë në tregun e lirë. Çmimet e larta të tregut të banesave, veçanërisht në kryeqytet, aty ky edhe drejtohet fluksi më i madh i migracionit të brendshëm, e ka bërë strehimin të papërballueshëm jo vetëm për shtresat e varfëra dhe grupet e pafavorizuara, por edhe për shtresën e mesme të shoqërisë. Një grup i veçantë prioritar i politikave të strehimit i shpallur edhe nga programi qeveritar 2021-2024 është edhe kategoria e të rinjve dhe çifteve të reja, të cilët për shkak edhe të pamundësisë së strehimit të përballueshëm, shpesh detyrohen të emigrojnë.

Një ndër problematikat kryesore në politikat e strehimit social dhe në zbatimin e Strategjisë është mungesa e të dhënave në nivel vendor. Sistemi elektronik i strehimit është ngritur tashmë por është ende në fazë "kolaudimi" dhe trajnimi me punonjësit e bashkive.

Kushtet e banimit për minoritetin Rom e Egjiptian, por edhe për banorë të zonave rurale, në pjesën më të madhe janë të papërshtatshme dhe nuk plotësojnë nevojat bazë. Strehimi, sipas Kombeve të Bashkuara është një nga elementet e të drejtave të njeriut, ndërkohë që synimi 11.1 i Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm kërkon që brenda vitit 2030, *<u>të siqurohet qasje për të gjithë në strehim dhe shërbime bazë të përshtatshme, të siqurta dhe të përballueshme, dhe të përmirësohen vendbanimet e papërshtatshme</u>*. Arritja e këtyre synimeve kërkon angazhim të burimeve njerëzore, financiare e materiale në një masë rreth 10 herë më të lartë se tradicionalisht.

Vizioni: *Qasje për të gjithë në strehim dhe shërbime bazë të përshtatshme, të sigurta dhe të përballueshme, dhe <u>përmirësim i vendbanimeve të papërshtatshme</u>.*

Qëllimet e politikës:

1. Të sigurojë aksesin në strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, përmirësimin e banesave dhe vendbanimeve për grupe shoqërore në pozita të pafavorizuara dhe integrimin e tyre shoqëror e hapësinor, në mënyrë që askush të mos ngelet pas;
2. Të zgjerojë digitalizimin e sistemit të strehimit dhe mbledhjes së të dhënave për hartimin a rishikimin e politikave;

3. Mbështetje për bashkëpronarët për përmirësimin e efiçencës së energjisë në banesat ekzistuese.

Fuqizimi i rinisë dhe fëmijëve

Organizimi rinor, veçanërisht jashtë kryeqytetit dhe jashtë organizimeve shkollore nuk i përgjigjet situatave dhe sfidave që kalojnë të rinjtë. Organizimi rinor në kuadër të organizatave jo-qeveritare është gjithashtu i vështirë për t'u realizuar për shkak të pagesave të larta që e shoqërojnë regjistrimin e një organizate jo-qeveritare dhe mungesës së përvojës nga ana e të rinjve në këtë proces. Edhe organizimet rinore në shkolla janë kryesisht formale dhe nuk i fuqizojnë të rinjtë.

Në këtë situatë, është parë me përparësi, rishikimi i ligjit të rinisë në tërësinë e tij dhe në veçanti për të rritur rolin e të rinjve në përmirësimin dhe zhvillimin e jetës në komunitet. Takimet me të rinjtë kanë nxjerrë në pah edhe nevojën për një komunikim më efektiv me ta në platformat e komunikimit që përdoren më së shumti prej tyre. Trajtimi i problematikës me të cilën përballen të rinjtë si abuzimet *on-line*, bullizmi, dhuna apo gjuha e dhunshme është pjesë e këtij procesi.

Jo vetëm infrastruktura digjitale por edhe ajo fizike në shërbim të të rinjve mbetet problematike dhe sfiduese. Sigurimi i infrastrukturës për aktivitete rinore do të rriste dhe promovonte veprimtarinë rinore dhe do të siguronte një bazë për zhvillime të mëtejshme për rininë si në çështjet e ndërgjegjësimit të tyre politik, vetëshprehjes dhe promovimit e zhvillimit të punës rinore.

Sipas raportit me zbatimin e politikave të Planit Kombëtar të Veprimit për Rininë 2015 –2020 e kanë lidhur shkallën e realizimit të këtij plani që shkon deri në masën 40 përqind edhe me mungesën e burimeve njerëzore për rininë. Fuqizimi i burimeve njerëzore dhe fuqizimi i organizatave rinore do të rriste edhe përfaqësimin më cilësor të rinisë në rajon e më gjerë duke ndërtuar edhe mbi përvojat pozitive të zbatimit të politikave të programit "Tirana – kryeqyteti Evropian i rinisë" dhe mbi mbështetjen e dhënë për këtë program nga qeveria.

Shkalla e pjesëmarrjes në forcat e punës për të rinjtë e moshës 15 – 29 vjeç, është në nivelet 53 - 54 përqind duke pësuar rritje të lehta nga viti në vit. Edhe shkalla e papunësisë së të rinjve rrotullohet mes shifrave 20 - 21 përqind dhe me ulje të lehta krahasuar në vitet e mëparshme. Shkak për këto ndryshime janë edhe politikat e ndërmarra për nxitjen e punësimit dhe zhvillimi i programeve që fokusohen tek punësimi i të rinjve duke përfshirë elemente si:

- Punësim i subvencionuar për të rinjtë, gratë me fëmijë në ngarkim, të rinjtë e pakicave, ata me aftësi të kufizuara si edhe ata që kthehen nga migrimi;
- Trajnimit nëpërmjet punës;
- Praktika profesionale;
- Punë publike në komunitet;
- Vetëpunësim.

Zhvillimet e fundit që ka ndërmarrë qeveria në lidhje me nxitjen e inovacionit përmes startup-eve, digjitalizimit të shërbimeve dhe zhvillimin e lëndëve të kodimit tregojnë për seriozitetin e masave për t'u përballuar me këto fenomene dhe rëndësinë që i kushtohet punësimit të të rejave dhe të rinjve. Ky proces duhet të shkojë krah për krah me një proces reformimi të shërbimit të këshillimit për karrierë që i ofrohet të rinjve në shkolla apo institucionet e formimit profesional. Rritja e pjesëmarrjes së vajzave në arsimin profesional mbetet një sfidë e rëndësishme për një përfshirje aktive dhe të denjë të tyre në tregun e punës ndërkohë që mungon veprimi sa duhet në nivel vendor për të nxitur dhe zhvilluar punësimin rinor.

Sfidat

- Forcimi i mëtejshëm i mekanizmave për kërkimin dhe aksesin në punë, investimin në shërbime profesionale dhe zhvillimi i aftësive punëkërkuese brenda një mjedisi lejues dhe mundësues për zhvillimin e vetëpunësimit dhe të aftësive sipërmarrëse;
- Lehtësim të aksesit në kredi dhe mbështetje të shtuar qeveritare për krijimin e fondeve për start-up duke i kushtuar shumë rëndësi edhe promovimit të këtyre skemave në çdo bashki si popullatën rinore të bashkisë por edhe për ata që kthehen nga migrimi;
- Punë të zgjeruar për përhapjen e ndërmarrjeve sociale bazuar edhe në udhëzuesit e hartuar në lidhje me këtë formë të biznesit social;
- Krijimin e kushteve mbështetëse për vajzat e reja me qëllim shpërndarjen më të drejtë të punëve në aspektin gjinor;
- Krijimin e alternativave të trajnimit dhe arsimit profesional si një mundësi alternative për arsim dhe riaftësim.

Konceptet për punësimin në Shqipëri lidhen ngushtë me degën e studimit që një e re apo i ri merr në universitet dhe me shanset për t'u punësuar në administratë publike duke kërkuar kështu një hyrje të sigurt në tregun e punës. Shumë të rinj e shohin si problem e jo si mundësi të re faktin që ata punësohen në një fushë që nuk lidhet drejtpërsëdrejti me studimet e tyre universitare. Zhvillimi i sektorit të ndërmjetësimit profesional apo shërbimit të karrierës si përmes zyrave të punës dhe në sistemin arsimor është një tjetër sfidë që kërkon zgjidhje të menjëhershme duke plotësuar edhe kërkesën më kryesore të të rinjve në takimet konsultuese në çdo nivel.

Kuptimi më i mirë i të dhënave të zbërthyera në nivel qarku apo bashkie do të siguronte një shpërndarje më të mirë të degëve të studimit duke i orientuar ato fuqishëm nga tregu i punës e duke zhvilluar programe studimi që lidhen me digjitalizimin dhe automatizimin e proceseve. Mbetet shumë për të bërë në lidhje me format e krimit kibernetik dhe të bullizimit të të rinjve në formë kibernetike.

Në kuadër të programeve si Garancia Rinore që do të mbështetet nga BE duhet gjetur rrugë e mundësi për të sfiduar burokracinë duke i zvogëluar hapat që një e re ose i ri duhet të ndërmarrë për të fituar nga këto programe, duke i bërë shërbimet për rininë më të orientuara e më miqësore kundrejt tyre.

Ligji për Rininë i kushton rëndësi të veçantë zhvillimit të hapësirave rinore të dedikuara për rininë dhe aktualisht qeveria po e mbështet këtë proces. Për më tej në programin qeveritar parashikohet mbështetja financiare për blerjen e apartamenteve nga çiftet e reja e cila lidhet edhe me politikën qeveritare të kalimit nga rindërtim pas tërmetit të vitit 2019 në ndërtime të reja banesash për çiftet e reja dhe ata që kërkojnë jetën e pavarur.

Sfidat:

- Zhvillimi i hapësirave rinore me standarde të përcaktuara dhe në përputhje me kërkesat dhe nevojat e të rinjve;
- Ndërtimi i hapësirave në çdo bashki, përfshirë zonat rurale;
- Krijimi i hapësirave të dedikuara për rininë në mjediset shkollore;
- Ofrimi i shërbimeve dhe mbështetjes së dedikuar për përfshirjen në shkolla;
- Fuqizimi i shërbimeve rinore për të lehtësuar integrimin e të rinjve dhe kalimin e tyre në jetesë të pavarur.

Qëllimet e Politikës:

1. *Të rejat dhe të rinjtë marrin pjesë aktivisht në shoqëri dhe ndihen të fuqizuar për t'u shprehur me zërin e tyre, veçanërisht në strukturat vendimmarrëse si Këshillat Bashkiakë. Politikat ndërsektoriale rinore janë të koordinuara, të bazuara në analiza, me mekanizma të mirë financuar;*
2. *Mbështetet dhe nxitet novacioni rinor dhe rritja e aftësive dhe profesionalizmit të të rejave dhe të rinjve përmes edukimit cilësor në TIK dhe fusha të tjera të zhvillimit digjital duke rritur dhe përmirësuar mundësitë për të hyrë në tregun e punës;*
3. *Mirëqenia aktive, e shëndetshme, fizike, sociale dhe mendore e të rejave / rinjve. Siguria, mbrojtja dhe përfshirja e të rejave/ të rinjve/ në të gjithë diversitetin e tyre, veçanërisht për ata të rinj që janë në situatë rreziku apo mënjanimi social (vulnerabiliteti).*

Lidhja midis qëllimit të politikës dhe Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ)

Qëllimi i politikës lidhet me OZHQ-të 5, 11, 13 dhe 16, të cilat promovojnë një shoqëri paqësore dhe gjithëpërfshirëse që garanton zhvillim të qëndrueshëm dhe synon ndërtimin e institucioneve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse në të gjitha nivelet. Kjo politikë ka lidhje edhe me PKIE 2022-24 veçanërisht në masat që ka parashikuar qeveria për forcimin e demokracisë dhe shtetit të së drejtës që në kuadër të kësaj strategjie përkthehet në forcimin e organizatave rinore, rrjetëzimin e tyre dhe lehtësimin e kushteve për të krijuar organizata rinore.

Fuqizimi i artit, kulturës dhe sporteve

Gjatë viteve të fundit janë forcuar kapacitet institucionale për rritjen e shkallës së pavarësisë së institucioneve dhe përmirësimin e cilësisë dhe performancës artistike dhe kulturore. Legjislacioni në fushën e kulturës është përshtatur me të drejtën komunitare dhe konventat ndërkombëtare ku Shqipëria është palë.

Sfidat në të ardhmen në fushën e artit dhe kulturës lidhen me rritjen e rolit të kulturës në jetën shoqërore dhe në përmirësimin e cilësisë së jetës si dhe rritjen e aftësive konkurruese. Sfida kryesore e sektorit është t'i japë më shumë përparësi produkteve kulturore, si pjesë e programit social, ekonomik dhe zhvillimor brenda vendit, si edhe promovimit të vlerave shqiptare jashtë saj.

Vizioni: "*Artet dhe trashëgimia kulturore e Shqipërisë, si forcë shtytëse për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik dhe shoqëror të vendit*".

Misioni: "*Krijimi i mjedisit të favorshëm për rritjen dhe zhvillimin e shërbimeve dhe produkteve kulturore dhe krijuese në sektorin publik dhe privat*".

Qëllimi strategjik: "*Më shumë vëmendje për artin dhe kulturën*"

Qëllimet e politikës:

1. Përmirësimi dhe zgjerimi i tregjeve kulturore përmes legjislacionit nga i cili do të përfitojnë krijuesit, krijimtaria artistike dhe kulturore dhe trashëgimia kulturore;

2. Ruajtja dhe mbrojtja e trashëgimisë materiale dhe jomateriale kulturore;

3. Nxitja dhe përfaqësimi i vlerave kulturore të arteve dhe trashëgimisë (materiale dhe jomateriale) shqiptare në aktivitete të rëndësishme ndërkombëtare;

4. Mbështetja e krijimtarisë së artistëve shqiptarë dhe shtimi i veprimtarive kulturore dhe artistike;

5. Hartimi dhe zbatimi i një platforme arsimore përmes institucioneve të artit dhe trashëgimisë kulturore dhe sistemit parauniversitar.

Objektivat prioritare në fushën e kulturës, mbështetur dhe në Strategjisë Kombëtare për Kulturën 2019-2025, ndër të tjera përfshijnë:

- Krijimi i një mjedisi të qëndrueshëm ligjor e institucional për zhvillimin e Artit dhe Kulturës
- Nxitjen e mirëkuptimit ndërkulturor, tolerancës, respektit reciprok të nënshtetësisë globale dhe përgjegjësisë së përbashkët
- Mbrojtja dhe promovimi i shumëllojshmërisë kulturore në kuadër të Konventës së UNESCO-s për mbrojtjen e diversitetit të shprehjeve kulturore
- Hartimi dhe pasurimi i *META Data* për treguesit e sektorit etj.

TRASHËGIMIA KULTURORE

Shqipëria është një vend me një histori të jashtëzakonshme, ndërthurje kulturash, me gjurmë që nga lashtësia, për të ardhur tek ato më moderne. Të gjitha këto e bëjnë vendin tonë tërheqës për vizitorin e huaj. Në lëmin e artit, do të vijohet me gjithë përfshirjen, me mbështetjen e krijimtarisë së artistëve shqiptarë, me përfshirjen në aktivitete kulturore të sa më shumë të rinj, duke nxitur aktivitetin e skenës së pavarur kulturore si edhe do në stimulimin e industrisë kreative dhe kulturore, me qëllim zhvillimin dhe promovimin e sektorëve kulturorë dhe synim pavarësimin e tyre në tregun e sotshëm. Në fushën e trashëgimisë kulturore asaj materiale dhe jomateriale do të synohet ruajtja, mirëmbajtja, restaurimi, rijetësimi, regjistrimi, digjitalizimi e promovimi.

Ekonomia inovative bazohet në idenë se dija, inovacioni, teknologjia dhe sipërmarrja janë forcat e zhvillimit ekonomik. Të drejtat e pronësisë intelektuale janë mjeti për mbrojtjen ligjore të atyre forcave lëvizëse. Sektorët që apelojnë për mbrojtjen e të drejtave të autorit dhe të drejtave të lidhura shpesh quhen sektorë të bazuar në të drejtën e autorit ose ***industri krijuese***. Ato gjenerojnë kontribute të drejtpërdrejta dhe të tërthorta në rezultatet dhe zhvillimin ekonomik dhe shihen të jenë të një rëndësie në rritje për arritjen e qëllimeve të rëndësishme kombëtare ekonomike dhe sociale. Ndërkohë vullneti i subjekteve privatë për të rijetëzuar pasuritë e paluajtshme të trashëgimisë kulturore në ansamble historike dhe jo vetëm, ka gjetur gjithashtu mbështetje normative nëpërmjet akteve nënligjore për "Bonusin e Rijetëzimi".

Qëllimi Strategjik: Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore dhe muzeve.

Qëllimi i Politikave

- *Forcimi i rolit të muzeve si institucione të ruajtjes se kujtesës; informimit; formimit si dhe në funksion të turizmit kulturor;*

- *Mbrojtja, restaurimi, rehabilitimi dhe promovimi i integruar i trashëgimisë materiale (qendra historike, ansamble historike urbane, monumente kulture, parqe dhe zona arkeologjikë) si dhe shndërrimi i tyre në qendra të hapura ndaj vizitorëve dhe modele miradministrimi në funksion të zhvillimit të qëndrueshëm dhe turizmit kulturor;*

- *Promovimi i vlerave të trashëgimisë kulturore, rritja e ndërgjegjësimit, aksesit dhe gëzimi publik i pasurive kulturore;*

- *Përmirësimi i kapaciteteve profesionale të sistemit të trashëgimisë kulturore.*

TË DREJTAT E AUTORIT

Ekonomia e të drejtës së autorit nuk është një por e shumëfishtë si funksion i zhvillimeve në sektorët e industrive kulturore, aktorët e tyre, metodat e funksionimit, format e punës, tregjet etj. Objekti i veprimtarisë konkrete të institucioneve është garantimi për mbrojtjen, ushtrimin dhe zbatimin e së drejtës së autorit, të drejtave të lidhura me to dhe të drejtave të tjera në përputhje me detyrimet ndërkombëtare, legjislacionin vendas dhe interesat përkatëse kombëtarë të Republikës së Shqipërisë, për të gjithë subjektet, persona fizikë/juridikë, privatë a publikë, përdorues të pronësisë letrare, artistike dhe shkencore. Autorësia për krijimet e veprave letrare, artistike dhe shkencore është automatike që në krijimin e veprës. Megjithatë, dispozita ligjore përjashtimore mundësojnë regjistrimin vullnetar për veprat e tyre. Mbrojtja e të drejtave të autorit dhe të drejtave të tjera të lidhura me të në Shqipëri ushtrohet në përputhje me instrumentet kombëtarë dhe ndërkombëtarë.

Qëllimet e Politikës

Pronësia Intelektuale në Republikën e Shqipërisë ka objektiva kryesore: përmirësimi i kornizës ligjore, zhvillimi dhe forcimi i kornizës institucionale, forcimi i koordinimit dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve, si në nivelin kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, ngritja e vetëdijes për rëndësinë e sistemit të pronësisë intelektuale.

SPORTET

Zbatimi i politikave në fushën e sportit me qëllim sigurimin e një shërbimi cilësor nëpërmjet sportit elitar dhe sportit në institucionet arsimore dhe forcimin e statusit të të rinjve shqiptarë në të gjitha fushat e jetës si: edukim, punësim, familje, shëndetësi, mjedis, mbrojtje sociale, drejtësi. Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët.

Qëllimi Strategjik: Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport, në përputhje me Kartën Evropiane të Sportit dhe me rekomandimet e organizatave ndërkombëtare në këtë fushë

Edukimi nëpërmjet sportit si një faktor efikas në përmirësimin e shëndetit e të mirëqenies për qytetarët. Krijimin e shanseve të barabarta dhe kushteve për pjesëmarrjen në aktivitete sportive të të gjithë shtetasve shqiptarë mbështetur në të drejtat e njeriut për të ushtruar aktivitet fizik e sportiv, duke krijuar infrastrukturën e duhur ligjore, financiare dhe fizike, rregullimin e marrëdhënieve shtet-institucione sportive.

Zbatimi dhe koordinimi

Koordinimi i punës lidhur me zbatimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim Evropian 2022 – 2030 është një proces i rëndësishëm i cili përfshin disa aktorë të ndryshëm dhe që organizohet në një kombinim të mekanizmave të brendshëm dhe të jashtëm.

Mekanizmat e koordinimit të brendshëm përfshijnë:

- Koordinimin e politikave, i cili udhëhiqet nga Komiteti i Planifikimit Strategjik (KPS), organ i lartë ndërinstitucional i drejtuar nga Kryeministri, i cili përcakton përparësitë e zhvillimit të vendit dhe harmonizon planifikimin e integruar me jetësimin e përparësive.

Ndër të tjera, detyrat e KPS janë: (1) të miratojë drejtimet themelore të Strategjisë Kombëtare të Zhvillimit të Vendit; (2) të miratojë vizionin, afatin, objektivat, kalendarin e përgatitjes së çdo strategjie sektoriale e ndërsektoriale, si dhe të vlerësojë përputhshmërinë e dokumentit të projektstrategjisë për t'i çelur rrugë miratimit; (3) të përcaktojë përparësitë e Këshillit të Ministrave; (4) të miratojë listën e programeve buxhetore, projektet me rëndësi kombëtare, përparësitë e përdorimit të ndihmës së huaj, si dhe listën vjetore të projekteve, për të cilat kërkohet asistencë financiare në programin e IPA-s kombëtare; (5) të miratojë strukturën e organizimit të Grupeve të Menaxhimit të Integruar të Politikave (GMIP) dhe të analizojë funksionimin e këtyre grupeve.

- Koordinimi institucional, udhëhiqet nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) e cila drejtohet nga Drejtori i Përgjithshëm. SASPAC kryen edhe detyrën e Sekretariatit Teknik për Komitetin e Planifikimit Strategjik.
- Koordinimi sektorial i udhëhequr nga GMIP-të. Qasja sektoriale dhe përdorimi i GMIP-ve pritet të forcojë koordinimin e përgjithshëm të politikave qeveritare, programimin dhe zbatimin e iniciativave të integrimit në BE dhe atyre të zhvillimit kombëtar në sektorët prioritarë. Kjo parashikohet të realizohet përmes hartimit të: (1) programeve kombëtare sektoriale që përcaktojnë qasjen e politikave, masat e performancës, kërkesat buxhetore, burimet financiare, marrëveshjet institucionale dhe proceset e monitorimit; dhe (2) programeve të mbështetjes sektoriale që përmbajnë ato elemente të programit kombëtar që mbështeten nga BE dhe partnerë të tjerë të zhvillimit, me instrumente financiare si: Asistenca teknike, hua, grante, mbështetje buxhetore etj. GMIP-të do të drejtojnë dhe koordinojnë në mënyrë të vazhdueshme dhe sistematike, zhvillimin, zbatimin dhe monitorimin e reformave sektoriale në vend. GMIP-të do të garantojnë që KPS-ja dhe komitetet e tjera të larta horizontale në institucione të ndryshme të ruajnë fokusin e tyre strategjik dhe të mbikëqyrin me efikasitet zbatimin e prioriteteve të qeverisë dhe programin në përgjithësi.

Koordinimi me jashtë dhe partneritetet e zhvillimit

Qeveria shqiptare ka marrëdhënie të forta bashkëpunimi me partnerët e saj të zhvillimit, ndaj dhe përgjatë viteve të fundit nëpërmjet këtij partneriteti vendi ka mundur të arrijë shumë prej objektivave të veta kombëtare, sektoriale dhe të integrimit në BE. Me zhvillimin e ekonomisë dhe shoqërisë shqiptare dhe me progresin e vendit drejt objektivit të vet final për t'u anëtarësuar në BE, partneriteti i zhvillimit do të marrë më shumë fokus, duke vënë theksin mbi: (1) menaxhimin e punës me strukturat përgjegjëse lidhur me financimin e huaj, sipas legjislacionit në fuqi; (2) sigurimin e bashkërendimit dhe të bashkëpunimit të vazhdueshëm me të gjithë donatorët/ kreditorët e huaj; (3) mundësimin e komunikimit me institucionet vendase apo të huaja lidhur me bashkërendimin dhe sigurimin e financimeve nga jashtë; (4) drejtimin dhe koordinimin e punës për administrimin e Sistemit Informatik për Menaxhimin e Ndihmës së Huaj (EAMIS) për të mundësuar shkëmbimin dhe përdorimin me efikasitet të të dhënave mbi ndihmën e huaj në Shqipëri; (5) udhëheqjen e punës në kuadër të procesit të monitorimit të efektivitetit të ndihmës së huaj përmes Partneritetit Global për Bashkëpunim Zhvillimor Efektiv (GPEDC).

Monitorimi dhe raportimi

Raportimi vjetor

Monitorimi i zbatimit të SKZHIE 2022 – 2030 është një proces tejet mase shumë i rëndësishëm pasi siguron që implementimi i politikave të pasqyruara në këtë dokument, të ndiqen hap pas hapi nga të gjithë aktorët në mënyrë permanente dhe të vazhdueshme.

Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC) do të punojë për ngritjen e një sistemi monitorimi për Strategjinë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrimin Evropian si dhe për strategjitë e tjera sektoriale dhe ndërsektoriale që do të lindin në harkun kohor 2022 - 2030. Standardizimi i procedurave,

bashkërendimi ndërinstitucional dhe ndihma e ofruar kundrejt ministrive të linjës dhe institucioneve të tjerë të përfshira, do të jenë elementët kryesorë në realizimin e monitorimit të treguesve strategjikë.
Sistemi Informatik për Planifikimin e Integruar (SIPI/IPSIS) do të jetë mjeti kryesor mbështetës në dispozicion të ministrive dhe institucioneve të tjera qendrore për hartimin e dokumentit të SKZHIE dhe monitorimin e zbatimit, duke përfshirë këtu edhe hartimin e raporteve të monitorimit.
Qëllimet primare mbi të cilët do të mbështetet e gjithë pjesa e punës së monitorimit dhe zbatimit kanë të bëjnë me: (1) kontrollin e cilësisë mbi arritjen e një performance sa më të lartë; (2) zhvillimin e një mekanizmi efektiv të zbatimit të SKZHIE 2030; (3) zbatimin e një sistemi monitorimi dhe vlerësimi në rezultatet që mbështesin SKZHIE 2030.
SASPAC do të përgatisë raportet e progresit për ecurinë e SKZHIE 2030 duke konsideruar dhe marrë parasysh në mënyrë të vazhdueshme: (1) vlerësimin e progresit në lidhje me zbatimin e strategjisë; (2) përpunimin e të dhënave të tjera statistikore në dispozicion, me qëllim analizimin e tendencave afatgjata mbi krahasimin e Shqipërisë me vendet e tjera të rajonit; (3) evidentimin në mënyrë selektive të problematikave të hasura gjatë procesit të monitorimit në raport me arritjet dhe objektivat kombëtare afatgjata mbi zhvillimin dhe integrimin e vendit.
Hapat kryesorë mbi të cilët do të ndërtohet procesi i kontrollit të përgjithshëm i ekzekutimit dhe monitorimit të progresit të indikatorëve të SKZHIE 2030 do të jenë: (1) përpunimi i të dhënave dhe nxjerrja e raportit të monitorimit të progresit; (2) vlerësimi i raportit të indikatorëve dhe të arritjeve; (3) marrja e masave të nevojshme për zbatimin e raportit të monitorimit dhe vlerësimit.
Të dhënat e raporteve do të përpunohen në afate kohore të parapërcaktuara me qëllim që institucionet qeveritare dhe partnerët e zhvillimit të përfshirë, do të mund të marrin masat e duhura për realizim sa më të frytshëm dhe efektiv të detyrave respektive.
Sipas rastit, me qëllim krahasimin, përpunimin e kombinuar dhe harmonizimin e rezultateve të nxjerra nga procesi i monitorimit, përpilimi i raporteve vjetore mund të shoqërohet edhe me takime, konferenca vjetore apo diskutime në tryeza të rrumbullakëta me të gjithë aktorët kryesorë të përfshirë në këtë proces.

Treguesit kombëtarë

Procesi i monitorimit dhe zbatimit të SKZHIE 2022-2030 do të monitorohet dhe vlerësohet nëpërmjet të dhënave dhe treguesve të vetëmonitorimit në rang kombëtar mbi informacione vjetore.

Monitorimi i progresit të reformës rregullatore

Reforma rregullatore në Shqipëri vijon të jetë një nga prioritetet kryesore të qeverisë për hedhjen e hapave të sigurt në integrimin në BE. Ndaj dhe hartimi i harmonizuar me kuadrin rregullator të brendshëm dhe me atë të vendeve të Bashkimit Evropian, përbën një pikënisje të mirëfilltë të zhvillimit të politikave dhe strategjive kombëtare. Përpilimi, rishikimi dhe zbatimi i legjislacionit apo i rregulloreve përbën një nga sfidat kryesore institucionale për ministritë dhe agjencitë e ndryshme shtetërore me qëllim për të rritur cilësinë dhe nivelin e legjislacionit dhe të politikëbërjes.

Kosto e zbatimit të SKZHIE 2022-2030

Konsiderata financiare dhe risqe zbatimi

Për periudhën e planifikimit SKZHIE 2030, dinamika e zhvillimit dhe rritjes është parë në bazë të një kombinimi të tre skenarëve, të përcaktuara në kuadrin makroekonomik dhe Programin Kombëtar të Reformave Ekonomike (NERP) 2022-2024: skenari përgjithësues, optimist, bazë dhe pesimist.

Me qëllim ruajtjen e thjeshtësisë së kuadrit dhe përputhjen me parimet e matura fiskale të menaxhimit të financave publike, janë konsideruar vetëm skenarët bazë dhe pesimist, me qëllim një planifikim sa më real financiar për zbatimin e politikave, siç pasqyrohet në SKZHIE 2030.

Pas recesionit të fortë në vitin 2020, ekonomia u rikuperua në vitin 2021, me 8.5 përqind dhe parashikohet të vijojë trendin pozitiv në periudhën afatmesme. Rritja ekonomike parashikohet në 3.7 përqind për vitin 2022 dhe parashikohet të vijojë të qëndrojë afër nivelit prej 3.4 përqind përgjatë periudhës afatmesme. Për vitin 2023 parashikohet që rritja ekonomike të ngadalësohet në 2.6 përqind, e ndikuar nga zhvillimet dhe pritshmëritë për ekonominë globale dhe veçanërisht atë të Bashkimit Evropian.

Gjatë periudhës afatmesme rritja pritet të gjenerohet kryesisht nga kërkesa e brendshme, si nga konsumi privat ashtu edhe nga investimet. Gjithashtu, edhe kërkesa e jashtme neto pritet të ketë efekt neto pozitiv. Eksportet si të mallrave ashtu edhe të shërbimeve (veçanërisht turizmi) pritet të kenë një ecuri të mirë, por njëkohësisht pritet që edhe importet të kenë po ashtu një rritje (në reflektim të rritjes së kërkesës agregate, veçanërisht investimeve), e për rrjedhojë kontributi neto i kërkesës së huaj në afat-mesëm pritet të jetë sërish pozitiv, por më i moderuar se ai i kërkesës së brendshme.

Normat e rritjes reale të PBB në skenarin bazë janë konsideruar si normë mesatare e rritjes për të gjithë periudhën e planifikimit, edhe pse këto norma të rritjes mund të ndryshojnë për shkak të ndryshimit të dinamikës kombëtare, rajonale dhe globale të rritjes. Megjithatë, në dritën e rreziqeve në rritje të situatës të ekonomisë globale, është marrë në konsideratë se niveli si mesatare e skenarit bazë, për SKZHIE 2030, mund të jetë edhe më i ulët se nivelet aktuale të kuadrit makroekonomik dhe [NERP 2022-2024]. Kjo shpjegohet me rreziqet e parashikuara që janë marrë parasysh, në mënyrë që të rrisin qëndrueshmërinë e zbatimit të SKZHIE-së, në rast të zbatimit të faktorëve të jashtëm, përkatësisht:

- Në kuadër të supozimeve të gabuara mbi reagimin e sektorit ndaj masave të reja të politikave afat shkurtër / mesme, ndikimi i politikave të reja në sektor mund të llogaritet gabimisht. Kjo mund të jetë veçanërisht e rëndësishme për aktivitetet që kanë një rëndësi specifike për nivelet aktuale të funksionimit të ekonomisë Shqiptare, si për shembull ndërtimi.
- Zgjerimi i konfliktit ose zgjatja e luftës në Ukrainë mund të shkaktojnë ndërprerje të tjera në zinxhirët e tregtisë globale dhe rritje të mëtejshme të çmimeve të energjisë dhe ushqimeve. Në rast se kushtet e financimit në tregjet ndërkombëtare do të jenë edhe më të shtrënguara, mund të shfaqen rreziqe që lidhen me rifinancimin e borxhit. Qëndrueshmëria e borxhit mund të kthehet në një shqetësim nëse hapësira e kufizuar fiskale do të ezaurohet nga politika të ndërmarra si kundërpërgjigje ndaj çmimeve më të larta të energjisë dhe ushqimeve dhe në kushtet e rritjes së kostove të rifinancimit.

Shtojca 1: Lista e dokumenteve strategjikë

Lista e dokumenteve strategjikë që janë konsideruar gjatë hartimit të SKZHIE-III 2022-2030:

1	Strategjia Kombëtare për Zhvillimin e qëndrueshëm të Turizmit 2019-2023 dhe Plani i Veprimit	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - VKM nr. 413, datë 19.06.2019
2	Strategjia Ndërsektoriale e Drejtësisë 2021–2025 dhe plani i saj i veprimit	Ministria e Drejtësisë - VKM nr. 823, datë 24.12.2021
3	Strategjia Kombëtare e Energjisë 2015 - 2030	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - VKM, nr.480, datë 31.07.2018

4	Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025	Ministria e Kulturës - VKM nr. 903, datë 24.12.2019
5	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit për periudhën 2020-2023	Ministria e Drejtësisë - VKM nr. 516, datë 01.07.2020
6	Strategjia e Sigurisë Kombëtare	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme - Ligji nr. 103/2014 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë"
7	Strategjia Ushtarake e Republikës së Shqipërisë	Ministria e Mbrojtjes - Ligji nr. 72/2015 "Për miratimin e Strategjisë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë"
8	Strategjia Kombëtare për Mospërhapjen e Armëve të Dëmtimit në Masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj	Ministria e Mbrojtjes - VKM nr. 33, datë 22.01.2020
9	Strategjia Afatmesme e Menaxhimit të Borxhit 2021-2023	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr.38, datë 27.01.2021
10	Strategjia e Menaxhimit të Integruar të Burimeve ujore 2018-2027	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - VKM nr. 73, datë 07.02.2018
11	Strategjia Kombëtare e Ujitjes dhe Kullimit 2019-2031 dhe Plani i Veprimit	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - VKM nr. 345, datë 22.05.2019
12	Strategjia për konsolidimin e tokës 2016 - 2030	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - VKM nr. 700, datë 12.10.2016
13	Strategjia e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 405, datë 20.05.2020
14	Strategjia për edukimin ligjor të publikut 2019-2023	Ministria e Drejtësisë dhe Kuvendi - VKM nr. 878, datë 11.11.2020/ Vendim i Kuvendit nr. 47/2019
15	Strategjia Minerare 2010-2025	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - VKM nr. 479, datë 29.06.2011
16	Strategjia e Strehimit Social 2016-2025	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr. 405, datë 01.06.2016
17	Strategjia për kontrollin e armëve të vogla, të lehta, municioneve dhe eksplozivëve 2019-2024 dhe të planit të veprimit 2019	Ministria e Brendshme - VKM nr. 50, datë 6.2.2019
18	Strategjia e zhvillimit të INSTAT 2017- 2030	Instat
19	Strategjia Kombëtare për Diasporën 2021-2025	Ministri i Shtetit për Diasporën - VKM nr. 585, datë 22.07.2020
20	Strategjia e Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat 2020-2024 dhe të planit të veprimit për periudhën 2020-2022.	Ministria e Brendshme - VKM nr. 554, datë 15.07.2020
21	Strategjia Kombëtare për prokurimin publik 2020-2023 dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj	Kryeministri/ Agjencia e Prokurimit Publik - VKM nr. 850, datë 04.11.2020
22	Strategjia Ndërsektoriale e Menaxhimit të Integruar të Kufirit 2021-2027 dhe Planin e Veprimit 2021-2023	Ministria e Brendshme - VKM nr. 1117, datë 16.12.2020
23	Strategjia Ndërsektoriale e Luftës Kundër Terrorizmit 2021-2025 dhe planit të veprimit 2021-2023	Ministria e Brendshme - VKM nr. 1137, datë 16.12.2020

24	Strategjia Kombëtare për Sigurinë Kibernetike dhe planit të veprimit 2020-2025	Zëvendëskryeministri/Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike - VKM nr. 1084, datë 24.12.2020
25	Strategjia Ndërsektoriale e Sigurisë në Komunitet 2021-2026	Ministria e Brendshme - VKM nr. 1139, datë 24.12.2020
26	Strategjia kundër Krimit të Organizuar dhe Krimeve të Rënda 2021-2025 dhe Planin e Veprimit 2021-2022 *(Ndryshim në VKM 1140, dt.24.12.2020)*	Ministria e Brendshme - VKM nr.1140, datë 24.12.2020/ VKM nr. 670, datë 10.11.2021
27	Strategjia e Barazisë Gjinore 2021-2030	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 400, datë 30.06.2021
28	Strategjia për zhvillimin e biznesit dhe investimeve 2021-2027 dhe të Planit të saj të veprimit	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr.466, datë 30.07.2021
29	Strategjia Kombëtare e Arsimit 2021-2026	Ministria e Arsimit dhe Sportit - VKM nr. 621, datë 22.10.2021
30	Strategjia Kombëtare e Shëndetësisë 2021-2030	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 210 datë 6.4.2022
31	Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022 -2025	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr. 350 datë 26.5.2022
32	Strategjia e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Peshkimit 2021-2027	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural - VKM nr. 460, datë 29.06.2022
33	Strategjia Ndërsektoriale Agjenda Digjitale e Shqipërisë 2022–2026	Zëvendëskryeministri/AKSHI - VKM nr. 370 datë 1.6.2022
34	Strategjia Kombëtare e Pronësisë Intelektuale 2022 - 2025	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr. 350 datë 26.5.2022
35	Strategjia e Drejtësisë për të Miturit 2022 -2026	Ministria e Drejtësisë
36	Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2020 - 2023	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 866, datë 24.12.2019
37	Plani kombëtar i kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë dhe plani i veprimit të tij 2019 - 2025	Ministria e Mbrojtjes - VKM nr. 729, datë 13.11.2019
38	Kuadri makroekonomik dhe fiskal i rishikuar 2022-2024	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr. 7, datë 13.1.2021
39	Plani kombëtar i veprimit për personat me aftësi të kufizuara, 2021-2025	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 276, datë 12.05.2021
40	Dokumenti i politikave të reformës së vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019-2024 për zbatimin e tij	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 380, datë 05.06.2019
41	Dokumenti politik kombëtar për moshimin, 2020–2024, dhe plani i veprimit për zbatimin e tij	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr.864, datë 24.12.2019
42	Udhërrëfyesi për politikën qeverisëse drejt një mjedisi mundësues për zhvillimin e shoqërisë civile 2019-2023, *i rishikuar*	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 539, datë 25.07.2019
43	Plani Kombëtar për zhvillimin e qëndrueshem të infrastrukturës digjitale Broadband 2020-2025	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - VKM nr. 434, datë 3.06.2020

44	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë/ Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare - VKM nr. 881, datë 14.12.2016
45	Plani i Integruar Ndërsektorial për Brezin Bregdetar	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe (AKPT) - Vendim i Këshillit Kombëtar i Territorit nr. 2, datë 14.06.2016
46	Plani i Integruar Ndërsektorial i Zonës Ekonomike Tiranë-Durrës (2015-2030)	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (AKPT) - Vendim i Këshillit Kombëtar i Territorit nr. 03, datë 14.06.2016
47	Plani Kombëtar për menaxhimin e cilesisë së ajrit (2019-2025)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - VKM nr. 412, datë 19.06.2019
48	Plani Kombëtar i Veprimit për heqjen nga përdorimi dhe eliminimi i ndotësve Organikë të Qëndrueshëm (2019-2024)	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - VKM nr. 505, datë 29.8.2018
49	Dokumenti strategjik dhe planet kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt sere dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - VKM nr. 466, datë 03.07.2019
50	Plani i veprimit 2022–2024, të Strategjisë për Kontrollin e Armëve të Vogla, të Lehta, Municioneve dhe Eksplozivëve 2019–2024	Ministria e Brendshme - VKM nr. 754, datë 9.12.2021
51	Dokumenti i politikave "Për qeverisjen e Sektorit të Informacionit Gjeohapesinor në Shqipëri 2020-2030"	Zëvendëskryeministri - VKM nr. 402, datë 20.05.2020
52	Plani i menaxhimit të basenit ujor Seman	Kryeministri/ Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore - VKM nr.453, datë 10.06.2020
53	Dokumenti i Politikave Strategjike dhe Planit Kombëtar për Menaxhimin e Integruar të Mbetjeve 2020-2035	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - VKM nr.418, datë 27.05.2020
54	Programi shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - VKM nr. 636, datë 29.07.2020
55	Plani i menaxhimit të basenit ujor Drin-Bunë	Kryeministri/ Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore - VKM nr. 849, datë 04.11.2020
56	Plani i veprimit 2020-2023, të strategjisë për edukimin ligjor për publikun 2019-2023	Ministria e Drejtësisë - VKM nr. 878, datë 11.11.2020
57	Plani kombëtar i frekuencave	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - VKM nr.700, datë 10.11.2021
58	Plani i menaxhimit për Butrintin	Ministria e Kulturës - VKM nr, 583, datë 27.07.2020
59	Agjenda Kombëtare për të Drejtat e Fëmijëve 2021-2026	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 659, datë 3.11.2021
60	Plani Kombëtar i veprimit LGBT 2021-2027	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 700, datë 18.11.2021
61	Plani Kombëtar i veprimit për integrimin e Romëve dhe Egjiptianëve 2021-2025	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale - VKM nr. 701, datë 18.11.2021
62	Programi Buxhetor Afatmesëm 2022 –2024, i rishikuar	Ministria e Financave dhe Ekonomisë - VKM nr.735, datë 3.12.2021

63	Plani i konsolidimit financiar të sektorit publik, elektroenergjitik *(Ndryshim në VKM 253,datë 24.12.2020)*		Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë - VKM nr. 253, datë 24.4.2019/ VKM nr.758, datë 9.12.2021
64	Plani Kombëtar për Energjinë dhe Klimën 2020 – 2030		Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit - VKM nr. 870, datë 29.12.2021
65	Dokumenti i rishikimit të strategjisë së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë		Ministria e Mbrojtjes - VKM nr. 628, datë 25.9.2019
	Strategji Sektoriale në proces	**Institucioni Përgjegjës**	**Statusi**
66	Strategjia sektoriale e Transportit	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Nisur si proces hartimi
67	Strategjia kombëtare e sektorit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, 2020-2030	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Draft i konsoliduar
68	Strategjia Kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë	Ministria e Mbrojtjes	Në pritje për t'u miratuar
69	Rishikimi i Strategjisë për strehim social 2016-2025	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Nisur si proces hartimi
70	Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit 2023-2030	Ministria e Drejtësisë	Nisur si proces hartimi
71	Strategjia Ndërsektoriale për Decentralizimin dhe Qeverisjen Vendore 2023-2030	Ministria e Brendshme	Janë miratuar në KPS propozimet fillestare, vizioni, objektivi, afati
72	Strategjia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi 2023 - 2030 dhe plani i veprimit të zbatimit të saj	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Në fazën para miratimit me VKM, projekt vendimi është dërguar për mendim
73	Strategjia për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe Mbikëqyrjen e Tregut 2030	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Janë miratuar në KPS propozimet fillestare, vizioni, objektivi, afati
74	Strategjia Blue Economy 2023-2030	Zëvendëskryeministri	Janë miratuar në KPS propozimet fillestare, vizioni, objektivi, afati
75	Strategjia kombëtare për shkencën, teknologjinë dhe inovacionin 2023 -	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Janë miratuar në KPS propozimet fillestare, vizioni, objektivi, afati
76	Strategjia e Specializimit Inteligjent	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Është ngritur grupi i punës
77	Strategjia Ndërsektoriale e reformës në Administratën Publike 2023 -	Departamenti i Administratës Publike	Ka filluar procesi i hartimit në prill 2022
78	Strategjia Kombëtare e Sigurisë Ushqimore 2022-	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Para miratimit me VKM, projekt vendimi është dërguar për mendim
79	Strategjia Kombëtare e Rinisë dhe plani i veprimit 2022-2029	Ministria e Shtetit për Rininë dhe Fëmijët	Miratuar me VKM Nr. 692, datë 26.10.2022

Shtojca 2: Lista e treguesve strategjikë të monitorimit

0	Fusha	Treguesi	Burimi	Lidhja me PKIE & Acquis	Lidhja me OZHQ2	Tregues OZHQ	2022	2030
1	Antikorrupsioni	Lufta kundër korrupsionit	Raporti i Prog. Vjetor, BE	Kap. 4, 24, 23 & RAP (PAR)	OZHQ 16		Progres i pjesshëm	Progres i mirë
2	Shërbimet publike	Nr. i personave që marrin shërbime online	AKSHI	Kap. 10, 24 & RAP (PAR)	OZHQ 16		80%	100%
3	Decentralizimi	Kontributi i të ardhurave të qeverisjes lokale në PBB (%)	MFE	Kap.22, 11	OZHQ 16		1.3%	2%
4	Investimet e Huaja Direkte	Rritja e kontributit të IHD në PBB (% PBB)	BSH/ MFE	Kriteri Ekonomik, Kap. 20	OZHQ 8		7%	9%
5	Konkurrueshmëria	Konkurrueshmëria dhe inovacioni 'Të bërit biznes' dhe 'Distanca nga kufiri'	Global Competitiveness Report	Kap. 8, 15, 20	OZHQ 8		67.7	75
6	Konkurueshmëria	Përqindja e eksportit ndaj PBB	INSTAT	Kap. 1,4,8, 12, 17, 20, 30	OZHQ 8		23.7%	30%
7	Konkurrueshmëria	Krijimi i Ndërmarrjeve (nr i bizneseve aktive cdo vit)	INSTAT	Kap.8, 20	OZHQ 8		209,993	230,000
8	Kreditimi i ekonomisë	Niveli i kredisë për ekonominë si pjesë e PBB	BSH/ MFE	Kap.17	OZHQ 8		39%	47%
9	Financat Publike	Niveli i rritjes ekonomike (reale)	INSTAT	Kap.33,32 16,22,5	OZHQ 8	8.1.1 (për person)	3.7%	3.9%
10	Financat Publike	Niveli i borxhit publik (në % e PBB)	MFE	Kap.33,32 16,22,5	OZHQ 17		68.8%	57.7%
11	Financat Publike	Shpenzimet kapitale (në % të PBB)	MFE	Kap.33,32 16,17, 22,5	OZHQ 8		5.6%	5.1%
12	Financat Publike	Niveli i deficitit (në % të PBB)	MFE	Kap.33,32 16,22,5	OZHQ 8		-3.2%	-0.4%
13	Punësimi	Shkalla e punësimit të të diplomuarve nga arsimi profesional	MFE	Kap. 18, 19	OZHQ 8		57.5%	60%
14	Punësimi	Nr. Ndërmarrjeve të drejtuara nga femra në % ndaj totalit	INSTAT	Kap. 18,19,23,24	OZHQ 5	5.2.2	22.7%	35%
15	Punësimi	Hendeku gjinor në punësim në % (15-64 vjec)	INSTAT	Kap. 18,19,23,24	OZHQ 8		14.4%	12%
16	Punësimi	Shkalla e përgjithshme e punësimit në % (15-64 vjec)	INSTAT	Kap. 2,19	OZHQ 8		60.9%	70%
17	Arsimi profesional	Pjesëmarrja në Arsimin Profesional (% e grave ne AFP)	MFE	Kap. 19,23,24	OZHQ 4		14.7%	25%
18	Mirëqenia	PBB/frymë	INSTAT	Kap. 17,16	OZHQ 8		736,700	1,112,500
19	Mirëqenia	Ecuria e mesatares së konsumit në familje	INSTAT	Kriteri Ekonomik, Kap. 19	OZHQ 10		86,241 Lekë	110,000 Lekë
20	Zhvillimi rural & Bujqësia	Shkalla e eksport - importit në bujqësi	INSTAT	Kap. 11, 13	OZHQ 2		1 me 2.8	1 me 2
21	Zhvillimi rural & Bujqësia	Shkalla e rritjes reale ekonomike në sektorin e bujqësisë (%)	INSTAT	Kap. 11, 13,17,22	OZHQ 2		0.15%	1.5%
22	Zhvillimi rural & Bujqësia	Produktiviteti i fermës	MBZHR	Kap .11, 8, 22	OZHQ 2		73.5%	80%
23	Zhvillimi rural & Bujqësia	Eksportet bujqësore	INSTAT	Kap. 11, 12,13	OZHQ 2		478 mln USD	1 mld USD
24	Zhvillimi rural & Bujqësia	Eksporti i produkteve të peshkimit	INSTAT	Kap. 13, 14	OZHQ 2		153 mln USD	200 mln USD
25	Telekomunikacioni	Kapacitetet e lidhjes broadband mbi 100 Mbits (% e lidhjeve broadband me kapacitet >100Mbits)	MIE	Kap.10,21	OZHQ 9		7%	50%

0	Fusha	Treguesi	Burimi	Lidhja me PKIE & Acquis	Lidhja me OZHQ2	Tregues OZHQ	2022	2030
26	Telekomunikacioni	Përdorimi i Broadband/TIK nga individët	MIE	Kap.10	OZHQ 9	17.6.1	79.3%	90%
27	Transporti	Udhëtarë (ajror, detar,hekurudhor) (000 udhëtarë)	MIE	Kap. 14, 21	OZHQ 9	9.1.2	4,197	4,327
28	Transporti	Mallra (ajror, detar,hekurudhor) (000 ton)	MIE	Kap. 14, 21	OZHQ 9	9.1.2	5,473	6,302
29	Transporti	Siguria rrugore: Nr. i aksidenteve per 100,000 automjete	MB	Kap. 14	OZHQ 3	3.6.1	1,376	-20%
30	Energjia	Pesha e burimeve të energjisë së rinovueshme në konsumin e energjisë %	MIE	Kap. 15,27	OZHQ 7	7.2.1	38%	54.4%
31	Energjia	Kapacitetet e instaluara te BRE nga era dhe dielli	MIE / ERE	Kap. 15,27	OZHQ 7		125 MW	300 MW
32	Energjia	Reduktimi i varësisë ndaj importeve të produkteve naftës	MIE	Kap.15, 17	OZHQ 7		1%	10%
33	Energjia	Ulja e humbjeve në rrjetin energjitik	MIE / ERE	Kap.15	OZHQ 7		20%	12%
34	Furnizimi me Ujë	Aksesi në sistemin e furnizimit me ujë	MIE/AKUM	Kap. 27, 11	OZHQ 6	6.1.1	86.5%	96.4%
35	Rrjeti i Kanalizimeve	Aksesi në trajtimin e ujrave të ndotur sipas zonave urbane dhe rurale	MIE/AKUM	Kap. 27, 11	OZHQ 6	6.2.1	60%	74.1%
36	Turizmi	Numri i turistëve të huaj	MTM	Kap. 17, 27, 20,21	OZHQ 8		7,5 milionë	10 milionë
37	Turizmi	Kontributi i Turizmit në ekonominë kombëtare (% e PBB)	MTM	Kap. 17, 27	OZHQ 8	8.9.1	19%	24%
38	Mjedisi	Zonat e mbrojtura si pjesë e territorit	MTM	Kap. 27, 15	OZHQ 15		21%	30%
39	Mjedisi	Pyjet si pjesë e territorit të përgjithshëm	MTM	Kap. 27, 10	OZHQ 15	15.1.1	45.6%	47%
40	Mbrojtja sociale	Fondi social për mbështetjen e pushtetit vendor për zgjerimin e hartës së shërbimeve shoqërore	MSHMS	Kap.19	OZHQ 10		200 mln Lekë	400 mln Lekë
41	Mbrojtja sociale	Integrimi në tregun e punës së personave me aftësi të kufizuar përmes shërbimeve mbështetëse të arsimit, formimit profesional dhe programeve të nxitjes së punësimit, në %	MSHMS/ MFE	Kap. 19	OZHQ 8		3%	3.5%
42	Rinia / Punësimi	Të rinjtë as në punësim, as në arsim apo trajnim (norma NEET) (mosha 15-29 vjeç) në %	INSTAT	Kap. 19	OZHQ 8	8.6.1	26.1%	15%
43	Arsimi	Rezultatet e PISA, mesatarja e matematikës, shkencës dhe leximit	MAS	Kap. 25, 26	OZHQ 4		420	445
44	Financat Publike	Përqindja e shpenzimeve totale të qeverisë për shërbimet thelbësore (arsim, shëndetësi dhe m.sociale)	MAS/ MSHMS/MFE	Kap. 19,26,28	OZHQ 1	1.a.2	17.8%	20%
45	Shëndetësia	Shpenzimet nga xhepi si % e shpenzimeve totale për kujdes shëndetësor	MSHMS	Kap 19, 28	OZHQ 3		43.5%	35%
46	Shëndetësia	Niveli i vdekshmërisë neonatale	MSHMS	Kap 28	OZHQ 3	3.2.2	7.5 / 1,000	3.7 / 1,000
47	Shëndetësia	Përqindja e popullsisë së përcaktuar e mbuluar nga të gjitha vaksinat e përfshira në programin kombëtar	MSHMS	Kap 28	OZHQ 3	3.b.1	95%	98%
48	Shëndetësia	Niveli i vdekshmërisë amëtare	MSHMS	Kap 28	OZHQ 3	3.1.1	3.4 / 100,000	1.5/ 100,000
49	Shëndetësia	Shkalla e vdekshmërisë që i atribuohet sëmundjeve kardiovaskulare,kancerit, diabetit ose sëmundjeve kronike të frymëmarrjes	MSHMS	Kap 28	OZHQ 3	3.4.1	17%	11.7%
50	Strehimi	Familje me të ardhura të ulëta dhe të mesme duke përfshirë familjet në pozita të pafavorizuara që vuajnë nga përjashtimi social, gra kryefamiljare dhe gra të dhunuara që kanë përmirësuar kushtet e banimit	MFE	Kap 23	OZHQ 11	11.1	13,500	35,000

VENDIM
Nr. 89, datë 22.2.2023

PËR KALIMIN TE BASHKITË DURRËS DHE KAMZË TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 6, të nenit 21, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore", miratuar me ligjin nr. 97/2019, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin te bashkitë Durrës dhe Kamzë të 133 (njëqind e tridhjetë e tre) njësive individuale të banimit, përkatësisht, sipas listave të inventarit, që i bashkëlidhen këtij vendimi, detajuar, si më poshtë vijon:

a) Bashkia Durrës 73 (shtatëdhjetë e tre) njësi individuale banimi;

b) Bashkia Kamzë 60 (gjashtëdhjetë) njësi individuale banimi.

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe bashkitë Durrës dhe Kamzë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTË INVENTARI
73 BANESA (PAKETA D) BASHKIA DURRËS

Nr.	ID	Emër Mbiemër	Tipologjia	Sip. (m²)	Bashkia	Njësia administrative	Vlera e objektit (lek)	Vlera e mbikëqyrjes (lek)	Vlera e kolaudimit (lek)
1	3	Skender Dervish Sokoli	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 4	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
2	5	Jemire Qamil Vathi	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 4	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
3	14	Brunilda Vangjel Tilka	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 4	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
4	16	Niko Selajdin Çakëri	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 4	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
5	17	Sotir Selajdin Çakëri	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 4	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
6	21	Durim Gani Mema	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 4	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
7	25	Nikoll Zef Marku	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 4	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
8	26	Andrea Mitro Plaku	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 4	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
9	3	Andi Isa Cengu	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 5	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
10	4	Isa Idriz Cengu	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 5	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
11	5	Armand Halit Sheqi	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 5	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
12	7	Halil Ibrahim Kola	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 5	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
13	1	Nurie Sadik Doçi	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 6	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
14	2	Albert Selman Sadikaj	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
15	5	Adriatik Kujtim Hysenaj	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 6	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
16	6	Dritan Xhemali Doçi	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 6	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
17	10	Trashe Hysen Mehmetaj	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 6	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
18	14	Gjyke Ali Gaxha	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 6	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
19	16	Naim Rexh Hasani	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
20	18	Ardian Halit Muliu	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 6	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
21	19	Hasan Abdi Ficorri	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 6	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
22	21	Vera Dalip Metaj	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 6	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
23	22	Astrit Caush Qypi	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
24	23	Nadire Ismail Cemenja	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 6	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
25	30	Arben Mark Lleshi	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
26	31	Sokol Kujtim Hysenaj	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
27	34	Luan Caush Qypi	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 6	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
28	35	Mark Nikoll Marku	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
29	37	Bari Mehdi Ceka	3+1	105.10	Durrës	Rajoni 6	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
30	39	Ndue Mark Filaj	2+1	80.00	Durrës	Rajoni 6	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
31	42	Belul Kurt Sina	1+1	70.00	Durrës	Rajoni 6	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
32	5	Ylmi Jonuz Meta	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
33	8	Bajame Ali Shqopa	1+1	70.00	Durrës	Katund i Ri	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
34	15	Bujar Shyqiri Tabaku	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
35	16	Have Islam Rexhaj	3+1	105.10	Durrës	Katund i Ri	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
36	20	Sali Dervish Shehu	1+1	70.00	Durrës	Katund i Ri	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
37	21	Dashamir Fiqiri Calama	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80

38	22	Petrit Ibrahim Bakalli	1+1	70.00	Durrës	Katund i Ri	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
39	24	Arben Gjergj Pepa	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
40	13	Ali Bajram Calama	1+1	70.00	Durrës	Katund i Ri	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
41	28	Edmond Avdush Thaci	3+1	105.10	Durrës	Katund i Ri	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
42	30	Ndre Mark Lalaj	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
43	31	Fatbardh Mark Lala	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
44	32	Mikel Mark Lala	3+1	105.10	Durrës	Katund i Ri	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
45	35	Tahir Haxhi Berisha	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
46	37	Jonuz Ramazan Meta	1+1	70.00	Durrës	Katund i Ri	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
47	38	Jonuz Sefer Ruci	1+1	70.00	Durrës	Katund i Ri	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
48	42	Kristaq Pasko Sinjari	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
49	43	Petrit Nazmi Pupa	2+1	80.00	Durrës	Katund i Ri	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
50	48	Sadik Hysen Dobroshi	3+1	105.10	Durrës	Katund i Ri	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
51	52	Kujtim Sali Kokiçi	3+1	105.10	Durrës	Katund i Ri	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
52	2	Myrvete Sheuqet Nuhi	1+1	70.00	Durrës	Sukth	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
53	4	Stefan Sotir Beshiri	1+1	70.00	Durrës	Sukth	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
54	14	Pellumb Osman Zogaj	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
55	22	Ahmet Asllan Miha	2+1	80.00	Durrës	Sukth	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
56	25	Bibe Llesh Arapi	2+1	80.00	Durrës	Sukth	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
57	26	Qemal Osman Demalija	1+1	70.00	Durrës	Sukth	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
58	30	Nafie Jashar Xhafa	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
59	33	Mahmut Zenel Lala	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
60	34	Avni Hysen Isufi	1+1	70.00	Durrës	Sukth	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
61	35	Sokol Hysen Isufi	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
62	53	Ndue Zef Kucaj	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
63	59	Bardhok Zef Frroku	2+1	80.00	Durrës	Sukth	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
64	61	Selim Idriz Basha	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
65	64	Luan Islam Kurti	2+1	80.00	Durrës	Sukth	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
66	67	Ilir Llambi Zaka	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
67	78	Bedri Zaim Beshiri	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
68	79	Dylaver Hysen Sabliqi	3+1	105.10	Durrës	Sukth	3,000,000.00	15,924.84	1,897.80
69	81	Lime Ismail Hoxha	1+1	70.00	Durrës	Sukth	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
70	85	Skender Hasan Kaculi	2+1	80.00	Durrës	Sukth	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
71	4	Latif Qerim Gjuzi	2+1	80.00	Durrës	Rrashbull	2,400,000.00	15,924.84	1,897.80
72	5	Damin Haxhi Telha	1+1	70.00	Durrës	Rrashbull	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80
73	6	Avni Myslim Hida	1+1	70.00	Durrës	Rrashbull	2,100,000.00	15,924.84	1,897.80

LISTË INVENTARI
60 BANESA (PAKETA E) BASHKIA KAMZË

Nr.	ID	Emër Mbiemër	Tipologjia	Sip. (m²)	Bashkia	Njësia administrative	Vlera e objektit (lek)	Vlera e mbikëqyrjes (lek)	Vlera e kolaudimit (lek)
1	7	Fetah Oruçi	1+1	70.00	Kamzë	Bathore	2,180,000	16,319.25	1,897.80
2	8	Lezam Mollaj	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
3	9	Fatmir Selmani	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
4	14	Rame Dunisha	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
5	20	Fisnik Manjani	1+1	70.00	Kamzë	Bathore	2,180,000	16,319.25	1,897.80
6	92	Halit Dardha	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
7	94	Selman Demiri	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
8	107	Gjergj Niklekaj	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
9	108	Luljeta Dedaj	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
10	110	Ali Brati	1+1	70.00	Kamzë	Bathore	2,180,000	16,319.25	1,897.80
11	112	Manual Poka	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
12	1	Ilir Tufa	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
13	33	Lindita Kallçaku	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
14	34	Lindita Hoxha	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
15	35	Hashim Hoti	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
16	37	Sokol Imeri	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
17	38	Flamur Mejdani	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
18	41	Xhelal Dragjoshi	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
19	42	Viktor Mejdani	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
20	47	Bukurije Shehu	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
21	48	Meliha Fusha	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
22	49	Ali Hajollari	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
23	50	Qazim Mici	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
24	51	Mexhit Muceku	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
25	54	Ramazan Bulku	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
26	55	Jurgen Vladi	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
27	56	Trendafile Mehmeti	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80

28	57	Sami Cara	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
29	58	Sherif Bulku	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
30	64	Jorgo Ago	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
31	68	Lije Dybeli	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
32	69	Halil Tusha	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
33	70	Selman Cani	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
34	71	Sen Sefa	1+1	70.00	Kamzë	Kamzë	2,180,000	16,319.25	1,897.80
35	73	Mentor Kurti	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
36	77	Reshat Selmanllari	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
37	80	Skender Likometi	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
38	81	Nurie Vrapi	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
39	88	Astrit Suçi	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
40	114	Qemal Dragjoshi	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
41	117	Ibrahim Ahmetaj	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
42	133	Zenel Erceku	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
43	135	Petrit Hasa	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
44	141	Musa Pasmaçiu	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
45	146	Bajram Pirra	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
46	163	Ilirian Kishta	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
47	172	Murat Qerimi	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
48	173	Qemal Laçi	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
49	177	Xheladin Haka	1+1	70.00	Kamzë	Paskuqan	2,180,000	16,319.25	1,897.80
50	4	Shkelqim Tershalla	1+1	70.00	Kamzë	Bathore	2,180,000	16,319.25	1,897.80
51	6	Elez Selimaj	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
52	11	Ibrahim Axhami	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
53	74	Skender Gjokmeli	3+1	105.10	Kamzë	Kamzë	3,170,000	16,319.25	1,897.80
54	82	Ilir Luzi	2+1	80.00	Kamzë	Kamzë	2,500,000	16,319.25	1,897.80
55	95	Fatmir Shima	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
56	99	Simon Markaj	2+1	80.00	Kamzë	Bathore	2,500,000	16,319.25	1,897.80
57	101	Bilbil Billa	3+1	105.10	Kamzë	Bathore	3,170,000	16,319.25	1,897.80
58	138	Rustem Driza	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80
59	151	Shkelqim Peca	2+1	80.00	Kamzë	Paskuqan	2,500,000	16,319.25	1,897.80
60	166	Qerim Topuzi	3+1	105.10	Kamzë	Paskuqan	3,170,000	16,319.25	1,897.80

VENDIM
Nr. 90, datë 22.2.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURISË SË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE 'BURDULLIAS', BASHKIA BERAT"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të bashkëpronarëve të pasurisë së paluajtshme, pronë private, që preket nga realizimi i projektit "Zgjerimi i varrezave publike 'Burdullias', Bashkia Berat".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Berat.

3. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, që shpronësohet, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasurinë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 491 260 (katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 491 260 (katërqind e nëntëdhjetë e një mijë e dyqind e gjashtëdhjetë) lekësh, përballohet nga Bashkia Berat.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga Bashkia Berat.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (tre) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Bashkëpronarët e pasurisë së paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Berat.

8. Bashkia Berat kryen procedurat për likuidimin e bashkëpronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Berat.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistron kalimin e pronësisë për pasurinë e shpronësuar në favor të Bashkisë Berat, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasurinë e shpronësuar, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Berat për pasurinë e shpronësuar, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Berat, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Berat, Drejtoria e Administrimit dhe e Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Berat dhe Agjencia Shtetërore për Shpronësimin për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E BASHKËPRONARËVE TË PASURISË TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKET NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "ZGJERIMI I VARREZAVE PUBLIKE 'BURDULLIAS', BASHKIA BERAT"

NR.	PRONARI							VLERËSIMET PËR SHPRONËSIM				SHËNIME (Kufizime hipotekare, barrë mbi pasurinë etj.)
								ARË			VLERA TOTALE (lek)	
	Emri	Atësia	Mbiemri	Z. kadastrale	Nr. i pasurisë	Lloji i pasurisë	Sipërfaqja totale	Sipërfaqja (m^2)	Çmimi (lek/m^2)	Vlera (lek)		
	A	B	C	Ç	D	E	F	L	M	N	Y	Z
1	Myfarete Feride	Iljas Ibrahim	Peshtani Bego	8501	4/149	Arë	2420	2420.0	203	491,260.00	491,260.00	Konfirmuar nga ASHK-ja
SHUMA										491,260.00	491,260.00	

Shënime:
Vlerësimi i pasurisë "arë" është bazuar në VKM-në nr. 138, datë 23.8.2000, "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive pronë private, që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik", të ndryshuar

VENDIM
Nr. 91, datë 22.2.2023

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "KRIJIM HAPËSIRE REKREATIVE NË ZONËN E LIQENIT ARTIFICIAL TË QYTETIT BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga projekti "Krijim hapësire rekreative në zonën e liqenit artificial të qytetit Ballsh, Bashkia Mallakastër".

2. Shpronësimi bëhet në favor të Bashkisë Mallakastër.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, që shpronësohen, kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për pasuritë e llojit "arë", me një vlerë të përgjithshme prej 405 900 (katërqind e pesë mijë e nëntëqind) lekësh.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 405 900 (katërqind e pesë mijë e nëntëqind) lekësh, përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale, në masën 50 000 (pesëdhjetë mijë) lekë, përballohet nga buxheti i Bashkisë Mallakastër.

6. Shpronësimi fillon menjëherë pas botimit të këtij vendimi në Fletoren Zyrtare dhe afati i përfundimit të shpronësimit është brenda 3 (muajve) muajve nga data e hyrjes në fuqi të tij.

7. Pronarët e pasurive të paluajtshme, pronë private, të pasqyruar në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, kompensohen për efekt shpronësimi, pasi të kenë paraqitur dokumentacionin justifikues për likuidim pranë Bashkisë Mallakastër.

8. Bashkia Mallakastër kryen procedurat për likuidimin e pronarëve të shpronësuar, sipas përcaktimeve të bëra në këtë vendim.

9. Afati i fillimit dhe i përfundimit të punimeve është në përputhje me afatet e parashikuara nga Bashkia Mallakastër.

10. Agjencia Shtetërore e Kadastrës pezullon të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara, deri në momentin e realizimit të procesit të hedhjes së gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale dhe regjistrimin e kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mallakastër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

11. Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, nis procedurat për hedhjen e gjurmës së projektit mbi hartën kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit të miratuar, dhe regjistrimit të kalimit të pronësisë në favor të Bashkisë Mallakastër për pasuritë e shpronësuara, sipas këtij vendimi.

12. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Bashkia Mallakastër, Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Fier, Zyra Vendore Mallakastër, Agjencia Shtetërore për Shpronësimin dhe Drejtoria e Administrimit dhe Mbrojtjes së Tokës pranë Këshillit të Qarkut Fier për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

LISTA EMËRORE E PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA REALIZIMI I PROJEKTIT "KRIJIM HAPËSIRE REKREATIVE NË ZONËN E LIQENIT ARTIFICIAL TË QYTETIT BALLSH, BASHKIA MALLAKASTËR"

									VLERËSIMI PËR SHPRONËSIM				
	PRONARI			TË DHËNAT KADASTRALE					TOKE ARË				
Nr.	Emri	Atësia	Mbiemri	Fshat/ qytet	Nr. i pas.	ZK	Lloji i pasurisë	Sip. totale	Sip. e shpronësuar (m²)	Çmimi (lek/ m²)	Vlera (lek)	Vlera totale	Shënime
1	Dashnor	Adem	Malasi	Ballsh	30/40	1090	Arë	1600	1600	123	196,800	196,800	Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mallakastër. Çmimi prej 123 lekësh/m² është sugjeruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 3720/1 prot., datë 15.7.2022, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 3520/1 prot., date 19.7.2022
2	Veledin	Adem	Malasi	Ballsh	30/42	1090	Arë	1700	1700	123	209,100	209,100	Konfirmuar nga ASHK Zyra Vendore Mallakastër. Çmimi prej 123 lekësh/m² është sugjeruar nga Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural me shkresën nr. 3720/1 prot., datë 15.7.2022, administruar pranë Bashkisë Mallakastër me nr. 3520/1 prot., date 19.7.2022
TOTALI												405 900	

VENDIM
Nr. 92, datë 22.2.2023

PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, pika 3, shkronja "c", e 6, pikat 2 e 5, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto shtesa:

1. Në fund të pikës 14, të kreut I, shtohen fjalët "... i ndryshuar me vendimet e Këshillit të Bashkimit Evropian (CFSP) 2022/2398, (CFSP) 2022/2412, që i bashkëlidhen këtij vendimi.".

2. Në aneksin 14, bashkëlidhur vendimit, shtohen vendimet (CFSP) 2022/2398, (CFSP) 2022/2412, që i bashkëlidhen këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

8.12.2022 Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian I 316 I/7

VENDIME

VENDIM PËR ZBATIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/2398

i datës 8 dhjetor 2022

në zbatim të Vendimit 2010/788/CFSP mbi masat kufizuese në funksion të situatës në Republikën Demokratike të Kongos

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 31(2),

Duke pasur parasysh Vendimin e Këshillit 2010/788/CFSP të datës 20 dhjetor 2010 lidhur me masat kufizuese në funksion të situatës në Republikën Demokratike të Kongos([1]) dhe në veçanti nenin 6(2),

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë,

Ndërkohë që:

(1) Më 20 dhjetor 2010, Këshilli miratoi Vendimin 2010/788/CFSP.

(2) Më 12 dhjetor 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/2231 ([2]) në përgjigje të bllokimit të procesit zgjedhor dhe shkeljeve lidhur me të drejtat e njeriut në Republikën Demokratike të Kongos (RDK). Vendimi (CFSP) 2016/2231 ndryshoi Vendimin 2010/788/CFSP dhe futi masa kufizuese shtesë.

(3) Pas një vlerësimi të rrethanave përkatëse dhe duke pasur parasysh rëndimin e situatës në RDK, Këshilli konsideron se tetë persona duhet t'i shtohen listës së personave dhe subjekteve të përcaktuara në Aneksin II të Vendimi 2010/788/CFSP.

(4) Vendimi 2010/788/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Aneksi II i Vendimit 2010/788/CFSP është ndryshuar siç përcaktohet në Aneksin e këtij Vendimi.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi në datën e botimit në Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 8 dhjetor 2022.

Për Këshillin

President

V. RAKUSHA

([1]) OJ L 336, 21.12.2010, f. 30.
([2]) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/2231 i datës 12 dhjetor 2016 që ndryshon Vendimin 2010/788/CFSP në lidhje me masat kufizuese kundër Republikës Demokratike të Kongos (OJ L 336I, 12.12.2016, f. 7).

ANEKSI

Personat e mëposhtëm i shtohen listës së përcaktuar në seksionin A ("Personat") të Aneksit II të Vendimit 2010/788/CFSP

Personat

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
'10	Ruvugayimikore PROTOGÈNE	a.k.a Ruhinda; Gaby Ruhinda; Zorro Midende DOB: 1968 ose 1969 Gjinia: mashkull Funksioni ose profesioni: Drejtues i Forcave Demokratike për Çlirimin e Ruandës - Forces Combattantes Abacunguzi (FDLR-FOCA); Udhëheqës i grupi Maccabé (ish Commando de recherche et d'action en profondeur (CRAP)) i FDLR-FOCA	Ruvugayimikore Protogène është një drejtues i Forcave Demokratike për Çlirimin e Ruandës - *Forces Combattantes Abacunguzi* (FDLR-FOCA), një organizatë joqeveritare grupi i armatosur që vepron në RDK Lindore. Ai drejton, në veçanti, grupin Maccabé (i njohur më parë si *Commando de recherche et d'action en profondeur* (CRAP)) i FDLR-FOCA. FDLR-FOCA, duke përfshirë grupin Maccabé, kontribuon në konfliktin e armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK, veçanërisht përmes dhunës dhe shkeljeve serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë sulmet ndaj civilëve, vrasjet, dhunën kundër fëmijëve, përdhunimeve dhe akteve të tjera të dhunës seksuale. Për shkak të pozicionit të tij drejtues në FDLR-FOCA, Ruvugayimikore Protogène është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze ose abuzime të të drejtave të njeriut në RDK. Ai është gjithashtu përgjegjës për vijueshmërinë e konfliktit të armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK.	8.12.2022
11	Meddie NKALUBO	a.k.a Mohammed Ali Nkalubo; Ebul Xhihad; Punny Djalë Datëlindja: 1991, 1992 ose 1993 Kombësia: Uganda Gjinia: Mashkull Funksioni ose profesioni: Drejtues i lartë i Forcave Aleate Demokratike	Meddie Nkalubo është një udhëheqës i lartë i Forcave Demokratike Aleate (FDA), një grup i armatosur joqeveritar që vepron në Ugandë dhe RDK Lindore. Ai ka qenë i identifikuar si bartës i përgjegjësive të ndryshme në FDA, përfshirë komunikimin dhe propagandën, rekrutimin, fabrikimin e armëve dhe afrimin me ISIL-in (Da'esh). FDA kontribuon në konfliktin e armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK (sidomos në provincat Ituri dhe Kivu Veriore), veçanërisht përmes dhunës dhe abuzime serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë sulmet kundër civilëve, vrasjet dhe rrëmbimet. Për shkak të pozicionit të tij të lartë drejtues dhe përgjegjësive të ndryshme në FDA, Meddie Nkalubo është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje ose abuzime serioze të të drejtave të njeriut në RDK. Ai është gjithashtu përgjegjës për mbajtjen e konfliktit të armatosur, paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë në RDK.	8.12.2022

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
12	Justin BITAKWIRA	a.k.a. Bihona-Hayi Datëlindja: 5.12.1960 Vendlindja: Lemera, RDK Kombësia: RDK Gjinia: Mashkull Funksioni ose profesioni: Politikan, ish-ministër kombëtar dhe kryetar i Aleancës për Republikën dhe Ndërgjegjen Kombëtare	Justin Bitakwira është një politikan kongolez, ish-ministër i qeverisë dhe anëtar i partisë politike "Union for the Congoese Nation". Në fjalimet e tij publike, ai vazhdimisht ka nxitur dhunën dhe ka inkurajuar diskriminimin dhe armiqësinë ndaj komunitetit Banyamulenge, i cili është shënjestruar dhe sulmuar nga grupet e armatosura. Këto fjalime dhe narrativa kontribuojnë në nxitjen e konfliktit dhe dhunës në RDK, veçanërisht në rajonin Hauts-Plateaux të karakterizuar nga konflikte ndër-komunale. Në këto rrethana, Justin Bitakwira është përgjegjës për mbështetjen e konfliktit të armatosur, paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë në RDK, përmes nxitjes së dhunës.	8.12.2022
13	Joseph Nganzo Olikwa TIPI	a.k.a. Koloneli Tipi Ziro Ziro, Joseph Ngadjole, Joseph Nganzole Olikwa Datëlindja: 10.11.1977 Vendlindja: Bunia Fataki, RDK Kombësia: RDK Gjinia: Mashkull Grada: Kolonel i FARDC Pozicioni: Zëvendës komandant i Brigadës së 12-të të Reagimit të Shpejtë në Minembwe, ish-komandant i batalionit 312 të Brigadës së 31-të të Mbrojtjes kryesore ID Ushtarake: 1-77-96-32692-76	Joseph Nganzo Olikwa Tipi ka qenë komandant i batalionit 312 të Brigadës së 31-të të Mbrojtjes kryesore të Forcave të Armatosura të Republikës Demokratike të Kongos (FARDK) deri në janar 2022. Forcat e batalionit 312 nën komandën dhe përgjegjësinë e tij kanë kryer sulme ndaj civilëve dhe shkelje të rënda të të drejtave të njeriut, veçanërisht përdhunime të grave në periudhën qershor - dhjetor 2021. Joseph Nganzo Olikwa Tipi mbetet një oficer i rangut të lartë në FARDK, si kolonel dhe zëvendës komandant i Brigadës së 12-të të Reagimit të Shpejtë në Minembwe (Kivu i Jugut). Për shkak të funksioneve të tij, ai mban përgjegjësi për shkeljet e fundit të të drejtave të njeriut të kryera nga FARDK. Në këto rrethana, Joseph Nganzo Olikwa Tipi është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK.	8.12.2022

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
14	Désiré LONDROMA NDJUKPA	a.k.a. Désiré Lokana Lokanza Gjinia: Mashkull Funksioni ose profesioni: Oficer i Mbrojtjes CODECO URDPC ('akuza e mbrojtjes')	Désiré Londroma Ndjukpa është një drejtues i Kooperativës për Zhvillimin e Kongos / Unioni i Revolucionarëve për Mbrojtjen e Popullit Kongolez (CODECO URDPC), i identifikuar si oficer i saj i mbrojtjes ('akuza e mbrojtjes') dhe bashkëdrejtues i krahut të saj politik. CODECO URDPC është një grup i armatosur joqeveritar që vepron në RDK Lindore dhe që kontribuon në konfliktin e armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK, veçanërisht përmes dhunës dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë vrasjet, dhunën seksuale dhe sulmet ndaj civilëve si p.sh. sulmet ndaj kampeve të personave të zhvendosur brenda vendit në periudhën nga mesi i nëntorit 2021 dhe shkurtit 2022, duke synuar kryesisht komunitetin Hema. Për shkak të pozicionit të tij drejtues në CODECO URDPC, Londroma Ndjukpa është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Ai është gjithashtu përgjegjës për mbështetjen e konfliktit të armatosur, paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë në RDK.	8.12.2022
15	Willy NGOMA	a.k.a Major Willy Ngoma Gjinia: Mashkull Funksioni ose profesioni: Zëdhënës i Lëvizjes 23 Mars / Ushtria Revolucionare e Kongos (M23/ARC)	Willy Ngoma mban pozicionin drejtues të zëdhënësit të Lëvizjes së 23 Marsit / Ushtrisë Revolucionare Kongoleze (M23/ARC), një grup i armatosur joqeveritar që vepron në RDK Lindore. M23/ARC kontribuon në konfliktin e armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK, veçanërisht përmes dhunës dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë vrasjet, sulmet dhe dhunën seksuale kundër civilëve. Për shkak të pozicionit të tij drejtues në M23/ARC, Willy Ngoma është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Ai është gjithashtu përgjegjës për mbështetjen e konfliktit të armatosur, paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë në DRC.	8.12.2022

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
16	William YAKUTUMBA	Datëlindja: 1970 Vendlindja: Lunbondia, Jug-Kivu, RDK Kombësia: RDK Gjinia: mashkull Funksioni ose profesioni: udhëheqës i Koalicionit Kombëtar të Peuple pour la Souverainité du Congo (CNPSC); themeluesi dhe udhëheqësi i milicisë Mai-Mai Yakutumba	William Yakutumba është Sekretari i Përgjithshëm dhe Komandanti i *Coalition Nationale du Peuple pour la Souverainité du Congo* (CNPSC), një koalicion i të ashtuquajturave milici Mai-Mai në provincën Kivu Jugor të RDK. Ai është themeluesi dhe udhëheqësi i një prej milicive më të mëdha të atij koalicioni, Mai-Mai Yakutumba. Mai-Mai Yakutumba kontribuon në konfliktin e armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK, veçanërisht përmes dhunës dhe abuzimeve serioze të të drejtave të njeriut, duke përfshirë masakrat e popullsisë së fshatit, sulmet ndaj civilëve, përdhunimet dhe aktet e tjera të dhunës seksuale. Mai-Mai Yakutumba kontrollon gjithashtu minierat e arit në RDK Lindore, së bashku me anëtarët e CNPSC që kontrollojnë rrugët e minierave. Ata përfitojnë nga shfrytëzimi i paligjshëm dhe tregtimi i arit. Mai-Mai Yakutumba përdor fitimet e nxjerra nga ajo tregti për të financuar aktivitetet e saj të armatosura. Për shkak të pozicionit të tij drejtues në CNPSC dhe në milicinë Mai-Mai Yakutumba, William Yakutumba është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Ai është gjithashtu përgjegjës për mbështetjen dhe shfrytëzimin e konfliktit të armatosur, paqëndrueshmërisë dhe pasigurisë në RDK, duke përfshirë shfrytëzimin dhe tregtimin e paligjshëm të burimeve natyrore.	8.12.2022
17	Alain François Viviane GOETZ	Datëlindja: 24.4.1965 Vendlidja: Deurne, Antwerp, Belgjikë Kombësia: Belge Gjinia: mashkull	Alain Goetz është një biznesmen, i cili është pronari përfitues dhe ish-drejtori i African Gold Rafinery Ltd, i regjistruar në Ugandë. Që nga viti 2016, African Gold Rafinery Ltd ka marrë, blerë, rafinuar dhe tregtuar ar të paligjshëm me origjinë nga miniera në DRC që kontrollohen nga grupe të armatosura joqeveritare, duke përfshirë Mai-Mai Yakutumba dhe Raia Mutomboki, të cilat janë të përfshira në aktivitete destabilizuese në Provinca e Kivu-së Jugore. Në këto rrethana, Alain Goetz po shfrytëzon konfliktin e armatosur, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në RDK përmes shfrytëzimit dhe tregtisë së paligjshme të burimeve natyrore.	8.12.2022

8.12.2022 EN Official Journal of the European Union L 316 I/7

DECISIONS

COUNCIL IMPLEMENTING DECISION (CFSP) 2022/2398

of 8 December 2022

implementing Decision 2010/788/CFSP concerning restrictive measures in view of the situation in the Democratic Republic of the Congo

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 31(2) thereof,

Having regard to Council Decision 2010/788/CFSP of 20 December 2010 concerning restrictive measures in view of the situation in the Democratic Republic of the Congo ([1]) and in particular Article 6(2) thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 20 December 2010, the Council adopted Decision 2010/788/CFSP.

(2) On 12 December 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/2231 ([2]) in response to the obstruction of the electoral process and the related human rights violations in the Democratic Republic of the Congo (DRC). Decision (CFSP) 2016/2231 amended Decision 2010/788/CFSP and introduced additional restrictive measures.

(3) Further to an evaluation of the relevant circumstances and in view of the gravity of the situation in the DRC, the Council considers that eight persons should be added to the list of persons and entities set out in Annex II to Decision 2010/788/CFSP.

(4) Decision 2010/788/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Annex II to Decision 2010/788/CFSP is amended as set out in the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the date of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 8 December 2022.

For the Council
The President
V. RAKUŠAN

([1]) OJ L 336, 21.12.2010, p. 30.
([2]) Council Decision (CFSP) 2016/2231 of 12 December 2016 amending Decision 2010/788/CFSP concerning restrictive measures against the Democratic Republic of the Congo (OJ L 336I, 12.12.2016, p. 7).

ANNEX

The following persons are added to the list set out in Section A ('Persons') of Annex II to Decision 2010/788/CFSP:

Persons

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
'10	Ruvugayimikore PROTOGÈNE	a.k.a. Ruhinda; Gaby Ruhinda; Zorro Midende DOB: 1968 or 1969 Gender: Male Function or profession: Leader of the Democratic Forces for the Liberation of Rwanda - *Forces Combattantes Abacunguzi* (FDLR-FOCA); Leader of the Maccabé group (formerly *Commando de recherche et d'action en profondeur* (CRAP)) of the FDLR-FOCA	Ruvugayimikore Protogène is a leader of the Democratic Forces for the Liberation of Rwanda - *Forces Combattantes Abacunguzi* (FDLR-FOCA), a non-governmental armed group operating in the Eastern DRC. He leads, in particular, the Maccabé group (formerly known as the *Commando de recherche et d'action en profondeur* (CRAP)) of the FDLR-FOCA. The FDLR-FOCA, including the Maccabé group, contributes to the armed conflict, instability and insecurity in the DRC, in particular through violence and serious human rights abuses, including attacks on civilians, killings, violence against children, rapes and other acts of sexual violence. Owing to his leading position in the FDLR-FOCA, Ruvugayimikore Protogène is therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. He is also responsible for sustaining the armed conflict, instability and insecurity in the DRC.	8.12.2022
11	Meddie NKALUBO	a.k.a. Mohammed Ali Nkalubo; Abul Jihad; Punny Boy DOB: 1991, 1992 or 1993 Nationality: Uganda Gender: Male Function or profession: Senior Allied Democratic Forces leader	Meddie Nkalubo is a senior leader of the Allied Democratic Forces (ADF), a non-governmental armed group operating in Uganda and the Eastern DRC. He has been identified as holding various responsibilities in the ADF, including communication and propaganda, recruitment, fabrication of arms, and rapprochement with ISIL (Da'esh). The ADF contributes to the armed conflict, instability and insecurity in the DRC (particularly in the Ituri and North Kivu provinces), in particular through violence and serious human rights abuses, including attacks against civilians, killings and abduction. Owing to his senior leading position and various responsibilities in the ADF, Meddie Nkalubo is therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. He is also responsible for sustaining the armed conflict, instability and insecurity in the DRC.	8.12.2022

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
12	Justin BITAKWIRA	a.k.a. Bihona-Hayi DOB: 5.12.1960 POB: Lemera, DRC Nationality: DRC Gender: Male Function or profession: Politician, former National Minister and President of the Alliance for the Republic and National Consciousness	Justin Bitakwira is a Congolese politician, former government Minister and member of the political party "Union for the Congolese Nation". In his public speeches, he has repeatedly incited violence and encouraged discrimination and hostility towards the Banyamulenge community, which has been targeted and attacked by armed groups. Those inflammatory speeches and narratives contribute to fuelling the conflict and violence in the DRC, in particular in the Hauts-Plateaux region characterised by inter-communal conflicts. Justin Bitakwira is therefore responsible for sustaining the armed conflict, instability and insecurity in the DRC, through inciting violence.	8.12.2022
13	Joseph Nganzo Olikwa TIPI	a.k.a. Colonel Tipi Ziro Ziro, Joseph Ngadjole, Joseph Nganzole Olikwa DOB: 10.11.1977 POB: Bunia Fataki, DRC Nationality: DRC Gender: Male Rank: Colonel of the FARDC Position: Deputy Commander of the 12th Rapid Reaction Brigade in Minembwe, former Commander of the 312th battalion of the 31st Main Defence Brigade Military ID: 1-77-96-32692-76	Joseph Nganzo Olikwa Tipi was Commander of the 312th battalion of the 31st Main Defence Brigade of the Armed Forces of the Democratic Republic of the Congo (FARDC) until January 2022. Forces of the 312th battalion under his command and responsibility have committed attacks on civilians and serious human rights violations, in particular rapes of women between June and December 2021. Joseph Nganzo Olikwa Tipi remains a high-ranking officer in the FARDC, as Colonel and Deputy Commander of the 12th Rapid Reaction Brigade in Minembwe (South Kivu). Owing to his functions, he bears responsibility for recent human rights violations committed by the FARDC. Joseph Nganzo Olikwa Tipi is therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC.	8.12.2022

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
14	Désiré LONDROMA NDJUKPA	a.k.a. Désiré Lokana Lokanza Gender: Male Function or profession: CODECO URDPC Defence Officer ('charge of defence')	Désiré Londroma Ndjukpa is a leader of the Cooperative for Development of the Congo / Union of Revolutionaries for the Defence of the Congolese People (CODECO URDPC), identified as its defence officer ('charge of defence'), and co-leader of its political wing. The CODECO URDPC is a non-governmental armed group operating in the Eastern DRC and contributing to the armed conflict, instability and insecurity in the DRC, in particular through violence and serious human rights abuses, including killings, sexual violence and attacks on civilians such as attacks on internally displaced persons camps between mid-November 2021 and February 2022, targeting in particular the Hema community. Owing to his leading position in the CODECO URDPC, Londroma Ndjukpa is therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. He is also responsible for sustaining the armed conflict, instability and insecurity in the DRC.	8.12.2022
15	Willy NGOMA	a.k.a. Major Willy Ngoma Gender: Male Function or profession: Spokesperson of the March 23 Movement / Congolese Revolutionary Army (M23/ARC)	Willy Ngoma holds the leading position of spokesperson of the March 23 Movement / Congolese Revolutionary Army (M23/ARC), a non-governmental armed group operating in the Eastern DRC. The M23/ARC contributes to the armed conflict, instability and insecurity in the DRC, in particular through violence and serious human rights abuses, including killings, attacks and sexual violence against civilians. Owing to his leading position in the M23/ARC, Willy Ngoma is therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. He is also responsible for sustaining the armed conflict, instability and insecurity in the DRC.	8.12.2022

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
16	William YAKUTUMBA	DOB: 1970 POB: Lunbondia, South-Kivu, DRC Nationality: DRC Gender: Male Function or profession: leader of the *Coalition Nationale du Peuple pour la Souveraineté du Congo* (CNPSC); founder and leader of the Mai-Mai Yakutumba militia	William Yakutumba is the Secretary-General and Commander of the *Coalition Nationale du Peuple pour la Souveraineté du Congo* (CNPSC), a coalition of the so-called Mai-Mai militias in South Kivu province of the DRC. He is the founder and leader of one of the largest militias of that coalition, the Mai-Mai Yakutumba. The Mai-Mai Yakutumba contributes to the armed conflict, instability and insecurity in the DRC, in particular through violence and serious human rights abuses, including massacres of village populations, attacks on civilians, rapes and other acts of sexual violence. The Mai-Mai Yakutumba also controls gold mines in the Eastern DRC, together with CNPSC members who control the mining routes. They profit from the illicit exploitation of and trade in gold. The Mai-Mai Yakutumba uses profits gained through that trade to finance its armed activities. Owing to his leading position in the CNPSC and in the Mai-Mai Yakutumba militia, William Yakutumba is therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. He is also responsible for sustaining and exploiting the armed conflict, instability and insecurity in the DRC, including through the illicit exploitation and trade of natural resources.	8.12.2022
17	Alain François Viviane GOETZ	DOB: 24.4.1965 POB: Deurne, Antwerp, Belgium Nationality: Belgian Gender: Male	Alain Goetz is a businessman, who is the beneficial owner and former director of African Gold Refinery Ltd, registered in Uganda. Since 2016, African Gold Refinery Ltd has received, purchased, refined and traded illicit gold originating from mines in the DRC that are controlled by non-governmental armed groups, including the Mai-Mai Yakutumba and Raia Mutomboki, which are involved in destabilising activities in South Kivu province. Alain Goetz is therefore exploiting the armed conflict, instability and insecurity in the DRC through the illicit exploitation and trade of natural resources.	8.12.2022'

L 317/122 Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian 9.12.2022

VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2022/2412

i datës 8 dhjetor 2022

ndryshimi i Vendimit 2010/788/CFSP në lidhje me masat kufizuese në funksion të situatës në Republikën Demokratike të Kongos

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Unionit për Punët e Jashtme dhe Politikat e Sigurisë,

Duke pasur parasysh se:

(1) Më 20 dhjetor 2010, Këshilli miratoi Vendimin 2010/788/CFSP ([1]).

(2) Më 12 dhjetor 2016, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2016/2231 ([2]) në përgjigje të pengimit të procesit zgjedhor dhe shkeljeve të lidhura me të drejtat e njeriut në Republikën Demokratike të Kongos (RDK). Vendimi (CFSP) 2016/2231 ndryshoi Vendimin 2010/788/CFSP dhe futi masa kufizuese shtesë në nenin 3(2) të Vendimit 2010/788/CFSP.

(3) Pas një rishikimi të masave kufizuese të përcaktuara në nenin 3(2) të Vendimit 2010/788/CFSP, dhe duke marrë parasysh shkeljet e vazhdueshme të të drejtave të njeriut, paqëndrueshmërinë dhe pasigurinë në Republikën Demokratike të Kongos, këto masa duhet të rinovohen deri më 12 dhjetor 2023.

(4) Deklaratat e arsyeve në lidhje me persona të caktuar të listuar në Aneksin II të Vendimit 2010/788/CFSP duhet gjithashtu të ndryshohen.

(5) Vendimi 2010/788/CFSP duhet të ndryshohet në përputhje me rrethanat,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Vendimi 2010/788/CFSP ndryshohet si më poshtë:

(1) në Nenin 9, paragrafi 2 zëvendësohet si vijon:

> '2. Masat e përmendura në nenin 3(2) do të zbatohen deri më 12 dhjetor 2023. Ato do të rinovohen, ose do të ndryshohen sipas rastit, nëse Këshilli gjykon se objektivat e tyre nuk janë përmbushur.';

(2) Aneksi II zëvendësohet me tekstin e paraqitur në aneksin e këtij vendimi.

Neni 2

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në *Fletoren Zyrtare të Bashkimit Evropian*.

Bërë në Bruksel, 8 dhjetor 2022.

Për Këshillin

President

V. RAKUSHA

([1]) Vendimi i Këshillit 2010/788/CFSP i 20 dhjetorit 2010 lidhur me masat kufizuese kundër Republikës Demokratike të Kongos dhe shfuqizimin e Pozicionit të Përbashkët 2008/369/CFSP (OJ L 336, 21.12.2010, f. 30).

([2]) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2016/2231 i datës 12 dhjetor 2016 që ndryshon Vendimin 2010/788/CFSP në lidhje me masat kufizuese kundër Republikës Demokratike të Kongos (OJ L 336 I, 12.12.2016, f. 7).

ANEKSI

Personat e mëposhtëm i shtohen listës së përcaktuar në seksionin A ("Personat") të Aneksit II të Vendimit 2010/788/CFSP

A. Personat

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
1	Ilunga KAMPETE	a.k.a Gaston Hughes Ilunga Kampete; Hugues Raston Ilunga Kampete Datëlindja: 24.11.1964 Vendlindja: Lubumbashi, RDK Kombësia: RDK Numri i identifikimit ushtarak: 1-64-86-22311-29 Adresa: 69, avenue Nyangwile, Kinsuka Mimosas, Kinshasa/Ngaliema, RDK Gjinia: mashkull	Si komandant i Gardës Republikane (GR) deri në prill 2020, Ilunga Kampete ishte përgjegjëse për njësitë e GR të dislokuara në terren dhe të përfshira në përdorimin disproporcional të forcës dhe represionin e dhunshëm në shtator 2016 në Kinshasa. Ai ka qenë gjithashtu përgjegjës për shtypjen dhe shkeljen e të drejtave të njeriut të kryera nga agjentët e GR, si për shembull shtypja e dhunshme e një mitingu të opozitës në Lubumbashi në dhjetor 2018. Që nga korriku 2020, ai është ushtar i rangut të lartë, si Gjeneral Lejtnant në Forcat e Armatosura të Kongos (FARDK) dhe komandant i bazës ushtarake Kitona në provincën e Kongos Qendrore. Në bazë të funksioneve të tij, ai mban përgjegjësi për shkeljet e fundit të të drejtave të njeriut të kryera nga FARDK. Prandaj, Ilunga Kampete ka qenë përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK.	12.12.2016
2	Gabriel Amisi KUMBA	a.k.a Gabriel Amisi Nkumba; "Tango Fort"; "Tango Four" Datëlindja: 28.5.1964 Vendlindja: Malela, RDK Kombësia: RDK Numri i identifikimit ushtarak: 1-64-87-77512-30 Adresa: 22, avenue Mbenseke, Ma Campagne, Kinshasa/Ngaliema, RDK Gjinia: mashkull	Ish-komandant i zonës së parë të mbrojtjes të Forcave të Armatosura Kongoleze (FARDK), e cila mori pjesë në përdorimin jo-proporcional të forcës dhe represionin e dhunshëm në shtator 2016 në Kinshasa. Gabriel Amisi Kumba ka qenë Zëvendës Shefi i Shtabit të FARDK i ngarkuar me operacionet dhe inteligjencën nga korriku 2018 deri në korrik 2020. Që atëherë, ai ka mbajtur funksionet e Inspektorit të Përgjithshëm të FARDK. Për shkak të funksioneve të tij të larta, ai mban përgjegjësi për shkeljet e fundit të të drejtave të njeriut të kryera nga FARDK. Për pasojë, Gabriel Amisi Kumba është i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje të rënda të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK.	12.12.2016

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
3	Célestin KANYAMA	a.k.a. Kanyama Tshisiku Celestin; Kanyama Celestin Cishiku Antoine; Kanyama Cishiku Bilolo Célestin; "Esprit de mort" Datëlindja: 4.10.1960 Vendlindja: Kananga, RDK Kombësia: RDK Numri i pasaportës së RDK: OB0637580 (e vlefshme nga 20.5.2014 deri më 19.5.2019) Numri i vizës Shengen 011518403, lëshuar më 2.7.2016 Adresa: 56, avenue Usika, Kinshasa/Gombe, RDK Gjinia: mashkull	Si Komisioner i Policisë Kombëtare të Kongos (PKK), Celestin Kanyama ka qenë përgjegjës për përdorimin jo-proporcional të forcës dhe shtypjen e dhunshme në shtator 2016 në Kinshasa. Në korrik 2017, Célestin Kanyama u emërua Drejtor i Përgjithshëm i shkollave të trajnimit të PKK. Në tetor 2018, kur ai kryente këtë funksion, oficerët e policisë frikësuan dhe privuan nga liria gazetarët, pas publikimit të një sërë artikujsh mbi shpërdorimin e racioneve të kadetëve të policisë dhe rolin që Célestin Kanyama luajti në këto ngjarje. Për shkak të rolit të tij si zyrtar i lartë i PKK, post të cilin e mban ende, ai mban përgjegjësi për shkeljet e fundit të të drejtave të njeriut të kryera nga PKK. Prandaj, Celestin Kanyama ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK.	12.12.2016
4	John NUMBI	a.k.a John Numbi Banza Tambo; John Numbi Banza Ntambo; Tambo Numbi Datëlindja: 16.8.1962 Vendlindja: Jadotville-Likasi-Kolwezi, RDK Kombësia: RDK Adresa: 5, avenue Oranger, Kinshasa/Gombe, RDK Gjinia mashkull	John Numbi ka qenë Inspektor i Përgjithshëm i Forcave të Armatosura të Kongos (FARDK) nga korriku 2018 deri në korrik 2020. Për shkak të rolit të tij, ai mban përgjegjësi për shkeljet e të drejtave të njeriut të kryera nga FARDK për periudhën kohore korrik 2018 dhe korrik 2020, të tilla si dhuna jo-proporcionale kundër minatorëve të paligjshëm nga qershori deri në korrik 2019 të kryera nga trupat e FARDK nën përgjegjësinë e tij të drejtpërdrejtë. Prandaj, John Numbi ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Deri në fillim të vitit 2021, John Numbi mbajti një pozicion ndikimi në FARDK, sidomos në Katanga, ku janë raportuar shkelje të rënda të të drejtave të njeriut të kryera nga FARDK. John Numbi është ende një kërcënim për situatën e të drejtave të njeriut në RDK, veçanërisht në Katanga.	12.12.2016

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
5	Evariste BOSHAB	a.k.a. Evariste Boshab Mabub Ma Bileng Datëlindja: 12.1.1956 Vendlindja: Tete Kalamba, RDK Kombësia: RDK Numri i pasaportës diplomatike: DP0000003 (e vlefshme nga 21.12.2015 deri më 20.12.2020) Viza Shengen ka skaduar me 5.1.2017 Adresa: 3, avenue du Rail, Kinshasa/Gombe, RDK Gjinia: mashkull	Në cilësinë e tij si Zëvendës Kryeministër dhe Ministër i Brendshëm dhe i Sigurisë nga dhjetori 2014 deri në dhjetor 2016, Evariste Boshab ka qenë zyrtarisht përgjegjës për policinë dhe shërbimet e sigurisë dhe për koordinimin e punës së guvernatorëve të provincave. Në këtë cilësi, ai ka qenë përgjegjës për arrestimet e aktivistëve dhe anëtarëve të opozitës, si dhe për përdorimin jo-proporcional të forcës, për periudhën shtator – dhjetor 2016 në përgjigje të demonstratave në Kinshasa, të cilat rezultuan me një numër të madh civilësh të vrarë ose të plagosur nga shërbimet e sigurisë. Prandaj, Evariste Boshab ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Evariste Boshab gjithashtu luajti një rol në shfrytëzimin dhe përkeqësimin e krizës në rajonin e Kasait, ku ai mban një pozicion ndikimi, veçanërisht që kur u bë Senator i Kasait në mars 2019.	29.5.2017
6	Alex Kande MUPOMPA	a.k.a Alexandre Kande Mupomba; Kande-Mupompa Datëlindja: 23.9.1950 Vendlindja: Kananga, RDK Kombësia: RDK dhe belg Numri i pasaportës së RDK: OP0024910 (e vlefshme nga 21.3.2016 deri më 20.3.2021) Adresat: Messidorlaan 217/25, 1180 Uccle, Belgium 1, avenue Bumba, Kinshasa/Ngaliema, RDK Gjinia: Mashkull	Si Guvernator i Kasai Central deri në tetor 2017, Alex Kande Mupompa ka qenë përgjegjës për përdorimin jo-proporcional të forcës, shtypjen e dhunshme dhe vrasjet jashtëgjyqësore të kryera nga forcat e sigurisë dhe Policia Kombëtare Kongoleze (PKK) në Kasain Qendror nga gushti 2016, duke përfshirë vrasjet në territorin e Dibaya-t në shkurt 2017. Prandaj, Alex Kande Mupompa ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Alex Kande Mupompa gjithashtu luajti një rol në shfrytëzimin dhe përkeqësimin e krizës në rajonin Kasai për të cilin ai ishte përfaqësues deri në tetor 2019 dhe në të cilin ai mban një pozicion ndikimi përmes Kongresit të aleatëve *pour l'action au Congo* (CAAC) që është pjesë e qeverisë provinciale të Kasait.	29.5.2017

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
7	Éric RUHORIMBERE	a.k.a.Eric Ruhorimbere Ruhanga; "Tango Two'; "Tango Deux" Datëlindja: 16.7.1969 Vendlindja: Minembwe, RDK Kombësia: RDK Numri i identifikimit ushtarak: 1-69-09-51400-64 Numri i pasaportës së RDK: OB0814241 Adresa: Mbujimayi, Provinca Kasai, RDK Gjinia: Mashkull	Si zëvendëskomandant i rajonit të 21-të ushtarak nga shtatori 2014 deri në korrik 2018, Éric Ruhorimbere ishte përgjegjës për përdorimin jo-proporcional të forcës dhe vrasjet pa gjyq të kryera nga Forcat e Armatosura të Kongos (FARDK), veçanërisht kundër milicisë Nsapu dhe kundër grave dhe fëmijëve. Éric Ruhorimbere është komandant i sektorit operacional të Nord Equateur që nga korriku 2018. Për shkak të rolit të tij, ai mban përgjegjësi për shkeljet e fundit të të drejtave të njeriut të kryera nga FARDK. Prandaj, Éric Ruhorimbere ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK.	29.5.2017
8	Emmanuel Ramazani SHADARY	a.k.a Emmanuel Ramazani Shadari Mulanda; Shadary Datëlindja: 29.11.1960 Vendlindja: Kasongo, RDK Kombësia: RDK Adresa: 28, avenue Ntela, Mont Ngafula, Kinshasa, RDK Gjinia mashkull	Si zëvendëskryeministër dhe ministër i Brendshëm dhe Sigurisë deri në shkurt 2018, Emmanuel Ramazani Shadary ka qenë zyrtarisht përgjegjës për policinë dhe shërbimet e sigurisë dhe për koordinimin e punës së guvernatorëve të provincave. Në këtë cilësi, ai është përgjegjës për arrestimet e aktivistëve dhe anëtarëve të opozitës, si dhe për përdorimin jo-proporcional të forcës, siç është goditja e dhunshme ndaj anëtarëve të lëvizjes Bundu Dia Kongo (BDK) në Kongon Qendrore, represioni në Kinshasa nga janari deri në shkurt 2017 dhe përdorimi jo proporcional i forcës dhe represioni i dhunshëm në provincat Kasai. Në këtë cilësi, Emmanuel Ramazani Shadary ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Që nga shkurti i vitit 2018, Emmanuel Ramazani Shadary ka qenë sekretar i përhershëm i *Parti du peuple pour la reconstruction et le développement* (PPRD), e cila deri në dhjetor 2020 ishte partia kryesore në koalicionin nën ish-presidentin Joseph Kabila. Në këtë cilësi, në korrik 2022, ai deklaroi se PPRD ishte e gatshme të shkojë në zgjedhjet presidenciale të vitit 2023.	29.5.2017

	Emri	Informacion identifikues	Arsyet për futje në listë	Data e futjes në listë
9	Kalev MUTONDO	a.k.a. Kalev Katanga Mutondo; Kalev Motono; Kalev Mutundo; Kalev Mutoid; Kalev Mutombo; Kalev Mutond; Kalev Mutondo Katanga; Kalev Mutund Datëlindja: 3.3.1957 Kombësia: RDK Numri i pasaportës së RDK: DB0004470 (e vlefshme nga 8.6.2012 deri më 7.6.2017) Adresa: 24, avenue Ma Campagne, Kinshasa, RDK Gjinia: mashkull	Si Shef i Shërbimit Informativ Kombëtar (ANR) deri në shkurt 2019, Kalev Mutondo ka qenë i përfshirë dhe përgjegjës për arrestimin arbitrar, ndalimin dhe keqtrajtimin e anëtarëve të opozitës, aktivistëve të shoqërisë civile dhe të tjerëve. Prandaj, Kalev Mutondo ka qenë i përfshirë në planifikimin, drejtimin ose kryerjen e akteve që përbëjnë shkelje serioze të të drejtave të njeriut ose abuzime në RDK. Në maj 2019, ai nënshkroi një deklaratë besnikërie në të kaluarën dhe të ardhmen ndaj Joseph Kabilës, me të cilin ai mbetet i afërt. Deri në fillim të vitit 2021, Kalev Mutondo ushtroi një shkallë të lartë ndikimi politik, në rolin e tij si "këshilltar politik" i Kryeministrit të RDK. Pretendohet se ai ende ka ndikim në disa pjesë të forcave të sigurisë.	29.5.2017

B. Subjektet

L 317/122 EN Official Journal of the European Union 9.12.2022

COUNCIL DECISION (CFSP) 2022/2412

of 8 December 2022

amending Decision 2010/788/CFSP concerning restrictive measures in view of the situation in the Democratic Republic of the Congo

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

(1) On 20 December 2010, the Council adopted Decision 2010/788/CFSP ([1]).

(2) On 12 December 2016, the Council adopted Decision (CFSP) 2016/2231 ([2]) in response to the obstruction of the electoral process and the related human rights violations in the Democratic Republic of the Congo (DRC). Decision (CFSP) 2016/2231 amended Decision 2010/788/CFSP and introduced additional restrictive measures in Article 3(2) of Decision 2010/788/CFSP.

(3) Following a review of the restrictive measures laid down in Article 3(2) of Decision 2010/788/CFSP, and considering the continuing violations of human rights, instability and insecurity in the Democratic Republic of the Congo, those measures should be renewed until 12 December 2023.

(4) The statements of reasons relating to certain persons listed in Annex II to Decision 2010/788/CFSP should also be amended.

(5) Decision 2010/788/CFSP should therefore be amended accordingly,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

Decision 2010/788/CFSP is amended as follows:

(1) in Article 9, paragraph 2 is replaced by the following:

'2. The measures referred to in Article 3(2) shall apply until 12 December 2023. They shall be renewed, or amended as appropriate, if the Council deems that their objectives have not been met.';

(2) Annex II is replaced by the text appearing in the Annex to this Decision.

Article 2

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 8 December 2022.

For the Council
The President
V. RAKUŠAN

([1]) Council Decision 2010/788/CFSP of 20 December 2010 concerning restrictive measures against the Democratic Republic of the Congo and repealing Common Position 2008/369/CFSP (OJ L 336, 21.12.2010, p. 30).
([2]) Council Decision (CFSP) 2016/2231 of 12 December 2016 amending Decision 2010/788/CFSP concerning restrictive measures against the Democratic Republic of the Congo (OJ L 336 I, 12.12.2016, p. 7).

ANNEX

'ANNEX II

LIST OF NATURAL OR LEGAL PERSONS, ENTITIES AND BODIES REFERRED TO IN ARTICLE 3(2)

A. Persons

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
1	Ilunga KAMPETE	a.k.a. Gaston Hughes Ilunga Kampete; Hugues Raston Ilunga Kampete DOB: 24.11.1964 POB: Lubumbashi, DRC Nationality: DRC Military ID number: 1-64-86-22311-29 Address: 69, avenue Nyangwile, Kinsuka Mimosas, Kinshasa/Ngaliema, DRC Gender: Male	As Commander of the Republican Guard (GR) until April 2020, Ilunga Kampete was responsible for the GR units deployed on the ground and involved in the disproportionate use of force and violent repression in September 2016 in Kinshasa. He was also responsible for the repression and infringement of human rights committed by GR agents, such as the violent repression of an opposition rally in Lubumbashi in December 2018. Since July 2020, he has been a high-ranking soldier, as a Lieutenant General in the Congolese Armed Forces (FARDC) and Commander of the Kitona military base in the province of Kongo Central. By virtue of his functions, he bears responsibility for the recent human rights violations committed by the FARDC. Ilunga Kampete was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC.	12.12.2016
2	Gabriel Amisi KUMBA	a.k.a. Gabriel Amisi Nkumba; 'Tango Fort'; 'Tango Four' DOB: 28.5.1964 POB: Malela, DRC Nationality: DRC Military ID number: 1-64-87-77512-30 Address: 22, avenue Mbenseke, Ma Campagne, Kinshasa/Ngaliema, DRC Gender: Male	Former Commander of the first defence zone of the Congolese Armed Forces (FARDC), which took part in the disproportionate use of force and violent repression in September 2016 in Kinshasa. Gabriel Amisi Kumba was Deputy Chief of Staff of the FARDC in charge of operations and intelligence from July 2018 to July 2020. Since then, he has held the functions of Inspector General of the FARDC. Owing to his high functions, he bears responsibility for recent human rights violations committed by the FARDC. Gabriel Amisi Kumba has therefore been involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC.	12.12.2016

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
3	Célestin KANYAMA	a.k.a. Kanyama Tshisiku Celestin; Kanyama Celestin Cishiku Antoine; Kanyama Cishiku Bilolo Célestin; 'Esprit de mort' DOB: 4.10.1960 POB: Kananga, DRC Nationality: DRC DRC passport number: OB0637580 (valid from 20.5.2014 to 19.5.2019) Schengen visa number 011518403, issued on 2.7.2016 Address: 56, avenue Usika, Kinshasa/Gombe, DRC Gender: Male	As Commissioner of the Congolese National Police (PNC), Célestin Kanyama was responsible for the disproportionate use of force and violent repression in September 2016 in Kinshasa. In July 2017, Célestin Kanyama was appointed Director-General of the PNC's training schools. In October 2018, when he was serving this function, police officers intimidated and deprived journalists of freedom, after the publication of a series of articles on the misappropriation of police cadet rations and the role that Célestin Kanyama played in these events. Owing to his role as a senior PNC official, which he still retains, he bears responsibility for the recent human rights violations committed by the PNC. Célestin Kanyama was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC.	12.12.2016
4	John NUMBI	a.k.a. John Numbi Banza Tambo; John Numbi Banza Ntambo; Tambo Numbi DOB: 16.8.1962 POB: Jadotville-Likasi-Kolwezi, DRC Nationality: DRC Address: 5, avenue Oranger, Kinshasa/Gombe, DRC Gender: Male	John Numbi was Inspector General of the Congolese Armed Forces (FARDC) from July 2018 until July 2020. Owing to his role, he bears responsibility for the human rights violations committed by the FARDC between July 2018 and July 2020, such as disproportionate violence against illegal miners from June to July 2019 committed by FARDC troops under his direct authority. John Numbi was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. Until early 2021, John Numbi retained a position of influence in the FARDC, especially in Katanga, where serious human rights violations committed by the FARDC have been reported. John Numbi is still a threat to the human rights situation in the DRC, especially in Katanga.	12.12.2016

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
5	Evariste BOSHAB	a.k.a. Evariste Boshab Mabub Ma Bileng DOB: 12.1.1956 POB: Tete Kalamba, DRC Nationality: DRC Diplomatic passport number: DP0000003 (valid from 21.12.2015 to 20.12.2020) Schengen visa expired on 5.1.2017 Address: 3, avenue du Rail, Kinshasa/Gombe, DRC Gender: Male	In his capacity as Vice Prime Minister and Minister of the Interior and Security from December 2014 to December 2016, Evariste Boshab was officially responsible for the police and security services and for coordinating the work of provincial governors. In this capacity, he was responsible for arrests of activists and opposition members, as well as for disproportionate use of force, including between September 2016 and December 2016 in response to demonstrations in Kinshasa, which resulted in a large number of civilians being killed or injured by security services. Evariste Boshab was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. Evariste Boshab also played a part in the exploitation and aggravation of the crisis in the Kasai region, where he maintains a position of influence, in particular since becoming Senator of Kasai in March 2019.	29.5.2017
6	Alex Kande MUPOMPA	a.k.a. Alexandre Kande Mupomba; Kande-Mupompa DOB: 23.9.1950 POB: Kananga, DRC Nationality: DRC and Belgian DRC passport number: OP0024910 (valid from 21.3.2016 to 20.3.2021) Addresses: Messidorlaan 217/25, 1180 Uccle, Belgium 1, avenue Bumba, Kinshasa/Ngaliema, DRC Gender: Male	As Governor of Kasai Central until October 2017, Alex Kande Mupompa was responsible for the disproportionate use of force, violent repression and extrajudicial killings committed by security forces and the Congolese National Police (PNC) in Kasai Central from August 2016, including killings in the territory of Dibaya in February 2017. Alex Kande Mupompa was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. Alex Kande Mupompa also played a part in the exploitation and aggravation of the crisis in the Kasai region for which he was a representative until October 2019 and in which he maintains a position of influence through the *Congrès des alliés pour l'action au Congo* (CAAC) which is part of the provincial government of Kasai.	29.5.2017

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
7	Éric RUHORIMBERE	a.k.a. Eric Ruhorimbere Ruhanga; 'Tango Two'; 'Tango Deux' DOB: 16.7.1969 POB: Minembwe, DRC Nationality: DRC Military ID number: 1-69-09-51400-64 DRC passport number: OB0814241 Address: Mbujimayi, Kasai Province, DRC Gender: Male	As Deputy Commander of the 21st military region from September 2014 to July 2018, Éric Ruhorimbere was responsible for the disproportionate use of force and extrajudicial killings perpetrated by the Congolese Armed Forces (FARDC), in particular against the Nsapu militia and against women and children. Éric Ruhorimbere has been the Commander of the Nord Equateur operational sector since July 2018. Owing to his role, he bears responsibility for the recent human rights violations committed by the FARDC. Éric Ruhorimbere was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC.	29.5.2017
8	Emmanuel Ramazani SHADARY	a.k.a. Emmanuel Ramazani Shadari Mulanda; Shadary DOB: 29.11.1960 POB: Kasongo, DRC Nationality: DRC Address: 28, avenue Ntela, Mont Ngafula, Kinshasa, DRC Gender: Male	As Vice Prime Minister and Minister of the Interior and Security until February 2018, Emmanuel Ramazani Shadary was officially responsible for the police and security services and for coordinating the work of provincial governors. In this capacity, he was responsible for the arrests of activists and opposition members, as well as for the disproportionate use of force, such as the violent crackdown on members of the Bundu Dia Kongo (BDK) movement in Kongo Central, the repression in Kinshasa from January to February 2017 and the disproportionate use of force and violent repression in the Kasai provinces. In this capacity, Emmanuel Ramazani Shadary was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. Since February 2018, Emmanuel Ramazani Shadary has been permanent secretary of the *Parti du peuple pour la reconstruction et le développement* (PPRD), which until December 2020 was the main party in the coalition under former President Joseph Kabila. In that capacity, in July 2022, he declared that the PPRD was ready to go for the presidential elections in 2023.	29.5.2017

	Name	Identifying information	Grounds for listing	Date of listing
9	Kalev MUTONDO	a.k.a. Kalev Katanga Mutondo; Kalev Motono; Kalev Mutundo; Kalev Mutoid; Kalev Mutombo; Kalev Mutond; Kalev Mutondo Katanga; Kalev Mutund DOB: 3.3.1957 Nationality: DRC DRC passport number: DB0004470 (valid from 8.6.2012 to 7.6.2017) Address: 24, avenue Ma Campagne, Kinshasa, DRC Gender: Male	As Head of the National Intelligence Service (ANR) until February 2019, Kalev Mutondo was involved in and responsible for the arbitrary arrest, detention and mistreatment of opposition members, civil society activists and others. Kalev Mutondo was therefore involved in planning, directing or committing acts that constitute serious human rights violations or abuses in the DRC. In May 2019, he signed a declaration of past and future loyalty to Joseph Kabila, to whom he remains close. Until early 2021, Kalev Mutondo wielded a high degree of political influence, in his role as 'political advisor' to the Prime Minister of the DRC. It is alleged that he still has influence in some parts of the security forces.	29.5.2017

B. Entities'

VENDIM
Nr. 93, datë 22.2.2023

PËR PJESËMARRJEN E PERSONELIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN E NATO-s "FOCOPS", NË DETIN MESDHE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të pikës 1, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit, si dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë", dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e 1 (një) anijeje të klasit "Iliria", e kompletuar me efektivë, të përbërë nga 21 (njëzet e një) ushtarakë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në operacionin e NATO-s "FOCOPS", pjesë e operacionit "*Sea Guardian*", në Detin Mesdhe.

2. Misioni i anijes është kryerja e detyrave të patrullimit, zbulimit detar, dhënies së ndihmës, njohjes së situatës detare, identifikimit, verifikimit, ndalimit të objekteve detare, në përbërje të grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, *Standing NATO Maritime Group*-2 (SNMG2), në detin Adriatik dhe në detin Jon (Deti Mesdhe), në kuadër të operacionit të NATOS-s, "*Sea Guardian*", në Detin Mesdhe.

3. Komandimi operacional i anijes gjatë periudhës së angazhimit në operacion kryhet nga komandanti i grupit të gatshëm të anijeve të NATO-s, SNMG2. Për çdo rast, anija ruan varësinë në nivelin kombëtar, duke raportuar në mënyrë periodike për mbarëvajtjen e operacionit.

4. Kohëzgjatja e këtij operacioni është deri në 20 (njëzet) ditë, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të anijes në operacion.

5. Ministria e Mbrojtjes përballon shpenzimet për personelin pjesëmarrës në këtë operacion dhe për anijen, për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b) sigurimin e jetës;

c) ushqim;

ç) sigurimin e anijes;

d) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

dh) mbështetje shëndetësore;

e) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

ë) karburant, lubrifikante;

f) transport personeli për në zonën e operacionit;

g) aktivitete social-kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së operacionit;

gj) transportimin e individëve të shkëputur nga operacioni për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

h) taksa portuale, shërbime portuale dhe të kalimit nëpër ngushtica;

i) riparim të nivelit të dytë pas kthimit nga operacioni;

j) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

6. Transporti i personelit të anijes që merr pjesë në operacion, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën, për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanderia, transporti i individëve të shkëputur të operacionit për në atdhe, në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline përballohen nga pala shqiptare, përveç rasteve kur arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dypalëshe, ku pala tjetër merr përsipër këto shpenzime.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 94, datë 22.2.2023

PËR MIRATIMIN E STRATEGJISË KOMBËTARE PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË 2023–2030 DHE PLANIT TË VEPRIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1, të nenit 10, të ligjit nr.45/2019, "Për mbrojtjen civile", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë 2023–2030 dhe të planit të saj të veprimit, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
2. Ngarkohen të gjitha ministritë dhe institucionet përgjegjëse për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

STRATEGJIA KOMBËTARE
PËR ZVOGËLIMIN E RISKUT NGA FATKEQËSITË (SKZRF 2023–2030)
TIRANË, TETOR 2022

Konsulenca: ABKONS shpk, Rruga Themistokli Gërmenji 6, Tirana

abkons
LOCAL Knowledge, GLOBAL Standards

Klienti:	UNDP në Shqipëria rruga "Skenderbej", Kati i 2-të, Tiranë, Shqipëri
Titulli Dokumentit:	Strategjia Kombëtare Për Zvogëlimin e Riskut Nga Fatkeqësitë 2023-2030
Versioni	Drafti Përfundimtar
Datë:	15 Tetor 2022
Dërguar:	UNDP në Shqipëri dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile
Projekti:	Forcimi i Aftësive Ripërtëritëse në Shqipëri – Projekti RESEAL, UNDP në Shqipëri.
Ekipi ABKONS i Projektit	
Drejtues i Ekipit të Konsulentëve:	Krunoslav Katic
Konsulent Strategjie	Josif Gjani
Konsulent kombëtar	Maksimiljan Dhima
Konsulente ndërkombëtare	Natasa Holcinger
Konsulent ndërkombëtar	Vlatko Jovanovski
Menaxhere Projektit	Blerina Kurti

Pasqyra e Lëndës:
Tabela e Përmbajtjes

1. Parathënie
1.1. Falënderime
2. Hyrje
2.1. Konteksti: rëndësia dhe argumentimi
2.2. Qëllimi dhe struktura e dokumentit
2.3. Kuadri ligjor dhe vendi i saj brenda politikës kombëtare
2.4. Procesi i zhvillimit
2.5. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës pas tërmetit të 2019
2.6. Koncepti i Strategjisë së ZRF
3. Gjendja aktuale dhe tendencat: sfidat
3.1. Tërmetet
3.2. Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave
3.3. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët
3.4. Zjarret në pyje
3.5. Rreziqet nga aksidentet teknologjike
3.6. Sëmundjet Infektive
4. Vizioni, Treguesit dhe Objektivat Strategjikë
4.1. Vizioni
4.2. Misioni
4.3. Treguesit e ndikimit
4.4. Objektiva Strategjike
5. Strategjia e zbatimit dhe Korniza Financiare
5.1. Fushat e ndërhyrjes
5.1.1. Fusha 1: Të menaxhojë risqet ekzistuese dhe parandalojë risqet e reja.
5.1.2. Fusha 2: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes
5.2. Komunikimi
5.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneriteti global
5.4. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi
5.4.1. Monitorimi dhe raportimi i progresit
5.4.2. Vlerësimi
5.4.3. Përditësimi dhe përshtatja
6. Elementet ndërsektoriale të Strategjisë së ZRF-së
6.1. Lidhja me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
6.2. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ZRF

6.3. Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe ZRF, ndryshueshmëria dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike

6.4. Grupet e cënueshme dhe ZRF

Shtojca 1: Analiza SWOT

Shtojca 2: Lista e dokumenteve kombëtare në përputhje me Strategjinë

Shtojca 3: Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive për Shqipërinë 2023-2027.

1. **Menaxhimi i riskut të fatkeqësive me shumë risqe**
2. **Tërmetet**
3. **Përmbytjet , vërshimet e ujit dhe çarjet e digave**
4. **Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët**
5. **Zjarret në Pyje**
6. **Aksidentet Teknologjike**
7. **Sëmundjet infektive**
8. **Përmbledhje e Planit të Veprimit**

Shtojca 4. Partneriteti me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe marrëveshjet përkatëse

Shtojca 5. Grupi teknik ndërinstitucional i punës. Rolet, përgjegjësitë dhe baza ligjore të ministrive kryesore dhe agjencive të përfshira në çështjet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile në vend

Figurat

Figura 1: Cikli i Menaxhimit të Emergjencave
Figura 2: Procesi i monitorimit të zbatimit të strategjisë

Tabelat

Tabela 1. Koordinatorët e Strategjisë së ZRF
Tabela 2. Treguesit e ndikimit
Tabela 3. Përmbledhje e ndryshimeve klimatike dhe efektet/risqet në 2100 (Burimi: Albania Revised NDC
Tabela 4. Lista e dokumenteve kombëtare
Tabela 5. Projektet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive me shumë risqe
Tabela 6. Projektet e lidhura me tërmetet
Tabela 7. Projektet e lidhura me përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave
Tabela 8. Projektet e lidhura me rrëshqitjet e tokës, rënien e dëborës dhe ortekët
Tabela 9. Projektet e lidhura me zjarret në pyje
Tabela 10. Projektet e lidhura me aksidentet teknologjike
Tabela 11. Projektet e lidhura me sëmundjet infektive
Tabela 12. Përmbledhje e Planit të Veprimit

SHKURTESAT

AKMC	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
AICS	Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim
AMBU	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AKP	Agjencia Kombëtare e Pyjeve
ASIG	Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor
BB	Banka Botërore
BE	Bashkimi Evropian
CBC	Bashkëpunimi Ndërkufitar
CECIS	Sistemi i Përbashkët i Komunikimit dhe Informacionit të Emergjencave
Desinventar	Sistema de Inventario de Desastres (Sistemi i Inventarit të Fatkeqësive)
DG ECHO	Drejtoria e Përgjithshme për Mbrojtjen Civile Evropiane dhe Operacionet e Ndihmës Humanitare
DPEC	Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (Paraardhësja e AKMC)
DPPI SEE	Iniciativa e Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Jug - Lindore
EERC	Kapaciteti Evropian i Përgjigjes Emergjente (European Emergency Response Capacity)
EM-DAT	Baza e të dhënave të ngjarjeve emergjente
ERCC	Qendra e Koordinimit të Përgjigjes Emergjente
EWS	Sistemi i Paralajmërimit të Hershëm (EWS)
FC	Mbrojtja nga Përmbytjet. (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente)
FRB	Shpëtimi nga Përmbytjet duke përdorur Barkat (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente)
FRMP	Plani i Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve
GFFF	Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente)
GPMSZRF	Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive
GIS	Sistemi i Informacionit Gjeografik
GIZ	Agjencia Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar
HUSAR	Kërkim Shpëtimi i Rëndë Urban (Modul i Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente)
IFBZ	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
IGJEO	Instituti i Gjeoshkencave
IKTK	Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
IN	Instituti i Ndërtimit

INSTAT	Instituti i Statistikave të Shqipërisë
IPA	Instrumenti i Ndihmës së Para Aderimit
ISHP	Instituti i Shëndetit Publik
JICA	Agjencia Japoneze e Bashkëpunimit Ndërkombëtar
KKSH	Kryqi i Kuq Shqiptar
KSZRF	Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive
MAS	Ministria e Arsimit dhe Sportit
MB	Ministria e Brendshme
MC	Mbrojtja Civile
MD	Ministria e Drejtësisë
MBZHR	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
MEPJ	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MIE	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
MK	Ministria e Kulturës
MM	Ministria e Mbrojtjes
MMC BE	Mekanizmi i Mbrojtjes Civile të BE-së
MRF	Menaxhimi i riskut të fatkeqësive
MSHMC	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
MTM	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
MZSH	Mbrojtja nga Zjarri dhe Shpëtimi
NDC	Kontributi i përcaktuar kombëtar (Nationally Determined Contribution)
OBM	Organizata Botërore e Meteorologjisë
OBSH	Organizata Botërore e Shëndetësisë
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
PDNA	Vlerësimi i Nevojave Pas Fatkeqësisë
PEC	Planifikimi/plani i Emergjencave Civile
PHEOC	Qendra Operacionale Emergjente e Shëndetit Publik
PKEC	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile
PNK	Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike
RBMP	Plani i Menaxhimit të Basenit Lumor
RESEAL	Forcimi i Aftësisë Ripërtëritëse në Shqipëri (Projekti i UNDP)
SECO	Sekretariati Teknik i çështjeve Ekonomike
SKZRF	Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë

SLR	Rritja e nivelit të detit (Sea-level rise)
SHGJSH	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
SKMI	Sistemi Kombëtar i Menaxhimit të Incidentit
SKZHI	Strategjia Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim
SWOT	Pikat e forta, Dobësitë, Mundësitë dhe Kërcënimet
TESTA	Shërbimet Trans Evropiane për Telematikë midis Administratave
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNDRR	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive
UNOPS	Zyra e Kombeve të Bashkuara për Shërbime Projektesh
UPT	Universiteti Politeknik i Tiranës
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKR	Vlerësimi Kombëtar i Riskut
VRF	Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive
ZRF	Zvogëlimi i Riskut të Fatkeqësive

1. Parathënie

Fatkeqësitë shkaktojnë humbje që kanë një efekt negativ në më shumë se një element social në zonën ku ato ndodhin.

Pothuajse të gjithë sektorët mbajnë përgjegjësi për të siguruar kapacitetet e menaxhimit të fatkeqësive duke garantuar kështu aftësinë ripërtëritëse dhe parandaluese të përgjithshme të vendit.

Duke e ditur këtë, në zhvillimin e kësaj Strategjie u zgjodh një qasje shumë-sektoriale, me shumë rreziqe për të siguruar përfshirjen e palëve të interesit.

Secili prej rreziqeve u përfaqësua në Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës të ngritur për Zhvillimin e Strategjisë Kombëtare Shqiptare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për të siguruar të gjithë ekspertizën dhe njohuritë përkatëse në zhvillimin e këtij dokumenti strategjik me rëndësi të jashtëzakonshme kombëtare.

Bashkësitë vendore dhe Shqipëria si vend, çdo vit përballen me humbje të konsiderueshme, ndonjëherë shkatërruese, nga fatkeqësitë. Përmbytjet, tërmetet, zjarret në bimësi dhe në pyje, rrëshqitjet e tokës dhe rreziqet e tjera dhe pasojat e tyre kanë një ndikim të konsiderueshëm në komunitet, ekonomi, infrastrukturë dhe mjedis.

Ndikimet e fatkeqësive vlerësohen në rritje për shkak të (i) ekspozimit të shtuar të njerëzve dhe aseteve ekonomike ndaj zonave të cenueshme; (ii) financimit të pamjaftueshëm për zvogëlimin e riskut në vite; dhe (iii) efekteve të ndryshimeve klimatike. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke qenë se të varfrit dhe kategoritë e popullsisë të riskuara nga varfëria preken në mënyrë jo proporcionale nga fatkeqësitë.

Në tre vitet e fundit Shqipëria i është nënshtruar një reforme të thellë në sistemin e saj të menaxhimit të fatkeqësive, duke e zhvendosur fokusin nga një menaxhim pasiv i situatave, në një menaxhim proaktiv, te orientuar drejt parandalimit dhe gatishmërisë. Me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile të sapokrijuar nxitet energji e re në kuadër të qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të adresuar të gjitha sfidat me të cilat po përballet Shqipëria në mbrojtjen e jetës dhe shëndetit të popullsisë, mjedisit, aseteve të rëndësishme materiale dhe kulturore, para, gjatë dhe pas fatkeqësive.

Si asnjëherë më parë në historinë moderne të Shqipërisë, po ndërmerren përpjekje të koordinuara nga qeveria për krijimin e një sistemi të qëndrueshëm të menaxhimit të fatkeqësive në vend, i cili do të jetë i gatshëm për të përballuar të gjitha sfidat, si ato aktuale edhe ato të ardhshme. Nëpërmjet një procesi të hartuar me kujdes dhe gjithëpërfshirës, këtë vit do të finalizohen Vlerësimi Kombëtar i Riskut, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë dhe Plani Kombëtar për Emergjencat Civile. Paralelisht me proceset e planifikimit strategjik, ne po rrisim gjithashtu kapacitetet tona të përgjigjes duke modernizuar dhe pajisur Shërbimin tonë të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit.

Zhvillimi i strategjive kombëtare dhe vendore për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive është një nga shtatë objektivat e Kuadrit Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015–2030. Strategjitë për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive janë guri themelit i të gjitha veprimeve të formalizuara për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive dhe vendosin drejtimin strategjik për zhvillimet e mëtejshme të sistemit kombëtar. Si e tillë, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë e Shqipërisë përcakton qëllimet dhe objektivat në periudha të ndryshme kohore, si dhe me objektiva, tregues dhe afate kohore konkrete. Për më tepër, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive promovon vendosjen e

rregullimeve funksionale për koordinimin midis të gjithë aktorëve në Shqipëri dhe përcakton fushat kritike ku kapacitetet duhet të forcohen.

Në samitin e fundit të Platformës Globale për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në Indonezi në maj 2022[1], shtetet anëtare ranë dakord për Axhendën e Balit për Aftësitë Ripërtëritëse. Kjo axhendë kërkon transformimin e mekanizmave të qeverisjes së riskut për të siguruar që menaxhimi i riskut është një përgjegjësi e përbashkët ndërmjet sektorëve, sistemeve, shkallëve dhe kufijve. Unë besoj fuqimisht se përmes këtij dokumenti strategjik po reflektojmë pikërisht përmbushjen e këtij angazhimi me qëllim që zvogëlimi i riskut të fatkeqësive të jetë prioriteti i të gjithëve.

Haki Cako

Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile

1.1. Falënderime

Dokumenti i Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë është përgatitur nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile me mbështetjen e drejtpërdrejtë të ministrit të Mbrojtjes z. Niko Peleshi, në kuadër të angazhimit të qeverisë shqiptare për zvogëlimin dhe parandalimin e risqeve të fatkeqësive.

Strategjia u zhvillua në kuadër të projektit të UNDP, "Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri - Reseal".

Grupi Teknik Ndër-Institucional i Punës për Përgatitjen e Strategjisë Kombëtare të Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive u drejtua nga Drejtori i Përgjithshëm i AKMC, Z. Haki Çako. Të dhënat u mblodhën me kontributin e ministrive dhe institucioneve, të cilat ishin pjesë integrale e procesit të përgatitjes së dokumentit të strategjisë.

Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile falënderon të gjithë institucionet, organizatat dhe individët e përfshirë në bashkë-hartimin e Strategjisë së parë kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për kohën, përpjekjen dhe ekspertizën e tyre. Ky dokument nuk do të ishte bërë i mundur pa këto kontribute.

[1] https://globalplatform.undrr.org/publication/co-chairs-summary-bali-agenda-resilience

2. Hyrje

2.1. Konteksti: rëndësia dhe argumentimi

Qeveria e Shqipërisë, duke iu përgjigjur angazhimeve të pranuara globalisht si pjesë e Kuadrit Sendai[2], si vend anëtar me të drejta të plota i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE), duke aspiruar të bëhet një shtet i ardhshëm anëtar i BE-së por sidomos duke synuar që Shqipëria të bëhet një vend me aftësi ripërtëritëse ndaj fatkeqësive, mbështet zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (SKZRF). Edhe pse parakushtet për sa i përket kuadrit ekzistues të nivelit kombëtar dhe ekspertizës ekzistonin, duhet theksuar se pika e kthesës që nxiti ndryshimet në mënyrën se si perceptohej sistemi i Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive (ZRF) në Shqipëri, ishte tërmeti i 26 nëntorit 2019. Pikërisht atëherë, Qeveria Shqiptare e konsideroi këtë fatkeqësi të madhe si një mundësi për të forcuar sistemin e përgjithshëm të ZRF, si në aspektin e kapaciteteve ashtu edhe të planifikimit strategjik. I gjithë ky proces i forcimit të ZRF-së është diçka që Qeveria Shqiptare mund të jetë dhe është e gatshme ta paraqesë ndërkombëtarisht si një shembull të praktikës më të mirë.

Shqipëria cënohet nga një sërë fatkeqësish natyrore. Rreziqet kryesore që prekin Shqipërinë janë tërmetet, përmbytjet, zjarret pyjore dhe rrëshqitjet e tokës. Rreziqet e tjera përfshijnë stuhi dëbore, thatësirë, ekstreme të temperaturës, epidemi, ortekët, rreziqe teknologjike (p.sh., shpërthime të digave) dhe stuhi të erës. Baza e të dhënave ndërkombëtare të Fatkeqësisë (EM-DAT) tregon se, gjatë viteve 1979-2019, përmbytjet përbënin pjesën kryesore të ngjarjeve të fatkeqësive (38%), të ndjekura nga tërmetet (15%). Cenueshmëria e popullsisë shqiptare ndaj fatkeqësive të shkallëve të mëdha dhe të vogla shoqërohet nga varfëria, infrastruktura dhe komunikimet me cilësi të dobët, rritja e ndërtimeve dhe një sërë faktorësh mjedisorë të ndikuar nga njeriu, nga shpyllëzimi i shpejtë dhe menaxhimi i dobët i baseneve ujore deri te ndotja e mjedisit. Për më tepër, edukimi dhe ndërgjegjësimi i popullatës mbi këto risqe mbetet i ulët.

Të dhënat më të fundit tregojnë se Shqipëria është në mënyrë eksponenciale më e cenueshme ndaj fatkeqësive pasi në dekadën e fundit të gjitha rreziqet e lartpërmendura në një moment janë kthyer në një emergjencë në shkallë të gjerë ose në një fatkeqësi. Raporte dhe dokumente të shumta evidentojnë nivelin e lartë të risqeve që kërcënojnë vendin, ekspozimin dhe cenueshmërinë e lartë, por edhe kapacitetin e pamjaftueshëm për t'u përballur dhe përshtatur me to. Si rezultat i ekspozimit të lartë dhe kapaciteteve të pamjaftueshme përballuese, fatkeqësitë po prekin rrugën e zhvillimit të Shqipërisë, kështu që mesatarisht dëmet nga tërmetet dhe përmbytjet vlerësohen në 147 milionë dollarë në vit, me një ngjarje katastrofike, si një tërmet 1 në 100 vjet për shembull që shkakton dëme mbi 2 miliardë dollarë.

Në këtë kuptim u konstatua se mungonte qasja strategjike e Zvogëlimit të Riskut të Fatkeqësive, për shembull, mungesa e SKZRF-së është evidente në gjetjet e Raporteve të njëpasnjëshëm të Progresit të Komisionit Evropian për Shqipërinë, duke përfshirë Raportin e fundit të Progresit për vitin 2021, ndërsa nevoja për përgatitjen e një dokumenti strategjik për gatishmërinë ndaj emergjencave evidentohet në SKZHI 2015-2020.

Sipas terminologjisë së Zyrës së Kombeve të Bashkuara për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (UNDRR), Menaxhimi i Riskut të Fatkeqësive (MRF) është aplikimi i politikave dhe strategjive për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive për të parandaluar riskun e ri të fatkeqësive, për të zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive dhe për të menaxhuar riskun e

[2] Objektivi F - Rritja e konsiderueshme e numrit të vendeve me strategji kombëtare dhe lokale për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive deri në vitin 2020

mbetur, duke kontribuar në forcimin e aftësive ripërtëritëse dhe zvogëlimin e humbjeve nga fatkeqësitë.[3]

Ristrukturimi i fundit i sistemit kombëtar të menaxhimit të fatkeqësive ishte një hap në drejtim të një sistemi të qëndrueshëm dhe efikas të menaxhimit të fatkeqësive, megjithatë ka shumë për të bërë në aspektin e ndërgjegjësimit dhe njohurive për riskun, zhvillimin e kapaciteteve, zhvillimin dhe përforcimin e infrastrukturës, komunikimin dhe bashkëpunimin ndërsektorial, si dhe gatishmërinë për përgjigje dhe rimëkëmbje.

Investimi në zvogëlimin e riskut të fatkeqësitë mund të rezultojë jo vetëm në zvogëlimin e humbjeve dhe dëmeve, por në qëndrueshmëri ekonomike dhe mundësi të reja. Periudha e zhvillimit dhe ristrukturimit të shpejtë të vendit është koha e përsosur për të integruar zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në zhvillimin e politikave të qeverisë në të gjitha nivelet, për të paraqitur investime të ndërgjegjshme ndaj riskut dhe për të siguruar që zhvillimet e reja të jenë të zgjuara dhe të qëndrueshme. Një përqasje gjithëpërfshirëse dhe shumë-sektoriale, që merr mësimet e nxjerra nga politikat, strategjitë dhe kërkimet ndërkombëtare, kombëtare dhe lokale të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në botë, mund të trajtojë faktorët e riskut dhe jo thjesht pasojat dhe duke e bërë kështu Shqipërinë një vend më të sigurt, më ripërtëritës – një shembull dhe spirancë për vendet e saj fqinje dhe një anëtar dinjitoz të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së.

2.2. Qëllimi dhe struktura e dokumentit

Qëllimi kryesor i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Shqipëri (Strategjia) është të drejtojë aktivitetet dhe investimet e ardhshme të Shqipërisë për menaxhimin e riskut të fatkeqësive në një mënyrë tërësore dhe gjithëpërfshirëse. Shqipëria ka identifikuar rreziqet më të rëndësishme kombëtare natyrore dhe të shkaktuara nga njeriu që mund të shkaktojnë një fatkeqësi dhe ka analizuar dhe vlerësuar riskun nga fatkeqësitë në Vlerësimin Kombëtar të Riskut 2022. Hapi tjetër i natyrshëm sipas ciklit të menaxhimit të fatkeqësive dhe objekt i kësaj Strategjie është të përmbledhë të gjitha aktivitetet dhe investimet e menaxhimit të fatkeqësive në mënyrë që të planifikohet zvogëlimi i riskut të risqeve të analizuara, të parandalohet zhvillimi i risqeve të reja dhe të menaxhohet risku i mbetur.

Figura 1: Cikli i Menaxhimit të Emergjencave

[3] https://www.undrr.org/terminology/disaster-risk-management

Sistemi i ri i mbrojtjes civile në Shqipëri do të jetë një sistem modern që ndjek të gjitha fazat sipas ciklit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe duke përfshirë të gjithë sektorët përkatës dhe nivelet e qeverisjes. Kjo Strategji është hapi i radhës në zhvillimin e mëtejshëm të këtij sistemi funksional në periudhën e parashikuar 8-vjeçare.

Prandaj, Strategjia përshkruan lidhjen me dokumentet përkatëse ndërkombëtare dhe kombëtare të lidhura me zvogëlimin e riskut të fatkeqësive, rrethanat aktuale të sistemit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në Shqipëri dhe statusin, potencialin dhe boshllëqet në lidhje me secilin prej risqeve që duhet të zvogëlohen nën udhëheqjen e kësaj Strategjie. Strategjia identifikon kornizën financiare të aktiviteteve të planifikuara, misionin, vizionin dhe qëllimet dhe përshkruan sistemin e monitorimit të zbatimit të Strategjisë.

Për të siguruar zbatimin e suksesshëm dhe realist të Strategjisë, Plani i parë 5-vjeçar i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive mund të gjendet bashkëlidhur Strategjisë.

2.3. Kuadri ligjor dhe vendi i saj brenda politikës kombëtare

Kjo Strategji është dokumenti themelor për të gjitha veprimtaritë dhe investimet e ardhshme të menaxhimit të riskut të fatkeqësive, si dhe dokumentet e tjera relevante të mbrojtjes civile, përgjigjes, rimëkëmbjes dhe planifikimit të zhvillimit. Strategjia është hartuar nga Qeveria Shqiptare nën koordinimin e Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile (AKMC) dhe do të miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Baza ligjore për Strategjinë është e specifikuar për herë të parë në ligjin Nr. 103/2014, datë 31.07.2014 “Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë” ku “miratimi i Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Mbrojtjen Civile” u caktua si një nga objektivat e domosdoshmërisë strategjike nr.5 – “Konsolidimi i Sektorit të Mbrojtjes dhe Sigurisë”.

Në vijim, VKM nr. 348, datë 11.5.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020 edhe pse nuk përmban një kapitull plotësisht të dedikuar për ZRF dhe MC, për herë të parë ky dokument përfshin kapitullin e përbërë nr.8.5: “Forcimi i rendit publik dhe përgatitja për emergjencat civile”.

Paragrafi “sfidat” përfshin një përmbledhje të tetë sfidave kryesore të menaxhimit të MRF dhe të MC ndër të cilat veçojmë sfidën nr.4: Nevojën për të përgatitur një dokument strategjik për përgatitjen për emergjencat.

Në këtë kapitull, forcimi i menaxhimit të MRF dhe MC, përcaktohet që do të realizohet nëpërmjet:

- Përgatitjes dhe miratimit të Planit Kombëtar Operacional për Menaxhimin e Integruar të Emergjencave Civile;
- Përditësimit dhe forcimit të legjislacionit dhe rregullave të lidhura me të, në përputhje me standardet e BE-së;
- Forcimit të kapaciteteve të entiteteve të përgatitjes për emergjenca dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive në gjithë Shqipërinë;
- Mbledhjes dhe organizimit të informacionit për risqet dhe forcimit të sistemit të paralajmërimit të hershëm; dhe
- Rishikimit të tregut të sigurimeve të lidhur me katastrofat.

Aktualisht, bazuar në Urdhrin e Kryeministrit nr.157, datë 30.12.2021 "Për hartimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2021-2030" është në proces hartimi i SKZHI 2021-2030.

Përpara tërmetit të vitit 2019, Qeveria e Shqipërisë miratoi një ligj të ri nr. 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i cili zëvendësoi ligjin nr. 8756/2001 "Për Emergjencat Civile", të ndryshuar, dhe e vendosi AKMC-në në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes (MM). Ligji i ri ofron një kuadër solid për promovimin e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe kërkon zhvillimin dhe miratimin e një strategjie kombëtare për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.

Në nenin 10, pika 1, të ligjit nr.45/2019 "Për Mbrojtjen Civile" përcaktohet se Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë do të jetë dokumenti bazë strategjik i Republikës së Shqipërisë që përcakton politikat e aktivitetet e institucioneve dhe të strukturave qendrore e vendore, si dhe të gjitha subjekteve të tjera në menaxhimin e riskut nga fatkeqësitë, dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave, me propozim të ministrit.

Në nenin 18, pika "a", të ligjit nr.45/2019 për Mbrojtjen Civile përcaktohet se Këshilli i Ministrave miraton Strategjinë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë në Republikën e Shqipërisë.

Sipas nenit 23, pika 1, të ligjit nr. 45/2019, AKMC që është një person publik qendror, në varësi të ministrit përgjegjës për Mbrojtjen Civile, do të koordinojë dhe bashkërendojë përpjekjet për zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, e cila do të miratohet nga Qeveria Shqiptare

Kjo do të jetë Strategjia e parë Kombëtare Shqiptare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë. Deri në miratimin e këtij dokumenti, Plani Kombëtar për Emergjencat Civile të Shqipërisë dhe ligji nr. 45/2019 ishin dy dokumentet kryesore në fushën e Mbrojtjes Civile, por asnjë dokument nuk përfshinte të gjitha aktivitetet e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në të gjithë sektorët në vend.

2.4. Procesi i zhvillimit

Fatkeqësitë shkaktojnë shumë humbje dhe dëme dhe ndikojnë negativisht në më shumë se një element social në zonën e goditur, duke shkaktuar kështu një degradim të standardit të jetesës dhe pamundësojnë progresin dhe prosperitetin e shoqërive.

Prandaj është e qartë se më shumë se një sektor vuan nga humbjet gjatë një fatkeqësie dhe është i detyruar të marrë përgjegjësinë dhe të sigurojë aftësinë ripërtëritëse të sektorit, vazhdimësinë e biznesit dhe qasjen e shoqërive në shërbimet bazë, si dhe të kontribuojë në aftësinë ripërtëritëse të përgjithshme të vendit. Aftësia ripërtëritëse e një vendi varet nga niveli i aftësisë ripërtëritëse të secilit prej sektorëve, në secilin nga nivelet e qeverisjes dhe nga aftësia ripërtëritëse e çdo personi. Qëllimi i kësaj Strategjie është të përcaktojë hapat me rëndësinë më të madhe në rrugën drejt një Shqipërie më të sigurt.

Një aftësi e tillë ripërtëritëse nuk mund të arrihet me përfshirjen aktive të vetëm një sektori, atij përgjegjës për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive në nivel kombëtar. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është punë e të gjithëve dhe duhet të trajtohet në bashkëpunim me të gjithë aktorët përkatës.

Duke e njohur këtë, Shqipëria zgjodhi një qasje shumë-sektoriale dhe me shumë rreziqe në zhvillimin e kësaj Strategjie për të siguruar përfshirjen e palëve të interesit më vonë në fazën

e zbatimit, si dhe për të siguruar që të identifikohen boshllëqet më të rëndësishme dhe objektiviteti dhe rëndësia e aktiviteteve të zgjedhura.

Strategjia trajton rreziqet më të rëndësishme për Shqipërinë, në përputhje me Vlerësimin Kombëtar të Riskut (VKR). Për secilin nga rreziqet u krijua një grup ndërinstitucional pune dhe secili prej grupeve të punës u përfaqësua nga koordinatori i tij në Grupin Teknik Ndërinstitucional të Punës për Zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë.

Tabela 1. Koordinatorët e Strategjisë së ZRF

Koordinatori kryesor i zhvillimit të Strategjisë Kombëtare të ZRF	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Rreziku	**Organi koordinues i nëngrupit të punës të riskut për zhvillimin e SKZRF**
Tërmetet	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Zjarret në pyje	Ministria e Brendshme
Aksidentet teknologjike	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Sëmundjet infektive	Ministria e Shëndetësisë

Në këtë mënyrë u sigurua përfshirja e të gjithë aktorëve përkatës, si dhe përdorimi i të gjitha të dhënave ekzistuese dhe ekspertizës në dispozicion duke ndikuar edhe në pronësinë e rezultateve të procesit të përgjithshëm.

Strategjia u zhvillua në kuadër të Projektit "Forcimi i aftësisë ripërtëritëse në Shqipëri - RESEAL dhe procesi u lehtësua nga një grup ekspertësh vendas dhe ndërkombëtarë.

Grupi Teknik Ndërinstitucional i Punës për Zhvillimin e Strategjisë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë u ngarkua nga Qeveria e Shqipërisë për të zhvilluar Strategjinë. Koordinimi dhe bashkëpunimi i ngushtë siguroi rrjedhjen e informacionit tek të gjithë të përfshirët në zhvillim, si dhe rrjetëzimin midis grupit kryesor të ardhshëm të zbatimit.

Pas hartimit të draftit, u kryen të gjitha proceset përkatëse kombëtare të konsultimit me qëllim që të sigurohej transparenca e procesit dhe të informoheshin të gjitha palët e interesit si dhe publiku i gjerë për përmbajtjen dhe qëllimin e dokumentit strategjik.

2.5. Arritjet dhe mësimet e nxjerra nga zbatimi i reformës pas tërmetit të 2019

Ligji nr. 8756, datë 26.3.2001 "Për Emergjencat Civile", i ndryshuar, vendosi bazën kryesisht në fushën e planifikimit dhe të përballimit të emergjencave civile, por nuk përfshinte politikat e

zvogëlimit të riskut të fatkeqësive, sikurse kishte boshllëqe thelbësore në shumë fusha të tjera si paralajmërimi i hershëm, edukimi, ndërgjegjësimi publik, trajnimi, ndihma ndërkombëtare dhe inspektimi.

Në vitin 2005, me organizimin e ri strukturor, për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore në Ministrisë së Brendshme, u krijua Drejtoria e Përgjithshme e Emergjencave Civile (DPEC) e cila vazhdoi veprimtarinë e saj në kuadër të Ministrisë së Brendshme deri në fund të vitit 2017. Me VKM nr. 9, datë 12.1.2018, fusha e "planifikimit dhe përballimit të emergjencave civile" i kaloi Ministrisë së Mbrojtjes dhe me urdhër të Kryeministrit nr. 47, datë 9.03.2018, DPEC u transferua në varësi të Ministrisë së Mbrojtjes. Edhe pse ishte një detyrim ligjor, i sanksionuar në nenin 9, pika 1, të ligjit 8756, datë 26.03.2001 "Për emergjencat civile", i ndryshuar dhe në Planin Kombëtar për Emergjencat Civile, Departamenti i Planifikimit dhe Përballimit të Emergjencave Civile, nuk u krijua asnjëherë në ministrinë përkatëse gjatë periudhës kohore 2001-2018.

Për periudhën 2011-2021, sipas Raportit të përvitshëm Botëror të Riskut [4] (Bündnis Entwicklung Hilft and Ruhr University Bochum–Instituti për të Drejtën Ndërkombëtare të Paqes dhe Konflikteve të Armatosura), i cili llogarit indeksin e riskut të fatkeqësive natyrore për shkak të tërmeteve, cikloneve, përmbytjeve, thatësirave dhe rritjes së nivelit të detit, bazuar në ekspozimin dhe cenueshmërinë (ndjeshmërinë dhe kapacitetet përballuese dhe përshtatëse), Shqipëria renditej vazhdimisht në vendin e parë në Evropë. Ndërsa sipas të njëjtit raport vjetor 2022, Shqipëria ka një përmirësim prej 21 vendesh krahasuar me vitin 2021 duke u renditur ndër vendet e para në Evropë dhe në vendin e 82-të në botë.

Raporti i parë në të cilin analizohej gjendja e shërbimit të emergjencave civile në vend, me gjetje dhe rekomandime të rëndësishme për transformimin e tij, ishte Raporti i Komandës së SHBA-së në Evropë, korrik 2014. Raporti konstaton mungesën e planifikimit të koordinuar dhe ekzekutimit të aktiviteteve të menaxhimit të emergjencave. DPEC identifikohet si një organizatë me burime të pamjaftueshme dhe autoritet të kufizuar, të cilat pengojnë aftësinë e saj për të drejtuar përpjekjet e gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive dhe për këtë arsye rekomandohet transformimi i saj në një agjenci nën Kryeministrin ose Këshillin e Ministrave.

Gjithashtu, sipas raportit "Vlerësimi i nevojave pas përmbytjes" të hartuar pas përmbytjeve të mëdha të shkurtit 2015 në jug të vendit, evidentohen kufizime në mandatet, kapacitetet dhe financimet e organizatave përkatëse të sistemit të menaxhimit të fatkeqësive, sikurse pamundësia e autoriteteve të Mbrojtjes Civile në të tre nivelet e qeverisjes për të qenë në gjendje që pa marrë leje ose buxhet të ndërmarrin veprime gjatë një situate krize.

Duke filluar nga Raporti i Progresit 2014 të Komisionit Evropian, çështja e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe Mbrojtjes Civile në Shqipëri u adresua në të vit pas viti, gjë që rriti më tej fokusin e qeverisë shqiptare në këtë fushë.

Strategjia u sanksionua për herë të parë si një detyrim ligjor, në pikën 5 të ligjit Nr. 103/2014, datë 31.07.2014 "Për Miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë dhe në vijim në seksionin 8.5 "Forcimi i rendit publik dhe përgatitjes për rastet e emergjencave civile" të SKZHI 2015-2020, çka përbënte një hap madhor përpara në këtë drejtim.

Në vitin 2019, pas një periudhe të gjatë pune dhe draftesh të njëpasnjëshme të hartuara në vite, u miratua ligji 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile", i cili shfuqizoi pas 18 vitesh ligjin paraardhës 8756, datë 26.03.2001 "Për Emergjencat Civile", të ndryshuar.

[4] https://weltrisikobericht.de/english/

Ligji 45/2019 rregullon funksionimin e sistemit të Mbrojtjes Civile, duke përcaktuar qartë përgjegjësitë e institucioneve dhe strukturave të këtij sistemi, bashkëpunimin ndërkombëtar, të drejtat dhe detyrimet e shtetasve dhe subjekteve private, edukimin, trajnimin dhe inspektimin. Ai siguron përshtatjen e sistemit të Mbrojtjes Civile me standardet evropiane, në përputhje me prioritetet e Kuadrit Sendai sikurse merr në konsideratë detyrimet ndërsektoriale që rrjedhin nga axhenda për zhvillimin e qëndrueshëm 2030, Marrëveshja e Parisit për ndryshimet klimatike dhe Axhenda e Re Urbane.

Një nga objektivat kryesore të ligjit 45/2019 është forcimi i sistemit të mbrojtjes civile, përmes krijimit të AKMC-së që është një person juridik publik qendror në varësi të Ministrit përgjegjës për mbrojtjen civile dhe është përgjegjës për ZRF dhe MC, në të gjithë territorin e vendit.

Disa nga risitë e tjera të ligjit janë:

- Ka përcaktuar strategjinë kombëtare të ZRF-së si dokumentin bazë strategjik në menaxhimin e riskut të fatkeqësive;
- Është paraparë zhvillimi i strategjisë së ZRF edhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore (NJVV) sikurse edhe vlerësimi i riskut të fatkeqësive (VRF) dhe Planet e Emergjencave Civile (PEC) në të tri nivelet;
- Përmban një kapitull të kushtuar për mbrojtjen e infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore;
- VRF, si dhe PEC, janë gjithashtu të detyrueshme për infrastrukturën kritike;
- Përmban sanksione të qarta për të gjitha institucionet publike, subjektet private dhe vendos mekanizmin e inspektimit;
- Përmban përcaktim të qartë për përqindjen e buxhetit të ZRF dhe Mbrojtjes Civile në 2-4% në ministritë e linjës dhe të paktën 4% të buxhetit të bashkisë.

Tërmeti shkatërrimtar i datës 26.11.2019 që tronditi sistemin e Mbrojtjes Civile duke përfshirë DPEC me personelin e saj krejtësisht të pamjaftueshëm, vuri në dukje domosdoshmërinë e zbatimit sa më të shpejtë të ligjit 45/2019 për të ndërtuar dhe forcuar sistemin e Mbrojtjes Civile dhe ndërtimin e një shoqërie ripërtëritëse.

Pas kësaj, dhe në kushtet kur vendi ishte në fazën e rimëkëmbjes nga pasojat e tërmetit të 26.11.2019, ai u godit sërish nga pandemia e shkaktuar nga virusi Covid-19. Kjo mbivendosje e fatkeqësive ndikoi në ritmin e përgatitjes dhe miratimit të akteve nënligjore dhe të reformës në sistemin e MC në tërësi.

AKMC-ja, ka në prioritetet e saj hartimin e tre dokumenteve kryesore qendrore strategjike, të cilët parashikohen të miratohen deri në fund të vitit 2022. Sa i përket kapaciteteve administrative të sistemit të MC, rekrutimi i stafit është në proces në AKMC, sikurse po vazhdon plotësimi i vendeve të punës dhe sektorëve në ministri si edhe plotësimi i strukturave të planifikimit dhe MC në Institucionet e Prefektit dhe në bashki.

Përfundime:

1. Krijimi i AKMC siguroi më në fund kapacitetet e mjaftueshme administrative në nivelin qendror krahas përgjegjësive dhe kompetencave të zgjeruara, duke e shndërruar kështu agjencinë në një organizatë udhëheqëse, prestigjioze dhe të krahasueshme me të gjitha organizatat homologe evropiane;
2. Rritja e kapaciteteve administrative, teknike dhe financiare të të gjithë sistemit të Mbrojtjes Civile është një nga sfidat kryesore me të cilat do të përballet AKMC në rrugëtimin e saj në zbatimin e reformës që filloi me miratimin e Ligjit 45/2019. Rritja e kapaciteteve financiare, bazuar në parashikimet e këtij ligji, por jo vetëm, do të përbëjë në fakt sfidën më të madhe dhe kritike që do të përcaktojë shkallën e suksesit të reformës në tërësinë e saj;

3. Aktivizimi i Komitetit të Mbrojtjes Civile krahas Komisionit Teknik Këshillimor po sigurojnë një ndërthurje midis bashkëpunimit dhe koordinimit ndërinstitucional të nivelit të lartë vendimmarrës me atë teknik.

4. Parimi i subsidiaritetit dhe obligimet e qarta për bashkitë kanë rritur ndërgjegjësimin e tyre për rolin vendimtar që ato luajnë në ZRF dhe MC. Kapacitetet financiare të bashkive janë rritur si rezultat i detyrimit për të planifikuar të paktën 4% të totalit të buxhetit vjetor të tyre për ZRF dhe MC. Megjithatë, ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim pasi kërkohet ndryshimi i mendësisë organizative, sipas së cilës në emergjenca, pritej gjithçka nga ndërhyrja e nivelit qendror;
5. Janë rritur fondet vjetore të kompensimit financiar të familjeve me banesa të dëmtuara nga fatkeqësitë sikurse është përmirësuar përpunimi tekniko-shkencor i dokumentacionit dhe regjistrimi i dosjeve në sistem (kompjuterik). Fondet e menaxhuara nga AKMC-ja për projektet strukturore të parandalimit dhe rehabilitimit të fatkeqësive janë shumëfishuar, sikurse edhe roli i AKMC-së në prokurim, zbatim, mbikëqyrje dhe dorëzim duke rritur përfundimisht rolin e saj në fazën e parandalimit dhe të zbutjes;
6. Duhet të vazhdojnë angazhimet intensive në marrëveshjet ndërkombëtare në projekte dhe programe të ndryshme në fushën e ZRF dhe MC të cilat do përkthehen në përfitime pasi, ndër të tjera, do mundësojnë financime për forcimin e mëtejshëm të kapaciteteve të sistemit të MC në vend;
7. Ngritja e sektorit të inspektimit do të rrisë aftësitë kontrolluese por edhe ndëshkuese të AKMC-së. Gjithsesi, nevojitet sigurimi i një kontrolli të vazhdueshëm, të shoqëruar me vendosjen e penaliteteve ndaj subjekteve kundërvajtës, sipas rastit;
8. Realizimi i anëtarësimit në MMC BE që përbënte një nga prioritetet madhore të AKMC-së do të duhet të shoqërohet edhe me vendosjen e lidhjes TESTA për ndërlidhjen me CECIS. Kjo duhet të shoqërohet edhe me krijimin dhe plotësimin e disa moduleve të BE-së për t'iu bashkuar Kapacitetit Evropian të Përgjigjes Emergjente (EERC);
9. Me ngritjen në AKMC, të Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente, janë rritur ndjeshëm kapacitetet operacionale të AKMC-së, si dhe kapacitetet e paralajmërimit të hershëm të saj. Gjithsesi, bazuar mbi përvojën e deritanishme te menaxhimit te fatkeqësive, shihet si domosdoshmëri rritja e mëtejshme e kapaciteteve operacionale të AKMC-së që përfshin fuqizimin e Qendrave te mbrojtjes Civile ne Qarqe me TIK dhe kapacitete të tjera operacionale.
10. Edhe pse aktivitetet e lidhura me edukimin për ZRF, ndërgjegjësimin dhe trajnimin e publikut janë rritur dhe përmirësuar nevojitet qe këto evente të jenë te planifikuara bazuar mbi programet përkatës të ndërgjegjësimit dhe atyre të trajnimit;
11. Nevojitet forcimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm, integrimi i të dhënave GIS sikurse përpunimi i informacionit të riskut të fatkeqësive dhe të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë nëpërmjet DesInventar;
12. Nevojitet hartimi i bazës së nevojshme ligjore dhe ndërmarrja e të gjitha hapave të tjerë të domosdoshëm për implementimin e plotë të numrit të unifikuar të emergjencave civile 112 në të gjithë vendin;
13. Përcaktimi dhe përfshirja në Ligjin 45/2019 e Shërbimit Vullnetar të Mbrojtjes Civile në Forcat Operacionale dhe miratimi i VKM nr. 667, datë 10.11.2021 "Për trajtimin e vullnetarëve për angazhimin e tyre në aktivitetet e Mbrojtjes Civile apo në operacionet e parandalimit dhe përballimit të fatkeqësive" kanë vendosur bazat për zgjerimin e vullnetarizmit në fushën e Mbrojtjes Civile në vend. Nevojitet të sigurohet zbatimi i masave të tjera të nevojshme për forcimin e vullnetarizmit në të gjitha fazat e MRF;
14. Nëpërmjet nenit 66 të ligjit 45/2019 për krijimin e një fondi solidariteti për përballimin e situatave emergjente, krijohet një instrument financiar shtesë krahas fondeve të ZRF dhe MC të ministrive dhe atyre të bashkive. Gjithsesi, vendit i nevojitet një qasje

gjithëpërfshirëse shumë sektoriale e forcimit të gatishmërisë financiare përmes miratimit dhe më pas implementimit të një Programi Financimit të Riskut të Fatkeqësive çka do të duhet të udhëhiqet nga MFE dhe mbështetet fuqimisht nga AKMC;

15. AKMC duhet të përshpejtojë punën për përfundimin e bazës nënligjore të ligjit 45/2019 sikurse dokumenteve të tjerë si SOP/SOG[5], udhëzime, manuale, rregullore, plane të vazhdimësisë së operacioneve (COOP) dhe vazhdimësisë së Qeverisë (COG) në ministri dhe institucione të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes etj.
16. Përfshirja në ligjin 45/2019 e kapitullit V "Mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe e trashëgimisë kulturore" është një hap i parë dhe i rëndësishëm për forcimin e aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike. Gjithsesi, është i nevojshëm hartimi sa më shpejt i një Ligji për Infrastrukturën Kritike, i cili do të transpozojë legjislacionin e BE-së për infrastrukturën kritike siç është Direktiva e Këshillit të BE-së 2008/114 e datës 8 dhjetor 2008. Krahas kësaj, nevojitet që AKMC të koordinojë punën për kryerjen e vlerësimit të aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe asaj publike, bazuar rezultateve të të cilit do të prioritizohen objektet më në nevojë, do të hartohet projekti i tyre dhe do të kryhen punimet e rehabilitimit të tyre

2.6. Koncepti i Strategjisë së ZRF

Koncepti i Strategjisë ishte të siguronte se ishin përshkruar konceptet dhe kornizat kombëtare dhe ndërkombëtare të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive. Secili prej rreziqeve u përshkrua, dhe për secilin u renditën boshllëqet dhe mundësitë, si dhe nevojat për të zvogëluar në mënyrë të qëndrueshme riskun nga fatkeqësitë. Përmbajtja e Strategjisë është si më poshtë:

1. Hyrje
2. Gjendja aktuale dhe tendencat
3. Vizioni, Treguesit dhe Qëllimet e Politikave
4. Strategjia e zbatimit dhe Korniza Financiare

3. Gjendja aktuale dhe tendencat: sfidat

Ky seksion i Strategjisë shtjellon statusin e menaxhimit të riskut, nevojat dhe potencialet duke përshkruar statusin e secilit risk, faktorët e riskut, kapacitetet dhe boshllëqet e sektorëve të përfshirë në menaxhimin e riskut të fatkeqësive sipas riskut specifik dhe në fund përshkruan nevojat e zhvillimit strategjik.

3.1. Tërmetet

Tërmeti përkufizohet si lëkundje intensive e sipërfaqes së Tokës e shkaktuar nga lëvizjet në shtresat më të jashtme të Tokës[6]. Si i tillë ai klasifikohet si rrezik gjeologjik ose gjeofizik që do të thotë se është rezultat i proceseve të brendshme të Tokës[7]. Tërmetet mund të shkaktojnë lëngëzim, rrëshqitje të tokës, zjarre dhe cunami, të cilat më pas çojnë në nivele shumë më të larta dëmtimesh dhe humbjesh[8].

[5] Udhëzime Operacionale Standarde (Standard Operational Guidelines)
[6] https://spaceplace.nasa.gov/earthquakes/en/
[7] https://www.undrr.org/terminology/hazard
[8] https://www.preventionweb.net/files/52828_01earthquakehazardandriskassessment.pdf

Shqipëria karakterizohet nga veprimtaria e mikrotërmeteve intensive (1.0 < M ≤3.0), e tërmeteve me madhësi të vogël (3.0< M ≤ 5.0) dhe mesatare (5.0 < M ≤ 7.0) dhe vetëm rrallë nga ngjarje me tërmete të mëdha (M>7.0). Shqipëria është një vend që ka përjetuar ngjarje të rëndësishme dhe të rënda sizmike, me 10 tërmete me magnitudë ≥ 6.0 Ms për periudhën 1919 deri më sot, brenda territorit të vendit.

Në Shqipëri ka tri zona sizmo-gjenike gjatësore (Joniane-Adriatike, Shkodër-Mat-Bilisht dhe Drini [Peshkopi-Korçë]) dhe tri tërthore (Shkodër-Pejë, Lushnjë-Elbasan-Dibër dhe Vlorë-Tepelenë).

Në përgjithësi, faktorët kryesorë të riskut për rrezikun sizmik në Shqipëri përfshijnë infrastrukturën e dobët dhe ndërtimet e paligjshme dhe/ose të papërgjegjshme të ndërtesave, të cilat shpesh përfshijnë mosrespektimin e kritereve të sigurisë së vetë ndërtimit dhe vendosjen e ndërtesave në zona me risk të lartë sizmik siç është ish-këneta e Durrësit, ku një tërmet shkakton shembjen e ndërtesave. Përveç kësaj, ekziston një nivel i ulët i sigurimit të pasurive të paluajtshme dhe aftësisë së popullsisë së varfër ekonomikisht (veçanërisht rurale) për t'u rimëkëmbur nga pasojat e tërmeteve.

Për më tepër, në Shqipëri ka 362 diga më të larta se 15 m me zona të populluara poshtë tyre. Ato janë relativisht të vjetra, veçanërisht ato në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural apo pushtetit vendor, të cilat përbëjnë rreth 90% të digave dhe për rrjedhojë më të cenueshme ndaj aktivitetit sizmik. Gjithashtu, kërkohet edhe ndërtimi i digave të reja, disa prej të cilave në zonat e ekspozuara ndaj rrezikut sizmik nga pikëpamja gjeologjike.

Një histori e gjatë tërmetesh në Shqipëri jo vetëm që ka nisur zhvendosjen e popullsisë nga zonat e goditura nga një tërmet, por ka ndikuar ndjeshëm edhe në trashëgiminë kulturore të Shqipërisë. Aktualisht mbi 2220 pasuri kulturore dhe mbi 210 qendra historike, zona të mbrojtura dhe zona arkeologjike të listuara në regjistrin kombëtar të trashëgimisë kulturore konsiderohen të prekshme nga tërmetet për shkak të një sërë faktorësh si vjetërsia e ndërtesave, kushtet e dobëta teknike të ndërtimit dhe projektimit dhe mungesa e mirëmbajtjes. Duke qenë se dëmtimi i aseteve kulturore rezulton jo vetëm në humbje të koleksioneve muzeale, fondeve arkeologjike dhe dokumenteve të rëndësishme arkivore, por edhe në humbje të kujtesës kolektive të komunitetit, humbja e trashëgimisë u vendos një nga shtyllat kryesore në Ligjin 45/2019 "Për Mbrojtjen Civile".

Shërbimi Gjeologjik Shqiptar (SHGJSH) është institucioni këshillimor teknik dhe shkencor i shtetit që ushtron aktivitete në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë dhe ka një bazë të dhënash të fuqishme në lidhje me veprimtarinë e rreziqeve të ndryshme natyrore, përfshirë hartat e rreziqeve gjeologjike. SHGJSH luan një rol kritik në parandalimin e fatkeqësive por edhe në aktivitete të ZRF.

Departamenti i Sizmologjisë së IGJEO (Universiteti Politeknik i Tiranës) është e vetmja njësi operacionale dhe shkencore në Shqipëri që mbulon monitorimin e vazhdueshëm të sizmicitetit në vend. Qendra Kombëtare e Monitorimit të aktivitetit sizmik ka detyrë parësore monitorimin e pandërprerë 24 orë në 24, të aktivitetit sizmologjik të ndodhur brenda territorit të Shqipërisë dhe rreth saj.

Në kuadër të emergjencave civile, kjo qendër mundëson informim thuajse në kohë reale të strukturave përkatëse operacionale mbi situata të emergjencave sizmike. Për përmbushjen e kësaj detyre parësore me një rëndësi të madhe për vendin, kjo qendër disponon dhe operon Rrjetin Sizmologjik Shqiptar, pjesë e të cilit janë:

- rrjeti i lëkundjeve të dobëta sizmike ose rrjeti sizmografik (AWMN);
- rrjeti i lëkundjeve të forta ose akselerografik (ASMN);

- rrjeti gjeodezik në ndihmë të studimit të karakteristikave sizmotektonike të Shqipërisë i përbërë nga disa stacione permanente regjistrimi (GPS). Stacionet e Përhershme (AlbGNSS).

Ka mangësi financiare, për studime të thelluara gjeologjike-inxhinierike të tërmeteve, të cilat reflektohen edhe në mungesën e pajisjeve të modernizuara (sizmografë) për matjen e energjisë së tërmeteve dhe përcaktimin e vendndodhjes së epiqendrave. Për më tepër, është perceptuar një mungesë e bashkëpunimit të vazhdueshëm ndërkombëtar për përparimin e sizmologjisë, si dhe përpjekje të fokusuara në parandalimin e humbjeve të jetëve.

Boshllëku kryesor në sistemin shqiptar të qeverisjes së ZRF-së do të ishte mungesa e strategjisë për zvogëlimin e riskut nga tërmetet, si dhe ristrukturimi organizativ dhe financat e lidhura ngushtë me të. Ka kapacitete të kufizuara si për financat ashtu edhe për personelin e administratës vendore në trajtimin e risqeve dhe pasojave të tërmeteve. Kur bëhet fjalë për parandalimin e fatkeqësive, ekziston ende mosndëshkimi për individët dhe personat juridikë që ndërtojnë pa leje në toka ku ndërtimi është i ndaluar me ligj, ose injorojnë masat e ndërtimit rezistente ndaj tërmeteve. Për më tepër, ndërtesat (përfshirë ato historike dhe veprat e artit) dhe infrastruktura e dëmtuar më parë nga tërmetet ende nuk janë përforcuar nga ana strukturore për t'i bërë ballë tërmeteve të ardhshme dhe ka mangësi kur bëhet fjalë për standardet e rindërtimit. Në rast tërmeti për mungesë fondesh do të ketë sfida lidhur me vlerësimin e ndërtesave dhe rikonstruksionin e godinave të vlerësuara nga autoriteti përkatës. Gjithashtu, ende nuk janë konsoliduar njësitë organizative të mbrojtjes civile në administratën qendrore dhe strukturat e planifikimit dhe MC në administratën lokale, gjë që me shumë mundësi do të çojë në vonesa në përgjigjen ndaj tërmeteve dhe dëmtime dhe humbje më të mëdha. Së fundmi, nivelet e ndërgjegjësimit dhe gatishmërisë të popullatës së përgjithshme ndaj tërmeteve janë të ulëta.

Në komunikim me qeverinë dhe institucionet përkatëse shtetërore, janë evidentuar masa të shumta të nevojshme për rritjen e aftësisë ripërtëritëse kombëtare ndaj tërmeteve, disa prej të cilave janë:

- Krijimi/përmirësimi i dokumenteve strategjike që adresojnë riskun e tërmeteve në çdo bashki;
- Rritja e numrit të ekspertëve të fushës në administratën vendore;
- Përditësimi dhe zbatimi i hartave dhe Kodeve të Rrezikut Sizmik për Projektimin e Ndërtesave Rezistente ndaj Tërmeteve në përputhje me Eurokodin;
- Kryerja e vlerësimeve sizmike të digave, shkollave, spitaleve dhe institucioneve të tjera që ushtrojnë funksione kolektive, godinave të Ministrive dhe institucioneve përbërës të Komisionit Teknik Këshillimor si dhe objekteve të tjera informale;
- Pushteti qendror dhe vendor duhet të sigurojnë që rezultatet e studimeve të SHGJSH të merren parasysh në planifikimin urban dhe menaxhimin e territorit të bashkive në mënyrë që të mos jepen leje ndërtimi në zona me ekspozim të lartë ndaj efekteve të tërmeteve;
- Rritja e shkallës së përgjegjësisë vendimmarrëse lidhur me menaxhimin e territorit dhe plotësimi i kuadrit ligjor të nevojshëm lidhur me punimet e ndërtimit dhe aspektet mjedisore që çojnë në ndryshimin e ekuilibrit natyror të territorit;
- Dënimi i personave dhe personave juridikë që ndërtojnë objekte pa leje ose nuk respektojnë masat e sigurisë në ndërtim;
- Përmirësimi i vazhdueshëm i sistemit të monitorimit sizmik;
- Bashkëpunimi për ZRF me vendet fqinje që përjetojnë aktivitet të ngjashëm sizmik si Shqipëria;
- Konsolidimi i stafit të Mbrojtjes Civile në administratën qendrore dhe lokale;

- Ngritja e kapaciteteve të reaguesve të parë dhe bashkëpunimi i tyre me AKMC-në dhe organet e tjera qeveritare dhe joqeveritare;
- Koordinimi i programeve/strategjive për trajtimin e pasojave të tërmeteve për të minimizuar risqet dhe kostot përkatëse të rimëkëmbjes;
- Përfshirja e informacionit bazë për tërmetet në kurrikulat shkollore.

Gjithashtu, theks i veçantë i është kushtuar mbrojtjes së trashëgimisë kulturore. Duhen marrë masa të shtuara për përforcimin strukturor sizmik të ndërtesave historike duke ruajtur në maksimum vlerat e trashëgimisë, nëpërmjet metodave tradicionale të përforcimit dhe restaurimit në masën maksimale të mundshme, duke siguruar nivele optimale të sigurisë. Duke qenë se ka vetëm pak mjeshtër të aftë në ndërtimet tradicionale, duhet të organizohet transferimi i njohurive dhe trajnimet e mjeshtrave të rinj të ndërtimit tradicional me manualet dhe udhëzuesit përkatës, si dhe trajnime për ekipet operacionale të emergjencave civile për përgjigjen emergjente ndaj trashëgimisë kulturore të dëmtuar. Për më tepër, është propozuar edhe zhvillimi i aplikacionit ueb/mobil për mbledhjen në kohë reale të të dhënave për dëmtimin e aseteve kulturore në rast fatkeqësie.

3.2. Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Mesatarja vjetore e reshjeve në Shqipëri është 1,485 mm/vit. Ajo varion nga 1000 mm/vit për ultësirat deri në 3000 mm/vit në zonat malore. Rreth 70% e totalit të reshjeve vjetore bie në periudhën tetor-mars. Nëntori është muaji me nivelin më të lartë të reshjeve.

Në Shqipëri rreth 130 000 ha janë të mbuluara me infrastrukturën e mbrojtjes nga përmbytjet. Megjithatë, përmbytjet e dimrit dhe thatësirat e verës po bëhen gjithnjë e më të shpeshta, veçanërisht gjatë dy dekadave të fundit.

Infrastruktura mbrojtëse e lumenjve dhe përrenjve malorë në vend është ndërtuar kryesisht pas përmbytjeve katastrofike të dimrit 1962-63. Përmbytje të konsiderueshme kanë ndodhur edhe në jug të vendit, në vitet 2015, 2017, 2018 dhe 2021.

Një vlerësim i bërë për gjendjen teknike të 626 digave, rezultoi në përfundimin se 410 (ose 65% e numrit të përgjithshëm), shfaqin probleme të theksuara teknike dhe kërkojnë vëmendje urgjente.

Drenazhimi i ujërave është përkeqësuar gjithashtu për shkak të përmbytjeve të kanaleve kulluese dhe uljes së kapacitetit kullues të hidrovorëve. Situata pritet të përkeqësohet më tej për shkak të ndryshimeve klimatike, të cilat janë pasqyruar në fenomene ekstreme të motit.

Vlerësohet se ka një numër të konsiderueshëm ndërtimesh pa leje në infrastrukturën e ujitjes, kullimit dhe mbrojtjes nga përmbytjet. Urbanizimi dhe ndërhyrja njerëzore nga njëra anë, degradimi natyror nga ana tjetër, kanë bërë që shumë prej infrastrukturave mbrojtëse të jenë jashtë funksionit ose gjysmë-funksionale, në një mjedis ku frekuenca, ashpërsia dhe shpërndarja gjeografike e përmbytjeve janë në rritje.

Për sa i përket sistemeve të paralajmërimit të hershëm (EWS) në lidhje me përmbytjet, duhet të theksohet se deri më tani janë kryer disa studime të paralajmërimit të përmbytjeve duke synuar pellgje të shumta lumore.

Instituti i GjeoShkencave është aktori kryesor që zbulon, monitoron, analizon, parashikon dhe shpërndan dhe komunikon në kohë informacionin paralajmërues për përmbytjet e mundshme.

Për të forcuar dhe rritur nivelin e menaxhimit të riskut nga përmbytjet, Shqipëria po harton dokumentin e Planit të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve të përbërë nga 3 komponentë:

1. Vlerësimin Paraprak të Riskut nga përmbytjet që çon në identifikimin e zonave ku ekziston risku i mundshëm i përmbytjeve ose ka të ngjarë të ndodhin përmbytje;
2. Hartat e rrezikut dhe hartat e riskut nga përmbytjet;
3. Planet e menaxhimit të riskut nga përmbytjet.

Ngjarjet e kaluara që janë vlerësuar kanë shërbyer si informacion i përgjithshëm për identifikimin e zonave të mundshme me risk të lartë të përmbytjeve.

Pavarësisht ndërhyrjeve të bëra në infrastrukturën e mbrojtjes nga lumenjtë, përmbytjet masive dhe të zgjatura, të ndodhura në vitet 2010-2021 tregojnë një rritje të shpeshtësisë së përmbytjeve, e cila ka të bëjë si me faktorë natyrorë ashtu edhe me faktorë njerëzorë.

Disa nga këta faktorë janë: reshjet në sasi dhe intensitet të madh (të pa regjistruara më parë), prurjet e ujit dhe luhatjet e shpejta të nivelit të rrjedhës në shtretërit e lumenjve, ndryshimet në grykëderdhjet e lumenjve, shpyllëzimi, ndryshimi i mbulesës bimore në zonën e ujëmbledhësit, përdorimi pa kriter i agregateve në shtretërit e lumenjve, hedhja e agregateve dhe mbetjeve urbane duke zvogëluar seksionin shoqërues të shtratit të lumit, urbanizimi i zonave pranë brigjeve të lumenjve dhe modifikimi i terrenit dhe zhvillimi i rrugëve përgjatë luginave të lumenjve. Ndikimet e ndryshimeve klimatike përsa i përket ekstremeve të parashikuara të motit, si p.sh. ngjarjet e reshjeve të mëdha dhe rritja e reshjeve janë të lidhura me shfaqjen e përmbytjeve, veçanërisht gjatë dimrit, por edhe gjatë muajve të vjeshtës dhe pranverës. Në të njëjtën kohë, për shkak të nivelit të ulët të zhvillimit të infrastrukturës vaditëse dhe uljes së reshjeve gjatë muajve të verës, pritet edhe rritje e thatësirës, të gjitha lidhur me çështjen e praktikave ende joadekuate të menaxhimit të ujit.

Kuadri legjislativ i menaxhimit të ujërave i përcaktuar me Ligjin Nr. 111/2012 "Për Menaxhimin e Integruar të Burimeve Ujore" përcakton masat për zbutjen efektive si të përmbytjeve ashtu edhe të thatësirave. Megjithatë, pritet që thatësira të ndikojë në sektorin e bujqësisë më shumë sesa përmbytjet apo rrëshqitjet e tokës në të ardhmen e afërt si rezultat i ndryshimeve klimatike. Faktorë shtesë si temperaturat e larta, erërat e forta dhe lagështia e ulët relative kanë potencialin të kontribuojnë gjithashtu në ashpërsinë e një ngjarjeje dhe të gjithë lidhen me ndryshimin e klimës. Thatësirat kanë potencialin të kenë ndikime negative në shkallë të gjerë në sektorin e bujqësisë në Shqipëri. Mbi 3 milionë njerëz u prekën nga thatësira e viteve 1989-1991, e cila ishte një nga fatkeqësitë më të domethënëse që ndodhi në Shqipëri dhe i kushtoi ekonomisë 24 milionë dollarë[9].

Duhet theksuar gjithashtu se siguria e projektimit të argjinaturave në vitet '60, mbi bazën e plotë me një periudhë përsëritjeje nga 10 deri në 35 vjet, është më e ulët, me përllogaritje të plota bazuar në seritë aktuale, të cilat japin vlera të tjera. Përveç kësaj, kapacitetet teknike dhe operacionale të institucioneve shqiptare për parashikimin, monitorimin dhe paralajmërimin e të dhënave hidro-meteorologjike konsiderohen ende të pamjaftueshme dhe si rrjedhojë ka nevojë për investime të mëtejshme në Sistemin e Paralajmërimit të Hershëm (SPH).

Përsa i përket mbrojtjes nga përmbytjet, nga 850 km argjinatura lumore dhe detare, rreth 300 km argjinatura kanë nevojë për riparim, rehabilitim, rindërtim, apo ridimensionim për shkak të ndryshimeve që kanë ndodhur në dekadat e fundit.

Ekziston gjithashtu nevoja për modernizim dhe rehabilitim të rrjetit të stacioneve të motit, mirëmbajtje të rregullt të pajisjeve, lidhje të rregullta të besueshme në internet, staf të ri të kualifikuar, si hidrologë dhe meteorologë dhe dixhitalizim të të dhënave me qëllim përmirësimin e Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm të Shqipërisë.

[9] FAO. (2018) Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri . https://www.fao.org/publications/card/en/c/I8866SQ/

Objektivat kryesore për mbrojtjen nga përmbytjet që duhen arritur brenda një periudhe 9-vjeçare janë:

1. Zvogëlimi i dëmeve nga përmbytjet dhe humbjeve në më pak se 50% të asaj që ka ndodhur vitet e fundit;
2. Rehabilitimi dhe modernizimi i infrastrukturës së dëmtuar dhe ku ka risk shembjeje;
3. Ndërtimi i infrastrukturës së re për zbutjen e përmbytjeve dhe thatësirës aty ku është e nevojshme;
4. Trajnimi i personelit të institucioneve përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin në drejtim të monitorimit, projektimit, ndërtimit dhe riparimit të infrastrukturës mbrojtëse;
5. Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së forcave operacionale ndaj përmbytjeve.

Përveç mbrojtjes së zonave shumë të populluara, qëllimi është të identifikohen zonat dhe kufijtë për mbajtjen e ujit ose zonat e evakuimit dhe të kufizohet ndërtimi i mbrojtjes nga përmbytjet, si argjinaturat, përforcimet e argjinaturës, etj., të cilat në fakt mund të pengojnë lëvizjen natyrale të ujit.

Në të njëjtën kohë, duhet të merren masa jo-strukturore, të cilat janë parandaluese dhe kanë të bëjnë me menaxhimin e zonave me risk nga përmbytjet, si vlerësimi i riskut si për përmbytjet ashtu edhe për thatësirat, hartografimi, paralajmërimi i hershëm dhe sistemet e parashikimit. Duhet të bëhet një vlerësim i mbrojtjes shtesë nga përmbytjet e nevojshme në zonat me risk të mesëm dhe të lartë nga përmbytjet dhe duhet të organizohet ndërtimi i kapaciteteve të personelit në strukturat përgjegjëse për ujitjen dhe kullimin. Masat e tjera kyçe përfshijnë: hartimin e kurrikulave shkollore për riskun nga përmbytjet, bashkëpunimin me vendet fqinje në lidhje me përmbytjet, rritjen e numrit të ekspertëve të fushës në administratën lokale, programet për trajtimin e pasojave të fatkeqësive nga përmbytjet për të minimizuar risqet dhe kostot përkatëse të rimëkëmbjes, shqyrtimi rast pas rasti i legjislacionit për çdo leje ndërtimi dhe një bazë të dhënash për të gjitha të dhënat e lidhura me riskun nga përmbytjet.

3.3. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët

Rrëshqitjet e tokës i përkasin grupit të rreziqeve gravitacionale. *Rrëshqitjet* e tokës përkufizohen si dukuri fiziko-gjeologjike që përfaqësojnë një zhvendosje të masave të tokës pa rrokullisje nën veprimin e forcës së gravitetit.

Territori i Republikës së Shqipërisë konsiderohet një vend i ekspozuar ndaj ndryshimeve klimatike dhe rreziqeve natyrore, duke përfshirë, rreziqet me origjine hidrometeorologjike (përmbytjet), meteorologjike (thatësirat, zjarret në pyje) si dhe rrëshqitjet e tokës.

Këto dukuri apo fenomene mund të jenë natyrore të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm gjeologjikë, por mund të shkaktohen edhe nga veprimtaria e njeriut (artificiale). Klima ka një ndikim të drejtpërdrejtë në erozionin e tokës.
Shumë nga pasuritë kulturore ndodhen në terrene të pjerrëta dhe/ose në rrëzë të kodrave dhe maleve. Monumentet kulturore por edhe kështjellat dhe vendet arkeologjike, janë të cenueshme nga rrëshqitjet e tokës si dhe rrëzimet apo shembjet e masave shkëmbore.

Faktorë të rëndësishëm të riskut janë shpyllëzimi dhe dëmtimi i zonave pyjore e vegjetative, dëmtimi i zonave kodrinore nga ndërtimet e papërgjegjshme si dhe dëmtimi i zonave malore nga shfrytëzimi i materialeve ndërtimore (p.sh. guroret) pa kritere dhe pa studimet e duhura gjeologjike. Gjithashtu, dëmtimet dhe devijimet e shtretërve të lumenjve për qëllime ndërtimi ose shfrytëzimi (p.sh., shfrytëzimi pa kriter dhe i pakontrolluar i inerteve), si dhe dëmtimi i kanaleve kulluese ndikojnë në risk në masë të madhe. Për më tepër, korrelacioni i ulët midis efekteve të pritshme të ndryshimeve klimatike si dhe politikave dhe programeve për adresimin e pasojave, kontribuon në nivelin e riskut. Në këtë drejtim, tendencat e ndryshimeve klimatike

po ndikojnë në potencialin e rritjes së sipërfaqeve të pyllëzimit të vlerësuar në 300 ha në vit.

Aktualisht ka vlerësime të mjaftueshme të riskut nga rrëshqitjet e tokës që mund të përdoret si udhërrëfyes për zhvillimin dhe planifikimin hapësinor dhe planet lokale për të zvogëluar këtë risk. Institucioni i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me dukuritë negative gjeodinamike, zotëron një bazë të fuqishme të dhënash duke kryer një numër të madh studimesh me produktet përfundimtare (harta dhe tekste shpjeguese të tyre).

Gjithashtu është në proces rajonizimi gjeologo-inxhinierik për territoret e bashkive të vendit.
Pavarësisht sa më sipër, ka ende pune për të bërë në këtë drejtim, si në perfeksionimin e produkteve të zhvilluara deri tani, ashtu edhe në avancimin e mëtejshëm, për përcaktimin dhe evidentimin e dukurive gjeodinamike, regjistrimin e tyre dhe monitorimin e atyre me rrezikshmëri të madhe.
Në sektorin e bujqësisë, është konstatuar se problemet kryesore të njohura ndër vite janë: emergjenca e shtretërve të lumenjve që shkaktojnë përmbytje dhe gërryerje të tokave bujqësore, dëmtimi i tokës bujqësore nga ndërtimet pa leje, shfrytëzimi i lumenjve për marrjen e inerteve lumore për ndërtime. Problematike është dëmtimi i tokës bujqësore nga ndikimi i ujërave të larta dhe erozioni, të cilat shkaktojnë zhavorr dhe gërryerje të tokës bujqësore. Shfrytëzimi jo i përshtatshëm i tokës në zona të pjerrëta etj. Moszbatimi i praktikave të mira bujqësore lidhur me; Shfrytëzimin e pamjaftueshëm të kanaleve të ujërave të larta, përdorimi i sistemeve joadekuate të ujitjes, etj. Shpyllëzimi dhe mbi-kullotja redukton bimësinë dhe e ekspozon tokën ndaj faktorëve klimatikë. EWS janë jashtëzakonisht të rëndësishme kur bëhet fjalë për rritjen e kapacitetit për të zbutur risqet nga rreziqet natyrore, veçanërisht në lidhje me bujqësinë dhe ato mungojnë në Shqipëri. Gjithashtu, në nivel lokal, në risk kontribuon edhe mungesa e njohurive të ekspertëve të pushtetit vendor për fenomenin e erozionit dhe masat parandaluese për zvogëlimin e riskut.

Kontributi i Shërbimit Gjeologjik Shqiptar, në kuadër të veprimtarisë për përballimin e emergjencave civile, përfshihet brenda kompetencave të saj. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar ka një bazë të dhënash të vlefshme lidhur me veprimtarinë e dukurive të ndryshme natyrore të cilat rrezikojnë komunitetin në përgjithësi. IGJEO është një qendër kombëtare kërkimore dhe është identifikuar si agjencia kombëtare e monitorimit dhe paralajmërimit për rreziqet natyrore. Instituti është i miratuar nga Organizata Botërore e Meteorologjisë (OBM) si Shërbimi Kombëtar Meteorologjik dhe Hidrologjik (SHKMH) për Shqipërinë.

Përveç zonave të mbrojtura, fenomeni i rrëshqitjes prek edhe shumë zona të tjera në territorin e Republikës së Shqipërisë, ku vëmendje më e madhe u duhet kushtuar zonave të populluara, veprave inxhinierike (kryesisht digat, urat, rrugët nacionale, hekurudhat etj.), zonave turistike dhe tokave bujqësore e pyjeve.

Për studime të thelluara gjeologo-inxhinierike të rrëshqitjeve dhe studimeve në përgjithësi ka mangësi financiare. Gjithashtu, për përpunimin dhe leximin e materialit gjeologjik është e nevojshme prania e një specialisti gjeolog në organikën e qeverisjes vendore. Ka mungesë të konsiderueshme të investimeve në infrastrukturë për monumentet kulturore dhe historike. Konstatohen politika dhe fonde të pamjaftueshme për të adresuar problemet e shpyllëzimit si dhe niveli i ulët i zbatimit të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e pyjeve dhe mbrojtjen e territorit në përgjithësi. Mungesa e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore të rrezikuara historikisht nga rrëshqitjet e tokës. Aftësia e ulët për të rikuperuar dëmet në zonat rurale për shkak të nivelit të ulët ekonomik të popullsisë dhe kapacitetit të ulët financiar të bashkive përkatëse. Mungesa e studimeve të thelluara gjeologjike për parandalimin e rrëshqitjeve në të ardhmen lidhur me akset rrugore që ndër vite kanë shfaqur probleme. Mbështetje e ulët financiare për programet e pyllëzimit në zonat me risk të lartë erozioni. Niveli i ulët i njohurive për përdorimin e burimeve tokësore lidhur me erozionin dhe EWS joadekuate në lidhje me

kushtet e motit që ndikojnë në shfaqjen dhe aktivizimin e rrëshqitjeve të tokës.

Ortekët e borës, të ngjashme me rrëshqitjet e tokës, i përkasin rreziqeve gravitacionale. Një ortek karakterizohet nga lëvizja e shpejtë në rënie e një mase dëbore.

Shqipëria është një vend i karakterizuar nga pjerrësi e lartë e shpateve të kodrave (>30%), bimësi e varfër pyjore në shumë rajone dhe reshje intensive të borës dimërore. Të kombinuara këto kushte janë të favorshme për shfaqjen e ortekëve që për shkak të modeleve demografike të vendit shoqërohen shpesh me dëmtime materiale. Reshjet e larta të borës janë karakteristike për Alpet Shqiptare dhe për rajonet malore qendrore dhe jugore. Periudha me riskun më të lartë për reshje të dendura bore është nga nëntori deri në fund të marsit. Vetëm në vitin 1985 ortekët shkaktuan vdekjen e 68 personave dhe shkatërrimin e 1604 shtëpive.

Reshjet konsiderohen si shkaktari më i madh i erozionit për shkak të intensitetit dhe shpërndarjes së tyre të parregullt gjatë vitit. Ortekët e borës shkaktohen kryesisht nga reshjet e dendura dhe erërat e forta që çojnë në grumbullimin e shtresave të paqëndrueshme të borës.

Mund të supozohet se pjesa më e madhe e ndërtesave në Shqipëri i përkasin klasave të ndërtesave me rezistencë mesatare dhe të lartë ndaj ndikimit të rrëshqitjes së dheut ose ortekëve. Megjithatë, reshjet e mëdha të borës dhe orteqet e shpeshta kanë shkaktuar dëme të konsiderueshme në dimrat e viteve 1933/34, 1940/41, 1953/54, 1963/64 dhe 1972/73 dhe në vitin 1985. Gjithashtu, mungon harta e konsoliduar e rrugëve/zonave të rrezikuara historikisht nga reshjet e borës dhe EWS joadekuate në lidhje me kushtet e motit që ndikojnë në shfaqjen dhe aktivizimin e ortekëve.

Disa nga masat e nevojshme për përmirësimin e aftësisë ripërtëritëse nga lëvizjet sizmike, rrëzimet e shembjet e masave shkëmbore, lëvizjet e tjera masive, dhe rrëshqitjeve të tokës dhe ortekëve janë:

- Hartimi i instruksioneve/udhëzimeve teknike që mund të përdoren në të ardhmen nga të gjitha njësitë vendimmarrëse në fushën e ndërtimit, në nivel vendor dhe qendror;
- Hartimi i Modelit të Pasaportës së Ndërtesës, me qëllim mbledhjen e informacionit teknik për njësitë e ndërtesës, për të vlerësuar nivelin e cenueshmërisë dhe ekspozimit në një shkallë më të vogël, në kuadër të regjistrimit të ardhshëm;
- Hartimi i udhëzimeve teknike për vlerësimin e infrastrukturës kritike;
- Përgatitja e udhëzimeve teknike dhe propozimi i masave ligjore për fazën e tranzicionit gjatë përmirësimit të kodeve të projektimit;
- Ndërgjegjësimi dhe njohja e studimeve kërkimore midis zyrtarëve të pushtetit qendror dhe vendor për të marrë parasysh gjetjet gjatë hartimit të planeve urbane dhe menaxhimit të përdorimit të territorit në Bashki;
- Rritja e ndërgjegjësimit të popullsisë, monitorimi i territorit;
- Monitorimi rigoroz i shfrytëzimit të lumenjve, ndërtimi i argjinaturave në zonat e dëmtuara;
- Përgatitja e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore të rrezikuara historikisht nga rrëshqitjet (zonimi i rrëshqitjeve);
- Përgatitja e një plani emergjence në rast të përballjes me një fatkeqësi natyrore/rrëshqitje toke;
- Përgatitja e një harte të konsoliduar të zonave/akseve rrugore historikisht të rrezikuara nga ortekët.

3.4. Zjarret në pyje

Zjarr në pyll, shkurre ose bimësi, mund të përshkruhet si çdo djegie ose djegie e pakontrolluar dhe e papërshkruar e bimëve në një mjedis natyror si p.sh. një pyll, livadhe ose tokë me shkurre, e cila konsumon lëndët djegëse natyrore dhe përhapet në bazë të kushteve mjedisore (p.sh., era, topografia). Mund të nxitet nga veprimet njerëzore dhe më pas konsiderohet si një rrezik antropogjenik, ose një rrezik hidrometeorologjik nëse provokohet nga thatësira ekstreme dhe, në raste të rralla, nga rrufeja[10].

Sipas raporteve për vlerësimin e riskut në kuadër të projekteve që përfshijnë Raportin e Vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive Natyrore 2003[11] dhe Struktura Globale për Zvogëlimin dhe Rimëkëmbjen nga Fatkeqësitë (SGZRF) mjeti ThinkHazard[12], rreziku nga zjarret në pyje në Shqipëri klasifikohet si i lartë. Kjo do të thotë se mundësia e kushteve të motit që mbështesin zjarre pyjore të mëdha që mund të rezultojnë në humbje të jetës dhe pronës në çdo vit të caktuar është më e madhe se 50%. Dëmtimi mund të ndodhë si rezultat i ekspozimit të drejtpërdrejtë të flakës dhe rrezatimit, si dhe nga stuhia e prushit dhe zjarri i nivelit të ulët në sipërfaqe. Zonat me pyje dhe bimësi janë kryesisht të rrezikuara nga zjarret e shkaktuara nga njeriu dhe/ose temperaturat e larta gjatë verës.

Risku i zjarreve në pyje me siguri do të rritet në të ardhmen për shkak të ndryshimeve klimatike. Projeksionet e modeluara të klimës së ardhshme identifikojnë një rritje të mundshme në shpeshtësinë dhe ashpërsinë e zjarreve në pyje në Shqipëri, duke përfshirë një rritje të temperaturës në përgjithësi dhe periudha të zgjatura thatësire. Sipas parashikimeve të ndryshimeve klimatike, temperatura mesatare vjetore do të rritet krahas shpeshtësisë së temperaturave jashtëzakonisht të larta, numrit të netëve tropikale dhe kohëzgjatjes së valëve të të nxehtit. Në të njëjtën kohë, parashikohet një ulje e reshjeve vjetore, veçanërisht për muajt e verës, gjë që çon në rritjen e rrezikut të zjarreve. Sezoni i zjarreve ka të ngjarë të rritet në kohëzgjatje dhe të përfshijë një numër më të madh ditësh me mot që mund të mbështesë përhapjen e zjarrit për shkak të periudhave më të gjata pa shi gjatë sezoneve të zjarrit.

Pavarësisht angazhimeve serioze të qeverisë, zvogëlimi i riskut nga zjarret në pyje mbetet një problem madhor në Shqipëri. Së pari, nuk ka ende një dokument të duhur që adreson risqet e zjarreve masive në pyje që të shërbejë si udhërrëfyes për planifikimin hapësinor lokal dhe kombëtar duke marrë parasysh këtë risk. Së dyti, aktet ligjore jo shumë të kuptueshme dhe institucionet me detyra të dyfishta rezultojnë në vendimmarrje shpesh me vonesë, gjë që reflekton në cilësinë e ndërhyrjes për zjarret masive në pyje. Së treti, nuk ka një sistem të mbikëqyrje-sinjalizimit të zjarrit (në pyje) mbarëkombëtar që siguron ndërhyrjen në kohën e duhur. Gjithashtu, janë konstatuar mangësi të theksuara në mjetet zjarrfikëse si dhe mungesë fondesh për trajnimin dhe përgatitjen e forcave të ndërhyrjes. Për më tepër, aktualisht janë rreth 626 rezervuarë për ujitje artificiale të listuara në Kadastrën e Ujit, e cila është e dixhitalizuar dhe menaxhuar nga Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, por nuk ka informacion në lidhje me vendndodhjen dhe kapacitetin e tyre ujor, duke e ulur efikasitetin e tyre për tu përdorur në dispozicion të shuarjes së zjarreve. Ngjashëm me rreziqet e tjera, IGJEO është përgjegjëse për shpërndarjen e EW, duke përfshirë shpërndarjen e të dhënave të parashikimeve dhe monitorimit të zjarreve tek AKMC dhe partnerë të tjerë ZRF në nivele të ndryshme. Në baza ditore gjatë kohës së verës (sezoni i thatë) Qendra Kombëtare e Parashikimit dhe Monitorimit të Rreziqeve Natyrore nxjerr Buletinin e Paralajmërimit për Zjarret në Pyje, i cili i dërgohet me e-mail AKMC, ministrive, prefekturave dhe bashkive. Në punën e

[10] https://www.un-spider.org/category/disaster-type/forest-fire
[11] https://www.geo.edu.al/durres/risk.pdf
[12] https://thinkhazard.org/en/report/3-albania/WF

tyre, Qendra përdor modelin RISICO për të parashikuar dhe monitoruar rreziqet nga zjarret në pyje për të gjithë territorin e Shqipërisë.

Ministria e Kulturës raporton se objektet e trashëgimisë kulturore janë mjaft të cenueshme në lidhje me zjarrin për shkak të mirëmbajtjes së ulët, e cila reflekton në zbulimin e vonuar të tymit brenda ndërtesave, testimin e parregullt të sistemeve automatike të mbrojtjes nga zjarri dhe zjarrfikësve, praninë e linjave të vjetëruara dhe të paizoluara të energjisë që shpesh kalojnë përgjatë tavaneve dhe dyshemeve me çati prej druri me shkallë të lartë ndezjeje dhe shpërndarje si dhe pajisje që mund të reagojnë si burim zjarri dhe rrugë shumë të ngushta në monumente dhe vende të ndryshme që pengojnë aksesin e automjeteve zjarrfikës, ose ka mungesë të plotë aksesi në objektet në zonat e thella malore.

Së fundi, aktualisht ekziston një ndërgjegjësim i kufizuar i qytetarëve për riskun e zjarreve (në pyje) në përgjithësi.

Në komunikim me qeverinë dhe institucionet përkatëse shtetërore, janë evidentuar masa të shumta të nevojshme për rritjen e aftësisë ripërtëritëse kombëtare ndaj zjarreve në pyje, disa prej të cilave janë:

- Rishikimi i kuadrit ligjor dhe krijimi i një ligji kuadër (specifik) për zjarret në pyje;
- Hartimi i një dokumenti për riskun e zjarreve masive në pyje në Shqipëri që përfshin një hartë risku, si instrument për planifikimin hapësinor dhe zhvillimin e sektorit;
- Krijimi i bazës së të dhënave për të gjitha informacionet mbi risqet e zjarreve në pyje, projektet, kërkimet në lidhje me këtë risk, me referencat përkatëse;
- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe rregulloreve të përshtatshme në lidhje me aktivitetet e djegies në fusha dhe kullota në Shqipëri, të cilat do të përfshinin emërtimin e burimeve të kontrollit të ndezjes, identifikimin e sezoneve të djegies, procedurat dhe lejet për djegien, djegien e kontrolluar, sistemet e zbulimit dhe njoftimit të hershëm, etj;
- Zhvillimi dhe zbatimi i politikave dhe rregulloreve të përshtatshme në lidhje me menaxhimin e riskut nga zjarret në pyje në zonat e trashëgimisë kulturore në Shqipëri;
- Trajnimi i njësive të vetëqeverisjes vendore për sistemet e mbikëqyrje-sinjalizimit të ngritura për përmirësimin e sistemit të paralajmërimit të hershëm;
- Përmirësimi i parandalimit dhe përgjigjes ndaj zjarreve në pyje duke modernizuar Qendrën Operacionale të Emergjencave Civile dhe duke siguruar burimet e nevojshme, pajisjet tokësore dhe ajrore dhe infrastrukturën e emergjencës për reaguesit e parë për të menaxhuar siç duhet zjarret në pyje, duke përfshirë edhe aktorët kombëtarë dhe ndërkombëtarë në ofrimin e konsultimeve dhe fondet e nevojshme për zvogëlimin e riskut nga zjarret në pyje.
- Sigurimi i zjarrfikësve me informacione kritike për rezervuarët artificialë të ujit të listuar në Kadastrën Ujore me qëllim të furnizimit me ujë të automjeteve dhe shuarjen e zjarrit në pyje dhe në sipërfaqe të tokës bujqësore;
- Sigurimi i sistemeve të kontrollit të hidranteve dhe shtigjeve të pastra të evakuimit pranë aseteve kulturore;
- Trajnimi, këshillimi dhe monitorimi i fermerëve lidhur me aktivitetet e tyre djegëse për qëllime bujqësore nga Agjencia Rajonale për Ekstensionin Bujqësor e cila vepron në varësi të Ministrisë së Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- Fushata ndërgjegjësuese që informojnë qytetarët për riskun e zjarrit në pyje dhe zvogëlimin e zjarreve të mundshme antropogjene në pyje të shkaktuara nga komuniteti (d.m.th. informacione dhe rregullore në lidhje me zjarret, asgjësimin dhe largimin e mbeturinave, mospirjen e duhanit etj.);
- Ofrimi i planeve të evakuimit të qytetarëve dhe organizimi i simulimeve të situatave të zjarrit për njohjen e komunitetit me procedurën e evakuimit.

3.5. Rreziqet nga aksidentet teknologjike

Sistemet teknologjike sipas përcaktimit shoqërohen me struktura komplekse që mbështeten në funksionalitetin e shumë nënsistemeve. Mosfunksionimi i tyre mund të jetë nga brenda kur një nga nënsistemet shembet ose mund të shkaktohet nga mjedisi i jashtëm si pasojë e goditjeve të jashtme. Sipas raportit Teknik të UNDRR mbi Përkufizimin dhe Klasifikimin e Rrezikut të vitit 2020, rreziqet teknologjike përfshijnë sistemet e transportit (tokë, det, ajër), një gamë të gjerë materialesh të rrezikshme (kimike, radiologjike, bërthamore, biologjike etj.) që mund të shkaktojnë aksidente në objektet industriale, rreziqet që lidhen me TIK-un duke pasur parasysh varësinë tonë të madhe nga teknologjitë e informacionit dhe komunikimit në sektorë jetikë për ekzistencën tonë (banka, energji, shëndetësi, transport etj.) duke e bërë sigurinë kibernetike prioritet në rritje. Ndryshe nga rreziqet e tjera të prioritizuara me Strategjinë, rreziqet tekniko-teknologjike nuk kanë origjinë natyrore. Një aspekt tjetër i rreziqeve tekniko-teknologjike është lidhja e tyre me strukturat sociale dhe ndikimi i tyre në mjedis. Thënë kjo, pajisjet dhe sistemet tekniko-teknologjike mund të rrisin ose zvogëlojnë cenueshmëritë tona si shoqëri dhe u hapin derën efekteve kaskadë të fatkeqësive. Për shembull shkatërrimi i digës që shkakton një përmbytje ose nevoja në rritje për lëndë djegëse fosile që çon në degradim të tokës, erozion, rrëshqitje toke dhe përmbytje të menjëhershme. Prandaj rreziqet tekniko-teknologjike nuk mund të analizohen veçmas nga rreziqet e tjera të prioritizuara me këtë Strategji.

Sipas dokumentit të raportit të riskut teknologjik 2022, rreziqet teknologjike (industriale) janë:

- Teknologjike të instalimeve dhe pajisjeve në industrinë e kërkimit, prodhimit, përpunimit (rafinimit), transportimit dhe tregtimit të naftës, gazit dhe nënprodukteve të tyre (lëndëve djegëse);
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve në industrinë e prodhimit, transportimit, përdorimit dhe depozitimit të substancave të rrezikshme industriale/kimike;
- Teknologjike të minierave dhe instalimeve në industrinë minerare, ne kërkimin (zbulimin) e shfrytëzimin e minierave dhe pasurimin e përpunimin e mineraleve;
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve të rrjeteve të furnizimit dhe shpërndarjes së ujit;
- Teknologjike të instalimeve industriale të prodhimit, transportimit dhe depozitimit të municioneve/lëndëve shpërthyese luftarake;
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve të transportimit, depozitimit dhe përdorimit të lëndëve bërthamore/radioaktive;
- Teknologjike të infrastrukturës së telekomunikacionit;
- Teknologjike të prodhimit/gjenerimit dhe infrastrukturës së transmetimit të energjisë elektrike;
- Teknologjike të impianteve dhe instalimeve të prodhimit në agroindustri.

Më 15 mars 2008, shpërthimi në vend-grumbullimin e municioneve pranë Tiranës shkaktoi 26 të vdekur, mbi 300 persona të plagosur, shkatërrimin e 2300 ndërtesave dhe shpërnguljen e 4000 personave. Të tjera si rrjedhjet e hidrokarbureve në 22 maj 2012 në Portin "Vlora-1" apo zjarri i rezervuarëve të naftës në Shëngjin më 17 dhjetor 2006 po tregojnë efektet negative që këto aksidente kanë në mjedis dhe ekonomi. Aksidentet e transportit janë gjithashtu të dokumentuara mirë në Shqipëri. Sipas INSTAT[13], numri i aksidenteve të raportuara të transportit në periudhën 2014-2021 është 13.742 me 18.491 viktima (të vrarë ose të plagosur). Edhe pse numri i viktimave në ngjarje individuale mund të jetë më i ulët në krahasim me aksidentet e tjera, në baza vjetore numri kolektiv është shumë më i madh duke imponuar

[13] http://www.instat.gov.al/en/themes/industry-trade-and-services/transport-accidents-and-characteristics-of-road-vehicles/#tab2

nevojën për veprime të planifikuara për zvogëlimin e këtij risku. Në tetor 2020, qeveria e Shqipërisë shpalli planin për të patur zero viktima nga aksidentet rrugore deri në vitin 2050.

Menaxhimi i riskut nga rreziqet teknologjike në Shqipëri ndër të tjera do të kërkojë:

- Përpjekje të vazhdueshme në vlerësimin e riskut dhe hartografimin e riskut të objekteve kritike që përmbajnë materiale të rrezikshme;
- Identifikimin e infrastrukturës kritike dhe mbrojtjen e saj;
- Zbatim të masave të kontrollit brenda objekteve që kanë të bëjnë me materiale dhe procese të rrezikshme;
- Ngritjen e kapaciteteve të institucioneve të përfshira dhe organeve rregullatore për monitorimin dhe zbatimin e standardeve më të fundit lidhur me sigurinë në punë.
- Pajtueshmëri me konventat ndërkombëtare për transportin e substancave të rrezikshme (tokë, ajër, ujë);
- Pajtueshmëri me legjislacionin e BE-së për aksidentet detare që shkaktojnë ndotje detare;
- Pajtueshmëri me Direktivën SEVESO III të BE-së për parandalimin e aksidenteve industriale.

Duke pasur parasysh karakterin e parashikueshëm të rreziqeve teknologjike dhe lidhjen e tyre me proceset shumë të rregulluara në sektorin e industrisë, mundësia për të parashikuar shfaqjen dhe rezultatet e tyre duhet të jetë relativisht e drejtpërdrejtë. Kjo gjithashtu mund të mbështetet me një EWS të organizuar mirë që mund të parashikojë që këto ngjarje të ndodhin dhe të lëshojë paralajmërime në kohë për autoritetet dhe popullatën. Një EWS e një natyre të tillë duhet të integrohet me aktivitetet e gatishmërisë së reaguesve të parë. Zjarrfikësit, policia dhe shërbimi i ambulancës në Shqipëri duhet të njohin natyrën e materialeve të rrezikshme që ndodhen në Shqipëri dhe të kenë përgatitur protokolle se si të reagojnë kur janë në kontakt me ta.

3.6. Sëmundjet Infektive

Sëmundjet infektive lidhen me mikroorganizmat që shkaktojnë ose lidhen me sëmundjet tek njerëzit, kafshët dhe bimët. Ato përfshijnë mikroorganizma patogjene, toksina dhe substanca bioaktive që ndodhin natyrshëm ose lëshohen qëllimisht ose pa dashje duke shkaktuar humbje të konsiderueshme të jetës, duke prekur njerëzit dhe të gjithë faunën dhe florën dhe mund të çojnë në humbje të rënda ekonomike dhe mjedisore. Sëmundjet infektive kuptohen si ato që ndodhin në mënyrë të pavarur (ose pjesërisht në mënyrë të pavarur) ose si pasojë e ngjarjeve të tjera të fatkeqësive. Shumë rreziqe të tjera si përmbytjet, tërmetet, thatësirat mund të kenë pasoja potencialisht të rënda epidemiologjike si efekte dytësore.

Përveç kësaj, tendencat e ndryshimeve klimatike mund të ndikojnë gjithashtu në rreziqet infektive, pasi disa sëmundje të transmetuara nga vektorët mund të ndikohen nga temperaturat më të larta dhe ndryshimi i modeleve të reshjeve. Në këtë kuptim, supozohet përhapja e shtuar e makro parazitëve, e cila më pas shoqërohet me shfaqjen dhe qarkullimin e sëmundjeve të reja si pjesë e modeleve të reja të transmetimit.

Nga ana tjetër, ekziston edhe kërcënimi i terrorizmit biologjik, i cili kërkon gatishmëri për identifikimin efektiv laboratorik të patogjenëve të terrorit dhe ekzistencën e protokolleve të komunikimit të shpejtë për publikun.

Cenueshmëria ndaj rreziqeve biologjike lidhet me shumë faktorë të përfshirë në sistemet tona socio-politike, si mungesa e imunitetit midis njerëzve, bimëve dhe kafshëve ndaj një mikroorganizmi të ri dhe virulent; praktikat e ujit dhe kanalizimeve midis njerëzve; aftësia ripërtëritëse e sistemit të shëndetit publik; urbanizimi i paplanifikuar etj. Komunikimet e

ngarkuara dhe lidhja mes njerëzve janë gjithashtu një faktor që lehtëson transmetimin e shpejtë.

COVID-19 tregoi se një organizëm i ri virulent mund të futet në komunitetet tona dhe të bëjë dëme të rënda falë një popullate jo imune, rrjeteve të ngarkuara të komunikimit. Rrjetet e ngarkuara të komunikimit dhe një botë e globalizuar janë vetëm disa nga faktorët që kontribuojnë në transmetimin e shpejtë të virusit të ri. Në këtë kuptim, COVID-19 është shembulli i përsosur i natyrës sistematike të rreziqeve bashkëkohore me të cilat po përballemi brenda shoqërive tona dhe Shqipëria nuk bën përjashtim. COVID-19 preku jo vetëm sistemet shëndetësore, por zinxhirët e furnizimit dhe sektorin e transportit, aksesin në arsim, shpërndarjen e ushqimit etj.

Kriza pandemike COVID-19, ekspozoi dobësitë e ngulitura në të gjitha sistemet e shëndetit publik në të gjithë botën. Shqipëria, duke mos u përjashtuar nga ai mësim global, duhet t'i japë përparësi riskut të pandemisë në të ardhmen dhe shëndetit publik në përgjithësi, duke krijuar strategji të qëndrueshme për ndërtimin e kapaciteteve të strukturave të saj për të parashikuar, parandaluar dhe përgjigjur pandemive në të ardhmen. Shumë herët në fazën e përgjigjes, sistemi i shëndetit publik në Shqipëri dhe në mbarë botën mësoi rëndësinë e zbulimit të hershëm, gjurmimit të kontakteve dhe komunikimit me publikun. Të gjitha këto janë komponentë të EWS dhe ato duhet të mbështeten me përpjekjet e vazhdueshme të të gjithë aktorëve kombëtarë në Shqipëri. Sipas OBSH-së[14], në Shqipëri nga 3 janari 2020 deri më 1 korrik 2022, ka pasur 280 298 raste të konfirmuara me 3499 vdekje dhe numër total prej 2 906 126 doza vaksinash të administruara.

Në një nivel më operacional, trajtimi i rreziqeve infektive në afat të shkurtër, Shqipëria mund të përfitojë nga:

- Përmirësimi i rrjetit laboratorik dhe forcimi i kapaciteteve laboratorike (teknike dhe personale) për zbulime dhe analiza të hershme.
- Përmirësimi i legjislacionit, krijimi i kompetencave të qarta dhe plotësimi i tyre me aktet e nevojshme nënligjore.
- Rritja e besueshmërisë së sistemeve të gjurmimit së ushqimit përmes ndërgjegjësimit të organizatave prodhuese të ushqimit.
- Forcimi i bashkëpunimit me ISHP-në në kuadër të menaxhimit të epidemisë.
- Ngritja e kapaciteteve të Qendrës Operacionale të Emergjencave të Shëndetit Publik.
- Vendosja e një Certifikate Kombëtare të Trajnimit për Biosigurinë dhe Biosigurimin

4. Vizioni, Treguesit dhe Objektivat Strategjikë

4.1. Vizioni

Një Shqipëri më e sigurt, e qëndrueshme, e aftë për të zvogëluar risqet e fatkeqësive natyrore dhe efektet e ndryshimeve klimatike, për të përgatitur, përballuar dhe për tu rimëkëmbur, integruar në të gjithë sektorët me kapacitete të zhvilluara për të siguruar parandalimin e risqeve të reja dhe menaxhimin e riskut të mbetur, që të gjitha së bashku të ndihmojnë në forcimin e aftësisë ripërtëritëse dhe si rezultat në arritjen e zhvillimit të qëndrueshëm të shoqërisë.

[14] https://covid19.who.int/region/euro/country/al

4.2. Misioni

Për të bërë përpjekje të koordinuara, të sigurohet bashkëpunimi dhe përdorimi i kapaciteteve dhe aftësive, teknologjive, burimeve ekzistuese dhe të reja të të gjithë sektorëve dhe palëve të interesit, me qëllim mbrojtjen e jetës së njerëzve, të gjësë së gjallë, të pronës, të trashëgimisë kulturore e të mjedisit.

Për të forcuar aftësinë ripërtëritëse në nivel kombëtar përmes ngritjes të strukturave institucionale të efektshme, llogaridhënëse dhe gjithëpërfshirëse të sistemit të Mbrojtjes Civile për të rritur gatishmërinë dhe partneritetin për përgjigje, rimëkëmbje dhe rindërtim. Të forcohet aftësia ripërtëritëse e komunitetit duke aftësuar, fuqizuar dhe duke mbështetur individët, organizatat dhe komunitetet që të veprojnë për veten dhe të tjerët, për sigurinë dhe mirëqenien e të gjithëve.

4.3. Treguesit e ndikimit

Treguesit e ndikimit, të miratuar nga Kuadri Sendai dhe OZHQ-të janë:

Tabela 2. Treguesit e ndikimit

Treguesi	Njësia matëse	Baza		Synimi	
		viti	vlera	viti	vlera
Zvogëlim i ndjeshëm i numrit të të prekurve, duke synuar uljen e shifrës mesatare për 100,000	Numër për 100,000	2018	163.15	2030	Ulja e vlerës bazë me 10%
Zvogëlimi i humbjeve të drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë e shkaktuara nga fatkeqësitë	Humbja/PBB	2018	0,36	2030	Ulja e vlerës bazë me 5%

4.4. Objektiva Strategjike

1. Të menaxhohen risqet ekzistuese dhe parandalohen risqet e reja.
2. Të rritet ndërgjegjësimi, njohuritë kombëtare dhe lehtësimi i shkëmbimit të informacionit për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe mbrojtjen civile dhe të krijohen komunitete ripërtëritëse dhe të qëndrueshme me vëmendje tek njerëzit me aftësi të kufizuara, barazi gjinore dhe grupet e tjera të cenueshme.
3. Të përmirësohen kapacitetet e përgjigjes përmes ndërtimit të infrastrukturave ripërtëritëse, nxitjes së industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitjes së inovacionit.

4. Të nxitet koherenca e politikave dhe kuadri rregullator që lidhet me zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë.
5. Forcimi i aftësive të menaxhimit të riskut nga fatkeqësitë me qëllim anëtarësim në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të BE-së (MMC BE) në një periudhë të shkurtër kohore, rrjedhimisht duke u shndërruar në një faktor shtesë sigurie për rajonin dhe BE-në[15].

5. Strategjia e zbatimit dhe Korniza Financiare

Zbatimi i Strategjisë është planifikuar përmes fushave të përcaktuara kyçe të ndërhyrjes, të vlerësuara si më të rëndësishme për investimet e ardhshme të MRF-së. Secila prej fushave ka një listë të aktiviteteve të identifikuara në mënyrë që të arrihen të gjitha objektivat e përcaktuara të politikave në mënyrën më efektive. Plani financiar tregues do të jetë pjesë e secilit prej planeve të veprimit të hartuara për të ndihmuar në zbatimin e Strategjisë.

Për zbatimin e Strategjisë u zhvillua një sistem monitorimi dhe u hartua një strategji komunikimi për të siguruar transparencën dhe shpërndarjen e informacionit si për publikun ashtu edhe për aktorët përkatës të zbatimit.

5.1. Fushat e ndërhyrjes

Fushat kryesore të ndërhyrjes janë fushat që, siç analizohen nga Grupi Ndërsektorial i Punës, janë të rëndësisë dhe urgjencës më të madhe për të menaxhuar riskun e nivelit më të lartë në Shqipëri.

Secila prej fushave kyçe të ndërhyrjes përfshin një numër aktivitetesh të planifikuara që do të renditen, për çdo rrezik, në Planin e Veprimit që korrespondojnë me periudhën përkatëse kohore.

Korniza e përmbledhur, e përafërt financiare për Strategjinë do të jetë përmbledhja e secilit prej kornizave financiare të Planit të Veprimit përkatësisht.

5.1.1. Fusha 1: Të menaxhojë risqet ekzistuese dhe parandalojë risqet e reja.

Fusha 1 do të përfshijë aktivitete që kontribuojnë në: kërkimin, inovacionin dhe ndërtimin e parandalimit, si dhe rritjen e ndërgjegjësimit, njohurive dhe lehtësimin e shkëmbimit të informacionit në shërbim të zvogëlimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjen civile, dhe promovimin e koherencës së politikave dhe kuadrit rregullator në lidhje me zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.

5.1.2. Fusha 2: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes

Fusha 2 do të përfshijë aktivitete për të forcuar kapacitetet e përgjigjes përmes ndërtimit të infrastrukturave ripërtëritëse, duke promovuar industrializimin gjithëpërfshirës dhe inovacionin, si dhe zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive me synimin forcimin e rolit të Shqipërisë në kuadër

[15]Vizioni, misioni dhe objektivat e strategjisë Kombëtare të ZRF u hartuan gjatë kohës që Shqipëria ishte në fazën e negociatave me Komisionin Evropian për nënshkrimin e "Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit" dhe u miratuam nga Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC). Në këto kushte, edhe pse objektivi nr. 5, kishte nevojë të përditësohej në kushtet e reja të krijuara pas nënshkrimit të marrëveshjes së sipërcituar në datën 18.11.2022, kjo nuk u bë e mundur për shkak të kohës së pamjaftueshme në dispozicion.

të Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të BE-së në të cilin ajo do të anëtarësohet zyrtarisht në 1.01.2023.

5.2. Komunikimi

AKMC si koordinatore e procesit dhe Qeveria e Shqipërisë si zotëruese dhe miratuese e Strategjisë siguron që të gjitha proceset dhe detyrimet kombëtare në lidhje me konsultimet me institucionet e tjera kombëtare dhe qeverisjen vendore, si dhe me publikun të konsultohen gjatë procesit të përshtatjes. Të gjitha palët e interesit janë njohur me draftin e Strategjisë përpara miratimit të saj.

Pas miratimit të Strategjisë, është e një rëndësie të madhe komunikimi i objektivave dhe qëllimit të saj tek institucionet kombëtare dhe publiku me qëllim që të rritet ndërgjegjësimi për agjendën në fjalë. Komunikimi është gjithashtu vendimtar në zhvillimin e një baze solide zbatimi dhe pronësie në të gjitha institucionet zbatuese, duke rritur kështu shkallën e zbatimit.

Qëllimet kryesore të komunikimit janë:

1. Ngritja e vetëdijes për **Strategjinë dhe rëndësinë e saj** në mesin e të gjitha palëve të interesit - njohja e Strategjisë dhe përmbajtjes së saj është parakusht për veprim pozitiv të të gjitha palëve të interesit, institucioneve qeveritare dhe institucioneve shkencore dhe eksperte me role në zvogëlimin e riskut të fatkeqësive.
2. Rritja e ndërgjegjësimit për **rëndësinë e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive për zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik** dhe për zvogëlimin e cenueshmërisë për shoqëritë – në mënyrë që të sigurohet vazhdimësia, palët e interesit dhe publiku duhet të dinë rëndësinë e përpjekjeve të tyre.
3. Shpërndarja e **njohurive për riskun** dhe **ndërgjegjësimi për mënyrat për të zvogëluar riskun** – është e rëndësishme që të informohen dhe edukohen palët e interesit dhe publiku për riskun e fatkeqësive, por edhe për rolin e tyre në sistemin e ZRF dhe si të veprohet në mënyrë që të zvogëlohet në mënyrë efektive risku i fatkeqësive.

Grupet e synuara të komunikimit:

1. Publiku - popullata më e gjerë të cilës duam t'ia afrojmë temën e zvogëlimit të riskut sa më pranë duke ofruar informacione dhe udhëzime të qarta sesi zgjedhjet e tyre ditore mund të rrisin ose zvogëlojnë riskun e fatkeqësive, veçanërisht duke synuar ata që janë më të prekur nga fatkeqësitë dhe më të margjinalizuar në shoqëri., e cila thekson rëndësinë e gjinisë dhe cenueshmërisë
2. Institucionet qeveritare të përfshira në zbatimin e Strategjisë – sektorët kanë identifikuar aktivitetet kyçe për të zvogëluar riskun nga fatkeqësitë në Shqipëri. Është e rëndësishme që ata të njohin se cilat nga aktivitetet e tyre të rregullta janë gjithashtu veprimtari për zvogëlimin e riskut.
   P.sh., risku i klimës dhe i fatkeqësisë nuk është integruar ende si pjesë e planifikimit të buxhetit të qeverisë. Përfshirja e vlerësimit të riskut të klimës dhe të fatkeqësive natyrore në deklaratën e riskut fiskal të qeverisë do të ndihmojë për një kuptim më të mirë të detyrimeve kontigjente të qeverisë për shkak të fatkeqësive.
3. Vendimmarrësit në nivel qendror, qarku dhe bashkie - zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është një fushë komplekse që hyn në sferën e të gjitha niveleve të qeverisjes, është e

rëndësishme që të gjitha nivelet të njihen me dokumentin dhe qëllimin e tij si dhe rolin e tyre në sistem.

Mesazhet kryesore të komunikimit:

1. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është me rëndësi të madhe kombëtare dhe prioritet kombëtar
2. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është çështje zgjedhjeje, vetëm zhvillimi që përfshin zvogëlimin e riskut të fatkeqësive është zhvillim i qëndrueshëm
3. Zvogëlimi i riskut të fatkeqësive është çështje e të gjithëve

5.3. Bashkëpunimi ndërkombëtar dhe partneriteti global

Shqipëria hodhi një hap të rëndësishëm në rrugëtimin e saj në BE pasi në 19.07.2022 u shënua hapja e negociatave për anëtarësimin në BE në konferencën e parë ndërqeveritare mes Bashkimit Evropian dhe Shqipërisë dhe Maqedonisë së Veriut që u mbajt në Bruksel.

Në përputhje me objektivin 'F" të Kuadrit Sendai, lidhur me rëndësinë e bashkëpunimit ndërkombëtar për ZRF, niveli i tij është në rritje dhe përmirësim të vazhdueshëm. AKMC, në zbatim të udhëzimeve teknike për monitorimin dhe raportimin mbi progresin në arritjen e objektivave globalë të Kuadrit Sendai duhet të udhëzojë dhe të bashkërendojë veprimtaritë e institucioneve përkatëse në këtë drejtim.

Bashkëpunimit ndërkombëtar i është dhënë një rëndësi e veçantë në ligjin 45/2019 duke i kushtuar tërësisht kreun VII të tij dhe duke vendosur bazat për një qasje të re proaktive dhe bashkëkohore në këtë fushë. Aktivitetet e bashkëpunimit ndërkombëtar janë mirë përcaktuar duke futur për herë të parë edhe konceptin e mbështetjes së vendit pritës. Ndryshe nga ligji i mëparshëm apo PKEC që më së shumti kishin ndonjë përcaktim për marrjen e asistencës ndërkombëtare, ligji 45/2019 ka vendosur përcaktime të detajuara edhe për dhënien e asistencës ndërkombëtare. Për këtë, ndër të tjera, ligji ka synuar përputhjen me Vendimin e Këshillit nr.1313/2013/BE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 17.12.2013, "Mbi Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian", i ndryshuar, duke vendosur përcaktime për asistencën humanitare për vendet e tjera sikurse për modulet dhe kapacitetet e tjera të përgjigjes emergjente.

Rritja dhe forcimi i vazhdueshëm i kapaciteteve për ZRF dhe MC të Shqipërisë, përfshi dhe krijimin sipas mundësive, të moduleve dhe të kapaciteteve të tjera të përgjigjes emergjente, dhënia e asistencës jashtë kufijve të Republikës së Shqipërisë janë masat e duhura për një vend anëtarë të MMC BE.

Shqipëria është pjesëmarrëse aktive në një sërë konventash, traktatesh, protokollesh, marrëveshjesh, iniciativash, komitetesh, programesh rajonale, Evropiane e ndërkombëtare, të lidhura me ZRF dhe MC.

Ndër vite vendi ka pasur marrëdhënie shumë të mira bashkëpunimi të ndërsjellë me një sërë institucionesh dhe organizatash ndërkombëtare. Gjithashtu, ai ka nënshkruar marrëveshje ndërkombëtare shumëpalëshe dhe dypalëshe në fushën e ZRF dhe MC duke i konsideruar ato si instrumente të rëndësishme politike që i sjellin shtetet dhe organizatat më pranë njëra tjetrës por edhe me vlera praktike të pazëvendësueshme që përfitohen gjatë implementimit të tyre.

Organizatat ku Shqipëria është anëtare sikurse marrëveshjet dhe memorandumet e nënshkruara dhe ato në proces, mund ti gjeni në shtojcën nr. 4 të strategjisë.

Në të kaluarën bashkëpunimi ndërkombëtar ka konsistuar më së shumti në marrjen e asistencës humanitare në rastet e fatkeqësive. Kështu Qeveria shqiptare ka shpallur gjendjen e fatkeqësisë natyrore në vitet 2007, 2010, 2011, 2012, 2019 dhe 2020. Ajo ka kërkuar aktivizimin e MMC BE në 2007, 2010, 2011, 2012, 2015, 2016, 2017, 2018, 2019, 2020, 2021 dhe 2022.

Në emergjencat e mëdha të së kaluarës të cilat i kalonin aftësitë përballuese të vendit, Shqipëria i është drejtuar për asistencë si ERCC-së ashtu edhe Qendrës Euro Atlantike të Koordinimit të Përgjigjes Emergjente (Euro-Atlantic Disaster Response Coordination Centre /EADRCC)

Përveç bashkëpunimit ndërkombëtar në fazën e përgjigjes ndaj emergjencave, bashkëpunimi ndërkombëtar ka konsistuar më së shumti në:

a) Trajnimet e ekspertëve shqiptarë në kuadrin e programit të Trajnimit të Menaxhimit të Fatkeqësive të DPPI SEE, të Programit të Trajnimit të MMC BE dhe trajnimeve të tjera;
b) Pjesëmarrjet në trajnime e stërvitje të tjera të financuara nga BE, NATO etj.;
c) Vizitat studimore në ambientet e Qendrës së Koordinimit të Përgjigjes Emergjente dhe institucione të tjera homologe në Evropë dhe në botë;
d) Përvoja të tjera që lidhen me zbatimin e programeve dhe projekteve të financuara nga donatorë dhe partnerë të ndryshëm ndërkombëtarë.

Objektivi i përgjithshëm i MMC BE është forcimi i bashkëpunimit ndërmjet shteteve pjesëmarrëse në fushën e mbrojtjes civile, me qëllim përmirësimin e parandalimit, përgatitjes dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive. Përmes Mekanizmit, Komisioni Evropian luan një rol kyç në koordinimin e përgjigjes ndaj fatkeqësive në Evropë dhe më gjerë. Kur shkalla e një emergjence tejkalon aftësitë e përgjigjes së një vendi, vendi mund të kërkojë ndihmë nëpërmjet Mekanizmit, i cili, pasi aktivizohet, koordinon ndihmën e vënë në dispozicion nga shtetet pjesëmarrëse të tij. Aktualisht i vetmi shtet që nuk është anëtarësuar ende në Mekanizëm është Kosova.
Dokumenti i parë që evidentoi nevojën e anëtarësimit të Shqipërisë në MMC BE ishte PDNA 2015 i pasuar nga PDNA 2020 si edhe Progres Raportet e Komisionit Evropian 2019, 2020 dhe 2021. Në këto të fundit në mënyrë konstante rekomandohet përshpejtimi i përgatitjes për t'iu bashkuar MMC BE dhe vendosjen e lidhjes TESTA për ndërlidhjen me CECIS. Për mbështetjen e anëtarësimit të Shqipërisë në Mekanizëm, BE financoi Programin PRO NEWS (2017-2021). Rëndësia e PRO NEWS ishte strategjike për shkak se aplikimi i Shqipërisë për pjesëmarrje në Mekanizëm do të mund të fillonte atëherë kur zbatimi i programit të kishte avancuar thelbësisht. Pas nënshkrimit në datën 18.11.2022 në Tiranë, të "Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit", duke filluar nga 1.01.2023, Shqipëria do të jetë anëtare me të drejta të plota në MMC BE.
Një listë të organizatave dhe partnerëve të tjerë ndërkombëtarë me të cilët Shqipëria ka marrëdhënie të ngushta partneriteti në fushën e ZRF dhe MC gjendet në shtojcën nr.4 të strategjisë.
Në lidhje me bashkëpunime dhe marrëveshje të tjera të rëndësishme për MRF, nevojitet forcimi e lidhjeve operacionale të autoritetit meteorologjik dhe hidrologjik dhe AKMC-së me organizatat Evropiane të infrastrukturës meteorologjike si Qendra Evropiane e Parashikimin Afatmesëm të Motit (European Center for Medium-Range Weather Forecasts /ECMWF) dhe Agjencia Evropiane për Shfrytëzimin e Sateliteve Meteorologjike (European Agency for

Exploitation of Meteorological Satellites/EUMETSAT)[16]. Anëtarësimi në Global Health Security Agenda u evidentua gjithashtu si një nevojë gjatë hartimit të dokumentit të strategjisë. Bashkëpunimi me UNDRR përfshin angazhimin për zbatimin e politikave të MRF në përputhje me parimet dhe praktikat e Kuadrit Sendai. Për rastet e emergjencave, në lidhje me UNOCHA-n, kjo e fundit përfaqësohet nga zyra e Koordinatorit të Përhershëm të OKB-së në Shqipëri. Vendet e Evropës Juglindore (EJL) shtrihen në një zonë të vogël gjeografike dhe rrjedhimisht, ndonëse ka dallime të dukshme në mjediset fizike dhe kulturat shoqërore midis vendeve të veçanta, në përgjithësi ndajnë të njëjtat risqe fatkeqësish. Shumë fatkeqësi janë ndërkufitare në efektet e tyre, si p.sh. moti i nxehtë dhe i thatë, thatësirat, ose përmbytje të disa sistemeve lumore, ndaj prej një qasjeje rajonale në lidhje me ZRF ka vend për përfitim për të gjithë.

Vënia në përdorim të plotë e strukturave dhe shërbimeve ekzistuese: Do të duhet që në radhë të parë të shfrytëzohen burimet aktuale të të dhënave, informacionit, dijeve, strukturave dhe proceseve për MRF dhe MC. Investimet për përmirësimin e sistemit të MRF brenda për brenda vendeve të EJL do të çojnë në rritje të aftësisë ripërtëritëse ndaj riskut të fatkeqësive për secilin vend më vete dhe gjithashtu mes të gjitha vendeve të EJL për të garantuar një menaxhim më të fuqishëm të riskut rajonal nga fatkeqësitë. Gjithashtu përpjekjet për rritjen e komunikimit dhe bashkëpunimit rajonal midis autoriteteve të MRF, sektorëve të MC dhe aktorëve të tjerë, duke përfshirë organet kërkimore dhe shkencore, sektorin privat, organizatat rajonale dhe organizatat ndërkombëtare të zhvillimit që punojnë në rajon, jo vetëm që do të sjellin një përmirësim të kapaciteteve në rang kombëtar dhe rajonal, por edhe do të zvogëlojnë mbivendosjen e aktiviteteve dhe do të ndihmojnë në procesin e kontrollit.

Natyra ndërkufitare e rreziqeve: Duke pasur parasysh natyrën ndërkufitare të rreziqeve dominuese në rajon, Shqipëria dhe vendet e tjera të rajonit kanë një nevojën të qartë për ruajtjen dhe forcimin e marrëveshjeve të bashkëpunimit rajonal, në veçanti në fushat kryesore të azhurnimit të sistemeve të monitorimit ndërkufitar dhe ato të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Një shembull shumë i mirë i bashkëpunimit ndërkufitar rajonal është ai i menaxhimit të integruar të burimeve ujore dhe menaxhimit të risqeve të përmbytjeve në lidhje me ndryshimet klimatike në basenin ndërkufitar të lumit Drin. Ka disa projekte në vazhdë brenda rajonit për krijimin e rrjeteve të monitorimit të motit dhe kushteve hidrologjike të cilat plotësojnë standardet e OBM-së, si edhe një rrjet stacionesh hidrometeorologjike që do të bënin të mundur përputhshmërinë me Direktivën Kuadër të BE-së për Ujin dhe Direktivën e BE-së për Përmbytjet.

Një fushë tjetër ndërkufitare ku ka nevojë për rritjen e bashkëpunimit rajonal është monitorimi dhe përballja me zjarret në pyje dhe ky njihet si një prioritet rajonal. Shqipëria nuk disponon ende një rrjet permanent vrojtimi dhe sinjalizimi për pyjet që janë në rrezik, sistemi i të cilit të vihet në punë nga shërbimi pyjor gjatë sezonit të zjarreve. Njëkohësisht, ka vend për përmirësim përsa i takon disponueshmërisë së infrastrukturës dhe pajisjeve për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve, sidomos në dritën e modeleve të paparashikuara në kuadrin e ndryshimeve klimatike. Ekziston një nevojë e përgjithshme në rajon për asistencë teknike për ndërtimin e kapaciteteve për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe për punë kërkimore në lidhje me zjarret në pyje.

Shkëmbim informacioni dhe dijesh: Shqipëria dhe rajoni i EJL-së janë të vetëdijshme që aksesi i ditëve të sotme në lidhje me teknologjinë e komunikimit të informacionit, shkëmbimin e të dhënave, informacionit dhe të dijeve është një nga format më pak të kushtueshme, por gjithsesi më efikase të bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

[16] Programi për Përmirësimin e Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimin e Përmbytjes në Shqipëri (PRO NEWS)

Mekanizma rajonalë dhe ndërkombëtarë rregullatorë: Shumë organizata rajonale dhe ndërkombëtare të MRF dhe MC kanë hartuar shumë mekanizma rregullatorë që përfshijnë standarde, kode etike dhe kode praktikash, kode ndërtimi, rregullore për përdorimin e tokës, rregullore për infrastrukturën etj. Duke qenë se këto ekzistojnë, vendet e EJL e kanë kuptuar që ky është një aktivitet relativisht i lirë, për të eksploruar mekanizmat përkatës rregullatorë, sipas nevojës dhe pastaj për të vlerësuar dhe nëse ia vlen për t'i përshtatur sipas nevojave kombëtare dhe sipas specifikave dhe prioriteteve rajonale. Njëkohësisht, përshtatja ndaj ndryshimeve klimatike po krijon një nevojë të re për mekanizma të rinj apo të rishikuar rregullatorë.

Ndarja e zhvillimit të kapaciteteve: Trajnimi për ZRF ka nevojë për fuqizim të vazhdueshëm. Një sërë veprimtarish trajnimi për zhvillimin e kapaciteteve, janë përqendruar në elementë të ndryshëm të përgjigjes ndaj emergjencave. Janë bërë shumë përpjekje edhe në kuadrin e trajnimeve rajonale për gatishmërinë në raste emergjencash. Ndarja në të ardhmen e përpjekjeve për trajnim dhe zhvillimin e kapaciteteve, në nivel rajonal dhe ndërkombëtar gjithashtu kërkon forcimin e rrjetëzimit, shkëmbimit të dijeve dhe bashkëpunimit në përgjithësi.

Sfidat kryesore: Sfidat në lidhje me bashkëpunimin rajonal përfshijnë burime financiare përgjithësisht të pamjaftueshme në nivel kombëtar dhe rajonal. Një sfidë tjetër në lidhje me bashkëpunimin gjatë momenteve të përgjigjes ndaj fatkeqësive është që shpesh fatkeqësia bie mbi të gjithë rajonin dhe çdo organizate kombëtare është e zënë "deri në fyt" me nevojat e veta.

Konteksti i ndryshimeve klimatike është një argument më tepër për përshkallëzimin e bashkëpunimit rajonal në lidhje me aspekte të ndryshme të përshtatjes klimatike. Nga pikëpamja pragmatike është e nevojshme të shtohen përpjekjet për të arritur njohje në nivele të larta të qeverisjes sa i takon rëndësisë shoqërore dhe ekonomike të investimeve në përpjekjet rajonale të MRF. Duhet mbajtur parasysh gjithashtu që bashkëpunimi rajonal është i nevojshëm gjatë përpjekjeve për financime nga institucionet rajonale dhe ndërkombëtare të zhvillimit dhe ato financiare.

5.4. Monitorimi, vlerësimi dhe raportimi

Figura 2: Procesi i monitorimit të zbatimit të strategjisë

5.4.1. Monitorimi dhe raportimi i progresit

Për të arritur shkallën optimale të zbatimit, procesi i zbatimit duhet të monitorohet rregullisht dhe të raportohet në mënyrë transparente.

Siç thuhet në Kuadrin Sendai, një zvogëlim thelbësor i riskut të fatkeqësive kërkon këmbëngulje dhe kokëfortësi, me një fokus më të qartë te njerëzit, shëndetin dhe jetesën e tyre, si dhe ndjekje të rregullt në vijimësi.[17]

Aktivitetet e kësaj Strategjie u zgjodhën duke përdorur udhëzimet SMART (**S**pecifike, të **M**atshme, të **A**rritshme, **R**ealiste dhe në **K**ohë).

Secili prej Grupeve të Punës së Rrezikut ka identifikuar boshllëqet dhe nevojat më të rëndësishme për të siguruar zvogëlimin efikas të riskut të fatkeqësive të shkaktuar nga rreziku i secilit prej grupeve përkatëse. Kjo u bë për të siguruar që produkti përfundimtar të jetë **realist** dhe i **arritshëm**.

Secila prej fushave kyçe të ndërhyrjes ka një sërë aktivitetesh të identifikuara që kontribuojnë në këtë fushë. Secili prej rreziqeve ka një listë të treguesve të rezultateve që do të ndihmojnë në monitorimin e progresit të zvogëlimit të riskut specifik. Kjo është për ta bërë strategjinë të **matshme**.

Për secilin nga boshllëqet, të përcaktuara në seksionin 3. "Gjendja aktuale dhe tendencat: Sfidat", propozohen një ose më shumë aktivitete, ose projekte. Secili nga aktivitetet e propozuara ka një afat kohor të identifikuar, institucionin e zbatimit, buxhetin e përafërt dhe burimin e buxhetit. Informacioni i detajuar mbi projektet dhe aktivitetet e tyre kryesore të zbatuara në kuadër të një Plani Veprimi specifik janë të listuara në Planin përkatës të Veprimit. Kjo është për ta bërë strategjinë **specifike** dhe në **kohë**.

Progresi i arritur nga secili prej palëve përkatëse të interesit do të monitorohet nga **AKMC**-ja dhe **Grupi i Punës për Monitorimin e Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive (GPMSZRF)** mbi baza vjetore. Meqë Shqipëria nuk ka një Platformë Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive (PKZRF), një tjetër bazë të një sistemi funksional multisektorial të MRF, grupi i punës i lartpërmendur do të duhej të ngrihej nëpërmjet Qeverisë Shqiptare në kuadër të një koordinimi mes Komitetit të Mbrojtjes Civile dhe Komisionit Teknik Këshillimor. Prandaj, ky proces do të siguronte gjithashtu që të gjitha pjesët e sistemit të MRF të përfshihen vazhdimisht në zbatimin dhe monitorimin e Strategjisë, si dhe në propozimin e amendamenteve të Strategjisë.

Informacioni mbi aktivitetet e realizuara dhe përqindjen e zbatimit si dhe hapat e mëtejshëm do t'i raportohet në mënyrë transparente Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë. Së bashku me raportin e progresit do të raportohet një vlerësim i rrezikut të zbatimit me zgjidhjet e propozuara.

5.4.2. Vlerësimi

Bazuar në raportimin e progresit çdo dy vjet, duke filluar nga viti 2024. Një vlerësim i zbatimit të Strategjisë do të bëhet nga një institucion i jashtëm i paanshëm me kërkesë të koordinatorit, AKMC-së.

[17] Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030

5.4.3. Përditësimi dhe përshtatja

Nëse vendoset kështu dhe evidentohet në ndonjë nga Raportet e Progresit dhe bazuar në përfundimet e vlerësimit, do t'i bëhet propozim ministrit përgjegjës për të përshtatur Strategjinë.

Në vijim të këtij propozimi dhe sipas nenit 10, pika 1, të ligjit nr. 45/2019, Strategjia Kombëtare për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë do të rishikohet, të paktën çdo pesë vjet, nga Këshilli i Ministrave, me propozim të Ministrit të Mbrojtjes.

6. Elementet ndërsektoriale të Strategjisë së ZRF-së

Koncepti i Strategjisë Kombëtare të ZRF-së bazohet në filozofinë kryesore të ZRF-së dhe që është zvogëlimi i riskut të identifikuar, parandalimi i risqeve të rejave dhe menaxhimi i riskut të mbetur. Për ta bërë këtë, siç thuhet shumë herë në tekstin e Strategjisë, ZRF nuk mund të jetë thjesht një përgjegjësi e agjencisë përgjegjëse për mbrojtjen civile në Qeverinë Shqiptare, por e gjithë shoqërisë. Për të ndërtuar atë ndjenjë llogaridhënieje dhe pronësie, procesi i hartimit të Strategjisë u përshtat me kujdes për të lejuar gjithashtu identifikimin e elementeve ndërsektoriale që duhet të merren parasysh kur Shqipëria trajton ZRF. Lista e mëposhtme nuk është shteruese kur bëhet fjalë për fushat ndersektoriale të ZRF, megjithatë ajo përmban ato që përdoren më shpesh, duke hedhur dritë në lidhjet horizontale me sektorët e tjerë. Të gjithë elementët e listuar më poshtë, dhe të rinjtë që do të dalin nga zbatimi i Strategjisë, duhet të merren parasysh kur projektet e ZRF-së të hartohen dhe zbatohen.

6.1. Lidhja me Kuadrin Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive dhe Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm

Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015 – 2030 u miratua në Konferencën e tretë Botërore të OKB-së për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive në 2015 nga anëtarët e Kombeve të Bashkuara. Nëpërmjet Kuadrit Sendai, vendet në mbarë botën njohin rëndësinë jo vetëm të menaxhimit të fatkeqësive, por menaxhimit të riskut të fatkeqësive.

Kuadri Sendai përshkruan shtatë objektiva dhe katër prioritete për veprim për të parandaluar dhe zvogëluar riskun ekzistues të fatkeqësive. Shtatë objektivat globale janë: (a) të zvogëlojë ndjeshëm vdekshmërinë globale nga fatkeqësitë deri në vitin 2030, duke synuar uljen e mesatares për 100,000 në shkallë globale të vdekshmërisë në dekadën 2020-2030 krahasuar me periudhën 2005-2015; (b) të zvogëlojë ndjeshëm numrin e njerëzve të prekur globalisht deri në vitin 2030, duke synuar uljen e shifrës mesatare globale për 100,000 në dekadën 2020–2030 krahasuar me periudhën 2005–2015; (c) të zvogëlojë humbjet e drejtpërdrejta ekonomike nga fatkeqësitë në lidhje me produktin e brendshëm bruto global (GDP) deri në vitin 2030; (d) të zvogëlojë ndjeshëm dëmtimin nga fatkeqësitë në infrastrukturën kritike dhe ndërprerjen e shërbimeve bazë, mes tyre objekteve shëndetësore dhe arsimore, duke përfshirë zhvillimin e aftësisë ripërtëritëse të tyre deri në vitin 2030; (e) Të rrisë thelbësisht numrin e vendeve me strategji kombëtare dhe lokale për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive deri në vitin 2020; (f) të rrisë ndjeshëm bashkëpunimin ndërkombëtar me vendet në zhvillim përmes mbështetjes adekuate dhe të qëndrueshme për të plotësuar veprimet e tyre kombëtare për zbatimin e këtij Kuadri deri në vitin 2030; dhe (g) Të rrisë thelbësisht disponueshmërinë dhe qasjen ndaj sistemeve të paralajmërimit të hershëm me shumë rreziqe dhe informacioneve dhe vlerësimeve të riskut të fatkeqësive për njerëzit deri në vitin 2030. Katër prioritetet globale të Kuadrit Sendai janë: të kuptuarit e riskut të fatkeqësive; forcimi i qeverisjes së riskut të fatkeqësive për të menaxhuar riskun e fatkeqësive; investimi në Zvogëlimin e Riskut të

Fatkeqësive për aftësinë ripërtëritëse; dhe rritja e gatishmërisë ndaj fatkeqësive për përgjigje efektive, dhe për të "Ndërtuar më mirë" në rimëkëmbje, rehabilitim dhe rindërtim.[18]

Kuadri Sendai përcaktoi rastin që zhvillimi të jetë i informuar për riskun në mënyrë që të jetë i qëndrueshëm. Nuk ka zhvillim të qëndrueshëm pa zvogëlimin e riskut të fatkeqësive. Si rezultatet e Kuadrit Sendai ashtu edhe të Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) janë produkt i proceseve të ndërlidhura sociale dhe ekonomike. Ka shumë sinergji midis dy instrumenteve të politikave. Monitorimi i Kuadrit Sendai synon të plotësojë monitorimin e 11 treguesve të OZHQ. [19]

6.2. Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe ZRF

Zbatimi i KSZRF dhe në këtë kontekst SKZRF është e lidhur ngushtë me të gjitha OZHQ-të, por veçanërisht:

OZHQ 1. Jo varfëri (1.5 Deri në vitin 2030, të ndërtohet aftësia ripërtëritëse e të varfërve dhe atyre në situata të cenueshme dhe të zvogëlohet ekspozimi dhe cenueshmëria e tyre ndaj ngjarjeve ekstreme të lidhura me klimën dhe fatkeqësive dhe tronditjeve të tjera ekonomike, sociale dhe mjedisore);

OZHQ 3. Shëndeti dhe mirëqenia (3.9 Deri në vitin 2030, të zvogëlohet ndjeshëm numri i vdekjeve dhe sëmundjeve nga kimikatet e rrezikshme, ndotja dhe kontaminimi i ajrit, ujit dhe tokës);

OZHQ 5. Arritja e barazisë gjinore dhe fuqizimi i të gjitha grave dhe vajzave (5.c Miratimi dhe forcimi i politikave të shëndosha dhe legjislacionit të detyrueshëm për promovimin e barazisë gjinore dhe fuqizimin e grave dhe vajzave në të gjitha nivelet)

OZHQ 6. Uji i pastër dhe kanalizimet (6.3 Deri në vitin 2030, përmirësimi i cilësisë së ujit duke zvogëluar ndotjen, minimizuar çlirimin e kimikateve dhe materialeve të rrezikshme, duke përgjysmuar përqindjen e ujërave të zeza të patrajtuara dhe duke rritur ndjeshëm riciklimin dhe ripërdorimin e sigurt);

OZHQ 9. Ndërtimi i infrastrukturës ripërtëritëse, promovimi i industrializimit gjithëpërfshirës dhe nxitja e inovacionit (9.1 Zhvillimi i infrastrukturës cilësore, të besueshme, të qëndrueshme dhe ripërtëritëse, duke përfshirë infrastrukturën rajonale dhe ndërkufitare, për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien, me fokus në qasje të përballueshme dhe akses të barabartë për të gjithë);

OZHQ 11. Qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme (11.5 Deri në vitin 2030, zvogëlim i ndjeshëm në numrin e vdekjeve dhe numrin e njerëzve të prekur si dhe të ulen ndjeshëm humbjet e drejtpërdrejta ekonomike në raport me produktin e brendshëm bruto të shkaktuar nga fatkeqësitë, duke përfshirë fatkeqësitë e lidhura me ujin, me një fokusim në mbrojtjen e të varfërve dhe njerëzve, në situata të cenueshme);

OZHQ 13. Ndryshimet klimatike (13.1 Forcimi i aftësisë ripërtëritëse dhe kapacitetit përshtatës ndaj rreziqeve të lidhura me klimën dhe fatkeqësive natyrore në të gjitha vendet).

Në këtë kontekst, të gjitha projektet dhe të gjitha aktivitetet si pjesë e kësaj SKZRF duhet të marrin në konsideratë OZHQ-të e shënuara dhe më pas, pasi të zbatohen, të kontribuojnë në arritjen e këtyre qëllimeve të veçanta.

[18] Kuadri Sendai për Zvogëlimin e Riskut të Fatkeqësive 2015-2030
[19] www.undrr.org

6.3. Përshtatja ndaj Ndryshimeve Klimatike dhe ZRF[20], ndryshueshmëria dhe ndikimet e ndryshimeve klimatike

Nevoja për koherencë midis Përshtatjes ndaj Ndryshimeve Klimatike (PNK) dhe ZRF është identifikuar nga OZHQ-të në nivel global dhe nga BE-ja në nivel rajonal. Gjetjet dhe raportet ekzistuese të PNK-së që vijnë nga burime të ndryshme që flasin për kushtet e qëndrueshme të temperaturave të larta dhe reshjeve të ulëta, ndryshimin e modeleve dhe shpeshtësinë e situatave që shkaktojnë përmbytje të shpejta dhe rrëshqitje të tokës, ndër të tjera, nuk kontestohen nga sektori i ZRF. Përkundrazi, marrja në konsideratë e skenarëve afatgjatë të klimës po bëhet një kërkesë e vlerësimeve të ardhshme të riskut të fatkeqësive dhe rrjedhimisht e strategjive kombëtare të ZRF. Prandaj, aty ku është e zbatueshme, masat PNK duhet të përfshihen fuqishëm në projektet e zbatuara siç është planifikuar në këtë SKZRF.

Marrëveshja e Parisit dhe Axhenda 2030 për Zhvillim të Qëndrueshëm (përfshirë Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm) theksojnë rëndësinë e përshtatjes klimatike dhe zvogëlimit të riskut të fatkeqësive. UNDRR thekson se nëse duam të zvogëlojmë riskun, ne gjithashtu duhet të bashkohemi në qasjet tona dhe duhet të përfshijmë të gjithë sektorët përkatës, të bashkëpunojmë brenda institucioneve dhe të sigurojmë harmoni nga politika në aktivitet.

Duke e njohur këtë, Shqipëria vendosi të zhvillojë këtë Strategji duke lidhur të gjitha strategjitë përkatëse kombëtare dhe ndërkombëtare në një qëllim të përbashkët – të zvogëlojë humbjet nga fatkeqësitë dhe të sigurojë zhvillim të qëndrueshëm.

Institucionet shpesh veçohen në axhendën e tyre duke synuar vetëm arritjen e qëllimeve të tyre të veçanta, prandaj është e rëndësishme të pranohet se të gjitha axhendat e lartpërmendura ndërkombëtare si dhe shumë nga ato kombëtare do të arriheshin më shpejt dhe me efikasitet nëse institucionet do të bashkëpunonin. Kufizimi i ndikimit të fatkeqësive tani dhe në të ardhmen kërkon një përpjekje të koordinuar në dhe brenda shumë fushave duke përfshirë planifikimin e përdorimit të tokës, infrastrukturën, menaxhimin e emergjencave, politikat sociale, bujqësinë, arsimin, shëndetin, zhvillimin e komunitetit, energjinë dhe mjedisin.

Siç thuhet në të gjithë kapitullin 3 të kësaj Strategjie, ndryshimi i klimës ndikon negativisht në shumicën e risqeve kyçe të identifikuara në Shqipëri, d.m.th., duke rritur nivelin e riskut. Më poshtë janë gjetjet nga NDC e Rishikuar e Shqipërisë siç janë artikuluar në dokument.

Temperatura

Tendencat e parashikuara tregojnë se temperatura mesatare vjetore në Shqipëri do të rritet ndërmjet 1,3°C dhe 2,2°C deri në vitin 2050 dhe ndërmjet 1,2°C dhe 4,4°C deri në vitin 2100 nga vlera bazë 1986-2005 prej 11,8°C. Rritjet më të rëndësishme do të ndodhin midis qershorit dhe shtatorit (5.8°C nën RCP 8.5), duke sjellë temperaturën mesatare të verës rreth 27°C deri në vitin 2100.

Si pasojë, numri dhe kohëzgjatja e valëve të të nxehtit pritet të rritet. Temperatura mbi 95 përqindshin e bazës 1986-2005, pritet të rritet ndjeshëm deri në vitin 2050 sipas të gjithë skenarëve, me një mesatare ndërmjet 20 dhe 41 ditë, nga 2.5 ditë

[20] Një fragment nga "Shqipëria. Kontributet e përcaktuara kombëtare e rishikuar (NDC)

Reshjet

Nivelet mesatare të reshjeve kanë mbetur relativisht të qëndrueshme që nga viti 1901, megjithëse me një tendencë të lehtë në rënie. Deri në vitin 2050, reshjet për Shqipërinë pritet të ulen ndërmjet 2.1% (RCP 2.6) dhe 4.3% (RCP 8.5)

Ndikimet e ndryshimeve klimatike

Ndryshimet aktuale dhe të parashikuara të klimës do të kenë efekte në kushtet meteorologjike dhe mjedisore në Shqipëri. Ndërsa temperatura mesatare rritet, ulja e reshjeve dhe rritja e nivelit të detit (SLR) do të kenë disa efekte në planin afat gjatë. Këto ndryshime do të rezultojnë gjithashtu në rritje të shpeshtësisë dhe intensitetit të fatkeqësive të lidhura me motin

Tabela 3. Përmbledhje e ndryshimeve klimatike dhe efektet/risqet në 2100 (Burimi: Albania Revised NDC)

Faktorët	Siperfaqja	Ndryshimi	Kohështrirja (në 2100)	Efektet/Risqet
Temperatura	Shqipëria	Rritja e temperaturës mesatare vjetore , veçanërisht për muajt e verës	+1,2-4,4°C (Verë: +1.-5.8°C)	Rritja e avullimit Rritja e temperaturës së ditëve të ftohta Rritja e përqindjes në reshjet e dimrit në formë shiu (në vend të borës)
	Bregdeti Shqiptar	Rritja e temperaturës minimale dhe maksimale (të gjitha stinët)	Maksimumi i verës: +1,5-6,4°C Min. dimri: +0,9-3,8°C	
	Bregdeti Shqiptar	Rritja e shpeshtësisë së temperaturave jashtëzakonisht të larta	Ulja e periudhës ciklike nga 100 vjet në 9.2 – 3.6 vjet (shembulli i Tiranës)	Rritja e frekuencës së thatësirave
	Shqipëria	Rritja e numrit të netëve tropikale	Nga 1 në 10-70 / vit	
	Shqipëria	Rritja e numrit dhe kohëzgjatjes së valëve të të nxehtit	+17,5 – 38,5 ditë (deri në vitin 2050)	
Reshjet	Bregdeti Shqiptar	Ulje e reshjeve vjetore, veçanërisht për muajt e verës	-1.6 në -7.1%	
	Bregdeti Shqiptar	Rritje e reshjeve për muajt e dimrit	+1.8 to +7.8%	Rritje e shfaqjeve të përmbytjeve, sidomos gjatë dimrit, por edhe gjatë muajve të
	Bregdeti Shqiptar	Ndryshueshmëri e shtuar e reshjeve, me frekuencë dhe intensitet të shtuar të ngjarjeve të reshjeve të dendura	Ulja e periudhës ciklike nga 100 vjet në 60-75 vjet	

Faktorët	Siperfaqja	Ndryshimi	Kohështrirja (në 2100)	Efektet/Risqet
			(shembulli i Tiranës)	vjeshtës dhe të pranverës.
	Bregdeti Shqiptar/Shqipëria	Ulja e bilancit kumulativ 12-mujor të ujit (SPEI)	-0.34 deri -2.08	Rritje e shpeshtësisë së thatësirave Ulje e rrjedhjes vjetore të lumenjve (pellgu i Vjosës)
Rritja e nivelit të detit (SLR)	Bregdeti Shqiptar	Rritja e nivelit të detit	Baseni i Vjosës: mesatarisht +45 cm (RCP 4.5) deri +60 cm (RCP 8.5)	Kripëzimi i akuifereve bregdetare Rritja e cenueshmërisë së zonave bregdetare ndaj përmbytjeve nga stuhitë dhe erozioni

Ndryshimet e parashikuara në modelet e reshjeve gjatë muajve të dimrit, vjeshtës dhe pranverës rrisin riskun e përmbytjeve të lumenjve. Për shkak të rrafshësisë së tyre, zonat bregdetare nuk janë vetëm të ndjeshme ndaj përmbytjeve të parashikuara në rritje nga lumenjtë, por edhe nga valët e stuhive për shkak të rritjes se nivelit te detit. Përmasat e përmbytjeve dhe erozionit të zonave bregdetare pritet të rriten, duke prekur në mënyrë jo proporcionale plazhet, grykëderdhjet e lumenjve dhe lagunat dhe duke shkaktuar rrëshqitje toke. Duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e infrastrukturës së Shqipërisë ndodhet në zonën e saj bregdetare, ajo mund të preket. Bregdeti i Adriatikut, dhe delta e lumenjve Drini dhe Mati në veçanti janë identifikuar me "cënueshmëri kritike" ndaj ndryshimeve klimatike.

Infrastruktura e furnizimit me ujë bën pjesë në infrastrukturën e rrezikuar nga ndryshimet klimatike, pasi përmbytjet dhe stuhitë mund të ndikojnë në rrjetin ekzistues dhe impiantet e trajtimit. Për më tepër, rritja e nivelit te detit parashikohet të rrisë nivelin e ujit të lumenjve, duke përmbytur brigjet e lumenjve dhe duke rritur kripëzimin e akuiferëve bregdetarë. Rritjet e parashikuara të temperaturës do të çojnë në rritje të avullimit, veçanërisht në verë. Disponueshmëria e ujit do të ndikohet më tej nga ulja e reshjeve të parashikuara të jenë më të forta gjatë muajve të verës, duke rezultuar në uljen e rrjedhjes së lumenjve.

Nga ana tjetër, kërkesa për ujë pritet të rritet. Kjo lidhet kryesisht me rritjen e aksesit në furnizim me ujë dhe rritjen e përdorimit personal të ujit për mirëqenien, si dhe sfidat për qeverisjen e tij. Edhe pse efekti margjinal i ndryshimit të klimës është i vështirë për t'u parashikuar, valët e të nxehtit dhe thatësirat ka të ngjarë të çojnë në kulme të larta të kërkesës.
Duke pasur parasysh varësinë e lartë të vendit nga hidrocentralet dhe gjendjen e keqe të infrastrukturës përkatëse, furnizimi me energji është i prekshëm nga ndryshimet klimatike. Ulja e parashikuar e rrjedhjes vjetore të lumenjve do ta përkeqësojë këtë situatë. Në të vërtetë, Politika Kombëtare e Ndryshimeve Klimatike (2019) vlerëson se “deri në vitin 2050, prodhimi mesatar vjetor i energjisë elektrike nga hidrocentralet e mëdha të Shqipërisë mund të reduktohet me rreth 15% dhe nga hidrocentralet e vegjël me rreth 20%”. Infrastruktura

hidroelektrike mund të dëmtohet gjithashtu gjatë ngjarjeve të reshjeve të mëdha, të cilat tentojnë të shkaktojnë sasi jashtëzakonisht të larta të sedimenteve që derdhen në lumenj dhe diga.

Nga ana e kërkesës konsumatore, temperaturat e rritura do të shkaktojnë një rritje të ditëve të ftohta midis majit dhe shtatorit, gjë që do të reflektojë në kërkesën më të lartë për energji elektrike. Rrjeti i energjisë është i ekspozuar ndaj rritjes së kërkesës pikërisht në periudhën e vitit ku furnizimi pritet të jetë më i ulët. Prandaj, muajt e thatë të verës, me avullim më të lartë dhe thatësira më të shpeshta, do të ndikojnë në nivelin e rezervuarëve në muajt e verës.
Rritja e frekuencës dhe intensitetit të valëve të të nxehtit dhe thatësirave ka të ngjarë të rrisë numrin e zjarreve, veçanërisht zjarret në pyje, të cilat kërcënojnë mjedisin natyror, por edhe jetesën, vendbanimet dhe jetët njerëzore.

Fatkeqësitë e lidhura me klimën do të rrisin riskun e lëndimit dhe vdekjes së parandalueshme në mesin e popullatës, dhe veçanërisht në mesin e grupeve të cenueshme. Përmbytjet kanë qenë rreziku natyror që ka prekur shumicën e njerëzve midis viteve 1985-2019 dhe kjo tendencë është rritur vitet e fundit. Përveç pasojave të drejtpërdrejta të shëndetit fizik dhe mendor nga përmbytjet, përfshihen sëmundjet e transmetueshme nga uji ndaj të cilave foshnjat dhe fëmijët janë më të cenueshëm.

6.4. Grupet e cënueshme dhe ZRF

Fatkeqësitë prekin të gjitha sferat e shoqërisë, megjithatë disa grupe sociale janë më të prekura se të tjerat për shkak të cenueshmërive të tyre specifike. Këtyre grupeve duhet t'u kushtohet vëmendje e veçantë gjatë përgjigjes ndaj fatkeqësive, por gjithashtu të përfshihen në fazat e gatishmërisë dhe parandalimit pasi ka një vlerë të shtuar në zhvillimin e politikave gjithëpërfshirëse jo vetëm për grupin në fjalë, por për të gjithë shoqërinë.

Të gjitha fazat e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe të gjitha projektet e identifikuara nga SKZRF do të duhet të marrin në konsideratë elementin e grupeve të cenueshme dhe cilat do të jenë efektet për mirëqenien e tyre. Për më tepër, kapilarizimi i elementeve të kësaj strategjie të grupeve të cenueshme është thelbësor për nivelin e hartimit dhe zbatueshmërisë së planeve të pushtetit vendor për menaxhimin e riskut të fatkeqësive. Prandaj, dispozitat e përgjithshme strategjike lidhur me grupet e cenueshme do të duhet të përshtaten në strategjitë dhe planet e nivelit vendor në përputhje me nevojat përkatëse lokale.

Grupet më të cenueshme përbëhen nga familje të pafavorizuara financiarisht, komunitete të margjinalizuara dhe të përjashtuara nga shoqëria, duke përfshirë minoritetet dhe anëtarët e komunitetit LGBTQ, gratë, fëmijët, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. Risku i fatkeqësisë varet nga aftësia ripërtëritëse e strukturës sociale, ekonomike dhe politike dhe mund të zvogëlohet duke zvogëluar ekspozimin dhe cenueshmërinë dhe duke rritur këtë aftësi ripërtëritëse. Ndërtimi i aftësisë ripërtëritëse në të gjitha pjesët e shoqërisë kërkon përfshirje dhe partneritet të gjithë sektorëve. Ai gjithashtu kërkon pjesëmarrje gjithëpërfshirëse, të aksesueshme dhe jodiskriminuese, duke i kushtuar vëmendje të veçantë njerëzve jashtëzakonisht të cenueshëm ndaj fatkeqësive.

Kjo Strategji dhe aktivitetet e planifikuara duhet t'u përmbahen nevojave dhe kërkesave të grupeve të cenueshëm. Kuptimi i cenueshmërive të ndryshme është i rëndësishëm për zvogëlimin e risqeve dhe për të siguruar që nevojat e veçanta të plotësohen në të gjitha fazat e MRF. Grupet e cenueshme mund të përballen me sfida specifike gjatë dhe pas fatkeqësive. Këto përfshijnë mungesën e aksesit në informacion dhe komunikim, lehtësira dhe shërbime të

paarritshme, mungesë aksesi në burimet e nevojshme mbështetëse, mungesë kornizash të politikave përfshirëse dhe të përgjegjshme etj.

Disa veprime mbështesin aftësinë ripërtëritëse të grupeve të cenueshme Këto përfshijnë: mbështetjen e projektimit dhe zbatimit të gatishmërisë emergjente të fokusuar në aftësinë ripërtëritëse; zgjidhje të qëndrueshme nga te cilat përfitojnë të gjithë nëse grupet e cenueshme përfshihen në planifikimin dhe zbatimin e menaxhimit të emergjencave, strategjitë efektive dhe gjithëpërfshirëse të menaxhimit të emergjencave dhe aktivitetet e përgjigjes, rimëkëmbjes dhe rigjenerimit që përfshijnë cenueshmërinë.

Rehabilitimi social është një pjesë e rëndësishme e rehabilitimit nga fatkeqësitë. Grupet e cenueshme shpesh kanë nevojë për mbështetje të veçantë sociale për t'i mbijetuar ndikimeve të fatkeqësive. Kështu, ky lloj rehabilitimi do të përfshinte aktivitete të ndryshme si aktivitete edukative dhe mbështetje psikologjike. Objektet arsimore mund të vuajnë shumë në fatkeqësi - duke shkaktuar stres të konsiderueshëm te fëmijët. Prandaj, është e rëndësishme, në fazën e rehabilitimit, të jepen këshilla të rregullta për mësuesit, prindërit dhe fëmijët, të inkurajohen fëmijët të ndjekin rregullisht shkollën, t'u sigurohet fëmijëve materiale shkrimi dhe libra, t'i bëjmë fëmijët të marrin pjesë në të gjitha aktivitetet duke arritur normalitet në oraret ditore , në shkollë dhe shoqëri.

Personat me aftësi të kufizuara dhe ZRF

Edhe në kohë normale (faza para fatkeqësisë) personat me aftësi të kufizuara janë subjekt i diskriminimit dhe përjashtimit. Cenueshmëria e tyre rritet me ndryshimin e rrethanave për shkak të fatkeqësive. Zbatimi i SKZRF-së në Shqipëri duhet të krijojë kushte dhe të forcojë rrjetet e aftësisë së kufizuar në fazën para fatkeqësisë, duke identifikuar kapacitetet e tyre dhe duke i përfshirë në procesin e planifikimit. Të qenit me aftësi të kufizuara nuk e bën dikë të pambrojtur sipas përkufizimit, madje mund të zbulojë gjithashtu kapacitete dhe aftësi të atij personi ose një grupi personash me vlerë të shtuar për komunitetin që nuk ekzistonin më parë. Për ta bërë këtë, sistemi për mbrojtjen sociale luan një rol vendimtar dhe për këtë arsye duhet të krijohen lidhje efektive me ZRF.

Gjinia dhe ZRF

Meqenëse fatkeqësitë prekin burrat, gratë, djemtë dhe vajzat në mënyra të ndryshme, integrimi i perspektivave gjinore në zbatimin e SKZRF-së u mundëson të gjithëve, pavarësisht aftësive dhe prejardhjes sociale, të gëzojnë të njëjtat mundësi. Zbatimi i një lente gjinore në këtë iniciativë ZRF do të mundësojë adresimin e kapaciteteve specifike gjinore dhe nevojave konkrete në popullatën e prekur, si dhe aftësinë e komuniteteve të prekura të grave dhe burrave për t'u përballur dhe rimëkëmbur nga fatkeqësitë. Gjinia shpesh ndërthuret me faktorë të tjerë si mosha, orientimi seksual, lëvizshmëria sociale, përkatësia etnike, prejardhja kulturore, statusi ekonomik ose profesioni, duke përforcuar cenueshmërinë e një individi ndaj fatkeqësive. Këta faktorë i bëjnë gratë dhe vajzat më të prirura për t'u prekur në mënyrë jo proporcionale nga fatkeqësitë dhe çojnë në një rritje të humbjes së mjeteve të jetesës, dhunës me bazë gjinore dhe vdekjeve. Meqenëse gjinia përcaktohet nga shpërndarja aktuale e pushtetit në shoqëri dhe lidhja e ngushtë e saj me normat dhe vlerat ekzistuese shoqërore, të pasurit e perspektivave gjinore të trajtuara në projektet e ZRF të identifikuara me Strategjinë e ZRF do të mundësojë adresimin më të mirë të nevojave të grave dhe vajzave të prekura nga perspektivat ndërsektoriale si dhe synimin dhe zbatimin e projekteve kuptimplotë.

Kuadri Sendai thekson rëndësinë e angazhimit të grave në ndërtimin e programeve të aftësive ripërtëritëse ndaj fatkeqësive. Rekomandimet specifikojnë marrjen në konsideratë të perspektivës së gjinisë, moshës, aftësisë së kufizuar dhe kulturore në të gjitha politikat dhe praktikat e ZRF-së, pasi: "Pjesëmarrja e grave është kritike për menaxhimin efektiv të riskut të

fatkeqësive dhe hartimin, dhënien e burimeve dhe zbatimin e politikave, planeve dhe programeve për zvogëlimin e riskut të fatkeqësive me ndjeshmëri gjinore; dhe duhet të merren masa adekuate për ngritjen e kapaciteteve për të fuqizuar gratë për gatishmëri, si dhe për të ndërtuar kapacitetin e tyre për mjete alternative të jetesës në situatat pas fatkeqësisë."

Për më tepër, angazhimi i grave dhe vajzave në rritjen e aftësisë ripërtëritëse të komunitetit është thelbësor për arritjen e Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm, veçanërisht OZHQ 5 (barazia gjinore dhe fuqizimi i grave). Barazia gjinore dhe fuqizimi i grave janë çështje ndërsektoriale dhe parakushte për arritjen e shumë OZHQ-ve të tjera, duke përfshirë OZHQ 1 (pa varfëri), OZHQ 11 (qytetet dhe komunitetet e qëndrueshme) dhe OZHQ 13 (Ndryshimet klimatike). Përmbushja e OZHQ -ve mbështetet në vlerësimin dhe promovimin e kapaciteteve unike të grave kur bëhet fjalë për ZRF. Të bësh këtë jo vetëm që do të ndihmojë politikëbërësit, ekipet e shpëtimit dhe profesionistët e ZRF-së që t'u shërbejnë komuniteteve të prekura në mënyrë më efektive, por gjithashtu mund të korrigjojnë pabarazitë dhe padrejtësitë ekzistuese gjinore.

SKZRF do t'u ofrojë grave mundësi për të marrë role udhëheqëse në zvogëlimin e riskut, gatishmërinë, përgjigjen dhe rimëkëmbjen, i pozicionon ato të ndikojnë në drejtimin e zhvillimit dhe mundëson shfaqjen e roleve dhe marrëdhënieve gjinore më progresive.

Një nga kriteret buxhetore në planin e veprimit për projektet strategjikë do të jetë edhe ndjeshmëria gjinore për të cilën do të ketë një listë kontrolli me kritere buxhetore të ndjeshme gjinore.

Të moshuarit, fëmijët, minoritetet dhe komuniteti LGBTQ

Të moshuarit, fëmijët dhe minoritetet e margjinalizuara dhe anëtarët e komunitetit LGBTQ janë më të prekshëm pas një fatkeqësie të madhe. Prandaj, është e rëndësishme që në fazën e rehabilitimit të organizohen këshillime të rregullta për forcimin e shëndetit, veçanërisht mendor të grupeve të cenueshme; kushtim vëmendje te shëndetit, ushqyerjes dhe higjienës në paketën e rehabilitimit afatgjatë; aktivizim ose riaktivizim për qendrat e kujdesit ditor dhe shtëpitë e të moshuarve; promovim për grupet e vetëndihmës etj.

Përveç këtyre veprimeve, është e rëndësishme që reaguesit e emergjencës të jenë të vetëdijshëm dhe kompetent në planifikimin, përgjigjen dhe rimëkëmbjen gjithëpërfshirëse, në mënyrë që grupet e cenueshme të mund të marrin pjesë në aftësinë ripërtëritëse, përgjigjen dhe rimëkëmbjen në të njëjtën bazë si të tjerët.

Në fund, ka një njohje në rritje në Evropë të komplementariteteve të shumta dhe një konvergjence në rritje në qasjet ndërmjet ndihmës së ofruar në kontekste krize dhe qasjeve të mbrojtjes sociale të miratuara në kontekste më të qëndrueshme. Kështu, vendi duhet të marrë në konsideratë zbatimin dhe funksionimin e programeve të mbrojtjes sociale në situata tronditjesh dhe krizash të zgjatura dhe lidhjen e ndihmës humanitare me sistemet e mbrojtjes sociale.[21].

[21] https://socialprotection.org/discover/publications/tools-and-methods-series-reference-document-no-26-social-protection-across

Shtojca 1: Analiza SWOT

Shtojca 2: Lista e dokumenteve kombëtare në përputhje me Strategjinë

Tabela 4. Lista e dokumenteve kombëtare

Nr.	Dokumenti
1.	Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë
2.	Ligji Nr. 103/2014 "Për miratimin e Strategjisë së Sigurisë Kombëtare të Republikës së Shqipërisë"
3.	VKM nr. 348, datë 11.5.2016 "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020"
4.	Progres Raportet e Komisionit Evropian për Shqipërinë
5.	VKM nr.91, datë 9.2.2022 "Për miratimin e planit kombëtar për integrimin evropian 2022–2024"
6.	Ligji nr. 75/2016 "Për ratifikimin e marrëveshjes së Parisit, në kuadër të konventës kuadër të kombeve të bashkuara, për ndryshimet klimatike"
7.	Raporti i Vlerësimit të rreziqeve në Shqipëri, Tetor 2003
8.	Plani Kombëtar për Emergjencat Civile në Shqipëri
9.	Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar
10.	Ligji nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
11.	Ligji nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut"
12.	Ligji nr. 45/2016 "Për vullnetarizmin"
13.	Ligji nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"
14.	VKM nr. 810 prot., datë 21.10.2020 "Për miratimin e dokumentit "standardet shtetërore për specifikimet teknike të informacionit gjeohapësinor në Shqipëri - tema: zonat me rreziqe natyrore"
15.	Aktet nënligjore të Ligjit Nr. 72/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e infrastrukturës kombëtare të informacionit gjeohapësinor në Republikën e Shqipërisë"
16.	Ligji nr.45/2019, "Për Mbrojtjen Civile"
17.	Aktet nënligjore të Ligjit 45/2019, "Për Mbrojtjen Civile"
18.	VKM nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat e dhënies së ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësi natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore"
19.	VKM nr. 148, datë 24.2.2016 "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të integruar të informacionit dhe statistikës të Këshillit të Ministrave"
20.	VKM nr. 501, datë 13.9.2017 "Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes", i ndryshuar me VKM nr. 9, datë 12.1.2018.

Nr.	Dokumenti
21.	Ligji nr.10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë"
22.	Ligji nr. 72/2015 "Për miratimin e strategjisë ushtarake të Republikës së Shqipërisë"
23.	VKM nr. 628, datë 25.9.2019 "Për miratimin e dokumentit të rishikimit të strategjisë së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë"
24.	VKM-të përkatëse lidhur me përcaktimin e fushës së përgjegjësive shtetërore të ministrive
25.	Ligji nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"
26.	Aktet nënligjore të Ligjit nr. 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin"
27.	VKM nr. 345, datë 22.5.2019 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të ujitjes dhe kullimit 2019–2031 dhe të planit të veprimit"
28.	VKM nr. 437, datë 17.5.2017 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë"
29.	VKM nr. 221, datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar
30.	Ligji nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit"
31.	Udhëzim nr.12, datë 30.12.2019 "Për rregullat dhe kriteret teknike për mirëmbajtjen dhe funksionimin e infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit"
32.	VKM nr. 73, datë 7.2.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027"
33.	Ligji nr. 8681, datë 2.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", i ndryshuar
34.	Ligji nr. 111/2012 "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", i ndryshuar
35.	VKM nr. 147 datë 18.3.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe të dambave"
36.	Urdhri nr. 370, datë 11.6.2019 "Për miratimin e statutit tip të Organizatës së Përdoruesve të Ujit"
37.	Urdhri nr. 697, datë 30.12.2019 "Për miratimin e regjistrave të drejtorive të ujitjes dhe të kullimit, bashkive dhe organizatave të përdoruesve të ujit"
38.	VKM nr. 1015, datë 16.12.2020 "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet"
39.	VKM nr.1157, datë 25.11.2009 "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit", i ndryshuar
40.	VKM nr.567, datë 14.7.2010 "Për transferimin e rezervuarëve dhe skemave ujitëse përkatëse nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në pronësi të njësive të qeverisjes vendore dhe për një ndryshim në vendimin nr.1157, datë 25.11.2009 të KM "për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të bordeve të kullimit, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit"

Nr.	Dokumenti
41.	VKM nr.1108, datë 30.12.2015 "Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave te bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit", i ndryshuar
42.	Projekti i Programit të Rimëkëmbjes nga Përmbytjet: UTF/ALB/010/ALB "Rikuperimi i dëmeve bujqësore dhe rivendosja e kapacitetit prodhues"
43.	Ligji nr. 57/2020, datë 30.4.2020, "Për pyjet"
44.	Ligji nr.9863, datë 28.1.2008 "Për ushqimin", i ndryshuar
45.	Ligji nr.10 465, datë 29.9.2011 "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar
46.	VKM nr. 1080, datë 22.12.2010, "Për rregullat për parandalimin dhe shuarjen e zjarreve në pyje dhe në kullota, si dhe për krijimin e njësive vullnetare të shuarjes së zjarreve".
47.	VKM nr.290, datë 30.4.2004, "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota"
48.	Dokument "Mbi politikat e sektorit të pyjeve në Shqipëri"
49.	Zbatimi i Politikës pyjore për kujdesin dhe shërbimet cilësore ndaj pyjeve-Politikat 10; 11 dhe 12 - Masat-31; 32; 33; 34; 35; 36; 37; 38; 39 and 40
50.	Ligji nr. 9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar
51.	VKM nr.80, datë 28.1.2005 "Për përbërjen, mënyrat e funksionimit, detyrat dhe përgjegjësitë e strukturave shtetërore të mbrojtjes së tokës bujqësore"
52.	Urdhri nr. 535, datë 27.9.2019 "Për miratimin e marrëveshjes tip të bashkëpunimit ndërmjet bashkisë dhe shoqërisë së bashkëpunimit bujqësor"
53.	Strategjia Kombëtare për Kulturën 2019-2025
54.	Menaxhimi i riskut nga fatkeqësitë për trashëgiminë botërore – Manual 2010
55.	Ligji nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"
56.	VKM nr. 420, datë 15.6.2022 "Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura"
57.	VKM nr. 1125, datë 30.12.2020 "Për miratimin e rregullave të projektimit, zbatimit të punimeve të ndërhyrjeve ruajtëse e mbrojtëse në pasuritë kulturore materiale, mbikëqyrjes dhe kolaudimit të tyre"
58.	Menaxhimi i Riskut të fatkeqësive të Siteve të Trashëgimisë Kulturore në Shqipëri- 2014
59.	Marrëveshja e bashkëpunimit ndërmjet Institutit Kombëtar të Trashëgimisë Kulturore dhe Trashëgimisë Kulturore pa Kufij (OJQ): Përmirësimi i sistemit të monitorimit të gjendjes së pasurive kulturore
60.	Planet për përgatitjen për emergjencat civile, të Ministrisë së Kulturës dhe 28 institucioneve në varësi
61.	VKM nr. 1099 datë 24.12.2020 "Për miratimin e mënyrave të trajtimit, normave teknike, kritereve dhe modeleve të ndërhyrjeve në fushën e ruajtjes së pasurive kulturore"

Nr.	Dokumenti
62.	Analiza e Riskut Sizmologjik - Gjeo-rrezikut dhe Udhëzimet për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive për parkun arkeologjik të Apolonisë, qendrat historike të Beratit dhe Gjirokastrës dhe Butrintit''
63.	Ligji nr. 7864, datë 29.9.1994 "Për Kryqin e Kuq Shqiptar", i ndryshuar.
64.	Ligji nr.7865, datë 29.9.1994, "Për mbrojtjen e emblemës dhe të emrit të Kryqit të Kuq"
65.	Plani i KKSH për gatishmërinë dhe përgjigjen ndaj fatkeqësive
66.	Politika e KKSH-së në fushën e Emergjencave dhe Krizave
67.	Strategjia KKSH për Zhvillim 2020-2030
68.	VKM nr.290, datë 30.4.2004, "Për miratimin e Strategjisë Kombëtare për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe kullota".
69.	Akti Normativ Nr. 9, datë 16.12.2019 "Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore" miratuar me ligjin 97/2019
70.	Gjithë paketa ligjore e përbërë nga ligjet, Aktet Normative dhe VKM-të që lidhen me Komisionin Shtetëror të Rindërtimit dhe më pas me Ministrin e Shtetit për Rindërtimin e cila gjendet në: https://rindertimi.gov.al/ligje/
71.	Plani i Përgjithshëm Kombëtar i Territorit
72.	Ligji nr. 107, datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar
73.	VKM nr. 686, datë 22.11.2017 "Për miratimin e rregullores së planifikimit të territorit", i ndryshuar
74.	Ligji nr. 10431, datë 09.06.2011 "Për mbrojtjen e mjedisit", i ndryshuar
75.	Ligji 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura"
76.	Ligji nr. 111/2015, datë 15. 10. 2015 "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar"
77.	Ligji nr. 8025, datë 9.11.1995 Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese, i ndryshuar
78.	Ligji nr. 824, datë 18.12.2019 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të menaxhimit të financave publike 2019-2022"
79.	Ligji nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar
80.	Legjislacioni i Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit
81.	Strategjia e zvogëlimit të riskut të fatkeqësive në Bashkinë Lezhë, 2020
82.	Vlerësimi i Riskut të Fatkeqësive në bashkinë Lezhë, 2020
83.	Plani vendor për emergjencat civile në bashkinë Lezhë, 2020
84.	Komanda Evropiane e Shteteve të Bashkuara (USEUCOM) "Raporti i Vlerësimit të aftësive të Kundërtrafikimit të Armëve të Shkatërrimit në Masë/ Menaxhimit të Pasojave dhe Gatishmërisë ndaj Fatkeqësive". Korrik 2014
85.	Raporti i Nevojave pas Përmbytjes në Shqipëri, prill 2015
86.	Menaxhimi i Fatkeqësive në Shqipëri. Analiza e Mangësive. Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Prezenca në Shqipëri. 2017

Nr.	Dokumenti
87.	Analizë gjithëpërfshirëse e reduktimit të rrezikut nga fatkeqësitë dhe e sistemit të menaxhimit për bujqësinë në Shqipëri
88.	Komunikimi i Tretë Kombëtar i Republikës së Shqipërisë mbi Ndryshimet Klimatike
89.	Vlerësimi i Nevojave pas Fatkeqësive (PDNA) në Shqipëri, shkurt 2020
90.	"Drejt strategjisë gjithëpërfshirëse të menaxhimit të riskut të fatkeqësive në Shqipëri". Vlerësimi i kapacitetit të sistemit të menaxhimit të riskut të fatkeqësive. Raport vlerësimi. UNDP 2020
91.	Diagnostikimi i Financave të Riskut të Fatkeqësive. Shqipëri. Banka Botërore. Dhjetor 2020
92.	Raport diagnostikues. Vlerësimi i gatishmërisë dhe përgjigjes emergjente. Shqipëri. Banka Botërore 2021
93.	Raport investimesh. Vlerësimi i gatishmërisë dhe përgjigjes emergjente. Shqipëri. Banka Botërore 2021
94.	Përmirësimi i informacionit për riskun e fatkeqësive dhe humbjet në Shqipëri. Katalogu i informacionit të lidhur me riskun - Detyra 1. Banka Botërore. Shkurt 2022
95.	Përmirësimi i informacionit për riskun e fatkeqësive dhe humbjet në Shqipëri. Vlerësimi dhe përmirësimi i aksesit të informacionit të lidhur me riskun - Detyra 2. Banka Botërore. Mars 2022
96.	Përmirësimi i informacionit për riskun e fatkeqësive dhe humbjet në Shqipëri. Rekomandime për përmirësimin e informacionit për humbjen pas fatkeqësisë. Detyra 3. Banka Botërore. Mars 2022
97.	Përmirësimi i informacionit mbi riskun dhe humbjet nga fatkeqësitë në Shqipëri. Përmbledhje ekzekutive. Maj 2022
98.	Planifikimi Kombëtar i Përshtatjes (NAP) ndaj ndryshimit të klimës në Shqipëri. Kornizë për procesin e vendit
99.	Raporti i parë i përditësimit dyvjeçar të Shqipërisë, korrik 2021
100.	Standardi ISO 31000 për Menaxhimin e Riskut
101.	Dokumenti i Referencës së Serisë së Mjeteve dhe Metodave Nr. 26: Mbrojtja sociale përgjatë lidhjes së zhvillimit humanitar. Një ndryshues loje në mbështetjen e njerëzve përmes krizave
102.	VKM Nr. 866, datë 24.12.2019 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të mbrojtjes sociale, 2020-2023 dhe të planit të veprimit në zbatim të saj"
103.	VKM Nr. 276, datë 12.05.2021 "Për miratimin e planit kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021-2025"
104.	Ligj Nr. 57/2019 "Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë".
105.	VKM Nr. 400, datë 30.06.2021 "Për miratimin e strategjisë kombëtare për barazinë gjinore, 2021 – 2030 dhe të planit të saj të veprimit"

Shtojca 3: Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut të fatkeqësive për Shqipërinë 2023-2027.

Menaxhimi i Riskut të Fatkeqësive është një fushë jashtëzakonisht komplekse dhe ka një efekt shumë-sektorial në pothuajse të gjitha aspektet e jetës dhe zhvillimit. Ai përfshin politika të ndryshme që duhet të veprojnë në sinergji për të përmirësuar aktivitetet e parandalimit, përgjigjes dhe rimëkëmbjes.

Si pjesë e zhvillimit të Strategjisë për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë, është hartuar Plani i Veprimit për Zvogëlimin e Riskut nga Fatkeqësitë për periudhën 2023-2027 si akt që bën operacional zbatimin e Strategjisë. Për periudhën e mbetur të zbatimit të Strategjisë do të zhvillohet edhe një plan veprimi, përkatësisht Plani i Veprimit për periudhën 2028-2030.

Shumat në Planin e Veprimit i referohen vlerësimit tregues të kornizës financiare të çdo aktiviteti ose kostos së zbatimit të projektit dhe bëhen në bazë të hulumtimit të tregut dhe përvojës së propozuesve.

Plani i veprimit i referohet aktiviteteve të menaxhimit të gjithsej 6 risqeve të përcaktuara për qëllime të hartimit të Strategjisë deri në vitin 2030. Për secilin risk janë përcaktuar një sërë aktivitetesh që do të realizohen me prioritet deri në fund të vitit 2026. Krahas aktiviteteve individuale të menaxhimit të riskut, Plani i Veprimit përfshin grupe aktivitetesh që njëkohësisht ndikojnë në nivelin e të gjitha ose më shumë risqeve njëherësh: aktivitete për forcimin e Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive.

1. Menaxhimi i riskut të fatkeqësive me shumë risqe[22]

Tabela 5. Projektet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive me shumë risqe

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes dhe ministritë e linjës. Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL

[22] Kostot e të gjithë projekteve strategjikë në seksionet 1-7 janë vendosur në monedhën origjinale të projekteve strategjikë të propozuar nga anëtarët e grupeve ndërinstitucionale të punës për hartimin e SKZRF-së

Projekti strategjik 1:	*Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)*
Përshkrimi: Pas nënshkrimit në datën 18.11.2022 të "Marrëveshjes ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit" Shqipëria është tashmë anëtarja e 35-të me të drejta të plota në MMC BE. . Zbatimi i procedurave kërkon aktet nënligjore që kërkohen për zbatimin e TESTA-s në mënyrë që të bëhet funksionale në Shqipëri duke siguruar kështu lidhjen me sistemin e përbashkët të komunikimit dhe informacionit emergjent (CECIS). *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti mes këtij projekti dhe:* - *Projektit Strategjik nr.3: "Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112"* - *Projektit Strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*	
Afati kohor:	*2023 - 2027*
Aktivitetet kryesore:	1. *Identifikimi i kërkesave teknike dhe institucionale për qasje në TESTA* 2. *Mbështetja e përgatitjes së udhërrëfyesit për ngritjen e sistemit TESTA* 3. *Zhvillimi i materialeve të trajnimit dhe planeve dhe programeve mësimore në përputhje me udhëzimet e BE-së.* 4. *Mbështetje për ngritjen e sistemit TESTA* 5. *Mbështetje për forcimin e protokolleve të bashkëpunimit dhe qasjes së pikës së vetme të kontaktit në trajtimin e MMC BE* 6. *Kryerja e trajnimeve mbi legjislacionin e MMC BE, rregullat zbatuese dhe procedurat e përgjithshme* 7. *Rekomandime teknike në lidhje me vendosjen e lidhjeve të komunikimit me Qendrën Koordinuese të Përgjigjes Emergjente të BE-së (ERCC)* 8. *Aktivizimi i lidhjes dhe lidhshmërisë me mjetet e monitorimit të BE-së dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm (EFAS, EFFIS, Copernicus)* 9. *Sigurimi i planifikimit në kohë të burimeve financiare të nevojshme për pagesën e tarifave vjetore për TESTA si dhe anëtarësimin në MMC BE*
Korniza financiare/burimi:	Gjithsej 1.840.000 USD - EUR Buxheti i BE/OKB/Buxhet Kombëtar nga të cilat 840,000 USD do të jenë të projektit UNDP RESEAL

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile

Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes
Projekti strategjik 2:	*Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot"*
Përshkrimi: Krijimi i një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot" sipas standardeve ndërkombëtare për t'iu bashkuar kapaciteteve të EERC. Ky modul do të certifikohet nga Komisioni Evropian dhe do të jetë gati për t'iu bashkuar EERC-së. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti mes këtij projekti dhe:* - *Projektit Strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* - *Projektit Strategjik nr.12: "Forcimi i sistemit të Paralajmërimit të Hershëm";* - *Projektin strategjik nr.8 të tërmeteve:* "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)"; - *Projektin strategjik nr.8 të përmbytjeve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytje";* - *Projektin strategjik nr.5 të zjarreve në pyje:* "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së"	
Afati kohor:	*2023 - 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. *Studimi për ngritjen e një "Ekipi me mjete ajrore pa pilot".* 2. *Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO.* 3. *Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO* 4. *Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve të trajnimit dhe/ose ushtrimeve në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian* 5. *Kryerja e procesit të certifikimit të modulit si dhe regjistrimi i tij në EERC* 6. *Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për modulin si dhe pagesat e tjera vjetore të funksionalitetit dhe operimit të tij*
Korniza financiare/burimi:	Kostot e zhvillimit: 15,500,000 euro (fondi maksimal i nevojshëm për krijimin e një moduli është vendosur) Mirëmbajtja: 7'500'000 EURO Dislokimi: 8'308'160 EURO Në total = 31,308,160 EURO

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes
Institucione kontribuuese	Ministria e Brendshme dhe ministri të tjera të linjës
Projekti strategjik 3:	*Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112*
Përshkrimi: Vënia në zbatim e Numrit të Unifikuar të Emergjencave 112, bazuar në fazën aktuale të zbatimit të tij si edhe studimin e fizibilitetit dhe projektin e zbatimit të hartuar në vitin 2011, nëpërmjet projektit të Bankës Botërore Al-DRMAP. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti dhe:* - *Projektit Strategjik nr 1: "Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)"* - *Projektit Strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*	
Afati kohor:	*2023 - 2026*
Aktivitetet kryesore:	1. *Hartimi dhe miratimi i VKM-së "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112"* 2. *Hartimi i një studimi për gjendjen e zbatimit të 112 në Shqipëri, bazuar në gjendjen faktike dhe studimin e fizibilitetit dhe projektin e zbatimit të vitit 2011.* 3. *Nëse është e nevojshme, bazuar në përfundimet e studimit, hartimi i një projekti të ri për zbatimin e numrit 112.* 4. *Zbatimi i numrit të Unifikuar të Emergjencës Civile 112 bazuar në konkluzionet e studimit të kryer dhe projektit të ri/studimit të fizibilitetit dhe projektit të zbatimit, të kryer në dhjetor 2011, në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Projekti për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP).* 5. *Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për zbatimin e numrit të unifikuar të emergjencës civile 112 sikurse pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij.*
Korniza financiare/burimi:	30,000,000 EURO BE/OKB/Buxhet kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Struktura qendrore e MZSH-së, përfshirë 12 drejtoritë e MZSH në bashkitë - qendra qarqesh. Projekti do të mbështetet nga AICS
Projekti strategjik 4:	*Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri*
Përshkrimi: Në vijim të Konferencës së Donatorëve, të datës 17 Shkurt 2020 (mbajtur për tërmetin e datës 26 Nëntor 2019), Cooperazione Italiane në bashkëpunim me qeverinë Italiane, do të menaxhojnë fondet për mbrojtjen civile që do të investohen apo dhurohen në Shqipëri nga të gjithë donatorët. Projekti konsiston në financimin nga Qeveria Italiane në formën e kredisë është një projekt i tërë dhe me nën komponentë të ndërtimit dhe infrastrukturave teknologjike të godinës së re të AKMC-së, pajisjet për sallat e operacionale në katër qendrat e AKMC-s dhe 8 Prefektura, mjetet dhe pajisjet, kampus shkollor për trajnim *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti dhe:* - *Projektit strategjik nr.1: "Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)"* - *Projektit strategjik nr.2: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot";* - *Projektit strategjik nr.3: "Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112";* - *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile":* - *Projekti strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave"* - *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";* - *Projektin strategjik nr.7 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit";* - *Projektin strategjik nr. 23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve"*	
Afati kohor:	*2022 - 2026*
Aktivitetet kryesore:	*1. Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme për miratimin e Marrëveshjes së Kredisë* *2. Ndërtimi dhe pajisja e ndërtesës së re të AKMC-së;* *3. Sigurimi i furnizimit me mjete, automjete dhe pajisje për AKMC-në dhe Shërbimin e MZSH-së;* *4. Rritja e formimit profesional të stafit të MZSH-së;*

Korniza financiare/burimi:	30,000,000 euro

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes dhe ministritë e linjës
Projekti strategjik 5:	*Politikat dhe legjislacioni*
Përshkrimi: Përfundimi i hartimit dhe miratimit të akteve nënligjore, në zbatim të ligjit 45/2019 "Për mbrojtjen civile". *AKMC duhet të sigurojë sinergjinë dhe komplementaritetin e:* *Aktivitetit nr.3 të këtij projekti me projektet respektive të lidhura me metodologjinë e vlerësimit të riskut të veçantë sikurse janë:* - *Projektin strategjik nr.15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku"* - *Projekti strategjik nr.2 i tërmetit: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";* - *Projekti strategjik nr,2 i zjarreve në pyje "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";* - *Projekti strategjike nr.1 i sëmundjeve infektive/biologjike "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik"* *Aktivitetit nr.4 të tij me:* - *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)".* - *Projektin strategjik nr. 20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut"*	
Afati kohor:	*2023 - 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. *Bazuar në rezultatet e konsulencës së dokumentit të PKEC-së, zhvillimi i vazhdimësisë së planifikimit të operacioneve (COOP) dhe vazhdimësisë së Qeverisë (COG) në ministri dhe institucione të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes;* 2. *Hartimi i metodologjisë për Planin e Emergjencave Civile në nivel qendror, qarku dhe vendor si dhe për infrastrukturën kritike, SEVESO dhe institucione të tjera (sipas detyrimit përkatës që buron nga neni 23, pika 6, shkronja "dh" e ligjit 45/2019);* 3. *Hartimi i Metodologjisë/Udhëzimit për Vlerësimin e Riskut të fatkeqësive në nivel qendror, qarku dhe vendor si dhe infrastrukturën kritike;*

	4. *Hartimi i udhëzimeve për funksionet e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë në ndihmë të përdoruesve të tij;* 5. *Hartimi i udhëzimeve, rregulloreve dhe manualeve të përcaktuara nga konsulenca e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile*
Korniza financiare/burimi:	500,000 EURO

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL
Projekti strategjik 6:	*Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)*
Përshkrimi: Identifikimi i sfidave të bashkëpunimit në përgjigje të emergjencave brenda dhe ndërmjet agjencive të emergjencave në Shqipëri dhe përpjekje për të ndërtuar kapacitete për t'i trajtuar ato në përputhje me rrethanat. Projekti do të bazohet në rezultatet e konsulencës së Planit Kombëtar të Emergjencave Civile që përfshin: - *kryerjen e një analize të mangësive të procedurave aktuale për zhvillimin e procedurave standarde të funksionimit të komunikimit dhe njoftimit të gjithë qeverisë (SOP) dhe ushtrimin e tyre në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe incidenti;* - *Rekomandime për udhëzimet, rregulloret, manualet dhe PSO-të e reja që do të zhvillohen në vend;* *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Aktivitetin nr.3 "Zhvillimi i procedurave standarde operacionale" të Projektit strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";* - *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"*	
Afati kohor:	*2023 - 2024*
Aktivitetet kryesore:	1. *Bazuar në rezultatet e Konsulencës së PECK, kryerja e një analize të mangësive të procedurave aktuale për të zhvilluar procedurat standarde të funksionimit të komunikimit dhe njoftimit të gjithë qeverisë (SOP) dhe ushtrimin e tyre në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe incidenti;* 2. *Bazuar në rezultatet e Konsulencës së PECK për SOP që do të zhvillohet në Shqipëri:*

	2.1. SOP-të e identifikuara me prioritet të zhvilluara në konsultim me palët e interesit dhe institucionet përkatëse *2.2. Mbështetje konsultimesh për SOP dhe miratimin e tyre*
Korniza financiare/burimi:	150,000 USD. UNDP. Projekti RESEAL

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL
Projekti strategjik 7:	*Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)*
Përshkrimi: Pas miratimit të VKM nr. 345, datë 26.5.2022 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të humbjeve nga fatkeqësitë" pritet të miratohen edhe udhëzime për funksionet e bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë në mbështetje të përdoruesve të saj. Projekti do të ndihmojë në përmbushjen e detyrimit ligjor për të krijuar një bazë të dhënash për humbjet nga fatkeqësitë, që është një detyrim për AKMC-në, ministritë dhe institucionet qendrore si dhe institucionin e prefektit dhe bashkitë. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.5: Politikat dhe legjislacioni"* - *Projektin strategjik nr.20 "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";* - *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcimi i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete".* - *Projektin strategjik nr.3 të tërmeteve: "Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave"*	
Afati kohor:	*2023 - 2024*
Aktivitetet kryesore:	1. *Studimi i të gjitha raporteve ekzistuese në lidhje me të dhënat e humbjeve nga fatkeqësitë në Shqipëri dhe identifikimi i gjendjes ekzistuese* 2. *Zbatimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë* 3. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave dhe përmirësime ligjor

Korniza financiare/burimi:	100,000 USD. UNDP. Projekti RESEAL

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Arsimit dhe Sportit (vetëm për kurrikulat)
Institucione kontribuuese	Strukturat vendore të shërbimit të MZSH
Projekti strategjik 8:	*Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut*
Përshkrimi: Krijimi dhe përfshirja në kurrikulat e njohurive të Mbrojtjes Civile, si dhe zhvillimi i burimeve njerëzore përmes trajnimeve dhe edukimit të vazhdueshëm. Përgatitja e një programi ndërgjegjësues të komunitetit dhe të planit përkatës të punës si dhe zbatimi i tij.	
Afati kohor:	*2023 - 2025*
Aktivitetet kryesore:	*1. Kryerja e një studimi për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të njohurive të Mbrojtjes Civile, verifikim nëse niveli parauniversitar ofron njohuri për mbrojtjen dhe parandalimin e fatkeqësive, në përputhje me profilin e tyre.* *2. Në përputhje me përfundimet e studimit, hartimi i një plani veprimi për përmbushjen e detyrimit ligjor.* *3. Zbatimi i planit të veprimit për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të njohurive të Mbrojtjes Civile* *4. Zhvillimi i një programi ndërgjegjësimi publik për ZRF dhe të planit të veprimit* *5. Zbatimi i planit të veprimit të ndërgjegjësimit publik për ZRF*
Korniza financiare/burimi:	600,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 9:	*Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile*

Përshkrimi: Sipas nenit 26, pika 6, shkronja "f" të ligjit 45/2019, AKMC përgatit Programin e Trajnimit të Strukturave Civile të Mbrojtjes Civile, në nivel qendror dhe vendor. AKMC, nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Trajnimit për Mbrojtjen Civile, kryen trajnime të strukturave shtetërore, subjekteve private dhe vullnetare. Nga ana tjetër, bashkitë duhet të organizojnë trajnime në fushën e Mbrojtjes Civile për punonjësit dhe banorët në territorin e tyre. Projekti mbështet AKMC-në në zhvillimin e moduleve të trajnimit me qëllim që të fillojë sa më shpejt zbatimi i Programit të Trajnimit të Personelit në të gjithë sistemin e Mbrojtjes Civile të vendit. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.17 të planifikuar nga Banka Botërore "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";* - *Projektin strategjik nr.19: "Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki;* - *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";* - *Projektin strategjik nr.23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve"*	
Afati kohor:	*2023 - 2027*
Aktivitetet kryesore:	1. *Zhvillimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile bazuar, ndër të tjera, në Planin e ri Kombëtar të Emergjencave Civile dhe veçanërisht në rekomandimet e konsulencës të PKEC lidhur me të.* 2. *Mbështetja e konsultimeve ndërinstitucionale dhe miratimi i programit të trajnimit* 3. *Implementimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile*
Korniza financiare/burimi:	1,000,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Do të mbështetet nga JICA dhe donatorë të tjerë
Projekti strategjik 10:	*Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje (JICA)*
Përshkrimi: Qëllimi i këtij projekti është forcimi i sistemit të integruar të menaxhimit të emergjencave në Shqipëri me kapacitet të zhvilluar të agjencive qeveritare për mbrojtjen nga zjarret në pyje dhe fatkeqësitë e tjera natyrore. Një sistem të tillë të paralajmërimit të hershëm, JICA e ka zhvilluar në Maqedoninë e Veriut dhe kjo shihet si një qasje për kontribut rajonal	

AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me: - *Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje: "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";* - *Projektin strategjik nr.11: "Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"";* - *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"*	
Afati kohor:	*2023-2025*
Aktivitetet kryesore:	1. *Kryerja e një misioni nga ekspertët japonezë për një vlerësim të gjendjes ekzistuese të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Identifikimi i boshllëqeve, mangësive dhe propozimet për përmirësim* 2. *Nënshkrimi i Marrëveshjes Teknike për Asistencën Teknike të Qeverisë së Japonisë* 3. *Implementimi i projektit*
Korniza financiare/burimi:	Kosto e përafërt e Projektit JICA 4,000,000 Euro

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit e mbështetur nga donatorët dhe institucione të tjera
Institucione kontribuuese	Do të mbështetet nga GIZ, donatorë dhe institucione të tjera
Projekti strategjik 11:	*Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"*
Përshkrimi: Projekti kërkon të transformojë të gjithë zinxhirin e vlerës së shërbimeve klimatike: nga ndërtimi i një Kornize Kombëtare për Shërbimet Klimatike tek ndërtimi i një sistemi paralajmërimi të hershëm të bazuar në ndikim me shumë rreziqe për veprim të hershëm dhe mobilizimin e burimeve financiare për masat e adaptimit. Për të zvogëluar ndikimet e rreziqeve hidrometeorologjike të shkaktuara nga klima, qasja në kohë në Sistemet e Informacionit Klimatik dhe Paralajmërimit të Hershëm (Climate Information & Early Warning Systems / CIEWS) dhe shpërndarja e masave dhe investimeve të synuara do të përmirësohet ndjeshëm përmes projektit. Si rezultat, komunitetet dhe vendimmarrësit e prekshëm shqiptarë do të jenë në gjendje të ndërmarrin veprime të hershme, të marrin vendime të informuara financiare të klimës dhe do të jenë më ripërtëritës ndaj ndikimeve të ndryshimit të klimës, veçanërisht ato që lidhen me rreziqet që lidhen me ujin në zonat bregdetare.	

AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me: - *Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje: "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";* - *Projektin strategjik nr.10: "JICA - Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje";* - *Projektin strategjik nr.21: "Rehabilitimi i 16 stacioneve të rrjetit hidrometeorologjik të siguruara në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP)" dhe që nuk u rehabilituan në kuadër të Programit PRO NEWS;* - *Projektin strategjik nr. 3 të përmbytjeve: "Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm";* - *Projektin strategjik nr.4 të përmbytjeve: "Vlerësimi i riskut nga thatësira";* - *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"*	
Afati kohor:	*2023-2027*
Aktivitetet kryesore:	*Komponenti 1 - Shërbimet e Informacionit për Klimën* *Komponenti 2- Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm dhe Veprimit të Hershëm me shumë rrezitje të bazuara në ndikim* *Komponenti 3 Vendime dhe investime të informuara nga klima*
Korniza financiare/burimi:	*Green Climate Fund (GCF) dhe GIZ* *Fondi i kërkuar i GCF 35,450,000 euro* *Kostoja totale e projektit (GCF + bashkëfinancim) 49,950,000 euro*

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 12:	*Forcimi i Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm*
Përshkrimi: Qëllimi i këtij projekti është forcimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm në vend nëpërmjet teknologjive të avancuara bashkëkohore sikurse janë dronët dhe blerjeve të një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katwarn, Nokia *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:*	

- *Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot"";* - *Projektin strategjik nr.4 të Zjarreve në pyje "Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit";*	
Afati kohor:	*2023-2027*
Aktivitetet kryesore:	*1. Blerja e 4 droneve të nivelit mesatar për 4 qendrat Rajonale të Mbrojtjes Civile.* *2. Trajnimi i nevojshëm për përdorimin e droneve* *3. Identifikimi i mangësive të tjera duke pasur parasysh investimet në vijim ose Zhvillimi i Listës Kontrolluese të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm* *4. Në një periudhë afat shkurtër: blerja e një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katwarn, Nokia* *5. Blerja e Licencave përkatëse për Software, Instalim, Integrim* *6. Parashikimi i kostove të mirëmbajtjes dhe llogaritja e kostove përkatëse për tarifat vjetore për kompanitë që blejnë licenca.*
Korniza financiare/burimi:	Kosto totale: 1,582.530 euro

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga donatorë
Projekti strategjik 13:	*IPA CBC STRATEGJIK Shqipëri, Mali i Zi, Itali*
Përshkrimi: Pesë akset prioritare janë: 1. Adriatik i Jugut krijues; 2. Adriatik i Jugut i ripërtëritës; 3. Adriatik i Jugut i lidhur; 4. Adriatik i Jugut i zgjuar; 5. Qeverisja e mirë e Adriatikut të Jugut. Shtylla kryesore në të cilën përfshihet Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile është shtylla nr. 2, Adriatik i Jugut i ripërtëritës;	
Afati kohor:	*2023-2025*
Aktivitetet kryesore:	*1. Rritja e qëndrueshmërisë së burimeve ujore ose qëndrueshmërisë së territoreve të prekura nga fatkeqësitë ujore ose të dyja.*

	2. *Rritja e kapaciteteve për aftësinë ripërtëritëse ndërkufitare, me investime të vogla në infrastrukturë, për mbrojtjen nga zjarri në pyje dhe studime të mundshme fizibiliteti dhe çdo studim tjetër vlerësues që nevojitet sipas legjislacionit shqiptar dhe atij të BE-së.*
Korniza financiare/burimi:	2.000,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
Institucione kontribuuese	Do të mbështetet nga Banka Botërore
Projekti strategjik 14:	*Forcimi i gatishmërisë financiare të vendit përmes miratimit të një Programi Kombëtar të Financimit të Riskut të fatkeqësive*
Përshkrimi: Programi synon të rrisë aftësinë ripërtëritëse financiare të vendeve me të ardhura të mesme kundër fatkeqësive natyrore dhe të mbështesë kapacitetin e tyre për të përmbushur nevojat e financimit pas fatkeqësisë nëpërmjet ofrimit të shërbimeve këshillimore neutrale dhe të pavarura. Ai synon të thellojë dialogun, të ndihmojë vendet të arrijnë një rimëkëmbje të gjelbër, ripërtëritëse dhe gjithëpërfshirëse. Programi mbështet Shqipërinë që nga viti 2019.	
Afati kohor:	*2022 - 2026*
Aktivitetet kryesore:	*1. Menaxhimi i detyrimeve kontingjente të qeverisë lidhur me fatkeqësitë* *1.1. Transparenca e shpenzimeve pas fatkeqësisë dhe ofrimi i likuiditetit të shpejtë* *1.2. Rritja e efikasitetit të kostos së përdorimit të financave publike* *1.3. Mobilizimi i kapitalit të sektorit privat për menaxhimin e detyrimeve të qeverisë* *1.4. Rregullimi i procesit të financimit pas fatkeqësisë* *1.5. Rritja e disponueshmërisë së fondeve për qeveritë vendore* *2. Qasje në shërbimet financiare pas fatkeqësisë nga familjet, fermerët dhe bizneset dhe të varfrit* *2.1. Sigurimi nga tërmetet për familjet* *2.2. Qasje në financa (nga fermerët, NMV-të)* *2.3. Mbrojtja sociale e përshtatur* *2.4. Zhvillimi i tregut të sigurimeve* *2.5. Futja e instrumenteve financiare që mund të forcojnë aftësinë ripërtëritëse të sektorit financiar dhe privat kundër fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike*

	3. Menaxhimi i risqeve të lidhura me fatkeqësitë e sektorit financiar dhe privat dhe mobilizimi i financave për forcimin e aftësisë ripërtëritëse (investime të gjelbra dhe të qëndrueshme) *3.1. Rritja e aftësisë ripërtëritëse së sektorit financiar dhe privat kundër fatkeqësive*
Korniza financiare/burimi:	Korniza financiare/burimi: SECO rreth 450.000 USD

Institucioni përgjegjës:	Institucionet e Prefektit të Qarkut
Institucione kontribuuese	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Projekti strategjik 15:	*Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive në nivel qarku*
Përshkrimi; Institucioni i Prefektit të qarkut ka një sërë detyrimesh në menaxhimin e riskut dhe të vetë të fatkeqësive të cilat përcaktohen në nenin 28 të ligjit 45/2019. Ndërkohë që niveli qendror dhe ai i bashkisë kanë në dispozicion burimet financiare për përmbushjen e këtyre detyrimeve, institucioni i Prefektit të Qarkut nuk ka buxhet për këtë qëllim. Është e domosdoshme hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku i cili do të kryhet krahas rishikimit të planeve të EC që do të kryhet në kuadër të projektit strategjik nr.4 "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri".. Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut në nivel qarku do të mbështetet tek dokumenti i VRF në nivel qendror, tek projekti pilot në bashkinë Lezhë por edhe në përvojën e hartimit të dokumenteve në gjashtë bashkitë e qarkut Fier që është në proces implementimi. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni":* - *Projektin strategjik nr.2 të tërmeteve: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";* - *Projektin strategjik nr. 2 të zjarreve në pyje: "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";* - *Projektin strategjik nr.1 të sëmundjeve infektive/biologjike : "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik"*	
Afati kohor:	*2023 - 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. Përgatitja e vlerësimit të riskut të fatkeqësive në nivel qarku në qarqe *2. Miratimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut në nivel qarku nga Institucioni i Prefektit të Qarkut*

Korniza financiare/burimi:	2,640,000 EURO Buxheti i BE/OKB/Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
Institucione kontribuuese	AKMC dhe ministritë e linjës
Projekti strategjik 16:	Hartimi dhe miratimi i bazës ligjore për infrastrukturën kritike
Përshkrimi: Ligji 45/2019 ka kapitullin V "Mbrojtja e infrastrukturës kritike dhe e trashëgimisë kulturore" të kushtuar mbrojtjes së infrastrukturës kritike dhe trashëgimisë kulturore. Ai ka gjithashtu një nen në këtë kapitull kushtuar infrastrukturës kritike me efekt ndërkufitar. Ligji 45/2019 nuk siguron përafrim të plotë me Direktivën e BE-së për IK prandaj dhe prej kohësh është evidente në praktikë nevoja e hartimit të bazës ligjore për infrastrukturën kritike që do të sigurojë bazën ligjore të munguar me qëllim, ndër të tjera, marrjen e masave të vazhdueshme për të siguruar rritjen e aftësisë ripërtëritëse të saj. Legjislacioni i IK do të sigurojë njëkohësisht edhe përafrim të plotë të legjislacionit shqiptar me Direktivën e Këshillit 2008/ 114/KE, datë 8.12.2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturave kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojës për të përmirësuar mbrojtjen e tyre"	
Afati kohor:	*2023 - 2024*
Aktivitetet kryesore:	*1. Hartimi dhe miratimi i ligjit "Për infrastrukturën kritike" duke siguruar, ndër të tjera, përafrim të plotë me Direktivën e Këshillit të BE-së 2008/114, datë 8 dhjetor 2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturës kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojave për përmirësimin e mbrojtjes së tyre".* *2. Hartimi i të gjitha akteve nënligjore të ligjit "Për infrastrukturën kritike" që hap rrugën për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe zbatimin në praktikë të Direktivës përkatëse të BE-së*
Korniza financiare/burimi:	

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH dhe strukturat vendore të MZSH
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore

Projekti strategjik 17:	*Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave*
Përshkrimi: Një vlerësim i kohëve të fundit[23] thekson mangësitë e rëndësishme në sistemet e gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave, duke përfshirë sistemet e informacionit, paralajmërimit të hershëm, strehimet, kapacitetet e përgjigjes dhe shpëtimit, zjarrfikësit dhe strukturat e organizimit të incidenteve. Sistemi sfidohet nga pajisjet pjesërisht të vjetruara dhe mungesa e një qendre operacionale të emergjencës (EOC) të integruar, të pajisur mirë dhe funksionale, dhe një qendre kombëtare trajnimi. Banka Botërore ka identifikuar investimet e nevojshme të gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave në tre horizonte: afatshkurtra (10.6 milionë USD), afatmesme (54.8 milionë USD) dhe afatgjata (33.0 milionë USD). *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* - *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";* - *Projektin strategjik nr.19: "Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki";* - *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";* - *Projektin strategjik nr.23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve";* - *Projektin strategjik nr.7 të "Zjarreve në pyje": "Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit";* - Në veçanti duhet siguruar sinergjia dhe komplementariteti i aktivitetit nr.3 "Zhvillimi i procedurave standarde operacionale" me projektin strategjik nr.6 "Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)"	
Afati kohor:	*2024 – 2027*
Aktivitetet kryesore:	1. *Prokurimi i pajisjeve të përgjigjes ndaj emergjencave dhe sistemeve të TIK* 2. *Punime të mundshme për qendrat e operacionale dhe qendrave të trajnimit* 3. *Zhvillimi i procedurave standarde operacionale* 4. *Trajnime* *Aktivitetet e mësipërme janë të gjitha nga projekti strategjik nr.2 i Bankës Botërore, "Forcimi i Gatishmërisë dhe Përgjigjes Emergjente"*
Korniza financiare/burimi:	$10 milion - $30 milion (me gjasa më e lartë)

[23] https://openknowledge.worldbank.org/handle/10986/35716

Institucioni përgjegjës:	Institucionet publike, strukturat qendrore dhe vendore apo subjektet private, të cilët i kanë në pronësi/administrim infrastrukturat e përzgjedhura. Instituti i Ndërtimit
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore
Projekti strategjik 18:	*Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike*
Përshkrimi: Duke pasur parasysh rolin kritik të stacioneve të përgjigjes së parë (zjarrfikës, polici, etj.), spitaleve, shkollave dhe ndërtesave të tjera publike, aftësia ripërtëritëse e tyre duhet të vlerësohet dhe nëse është e nevojshme të përforcohet, në mënyrë që jo vetëm të rritet siguria, por edhe të sigurohet vazhdimësia e shërbimeve, veçanërisht gjatë krizave. Kjo do të ofronte gjithashtu mundësinë për të përmirësuar funksionalitetet e infrastrukturës dhe për t'i bërë ato më gjithëpërfshirëse dhe efikase për energjinë. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.16: "Hartimi dhe miratimi i bazës ligjore për infrastrukturën kritike";* - *Projektin strategjik nr. 7 të "Zjarreve në pyje": "Forcimi i kapaciteteve teknike të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit (MZSH)";* - *Projektin strategjik nr.3 të risqeve teknologjike-industriale: "Krijimi i një baze të dhënash për llogaritjen, menaxhimin dhe parandalimin e risqeve teknike dhe teknologjike, sipas sektorëve"*	
Afati kohor:	*2024 – 2027*
Aktivitetet kryesore:	1. *Vlerësimi i stacioneve të përgjigjes së parë (si dhe infrastrukturës tjetër të përzgjedhur kritike publike) për aftësinë ripërtëritëse prej fatkeqësive (fizike dhe funksionale)* 2. *Projektimi i stacioneve/ndërtesave ripërtëritëse* 3. *Punime ndërtimi/rehabilitimi*
Korniza financiare/burimi:	20$ milion - 40$ milion (me gjasa më e lartë)

Institucioni përgjegjës:	Bashkitë e përzgjedhura

Institucione kontribuuese	Institucioni i Prefektit të Qarkut, Ministria e Brendshme dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore
Projekti strategjik 19:	*Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki*
Përshkrimi: Legjislacioni aktual vendos përgjegjësi të konsiderueshme për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive mbi bashkitë, shumë prej të cilave po përpiqen të mobilizojnë burimet dhe kapacitetet e nevojshme për të përmbushur nevojat lokale. Ndonëse pjesa më e madhe e investimeve të sipërpërmendura në infrastrukturën kritike të aftësisë ripërtëritëse do të realizohen në nivel bashkie, shumë bashki nuk e shfrytëzojnë buxhetin e angazhuar zyrtarisht për Menaxhimin e Riskut të Fatkeqësive, dhe sistemi me të cilin autoritetet lokale aksesojnë dhe marrin mbështetje nga institucionet kombëtare duhet të të bëhet më i menaxhueshëm, i besueshëm dhe më i fortë. *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";* - *Projektin strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave"* - *Projektin strategjik nr.23: "Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve"*	
Afati kohor:	*2023 – 2024*
Aktivitetet kryesore:	1. *Trajnime* 2. *Prokurimi i sistemeve përkatëse TIK/GIS*
Korniza financiare/burimi:	$1 milion - $3 milion

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore
Projekti strategjik 20:	*Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut*

Përshkrimi: Ndërsa vlerësimi i riskut të fatkeqësive dhe mbledhja e të dhënave të humbjeve të fatkeqësive janë kryer për shumë vite në Shqipëri, detyrimet sipas ligjit 45/2019 zyrtarizojnë kërkesat dhe përgjegjësitë e palëve të përfshira dhe synojnë të sigurojnë që informacioni përkatës të përdoret në mënyrë pro-aktive për të dhënë përparësi, planifikuar dhe zbatuar ZRF. Projekti synon të mbështesë Shqipërinë për ta arritur këtë, në përputhje me praktikat e mira globale dhe duke ndjekur rekomandimet e zhvilluara gjatë një vlerësimi të fundit të Bankës Botërore[24]. AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me: - *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";* - *Projektin strategjik nr. 5: "Politikat dhe legjislacioni";* - *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete";* - *Projektin strategjik nr.3 të tërmeteve: "Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave"*	
Afati kohor:	*2023 – 2024*
Aktivitetet kryesore:	1. *Zhvillimi i procedurave standarde operacionale* 2. *Prokurimi i sistemeve përkatëse TIK/GIS* 3. *Trajnime*
Korniza financiare/burimi:	$1 milion - $3 milion

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Instituti i Gjeoshkencave
Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes

[24] https://documents1.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/099430106142216471
https://documents1.worldbank.org/en/publication/documents-reports/documentdetail/099430006142239792

Projekti strategjik 21:	*Rehabilitimi i 16 stacioneve të rrjetit hidrometeorologjik të siguruara në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP) dhe që nuk u rehabilituan në kuadër të Programit PRO NEWS.*
Përshkrimi: 40 stacione hidrometeorologjike janë blerë dhe instaluar në vitin 2013 në kuadër të Projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP). AKMC është pronare e këtyre stacioneve të cilat i kanë kaluar për operim Institutit të Gjeoshkencave nëpërmjet një marrëveshje të përbashkët operacionale. Në kuadër të komponentit "D" të Programit "Përmirësimi i Sistemit Kombëtar të Paralajmërimit të Hershëm dhe Parandalimi i Përmbytjeve" / PRO NEWS u rehabilituan vetëm 24 nga 40 stacionet e planifikuara. 16 stacionet e mbetura janë edhe ato më problematiket dhe të cilat nevojitet që të rehabilitohen sa më shpejt. Projekti përfshin gjithçka nevojitet për funksionalitetin e plotë në rrjet të stacioneve. *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me projektin strategjik nr. 11: ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse".*	
Afati kohor:	*2023 – 2024*
Aktivitetet kryesore:	*1. Inspektimi i 16 stacioneve për të konstatuar gjendjen e tyre reale dhe nevojat për rehabilitim* *2. Sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për projektimin dhe zbatimin e investimit rehabilitues* *3. Hartimi i projektit të zbatimit bazuar mbi gjendjen e evidentuar nga inspektimet sikurse në të gjithë dokumentacionin dhe përvojën e realizimit të projektit të rehabilitimit të 24 stacioneve nëpërmjet programit PRO NEWS* *4. Implementimi i projektit, mbikëqyrja, marrja në dorëzim*
Korniza financiare/burimi:	535,928.56 euro

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Projekti do mbështetet nga AICS
Projekti strategjik 22:	*Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.*

Përshkrimi: Projekti synon plotësimin e disa mangësive të evidentuara në shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit. Ai konsiston në forcimin e kapaciteteve të sistemit të mbrojtjes civile sikurse janë përmes krijimit të ekipeve me qen për S&R. Ai do të implementohet në bashkëpunim me Agjencinë Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim. *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* - *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* - *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";* - *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";* - *Projektin strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";* - *Projektin strategjik nr.20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";*	
Afati kohor:	*2023 – 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. *Ndërgjegjësimi dhe ngritja e organizatave vullnetare;* 2. *Forcimi i teknologjisë për monitorimin operacional;* 3. *Sistemi për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore;* 4. *Mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.*
Korniza financiare/burimi:	4,000,000 euro

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Shërbimi i Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimi. Projekti do të mbështetet nga AICS
Projekti strategjik 23:	*Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve*
Përshkrimi: Projekti synon që të rrisë gatishmërinë e sistemit të mbrojtjes civile përmes trajnimeve të stafit të AKMC, pajisjeve, forcimit të kapaciteteve njerëzore të forcave zjarrfikëse si dhe mbështetje të tjera në fushën e ZRF. Projekti do të zbatohet me mbështetjen e AICS. *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:*	

- *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile";* - *Projektin strategjik nr.17: "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";* - *Projektin strategjik nr.19: "Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki"*	
Afati kohor:	*2023 – 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. *Zhvillimi i trajnimeve për stafin e AKMC-së;* 2. *Sigurimi i pajisjeve të forcave zjarrfikëse;* 3. *Forcimi i kapaciteteve njerëzore të forcave zjarrfikëse;* 4. *Ngritja e ekipit me qen për MZSH-në*
Korniza financiare/burimi:	1,000,000 euro

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga donatorët
Projekti strategjik 24:	Sigurimi i ndihmës teknike për MTM për Kap.27 -Shkrimi dhe negociatat; dhe sigurimi i ndihmës teknike për MTM për të identifikuar nevojat e planifikimit dhe për të mbështetur zbatimin e dokumenteve të planifikimit strategjik. Faza II, SANE 27.
Përshkrim: Faza e re e quajtur "Mbështetja e negociatave shqiptare në mjedis, Kapitulli 27 (SANE27)- Faza 2" zbatohet nga Brooks Hannas & Partners, e financuar nga Sida dhe në thelb ka të njëjtën njësi zbatuese që ishte përfshirë për fazën e parë. Programi i ri ka filluar në 1 Shtator 2021, ka një periudhë të fillimit dy-mujor dhe një periudhë të zbatimit njëzet e gjashtë muaj. *SANE27 konsiderohet si program horizontal që përfshin të gjitha çështjet që lidhen me Kapitullin 27 Bisedimet e BE -së dhe qëllimi i tij është: (i) të sigurojë ndihmë teknike për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit (MTE) për Kap.27 -Shkrimi dhe negociatat; dhe (ii) të sigurojë ndihmë teknike për Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit për të identifikuar nevojat e planifikimit dhe për të mbështetur zbatimin e dokumenteve të planifikimit strategjik.* *Përfituesi kryesor i programit do të jetë Ministria e Turizmit dhe Mjedisi me një fokus të veçantë në Departamentin e Integrimit, Koordinimit, Marrëveshjes dhe Ndihmës (Dicaa). Sidoqoftë, të gjitha institucionet dhe personat e lidhur të përfshirë në proceset e integrimit në lidhje me Kapitullin 27 do të përfitojnë nga programi. Programi do të vazhdojë të ketë marrëdhënie të ngushta pune me të gjithë palët e interesuara dhe gjithashtu të përpiqet të krijojë*	

qëndrueshmëri dhe transferim të njohurive. Programi do të mobilizojë një kombinim të ekspertëve ndërkombëtarë dhe kombëtarë që do të mbështesin stafin e projektit dhe përfituesit në arritjen e rezultateve. Projekti do të funksionojë bazuar në planet e punës 6-mujore që do të rishikohen dhe miratohen nga komiteti drejtues që përfshin përfaqësues nga MTE dhe SIDA. Takimi i Planifikimit do të mbahet para se të merret dakord secila plan pune	
Afati kohor:	*1/09/2021 – 21/12/2023*
Aktivitetet kryesore:	Bazuar në sa më sipër programi është i strukturuar rreth dy rezultateve: Rezultati Nr.1 - Ministria dhe institucionet e tjera të Kap.27 kanë forcuar aftësinë për shqyrtimin dhe negociatat e Kap.27. Sipas këtij rezultati, programi do të mbështesë MTM për të koordinuar procesin e negociatave të BE -së, veçanërisht për të përgatitur përgjigje për pyetjet zyrtare të shqyrtimit të BE -së, të përgatisë prezantime për takime bilaterale të KE, të përgatisë pozicione negociuese dhe të propozojë veprime për të mbyllur boshllëqet e identifikuara. Gjithashtu, ai do të mbështesë MTM në krijimin e një sistemi të mirë të menaxhimit të procesit për të ndjekur përparimin e negociatave të BE -së. Kur kërkohet do të mbështesë MTM me hartimin e vogël ligjor që rrjedhin nga PKIE dhe për të përmbushur detyrimet nga përfundimet e takimeve të nën-komitetit me KE. Ekipi SANE27 do të jetë një shërbim këshillues për MTM kur të jetë e nevojshme. Rezultati Nr.2 - Nevojat për planifikimin strategjik të Kap.27, dokumentet e planifikimit strategjik të rëndësishëm për negociatat e BE -së janë përgatitur dhe ofrohet mbështetje për zbatimin e tyre. Sipas këtij rezultati, programi do të mbështesë MTM në identifikimin e dokumenteve të planifikimit të nevojshëm për negociatat e BE-së, të propozojë veprime për të përgatitur dokumente të tilla dhe për të ndjekur zbatimin e tyre. Gjithashtu, ajo do të mbështesë MTM në programimin e fondeve IPA të BE-së dhe fondeve të tjera të donatorëve me përgatitjen e dokumenteve të veprimit, TOR, propozimet e projektit dhe dokumentet e tjera të prokurimit. Ai do të sigurojë mbështetje në rritjen e koordinimit të donatorëve për sektorin e mjedisit në Shqipëri dhe për të krijuar mekanizma të mirë për planifikimin e investimeve në sektorin e mjedisit.
Kuadri financiar/burimi:	Kosto 2,200,000 euro

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 25:	Hulumtimi, zhvillimi dhe zbatimi i një Sistemi Kombëtar të Menaxhimit të Incidenteve (SKMI)

Përshkrim: Menaxhimi i incidenteve është një proces sistematik i njohur globalisht për agjencitë e menaxhimit emergjent dhe reaguesit e parë për të menaxhuar emergjencat operacionale, krizat ose fatkeqësitë. Një SMI i standardizuar lehtëson të gjitha agjencitë që punojnë së bashku me procedura, terminologji dhe procese të përbashkëta. Një sistem Shqiptar i menaxhimit të incidenteve (SSHMI) është një koncept thelbësor i shumë-agjencive, me shumë nivele i përdorur për koordinimin dhe zgjidhjen efektive dhe efikase të incidenteve emergjente, pavarësisht nga shkalla ose kompleksiteti. Një SMI i udhëhequr nga AKMC përshtatet me të gjitha rreziqet dhe risqet që rezultojnë në ndërveprim optimal në tokën e incidentit dhe në qendrat operacionale të emergjencës (QOE). *AKMC duhet të harmonizojë çdo lloj sinergjie dhe komplementariteti midis këtij projekti me:* - *Projektin strategjik nr.1: "Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)";* - *Projektin strategjik nr.4: Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri* - *Projektin strategjik nr.6: Politikat dhe legjislacioni;* - *Projektin strategjik nr. 7 të zjarreve në pyje: Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit;* - *Projektin strategjik nr. 9: Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile;* - *Projektin strategjik nr. 17: Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave;* - *Projektin strategjik nr.22: Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje;* - *Projektin strategjik nr.23: Forcimi i kapacitete të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve*	
Afati kohor:	*2023 – 2024*
Aktivitetet kryesore:	1. Faza e hulumtimit që përfshin një analizë të boshllëqeve dhe nevojave të sistemeve, procedurave, palëve të interesit dhe burimeve; 2. Hartimi dhe zhvillimi i një kuadri kombëtar të sistemit të menaxhimit të incidenteve dhe procedurave standarde operacionale; 3. Dizajnimi dhe përshtatja e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile (QKOEC) dhe Qendrave të Emergjencave Civile në Qarqe (QOECQ); 4. Programi i Trajnimit dhe Zhvillimit Kombëtar dhe në qarqe i SMI me shumë nivele për agjencitë e palëve të interesit; 5. Zbatimi i platformës së softuerit të menaxhimit të incidenteve i lidhur me platformat e reja ose ekzistuese të TIK -ut.
Kuadri financiar/burimi:	Kosto 3,250,000 euro. Buxheti i BE/OKB/Kombëtar

2. Tërmetet

Tabela 6. Projektet e lidhura me tërmetet

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe Instituti i Gjeoshkencave
Institucione kontribuuese	Universiteti Politeknik i Tiranës
Projekti strategjik 1:	*Përmirësimi dhe ristrukturimi i Rrjetit Sizmologjik Shqiptar*
Përshkrimi: Projekti do të përfshijë përmirësime teknologjike në monitorimin e aktivitetit sizmik dhe dendësimin e rrjetit aktual sizmologjik, si rrjetin e lëkundjeve të forta ashtu edhe atë të lëkundjeve të dobëta, të cilat do të rrisin kapacitetin e Departamentit të Sizmologjisë të Institutit të Gjeoshkencave për të monitoruar aktivitetin sizmik,si dhe për të vlerësuar rrezikun sizmik në nivel kombëtar. Gjithashtu, do të kryhet edhe rinovimi i stacioneve sizmike si dhe i Qendrës Kombëtare të Monitorimit Sizmik.	
Afati kohor:	2023 - 2025
Aktivitetet kryesore:	1. Përmirësimi i teknologjisë aktuale të monitorimit të Rrjetit Sizmologjik Shqiptar; 2. Dendësimi i stacioneve të rrjetit të monitorimit të tërmeteve, dhe atyre të lëkundjeve të forta, për karakterizimin e impaktit sizmik në kushte të ndryshme trojesh; 3. Përmirësimi i teknologjisë dhe sistemimi i rrjetit aktual në Qendrën Kombëtare te Monitorimit Sizmik; 4. Ripërtëritja e stacioneve sizmologjike aktuale.
Korniza financiare/burimi:	2,200,000 euro nga buxheti i shtetit dhe/ose donatorë

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit, Instituti i Gjeoshkencave, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Institucione kontribuuese	Universiteti Politeknik, dhe Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Projekti strategjik 2:	*Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet*
Përshkrimi: Projekti do të kontribuojë në qëllimin strategjik të zvogëlimit të riskut nga tërmetet duke: ● *Siguruar një sistem monitorimi sa më modern dhe kapilar për mbledhjen dhe administrimin e të dhënave, që do të shërbejë si bazë për trajtimin shkencor të tyre dhe nxjerrjen e konkluzioneve dhe konsideratave strategjike në nivel lokal dhe kombëtar.* ● *Duke pasur parasysh se në nivel evropian është bërë përpilimi i të dhënave për hartën e riskut nga tërmetet, ngjarjet e fundit sizmike kanë ndikuar që Shqipëria të përditësojë dhe korrigjojë konkluzionet e deritanishme në lidhje me ekspozimin sizmik të Shqipërisë.* ● *Sa më të sakta të jenë të dhënat e mbledhura dhe ngjarjet e regjistruara, aq më efikase do të jenë ndërhyrjet për parandalimin ose zvogëlimin e risqeve nga tërmetet. Natyrisht, kjo kërkon harmonizimin e planeve strategjike të zhvillimit të të gjithë aktorëve, harmonizimin e kuadrit legjislativ të institucioneve përgjegjëse për përgjigjen, përmirësimin e situatës ekzistuese të masave apo mekanizmave parandalues dhe në fund të fundit zhvillim të qëndrueshëm në nivel lokal apo kombëtar.* *Përfitimet e pritshme të këtij projekti lidhen me standardizimin e praktikave të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave të riskut, standardizimin e sistemit të monitorimit të riskut nga tërmetet në të gjitha bashkitë, praktikat e certifikimit të sigurisë së ndërtesave, etj. Rezultati përfundimtar i këtij projekti është një metodologji e unifikuar për vlerësimin e riskut nga tërmetet, i harmonizuar me praktikat e BE-së ose procedurat standarde ndërkombëtare.* *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* - *Projektin strategjik nr.5 "Politikat dhe legjislacioni";* - *Projektin strategjik nr.15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të Fatkeqësive në nivel qarku";* - *Projektin strategjik nr.2 të zjarreve në pyje: "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";* - *Projektin strategjik nr.1 infektiv/biologjik: "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik";*	
Afati kohor:	2023 - 2025
Aktivitetet kryesore:	1. Një studim i gjerë mbi vlerësimet moderne të riskut i cili përfshin një pasqyrë të situatës në vend dhe një strategji zbatimi. 2. Trajnime me ekspertë të fushës për Modelin Evropian të Riskut Sizmik për vlerësimin e riskut në nivel kombëtar dhe rajonal. 3. Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për përshtatjen e kornizave të institucioneve përgjegjëse për parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen, të cilat përfshijnë rezultatet e vlerësimit të riskut me qëllim menaxhimin më të mirë të riskut nga tërmetet dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.
Korniza financiare/burimi:	400,000 euro nga buxheti i shtetit dhe fondet e BE-së, donatorë të tjerë

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit, bashkitë, prefekturat,
Institucione kontribuuese	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Ministria e Brendshme
Projekti strategjik 3:	*Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave*

Përshkrimi: Shqipëria klasifikohet si një vend me sizmicitet mesatar (i karakterizuar nga tërmete me intensitet të vogël dhe të mesëm). Lëkundjet janë subjekt i një periodiciteti të caktuar. Zhvendosja masive e popullsisë në zonat urbane me ndërtime pa respektuar kriteret e sigurisë, si dhe në zonat me risk të lartë, mbetet prezente dhe përbën një nga segmentet më në risk nga fatkeqësitë natyrore. Po kështu, ndërtimet pa leje, problemet me çështjet pronësore, gjendja ekonomike, veçanërisht në zonat rurale, vlerësohen si problematike për sa i përket kritereve të ndërtimit si dhe aftësisë për tu rimëkëmbur nga pasojat e tërmeteve.

Ky projekt përcakton bazën e nevojshme për të gjitha aktivitetet që lidhen me rrezikun e tërmeteve nga pikëpamja e ndërtimit, dhe përbëhet nga një bazë të dhënash cilësore e stokut të ndërtesave, të vlerësuara si të pambrojtura nga risqet e tërmeteve. Për shembull, për riskun e tërmetit është thelbësore të përcaktohet parametri i ekspozimit që në përgjithësi lidhet me grumbullimin e atributeve në vetitë strukturore të ndërtesave, për shpëtimin dhe evakuimin është thelbësore të dihet se në cilën ndërtesë duhet të hyni ose cilat janë rreziqet dhe si ti afrohesh (depërtim, mbështetje). Të dhënat e besueshme për dëmtimet e ndërtesave pas tërmetit janë thelbësore për të përcaktuar përforcimet tipike dhe të ngjashme.

Prioritetet kryesore të projektit janë si më poshtë:

- *përditësimin dhe korrigjimin e bazës së të dhënave për stokun e ndërtesave informale të ndërtuara pa marrë parasysh risqet natyrore (tërmete, rrëshqitje toke, përmbytje) si dhe ndërtesa të tjera (jo banesore) të vlerësuara si të riskuara nga tërmetet;*
- *rivlerësim/vlerësim periodik i sigurisë sizmike të objekteve publike me rëndësi strategjike, si diga, shkolla, konvikte, spitale, objekte të trashëgimisë historiko-kulturore etj., në mënyrë që siguria e këtyre objekteve të garantohet për periudha më të gjata (në qindra vjet);*
- *rivlerësimi i sigurisë së digave (të mëdha) mbi 20 vjeçare, siguria e të cilave mund të jetë cenuar nga tërmeti i vitit 2019; kjo mund të përfshijë gjithashtu një rivlerësim të stokut të minierave të braktisura dhe të pa rehabilituara, të cenueshme nga aktivitetet sizmike;*
- *përditësimi i hartave sizmike, miratimi i hartave të zonave sizmike, rishikimi i kodeve teknike të projektimit në përputhje me standardet e BE-së.*

Rezultati i pritshëm i projektit është krijimi i një baze të dhënash cilësore që përfshin atributet e kërkuara për të gjitha aktivitetet, ku është thelbësore që njerëzit me njohuri dhe përvojë në këtë fushë të punojnë mbi bazat (korrigjimi i të dhënave është problematik). Gjithashtu, baza e të dhënave duhet të lidhet me risqet dhe nevojat e tjera të shërbimeve të ndryshme në nivel vendor dhe shtetëror. Krijimi i bazës së të dhënave është një aktivitet shumë i gjerë që përfshin aktivitete specifike që lidhen me aspektet e ndërtimit, por edhe ndërlidhjen/harmonizimin me bazat e tjera të të dhënave (p.sh. të dhënat kadastrale të përfshira në Sistemin e Përbashkët të Informacionit të Regjistrimit dhe Kadastrës së Tokës dhe baza të ndryshme GIS, statistika...) Baza e të dhënave do të mundësojë adresimin sistematik të riskut si dhe një planifikim më të mirë të kapaciteteve institucionale dhe financiare si dhe minimizimin e kostove të ndërhyrjes.
AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:

- *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";* - *Projektin strategjik nr.20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";* - *Projektin strategjik nr.4 të tërmeteve: "Përgatitja e kodeve të reja të ndërtimit sipas Eurokodit dhe e shtojcave kombëtare (UNDP RESEAL)"*	
Afati kohor:	2023 - 2027
Aktivitetet kryesore:	1. Është krijuar një sistem për mbledhjen e të dhënave i cili përfshin analizën e bazave të të dhënave ekzistuese (kadastra, të dhënat nga procesi i legalizimit, arkivat), rregullimi i atributeve në vetitë e projektimit, modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, servera, cloud, etj.). 2. Janë përgatitur rekomandime për rinovimin e hartave sizmike, kodeve teknike të projektimit në përputhje me standardet e BE-së. 3. Kryerja e seminareve dhe trajnimeve (minimumi 3 në vit) të cilat përfshijnë dhe lidhin ekspertë të disponueshëm brenda sistemit (minimumi 100 ekspertë në të gjithë vendin). 4. Grumbullimi i atributeve të disponueshme për pasuritë e ndërtesa ndërtimore në qytetet kryesore të vendit ku rreziku i tërmeteve është i lartë.
Korniza financiare/burimi:	7.875.000 EURO buxheti i shtetit, fondet e BE-së, donatorë të tjerë

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit dhe Instituti i Gjeoshkencave
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga UNDP RESEAL
Projekti strategjik 4:	*Përgatitja e kodeve të reja të ndërtimit sipas Eurokodit dhe e anekseve kombëtare (UNDP RESEAL)*
Përshkrimi: Ky rezultat lidhet me asistencën teknike që do t'i jepet Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për përditësimin e kodeve të ndërtimit (20-vjeçare) sipas Eurokodit si dhe anekseve kombëtare përkatëse. Raporti i PDNA 2020 thekson nevojën urgjente për përditësimin e kodeve shqiptare të ndërtimit, duke përfshirë formalizimin e integrimit të Eurokodit, dhe që rindërtimi të bazohet në parimin "rindërto më mirë" (BBB), me standarde të përditësuara dhe sipas kodeve të reja të ndërtimit *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr. 3 të tërmeteve: "Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave";*	
Afati kohor:	2023 - 2024

Aktivitetet kryesore:	1. Përgatitja e anekseve kombëtare, me fokus në Paketën 2.1 (ndërtesë prej betoni të armuar). 2. Përditësimi i Udhëzimeve Kombëtare për zbatimin e Eurokodit në Shqipëri. 3. Përgatitja e 4 grupeve të udhëzuesve projektues. 4. Mbështetja e trajnimeve rajonale të inxhinierëve në bashkëpunim me MIE-në, AKMC dhe Prefekturat.
Korniza financiare/burimi:	850,000 USD. UNDP RESEAL

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga donatorë
Projekti strategjik 5:	*Ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektet e trashëgimisë kulturore "Kalaja Krujës"*
Përshkrimi: Projekti përfshin restaurimin e Kalasë së Krujës si dhe përforcimin e shpatit shkëmbor në të cilin ndodhet Kalaja. Projekti u hartua pas tërmetit të 26 nëntorit 2019, bazuar në Marrëveshjen e Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Kulturës dhe Shoqërisë Urbatrans (2020) për të kryer rilevimin gjeologjik dhe për të shkruar projektin e plotë. Projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).	
Afati kohor:	2023 - 2025
Aktivitetet kryesore:	1. Restaurimi i Kalasë së Krujës 2. Stabilizimi i shpatit të pjesës verilindore të Kalasë së Krujës
Korniza financiare/burimi:	6,600,000 EURO - Buxheti i BE/Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga UNOPS
Projekti strategjik 6:	*Masat për rehabilitimin e objekteve të trashëgimisë kulturore*

Përshkrimi: Projekti parashikon ruajtjen, restaurimin dhe rehabilitimin sipas parimit "Rindërto më Mirë" të: - *Muzeut Etnografik të Kavajës, monument kulture i kategorisë së parë,* - *Teatrit të Kukullave, Tiranë, monument kulture i kategorisë së parë,* - *Godina e Institucionit të të Përndjekurve Politikë, Tiranë, monument kulture i kategorisë së dytë,* - *Ish-Ndërtesa e Kryepeshkopit Durrës, Delbnisht, Lezhë, monument kulture i kategorisë së dytë,* *pasi u dëmtua nga tërmeti i 26 nëntorit 2019.* *Faza e projektimit e financuar nga BE-ja ka përfunduar dhe aktualisht projektet janë në fazën e realizimit, të implementuar nga UNOPS në partneritet me Ministrinë e Kulturës në kuadër të programit EU4Culture. Projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM).*	
Afati kohor:	2022 - 2024
Aktivitetet kryesore:	1. Projektim arkitektonik dhe strukturor. 2. Restaurimi, përforcimi strukturor dhe përmirësimi i instalimeve. 3. Hartimi i planit të menaxhimit dhe biznesit.
Korniza financiare/burimi:	4,038,300 EURO - Buxheti i BE/Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 7:	*Ngritja e kapaciteteve për zbutjen e riskut sizmik në vendet e trashëgimisë kulturore nëpërmjet:* - Trajnimit të mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimit të njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim; - Përpilimit të manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit; - Përmirësimit të normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit.
Përshkrimi: ***Trajnimi i mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim:*** *Parashikon vazhdimin e programit Aftësia për punësimin e së nesërmes (APN), me qëllim kryesor ruajtjen e mjeshtërive dhe teknikave tradicionale, kualifikimin e personave që ushtrojnë aktivitetin e tyre në fushën e ruajtjes së trashëgimisë kulturore, rritjen e cilësisë së punimeve (sipas standardeve bashkëkohore të restaurimit dhe konservimit) si dhe rritjen e mundësive të punësimit për mjeshtrit me përvojë, si dhe për praktikantët e rinj që do të kualifikohen në këtë fushë. Projekti synon të ruajë dhe të transmetojë njohuri mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim, të cilat do të ndihmojnë gjithashtu në zbutjen e efekteve që risku i*	

tërmetit mund të ketë në asetet kulturore. Projekti përfshin zhvillimin e moduleve (6-mujore brenda çdo viti) ku pritet të marrin pjesë rreth 40 pjesëmarrës/vit. Ky program u zbatua fillimisht në periudhën 2016-2019, nga fondacioni Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB) Shqipëri në bashkëpunim me Ministrinë e Kulturës, Institutin e Monumenteve të Kulturës, MFE, Drejtoritë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Berat, Gjirokastër dhe Korçë si dhe Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik në Gjirokastër, Korçë dhe Berat. Kurrikulumi për këtë program i hartuar në bashkëpunim me IKTK-në dhe me mbështetje teknike nga ekspertë vendas dhe të huaj është miratuar si pjesë e trajnimit profesional në Drejtoritë Rajonale të Formimit Profesional Publik. ***Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit**: Udhëzuesi (rast studimor Qendrat Historike Berat dhe Gjirokastër, trashëgimi botërore) synon ruajtjen dhe mbrojtjen e trashëgimisë kulturore materiale nëpërmjet studimit, njohjes dhe promovimit dhe ndërgjegjësimit të specialistëve dhe komunitetit për përdorimin e teknikave tradicionale të ndërtimit. Gjithashtu ai do të shërbejë për orientimin e të gjithë të interesuarve për ruajtjen, zhvillimin e qëndrueshëm dhe rehabilitimin e këtyre qendrave historike me qëllim zbutjen e risqeve të fatkeqësive. Ai do t'u drejtohet jo vetëm banorëve, por edhe pronarëve apo përdoruesve të ndërtesave, si dhe administratorëve, institucioneve, kompanive të ndërtimit, specialistëve dhe mjeshtërve të ndërtimit. Ky udhëzues do të përshkruajë aspektet historike, problemet ekzistuese dhe do të japë rekomandime praktike se si të kryhen punimet e mirëmbajtjes dhe restaurimit, si dhe riparimet dhe rindërtimet në këto qendra historike.* ***Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit:** Synon të përmirësojë standardet e projektimit në restaurimin e pasurive kulturore. Përmirësimi i normave teknike do të synojë përfshirjen e normave teknike të sigurisë ndaj riskut sizmik dhe zjarrit si dhe efiçencës së energjisë.*	
Afati kohor:	2024 - 2026
Aktivitetet kryesore:	1. Trajnimi i mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim. 1.1. Zhvillimi i Sesioneve Teorike për forcimin e njohurive mbi trashëgiminë kulturore (pjesë e modulit 6-mujor). 1.2. Sesione praktike ku njohuritë praktike do të forcohen në aplikim sipas specifikimeve të materialeve "gur", "punime druri", "llaç" (pjesë e modulit 6-mujor). 2. Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit 2.1. Ndarja e ekspertizës ndërkombëtare (2 ekspertë) dhe kombëtare (3 ekspertë). 2.2. Punëtori në terren që përfshin profesionistë dhe studentë të arkitekturës. 2.3. Publikime. 3. Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit. 3.1. Ekspertizë ndërkombëtare (2 ekspertë) dhe kombëtare (2 ekspertë) 3.2. Punë me grupet teknike të institucioneve të specializuara.
Korniza financiare/burimi:	- Trajnimit të mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim: 450.000 EUR - Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit: 100.000 EUR - Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit: 200.000 EUR Kosto totale: 750,000 EURO - BE/ Buxheti Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes
Institucione kontribuuese	Drejtoria e Përgjithshme e MZSH
Projekti strategjik 8:	*Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)*
Përshkrimi: Krijimi i një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR) kombëtar dhe ndërkombëtar sipas standardeve ndërkombëtare për t'iu bashkuar kapaciteteve të EERC. Zbatimi i këtij moduli kërkon procedurat kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO. *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* - *Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot";* - *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* - *Projektin strategjik nr. 5 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së";* - *Projektin strategjik nr.8 të përmbytjeve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet";*	
Afati kohor:	2023-2025
Aktivitetet kryesore:	1. Studimi për krijimin e një moduli të ri HUSAR. 2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO. 3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO si komunikimi me Grupin Këshillimor Ndërkombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit (INSARAG). 4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve trajnuese si dhe stërvitjes përfundimtare në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian. 5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit si dhe regjistrimit të tij në EERC 6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për ngritjen e modulit si dhe pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij.
Korniza financiare/burimi:	Kostot përfshijnë: trajnim; Vaksinim: Amortizimi i pajisjeve; Mirëmbajtja dhe ruajtja e pajisjeve, materialeve të konsumueshme dhe automjeteve; Licencat: ushtrime; kostot e vendosjes etj. Përafërsisht shpenzimet e dislokimit duke marrë maksimumin i cili mund të jetë nga toka ose ajri mund të jenë: 540,620 euro;

	Kostot e mirëmbajtjes: 140,689 euro Zhvillimi ose krijimi i modulit: 602,787 euro 1,284,096 EURO BE/OKB/buxheti i shtetit

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Ndërtimit, Universiteti Politeknik i Tiranës, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Fakulteti i Inxhinierisë së Ndërtimit, Instituti i Ndërtimit dhe donatorë
Projekti strategjik 9:	Hartimi i rregulloreve e dokumenteve teknike për vlerësimin dhe riaftësimin strukturor të veprave ndërtimore
Përshkrimi: Tërmeti i datës 26.11.2019 nxori në pah një sërë të metash dhe nevojash për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të ndërtesave ekzistuese dhe në veçanti të infrastrukturës publike dhe asaj kritike. Krahas tyre tërmeti nxori në pah edhe një nevojë urgjente për masa jostrukturore që konsistojnë në përmirësimin e bazës ligjore por edhe në zhvillimin e trajnimeve për rritjen e kapaciteteve të inxhinierëve	
Afati kohor:	2023-2025
Aktivitetet kryesore:	1. Përditësimi i kornizës ligjore për vlerësimin dhe riaftësimin e veprave ekzistuese. 2. Hartimi i udhëzueseve të përdorimit për vlerësimin dhe riaftësimin e veprave ekzistuese. 3. Përgatitja dhe përhapja e materialeve trajnuese në grupet e interesit
Korniza financiare/burimi:	2,500,000 EURO BE/OKB/buxheti i shtetit

3. Përmbytjet , vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Tabela 7. Projektet e lidhura me përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural

Institucione kontribuuese	Bashkitë
Projekti strategjik 1:	*Rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytjet e lumenjve, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja*
Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar frekuencës në rritje të përmbytjeve në vendin tonë dhe efekteve në pritshmërinë e ndryshimeve klimatike, synohet të vlerësohet situata e sigurisë së punimeve ekzistuese të mbrojtjes nga përmbytjet dhe të vendoset një standard më i lartë sigurie për punimet ekzistuese dhe ato të reja që duhet të ndërtohen, sipas dispozitave të Direktivës së Bashkimit Evropian për vlerësimin dhe menaxhimin e risqeve nga përmbytjet (Direktiva e BE-së 2007/60 / EC ; Direktiva e Përmbytjeve - FD). Ndërsa minimizimi i përmbytjeve me standard më të lartë sigurie do të realizohet nëpërmjet rehabilitimit/rikonstruksionit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja të mbrojtjes nga përmbytjet dhe erozioni të brigjeve të lumenjve. *AKMC dhe MBZHR të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.9 të përmbytjeve: "Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet";*	
Afati kohor:	*2019-2031*
Aktivitetet kryesore:	*1. Kryerja e studimeve të fizibilitetit për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet* *1.1. Aktualisht është kryer studimi i fizibilitetit të lumenjve Mat dhe lumenjve Drin e Bunë.* *1.2. Është në proces studimi i fizibilitetit për lumenjtë Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, i cili pritet të përfundojë në vitin 2023.* *2. Kryerja e projekteve të zbatimit* *2.1. Aktualisht është duke u zhvilluar projekti i plotë i zbatimit për lumin Mat* *3. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në punimet e mbrojtjes nga përmbytjet* *4. Rehabilitimi/Rikonstruksioni dhe ndërtimi i argjinaturave kundër përmbytjeve dhe strukturave mbrojtëse nga erozioni* *5. Rritja e kapaciteteve operacionale, mirëmbajtjes dhe monitoruese të sigurisë së argjinaturave në strukturat përkatëse të MBZHR dhe Bashkive*
Korniza financiare/burimi:	276.8 milionë USD me burim buxhetin e shtetit me investime të brendshme dhe të huaja

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Institucione kontribuuese	Bashkitë përkatëse dhe Institucionet e Prefektit të qarkut

Projekti strategjik 2:	*Rritja e sigurisë së digave të rezervuarëve të ujitjes, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të digave ekzistuese*
Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar kontekstit aktual, ku rezulton se 626 diga janë në gjendje të vështirë teknike, pasi rreth 65% e tyre kanë probleme të ndryshme teknike (kryesisht në trupin e digës, shkarkuesin katastrofik, ujëlëshuesin etj.) dhe ndërhyrjet rehabilituese në vazhdimësi në një pjesë të konsiderueshme janë një domosdoshmëri imediate, synohet rritja e sigurisë së digave sipas standardeve shqiptare dhe ndërkombëtare për mbrojtjen e zonave të banuara në pjesën e poshtme të digave dhe garantimin e burimeve ujore për ujitje, pasi në vetvete edhe thatësira është një risk për bujqësinë dhe sigurinë e prodhimit bujqësor. Projekti përfshin analizimin e gjendjes së çdo dige, përcaktimin e përdorimit të saj për periudhën në vijim, prioritizimin e ndërhyrjeve sipas shkallës së riskut dhe kryerjen e ndërhyrjeve strukturore përkatëse në trupin e digave. Projekti ka gjithashtu një komponent të rëndësishëm të ndërtimit të kapaciteteve teknike të bashkive për të monitoruar sigurinë e digave.	
Afati kohor:	*2019-2031*
Aktivitetet kryesore:	*1. Kryerja e studimit të fizibilitetit të 626 digave* *1.1. Aktualisht përmes projektit të Bankës Botërore është kryer studimi i parafizibilitetit për 195 diga dhe ndërkohë në kuadër të fondeve të granteve të WBIF dhe BE-së, pritet të kryhet parafizibiliteti për 431 diga të tjera deri në fund të vitit 2024.* *2. Kryerja e një studimi fizibiliteti* *2.1. Me përfundimin e para fizibilitetit bazuar në analizën shumë-kritere do të prioritizohen digat që do të kalojnë në studimin e fizibilitetit.* *3. Kryerja e projekteve të zbatimit për grupin prioritar të digave* *4. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në diga* *5. Rehabilitimi/Rikonstruksioni i digave ekzistuese sipas prioritetit të përcaktuar* *6. Ngritja/Konsolidimi dhe trajnimi i Grupeve të Sigurisë së Digave për çdo bashki.* *7. Koordinimi i aktiviteteve për sigurinë e digave ndërmjet MBZHR-Bashkive-Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha*
Korniza financiare/burimi:	171 milionë USD me burim buxhetin e shtetit me investime të brendshme dhe të huaja

Institucioni përgjegjës:	Instituti i Gjeoshkencave
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 3:	*Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm*

Përshkrimi: Nëpërmjet këtyre projekteve synohet vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm i tyre sipas Direktivës 2007/60/KE të Parlamentit Evropian dhe të Këshillit, datë 23.10.2007, "Për vlerësimin dhe menaxhimin e riskut të përmbytjeve" dhe Ligjit 45/2019. Nëpërmjet këtij projekti synohet të realizohen modele të cilat parashikojnë dhe bëjnë të mundur paralajmërimin e hershëm të përmbytjeve në lumin Vjosa. AKMC dhe IGJEO të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.11: "Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"	
Afati kohor:	*2022-2031*
Aktivitetet kryesore:	*1.Analiza Hidrologjike dhe Hidraulike* *1.1. monitorimi i prurjeve, reshjeve, temperaturave, avullimit në territorin e Shqipërisë.* *1.2. analiza e hidrologjike e prurjeve në lumenj* *1.3. analiza hidraulike e përhapjes së plotave në lumenj.* *2. Parashikimi i motit me një hapësire kohore 10 ditore* *2.1. Anëtarësimi në Qendrën Evropiane për Parashikimin e Motit me interval mesatar ECMWF (European Centre for Medium-Range Weather Forecasts)* *3. Parashikimi i Përmbytjeve në lumin Vjosa* *3.1. Ndërtimi i një modeli hidrologjik për parashikimin e përmbytjeve.*
Korniza financiare/burimi:	1.2 milion euro

Institucioni përgjegjës:	Instituti i Gjeoshkencave dhe Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 4:	*Vlerësimi i riskut nga thatësira*
Përshkrimi: Një fenomen që po vjen gjithnjë dhe në rritje janë dhe thatësirat, të cilat lidhen drejtpërdrejt dhe me menaxhimin e integruar të burimeve ujore, sipas ligjit 111/2012. *Nëpërmjet këtij projekti synohet të ndërtohet një model i bilancit ujor i cili do të kryejë një analizë për optimizimin e shfrytëzimit të burimeve ujore.* AKMC dhe IGJEO të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.11: "Alb-Adapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"	

Afati kohor:	*2022-2031*
Aktivitetet kryesore:	*1. Ndërtimi i një modeli për analizën e bilancit ujor në lumin Seman* *1.1. Nëpërmjet këtij projekt synohet ndërtimi i një modeli që do të bëjë një analizë të detajuar të kapacitetit dhe shfrytëzimit të ujit në basen. Gjithashtu do të jetë e mundur të menaxhohet sasia e ujit për të shmangur ose minimizuar thatësirat.* *2. Analiza e transportit të sedimentit në lumin Seman* *2.1. Nëpërmjet këtij projekti synohet vlerësimi i sedimenteve që transporton lumi Seman. Ndërtimi i një modeli i cili i analizon ato në varësi të reshjeve, llojit të terrenit, përdorimit të tokës, etj.*
Korniza financiare/burimi:	500,000 euro

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 5:	*Zbutja, zvogëlimi i pasojave të mundshme negative të përmbytjeve*
Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar historisë dhe frekuencës në rritje të përmbytjeve në vendin tonë dhe efekteve në pritshmërinë e ndryshimeve klimatike, synohet zbutja, zvogëlimi i pasojave të mundshme negative të përmbytjeve. *AKMC, MBZHR dhe AMBU duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* *- Projektin strategjik nr.2 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)"*	
Afati kohor:	*2021-2024*
Aktivitetet kryesore:	*Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet për basenet ujore: Vjosë, Seman, Shkumbin, Ishëm dhe Erzen;* *Aktualisht:* *- Ka përfunduar drafti përfundimtar i Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet për qarkun e Shkodrës (Baseni i Drinit). Parashikuar të miratohet në fund të vitit 2022;* *- Janë hartuar raportet e vlerësimit paraprak dhe hartat e rrezikut nga përmbytjet për basenet e Ishmit, Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës.* *- Janë në proces Hartat e dëmeve dhe dokumenti i Planeve të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve për këto basene ujore. Parashikuar të përfundojë në vitin 2023.*

Korniza financiare/burimi:	2,000,000 EUR Buxheti i shtetit me investime të brendshme dhe të huaja

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore
Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga UNDP
Projekti strategjik 6:	*Menaxhimi i integruar ndërkufitar i riskut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin*
Përshkrimi: Nëpërmjet këtij projekti strategjik, referuar historisë dhe frekuencës në rritje të përmbytjeve në vendin tonë dhe efekteve në pritshmërinë e ndryshimeve klimatike, synohet të menaxhohen njohuritë mbi risqet e rreziqeve; ndërtimi i një kuadri institucional ndërkufitar dhe politikave të menaxhimit të riskut nga përmbytjet; hartimin e masave për t'iu përshtatur ndryshimeve klimatike në dobi të komunitetit.	
Afati kohor:	*2019 - 2024*
Aktivitetet kryesore:	*1. Rishikimi i procedurave të mbledhjes së të dhënave dhe cilësisë së tyre;* *2. Vlerësimi i kërkesave të rrjetit monitorues për menaxhimin strategjik të rrezikut nga përmbytjet;* *3. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e rrjetit hidrometrik;* *4. Plani operacional për procedurat e raportimit;* *5. Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse për zhvillimin e një plani afatgjatë të zhvillimit të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim.* 6. *Përpilimi i një listë opsionesh për të identifikuar më ekonomikisht të favorshme për basenin.*
Korniza financiare/burimi:	642,430 USD (UNDP)

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Kulturës, Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore

Institucione kontribuuese	Projekti do të mbështetet nga Qeveria Turke
Projekti strategjik 7:	*Rritja e sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore ndaj riskut të përmbytjeve - "Restaurimi dhe ndërtimi i sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet të Xhamisë së Plumbit (Mehmet Pashë Bushatlliu) në Shkodër"*
Përshkrimi: Projekti parashikon realizimin e punimeve për restaurimin e Xhamisë së Plumbit në Shkodër si dhe ndërtimin e një sistemi mbrojtjeje nga përmbytjet. Ndërhyrjet parashikojnë ndërtimin e një muri të vazhdueshëm me pilota. Hartimi i projektit si dhe realizimi i punimeve do të financohen nga Republika e Turqisë, Drejtoria e Përgjithshme e Vakëfeve, bazuar në Protokollin e Bashkëpunimit të nënshkruar ndërmjet Ministrisë së Kulturës së Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Kulturës së Republikës së Turqisë në vitin 2020. Ka përfunduar procesit i hartimit të projektit të financuar nga TIKA dhe projekti është miratuar nga Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale (KKTKM) dhe Këshilli Kombëtar i Territorit (KKT).	
Afati kohor:	*2023 - 2024*
Aktivitetet kryesore:	*1. Restaurimi i Xhamisë së Plumbit* *2. Ndërtimi i sistemit të pilotave për mbrojtjen nga përmbytjet*
Korniza financiare/burimi:	4,000,000 EUR - Qeveria e Turqisë / Buxheti Kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Policia e Shtetit
Projekti strategjik 8:	*Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet*
Përshkrimi: Forcimi i kapaciteteve do të realizohet duke plotësuar dy nga tre modulet ekzistuese të BE-së për përmbytjet. Studimi i këtij projekti do të jetë mbi 1/3 e moduleve kombëtare dhe ndërkombëtare të FRB dhe FC të krijuara nëpërmjet programit IPA Floods, si dhe kompletimi i tyre në module të plota që do t'i bashkohen EERC. AKMC duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë me: - Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot";	

- Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri"; - Projektin strategjik nr.8 të tërmeteve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)"; - Projektin strategjik nr.5 të zjarreve Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së.	
Afati kohor:	*2023 – 2026*
Aktivitetet kryesore:	*1. Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale të 1/3 moduleve kombëtare dhe ndërkombëtare të krijuara përmes programit IPA Floods si më poshtë:* *1.1. "Shpëtimi nga përmbytjet me varka"/ (Flood Rescue with Boats/FRB)* *1.2. Mbrojtja nga Përmbytjet / (Flood Containment/ FC)* *2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të kërkuara për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO* *3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO* *4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve të trajnimit dhe të stërvitjes përfundimtare në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian* *5. Kryerja e procesit të certifikimit të moduleve të plota FRB dhe FC si dhe regjistrimi i tyre në EERC* *6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për ngritjen e moduleve si pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij*
Korniza financiare/burimi:	FRB - Zhvillimi: 983,200 EURO - Mirëmbajtja: 554,550 EURO - Dislokimi: 203,000 EURO TOTALI FRB = 1,740,750 EURO FC: - Zhvillimi: 116,356 EURO - Mirëmbajtja: 554,550 EURO - Dislokimi: 203,000 EURO Totali FC = 873,906 EURO Kosto totale FRB dhe FC = 2,614,656 euro

Institucioni përgjegjës:	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore, Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural
Institucione kontribuuese	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile. Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore
Projekti strategjik 9:	*Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet*
Përshkrimi: Disa partnerë zhvillimi po mbështesin Shqipërinë për të zhvilluar plane për menaxhimin e riskut nga përmbytjet për shtatë basenet ujorë kryesorë të saj. Në përputhje me Direktivën e BE-së për përmbytjet, planet rezultante (të pritshme deri në vitin 2024) duhet të përfshijnë plane investimi që fokusohen në parandalimin, mbrojtjen dhe gatishmërinë nga përmbytjet. Me synimin për t'u dhënë lumenjve më shumë hapësirë, ata duhet të marrin në konsideratë ku është e mundur mirëmbajtjen dhe/ose restaurimin e zonave të përmbytura, si dhe masat për të parandaluar dhe zvogëluar dëmin ndaj shëndetit të njerëzve, mjedisit, trashëgimisë kulturore dhe aktivitetit ekonomik. Pritet që nevojat e identifikuara për investime të jenë rreth qindra miliona USD.	
Afati kohor:	*2024 – 2027*
Aktivitetet kryesore:	1. *Studimet e fizibilitetit dhe projektimi i mbrojtjes strukturore dhe jostrukturore nga përmbytjet, me prioritet zgjidhjet e bazuara në natyrë* 2. *Punime ndërtimi/rehabilitimi* 3. *Planifikimi i mirëmbajtjes dhe prokurimi i pajisjeve të nevojshme* 4. *Trajnime*
Korniza financiare/burimi:	20$ milion - 40$ milion (me gjasa më e lartë)

4. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët

Tabela 8. Projektet e lidhura me rrëshqitjet e tokës, rënien e dëborës dhe ortekët

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Kulturës - Instituti Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore,
Institucione kontribuuese	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, Fondi Shqiptar i Zhvillimit. Projekti do të mbështetet nga Banka Botërore,

Projekti strategjik 1:	*Masa përforcuese në objektet e trashëgimisë kulturore - Menaxhimi i sitit, Plan Interpretimi, projektimi dhe mbikëqyrja e punimeve në Kalanë e Kaninës, Kalanë e Borshit dhe Shpellën e Spilesë, Himarë. Ndërhyrje strukturore për përforcimin e shpateve shkëmbore të Kalasë së Borshit dhe Kalasë së Kaninës.*
Përshkrimi: Projekti "Menaxhimi i sitit, Plani i Interpretimit, Projektimi dhe Mbikëqyrja e Punimeve në Kalanë e Kaninës, Kalanë e Borshit dhe Shpellën e Spilesë, Himarë. Ndërhyrja strukturore për përforcimin e shpateve shkëmbore të Kalasë së Borshit dhe Kalasë së Kaninës" është pjesë e Projektit për Zhvillimin e Integruar Urban dhe Turistik (PZhIUT) financuar nga Banka Botërore dhe zbatuar nga FSHZH. Aktualisht, termat e referencës për projektin janë hartuar nga FSHZH.	
Afati kohor:	*2023 - 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. *Projektim/mbikëqyrje punimesh* 2. *Punimet restauruese dhe interpretimi i Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit, Shpellës së Spilesë* 3. *Përforcimi i shpatit shkëmbor të kalasë së Kaninës* 4. *Përforcimi i shpatit shkëmbor të kalasë së Borshit*
Korniza financiare/burimi:	2,800,000 dollarë - Banka Botërore/ Buxheti kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 2:	*Identifikimi i rrëshqitjeve të tokës në të gjithë territorin e vendit, bazuar në kritere të standardizuara dhe pasqyrimi i tyre në një hartë të vetme, si dhe krijimi i një inventari kombëtar për rrëshqitjet, i cili përmban të gjitha të dhënat e tyre. Monitorimi i rrëshqitjeve më të fuqishme dhe më të rrezikshme për komunitetin*
Përshkrimi: Territori i Republikës së Shqipërisë, duke qenë një tokë relativisht e re, ka një konfigurim të larmishëm dhe si i tillë është i ekspozuar ndaj dukurive gjeodinamike. Këto dukuri mund të rrezikojnë qendra të banuara, objekte të veçanta inxhinierike apo edhe vepra të ndryshme inxhinierike të kudo-gjendura. *Këto dukuri apo fenomene mund të jenë natyrore të shkaktuara nga faktorë të ndryshëm gjeologjikë, por mund të shkaktohen edhe nga veprimtaria praktike e njeriut. Në të dyja rastet, ato përbëjnë një rrezik gjeologjik për ekzistencën dhe shfrytëzimin normal dhe efektiv të mjedisit natyror gjeologjik dhe, për rrjedhojë, për përdorimin kompleks të plotë dhe racional të të gjitha objekteve inxhinierike të ndërtuara në fusha të ndryshme të ekonomisë së vendit. Ndër*	

dukuritë natyrore me rrezikshmëri të madhe janë rrëshqitjet e tokës (të cilat janë shumë të përhapura në Shqipëri), me pasoja të rënda për jetën e njerëzve. Shërbimi Gjeologjik Shqiptar, në lidhje me dukuritë negative gjeodinamike, zotëron një bazë të fuqishme të dhënash duke kryer një numër të madh studimesh me produktet përfundimtare:

- *Harta gjeologo-inxhinierike e Shqipërisë në shkallën 1: 200,000*
- *Harta e rrezikut gjeologjik të Shqipërisë në shkallën 1: 200,000*
- *Harta e ndjeshmërisë ndaj rrëshqitjes së tokës në Shqipëri në shkallën 1: 200,000*
- *Harta e përshtatshmërisë ndërtuese të trojeve në shkallën 1: 100,000*
- *Hartat e rrezikut gjeologjik në shkallën 1: 100,000*
- *Hartat gjeologo-inxhinierike në shkallën 1: 100,000*
- *Harta e përshtatshmërisë ndërtuese të trojeve në shkallën 1: 50 000*
- *Hartat e rrezikut gjeologjik në shkallën 1: 50,000*
- *Hartat gjeologjiko-inxhinierike në shkallën 1: 50,000*
- *Hartat e rrezikut gjeologjik në shkallën 1: 25,000*
- *Hartat gjeologo-inxhinierike në shkallën 1: 25,000*

Pavarësisht sa thamë më sipër, ka ende punë për të bërë në këtë drejtim, si në perfeksionimin e produkteve të nxjerra deri tani, ashtu edhe në avancimin e mëtejshëm, për përcaktimin dhe evidentimin e dukurive gjeodinamike, regjistrimin e tyre dhe monitorimin e atyre me rrezikshmëri të madhe për komunitetin. Kjo do të parandalonte pasoja të rënda, veçanërisht në jetën e njeriut.

Pra, me fjalë të tjera, projekti do të kontribuonte në synimin strategjik për zvogëlimin e riskut nga rrëshqitjet e tokës nëpërmjet identifikimit të tyre, mbledhjes së të dhënave dhe në fund marrjen e masave për parandalimin dhe zbutjen e riskut të fatkeqësive natyrore nga ky fenomen.

Rezultati i projektit do të ishte zhvillimi dhe harmonizimi i marrjes së të dhënave dhe njëkohësisht metodologjia e vlerësimit të riskut të rrëshqitjes së tokës në të gjitha nivelet bazë për aktivitetet e ardhshme ciklike të vlerësimit të riskut. Vlerësimet e riskut të rrëshqitjes së tokës janë baza për harmonizimin e planeve strategjike të zhvillimit urban të të gjitha njësive territoriale përgjegjëse për përgjigjen dhe përmirësimin e situatës ekzistuese si dhe zhvillimin e qëndrueshëm të zonës.

AKMC në koordinim me MIE dhe SHGJSH duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:

- *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni";*
- *Projektin strategjik nr.7: "Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)";*
- *Projektin strategjik nr.20: "Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut";*
- *Projektin strategjik nr.22: "Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të zjarrfikësve, sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe mjete"*

Afati kohor:	*2022 – Në vazhdim*
Aktivitetet kryesore:	*1. Është përgatitur baza e nevojshme për identifikimin dhe vlerësimin modern të riskut nga dukuritë negative gjeodinamike, e cila përfshin një pasqyrë të situatës në vend dhe shërben për strategjinë e ardhshme të perfeksionimit si të performancës aktuale, ashtu edhe të vazhdimësisë.* *2. Përgatitja e propozimeve për ndryshime në legjislacion dhe përgatitja e rregulloreve, të cilat përfshijnë zbatimin e këtyre studimeve në planifikimin urban në të gjithë territorin e Republikës.*
Korniza financiare/burimi:	100,000 EURO BE / OKB / Buxheti kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Shërbimi Gjeologjik Shqiptar
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 3:	*Rajonizimi gjeologo-inxhinierik në shkallën 1: 10 000, për planifikimin urban në zonat më të populluara të vendit, si dhe në zonat me premisë për zhvillime turistike.*
Përshkrimi: Në dekadat e fundit, kemi qenë dëshmitarë të rritjes së dëmeve në përgjithësi të veprave të ndryshme inxhinierike (përfshi ndërtesa private dhe publike, monumente kulture, ura, diga, rrjete rrugore, hekurudha, rrjete elektrike etj.), si rezultat i proceseve dhe dukurive fiziko- gjeologjike negative. Kjo ka bërë që të rritet niveli i riskut gjeologjik, si për shkak të rritjes së elementëve të rrezikuar (objekte inxhinierike apo punime infrastrukturore), ashtu edhe për shkak të tolerancës së shoqërisë ndaj dëmtimeve (objekte inxhinierike dhe kryesisht jetë njerëzish). Në këto kushte, ndër të tjera, lind nevoja për kryerjen e studimeve gjeologo-inxhinierike në shkallë të ndryshme, për planifikimin urban në zonat më të populluara të vendit, si dhe në zona me pritshmëri për zhvillime turistike". Kjo do t'i lejonte ata të identifikonin zonat problematike në të gjithë territorin, veçanërisht në zonat më të populluara të vendit si dhe në zonat e prirura për zhvillimin e turizmit dhe mbi bazën e këtyre studimeve, strukturat e qeverisjes vendore që administrojnë territorin, planifikojnë zonat e zhvillimit urban në qendrat më të populluara si dhe në ato me premisa për zhvillime turistike. *Pra, rezultati i këtij projekti do të ishte përcaktimi i zonave me risk gjeologjik dhe orientimi i zhvillimeve urbane në zona të qëndrueshme, si në kapacitetin mbajtës të tokës ashtu edhe në riskun gjeologjik.*	
Afati kohor:	*2022 – Në vazhdim*
Aktivitetet kryesore:	*1. Është gati baza e nevojshme e studimeve të kryera më parë nga ShGjSh, të cilat do të shërbenin si bazë për realizimin e këtyre rajonizimeve gjeologo-inxhinierike. Mbetet organizimi dhe grumbullimi i të dhënave në terren nëpërmjet rilevimeve në shkallët përkatëse për të hartuar hartat përkatëse të rajonizimit në shkallën e planifikuar.*

	2. *Hartimi i propozimeve për ndryshime legjislative dhe paraprërgatitja e rregulloreve, të cilat përfshijnë zbatimin e këtyre studimeve në planifikimet urbane në të gjithë territorin e vendit.*
Korniza financiare/burimi:	150,000 EURO BE / OKB / Buxheti kombëtar

5. Zjarret në Pyje

Tabela 9. Projektet e lidhura me zjarret në pyje

Rreziku	Përmbytjet dhe zjarret në pyje
Institucioni përgjegjës	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Strukturat e MZSH-së në nivel qendror dhe vendor
Projekti strategjik 1	Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)
Përshkrimi: Programi 3-vjeçar IPA "Floods and Fires" i financuar nga BE synon përmirësimin e kapaciteteve për menaxhimin e riskut nga përmbytjet dhe nga zjarri në Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoninë e Veriut, Serbi dhe Turqi. Programi është i strukturuar në dy komponentë përkatësisht për përmbytjet dhe zjarret pyjore. Duke nxitur bashkëpunimin rajonal dhe shkëmbimin e praktikave të mira, IPA "përmbytjet dhe zjarret" bashkëpunon me autoritetet lokale të mbrojtjes civile dhe agjencitë dhe institucionet e tjera përkatëse lokale për të përmirësuar kornizën ligjore dhe institucionale në lidhje me Direktivën e Përmbytjes së BE -së, dhe Koordinimin institucional midis të gjithë aktorëve të përfshirë në zbatimin e EUFD dhe për të përmirësuar parandalimin, gatishmërinë dhe aftësinë për t'iu përgjigjur zjarreve pyjore në nivelin qendror, rajonal dhe BE.* *AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:* - *Projektin strategjik nr.6: "Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)";* - *Projektin strategjik nr.5 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së".* - *Projektit strategjik nr.10: "JICA - Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje";*	

- *Projekti strategjik nr.11: "ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse""* - *Projekti strategjik nr.6 të përmbytjeve: "Menaxhimi i integruar ndërkufitar i riskut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin"*	
Afati kohor:	2023-2026
Aktivitetet kryesore:	Komponenti 1: Përmbytjet Hartimi i një Udhëzuesi për Planin e Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet (FRMP) në përputhje me masat e renditura në Udhëzimin për zbatimin e Direktivës së Përmbytjes së BE-së. Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese për planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja / FRMP-të dhe planet e menaxhimit të baseneve lumore (RBMP). 1.1 Ndërtimi i kapaciteteve për planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja (FRMP) bazuar në praktikat e mira të Shteteve Anëtare të BE-së dhe Direktivën e Përmbytjes së Bashkimit Evropian (EUFD). 1.2 Ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin e planeve të përbashkëta ndërkufitare.të menaxhimit të riskut nga përmbytja (FRMP) 1.3 Zhvillimi i procedurave dhe marrëveshjeve për përfshirjen rishtas të sistemeve të paralajmërimit të hershëm në planet lokale/qendrore të përgjigjes ndaj emergjencave (ERP). 1.4 Harmonizimi i Planit të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjes (FRMP) me Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor (RBMP). 1.5 Hartimi i procedurave specifike për zhvillimin e FRMP dhe harmonizimin me RBMP. Komponenti 2: Zjarret në pyje 2.1 Sigurimi i mbështetjes teknike për zhvillimin e Vlerësimeve të Riskut nga Zjarri në Pyje (FFRA) dhe aftësive të menaxhimit të riskut nga zjarri në pyje. 2.2 Ngritja, Pajisja, Trajnimi i Moduleve të Mbrojtjes Civile të Shuarjes së zjarrit nga toka (GFFF) në përputhje me Vendimin e Komisionit për Modulet e Mbrojtjes Civile të BE-së. 2.3 Krijimi i protokolleve të Kalimit Kufitar (BC) dhe Mbështetjes së Vendit Pritës (HNS) në përputhje me Udhëzimet e BE-së për Mbështetjen e Vendit Pritës (HNS). 2.4 Organizimi i ushtrimeve rajonale në tavolinë (TTX) dhe një stërvitjeje fushore (FX) për modulet GFFF.
Korniza financiare/burimi:	1,000,000 EURO

Institucioni përgjegjës	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit dhe Instituti i Gjeoshkencave
Institucione kontribuuese	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH

Projekti strategjik 2:	Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor
Përshkrimi: Nisur nga qëllimi strategjik i zvogëlimit të riskut nga zjarret masive në pyje, dhe varësia e tij nga të dhënat e sakta, është i nevojshëm përditësimi i të dhënave aktuale për gjendjen e territorit, cenueshmëria e tij ndaj zjarreve, përditësimi i hartës së rrezikut dhe krijimi i një harte risku, por edhe të bëhen kërkime shkencore në lidhje me metodat më moderne dhe më efikase të vlerësimit të riskut nga zjarret masive në pyje që do të përfshihen në dokumentet strategjike lokale dhe kombëtare. *Rezultatet përfundimtare të projektit janë metodologjia e përmirësuar e vlerësimit të riskut nga zjarret masive në pyje e zhvilluar në të gjitha nivelet (themeli për aktivitetet e ardhshme ciklike të vlerësimit të riskut dhe zhvillimi i skenarëve të personalizuar për ngjarjet individuale) dhe kornizat e harmonizuara në përputhje me rrethanat e institucioneve legjislative përgjegjëse për menaxhimin e riskut, parandalimin e zjarreve masive në pyje, gatishmërinë dhe përgjigjen si dhe planet e përgjithshme të zhvillimit strategjik të të gjitha palëve të interesit.* *AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:* - *Projektin strategjik nr.5 "politikat dhe legjislacioni";* - *Projektin strategjik nr.15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive në nivel qarku";* - *Projektin strategjik nr.2 të tërmeteve: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";* - *Projektin strategjik nr. 1 infektive/biologjike: "Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik";*	
Afati kohor:	2023-2025
Aktivitetet kryesore:	1. Një studim i gjerë mbi vlerësimet moderne të riskut i cili përfshin një pasqyrë të situatës në Shqipëri dhe një strategji zbatimi për përditësimet e hartave të riskut të Shqipërisë që do të përfshijnë zjarret masive në pyje. 2. Workshop për transferimin e njohurive me ekspertë ndërkombëtarë (minimum 5) dhe kombëtarë (minimum 50) mbi modelin evropian të menaxhimit të riskut nga zjarret masive në pyje në nivel kombëtar dhe/ose lokal; 3. Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për zbatimin e rezultateve të vlerësimit të riskut në të gjitha nivelet me synimin e menaxhimit cilësor të riskut nga zjarret masive në pyje.
Korniza financiare/burimi:	400,000 euro nga buxheti i shtetit dhe fondet e BE-së

Institucioni përgjegjës	Bashkitë, AKZM dhe Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (bashkëpërgjegjëse vetëm për metodologjinë e planeve të menaxhimit të zjarreve)

Institucione kontribuuese	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH
Projekti strategjik 3:	Zhvillimi i metodologjisë për planet e menaxhimit të zjarrit në nivel vendor
Përshkrimi: Në këtë projekt do të hartohen planet vjetore dhe afatmesme të menaxhimit për parandalimin dhe kontrollin e zjarreve në pyje në bashkëpunim me pushtetin vendor me theks të veçantë në hartimin metodologjik të këtyre planeve. *AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:* - *Projektin strategjik nr.1 të zjarreve në pyje: "Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)";* - *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* - *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni"*	
Afati kohor:	2023-2024
Aktivitetet kryesore:	1. Ngritja e një grupi pune ndërinstitucional për përgatitjen e metodologjisë. 2. Studimi i bazës ligjore mbështetëse dhe eksplorimi i nevojave për ndryshim. 3. Përgatitja e metodologjisë dhe drafteve paraprake të ndjekura nga diskutimi me palët e interesit. 4. Përshtatja dhe miratimi i metodologjisë.
Korniza financiare/burimi:	12,000 euro nga buxheti i shtetit

,

Institucioni përgjegjës	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit, AKZM dhe bashkitë
Institucione kontribuuese	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH
Projekti strategjik 4:	Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit

Përshkrimi: Në këtë projekt do të përcaktohen nevojat në nivel kombëtar, ku përfshihen edhe kapacitetet e personelit dhe do të llogariten kostot përkatëse për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sinjalizimit të vëzhgimit. Projekti do të rezultojë në një akt ligjor në lidhje me ngritjen dhe funksionimin e sistemit të sinjalizimit të vëzhgimit dhe ngritjen e strukturave përkatëse në nivel rajonal dhe kombëtar. *AKMC duhet të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:* *- Projektin strategjik nr.10: " JICA - Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje";* *- Projektin strategjik nr. 11. ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse";* *- Projektin strategjik nr. 12: "Paralajmërimi i Hershëm"*	
Afati kohor:	2023 - 2025
Aktivitetet kryesore:	1. Studimi i zonave pyjore me risk të lartë nga zjarri në Shqipëri. 2. Studimi i nevojave të kapaciteteve njerëzore në lidhje me sistemin e vrojtim - sinjalizimit në nivel kombëtar. 3. Studimi i kostove dhe burimeve financiare të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të vrojtim-sinjalizimit.
Korniza financiare/burimi:	18 000 euro nga buxheti i shtetit

Institucioni përgjegjës	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së
Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes
Projekti strategjik 5:	Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së
Përshkrimi: Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së forcave operacionale ndaj zjarreve do të kryhet përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së (Ground Forest Fire Fighting/GFFF) një pjesë e të cilit do të krijohet përmes Programit IPA për Përmbytjet dhe Zjarret (IPA Floods and Forest Fires), me qëllim kompletimin e tij në një modul të plotë dhe për tu bashkuar me EERC. Për përfundimin e këtij moduli të pjesshëm do të kryhen studimi, aktivitetet trajnuese dhe stërvitja përfundimtare me praninë e Komisionit Evropian dhe DG ECHO *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* *- Projektin strategjik nr.2: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot";* *- Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*	

- *Projektin strategjik nr. 8 të tërmeteve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR)";* - *Projektin strategjik nr.8 të përmbytjeve: "Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet";*	
Afati kohor:	2024-2027
Aktivitetet kryesore:	1. Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale të *të modulit të pjesshëm kombëtar dhe ndërkombëtare të luftimit nga toka të zjarrit në pyje* (GFFF) e krijuar përmes programit IPA FF për përmbytjet dhe zjarret në pyje. 2. Zbatimi i procedurave të nevojshme kombëtare të kërkuara për miratimin dhe fillimin e komunikimit me *Komisionin Evropian* dhe DG ECHO. 3. Zbatimi i aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me *Komisionin Evropian* dhe DG ECHO. 4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, e aktiviteteve të trajnimit dhe stërvitjes përfundimtare, në prani të autoriteteve të *Komisionit Evropian.* 5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit të plotë GFFF si dhe regjistrimi i tij në EERC. 6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për krijimin e modulit sikurse pagesave të tjera vjetore të funksionalitetit dhe operimit të tij.
Korniza financiare/burimi:	GFFF: Zhvillimi 1,530,420 euro Mirëmbajtja: 117,880 euro Dislokimi: 123,000 euro Kosto totale: 1,771,300 EURO BE/OKB/buxheti i shtetit

Institucioni përgjegjës	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile
Institucione kontribuuese	Ministria e Mbrojtjes
Projekti strategjik 6:	Forcimi i kapaciteteve operacionale për shuarjen e zjarreve nga ajri
Përshkrimi: Forcimi i kapaciteteve operacionale ajrore ka të bëjë me krijimin e flotës ajrore shqiptare të shuarjes së zjarreve në pyje me blerjen/marrjen me qira të avionëve/helikopterëve, për të cilat AKMC duhet të ketë burimet e duhura financiare.	

Krahas mjetit ajror shtesë, brenda kostos së projektit nuk është paraparë kostoja e dy avionëve për shuarjen e zjarrit nga ajri të llojit Air Tractor me kapacitet 3000 litra, të përshtatshëm për furnizim me ujë edhe në depozita të vogla që do sigurohen nëpërmjet asistencës së AICS. *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr. 4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri"*	
Afati kohor:	2023-2026
Aktivitetet kryesore:	1. Kryerja e një studimi mbi nevojat për zgjerimin dhe forcimin e kapaciteteve të zjarrfikësve ajrorë shqiptarë që konsistojnë në dy avionë nëpërmjet kredisë nga Republika e Italisë (Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim) duke shqyrtuar nëse nevojitet një avion/helikopter tjetër. 2. Blerja e një avioni shtesë me kapacitet 3000 litra, të përshtatshëm për furnizim me ujë edhe në depozita të vogla dhe/ose helikopteri bazuar në përfundimet e studimit. 3. Planifikimi i buxhetit vjetor të AKMC-së duke pasur parasysh edhe fondet e nevojshme për marrjen me qira të mjeteve zjarrfikëse kombëtare/ndërkombëtare tokësore apo ajrore. 4. Planifikimi buxhetor i burimeve financiare për funksionimin dhe funksionalitetin e flotës ajrore zjarrfikëse.
Korniza financiare/burimi:	3,000,000 EUR (kostoja e një avioni Air Tractor sipas AICS)

Institucioni përgjegjës	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 7:	Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit
Përshkrimi: Ndër nevojat e shumta që ka pasur në vite Shërbimi i MZSH-së janë edhe ndërtesat e stacioneve zjarrfikëse një pjesë e të cilave për shkak të amortizimit kanë nevojë për rikonstruksion sikurse ka edhe nevoja për ndërtim të stacioneve të reja zjarrfikës. Projekti synon së pari kryerjen e një vlerësimi të vendndodhjeve të stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki sikurse gjendjes së tyre nga pikëpamja funksionale, dhe e sigurisë. Bazuar në konkluzionet e vlerësimit do të kryhen disa prej projekteve të zbatimit për të vijuar me ndërtimin/rikonstruksionin e disa stacioneve më prioritare. Projekti do të përfshijë edhe krijimin e Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së. *AKMC të sigurojë komplementaritetin dhe sinergjinë me:* - *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";* - *Projektin strategjik nr.17 "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave";* - *Projektin strategjik nr.18: "Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike";*	

Afati kohor:	2023-2026
Aktivitetet kryesore:	1. Vlerësimi i vendndodhjeve, funksionalitetit dhe sigurisë së stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki. 2. Bazuar në konkluzionet e vlerësimit hartimi i projekteve të zbatimit për ndërtimin/rikonstruksionin e disa stacioneve më prioritare; 3. Ndërtimi dhe rindërtimi i stacioneve të projektuara; 4. Krijimi i Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së.
Korniza financiare/burimi:	EUR Buxheti i BE/OKB/shteti 2,200,000 euro

6. Aksidentet Teknologjike

Tabela 10. Projektet e lidhura me aksidentet teknologjike

Institucioni përgjegjës:	Instituti i Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës, Instituti i Shëndetit Publike, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 1:	*Ngritja e një laboratori për matjen e Radonit*
Përshkrimi: Radoni në ambiente të mbyllura, kryesisht në bodrume dhe katet e para rrit rrezikun e kancerit të mushkërive. Përqendrimi i radonit ndikohet nga disa faktorë: gjeologjik, fizik dhe meteorologjik duke diktuar monitorim në periudha të ndryshme sezonale. Në Shqipëri janë bërë matje sporadike me ndihmën e disa projekteve, si dhe është hartuar Harta e Rrezatimit Natyror që disponohet nga Shërbimi Gjeologjik, por kjo nuk e eliminon nevojën për monitorime të mëtejshme, më të detajuara, veçanërisht në ato zona që janë në rrezik dhe kanë një numër të lartë banorësh si Tirana, Durrësi etj. Laboratori për matjen e radonit fillimisht do të fokusohet në objektet publike si çerdhe, kopshte, shkolla, fakultete etj. Laboratori do të ndihmojë në informimin dhe ndërgjegjësimin e popullatës, veçanërisht në ato zona që paraqesin rrezik për të qenë në gjendje të marrin masa mbrojtëse. Me këtë laborator do të hidhen themelet për një punë që mund të vazhdojë me vendosjen e pajisjeve reale të monitorimit të minave në objekte apo zona që përbëjnë risk. Gjithashtu do të ishte e mundur të krijohej një bazë të dhënash me të dhëna të vazhdueshme të kryera në intervale të rregullta. Laboratori do të kontribuonte në objektivin strategjik për zvogëlimin e riskut nga radoni në drejtim të marrjes së të dhënave përfaqësuese duke u konsultuar dhe bashkëpunuar me institucione si ISHP	

dhe IFBZ dhe gjithashtu duke kontribuar në fushën e kërkimit shkencor për njohjen e situatës dhe marrjen e masave mbrojtëse më efikase dhe më pak të kushtueshme.	
Afati kohor:	*2023 - 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. Është kryer një konsultim me ekspertë të fushës në lidhje me pajisjet e nevojshme për matjet në afatshkurtër e afatgjatë në tokë, ujë dhe ajër me qëllim ngritjen e një laboratori me padisje profesionale që mundësojnë matjen e përqendrimit të radonit, kryesisht në zona që paraqesin rrezikshmëri nga pikëpamja gjeologjike dhe strukturore me një vëmendje të veçantë ndaj objekteve publike apo ndaj zonave të populluara. 2. Për këtë qellim duhet kryer vendosja e sensorëve në çerdhe, kopshte e shkolla, apo struktura të tjera publike, kryesisht në katet përdhese, bodrume, garazhe Në harmonizim me kornizat ligjore të BE të hartohen propozime për ndryshime legjislacioni në lidhje me kontrollin e banesave publike e private, veçanërisht katet përdhese, garazhe në ato zona që paraqesin rrezik.
Korniza financiare/burimi:	160,000 EURO Buxheti Kombëtar dhe fondet e BE-së

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Instituti i Gjeoshkencave, Agjencia Kombëtare Bërthamore, Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar dhe Ministria e Mbrojtjes
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 2:	*Zgjerimi i rrjetit për monitorimin e radioaktivitetit*
Përshkrimi: Projekti do të kontribuojë në objektivin strategjik për zvogëlimin e riskut nga radioaktiviteti në përgjithësi dhe nga rrezatimet e ndryshme jonizuese nëpërmjet forcimit, përmirësimit dhe zgjerimit të rrjetit të monitorimit apo rrjetit të emergjencës radiologjike. *Metodologjitë për vlerësimin e riskut radioaktiv në nivel global janë përcaktuar dhe zbatuar edhe në Shqipëri. Aktualisht, të dhënat për vendin janë të parregulluara, ndaj është e nevojshme që të dhënat e regjistruara të transferohen në kohë reale dhe të harmonizohen me Sistemin Informativ Ndërkombëtar të Monitorimit të Rrezatimit (IRMIS) të Agjencisë Ndërkombëtare të Energjisë Atomike (IAEA). Në kuadër të këtij Projekti, i cili është pjesë e projektit të financuar nga BE, përveç 7 stacioneve të administruara nga IFBZ - UT (ALB-9-009 - Rritja e Kapacitetit Kombëtar për Monitorimin e Rrezatimit dhe*	

Paralajmërimin e Emergjencave), është planifikuar të shtohen edhe 4 stacione të tjera në mjedisin ekzistues të rrjetit të monitorimit të radioaktivitetit, për të zgjeruar rrjetin e monitorimit. Ministria e Mbrojtjes do të jetë përfituese dhe administratore e 4 stacioneve shtesë.	
Afati kohor:	*2023 - 2024*
Aktivitetet kryesore:	*1. Është krijuar një rrjet për mbledhjen e të dhënave në 7 stacione, që përcaktojnë fuqinë e dozës së ambientit në ajër, në mënyrë të vazhdueshme.* *2. Rrjeti i monitorimit të radioaktivitetit i lidhur me sistemin e Emergjencave Radiologjike do të përmirësohet dhe forcohet me 4 stacione të reja.* *3. Të katër stacionet e rrjetit monitorues do të depozitojnë të dhëna në një sistem të vetëm IT (server) të vendosur në IFBZ – UT.* *4. Analiza e bazave të të dhënave dhe modelimi i të dhënave bazë të saj (aplikacione, server, cloud, etj.) do të realizohet nga IFBZ -UT.*
Kuadri financiar/burimi:	Buxheti Kombëtar dhe fondet e BE-së

Institucioni përgjegjës:	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Turizmit dhe Mjedisit
Institucione kontribuuese	Ministri të tjera të linjës
Projekti strategjik 3:	*Krijimi i një baze të dhënash për llogaritjen, menaxhimin dhe parandalimin e risqeve teknike dhe teknologjike, sipas sektorëve*
Përshkrimi: Rezultati i pritshëm i projektit është krijimi i një baze të dhënash cilësore të orientuar sipas sektorëve potencialisht të ekspozuar ndaj risqeve teknike dhe teknologjike. Të dhënat e regjistruara në këtë bazë të dhënash do të shërbejnë si bazë për orientimin e politikave dhe strategjive kombëtare për shmangien apo parandalimin e risqeve në tërësi, si dhe për minimizimin e kostove në planin afatgjatë. Baza e të dhënave do të jetë lehtësisht e aksesueshme nga të gjitha palët e interesit, si në nivel qendror ashtu edhe në atë lokal. Në një plan afatmesëm, projekti do të ndihmojë në përmirësimin e kapaciteteve të planifikimit financiar dhe njerëzor si dhe një adresim sistematik të riskut, me synimin për të kaluar nga politika pasive në ato proaktive dhe parandaluese. AKMC të sigurojë sëbashku me MIE, MTM dhe ministritë e tjera të linjës komplementaritetin dhe sinergjinë me Projektin strategjik nr.18: "Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike";	
Afati kohor:	*2023 - 2030*

Aktivitetet kryesore:	1. *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, rafineritë e përpunimit të naftës bruto, gazsjellësit dhe naftësjellësit;* 2. *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në objektet e sektorit minerar, impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, modelimin e bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.);* 3. *Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në sistemin e digave dhe rezervuarëve;* 4. *Modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.).*
Korniza financiare/burimi:	300,000 EURO Buxheti Kombëtar, fondet e BE-së, donatorë të tjerë

7. Sëmundjet infektive

Tabela 11. Projektet e lidhura me sëmundjet infektive

Institucioni përgjegjës:	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
Institucione kontribuuese	
Projekti strategjik 1:	*Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik*
Përshkrim: Projekti do të kontribuojë në qëllimin strategjik të zvogëlimit të riskut biologjik në drejtim të marrjes së të dhënave nga nëntë institucione për të bërë të mundur hartimin e metodologjisë e vlerësimit të riskut biologjik. Adresimi i masave të duhura për të menaxhuar riskun nga sëmundjet infektive në shërbim të mbrojtjes së jetës së konsumatorëve. Realizimi i tij do të arrihet nëpërmjet përmirësimit të infrastrukturës së laboratorëve dhe pajisjes së tyre me mjetet dhe aparaturat përkatëse në qytetet Fier, Shkodër, Gjirokastër, Korçë dhe Vlorë. AKMC të sigurojë sëbashku me AKU komplementaritetin dhe sinergjinë me: - *Projektin strategjik nr.5 "Politikat dhe legjislacioni";* - *Projektin strategjik nr. 15: "Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të fatkeqësive në nivel qarku";* - *Projektin strategjik nr. 2 të tërmeteve: "Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet";*	

- *Projektin strategjik nr.2 të zjarreve në pyje: "Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor";*	
Afati kohor:	*2023 – 2025*
Aktivitetet kryesore:	1. Përmirësimin e infrastrukturës së laboratorëve në vlerën 100 milionë lekë. 2. Pajisje dhe makineri për laboratorët në vlerën 179.784.861 lekë.
Kuadri financiar/burimi:	2.372.500 EUR BE / OKB / Buxheti kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Instituti i Shëndetit Publik
Institucione kontribuuese	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor (OSHKSH), Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH), Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare (ISUV), Autoriteti Kombëtar i Ushqimit etj.
Projekti strategjik 2:	*Zbatimi i regjimit të biosigurisë dhe biosigurimit nëpërmjet një rrjeti efektiv kombëtar laboratorik*
Përshkrim: Rregullorja Ndërkombëtare e Shëndetit IHR (2005) kërkon garantimin e sigurisë dhe sigurimit në të gjithë laboratorët që testojnë agjentët infektivë ose rreziqe të tjera që mund të shkaktojnë emergjenca të shëndetit publik me shqetësim kombëtar dhe ndërkombëtar. Laboratorët janë pjesë kritike e mbikëqyrjes, gatishmërisë dhe përgjigjes dhe marrin pjesë në zbulimin dhe hetimitn me ekzaminimin e mostrave të kryera në nivel vendi ose në qendrat ndërkombëtare bashkëpunuese të referencës ose laboratorët e referencës. Krijimi i një rrjeti efektiv kombëtar laboratorik Shëndetësor me një regjim të standardizuar Kombëtar të biosigurisë dhe biosigurimit është një domosdoshmëri për të përmirësuar sigurinë shëndetësore të vendit	
Afati kohor:	*01/01/2023 – 15/11/2023*
Aktivitetet kryesore:	Objektivi 1: Vleresimi i shkallës së përgatitjes dhe zbatimit të udhëzimeve dhe/ose rregulloreve për biosigurinë dhe biosigurimin laboratorik shëndetësor kombëtare në laboratorët shëndetësore, veterinare, sigurinë ushqimore dhe mjedisore në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal. Objektivi 2: Adresimi i mangësive në udhëzimet dhe/ose rregulloret e biosigurisë dhe biosigurimit dhe rishikimi i tyre në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal.

	Objektivi 3: Krijimi i një sistemi për mbikëqyrjen e zbatimit të një regjimi të biosigurisë dhe të biosigurimit shëndetësor dhe testimi i vazhdueshëm i tij
Kuadri financiar/burimi:	100,000,000 USD BE / OKB / Buxheti kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Institucione kontribuuese	Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit etj.
Projekti strategjik 3:	*Krijimi i një Qendre Operacionale Emergjente të Shëndetit Publik në Institutin e Shëndetit Publik*

Përshkrim: Një Qendër Operacionale e Emergjencave të Shëndetit Publik (PHEOC) shërben si një qendër për përgatitjen dhe përgjigjen ndaj emergjencave të shëndetit publik dhe integron shërbimet tradicionale të shëndetit publik në një model të menaxhimit të emergjencës për koordinimin e informacionit dhe burimeve për të mbështetur aktivitetet e menaxhimit të incidenteve. QOESHP (Public Helath Emergency Operation Center/PHEOC), është pjesë e një programi gjithëpërfshirës të përgatitjes së emergjencës së shëndetit publik, planifikimit dhe ndërtimit të kapaciteteve. Një program i tillë përfshin, por nuk kufizohet vetëm tek:

1. *Parandalimi dhe zbutja e rreziqeve*
2. *Rritja e gatishmërisë duke planifikuar dhe grumbulluar burimet e përgjigjes;*
3. *Krijimi i kapaciteteve dhe aftësive të ndërlidhura institucionale dhe teknike (p.sh. laboratorët, klinikat e komunitetit dhe ekipet e epidemiologëve dhe të përgjigjes së shpejtë)*
4. *Zbatimi i programeve të mbikëqyrjes së shëndetit publik*
5. *Zbatimi i programeve të shëndetit mjedisor*
6. *Angazhimi i komuniteteve*
7. *Trajnimi i stafit dhe vlerësimi i planeve.*

AKMC në koordinim me ISHP dhe MSHMC duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me:

- *Projektin strategjik nr.5: "Politikat dhe legjislacioni";*
- *Projektin strategjik nr.4: "Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri";*
- *Projektin strategjik nr.17 "Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave"*

Afati kohor:	*19/01/2022 – 15/12/2024*
Aktivitetet kryesore:	Një PHEOC funksionale është kritike për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR 2005). Hapi 1: Krijimi rregulloreve, standardeve kombëtare dhe procedurave operacionale për PHEOC; Hapi 2. Sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjet e duhura për PHEOC; sigurimi pajisjeve dhe sistemeve; Hapi 3: Krijimi i sistemit të survejancës së emergjencave në shëndet publik dhe alertit të tyre; Përditësim i sistemit të survejancës së sëmundjeve infektive (përfshirë dhe modelin e biosigurisë së risqeve biologjike) Hapi 4: Krijimi i kapaciteteve njerëzore kombëtare për një PHEOC funksionale duke u trajnuar dhe duke ushtruar. Hapi 5: Krijimi i kapaciteteve kombëtare për vlerësimin analitik të riskut, parashikimin dhe zvogëlimin e riskut.
Kuadri financiar/burimi:	700,000 USD EURO BE / OKB / Buxheti kombëtar

Institucioni përgjegjës:	Instituti i Shëndetit Publik dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Institucione kontribuuese	Qendra Kombëtare e Cilësisë Sigurisë dhe Akreditimit te Institucioneve Shëndetësore (QKCSAISH), Operatori i Shërbimeve të Kujdesit Shëndetësor, Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor, Instituti i Sigurisë Ushqimore dhe Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Ushqimit dhe Autoriteti Kombëtar i Mjedisit (AKM).
Projekti strategjik 4:	Krijimi i kurrikulës dhe certifikatës për trajnimin kombëtar për biosigurinë dhe biosigurimin
Përshkrim: Aktualisht ekziston një kurs trajnimi i shkurtër për biosigurinë dhe biosigurimin ndërsa IHR kërkon një program kombëtar për trajnimin në biosiguri dhe biosigurim. Trajnimi synon të rrisë kapacitetet dhe aftësitë për të siguruar një siguri të shëndetit të njesuar për të gjitha laboratorët e përfshirë në zbulimin e agjentëve infektivë dhe rreziqeve të tjera. Trajnimi do të përfshijë staf të shëndetit publik, laboratorëve klinikë, veterinarë, sigurisë ushqimore dhe mjedisore. AKMC në koordinim me ISHP dhe MSHMC duhet të sigurojnë komplementaritetin dhe sinergjinë e projektit me *Projektin strategjik nr.9: "Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile"*	
Afati kohor:	*10/11/2022 – 10/11/2024*
Aktivitetet kryesore:	Hapi 1: Përgatitja e një kurrikule shëndetësore mbi biosigurinë dhe biosigurimin

	Hapi 2: Krijimi i një programi bazë dhe një kaskadë të vazhdueshme trajnimi të një kurrikule të shëndetit të njesuar mbi biosigurinë dhe biosigurimin. Hapi 3: Fuqizimi i kapaciteteve humane të tanishme të laboratorëve shëndetësorë duke i ofruar trajnim të vazhdueshëm kaskadë.
Kuadri financiar/burimi:	200,000 USD BE / OKB / Buxheti kombëtar

8. Përmbledhje e Planit të Veprimit[25]

Tabela 12. Përmbledhje e Planit të Veprimit

1. Menaxhimi i riskut të fatkeqësive me shumë risqe

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë

[25] Në ndryshim nga kostot e projekteve strategjike në seksionet 1-7, kostot e projekteve strategjikë të planit të veprimit janë konvertuar në lekë. Kursi 1 euro = 117,25 lekë dhe 1 USD= 119,26 lekë janë mesataret e muajit tetor 2022 të dhëna nga Banka e Shqipërisë

1	Përmbushja e mëtejshme e detyrimeve të Shqipërisë si një vend anëtar i Mekanizmit të Mbrojtjes Civile të Bashkimit Evropian (MMC BE)	1. Identifikimi i kërkesave teknike dhe institucionale për qasje në TESTA 2. Mbështetja e përgatitjes së udhërrëfyesit për ngritjen e sistemit TESTA 3. Zhvillimi i materialeve të trajnimit dhe planeve dhe programeve mësimore në përputhje me udhëzimet e BE-së. 4. Mbështetje për ngritjen e sistemit TESTA 5. Mbështetje për forcimin e protokolleve të bashkëpunimit dhe qasjes së pikës së vetme të kontaktit në trajtimin e MMC BE 6. Kryerja e trajnimeve mbi legjislacionin e MMC BE, rregullat zbatuese dhe procedurat e përgjithshme 7. Rekomandime teknike në lidhje me vendosjen e lidhjeve të komunikimit me Qendrën Koordinuese të Përgjigjes Emergjente të BE-së (ERCC) 8. Aktivizimi i lidhjes dhe lidhshmërisë me mjetet e monitorimit të BE-së dhe sistemet e paralajmërimit të hershëm (EFAS, EFFIS, Copernicus) 9. Sigurimi i planifikimit në kohë të burimeve financiare të nevojshme për pagesën e tarifave vjetore për TESTA si dhe anëtarësimin në MMC BE	AKMC	MM, ministritë e linjës dhe UNDP RESEAL	2023	2027	219.438.400	119.260.000
2	Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes së AKMC-së dhe forcave operacionale përmes krijimit të një moduli të ri të BE-së "Ekipi me mjete ajrore pa pilot".	1. Studimi për ngritjen e një "Ekipi me mjete ajrore pa pilot". 2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO. 3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO 4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve të trajnimit dhe/ose ushtrimeve në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian 5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit si dhe regjistrimi i tij në EERC 6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për modulin si dhe pagesat e tjera vjetore të funksionalitetit dhe operimit të tij	AKMC	MM	2023	2025	3.670.881.760	3.670.881.760
3	Zbatimi i plotë dhe në të gjithë territorin e Shqipërisë i numrit të unifikuar të Emergjencave Civile 112	1. Hartimi dhe miratimi i VKM-së "Për ngritjen dhe funksionimin e sistemit të unifikuar të thirrjeve emergjente 112" 2. Hartimi i një studimi për gjendjen e zbatimit të 112 në Shqipëri, bazuar në gjendjen faktike si edhe studimin e fizibilitetit dhe projektin e zbatimit të vitit 2011. 3. Nëse është e nevojshme, bazuar në përfundimet e studimit, hartimi i një projekti të ri për zbatimin e numrit 112. 4. Zbatimi i numrit të Unifikuar të Emergjencës Civile 112 bazuar në konkluzionet e studimit të kryer dhe projektit të ri/studimit të fizibilitetit dhe projektit të zbatimit, të kryer në dhjetor 2011, në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Projekti për Zbutjen dhe Përshtatjen ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP). 5. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për zbatimin e numrit të unifikuar të emergjencës civile 112 sikurse pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij.	AKMC, MM	MB, ministri të tjera të linjës	2023	2026	3.517.500.000	3.517.500.000
4	Mbështetja për krijimin e një sistemi të Mbrojtjes Civile në Shqipëri.	1. Ndjekja e të gjitha procedurave të nevojshme për miratimin e Marrëveshjes së Kredisë 2. Ndërtimi dhe pajisja e ndërtesës së re të AKMC-së; 3. Sigurimi i furnizimit me mjete, automjete dhe pajisje për AKMC-në dhe Shërbimin e MZSH-së; 4. Rritja e formimit profesional të stafit të MZSH-së	AKMC	AICS, DP e MZSH, 12 drejtoritë e MZS	2022	2025	3.517.500.000	

				H në bashkitë-qendër qarku				
5	Politikat dhe legjislacioni	1. Bazuar në rezultatet e konsulencës së dokumentit të PKEC-së, zhvillimi i vazhdimësisë së planifikimit të operacioneve (COOP) dhe vazhdimësisë së Qeverisë (COG) në ministri dhe institucione të tjera të sigurisë dhe mbrojtjes; 2. Hartimi i metodologjisë për Planin e Emergjencave Civile në nivel qendror, qarku dhe vendor si dhe për infrastrukturën kritike, SEVESO dhe institucione të tjera (sipas detyrimeve përkatëse që burojnë nga neni 23, pika 6, shkronja "dh" e ligjit 45/2019); 3. Hartimi i Metodologjisë/Udhëzimit për Vlerësimin e Riskut të Fatkeqësive në nivel qendror, qarku dhe vendor si dhe infrastrukturën kritike; 4. Hartimi i udhëzimeve për funksionet e Bazës së të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë në ndihmë të përdoruesve të tij; 5. Hartimi i udhëzimeve, rregulloreve, manualeve dhe PSO të përcaktuara nga konsulenca e Planit Kombëtar të Emergjencave Civile	AKMC	MM, ministritë e linjës	2023	2025	58.625.000	58.625.000
6	Zhvillimi i Procedurave Standarde Operacionale prioritare të sistemit të MC (UNDP RESEAL)	1. Bazuar në rezultatet e Konsulencës së PECK, kryerja e një analize të mangësive të procedurave aktuale për të zhvilluar procedurat standarde të funksionimit të komunikimit dhe njoftimit të gjithë qeverisë (SOP) dhe ushtrimin e tyre në nivel kombëtar, qarku, bashkie dhe incidenti; 2. Bazuar në rezultatet e Konsulencës së PECK për PSO që do të zhvillohet në Shqipëri: 2.1. PSO-të e identifikuara me prioritet të zhvilluara në konsultim me palët e interesit dhe institucionet përkatëse 2.2. Mbështetje konsultimesh për PSO dhe miratimin e tyre	AKMC	UNDP RESEAL	2023	2024	17.889.000	
7	Mbështetja e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë përmes DesInventar në AKMC, ministri dhe institucione qendrore, qark dhe bashki (UNDP RESEAL)	1. Studimi i të gjitha raporteve ekzistuese në lidhje me të dhënat e humbjeve nga fatkeqësitë në Shqipëri dhe identifikimi i gjendjes ekzistuese 2. Zbatimi i bazës së të dhënave të humbjeve nga fatkeqësitë 3. Mirëmbajtja e bazës së të dhënave dhe përmirësime ligjore	AKMC	UNDP RESEAL	2023	2024	11.926.000	
8	Edukimi dhe ndërgjegjësimi i publikut	1. Kryerja e një studimi për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të njohurive të Mbrojtjes Civile, verifikim nëse niveli parauniversitar ofron njohuri për mbrojtjen dhe parandalimin e fatkeqësive, në përputhje me profilin e tyre. 2. Në përputhje me përfundimet e studimit, hartimi i një plani veprimi për përmbushjen e detyrimit ligjor. 3. Zbatimi i planit të veprimit për përfshirjen në planet dhe programet mësimore të njohurive të Mbrojtjes Civile 4. Zhvillimi i një programi ndërgjegjësimi publik për ZRF dhe të planit të veprimit 5. Zbatimi i planit të veprimit të ndërgjegjësimit publik për ZRF	AKMC, MAS	Strukturat vendore e të MZSH	2023	2025	70.350.000	70.350.000

9	Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë nëpërmjet programit të trajnimit të Mbrojtjes Civile	1. Zhvillimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile bazuar, ndër të tjera, në Planin e ri Kombëtar të Emergjencave Civile dhe veçanërisht në rekomandimet e konsulencës të PKEC lidhur me të. 2. Mbështetja e konsultimeve ndërinstitucionale dhe miratimi i programit të trajnimit 3. Implementimi i Programit të Trajnimit të Mbrojtjes Civile	AKMC		2023	2027	117.250.000	117.250.000
10	Ngritja dhe forcimi i sistemit të paralajmërimit dhe njoftimit të hershëm për zjarret në pyje (JICA)	1. Kryerja e një misioni nga ekspertët japonezë për një vlerësim të gjendjes ekzistuese të sistemit të paralajmërimit të hershëm. Identifikimi i boshllëqeve, mangësive dhe propozimet për përmirësim 2. Nënshkrimi i Marrëveshjes Teknike për Asistencën Teknike të Qeverisë së Japonisë 3. Implementimi i projektit	AKMC	JICA dhe donatorët	2023	2025	469.000.000	
11	ALBAdapt – "Shërbimet Klimatike për një Shqipëri Ripërtëritëse"	Komponenti 1 - Shërbimet e Informacionit për Klimën Komponenti 2- Sistemet e Paralajmërimit të Hershëm dhe Veprimit të Hershëm me shumë rrezitje të bazuara në ndikim Komponenti 3 Vendime dhe investime të informuara nga klima	MTM	GIZ, donatorë dhe institucione të tjera	2023	2027	5.856.637.500	
12	Forcimi i sistemit të paralajmërimit të hershëm	1. Blerja e 4 dronëve të nivelit mesatar për 4 qendrat Rajonale të Mbrojtjes Civile 2. Trajnimi i nevojshëm për përdorimin e dronëve në vlerë prej 228 240 euro (PBA) 3. Identifikimi i mangësive të tjera duke pasur parasysh investimet në vijim ose Zhvillimi i Listës Kontrolluese të Sistemit të Paralajmërimit të Hershëm 4. Në një periudhë afat shkurtër: blerja e një softueri që do të ndihmojë sistemin e paralajmërimit të hershëm të tipit Katwarn, Nokia 5. Blerja e Licencave përkatëse për Software, Instalim, Integrim 6. Parashikimi i kostove të mirëmbajtjes dhe llogaritja e kostove përkatëse për tarifat vjetore për kompanitë që blejnë licenca.	AKMC		2023	2027	185.551.643	185.551.643
13	IPA CBC Strategjik Shqipëri, Mali i Zi, Itali	1. Rritja e qëndrueshmërisë së burimeve ujore ose qëndrueshmërisë së territoreve të prekura nga fatkeqësitë ujore ose të dyja. 2. Rritja e kapaciteteve për aftësinë ripërtëritëse ndërkufitare, me investime të vogla në infrastrukturë, për mbrojtjen nga zjarri në pyje dhe studime të mundshme fizibiliteti dhe çdo studim tjetër vlerësues që nevojitet sipas legjislacionit shqiptar dhe atij të BE-së. 3. Rritja e qëndrueshmërisë së burimeve ujore ose qëndrueshmërisë së territoreve të prekura nga fatkeqësitë ujore ose të dyja.	AKMC	Donatorët	2023	2025	234.500.000	

14	Forcimi i gatishmërisë financiare të vendit përmes miratimit të një Programi Kombëtar të Financimit të Riskut të fatkeqësive	1. Menaxhimi i detyrimeve kontingjente të qeverisë lidhur me fatkeqësitë 1.1. Transparenca e shpenzimeve pas fatkeqësisë dhe ofrimi i likuiditetit të shpejtë 1.2. Rritja e efikasitetit të kostos së përdorimit të financave publike 1.3. Mobilizimi i kapitalit të sektorit privat për menaxhimin e detyrimeve të qeverisë 1.4. Rregullimi i procesit të financimit pas fatkeqësisë 1.5. Rritja e disponueshmërisë së fondeve për qeveritë vendore 2. Qasje në shërbimet financiare pas fatkeqësisë nga familjet, fermerët dhe bizneset dhe të varfërit 2.1. Sigurimi nga tërmetet për familjet 2.2. Qasje në financa (nga fermerët, NMV-të) 2.3. Mbrojtja sociale e përshtatur 2.4. Zhvillimi i tregut të sigurimeve 2.5. Futja e instrumenteve financiare që mund të forcojnë aftësinë ripërtëritëse të sektorit financiar dhe privat kundër fatkeqësive dhe ndryshimeve klimatike 3. Menaxhimi i risqeve të lidhura me fatkeqësitë e sektorit financiar dhe privat dhe mobilizimi i financave për forcimin e aftësisë ripërtëritëse (investime të gjelbra dhe të qëndrueshme) 3.1. Rritja e aftësisë ripërtëritëse së sektorit financiar dhe privat ndaj fatkeqësive	MFE	BB	2022	2026	53.667.000	
15	Hartimi i dokumenteve të vlerësimit të Riskut të Fatkeqësitë në nivel qarku	1. Përgatitja e dokumenteve të vlerësimit të riskut të fatkeqësitë në nivel qarku 2. Miratimi i dokumenteve të vlerësimit të riskut në nivel qarku nga Institucioni i Prefektit të Qarkut	Institucionet e Prefektit të Qarkut	AKMC	2023	2025	314.846.400	314.846.400
16	Hartimi dhe miratimi i bazës ligjore për infrastrukturën kritike	1. Zhvillimi dhe miratimi i ligjit "Për infrastrukturën kritike" duke siguruar, ndër të tjera, përafrim të plotë me Direktivën e Këshillit të BE-së 2008/114, datë 8 dhjetor 2008, "Për identifikimin dhe përcaktimin e infrastrukturës kritike evropiane dhe vlerësimin e nevojave për përmirësimin e mbrojtjes së tyre". 2. Hartimi i të gjitha akteve nënligjore të ligjit "Për infrastrukturën kritike" që hap rrugën për rritjen e aftësisë ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe zbatimin në praktikë të Direktivës përkatëse të BE-së	MIE	AKMC, ministritë e linjës	2023	2024		
17	Forcimi i gatishmërisë dhe përgjigjes ndaj emergjencave	1. Prokurimi i pajisjeve të përgjigjes ndaj emergjencave dhe sistemeve të TIK 2. Punime të mundshme për qendrat e operacionale dhe qendrat e trajnimit 3. Zhvillimi i procedurave standarde operacionale 4. Trajnime	AKMC, strukturat e MZSH-së në nivel vendor dhe qendror	BB	2024	2027	3.577.800.000	3.577.800.000
18	Përmirësimi i aftësive ripërtëritëse të infrastrukturës kritike dhe ndërtesave publike	1. Vlerësimi i stacioneve të përgjigjes së parë (si dhe infrastrukturës tjetër të përzgjedhur kritike publike) për aftësinë ripërtëritëse prej fatkeqësive (fizike dhe funksionale) 2. Projektimi i stacioneve/ndërtesave ripërtëritëse 3. Punime ndërtimi/rehabilitimi	Institucionet publike, strukturat qendrore dhe vendore apo subjektet private, të cilët i kanë në pronësi/administrim infrastrukturat e përzgjedhura. Instituti i Ndërtimit	BB	2024	2027	4.770.400.000	4.770.400.000

19	Forcimi i Menaxhimit të Riskut të Fatkeqësive në Bashki	1. Trajnime 2. Prokurimi i sistemeve përkatëse TIK/GIS	Bashkitë e përzgjedhura	Institucionet përkatës të Prefektit të Qarkut, MB dhe AKMC, BB	2024	2027	357.780.000	357.780.000
20	Përmirësimi i të Dhënave të Humbjeve nga Fatkeqësitë dhe Menaxhimi i Informacionit të Riskut.	1. Zhvillimi i procedurave standarde operacionale 2. Prokurimi i sistemeve përkatëse TIK/GIS 3. Trajnime	AKMC	BB	2024	2027	357.780.000	357.780.000
21	Rehabilitimi i 16 stacioneve të rrjetit hidrometeorologjik të siguruara në kuadër të projektit të Bankës Botërore "Zbutja dhe Përshtatja ndaj Riskut të Fatkeqësive" (AL-DRMAP) dhe që nuk u rehabilituan në kuadër të Programit PRO NEWS.	1. Inspektimi i 16 stacioneve për të konstatuar gjendjen e tyre reale dhe nevojat për rehabilitim 2. Sigurimi i burimeve financiare të nevojshme për projektimin dhe zbatimin e investimit rehabilitues 3. Hartimi i projektit të zbatimit bazuar mbi gjendjen e evidentuar nga inspektimet sikurse në të gjithë dokumentacionin dhe përvojën e realizimit të projektit të rehabilitimit të 24 stacioneve nëpërmjet programit PRO NEWS 4. Implementimi i projektit, mbikëqyrja, marrja në dorëzim	AKMC dhe IGJEO	MM	2023	2024	62.837.675	62.837.675
22	Forcimi i kapaciteteve të Shërbimit të MZSH; forcimi i vullnetarizmit; forcim i kapaciteteve monitoruese të AKMC-së; sistem për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.	1. Ndërgjegjësimi dhe ngritja e organizatave vullnetare; 2. Forcimi i teknologjisë për monitorimin operacional; 3. Sistemi për mbledhjen dhe mbrojtjen e të dhënave për humbjet nga fatkeqësitë natyrore; 4. Mbështetje për strukturat operacionale të MZSH në trajnime dhe pajisje.	AKMC	MZSH dhe AICS	2023	2024	469.000.000	469.000.000
23	Forcimi i kapaciteteve të gatishmërisë së forcave operacionale përmes trajnimeve, ushtrimeve dhe stërvitjeve	1. Zhvillimi i trajnimeve për stafin e AKMC-së; 2. Sigurimi i pajisjeve të forcave zjarrfikëse; 3. Forcimi i kapaciteteve njerëzore të forcave zjarrfikëse; 4. Ngritja e ekipit me qen për MZSH-në	AKMC	MZSH dhe AICS	2023	2024	117.250.000	117.250.000

24	Sigurimi i ndihmës teknike për MTM për Kap.27 -Shkrimi dhe negociatat; dhe sigurimi i ndihmës teknike për MTM për të identifikuar nevojat e planifikimit dhe për të mbështetur zbatimin e dokumenteve të planifikimit strategjik. Faza II, SANE 27	Rezultati Nr.1 - Ministria dhe institucionet e tjera të Kap.27 kanë forcuar aftësinë për shqyrtimin dhe negociatat e Kap.27. Sipas këtij rezultati, programi do të mbështesë MTM për të koordinuar procesin e negociatave të BE -së, veçanërisht për të përgatitur përgjigje për pyetjet zyrtare të shqyrtimit të BE -së, të përgatisë prezantime për takime bilaterale të KE, të përgatisë pozicione negociuese dhe të propozojë veprime për të mbyllur boshllëqet e identifikuara. Gjithashtu, ai do të mbështesë MTM në krijimin e një sistemi të mirë të menaxhimit të procesit për të ndjekur përparimin e negociatave të BE -së. Kur kërkohet do të mbështesë MTM me hartimin e vogël ligjor që rrjedhin nga PKIE dhe për të përmbushur detyrimet nga përfundimet e takimeve të nën-komitetit me KE. Ekipi SANE27 do të jetë një shërbim këshillues për MTM kur të jetë e nevojshme. Rezultati Nr.2 - Nevojat për planifikimin strategjik të Kap.27, dokumentet e planifikimit strategjik të rëndësishëm për negociatat e BE -së janë përgatitur dhe ofrohet mbështetje për zbatimin e tyre. Sipas këtij rezultati, programi do të mbështesë MTM në identifikimin e dokumenteve të planifikimit të nevojshëm për negociatat e BE-së, të propozojë veprime për të përgatitur dokumente të tilla dhe për të ndjekur zbatimin e tyre. Gjithashtu, ajo do të mbështesë MTM në programimin e fondeve IPA të BE-së dhe fondeve të tjera të donatorëve me përgatitjen e dokumenteve të veprimit, TOR, propozimet e projektit dhe dokumentet e tjera të prokurimit. Ai do të sigurojë mbështetje në rritjen e koordinimit të donatorëve për sektorin e mjedisit në Shqipëri dhe për të krijuar mekanizma të mirë për planifikimin e investimeve në sektorin e mjedisit.	MTM	Donatorë	1/9/2021	21/12/2023	257.950.000	
25	Hulumtimi, zhvillimi dhe zbatimi i një Sistemi Kombëtar të Menaxhimit të Incidenteve (SKMI)	1. Faza e hulumtimit që përfshin një analizë të boshllëqeve dhe nevojave të sistemeve, procedurave, palëve të interesit dhe burimeve; 2. Hartimi dhe zhvillimi i një kuadri kombëtar të sistemit të menaxhimit të incidenteve dhe procedurave standarde operacionale; 3. Dizajnimi dhe përshtatja e Qendrës Kombëtare Operacionale të Emergjencave Civile (QKOEC) dhe Qendrave të Emergjencave Civile në Qarqe (QOECQ); 4. Programi i Trajnimit dhe Zhvillimit Kombëtar dhe në qarqe i SMI me shumë nivele për agjencitë e palëve të interesit; 5. Zbatimi i platformës së softuerit të menaxhimit të incidenteve i lidhur me platformat e reja ose ekzistuese të TIK -ut.	AKMC		2023	2024	381.062.500	381.062.500
	Totali: Menaxhimi i riskut të fatkeqësive me shumë risqe						28.667.422.878	18.148.174.978

2. Tërmetet

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribues (nëse ka)	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë

1	Përmirësimi dhe ristrukturimi i Rrjetit Sizmologjik Shqiptar	1. Përmirësimi i teknologjisë aktuale te monitorimit të Rrjetit Sizmologjik Shqiptar; 2. Dendësimi i stacioneve të rrjetit të monitorimit të tërmeteve, dhe atyre të lëkundjeve të forta, për karakterizimin e impaktit sizmik në kushte të ndryshme trojesh; 3. Përmirësimi i teknologjisë dhe sistemimi i rrjetit aktual në Qendrën Kombëtare te Monitorimit Sizmik; 4. Ripërtëritja e stacioneve sizmologjike aktuale.	MIE, IGJEO	UPT	2023	2025	257.950.000	257.950.000
2	Përmirësimi, përditësimi dhe harmonizimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga tërmetet	1. Një studim i gjerë mbi vlerësimet moderne të riskut i cili përfshin një pasqyrë të situatës në vend dhe një strategji zbatimi. 2. Trajnime me ekspertë të fushës për Modelin Evropian të Riskut Sizmik për vlerësimin e riskut në nivel kombëtar dhe rajonal. 3. Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për përshtatjen e kornizave të institucioneve përgjegjëse për parandalimin, gatishmërinë dhe përgjigjen, të cilat përfshijnë rezultatet e vlerësimit të riskut me qëllim menaxhimin më të mirë të riskut nga tërmetet dhe zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.	MIE, IN, IGJEO, SHGJSH	UPT, AKMC	2023	2025	46.900.000	46.900.000
3	Baza e të dhënave të vetive strukturore të ndërtesave	1. Është krijuar një sistem për mbledhjen e të dhënave i cili përfshin analizën e bazave të të dhënave ekzistuese (kadastra, të dhënat nga procesi i legalizimit, arkivat), rregullimi i atributeve në vetitë e projektimit, modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, servera, cloud, etj.). 2. Janë përgatitur rekomandime për rinovimin e hartave sizmike, kodeve teknike të projektimit në përputhje me standardet e BE-së. 3. Kryerja e seminareve dhe trajnimeve (minimumi 3 në vit) të cilat përfshijnë dhe lidhin ekspertë të disponueshëm brenda sistemit (minimumi 100 ekspertë në të gjithë vendin). 4. Grumbullimi i atributeve të disponueshme për pasuritë e objekteve ndërtimore në qytetet kryesore të vendit ku risku i tërmeteve është i lartë.	MIE, IN, bashkitë, Institucionet e Prefektit të Qarkut	AKMC, MB	2023	2027	923.343.750	923.343.750
4	Përgatitja e kodeve të reja të ndërtimit sipas Eurokodit dhe e shtojcave kombëtare (UNDP RESEAL)	1.. Përgatitja e anekseve kombëtare, me fokus në Paketën 2.1 (ndërtesë prej betoni të armuar). 2. Përditësimi i Udhëzimeve Kombëtare për zbatimin e Eurokodit në Shqipëri. 3. Përgatitja e 4 grupeve të udhëzuesve projektues. 4. Mbështetja e trajnimeve rajonale të inxhinierëve në bashkëpunim me MIE-në, AKMC dhe Prefekturat.	MIE, IN, IGJEO	UNDP	2023	2024	101.371.000	
5	Ndërhyrje përforcuese dhe restauruese në objektet e trashëgimisë kulturore "Kalaja e Krujës"	1. Restaurimi i Kalasë së Krujës 2. Stabilizimi i shpatit të pjesës verilindore të Kalasë së Krujës	MK, IKTK	Donatorët	2023	2025	773.850.000	773.850.000
6	Masat për rehabilitimin e objekteve të trashëgimisë kulturore	1. Projektim arkitektonik dhe strukturor. 2. Restaurimi, përforcimi strukturor dhe përmirësimi i instalimeve. 3. Hartimi i planit të menaxhimit dhe biznesit.	Ministria e Kulturës, IKTK	UNOPS	2022	2024	473.490.675	

7	Ngritja e kapaciteteve për zbutjen e riskut sizmik në vendet e trashëgimisë kulturore nëpërmjet: - Trajnimit të mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimit të njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim; - Përpilimit të manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit; - Përmirësimit të normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit.	1. Trajnimi i mjeshtrave në fushën e restaurimit dhe transmetimi i njohurive mbi materialet dhe teknikat tradicionale në ndërtim. 1.1. Zhvillimi i Sesioneve Teorike për forcimin e njohurive mbi trashëgiminë kulturore (pjesë e modulit 6-mujor). 1.2. Sesione praktike ku njohuritë praktike do të forcohen në aplikim sipas specifikimeve të materialeve "gur""punime druri", "llaç" (pjesë e modulit 6-mujor). 2. Përpilimi i manualeve dhe udhëzuesve për tipologjitë tradicionale të ndërtimit 2.1. Ndarja e ekspertizës ndërkombëtare (2 ekspertë) dhe kombëtare (3 ekspertë). 2.2. Punëtori në terren që përfshin profesionistë dhe studentë të arkitekturës. 2.3. Publikime. 3. Përmirësimi i normave teknike të projektimit në fushën e restaurimit. 3.1. Ekspertizë ndërkombëtare (2 ekspertë) dhe kombëtare (2 ekspertë) 3.2. Punë me grupet teknike të institucioneve të specializuara.	MK, IKTK		2024	2026	87.937.500	87.937.500
8	Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të Forcave Operacionale ndaj tërmeteve nëpërmjet krijimit të një moduli të Kërkim Shpëtimit të Rëndë Urban (HUSAR).	1. Studimi për krijimin e një moduli të ri HUSAR. 2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të nevojshme për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO. 3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO si komunikimi me Grupin Këshillimor Ndërkombëtar të Kërkimit dhe Shpëtimit (INSARAG). 4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve trajnuese si dhe stërvitjes përfundimtare në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian. 5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit si dhe regjistrimit të tij në kapacitetin vullnetar të Kapacitetit të Përgjigjes Emergjente Evropiane (European Emergency Response Capacity/EERC) 6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për ngritjen e modulit si dhe pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij.	AKMC, MM	DP e MZSH	2023	2025	150.560.256	150.560.256
9	Hartimi i rregulloreve e dokumenteve teknike për vlerësimin dhe riaftësimin strukturor të veprave ndërtimore	1. Përditësimi i kornizës ligjore për vlerësimin dhe riaftësimin e veprave ekzistuese. 2. Hartimi i udhëzuesve të përdorimit për vlerësimin dhe riaftësimin e veprave ekzistuese. 3. Përgatitja dhe përhapja e materialeve trajnuese tek grupet e interesit	MIE, IN, UPT, AKMC	FIN, IN, Donatorë	2023	2025	293.125.000	293.125.000
	Totali: Tërmetet						3.108.528.181	2.533.666.506

3.Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribues	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë

				(nëse ka)				
1	Rritja e sigurisë së mbrojtjes nga përmbytjet e lumenjve, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të argjinaturave ekzistuese dhe ndërtimit të strukturave të reja	1. Kryerja e studimeve të fizibilitetit për të përmirësuar mbrojtjen nga përmbytjet 1.1. Aktualisht është kryer studimi i fizibilitetit të lumenjve Mat dhe lumenjve Drin e Bunë. 1.2. Është në proces studimi i fizibilitetit për lumenjtë Ishëm, Erzen, Shkumbin, Seman dhe Vjosë, i cili pritet të përfundojë në vitin 2023. 2. Kryerja e projekteve të zbatimit 2.1. Aktualisht është duke u zhvilluar projekti i plotë i zbatimit për lumin Mat 3. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në punimet e mbrojtjes nga përmbytjet 4. Rehabilitimi/Rikonstruksioni dhe ndërtimi i argjinaturave kundër përmbytjeve dhe strukturave mbrojtëse nga erozioni 5. Rritja e kapaciteteve operacionale, mirëmbajtjes dhe monitoruese të sigurisë së argjinaturave në strukturat përkatëse të MBZHR dhe Bashkive	MBZHR	Bashkitë	2019	2031	33.011.168.000	30.244.336.000
2	Rritja e sigurisë së digave të rezervuarëve të ujitjes, nëpërmjet rehabilitimit/rindërtimit të digave ekzistuese	1. Kryerja e studimit të fizibilitetit të 626 digave 1.1. Aktualisht përmes projektit të Bankës Botërore është kryer studimi i parafizibilitetit për 195 diga dhe ndërkohë në kuadër të fondeve të granteve të WBIF dhe BE-së, pritet të kryhet parafizibiliteti për 431 diga të tjera deri në fund të vitit 2024. 2. Kryerja e një studimi fizibiliteti 2.1. Me përfundimin e para fizibilitetit bazuar në analizën shumë-kritere do të prioritizohen digat që do të kalojnë në studimin e fizibilitetit. 3. Kryerja e projekteve të zbatimit për grupin prioritar të digave 4. Programimi buxhetor për ndërhyrjet strukturore në diga 5. Rehabilitimi/Rikonstruksioni i digave ekzistuese sipas prioritetit të përcaktuar 6. Ngritja/Konsolidimi dhe trajnimi i Grupeve të Sigurisë së Digave për çdo bashki. 7. Koordinimi i aktiviteteve për sigurinë e digave ndërmjet MBZHR-Bashkive-Komitetit Kombëtar të Digave të Mëdha	MBZHR	Bashkitë përkatëse dhe Institucionet e Prefektit të Qarkut	2019	2031	20.393.460.000	20.035.680.000
3	Vlerësimi i riskut nga përmbytjet dhe paralajmërimi i hershëm	1.Analiza Hidrologjike dhe Hidraulike 1.1. monitorimi i prurjeve, reshjeve, temperaturave, avullimit në territorin e Shqipërisë. 1.2. analiza e hidrologjike e prurjeve në lumenj 1.3. analiza hidraulike e përhapjes së plotave në lumenj. 2. Parashikimi i motit me një hapësire kohore 10 ditore 2.1. Anëtarësimi në Qendrën Evropiane për Parashikimin e Motit me interval mesatar ECMWF (European Centre for Medium-Range Weather Forecasts) 3. Parashikimi i Përmbytjeve në lumin Vjosa 3.1. Ndërtimi i një modeli hidrologjik për parashikimin e përmbytjeve.	IGJEO		2022	2031	140.700.000	140.700.000

4	Vlerësimi i riskut nga thatësira	1. Ndërtimi i një modeli për analizën e bilancit ujor në lumin Seman 1.1. Nëpërmjet këtij projekt synohet ndërtimi i një modeli që do të bëjë një analizë të detajuar të kapacitetit dhe shfrytëzimit të ujit në basen. Gjithashtu do të jetë e mundur të menaxhohet sasia e ujit për të shmangur ose minimizuar thatësirat. 2. Analiza e transportit të sedimentit në lumin Seman 2.1. Nëpërmjet këtij projekti synohet vlerësimi i sedimenteve që transporton lumi Seman. Ndërtimi i një modeli i cili i analizon ato në varësi të reshjeve, llojit të terrenit, përdorimit të tokës, etj.	IGJEO, MBZHR		2022	2031	58.625.000	58.625.000
5	Zbutja, zvogëlimi i pasojave të mundshme negative të përmbytjeve	Hartimi i Planeve të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet për basenet ujore: Vjosë, Seman, Shkumbin, Ishëm dhe Erzen; Aktualisht: • Ka përfunduar drafti përfundimtar i Planit të Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet për qarkun e Shkodrës (Baseni i Drinit). Parashikuar të miratohet në fund të vitit 2022; • Janë hartuar raportet e vlerësimit paraprak dhe hartat e rrezikut nga përmbytjet për basenet e Ishmit, Erzenit, Shkumbinit, Semanit dhe Vjosës. • Janë në proces Hartat e dëmeve dhe dokumenti i Planeve të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjeve për këto basene ujore. Parashikuar të përfundojë në vitin 2023.	MBZHR, AMBU		2021	2024	234.500.000	
6	Menaxhimi i integruar ndërkufitar i riskut nga përmbytjet në basenin e lumit Drin	1. Rishikimi i procedurave të mbledhjes së të dhënave dhe cilësisë së tyre; 2. Vlerësimi i kërkesave të rrjetit monitorues për menaxhimin strategjik të riskut nga përmbytjet; 3. Vlerësimi i kapaciteteve institucionale për monitorimin e rrjetit hidrometrik; 4. Plani operacional për procedurat e raportimit; 5. Vlerësimi i kapaciteteve të institucioneve përkatëse për zhvillimin e një plani afatgjatë të zhvillimit të kapaciteteve dhe nevojave për trajnim. 6. Përpilimi i një listë opsionesh për të identifikuar më të favorshmit ekonomikisht për basenin.	MBZHR, AMBU	UNDP	2019	2024	76.605.468	
7	Rritja e sigurisë së objekteve të trashëgimisë kulturore ndaj riskut të përmbytjeve - "Restaurimi dhe ndërtimi i sistemit të mbrojtjes nga përmbytjet të Xhamisë së Plumbit (Mehmet Paşe Bushatlliu) në Shkodër"	1. Restaurimi i Xhamisë së Plumbit 2. Ndërtimi i sistemit të pilotave për mbrojtjen nga përmbytjet	MK, IKTK	Qeveria Turke	2023	2024	469.000.000	

8	Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj përmbytjeve duke plotësuar modulet ekzistuese FRB dhe FC të BE-së për përmbytjet	1. Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale të 1/3 moduleve kombëtare dhe ndërkombëtare të krijuara përmes programit IPA Floods si më poshtë: 1.1. "Shpëtimi nga përmbytjet me varka"/ (Flood Rescue with Boats/FRB) 1.2. Mbrojtja nga Përmbytjet / (Flood Containment/ FC) 2. Kryerja e të gjitha procedurave të nevojshme kombëtare të kërkuara për miratimin dhe fillimin e komunikimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO 3. Kryerja e aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO 4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, të aktiviteteve të trajnimit dhe të stërvitjes përfundimtare në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian 5. Kryerja e procesit të certifikimit të moduleve të plota FRB dhe FC si dhe regjistrimi i tyre në EERC 6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për ngritjen e moduleve si pagesat e tjera vjetore të funksionimit dhe operimit të tij	AKMC	MM, MB, PSH	2023	2026	306.568.416	306.568.416
9	Përmirësimi i Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet	1. Studimet e fizibilitetit dhe projektimi i mbrojtjes strukturore dhe jostrukturore nga përmbytjet, me prioritet zgjidhjet e bazuara në natyrë 2. Punime ndërtimi/rehabilitimi 3. Planifikimi i mirëmbajtjes dhe prokurimi i pajisjeve të nevojshme 4. Trajnime	MBZHR, AMBU	AKMC, BB	2024	2027	4.770.400.000	4.770.400.000
	Totali: Përmbytjet, vërshimet e ujit dhe çarjet e digave						59.461.026.884	55.556.309.416

4. Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë
1	Masa përforcuese në objektet e trashëgimisë kulturore - Menaxhimi i sitit, Plani Interpretimi, Projektimi dhe mbikëqyrja e punimeve në Kalanë e Kaninës, Kalanë e Borshit dhe Shpellën e Spilesë, Himarë. Ndërhyrje strukturore për përforcimin e shpateve shkëmbore të Kalasë së Borshit dhe Kalasë së Kaninës.	1. Projektim/mbikëqyrje punimesh 2. Punimet restauruese dhe interpretimi i Kalasë së Kaninës, Kalasë së Borshit, Shpellës së Spilesë 3. Përforcimi i shpatit shkëmbor të kalasë së Kaninës 4. Përforcimi i shpatit shkëmbor të kalasë së Borshit	MK, IKTK	SHGJSH, FSHZH dhe BB	2023	2025	333.928.000	

2	Identifikimi i rrëshqitjeve të tokës në të gjithë territorin e vendit, bazuar në kritere të standardizuara dhe pasqyrimi i tyre në një hartë të vetme, si dhe krijimi i një inventari kombëtar për rrëshqitjet, i cili përmban të gjitha të dhënat e tyre. Monitorimi i rrëshqitjeve më të fuqishme dhe më të rrezikshme për komunitetin	1. Është përgatitur baza e nevojshme për identifikimin dhe vlerësimin modern të riskut nga dukuritë negative gjeodinamike, e cila përfshin një pasqyrë të situatës në vend dhe shërben për strategjinë e ardhshme të perfeksionimit si të performancës aktuale, ashtu edhe të vazhdimësisë. 2. Përgatitja e propozimeve për ndryshime në legjislacion dhe përgatitja e rregulloreve, të cilat përfshijnë zbatimin e këtyre studimeve në planifikimin urban në të gjithë territorin e Republikës.	MIE, SHGJSH		2023	Vazhdim	11.725.000	11.725.000
3	Rajonizimi gjeologo-inxhinierik në shkallën 1: 10 000, për planifikimin urban në zonat më të populluara të vendit, si dhe në zonat me premisë për zhvillime turistike.	1. Është gati baza e nevojshme e studimeve të kryera më parë nga ShGjSh, të cilat do të shërbenin si bazë për realizimin e këtyre rajonizimeve gjeologo-inxhinierike. Mbetet organizimi dhe grumbullimi i të dhënave në terren nëpërmjet rilevimeve në shkallët përkatëse për të hartuar hartat përkatëse të rajonizimit në shkallën e planifikuar. 2. Hartimi i propozimeve për ndryshime legjislative dhe parapërgatitja e rregulloreve, të cilat përfshijnë zbatimin e këtyre studimeve në planifikimet urbane në të gjithë territorin e vendits.	MIE, SHGJSH		2022	Vazhdim	17.587.500	17.587.500
	Totali: Rrëshqitjet e tokës, reshjet e dëborës dhe ortekët						363.240.500	29.312.500

5. Zjarret në Pyje

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëseka)	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë
1	Forcimi i kapaciteteve për mbrojtjen nga zjarri dhe përmbytjet në kuadër të forcimit të kapaciteteve të shërbimeve homologe të rajonit të Ballkanit (Shqipëri, Bosnje dhe Hercegovinë, Kosovë, Mali i Zi, Maqedoni e Veriut, Serbi dhe Turqi)	Komponenti 1: Përmbytjet Hartimi i një Udhëzuesi për Planin e Menaxhimit të Riskut nga Përmbytjet (FRMP) në përputhje me masat e renditura në Udhëzimin për zbatimin e Direktivës së Përmbytjes së BE-së. Vlerësimi i kapaciteteve ekzistuese për planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja / FRMP-të dhe planet e menaxhimit të baseneve lumore (RBMP). 1.1 Ndërtimi i kapaciteteve për planet e menaxhimit të riskut nga përmbytja (FRMP) bazuar në praktikat e mira të Shteteve Anëtare të BE-së dhe Direktivën e Përmbytjes së Bashkimit Evropian (EUFD). 1.2 Ndërtimi i kapaciteteve për zhvillimin e planeve të përbashkëta ndërkufitare.të menaxhimit të riskut nga përmbytja 1.3 Zhvillimi i procedurave dhe marrëveshjeve për përfshirjen rishtas të sistemeve të paralajmërimit të hershëm (EW) në planet lokale/qendrore të përgjigjes ndaj emergjencave (ERP). 1.4 Harmonizimi i Planit të Menaxhimit të Riskut të Përmbytjes me Planin e Menaxhimit të Basenit Lumor. 1.5 Hartimi i procedurave specifike për zhvillimin e FRMP dhe harmonizimin me	AKMC	Strukturat e MZSH-së në nivel vendor dhe qendror	2023	2026	117.250.000	

		RBMP. Komponenti 2: Zjarret në pyje 2.1 Sigurimi i mbështetjes teknike për zhvillimin e Vlerësimeve të Riskut nga Zjarri në Pyje dhe aftësive të menaxhimit të riskut nga zjarri në pyje. 2.2 Ngritja, Pajisja, Trajnimi i Moduleve të Mbrojtjes Civile të Shuarjes së zjarrit nga toka (GFFF) në përputhje me Vendimin e Komisionit për Modulet e Mbrojtjes Civile të BE-së. 2.3 Krijimi i protokolleve të Kalimit Kufitar (BC) dhe Mbështetjes së Vendit Pritës (HNS) në përputhje me Udhëzimet e BE-së për Mbështetjen e Vendit Pritës (HNS). 2.4 Organizimi i ushtrimeve rajonale në tavolinë (TTX) dhe një stërvitjeje fushore (FX) për modulet GFFF.						
2	Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e riskut nga zjarri në territor	1. Një studim i gjerë mbi vlerësimet moderne të riskut i cili përfshin një pasqyrë të situatës në Shqipëri dhe një strategji zbatimi për përditësimet e hartave të riskut të Shqipërisë që do të përfshijnë zjarret masive ne pyje. 2. Workshop për transferimin e njohurive me ekspertë ndërkombëtarë (minimum 5) dhe kombëtarë (minimum 50) mbi modelin evropian të menaxhimit të riskut nga masive në pyje në nivel kombëtar dhe/ose lokal; 3. Analiza dhe vlerësimi i kuadrit rregullator për zbatimin e rezultateve të vlerësimit të riskut në të gjitha nivelet me synimin e menaxhimit cilësor të riskut nga zjarret masive në pyje.	MTM, IGJEO	AKMC, DP e MZSH	2023	2025	46.900.000	46.900.000
3	Zhvillimi i metodologjisë për planet e menaxhimit të zjarrit në nivel vendor	1. Ngritja e një grupi pune ndërinstitucional për përgatitjen e metodologjisë. 2. Studimi i bazës ligjore mbështetëse dhe eksplorimi i nevojave për ndryshim. 3. Përgatitja e metodologjisë dhe drafteve paraprake të ndjekura nga diskutimi me palët e interesuara. 4. Përshtatja dhe miratimi i metodologjisë.	Bashkitë, AKZM dhe MTM	AKMC, DP e MZSH	2023	2024	1.407.000	1.407.000
4	Studim mbi nevojat për ngritjen e sistemit të sinjalizimit dhe të vëzhgimit	1. Studimi i zonave pyjore me risk të lartë nga zjarri në Shqipëri. 2. Studimi i nevojave të kapaciteteve njerëzore në lidhje me sistemin e vrojtim - sinjalizimit në nivel kombëtar. 3. Studimi i kostove dhe burimeve financiare të nevojshme për ngritjen dhe funksionimin e shërbimit të vrojtim-sinjalizimit.	MTM, AKZM dhe bashkitë	AKMC, DP e MZSH	2023	2025	2.110.500	2.110.500
5	Forcimi i kapaciteteve të përgjigjes të forcave operacionale ndaj zjarreve në pyje përmes modulit "Luftimi nga Toka i Zjarrit në Pyje" të BE-së	1. Kryerja e një studimi mbi situatën aktuale të modulit të pjesshëm kombëtar dhe ndërkombëtare të luftimit nga toka të zjarrit në pyje (GFFF) të krijuar përmes programit IPA FF për përmbytjet dhe zjarret në pyje. 2. Zbatimi i procedurave të nevojshme kombëtare të kërkuara për miratimin dhe fillimin e komunikimit me KE dhe DG ECHO. 3. Zbatimi i aktiviteteve të nevojshme të komunikimit dhe koordinimit me Komisionin Evropian dhe DG ECHO. 4. Kryerja, në bashkëpunim me Komisionin Evropian dhe DG ECHO, e aktiviteteve të trajnimit dhe stërvitjes përfundimtare, në prani të autoriteteve të Komisionit Evropian. 5. Kryerja e procesit të certifikimit të modulit të plotë GFFF si dhe regjistrimi i tij në Kapacitetin Evropian të Përgjigjes EERC. 6. Planifikimi i buxhetit dhe kryerja e të gjitha pagesave të nevojshme për krijimin e modulit sikurse pagesave të tjera vjetore të funksionalitetit dhe operimit të tij.	AKMC, DP e MZSH	MM	2024	2027	207.684.925	207.684.925

6	Forcimi i kapaciteteve operacionale për shuarjen e zjarreve nga ajri	1. Kryerja e një studimi mbi nevojat për zgjerimin dhe forcimin e kapaciteteve të zjarrfikësve ajrorë shqiptarë që konsistojnë në dy avionë nëpërmjet kredisë nga Republika e Italisë (Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim) duke shqyrtuar nëse nevojitet një avion/helikopter tjetër. 2. Blerja e një avioni shtesë me kapacitet 3000 litra, të përshtatshëm për furnizim me ujë edhe në depozita të vogla dhe/ose helikopteri bazuar në përfundimet e studimit. 3. Planifikimi i buxhetit vjetor të AKMC-së duke pasur parasysh edhe fondet e nevojshme për marrjen me qira të mjeteve zjarrfikëse kombëtare/ndërkombëtare tokësore apo ajrore. 4. Planifikimi buxhetor i burimeve financiare për funksionimin dhe funksionalitetin e flotës ajrore zjarrfikëse.	AKMC	MM	2023	2026	351.750.000	351.750.000
7	Forcimi i kapaciteteve teknike të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit	1. Vlerësimi i vendndodhjeve, funksionalitetit dhe sigurisë së stacioneve ekzistuese të MZSH-së në bashki. 2. Bazuar në konkluzionet e vlerësimit hartimi i projekteve të zbatimit për ndërtimin/rikonstruksionin e disa stacioneve më prioritare; 3. Ndërtimi dhe rindërtimi i stacioneve të projektuara; 4. Krijimi i Qendrës së re Kombëtare Operacionale të MZSH-së.	AKMC, DP e MZSH		2023	2026	257.950.000	257.950.000
	Totali: Zjarret në pyje						985.052.425	867.802.425

6. Aksidentet teknologjike

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëse ka)	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë
1	Ngritja e një laboratori për matjen e Radonit	1. Është kryer një konsultim me ekspertë të fushës në lidhje me pajisjet e nevojshme për matjet afatshkurtra e afatgjata në tokë, ujë dhe ajër me qëllim ngritjen e një laboratori me pajisje profesionale që mundësojnë matjen e përqendrimit të radonit, kryesisht në zona që paraqesin rrezikshmëri nga pikëpamja gjeologjike dhe strukturore me një vëmendje të veçantë ndaj objekteve publike apo ndaj zonave të populluara. 2. Për këtë qellim duhet kryer vendosja e sensorëve në çerdhe, kopshte e shkolla, apo struktura të tjera publike, kryesisht në katet përdhese, bodrume, garazhe Në harmonizim me kornizat ligjore të BE të hartohen propozime për ndryshime legjislacioni në lidhje me kontrollin e banesave publike e private, veçanërisht katet përdhese, garazhe në ato zona që paraqesin rrezik.	IGJEO, UPT, ISHP, IFBZ		2023	2025	18.760.000	18.760.000

2	Zgjerimi i rrjetit për monitorimin e radioaktivitetit	1. Është krijuar një rrjet për mbledhjen e të dhënave në shtatë stacione, që përcaktojnë fuqinë e dozës së ambientit në ajër, në mënyrë të vazhdueshme. 2. Rrjeti i monitorimit të radioaktivitetit i lidhur me sistemin e Emergjencave Radiologjike do të përmirësohet dhe forcohet me 4 stacione të reja. 3. Të katër stacionet e rrjetit monitorues do të depozitojnë të dhëna në një sistem të vetëm IT (server) të vendosur në IFBZ – UT. 4. Analiza e bazave të të dhënave dhe modelimi i të dhënave bazë të saj (aplikacione, server, cloud, etj.) do të realizohet nga IFBZ-UT.	MIE, IGJEO, AKB, IFBZ dhe MM		2023	2024		
3	Krijimi i një baze të dhënash për llogaritjen, menaxhimin dhe parandalimin e risqeve teknike dhe teknologjike, sipas sektorëve	1. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, rafineritë e përpunimit të naftës bruto, gazsjellësit dhe naftësjellësit;; 2. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në objektet e sektorit minerar, impiantet e përpunimit të produkteve hidrokarbure, modelimin e bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.). 3. Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave për praninë e risqeve teknike dhe teknologjike në sistemin e digave dhe rezervuarëve; 4. Modelimi i bazës së të dhënave (aplikacione, serverë, cloud, etj.).	MIE,MTM	Ministri të tjera të linjës	2023	2030	35.175.000	35.175.000
	Totali: Aksidentet teknologjike						53.935.000	53.935.000

7. Sëmundjet Infektive

Nr.	Objektivi specifik	Masat/aktivitetet	Institucionet përgjegjëse		Afati		Kosto	Boshllëku financiar
			Institucioni përgjegjës (Udhëheqës)	Institucion kontribuues (nëseka)	Koha e fillimit	Koha e mbarimit	Lekë	Lekë
1	Metodologjia e zhvillimit për vlerësimin e riskut biologjik	1. Përmirësimi i infrastrukturës së laboratorëve. 2. Pajisje dhe makineri për laboratorët.	AKU		2023	2025	278.175.625	278.175.625
2	Zbatimi i regjimit të biosigurisë dhe biosigurimit nëpërmjet një rrjeti efektiv kombëtar laboratorik	Objektivi 1: Vlerësimi i shkallës së përgatitjes dhe zbatimit të udhëzimeve dhe/ose rregulloreve për biosigurinë dhe biosigurimin laboratorik shëndetësor kombëtar në laboratorët shëndetësore, veterinare, sigurinë ushqimore dhe mjedisore në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal. Objektivi 2: Adresimi i mangësive në udhëzimet dhe/ose rregulloret e biosigurisë dhe biosigurimit dhe rishikimi i tyre në nivel kombëtar, të ndërmjetëm dhe lokal. Objektivi 3: Krijimi i një sistemi për mbikëqyrjen e zbatimit të një regjimi të biosigurisë dhe të biosigurimit shëndetësor dhe testimi i vazhdueshëm i tij	ISHP	OSHKSH, NJVKSH, ISUV, AKU etj.	1/1/2023	15/11/2023	11.926.000	11.926.000

3	Krijimi i një Qendre Operacionale Emergjente të Shëndetit Publik në Institutin e Shëndetit Publik	Një PHEOC funksionale është kritike për zbatimin e Rregulloreve Ndërkombëtare të Shëndetit (IHR 2005). Hapi 1: Krijimi rregulloreve, standardeve kombëtare dhe procedurave operacionale për PHEOC; Hapi 2. Sigurimi i infrastrukturës dhe pajisjeve të duhura për PHEOC; sigurimi pajisjeve dhe sistemeve; Hapi 3: Krijimi i sistemit të survejancës së emergjencave në shëndet publik dhe alertit të tyre; Përditësim i sistemit të survejancës së sëmundjeve infektive (përfshirë dhe modelin e biosigurisë së risqeve biologjike) Hapi 4: Krijimi i kapaciteteve njerëzore kombëtare për një PHEOC funksionale duke u trajnuar dhe duke ushtruar. Hapi 5: Krijimi i kapaciteteve kombëtare për vlerësimin analitik të riskut, parashikimin dhe zvogëlimin e riskut.	ISHP dhe MSHMS	OSHKSH, NJVKSH, ISUV, AKU etj.	19/1/2022	15/12/2024	83.482.000	83.482.000
4	Krijimi i kurrikulës dhe certifikatës për trajnimin kombëtar për biosigurinë dhe biosigurimin	Hapi 1: Përgatitja e një kurrikule shëndetësore mbi biosigurinë dhe biosigurimin Hapi 2: Krijimi i një programi bazë dhe një kaskadë të vazhdueshme trajnimi të një kurrikule të shëndetit të njësuar mbi biosigurinë dhe biosigurimin. Hapi 3: Fuqizimi i kapaciteteve humane të tanishme të laboratorëve shëndetësorë duke i ofruar trajnim të vazhdueshëm kaskadë.	ISHP, MSHMS	QKCSAISH, OSHKSH, NJVKSH, ISUV, AKU dhe AKM.	10/11/2022	10/11/2024	23.852.000	23.852.000
	Totali: Sëmundjet Infektive						397.435.625	397.435.625
	TOTALI i 7 grupeve						93.036.641.493	77.586.636.450

Shtojca 4. Partneriteti me organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe marrëveshjet përkatëse

Shqipëria është anëtare e:

- OKB-së;
- Këshillit të Evropës (KE);
- Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE);
- Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut (NATO);
- Agjencisë Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (IAEA).
- Organizatës Botërore të Shëndetësisë (OBSH);
- Organizatës Botërore të Meteorologjisë (OBM);
- Sistemit Evropian të Ndërgjegjësimit ndaj Përmbytjeve (European Flood Awareness System/EFAS)
- Sistemit Evropian të Informacionit për Zjarrin Pyjor (European Forest Fire Information System /EFFIS)
- Qendrës së Menaxhimit të Thatësirave të Evropës Jug - Lindore (DMCSEE).
- EUR-OPA, Marrëveshja e Rreziqeve të Mëdha;
- Komisionit Ndërqeveritar Oqeanografik (Intergovernmental Oceanographic Commission/IOC);
- Shërbimi Gjeologjik Shqiptar është anëtar me të drejta të plota i Shërbimit Gjeologjik Evropian që nga 1.01.2015 sikurse është anëtar i Konsorciumit Ndërkombëtar të Rrëshqitjeve që nga viti 2011.

Marrëveshje dhe memorandume shumëpalëshe në fuqi janë:

- Memorandumi i Mirëkuptimit, për Kuadrin Institucional të Iniciativës për Gatishmërinë, dhe Parandalimin e Katastrofave për Evropën Juglindore (DPPI SEE) miratuar me VKM nr. 1013, datë 22.11.2013. Memorandumi është nënshkruar nga pala shqiptare në 28.11.2013 dhe ka hyrë në fuqi në 12.11.2014;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Bosnjë dhe Hercegovinës dhe qeverive të vendeve të tjera anëtare të Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të fatkeqësive për Evropën Juglindore mbi marrëveshjet e vendit pritës për Sekretariatin e Iniciativës së Gatishmërisë dhe Parandalimit të Fatkeqësive për Evropën Juglindore nënshkruar nga Shqipëria në 20.09.2018;
- Marrëveshja ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) mbi bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në fushën e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut", miratuar me Ligjin nr.10 372, datë 10.2.2011;
- Memorandumi i Mirëkuptimit për menaxhimin e basenit të zgjeruar ndërkufitar të Drinit i nënshkruar nga Ministrat e ministrive kompetente të Menaxhimit të Ujit dhe Mjedisit të vendeve që përshkohen nga Drini, d.m.th. Shqipëria, Maqedonia e Veriut (ish -Republika Jugosllave e Maqedonisë), Greqia, Kosova dhe Mali i zi.
- Protokolli mbi bashkëpunimin shumëpalësh në shkëmbimin e të dhënave sizmike ndërmjet institucioneve: Departamenti i Gjeofizikës, Fakulteti i Shkencave, Universiteti i Zagrebit, Kroaci; Shërbimi Federal Hidrometeorologjik, Qendra e Sizmologjisë Sarajevë, Shërbimi Hidrometeorologjik i Republikës SRPSKA - Sektori për Sizmologji, Banja Luka dhe Ministria e Çështjeve Civile të Qeverisë Federale të Bosnjës dhe Hercegovinës; Instituti i Gjeoshkencave, Universiteti Politeknik i Tiranës, Shqipëri; Observatori Sizmologjik i Malit të Zi; Observatori Sizmologjik, Fakulteti i Shkencave Natyrore, Universiteti "SS. Cyril dhe Metodius" Shkup, Maqedonia e Veriut dhe Shërbimi Sizmologjik i Serbisë;

Marrëveshje dhe memorandumet dypalëshe në fuqi janë:

- Marrëveshja ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Ministrisë së Rendit Publik të Republikës së Greqisë, e datës 27.05.2006, "Për bashkëpunimin ndërmjet shërbimeve zjarrfikëse të tyre dhe kompetencave që kanë ata në këtë fushë".
- Marrëveshja ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Republikës së Austrisë e datës 27.01.2010, "Mbi ndihmën e ndërsjellët në rast të katastrofave ose të fatkeqësive të mëdha", nënshkruar më 27.1.2010, hyrë në fuqi në 1.7.2011;
- Marrëveshja e datës 7.10.2011, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Kroacisë "Për ndihmë reciproke në rast të fatkeqësive dhe aksidenteve të mëdha". nënshkruar më 7.10.2011, hyrë në fuqi në 28.9.2012;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës, "për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë, në raste të fatkeqësive natyrore dhe të fatkeqësive të tjera", nënshkruar në 2.10.2020;
- Marrëveshja operacionale e bashkëveprimit në fushën e Mbrojtjes Civile e nënshkruar në 28.10.2021 në kuadër të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës së Kosovës.
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Malit të Zi "për bashkëpunim dhe ndihmë të ndërsjellë në emergjenca" nënshkruar në 3.7.2018, hyrë në fuqi në 22.11.2018;
- Memorandumi i mirëkuptimit për bashkëpunimin në fushën e mbrojtjes nga fatkeqësitë natyrore dhe ato teknologjike ndërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile në Ministrinë e Brendshme të Republikës së Shqipërisë dhe Drejtorisë Kombëtare të Mbrojtjes dhe Shpëtimit të Republikës së Kroacisë, nënshkruar më 23.2.2010, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Ministrisë së Punëve të Brendshme të Republikës së Shqipërisë, Drejtorisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit dhe Ministrisë së Brendshme të Republikës Çeke, Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit për Mbrojtjen nga Zjarri, mbi bashkëpunimin në fushat e parapërgatitjes dhe zbutjes ndaj fatkeqësive, nënshkruar më 13.10.2015, hyrë në fuqi datën e nënshkrimit;
- Memorandumi i mirëkuptimit ndërmjet Qeverisë së Republikës se Shqipërisë dhe Qeverisë se Republikës se Italisë për bashkëpunimin në veprimet e kërkim shpëtimit në detin Adriatik miratuar me VKM nr. 671 datë 7.12.2001;
- Memorandumi i Mirëkuptimit, "Për Lehtësimin e Transportit Civil Jetësor Ndërkufitar" i ratifikuar me Ligjin nr. 9805 datë 17.9.2007;
- Protokolli "Mbi shkëmbimin në kohë reale të të dhënave sizmologjike" ndërmjet Republikës së Turqisë, Presidenca e Menaxhimit të Fatkeqësive dhe Emergjencave dhe Universitetit Politeknik të Tiranës", të nënshkruar në 1.03.2018.
- Memorandumi i Bashkëpunimit mes Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Shërbimit Gjeologjik të Republikës së Maqedonisë së Veriut të nënshkruar në 14.06.2017;
- Memorandum i Bashkëpunimit mes Shërbimit Gjeologjik Shqiptar dhe Shërbimit Gjeologjik të Kosovës nënshkruar në 12.12.2016;

Marrëveshje në proces janë;

- Marrëveshja ndërmjet Bashkimit Evropian, njëra palë dhe Republikës së Shqipërisë, pala tjetër, për pjesëmarrjen e Shqipërisë në Mekanizmin e Mbrojtjes Civile të Bashkimit;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Maqedonisë "Mbi bashkëpunimin në rast fatkeqësish" miratuar në parim me VKM nr. Nr. 659 , datë 29.7.2015;
- Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Azerbajxhanit mbi bashkëpunimin dhe ndihmën e

ndërsjellë në fushën e parandalimit dhe eliminimit të pasojave të fatkeqësive natyrore dhe aksidenteve të shkaktuara nga dora e njeriut;

- Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Autoritetit të Menaxhimit të Fatkeqësive, Ministria e Brendshme, Republika e Turqisë, dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile, Ministria e Mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë mbi Menaxhimin e Fatkeqësive dhe Emergjencës.

Organizata dhe institucione, partnere të sistemit të MC në Shqipëri janë:

- UNDP;
- Komisioni Evropian (European Commission/EC);
- Banka Botërore (World Bank/WB);
- NATO;
- Agjencia e SHBA për Zhvillim Ndërkombëtar (U.S. Agency for International Development/USAID);
- Organizata e Ushqimit dhe Bujqësisë (Food and Agriculture Organization/FAO);
- Organizata e Kombeve të Bashkuara për Edukim, Shkencë dhe Kulturë (United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization/UNESCO);
- Organizata Botërore e Shëndetësisë (World Health Organization/WHO);
- Organizata Botërore e Meteorologjisë/OBM (World Meteorological Organization/WMO);
- Agjencia Ndërkombëtare për Energjinë Atomike (International Atomic Energy Agency/IAEA);
- Programi Botëror i Ushqimit (World Food Programme/WFP)
- Fondi i Kombeve të Bashkuara për Fëmijët (United Nations Children's Fund (UNICEF);
- Komisioneri i Lartë i Kombeve të Bashkuara për Refugjatët (United Nations High Commissioner for Refugees/UNHCR);
- OSBE;
- World Vision (WV);
- Save the children;
- Organizata Ndërkombëtare për Migrimin (International Organization for Migrants/IOM);
- Federata ndërkombëtare e Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (International Federation for Red Cross and Red Cressent/IFRC);
- Agjencia Italiane për Bashkëpunim dhe Zhvillim/AICS;
- GIZ;
- JICA;
- Agjencia e Bashkëpunimit dhe Koordinimit Turk – TiKA;
- Ambasadat e SHBA, Zvicrës, Portugalisë, Suedisë, Turqisë, Holandës

Shtojca 5. Grupi teknik ndërinstitucional i punës. Rolet, përgjegjësitë dhe baza ligjore të ministrive kryesore dhe agjencive të përfshira në çështjet e menaxhimit të riskut të fatkeqësive dhe mbrojtjes civile në vend

GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK)				GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS
Nr.	**Institucioni**	**Personi përfaqësues**	**Funksioni**	**Personi përfaqësues**
1	Ministria e Mbrojtjes	Dallëndyshe Bici	Zëvendësministër i Mbrojtjes	
2	Ministria e Brendshme	Romina Kuko	Zëvendësministër i Brendshëm	Anastas Meçi
3	Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme	Megi Fino	Zëvendësministër për Evropën dhe Punët e Jashtme	Klea Doko
4	Ministria e Financave dhe Ekonomisë	Adela Xhemali	Zëvendësministër i Financave dhe Ekonomisë	Ismet Lala Iris Gjishti Valion Cenalia
5	Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë	Ilir Bejtja Enkelejda Muça	Zëvendësministër i Infrastrukturës dhe Energjisë	Artur Pilkati
6	Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural	Dhimitër Kote	Zëvendësministër i Bujqësisë dhe i Zhvillimit Rural.	Arben Mukaj Sivi Gode
7	Ministria e Arsimit dhe Sportit	Nina Guga	Zëvendësministër i Arsimit dhe Sportit.	Jetlir Gjergji Shkelqim Akllaj Griselda Sulaj Besfort Goxhi Eglantina Killo Edlira Nastimi
8	Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Vjollca Braho	Zëvendësministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	Silva Bino
9	Ministria e Turizmit dhe Mjedisit	Ornela Çuçi	Zëvendësministër i Turizmit dhe Mjedisit	Admir Seci Josif Tashulla Ylli Hoxha

GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK)				GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS
10	Ministria e Drejtësisë	Klajd Karameta	Zëvendësministër i Drejtësisë	Arber Sanxhaku
				Erjon Ndreca
11	Ministria e Kulturës	Meri Kumbe	Zëvendësministër i Kulturës	Kozeta Angjeliu
				Klodiana Gjata
				Teodor Droboniku
				Marsela Demaj
				Regi Cibaku
12	Ministri i Shtetit për Rindërtimin	Alda Klosi	Këshilltare, Përfaqësues i Kabinetit të Ministrit të Shtetit për Rindërtimin	Darien Mero
13	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Haki Çako	Drejtor i Përgjithshëm i AKMC-së	
14	Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore	Gerta Lubonja	Drejtor i Përgjithshëm	Margarita Lutaj
15	Instituti i Gjeoshkencave	Ylber Muceku	Drejtor i Përgjithshëm	Gjon Rrota
16	Shërbimi Gjeologjik Shqiptar	Viktor Doda	Drejtor i Përgjithshëm	Mehmet Kënga
17	Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit	Adelina Greca	Drejtor i Përgjithshëm	Nensi Lalaj
18	Instituti i Shëndetit Publik	Eugena Tomini	Drejtori i Përgjithshëm	Silva Bino
19	Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës (SASPAC)	Ilir Beqja	Drejtori i Përgjithshëm	Robert Ceco
20	Universiteti i Mjekësisë Tiranë	Prof. Dr. Arben Gjata	**Rektor**	Prof. Asoc. Edmond Zaimi
21	Universiteti Bujqësor i Tiranës	Prof. Dr. Fatbardh Sallaku	**Rektor**	Romina Koto
				Alban Ibraliu
22	Universiteti i Tiranës	Prof. Dr. Artan Hoxha	**Rektor**	Dr. Elona Pojani
				Dr. Fjorda Shqarri
				Prof. Dr. Fatos Ylli
Institucionet e tjera				

GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK)				GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS
23	Agjencia Kombëtare e Mjedisit	Arta Dollani	Drejtor i Përgjithshëm	Arta Kodra
24	Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura	Daniel Pirushi	Drejtor i Përgjithshëm	Holta Copani Kasem Uzuni
25	Kryqi i Kuq Shqiptar	Ylli Alushi	Presidenti i KKSH	Fatos Xhengo
26	Komiteti Kombëtar i Digave të Mëdha	Arjan Jovani	Kryetar i KKDM	Ermal Kacurri
27	Agjencia Kombëtare e Pyjeve	Artur Kala	Drejtor i Përgjithshëm	Behar Hate
28	Autoriteti Kombëtar i Sigurisë dhe Emergjencave në Miniera	Mimoza Hajdarmataj	Drejtor i Përgjithshëm	Muharrem Hida
29	Instituti i Fizikës Bërthamore të Zbatuar	Brunilda Daci	Drejtor i Përgjithshëm	Dritan Prifti
30	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit	Jeta Deda	Drejtor i Përgjithshëm	Edlira Dibra
Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile				
31	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Adisa Bala	Drejtor i Drejtorisë së Zvogëlimit të Riskut dhe Fatkeqësive dhe të Parandalimit	
32	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Robert Hysenllari	Drejtor i Drejtorisë së Gatishmërisë dhe Koordinimit të Përgjigjes Emergjente	
33	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Klajdi Nikolla	Drejtor i Drejtorisë së Bashkëpunimit Ndërkombëtar dhe Projekteve	

GRUPI NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS (NIVELI POLITIK)				GRUPI TEKNIK NDËRINSTITUCIONAL I PUNËS
34	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Jonian Harka	Drejtor i Drejtorisë së Edukimit, Trajnimit dhe Teknologjisë së Informacionit	
Sekretariati Teknik				
35	Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile	Malvina Shira	Specialist	
		Andi Pogaci		
		Ambra Fusha		
Autorë dhe Kontribues				
36	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP) në Shqipëri	Elvita Kabashi	Drejtuese e Departamentit te Mjedisit, Ndryshimit të Klimës dhe të Energjisë	
		Doreid Petoshati	Koordinator Kombëtar i Projektit RESEAL	
		Gentjan Dema	Asistent Financiar dhe Administrativ i Projektit RESEAL	
37	Konsulenca ABKONS shpk, pjesë e projektit RESEAL të UNDP në Shqipëri	Krunoslav Katic	Drejtues i Ekipit të konsulentëve	
38		Josif Gjani	Konsulent Strategjie	
39		Blerina Kurti	Menaxhere Projekti	
40		Maksimiljan Dhima	Konsulent kombëtar	
41		Natasa Holcinger	Konsulente ndërkombëtare	
42		Vlatko Jovanovski	Konsulent ndërkombëtar	

1. **Ministria e Mbrojtjes**

   Është aktori kryesor dhe vendimmarrësi në zhvillimin e sistemit të MRF. Aktualisht, AKMC është pjesë e strukturës së MM-së. Si e tillë, MM-ja luan një rol të rëndësishëm në vendosjen e drejtimeve strategjike dhe objektivave të AKMC-së sikurse harton dhe mbikëqyr zbatimin e politikave të ZRF dhe të MC. Fusha e përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe kompetencat për realizimin e saj parashikohen në ligjin nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e drejtimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", të ndryshuar. Neni 34, pika 1, shkronja "a" e Ligjit 45/2019 parashikon që FA duhet të angazhohen në operacionet e ciklit të menaxhimit të fatkeqësive nëse kapacitetet e tjera në dispozicion janë të pamjaftueshme për këtë qëllim, duke mbështetur institucionet, autoritetet qendrore dhe vendore dhe komunitetin. Një nga

strukturat në varësi të MM është Qendra Kombëtare e Kërkimit Shpëtimit. Në varësi të MM janë Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit.
Veprimtaria e MM lidhet me të gjitha risqet dhe sipas rastit në të gjitha fazat e menaxhimit emergjent.
Disa nga ligjet dhe strategjitë e MM të lidhura me MRF janë:

- Ligji nr. 64/2014 "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë";
- Ligji nr.10 435, datë 23.6.2011 "Për shërbimin e kërkim-shpëtimit në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji nr.9224, datë 29.4.2004 "Për Shërbimin Meteorologjik Ushtarak";
- "Strategjia Kombëtare për mospërhapjen e armëve të dëmtimit në masë dhe të planit të veprimit për zbatimin e saj" miratuar me VKM nr. 33, datë 22.1.2020;
- Strategjia ushtarake të Republikës së Shqipërisë e miratuar me ligjin nr. 72/2015;
- "Dokumenti i rishikimit të strategjisë së mbrojtjes të Republikës së Shqipërisë" miratuar me VKM nr. 628, datë 25.9.2019.

2. **Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile**
Është aktori kryesor në konfigurimet aktuale të sistemit të MC në vend. Është agjencia udhëheqëse e cila ka përgjegjësi të drejtpërdrejtë për të siguruar zhvillimin e kapaciteteve të MRF-së në vend dhe angazhimin e aktorëve të tjerë kyç në fusha specifike funksionale. Ajo ka për detyrë të koordinojë punën për hartimin e SKZRF, PKEC dhe VRF në nivel qendror. AKMC organizon punën për ngritjen e kapaciteteve të strukturave të mbrojtjes civile në nivel qendror dhe vendor, si dhe trajnimin e subjekteve private dhe vullnetare. Në nivel vendor, sipas nenit 23, pika 4 të ligjit 45/2019, Agjencia organizohet dhe funksionon nëpërmjet qendrave të mbrojtjes civile në qark.

3. **Ministria e Brendshme**
Është një aktor i rëndësishëm në sistemin e MC në vend. Përveç rendit dhe sigurisë publike, MB ka për detyrë a) bashkërendimin me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shoqatat e të zgjedhurve vendorë; b) hartimin e politikave, koordinimin dhe mbikëqyrjen e shërbimit të MZSH; c) ruajtjen dhe sigurinë e territorit dhe ndërtimeve. Ministria e Brendshme kontribuon në menaxhimin e emergjencave nëpërmjet strukturave në varësi të saj si Policia e Shtetit, Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së; Agjencia për Mbështetjen e Vetëqeverisjes Vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Politikave për Çështjet Vendore dhe Prefekturat dhe Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.
Veprimtaria e MB lidhet me të gjitha risqet. Ligjet kryesore dhe strategjitë e MB të lidhura me MRF janë:
   - Ligji nr. 108/2014 "Për policinë e shtetit", i ndryshuar;
   - Ligji nr. 152/2015 "Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin";
   - Ligji nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar;
   - Ligji nr. 107/2016 "Për prefektin e qarkut";
   - "Strategjia Ndërsektoriale e luftës kundër krimit të Organizuar, trafiqeve të Paligjshme dhe terrorizmit, 2013-2020 dhe planit të veprimit për vitet 2013-2016" miratuar me VKM nr. 663, datë 17.7.2013, të ndryshuar;
   - Strategjia kombëtare për migracionin dhe plani i veprimit 2019-2022 miratuar me VKM nr. 400, datë 19.6.2019;
   - "Strategjia ndërsektoriale e menaxhimit të integruar të kufirit 2021–2027 dhe të planit të veprimit 2021–2023", e miratuar me VKM nr. 1117, datë 16.12.2020".

4. **Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme.**
Misioni i Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme është hartimi dhe zbatimi i politikave të jashtme, drejtimi teknik dhe bashkërendimi i procesit të integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian, zhvillimi dhe fuqizimi i diplomacisë ekonomike, si dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve shqiptarë dhe komuniteteve shqiptare jashtë vendit.
Në gjendje të qetë dhe gjatë gjendjes emergjente, MEPJ kujdeset për të gjitha marrëveshjet ndërkombëtare në fuqi dhe ato në proces sikurse krijon lidhjet e nevojshme me shtete, organizma dhe struktura të huaja, të cilat ofrojnë ndihmë të çdo lloji për përballimin e emergjencave civile. MEPJ mbështet komunikimin me shtetet apo organizatat ndërkombëtare për çështje të MRF dhe në veçanti për rastet e marrjes apo dhënies së asistencës ndërkombëtare. Veprimtaria e MEPJ lidhet me të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent dhe roli i saj pritet të rritet në kuadër bashkëpunimit të shtuar me MMC BE pas anëtarësimit të Shqipërisë në të, por dhe më gjerë, në kuadër të proceseve të përafrimit për anëtarësim në BE.

5. **Ministria e Financave dhe Ekonomisë.**
Angazhimi i palëve të interesuara në MRF është i lidhur kryesisht me menaxhimin e burimeve financiare, aplikimin e procedurave ligjore doganore, adresimin e nevojave për përgjigje dhe rimëkëmbje në subjektet private, infrastrukturën publike dhe kritike.
Për vetë karakteristikat institucionale të MFE, veprimtaria dhe përgjegjësitë e saj lidhen me risqe të shumëfishta në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent.
Ligji kryesor i MFE dhe që lidhen me MRF është Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;

6. **Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë.**
MIE ka si mision hartimin e zbatimin e politikës së përgjithshme shtetërore në sektorin e planifikimit dhe të zhvillimit urban, në sektorin e infrastrukturës e të transportit, në sektorin e telekomunikacionit dhe të shërbimit postar, në sektorin e energjisë, të shfrytëzimit të burimeve energjetike e minerare, si dhe në sektorin e industrisë.
Për shkak të fushës së gjerë të përgjegjësisë shtetërore të MIE, angazhimi i saj është në të gjitha fazat e MRF dhe për shumë prej risqeve.
Legjislacioni i MIE përbëhet nga shumë ligje dhe bazë nënligjore e fushave të energjisë, transporteve, industrisë, zhvillimit urban, telekomunikacionit dhe postës, disa prej të cilëve janë më poshtë:
   - Ligji nr.9918, datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë";
   - Ligji nr. 118/2012 "Për transportin e mallrave të rrezikshme";
   - Ligji nr.9126, datë 29.7.2003 "Për përdorimin civil të lëndëve plasëse në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
   - Ligji nr.10 304, datë 15.7.2010 'Për sektorin minerar në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar;
   - VKM nr. 811, datë 16.11.2016 "Për miratimin e strategjisë sektoriale të transportit dhe planit të veprimit 2016–2020";
   - VKM nr.643, datë 14.9.2011 "Për miratimin e strategjisë kombëtare sektoriale të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve";
   - VKM nr. 480, datë 31.7.2018 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të energjisë për periudhën 2018–2030".

7. **Ministria e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural**

MBZHR ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së gjësë së gjallë mishërohet në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile" duke përbërë njërën nga 5 shtyllat e tij.

MBZHR ka si mision hartimin e zbatimin e politikave në fushat e bujqësisë, zhvillimit rural, veterinarisë, ushqimit dhe sigurisë ushqimore, peshkimit, akuakulturës, pyjeve drufrutorë.

Disa nga funksionet më kryesore të MBZHR janë më poshtë:

Mbrojtja e tokës nga erozioni; mbrojtja e burimeve dhe e rezervave ujore; mbrojtja e kafshëve nga sëmundjet dhe parandalimi i përhapjes së tyre; garantimi i qëndrueshmërisë, mirëmbajtja dhe shfrytëzimi sipas rregullave i rezervuarëve; inspektimi i kushteve optimale të prodhimit, magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të produkteve ushqimore, blegtorale dhe bujqësore; inspektimi i kushteve të magazinimit, tregtimit dhe përdorimit të preparateve të mbrojtjes së bimëve; ushtrimi i kontrollit në vendkalimet kufitare, për parandalimin e transmetimit të sëmundjeve në bimë dhe në kafshë; mirëmbajtja, monitorimi dhe vënia në gatishmëri e sistemit të kanalizimeve, pritave, argjinaturave dhe sistemeve të pompimit; Riaftësimin e zonave të përmbytura.

Disa nga ligjet dhe dokumentet strategjike të MBZHR që lidhen me MRF janë renditur më poshtë:

- Ligji nr. 24/2017 "Për administrimin e ujitjes dhe të kullimit";
- Ligji nr.9244, datë 17.6.2004 "Për mbrojtjen e tokës bujqësore", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9863, datë 28.1.2008, "Për ushqimin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 10 465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji Nr.8681, datë 2.11.2000 "Për projektimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e digave dhe dambave", i ndryshuar;
- VKM Nr. 437, datë 17.5.2017 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e drejtorive të ujitjes dhe të kullimit Lezhë, Durrës, Fier dhe Korçë";
- VKM nr.147, datë 18.3.2004 "Për miratimin e rregullores për sigurinë e digave dhe te dambave";
- Urdhër i Ministrit të Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural nr. 370, datë 11.6.2019 "Për miratimin e statutit tip të organizatës së përdoruesve të ujit";
- Strategjia kombëtare e ujitjes dhe kullimit 2019–2031 dhe e planit të veprimit miratuar me VKM nr. 345, datë 22.5.2019;
- Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027, miratuar me VKM nr. 73, datë 7.2.2018;
- Strategjia ndërsektoriale për zhvillimin rural dhe bujqësor 2014-2020, miratuar me VKM nr. 709, datë 29.10.2014, e ndryshuar.
- Strategjia kombëtare të peshkimit 2016–2021miratuar me VKM nr. 701, datë 12.10.2016;

8. **Ministria e Arsimit dhe Sportit**

MAS ushtron veprimtarinë e saj, në përputhje me legjislacionin përkatës, kryesisht, por jo vetëm, në fushat e përgjegjësisë shtetërore, si dhe çdo fushë tjetër përgjegjësie që i ngarkohet, si më poshtë vijon:

- arsimi parauniversitar;
- arsimi i lartë;
- zhvillimi i sportit;
- kërkimi shkencor.

MAS është një aktor shumë i rëndësishëm në të gjithë ciklin e menaxhimit emergjent. Detyra specifike të MAS përcaktohen në ligjin 45/2019 dhe PKEC.

Legjislacioni MAS që lidhet me MRF është si më poshtë:

- Ligji nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë";
- Ligjin Nr.79/2017, datë 27.04.2017 "Për sportin", i ndryshuar.
- Strategjia kombëtare për arsimin 2021–2026 dhe planin e veprimit për zbatimin e saj e miratuar me VKM nr. 621, datë 22.10.2021

Disa detyra specifike të MAS që mund të veçohen në të gjithë ciklin e menaxhimit emergjent janë garantimi i sigurisë së ambienteve mësimore ndaj fatkeqësive, përgatitja e PEC dhe trajnimi i nxënësve, studentëve dhe personelit mësimdhënës për rastet e fatkeqësive, organizimi dhe përkujdesja e duhur për nxënësit dhe studentët gjatë emergjencave etj.
Për vetë karakteristikat e MAS, ajo ka një kontribut në të gjithë ciklin e menaxhimit emergjent sikurse për të gjitha llojet e fatkeqësive.

9. Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale

MSHMC ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së jetës së njeriut mishërohet në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile" duke përbërë njërën nga 5 shtyllat e tij.
MSHMS ka për mision hartimin e zbatimin e politikave dhe të strategjive të zhvillimit në sektorin e kujdesit shëndetësor, është përgjegjëse për rregullimin e shërbimeve të kujdesit shëndetësor e për bashkërendimin e punës ndërmjet të gjithë aktorëve, brenda dhe jashtë sistemit të kujdesit shëndetësor, të cilët kontribuojnë dhe synojnë të garantojnë të drejtën kushtetuese, të përcaktuar në nenin 55, të Kushtetutës. Ajo ka si mision, gjithashtu, garantimin e të drejtave kushtetuese për mbrojtje e përfshirje sociale dhe përkujdesje sociale e shanse të barabarta.
Përfshirja e MSHMS është në të gjitha fazat e ciklit të menaxhimit emergjent dhe për të gjitha llojet e risqeve.
Disa nga ligjet dhe dokumentet strategjike më të lidhura me MRF janë renditur më poshtë:

- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar;
- Nr.10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 147/2014 "Për shërbimin e urgjencës mjekësore";
- Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", i ndryshuar;
- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";
- Nr. 93/2014 "Për përfshirjen dhe aksesueshmërinë e personave me aftësi të kufizuara";
- Ligji nr.9970, datë 24.7.2008 "Për barazinë gjinore në shoqëri";
- Ligji nr.10 221, datë 4.2.2010 "Për mbrojtjen nga diskriminimi", i ndryshuar;
- Strategjia e zhvillimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor parësor në Shqipëri 2020-2025 e miratuar me VKM nr. 405, datë 20.5.2020;
- Strategjia kombëtare e shëndetësisë 2021-2030 e miratuar me VKM nr. 210, datë 6.4.2022.
- Dokumentit politik "Reforma e vlerësimit të aftësisë së kufizuar në sistemin e mbrojtjes sociale dhe plani i veprimit 2019–2024 për zbatimin e tij", i miratuar me VKM nr. 380, datë 5.6.2019;
- Strategjia kombëtare e mbrojtjes sociale, 2020–2023, dhe plani i veprimit në zbatim të saj, të miratuar me VKM nr. 866, datë 24.12.2019;

- Strategjia kombëtare për barazinë gjinore, 2021–2030, dhe plani i saj i veprimit, të miratuar me VKM nr. 400, datë 30.6.2021;
- Plani kombëtar për personat me aftësi të kufizuara, 2021–2025 i miratuar me VKM nr. 276, datë 12.5.2021.

10. Ministria e Turizmit dhe Mjedisit

MTM ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së mjedisit mishërohet në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile" duke përbërë njërën nga 5 shtyllat e tij.
MTM ka si mision hartimin e zbatimin e politikave që synojnë mbrojtjen e mjedisit, mbrojtjen nga ndryshimet klimatike, përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore, mbrojtjen e natyrës dhe të biodiversitetit, zhvillimin e qëndrueshëm të pyjeve e kullotave, monitorimin e cilësisë së ujërave, si dhe hartimin e zbatimin e politikave për turizmin.
MTM, për shkak të fushës së saj të përgjegjësisë shtetërore ka një rol të shumëfishtë në sistemin e MRF. Veprimtaria e saj bazohet në:

- Ligjin nr. 57/2020 "Për pyjet";
- Ligjin nr.10 431, datë 9.6.2011, "Për mbrojtjen e mjedisit", të ndryshuar;
- Ligjin nr. 8906, datë 6.6.2002 "Për zonat e mbrojtura"
- Ligjin nr. 91/2013 "Për vlerësimin strategjik mjedisor";
- VKM nr. 814, datë 31.12.2018 "Për miratimin e dokumentit të politikave për pyjet në Shqipëri, 2019–2030";
- Ligjin nr.162, datë 04.12.2014 "Për mbrojtjen e cilësisë së ajrit në mjedis", i ndryshuar;
- VKM Nr.290, datë 30.4.2004 "Për miratimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të zjarreve në pyje dhe kullota";
- Dokumentin e politikave strategjike dhe të planit kombëtar për menaxhimin e integruar të mbetjeve, 2020–2035, të miratuar me VKM nr. Nr. 418, datë 27.5.2020;
- "Planin kombëtar për menaxhimin e cilësisë së ajrit" të miratuar me VKM nr. 412, datë 19.6.2019;
- "Dokumentin strategjik dhe planet kombëtare për zbutjen e gazeve me efekt serrë dhe për përshtatjen ndaj ndryshimeve klimatike" miratuar me VKM nr. 466, datë 3.7.2019;
- "Strategjinë ndër sektoriale të mjedisit", të miratuar me VKM nr. 847, datë 29.11.2007;

11. Ministria e Drejtësisë

Ministria e Drejtësisë është organi përgjegjës për zbatimin e politikës së drejtësisë, në kërkim të respektimit të Kushtetutës, të ligjeve, realizimit dhe mbrojtjes së dinjitetit, të të drejtave të njeriut dhe lirive themelore dhe kontribuon në parandalimin e shkeljeve të ligjit, në përputhje dhe në funksion të kërkesave të zhvillimit demokratik e të integrimit evropian të Republikës së Shqipërisë.
Ministria e Drejtësisë vepron në bazë të ligjit 45/2019 dhe legjislacionit tjetër që lidhet me fushën e veprimit të saj në MRF.
Veprimtaria e MD ka të bëjë me nxjerrjen e akteve ligjore të lidhura me MRF sikurse me veprimtari të tjera gjate fazave të ciklit te menaxhimit emergjent të lidhura me institucione të varësisë siç janë Drejtoria e Përgjithshme të Burgjeve.

12. Ministria e Kulturës

MK ka një rol veçanërisht të rëndësishëm që buron nga fakti se garantimi i mbrojtjes së trashëgimisë kulturore është njëri nga 5 shtyllat e mishëruara në qëllimin dhe objektin e ligjit "Për mbrojtjen civile".
MK angazhohet në parandalimin, lehtësimin dhe rindërtimin e objekteve kulturore si dhe në ruajtjen e vlerave të monumenteve të kulturës, prekur nga emergjenca. Gjatë emergjencave merr masa për mbrojtjen e jetës së spektatorëve, të popullsisë, të vlerave kulturore dhe objekteve monumentale e muzeale.
Veprimtaria e MK lidhet me legjislacionin si më poshtë:

- Ligjin nr. 27/2018 "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë";
- VKM nr. 420, datë 15.6.2022 "Për marrjen e masave për ruajtjen e trashëgimisë kulturore në rastet e fatkeqësive natyrore dhe konflikteve të armatosura";
- Strategjinë kombëtare për kulturën, 2019–2025 të miratuar me VKM nr. 903, datë 24.12.2019.

13. Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore

Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujore është person juridik publik në varësi të Kryeministrit dhe është krijuar me VKM Nr. 221 datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", të ndryshuar.
Misioni i Agjencisë është mirëqeverisja e burimeve ujore me qëllim përmbushjen e të gjitha nevojave jetësore, duke mbajtur në vëmendje qëndrueshmërinë e ekosistemeve, duke nxitur konkurrueshmërinë e përdorimeve dhe prioritizimin drejt përfitueshmërisë ekonomike. Agjencia organizohet dhe funksionon në përputhje dhe në zbatim të ligjit 111/2012, "Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore", të ndryshuar. Veprimtaria e AMBU lidhet më së shumti me risqet hidrologjike. Agjencia organizohet në nivel qendror dhe në nivel baseni ujor nëpërmjet zyrave të administrimit të baseneve ujore, degë të saj, në përputhje me basenet ujore të miratuara me vendim të Këshillit të Ministrave.
Legjislacioni dhe strategjitë e AMBU të lidhura veçanërisht me MRF janë:

- VKM Nr. 1015, datë 16.12.2020 "Për përmbajtjen, zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë kombëtare të menaxhimit të burimeve ujore, të planeve të menaxhimit të baseneve ujore dhe planeve të menaxhimit të rrezikut nga përmbytjet";
- VKM Nr. 221 datë 26.4.2018 "Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore", i ndryshuar;
- Strategjia kombëtare e menaxhimit të integruar të burimeve ujore, 2018–2027, miratuar me VKM nr. 73, datë 7.2.2018.

14. **Instituti i Gjeoshkencave**

Është institucion kërkimor dhe shkencor i krijuar me Urdhrin Nr. 371, datë 28.7.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës "për krijimin e Institutit të Gjeoshkencave dhe Energjisë, Ujit dhe Mjedisit (IGJEUM), pranë Universitetit Politeknik të Tiranës. IGJEO është një aktor i rëndësishëm në fushën e zhvillimit të njohurive dhe të kuptuarit të risqeve ekzistuese dhe të mundshme nga fatkeqësitë. IGJEO është identifikuar si struktura kombëtare monitoruese dhe paralajmëruese për aktivitetin meteorologjik, hidrologjik dhe sizmologjik në Shqipëri. IGJEO është pjesë e Universitetit Politeknik të Tiranës. IGJEO i jep informacion AKMC-së dhe institucioneve, agjencive dhe strukturave të tjera nëpërmjet "Qendrës Kombëtare për Parashikimin dhe Monitorimin e Rreziqeve Natyrore" dhe "Qendrës Kombëtare të Monitorimit të Aktivitetit Sizmik". Gjithashtu, IGJEO siguron informacion të vazhdueshëm dhe bashkëpunon me strukturat e tjera të emergjencave civile në nivel vendor në analizimin dhe monitorimin e situatës, si dhe informimin e rregullt.
Veprimtaria e IGJEO lidhet me risqet gjeologjike, hidrologjike, atmosferike dhe biofizike

15. **Shërbimi Gjeologjik Shqiptar**

Është institucioni këshillimor teknik dhe shkencor nën Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë dhe ushtron aktivitete në fushën e shkencave të tokës në territorin e Republikës së Shqipërisë. Veprimtaria e SHGJSH bazohet në ligjin 111/2015, "Për Shërbimin Gjeologjik Shqiptar", i cili përcakton marrëdhëniet ndërmjet këtij institucioni dhe palëve të tjera publike dhe private.

Veprimtaria SHGJSH dhe përgjegjësitë e saj lidhen më së shumti me risqet gjeologjike.

16. **Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit**

Është autoritet me përgjegjësi planifikimi, në varësi të ministrisë përgjegjëse për çështjet e planifikimit dhe zhvillimit të territorit. Misioni i saj është të kontribuojë për zhvillimin e qëndrueshëm të territorit të udhëhequr nga strategjitë e mirëplanifikuara dhe programet afatmesme e afgjata të zhvillimit; të sigurojë zbatimin e ligjit dhe akteve nënligjore në fuqi që garantojnë mirëplanifikimin e territorit; si edhe të mbështesë dialogun profesional në fushën e planifikimit të territorit, duke përhapur njohuritë e fituara gjatë eksperiencës së saj në këtë fushë. Në këtë kuadër, AKPT harton në bashkëpunim dhe bashkërendon proceset e hartimit të dokumenteve të planifikimit të territorit, si dhe siguron bashkërendimin ndërmjet autoriteteve të planifikimit të territorit, si atë horizontal (mes institucioneve të pushtetit qendror), ashtu edhe atë vertikal (mes institucioneve vendore e qendrore). Gjithashtu, AKPT udhëheq, koordinon dhe ndërlidh veprimtaritë për modernizimin e modelit të planifikimit dhe promovimin e praktikave novatore në projektim urban dhe planifikim.

Baza Ligjore për krijimin e AKPT është ligji 107/2014 "Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit", i ndryshuar dhe VKM Nr. 427, datë 08.06.2016 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit".

Për vetë karakteristikat institucionale të AKPT, veprimtaria dhe përgjegjësitë e saj lidhen me risqe të shumëfishta dhe më së shumti në fazat e lehtësimit/zbutjes dhe atë atë të rimëkëmbjes.

17. **Instituti i Shëndetit Publik**

Veprimtaria e ISHP bazohet në ligjin nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar.

ISHP në varësi të MSHMS, është Qendra Kombëtare në fushën e shëndetit publik dhe ka mision të tij zhvillimin dhe aplikimin e parandalimit dhe kontrollit të sëmundjeve, dëmtimeve, paaftësive, e faktorëve dëmtues shëndetësorë të mjedisit, dhe zhvillimin dhe aplikimin e promocionit të shëndetit, në bashkëpunim të ngushtë me agjensi/organizma/organizata kombëtare dhe ndërkombëtare.

ISHP është përgjegjës për:

- Informimin, këshillimin dhe mbështetjen e MSHMS në hartimin e politikave dhe të strategjive në fushën e shëndetit publik;
- Sigurimin e ekspertizave;
- Realizimin e studimeve të pavarura dhe prodhimin e informacioneve, bazuar në fakte; Pjesëmarrjen në formimin e burimeve njerëzore në shëndet publik.

Disa nga ligjet dhe dokumente strategjike me të cilët lidhet veprimtaria e ISHP janë:

- Ligji nr.10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", i ndryshuar;
- Nr.10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 15/2016 "Për parandalimin dhe luftimin e infeksioneve dhe sëmundjeve infektive", i ndryshuar;
- Ligji nr. 121/2016 "Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë";

- Ligji nr.8025, datë 9.11.1995 "Për mbrojtjen nga rrezatimet jonizuese", i ndryshuar.
- Strategjia kombëtare e shëndetësisë 2021-2030 e miratuar me VKM Nr. 210, datë 6.4.2022.

18. **Drejtoria e Njësisë së Koordinimit të Programeve të Zhvillimit dhe Planifikimit Strategjik në Departamentin e Programit të Zhvillimit, Financimit dhe Asistencës në Kryeministri.**
SASPAC është krijuar me VKM nr. 642, datë 29.10.2021 "Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Shtetërore të Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës" SASPAC është person juridik publik buxhetor, në varësi të Kryeministrit. SASPAC-ja ka si mision koordinimin e ndihmës së huaj për programet dhe projektet zhvillimore, asistimin e strukturave vendimmarrëse për hartimin e SKZHI dhe monitorimin e zbatimin e saj, ofrimin e mbështetjes metodologjike në hartimin e strategjive ndërsektoriale dhe sektoriale, me qëllim harmonizimin e tyre me SKZHI-në, si dhe monitorimin e zbatimit të tyre, koordinimin e procesit të administrimit të projekteve me interes kombëtar, ofrimin e mbështetjes për institucionet e administratës shtetërore për rritjen e kapaciteteve në fushën programeve dhe projekteve zhvillimore.

VENDIM
Nr. 96, datë 22.2.2023

PËR MIRATIMIN E FORMATIT TË AKTIT ADMINISTRATIV QË VENDOS MASËN ADMINISTRATIVE DHE LLOJIN E MASAVE, QË PËRBËJNË SHKAK PËR KUFIZIMIN E HYRJES

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 6, pika 1, shkronja "dh", e 141, pika 3, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Masat administrative, të cilat përbëjnë shkak për kufizimin e hyrjes, sipas ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", janë, si më poshtë vijon:

a) Urdhër largimi, nëse në të përcaktohet kufizim lidhur me ndalimin e hyrjes;

b) Urdhër dëbimi nga autoriteti përgjegjës vendor për kufirin dhe migracionin;

c) Urdhër dëbimi nga ministri i Brendshëm, si pasojë e shpalljes të të huajit person i padëshiruar.

2. Masat administrative, të parashikuara në nenin 141, të ligjit nr. 79/2021, "Për të huajt", vendosen nga autoriteti shtetëror përgjegjës vendor, sipas formatit të aktit administrativ, të parashikuar në aneksin nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

3. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

ANEKSI NR. 1

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit
Departamenti për Kufirin dhe Migracionin
Drejtoria Vendore për Kufirin dhe Migracionin

Nr. 00000000000

_____, më _____

PROCESVERBAL I KONSTATIMIT TË KUNDËRVAJTJES
RECORD OF FINDING OF THE OFFENCE

Data, vendi, konstatuesi *Date, place, authority*	Sot më datë (*data, muaji, viti),* _____ ora _____, në vendin _____ *(emri i plotë i vendit).* Today on *(date, month, year),* _____ at _____ at the place_____*(full denomination of the place)* . Unë _____*(grada, emri, mbiemri i punonjësit të policisë)*, me detyrë_____ (*funksioni).* I _____ *(tank, full name of police employee),* in the position of _____ *(function).* **Konstatova se:** Found:_____
Kundërvajtësi *Offender*	_____ (*emri, atësia, mbiemri i plotë i Kundërvajtësit/first name, father's name, family name of the offender)* Pasaporta nr._____, lëshuar në _____ Passport no. _____, issued on Adresa në Republikën e Shqipërisë_____*(adresa e plotë e kundërvajtësit)* Address in the Republic of Albania_____ *(full address of the offender)*
Shkelja e konstatuar *Found violation*	Ka shkelur ligjin nr. _____, datë _____ , neni ___, pika ____ shkronja _____. _____ Has violated law No. _____, date _____, article____, paragraph ____ letter _____ _____ _____ _____ *Shkruani referencën e ligjit për shkeljen e konstatuar dhe një përshkrim të shkeljes / Write the law reference for the found violation and a description of the offence*
Deklaratë *Statement*	Kundërvajtësi deklaron: *Offender statement*_____ _____ _____ _____

Për shkaqet e sipërshënuara vendosa:
Considering the foregoing reasons, I decided:

SANKSIONI: Të gjobitet me (_____) lekë.
SANCTION: *Imposition of a fine* (_____) *All.*

KUNDËRVAJTËSI (*Emri, mbiemri i kundërvajtësit*) _____
OFFENDER *(First name, family name of the offender)*

PËRPILUESI I PROCESVERBALIT _____
(Grada, emri, mbiemri i punonjësit te policisë)
RECORD PREPARED BY _____ ***(****Rank, first name, family name of the police employee)*

Shënim. Likuidimi i gjobës bëhet brenda 10 ditëve nga data që ky akt administrativ ka marrë formë të prerë. Pas kalimit të këtij afati, për çdo ditë vonesë paguhet 2% kamatëvonesë.
Note: *Liquidation of the fine is done within 10 days from the date that the decision has become final. After this deadline, 2% late interest is paid for each day of delay.*

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Vulosur elektronikisht nga Qendra e Botimeve Zyrtare
Viti: 2023 - Numri: 31
Datë: 2023/02/24 13:35:56
099f9b27-e232-4aa5-ae19-20d532632f74

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 1312 lekë